AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

STUDIME

Revistë për studime filologjike

21

2014

PRISHTINË
2014

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS

STUDIME

A Review for philological Studies

21

2014

Del një herë në vit.
Published annually.

Këshilli redaktues - Editorial Board

Rexhep Ismajli - Kryeredaktor, editor-in-chief
Eqrem Basha - Sekretar, secretary
Victor A. Friedman, anëtar, member
Teuta Abrashi, anëtar, member
Mehmet Kraja, anëtar, member

Idriz Ajeti, Kryeredaktor nderi - Editor-in-chief of honour

Adresa e Redaksisë / Address:

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës
Redaksia e revistës “Studime”
Rr. Agim Ramadani, p.n.
10 000 Prishtinë
Republika e Kosovës
Tel. + 381 38 249 303
Fax. + 381 38 244 636
E-mail: ashak@ashak.org

Copyright © ASHAK

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës
Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë

NË 200-VJETORIN E LINDJES SË JERONIM DE RADËS

Tryezë shkencore

21 nëntor 2014

Me rastin e shënimit të 200-vjetorit të lindjes së poetit të madh arbëresh, veprimtarit të shquar të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, Jeronim De Rada, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i AshAK-ut organizoi një Tryezë shkencore për figurën dhe veprimtarinë e tij. Në tryezë u lexuan 16 kumtesa. Redaksia e revistës *Studime* ka vendosur t'i botojë të gjitha. Kumtesat botohen sipas radhitjes në programin e tryezës.

Redaksia

PROGRAMI

09:00

Seanca I

1. Ali Aliu: Karakteri testamental i veprës Parimet e estetikës të De Radës;
2. Françesko Altimari: Mbi strukturën e dyfishtë të poemës Këngët e Milosaut të Jeronim De Radës;
3. Floresha Dado: De Rada i papërfunduar;
4. Sabri Hamiti: Milosao e lirika shqipe;
5. Pajazit Nushi: Ndjenjat estetike në veprën e Jeronim De Radës Parime të estetikës dhe në veprën e Uiliam Xhejmsit Parime të psikologjisë;
6. Dhurata Shehri: Ndërtimi i figurës në veprën e De Radës;
7. Luan Starova: Jeronim De Rada – Faik Konica: një dikotomi në kërkimin e identitetit shqiptar;
8. Alfred Uçi: De Rada përballë Rilindjes Kombëtare Shqiptare

Pushim

Seanca II

1. Mateo Mandalà: Jeronim De Rada dhe arbëreshët e Sicilisë;
2. Ymer Çiraku: Qasje rivlerësimi rreth opusit të kritikës mbi veprën deradiane;
3. Zejnullah Rrahamani: Estetika si teori e artit romantik;
4. Ardian Marashi: Vendi i Milosaos në romantizmin europian;
5. Fatmir Sulejmani: Personazhet iluzione;
6. Mark Marku: Narrativa e De Radës: nga narrativa personale tek metanarrativa;
7. Kujtim Shala: Mësimet e De Radës;
8. Mehmet Kraja: Një rilexim i Rapsodive...

Ali ALIU, Prishtinë

VIZIONI TESTAMENTAR I JERONIM DE RADËS TE PARIME TË ESTETIKËS

KDU 821.18' 282.4(450).09

Pas një rileximi të veprës Parime të Estetikës, në këtë përvjetor të madh të letërsisë shqipe, m'u nxit ngasja për të veçuar refleksin misionar, përkatësisht frymën testamentare që reflekton nga ajo. Duke shfletuar edhe veprat e tjera të shkrimtarit të madh, refleksi i mësipërm fare natyrshëm shtrihet mbi tërë krijimtarinë letrare të tij. Ecur më tej dhe tutje, gjithnjë në vijë të këtij refleksi, fundja, arti përgjithësisht rrezaton këtë ngasje që nga fillimet...

Vepra Parime të Estetikës, i bart idetë dhe shqetësimet autentike, iluzionet, thellimet teoriko-estetike dhe filozofike të arbëreshit të madh. De Rada e shkruan testamentin e tij estetik duke iu drejtuar arbëreshëve, duke pasur parasysh edhe lexuesin italian dhe evropian, por gjithnjë me sytë e kthyer drejt atdheut të vet të humbur, përtej Adriatikut. Tërë kozmopolitizmin dhe mediteranizmin antik do ta derdhë në librin Parime të Estetikës, vepër që është mbështetur në përvojat më të qëndrueshme dhe më të njohura të estetikës, artit dhe letërsisë botërore. Vlerë të veçantë, të dorës së parë, kjo vepër me karakter teoriko-estetik ka edhe për funksionin dhe misionin e theksuar pragmatik, të kërkojë zgjidhje të çështjeve themelore nga jeta e arbëreshëve, veçmas në drejtim të identitetit, të gjuhës dhe lashtësisë, të dëshmojë përkatësinë arbëreshe brenda familjes së madhe evropiane, afërsinë e saj me kulturën dhe lashtësinë antike europiane.

Tek libri Parime të Estetikës, që është i fushës teorike shkencore, fryma testamentare është e drejtpërdrejtë dhe përjashton çdo shteg për hamendësim, që nuk është e thënë edhe për krijimtarinë e fiksionit. Nuk ka dyshim se Jeronim de Rada në këtë vepër, bashkëvendësve dhe bashkëkombësve u përcjell porosi të përhershme, pra të përjetshme, të tillë çfarë

është edhe vepra e tij, porosi për origjinën, për rrënjët e etnisë dhe të kaluarën e lavdishme, për atdheun e të parëve, për gjuhën, gjuhën sidomos që ka bartur dhe ruajtur shpirtin arbëresh gjatë shekujve, veçmas përmes poemës për Skënderbeun. Dhe, siç thotë vetë Jeronim De Rada, të gjitha ato që e përbëjnë, që janë qenia, etnia, t'i kenë të shenjta...

Jeronim de Rada krijues, pa dyshim që është shkrimtar i përmasave të mëdha. Këtë rrezatim ka vepra që ka lënë. Këtyre lartësirave është besimi, vetëbesimi që ai kishte për mundësitë e veta, e kësaj lartësie është edhe kauza, i tillë edhe ëndërrimi i tij. Vjen i natyrshëm prandaj, edhe rrezatimi testamentar që ai ia kishte përcaktuar vetes në botën shqiptare arbëreshe të shekullit nëntëmbëdhjetë. Larg atdheut të të parëve, njësoj si edhe rilindësit e tjerë shqiptarë të pjesës së dytë të shekullit 19 dhe vatrat e tjera të para të zgjimit kombëtar, por edhe me përparësinë e kujtesës shpirtërore, bashkë me çrrënjosjen fizike, të parët e Jeroni De Radës me vete kishin marrë edhe një copë atdhe, një copë të gjallë të shpirtit shqiptar. Dhe e kishin ruajtur atë për katërqind vjet. Nga kjo perspektivë rrezatoi mbi hapësirën shqiptare gjeniu i arbëreshëve. Ai kishte me vete thesarin më të madh dhe gjuhën që ruante të gjallë eposin mbi heroizmin e Skënderbeut, të cilin ai si një i uritur që sa e hiqte pluhurin e kohës e ndjente shpërthimin e ndriçimit madhor të eposit. Kështu, që në rini nën hovin e dashurisë për vashën, nën veshjen e Milosaos, Jeronim De Rada edhe afshin intim nga Kalabria do ta vendosë në Shqipëri, atje do t'i vendosë ëndrrat e tij, familjen, betejat e veta, personazhet, natyrën, në Shkodrën e vet.

Por vepra Parime të estetikës, siç e thamë më sipër, këtë testament e përcjell si komunikim të drejtpërdrejtë, të qartë, si një vlerë shpirtërore madhore. Kapitulli i tretë i kësaj vepre, e pjesërisht edhe ai i fundit, kapitulli katër, për më shumë, shtyllë parësore e kanë këtë mision. Ajo që duhet veçuar nga ky kapitull i librit është analiza që De Rada i bën ndjenjës së patriotizmit, si një ndër veçoritë madhore të njeriut që e çmon edhe si manifest të bukurisë, të përsosmërisë. Porosia që rrezaton nga kjo pjesë e estetikës është objektivi dhe ëndrra që shtrihet në krejt rrugën krijuese dhe jetësore të de Radës. I shqetësuar që të mos e lërë në harresë tek bashkëkombësit e vet origjinën dhe rrënjët e të parëve, për ta bërë të përjetshme, për ta ngritur në këtë lartësi ideale ndërgjegjen kombëtare në botën shqiptare arbëreshe.

Rrezatimi i këtij misioni përmes teksteve fiksionale ndryshon vetëm gjuhën e diskursin. Tek parimet estetike, porosia vjen komunikim saktësisht i qartë përmes tekstit diskursiv, të cilin de Rada e shkarkon nga kornizat e rrepta të parimeve, të kodeve. Prandaj shumë kapituj dhe nënkapituj, por edhe pasuse të kësaj vepre, herë thuren me gjuhën e esesë, herë me ligjërimin bisedimor të llojit unë mendoj se të bukurit ose unë jam i bindur se dashuria për atdheun, ose unë them se e madhërishmja etj., me çfarë Jeronim de Rada dëshmon se dijen nga kjo sferë e ka përvojë, e ka formim jetësor, e ka bindje të brendshme, e ka perceptim të vetin jetësor dhe kulturor. Diskursi personalizues përballë disa parimeve estetike, përballë disa kategorive si e madhërishmja, e bukura, dashuria (të dashurit mirë – thotë De Rada), heroikja, trimëria, rrezaton një shpirt dhe mendje të madhe kreative, që le gjurmë të vetën kudo vë dorë. Parimet e estetikës nuk është tekst që vjen vetëm nga një ekspert, nga një specialist i një fushe për shërbime praktike shkollore, por vjen nga një dije, nga një perspektivë krijuese që merr dhe jep njëkohësisht.

Nga kjo lartësi e mendimtarit dhe misionarit, te vepra Parime të estetikës Jeronim de Rada do të vërë në lidhje dashurinë, të madhërishmen, bukurinë, si kategori të dijes së estetikës dhe filozofisë, me dashurinë për atdheun, për motin e madh, për gjuhën në hapësirën shqiptare arbëreshe, dashuri që do të rrezatojë dhe shtrihet mbi tërë hapësirën shqiptare të shekullit nëntëmbëdhjetë. Dhe, në këtë mënyrë ai i ngre kategoritë atdhe e gjuhë në dhunti njerëzore dhe në parime të shenjtë.

Dashuria dhe bukuria janë kategoritë estetike të De Radës të cilat shtrihen në hapësirën më të madhe të veprës. Po në këto lartësi vendosen edhe kategoritë atdhe, gjuhë, identitet, trimëri duke u barazuar mes vedi. Dashuria ndaj atdheut është natyrore dhe e lindur në njeriun... Dashuria ndaj atdheut rrënjoset në moshën e rinisë... Dashuria e madhe për ruajtjen e popullit të vet, për përparimin e të cilit, duhet që ta madhërojnë atë, ka qenë, është dhe do të jetë gjithherë në natyrën shpirtërore të çdo fisi, thotë De Rada që në kapitullin e dytë të Estetikës. E gjen këtë dashuri ai sidomos tek këngët popullore. S'ka popull në botë që t'i ketë të zbukuruara trimëritë e veta me këngë popullore, të veshura me vargje të thjeshta, në të cilat mishërohet shpirti shqiptar e dashuria ndaj atdheut, si ne shqiptarët.

Edhe pse Rapsodi i një poemi arbëresh u botua nga mesi i viteve gjashtëdhjetë, afërsisht kur edhe estetika, me medaljonet e para të poemit De Rada kishte kontaktuar tridhjetë vite më parë. Duke qenë i vetëdijshëm se bëhej fjalë për një kryevepër të llojit të vet, ai kishte objektivin që ta vinte edhe atë në shërbim të kauzës shqiptare: Bukuria e veçantë e këtyre këngëve të dala nga gjiri i popullit që lartësohet si mbrojtës i Evropës, bëri që këto të përhapeshin gjithandej në shekullin 15. Për ne shqiptarët, botimi i kësaj poeme do të ketë edhe efekte të tjera të dobishme. Në këtë poemë përshkruhen fitoret e fundit dhe thyerja e të parëve tanë me një vërtetësi aq të madhe sa secili që merret me historinë e kësaj kohe nuk mund t'i mohojë. Këto këngë për të gjithë ne janë monument më i vjetër i gjuhës shqipe dhe pasqyrë e dëshmisë e një të foluri të thjeshtë, të pastër e të fuqishëm.... Që nga momenti kur ai përqendrohet, me pasion të madh, në domethënien dhe rëndësinë e këngëve të vendlindjes, duke i trajtuar si rojtarë të dëshmisë së pavdekshme të jetës sonë të veçantë, thotë De Rada dhe do të ndalet tek pyetja; Çka shpreh gjuha shqipe nga shpirti ynë dhe pse ka rëndësi të veçantë për të gjithë arbëreshët?

Gjithnjë i përfshirë nga pesha dhe rëndësia e madhe, monumentale e rapsodive arbëreshe, De Rada do të vazhdojë Sa i përket Shqipërisë, do vazhdojë më tej De Rada, kah i kemi të kthyer sytë tanë, kjo poemë do të jetë një zë shumë i fortë e i përshtatshëm për të nxitur trimërinë e dikurshme. Dhe, siç shihet, të gjitha këto, De Rada i përfshin, i thotë në faqet e një teksti teorik shkencor që u dedikohet në radhë të parë nevojave praktike shkollore, pra të rinjve arbëreshë. Prandaj, shkon edhe më thellë ai, duke thënë: ... kënga kombëtare që përmban shpirtin dhe historinë e kohëve të saj jetike, i jep fuqi për rilindje kombëtare... Prandaj mund të themi se kjo këngë është e lidhur me fatin e Shqipërisë, sikur fjala e gjallë e një gjeniu mbrojtës....

Në kapituj të tërë të kësaj pjese të estetikës duket sikur kategoritë e kësaj fushe si e bukura, e madhërishmja, trimëria, heroizmi, mirësia të ishin dhuratë qiellore, thuaja të shenjta për autorin, që është paracaktuar t'i identifikojë me dashurinë arbëreshe për origjinën, e sidomos për rrënjët antike të shqiptarëve, t'i identifikojë me dashurinë e ngritur në adhurim shenjtëror për atdheun e të parëve, e veçmas me gjuhën dhe historinë, me

figurën e Skënderbeut dhe bëmat heroike të tij, t'i identifikojë ato kategori estetike me ciklin epik, monument madhor i gjeniut shqiptar arbëresh, i ruajtur në kujtesën arbëreshe katër shekuj me radhë, t'i barazojë ato me tërë atë që është shpirti dhe urtia arbëreshe: fillimi e themeli i çdo diturie është gjuha që popujve u mban gjallë kombësinë e tyre të shtrenjtë. Shtetet shkatërrohen e zhduken, trojet e disa fiseve zihen nga fiset e tjera, por e vetmja cilësi që e shquan një popull dhe e bën të njihet kudo ku mund ta hedhë fati është vetëm gjuha. Në këtë kontekst Jeronim De Rada do të shtrojë pyetjen: Çka shpreh gjuha shqipe nga shpirti ynë dhe pse ka rëndësi të veçantë për të gjithë arbëreshët posaçërisht, për njerëzit e shpërngulur dhe, çka duhet të çmohet si faktor kryesor i cili na lidh dhe na largon si fis, i respektuar mes tjerëve?. Gjithë në këtë frymë, de Rada besimin e vet të plotë ua përcjell bashkëvendësve duke thënë se gjuha mund të jetë deri, shpirti më i ndjeshëm i popullit.

I ekzaltuar për atë dhe nga ajo që gjeti të regjistruar në memorien arbëreshe Jeronim de Rada beson që gjuha shqipe, pra gjuha e bashkëkombësve të vet, është në sërën e gjuhëve më të zhvilluara të Europës, mbase superiore edhe përballë asaj italiane, greke, e mbase edhe asaj latine: për rrënjët e veta antike, thotë De Rada, por edhe për thjeshtësinë e saj me të cilën është e zonja të shprehë nuancat më bujare. Entuziazmi dhe bindja për këtë mundësi të veçantë shprehjeje vinte edhe nga besimi i de Radës se rrënjët antike të shqipes datojnë që nga pellazgo-ilirët dhe de Rada njësoj si edhe Skënderbeu i paracaktuar në fushën e betejave për çlirimin e atdheut, edhe ai qe i ardhur për ta vazhduar luftën e madhe pas humbjes së madhe që beson se e tillë e madhe ajo është humbje edhe për Europën. Dhe krejt çfarë thuhet në veprën Parime të estetikës, në të vërtetë është një thirrje për njohjen, për ruajtjen dhe për mostretjen e gjuhës shqipe dhe e shpirtit shqiptar dhe arbëresh.

Francesco ALTIMARI, Kozencë

MBI STRUKTURËN E DYFISHTË TË POEMËS *KËNGËT E MILLOSAUT*[1]: NJË PËRPJEKJE PËR NJË PËRQASJE TË RE NË INTERPRETIMIN E POEMËS SË JERONIM DE RADËS

KDU 821.18'282.4(450)-1.09

Po përpiqemi, brenda kohës së disponueshme që kemi për këtë kumtesë, të përqëndrohemi në vija të përgjithshme mbi strukturën e ashtuquajtur të dyfishtë të poemës deradiane. Në krahasim me interpretimin tonë të mëparshëm (Altimari 1998) që u përqëndrua mbi analizën e këtij termi për sa i përket strukturës së jashtme binjake që në origjinë i lidh dhe i ndërthur midis tyre poemat e para deradiane *Këngët e Millosaut* dhe *Kën-*

[1] Preferojmë të përdorim, në respekt të vullnetit të Autorit, që na rezulton qartas që prej analizës së dorëshkrimeve të para të tij arbërisht, trajtat *Millosa - Millosau*, lakuar sipas emrave të gjinisë mashkullore me zanore fundore të theksuar dhe jo *Milosao – Milosaoja*, të përshtatura shqip sipas lakimit të emrave femërore që dalin në -o duke u nisur nga trajta e italishtes *Milosao* dhe tashmë të bëra tradicionale në traditën shkrimore shqiptare. Por duhet saktësuar se në traditën studimore shqiptare trajta Millosau është më e hershme, por në formën Milosau, për shkak të varësisë së saj nga italishtja e shkruar dhe jo nga arbërishtja që kërkonte adaptimin e emrit me dyshkronjën <ll>! Milosau është përdorur në shqipërimin e poemës së De Radës në gjuhën bashkëkohëse shqipe të studiuesve Jup Kastrati (Tiranë 1956), Din Mehmeti (Beograd 1965), Andrea Varfi (Tiranë 1974, Tiranë 1976, Prishtinë 2002), ndërsa Milosao është ajo sot e standardizuar, qe përhapur nga Dhimitër S. Shuteriqi (Tiranë 1964, Tiranë 1976, Prishtinë 1980, Tiranë 1987). Edhe në botimin e fundit të veprave të De Radës të sapocituar, të përgatitur nga J. Kastrati, K. Kodra e P. Jorgoni, vazhdohet të ndiqet 'versioni' i Shuteriqit dhe jo ai i Kastratit, megjithëse studiuesi shkodran ishte ndër përgatitësve të botimit. Dhe sipas kësaj 'tradite' të nisur nga Dh. S. Shuteriqi, vazhduan ta përdorin trajtën Milosao dhe jo Millosau edhe autorë të tjerë në botimet e mëpasshme, si P. Çabej (Tiranë 1999), Gj. Zheji (Tiranë 2009), A.Toli (Tiranë 2009).

gët e Serafina Topias, ne do t' i referohemi këtu edhe strukturës së brendshme duale të poemës rinore deradiane. Dhe me këtë përpjekje të re interpretimi dëshirojmë të vëmë në pah një dualizëm tematik që na duket jo vetëm interesant, por edhe i volitshëm për të hyrë në thellësinë e kësaj poeme që na zbulon çdo herë që e lexojmë margaritarë të paimagjinueshme që na e zgjerojnë njohjen e botës së begatë dhe të madhe artistike të Jeronim De Radës, të këtij gjeniu të madh të letrave arbëreshe dhe shqiptare.

Viti 1836, kur u botua poema *Këngët e Millosaut*, shënon një kthesë epokale për letërsinë shqipe, e cila falë kësaj poeme hyn në erën moderne. Kjo poemë nuk mund të analizohet veçmas, vetëm duke ndjekur kronologjikisht tri botimet e shtypura – 1836, 1847 dhe 1873 –, pasi ajo përfaqëson bërthamën e një projekti letrar të veçantë që De Rada ndoqi gjatë gjithë jetës dhe veprimtarisë së tij të gjatë, paralelisht dhe në lidhje të ngushtë me poemën tjetër të tij *Këngët e Serafina Topias*. Këtë projekt binar autori e kishte përsiatur qysh përpara se ta kishte gati poemën për botim, posa që në letrën drejtuarmikut Raffaele Zagarese, që më pas u përfshi si parathënie e botimit të parë të *Këngëve të Millosaut*, më 1836, thotë se kishte menduar për një roman lirik të dyfishtë.

Por ky përkufizim që, siç dëftuam në botimin tonë kushtuar *Këngëve para Millosaut* (1998), autori ia vuri gabimisht një varianti jopërfundimtar të veprës, nuk i referohej vetëm kësaj poeme. Sikurse dihet tashmë, mbi këtë pohim u përqendrua vëmendja e shumë studiuesve të shquar të cilët u rrekën më kot të shpjegonin enigmën e romanit lirik të dyfishtë me dyzimin e tematikës – patriotike dhe dashurore – (teza e Shuteriqit) ose në frymëzimin – popullor dhe klasik- (teza e Pipës) të kësaj vepre.

Me të De Rada synonte të jepte një çelës leximi për të kuptuar strukturën binare, mund ta quajmë 'binjake', që karakterizonte projektin e tij letrar, i cili, sipas një varianti paraprak në shkrim e sipër që zbuloi Dh. Shuteriqi në vitin 1973 në Arkivin e Shtetit në Tiranë[2], përfshinte dy vepra bashkë: ato që A. Pipa quajti Proto Milosao A dhe Proto Serafina A[3].

---

[2] Një version i parë i 'Milosaos' dhe i 'Serafinës' së De Radës (f.35-119) në Dhimitër S. Shuteriqi, *Gjurmime letrare*, Shtëpia botuese 'Naim Frashëri', Tiranë 1974.

[3] A genesis of a Poetry (f.15-85) in Arshi Pipa, *Hieronymus De Rada*, Albanische Forschungen, Trilogia Albanica II, Dr.Dr.Rudolf Trofenik, München 1978.

Projekti binar vërtitej rreth këtyre dy figurave letrare që fitojnë tiparet e dy subjekteve eponimike: njëri mashkullor, Millosau, e tjetri femëror, Serafina Topia. Pikërisht ky fakt na shtyu të propozojmë qysh në vitin 1998 me botimin kritik të *Këngëve të para Millosaut* një interpretim të ri të romanit lirik të dyfishtë.

Përmes një analize të rreptë paratekstore që zbaton për të parën herë në studimin e veprës deradiane metodën strukturaliste të Gérard Genette-it, ky interpretim u shtjellua më tej nga Matteo Mandalà (Mandalà 2008), i cili e shtriu atë mbi të gjithë arkitekturën e veprës deradiane, duke na lejuar të zgjidhim kështu një sërë problemesh, ambuguitetesh, kundërshtish dhe inkoherencash që vihen re në strukturën editoriale të shumë veprave të tjera, e që shpesh i janë veshur padrejtësisht kushteve të vështira të shtypit të asaj kohe.

Millosau dhe *Serafina Topia* thuajse në mënyrë të ndërvarur dhe spekulare do të përfaqësojnë dy polet qendrore e strategjike të këtij projekti letrar – unë do ta quaja polisistemi letrar deradian - që do ta shoqërojë De Radën nga fillimi deri në fund të jetës së tij krijuese.

Projekti do të riformësohet disa herë dhe, sikurse e ka vënë në dukje Mandalà (2008), do të zgjerohet vazhdimisht duke përfshirë në pjesën e parë të romanit lirikbotimin e dytë të *Millosaut* (1847), ndërsa në pjesën e dytë jo më *Serafinën*, por një trilogji poemash me subjekte femërore, me titullin *L'Albania dal 1460 al 1487* (1848), që më pas u bë tetralogji, gjithmonë me subjekte femërore, me titullin *Rrëfimet e Arbërit* (1848).

Vizioni poetik dhe ideologjik i Poetit tonë, që u zgjerua dhe u zhvillua dora-dorës, e shtyu ta përfytyronte dhe ta paraqiste gjithë epokën e Skënderbeut me një metaforë të vetme qendrore që ai e quajti *Moti i Madh.* Në këtë makrostrukturë ideale hynin të gjitha veprat e tij me ngjarje që vendoseshin në kohën e Skënderbeut, pra në shek. XV.

Kështu, përmes riorganizimit dhe risistemimit të botimeve të mëparshme De Rada arriti qysh nga fillimi i viteve '70 të shek. XIX ta konceptonte tërë veprën e tij si një makrostrukturë të vetme të përbërë nga disa libra, secili syresh përfaqësonte një segment të *Historisë shqiptare të shek. XV*.

Kjo makrostrukturë me titullin e përbashkët *Skanderbeku i pa-fān* që sipas autorit do të përbëhej nga 12 libra, të cilët do të përfaqësonin veprën më të rëndësishme të poetit, u botua e paplotë me vetëm 6 libra në vitin 1884. Kjo përpjekje e vështirë për të rikrijuar poetikisht historinë e Arbrit të shek. XV, me një titull simbolik që evokon figurën e Skënderbeut – edhe pse në të vërtetë i pafat nuk ishte Skënderbeu, por Arbri pa Skënderbeun – paralajmërohet qysh me nëntitullin e përgjithshëm *Histori arbëreshe të shek. XV* (Storie albanesi del XV secolo).

Hyjnë në skenë këtu heronj të tjerë (Skënderbeu, Huniadi etj.) dhe heroina të tjera (Annamaria Cominiate, Delia, Adine, Videlaide, si p.sh. te *Rrëfimet e Arbërit*), por Millosau dhe Serafina Topia do të mbeten për poetin figurat qendrore të poezisë së tij dhe protagonistët paralelë të romanit lirik të dyfishtë që do të vazhdojë ta shkruajë gjithë jetën, edhe pse tashmë në një sistem letrar të ndryshuar e të riformësuar.

De Rada do t'i rikthehet idesë fillestare të romanit lirik të dyfishtë në fazën e fundit të krijimtarisë së tij, kur do të botojë në Napoli në vitin 1898 (edhe pse ai më vonë do të ngulë këmbë se vepra u shtyp një vit përpara) vëllimin e dytë të poemës *Pasqyrë e shtegtimit njerëzor* Specchio di umano transito, që me titullin e frontespicit do t'i kthehet tradetës:*Vita di Serafina Topia Principessa di Ducagino e frammenti de' suoi canti nel secolo XV*. Ky vëllim i dytë duhej të kishte si vëllim të parë pikërisht *Millosaun*, sikurse del nga shënimi që autori bën në pjesën e brendshme të kopertinës së poemës *Specchio di umano transito*:

> *Nel venturo Gennajo si comincerà la stampa del Milosao (IV edizione) il quale costituirà il 1° volume delle Poesie di Gerolamo De Rada.*

Dorëshkrimi i variantit të fundit të Millosaut që ndodhet në Bibliotekën e Komunës së Kozencës, sipas alfabetit të përdorur, është shkruar me siguri pas gjysmës së viteve '90 të shekullit XIX, meqenëse aty gjejmë të njëjtin alfabet të gramatikës së dytë të De Radës, *Caratteri e grammatica della lingua albanese*, Napoli 1894 dhe atë të veprës tjetër të tij, *Abecedario della lingua albanese*, Corigliano Calabro, i adoptuar zyrtarisht në Kongresin gjuhësor të Koriljanos (1895).

Autori na tregon se baronesha austriake dhe poete e afirmuar, Josephine Freiin von Knorr, e kishte në plan ta botonte me shpenzimet e veta:

> *Ed oggi a conforto di quste lodi prevale la simpatia della grande poetessa Madama Giuseppina Baronessa di Knorr, che ne ha impresa a sue spese la sesta edizione*

Me këtë variant të paplotë të *Millosaut*, i cili tani ruhet në Fondin De Rada të Bibliotekës së qytetit të Kozencës, mbyllet në mënyrë ciklike veprimtaria krijuese e De Radës (1898), që zuri fill po me këtë poemë (1835).

Tani, pasi e analizuam poemën brenda arkitekturës së 'polisistemit letrar deradian', do të përpiqemi ta shqyrtojmë atë sipas një përqasjeje të tipit psikanalitik që na duket interesant ta ndajmë me ju në këtë treyzë të rrumbullaktë dhe që orvatet të zgjidhë disa moskoherenca vetëm të sipërfaqshme në boshtin e veprës së parë poetike deradiane, që ka shtyrë shumë kritikë të na jepnin disa zgjidhje interpretuese që nuk na duken shumë të mbështetura.

Kjo përqasje i afrohet modelit interpretues të shkollës psikanalitike, të inaugurar nga Sigmund Freud, sipas së cilës ne kemi në zanafillë dy shtysa: Erosin dhe Thanatosin. Eros (dashuria) më shumë se forca e kundërt e Thanatosit (vdekja) mund ta konsiderojmë palë tjetër, palë kundërshtare të tij. Por Erosi është në fund vëllai i Thanatosit, një faqe e tij, një lloj hije e tij, dhe kjo sepse krahas një shtyse jete që na shërben për të bërë, për të mbledhur, për të lidhur, për të dashur, ka edhe një shtysë vdekjeje, që na duhet për të shpërbërë, për të ndarë, për të luftuar, për të urryer.

Thanatosi sipas disa vizioneve që na vijnë nga mitet e lashta na paraqitet disa herë është si biri i natës dhe vëllai i hypnosit (gjumi), por herë të tjera edhe si një fuqi zanafillëse që lind nga nata e kohëve dhe që bashkë me Erosin e ngjesh vazhdimisht jetën dhe psikën e njerëzve.

Për Freud këto shtysa zanafillëse dëftohen gjithmonë si të çiftëzuara, sepse, krahas dëshirës së jetës që na shtyn të eksplorojmë dhe të arrijmë një obiektiv, ka edhe një dëshirë vdekjeje që na shtyn të stabilizohemi dhe ta qetësojmë çdo shtytje. Sipas James Hillman, Erosi është edhe një faqe e

Thanatosit, sepse përmbledh brenda vetes vdekjen dhe shpie jetën në mbretërinë e padukshme të psikës përtej jetës së thjeshtë, duke e ngarkuar me domethënie që shpirtit i jep vdekja.

Freudi shihte shtysën e jetës, Erosin, dhe shtysën e vdekjes, Thanatosin, si dy fuqi në një farë mënyre paralele, si dy lumenj plot me energji që rrjedhin nga Es-i, rezervuari i instinkteve i të cilit secili prej nesh është i pajisur. Ndërse Karl Gustav Jung-u dhe James Hillman, bashkë me të, i përfaqësojnë këto fuqi në mënyrë më rrethore, unazore, se sa vijore, meqenëse nga çdo gjë lind e kundërta: nga jeta lind vdekja dhe nga vdekja lind jeta, siç na përmendi para Jung-ut dhe para Hillman-it filozofi grek Platoni në veprën e tij *Fedoni*.

Në çdo individ Erosi dhe Thanatosi ecin të pleksur dhe njëri e plotëson tjetrin sepse s'ka krijim pa shkatërrim, pa rrënim, dhe natyrisht është e mundur e kundërta. Dhe ka një lodër të vazhdueshme midis figurës dhe sfondit dhe kur njëri del në pah tjetri është në hije.

Sipas Sigmund Freud, pjesa e vetëdijshme e jetës psikike është e zotëruar nga instinktet që veprojnë në mënyrë të pavetëdijshme, Es-i, që bën që njeriu të mos jetë kurrë i zot i vetvetes. Për të përshkruar këtë gjendje, Freudi krahason Un-in me një kalorës dhe fushën instinktuale, Es-in, me një kalë.

> *Raporti i Un-it me Es-in mund të ishte krahasuar me të kalorësit me kalin e vet. Kali jep energji për lëvizjen, kalorësi ka privilegjin të përcaktojë cakun, vendmbërritjen, të drejtojë lëvizjen e kafshës së fuqishme*[4].

[4] Siç dihet Sigmund Freud përcakton tre përbërës (topoi), qoftë të pavetëdijshme, si Es-i, dhe qoftë të vetëdijëshme, si Un-i dhe Superun-i, duke na përshkruar strukturimin psikik të personalitetit të njeriut. Te kangjeli VI i veprës *Këngët e Millosaut* në botimin e parë (që përkon me këngën VIII të botimeve II dhe III) De Rada merr nga ëndrrra si manifestim i pjesës së pavetëdijshme të psikës së njeriut skenën e së dashurës së Millosaut që arrin ta shtrojë energjinë jetësore - instinktuale dhe të pakontrolluar - të kalit duke e zbutur atë me shikimin e saj të magjepsur. Këtu poeti ynë duket se para kohe do të na paralajmërojë imazhin e Freudit të kalit si shprehje e një fuqie instinktive dhe parake (Es-i), të nënshtruar jo nga kalorësi siç bën Freudi, në rolin e Un-it, pjesa e vetëdij-

Poema Këngët e Millosaut (por paralelisht, duke konsideruar binjakëzimin e saj strukturor, edhe poema Këngët e Serafina Topias), lexuar dhe interpretuar nga Freud-i, do të përfaqësonte një pikëtakimi në konfliktin dualist mes Erosit dhe Thanatosit, mes shtysës së jetës dhe shtysës së vdekjes: mes Erosit që e shtyn Millosaun ta rikrijojë pareshtur jetën e tij, duke ia nënshtruar realitetin gjithnjë e më të ndërlikuar modeleve që mbruhen e përshtaten vazhdimisht, dhe Thanatosit që shkatërron gjithherë çka Erosi krijon dhe rikrijon. Mirëpo kjo forcë shkatërruese nga ana e saj është njëherësh bartëse e një energjie pozitive që e bën heroin të vetëflijohet për një kauzë të drejtë e të luftojë për atdheun e tij si edhe të një energjie negative që dëshmon tundimin e heroit të shkojë me këmbët e veta drejt flijimit ekstrem, të therorizohet, t'u japë fund kështu mundimeve të jetës e të gjejë prehjen e përjetshme në varr.

Poema hapet në emër të Erosit: llumbardha kasnece e Afërditës (Venusit) vjen e troket në dritaren e shtëpisë së Millosaut[5] që ta grishë për dashuri, ta shtyjë drejt jetës, dhe mbyllet në emër të Thanatosit që vjen ta marrë heroin i cili i kërkon t'i hapë shatorren për t'i dhënë lamtumirën atdheut dhe të motrës, në dritaren përkundruall, në mënyrë që shpirti i tij të mund të flatrojë bashkë me Thanatosin - sikurse kishte flatruar në këngën e parë me Erosin e shndërruar në lumbardhë - për ta lënë këtë botë duke u tretur si ëndërrëz.

Konflikti mes Erosit dhe Thanatosit nuk ndeshet vetëm në fazat kyçe, të përfaqësuara simbolikisht nga fillimi dhe nga fundi i poemës, as

---

shme, por nga dashnorja, që shtron kalin që simbolizon forcën e papërmbajtshme të pjesës së pavetëdijshme. Është Rina, pra, që e ndihmon kalin e sertë, simbol i instinktivitetit të pakontrollueshëm, të gjejë drejtimin e humbur (shih veprën e tij *Einführung in die Psychoanalyse* 1924, të konsultuar në versionin ital. *Introduzione alla psicanalisi*, vëllimi i tetë i veprës së plotë të botimit *Opere di Sigmund Freud*, a cura di Cesare L. Musatti, Boringhieri, Torino 1976).

[5] Poeti arbëresh ia atribuon gabimisht Anakreontit një këngë që ngjante për nga fryma dhe forma me krijimet anakreontike dhe që ishte në modë në fillim të shek. XIX, në të cilën rrëfehej se poeti i Teosit i kishte blerë disa vargje perëndeshës Afërditë. Në fakt bëhej fjalë për një nga krijimet apokrife, sikurse do ta vërë në dukje Vincenzo Gualtieri (f. 130) i cili saktëson se kemi të bëjmë me oden XIV (Bergk, Lipsia, Teubner, 1867).

edhe ndërvepron në rrjedhë të drejtë kronologjike te protagonisti, i cili pasi joshet prej Erosit, shtysës së jetës, kënaqësisë dhe lektisjes së dashurisë, befas i braktis të gjitha këto për t'u përballur me detyrën, me shtysën e vdekjes që e shpie drejt flijimit.

Nuk na e mbush mendjen interpretimi që i bën Dhimitër Shuteriqi romanit lirik të dyfishtë për të cilin flet De Rada në letrën drejtuar mikut Raffaele Zagarese dhe që poeti e boton si parathënie të poemës. Studiuesi shqiptar (Shuteriqi 1964) lexon në poemë dy motive në vijimësi kohore: fillimisht motivin erotik dhe pastaj motivin patriotik, që sipas tij ndahen qartë kronologjikisht në veprimet e protagonistit të poemës[6]. Në të vërtetë është fjala për dy objektiva të ndryshëm dhe për dy sjellje të ndryshme, a më saktë, për bashkëpraninë e njëkohshme të dy ndjenjave me intensitet të ndryshëm që mundojnë heroin tonë dhe personazhet e tjera të poemës. Kështu që lirikën e dyfishtë edhe në dualitetin e shtysave që alternohen në njëkohësi dhe jo në vijimësi kohore mund ta shohim me një spektër të gjerë.

Heroi ynë Millosau gjendet në mëdyshje mes shtysës së jetës dhe shtysës së vdekjes, mëdyshje kjo që shtrihet përgjatë gjithë poemës. Për mendimin tonë ky mund të ishte një çelës leximi për poemën: në këtë mënyrë mund të rrokim gjithë tensionin e brendshëm që përshkon subjektin e këtij romani në vargje, sa të vërtetë aq edhe koherent, pra aspak të stisur, dhe atëherë ndoshta duke ndjekur këtë fill të kuq mund të bindemi se sa të brishta na paraqiten akuzat për fragmentarizëm që i bëhen kësaj poeme e që përsëriten si litani e zakonshme tashmë prej më se njëqind vjetësh.

Jo vetëm kaq, por si karakterizim i brendshëm i protagonistit dhe jo vetëm si karakterizim i jashtëm motivesh rrethanore, konflikti psikolo-

---

[6] *Poeti e quajti 'romanin tim dyfish lirik', te parathënia e veprës. Përse 'dyfish'? Një herë, për dashurinë e bareshës, që u bë shkak për poemën. Po së dyti, sigurisht për ndjenjën dhe idealin patriotik, që është në themel të kësaj vepre dhe që do ta quaja idenë kryesore të saj. Ndofta ky pohim do të duket i tepëruar për një poemë lirike me temë dashurinë, prandaj edhe thashë se do të ngul këmbë në një ide* në: Jeronim De Rada, *Milosao*. Përshtatur në shqipen e sotme nga Dh. S. Shuteriqi, N. Sh. Botimeve Naim Frashëri, Tiranë 1964, f.12-13.

gjik mes Erosit dhe Thanatosit qëndron në bazë të veprës, të heroit të saj dhe të personazheve të tjera, përfshirë korin, këtu të përfaqësuar nga vallja, që në zgafellat e pavetëdijes së Un-it më të thellë mbetet peng i këtij identiteti sa konfliktual aq edhe vital. Analogjikisht një tendencë të ngjashme mund të vërejmë në poemën 'binjake', duke u përqendruar në analizën e personazhit të Serafinës.

Nga ky konflikt nuk mbetet e jashtme natyra: ajo vetë, me të cilën njeriu jeton në sintoni, shfaq pafundësinë që romantizmi, duke përmbysur vizionin iluminist, e konsideron si fillimin e gjithçkaje. Por ajo pafundësi është e paarritshme nga njeriu edhe pse përbën thelbin e natyrës pjesë harmonike e së cilës është ai. Për këtë arsye Schelling e sheh artin si shprehje supreme të filozofisë dhe si të vetmin mjet që ka në dorë njeriu për të rrokur e për të shprehur këtë koncept, ndërsa artisti arrin që përmes veprës artistike të na japë një sintezë mes shpirtit dhe natyrës, mes së fundmes dhe pafundësisë.

Si bashkëpjesëmarrëse e këtij tensioni të vazhdueshëm psikologjik, natyra pasqyron plotësisht mëdyshjen mes Erosit dhe Thanatosit: në prologun e poemës gjejmë një natyrë të përjetshme dhe të mirë që shprehet në shtysën pozitive të Erosit (lisat që kishte ndërruar jeta, përtëritja e ujit të detit, harmonia e peizazheve të paqta dhe... të pafundme etj.) ndërsa në epilog gjejmë një natyrë gërnjare dhe të ligë (erëra të stuhishme që fryjnë nga malet, lisa të rrëzuar, Millosau i plagosur për vdekje etj.), sfondi ideal për Thanatosin, që mbyll siparin e kësaj shfaqjeje teatrale me një skenografi të denjë për këtë roman origjinal deradian në vargje.

Bibliografi

Girolamo De Rada, *I Canti Premilosaici*. Edizione critica e traduzione italiana a cura di Francesco Altimari, con edizione ipertestuale su cd –rom in collaborazione con Francesco Iusi, Rubbettino editore, Soveria Mannelli 1998.

Opere di Sigmund Freud, a cura di Cesare L.Musatti, VIII vol.: *Introduzione alla psicanalisi*, Boringhieri, Torino 1976.

Milosao, romanzo lirico albanese di Girolamo De Rada, Traduzione e Introduzione di Vittorio G. Gualtieri, Carabba editore, Lanciano 1917.

James Hillman, *The Myth of Analysis: Three Essays in Archetypal Psychology*, Northwestern University Pres 1972; trad. italiana di Aldo Giuliani, *Il mito dell' analisi*, Adelphi, Milano 1979.

Matteo Mandalà, «The crux […]is the phrase double lyrical narrative për një interpretim të poemave dhe të poetikës së De Radës (f.225-250) në *Omaggio a Girolamo De Rada.* Atti del V Seminario Internazionale di Studi Italo-Albanesi (2-5 ottobre 2003) e altri contributi albanologici, a cura di Francesco Altimari e Emilia Conforti, Università della Calabria, Dipartimento di Linguistica – Sezione di Albanologia, Rende 2008.

Arshi Pipa, *Hieronymus De Rada*, Albanische Forschungen, Trilogia Albanica II, Dr. Dr. Rudolf Trofenik, München 1978.

Jeronim De Rada, *Milosao*. Përshtatur në shqipen e sotme nga Dh. S. Shuteriqi, N. Sh. Botimeve Naim Frashëri, Tiranë 1964.

Dhimitër S.Shuteriqi, *Gjurmime letrare*, Një version i parë i 'Milosaos' dhe i 'Serafinës' së De Radës (f.35-119), Shtëpia botuese 'Naim Frashëri', Tiranë 1974.

Floresha DADO, Tiranë

DE RADA I PAPËRFUNDUAR…

KDU 821.18' 282.4(450).09

S'ka vlerë një autor nëse mendohet se ka përfunduar interpretimi i veprës së tij. Është e dyshimtë një metodë studimi, nëse mendohet se, përmes saj, interpretimi dhe e vërteta kanë arritur harmoninë e plotë. Është larg së vërtetës nëse pretendohet se çdo periudhë interpretimi hedh poshtë gjithçka që periudhat e mëparshme kishin arritur. Këto paradigma të ashpra i konfirmon vetë *vepra letrare*, e cila, në misterin e komponentëve të brendshëm të saj, sfidon studiuesit, bën që ata, në çdo kohë, t'i kthehen e rikthehen krijimtarisë së një autori, me qasje dhe konstatime të reja, shpesh herë të ndryshme nga të mëparshmet. Në këtë kuptim edhe krijimtaria e De Radës ishte një *kurth* për studiuesit e tre shekujve: në shekullin XIX ajo erdhi aq befasuese sa mendimi kritik i kohës nuk kishte nivelin që t'i qasej në tërësinë e vet kësaj dukurie të re letrare. Shekulli XX u përpoq ta rrokte në shumanshmërinë e vlerave, por nuk arriti ta bënte shterruese këtë rrokje, shumë aspekte të rëndësishme mbetën në horizont të hapur. Fundi i fundit të shekullit XX dhe fillimi i shekulli XXI, nisi të sfidojë me qasje, pak ose aspak të aplikuara më parë, duke sjellë sfida dhe teza të reja. Në këtë kuptim vepra e De Radës shfaqet sot, në shekullin tonë, *'e pë-r-jetshme'* (domethënë ruan kuptim dhe vlerë për të gjitha kohët), edhe *'historike'* (domethënë kalon nëpër një proces të vazhdueshëm 'zhvillimi'). Metodologjia e studimit të këtij korpusi letrar, nëse do të mbyllej në kufijtë e një periudhe, duke shpërfillur kapërximin e kufijve kohorë, do të sillte largimin ndaj këtij sistemi. E tashmja jashtëkohore e krijimtarisë deradiane, do të thotë që ky prodhim letrar, i gati dy shekujve të mëparshëm, është aktiv, madje më shumë në periudhën e sotme, përmes studimeve komplekse, që orientohen si nga thelbi i letërsisë, si lloj arti, ashtu dhe nga thelbi i veprës së De Radës, si i papërsëritshëm në specifikat artistike të tij.

Kalimet nga shekulli XIX te shekulli XX

Nëse i referohemi Shuteriqit sipas të cilit shekulli XVIII përgatiti kthesën e madhe që u shënua në pjesën e parë të shek.19 dhe se prodhimi letrar arbëresh ngrihet në nivelin e një letërsie artistike dhe nis një etapë e re, e cilësisë më të lartë, kjo sigurisht ka një pikë referimi themelore: krijimtarinë e De Radës. Por, po aq e saktë është ideja e R. Qosjes sipas të cilit horizonti i pritjes së poetit gjatë shek.19 dhe 20 është i kufizuar sepse vlerën e tij e sheh si formues artistik, kulturor dhe shoqëror, pra vetëm në funksionin e saj kombëtar. Studiuesi arbëresh Albert Straticò kish sqaruar më parë, se vepra e tij synonte të ndërtonte një pamje të shkurtër, por komplete, të lëvizjes letrare të shqiptarëve nga kohët e vjetra deri në ditët tona (pra fundi i shekullit XIX, viti 1896). Ndërsa studimin e M. Markianoit mbi De Radën, ndonëse botohet më 1902, mund ta konsiderojmë si frut të vëzhgimeve dhe studimit të fundit të shekullit XIX, ku shfaqet paksa metodë psikologjike, paksa biografike, paksa vështrim krahasimtar, pak metodë filologjike dhe analizë stilistikore, por dhe impresioniste. Megjithë rëndësinë e trajtimit të këtyre aspekteve, mbetet karakteri i kufizuar i interpretimit, ndonëse dimë se debati mbi veprën e De Radës u ndez që në shek. 19, vazhdoi edhe në shek. 20. Gjithsesi, ajo që karakterizon shek. XIX është raporti jo logjik midis veprës së tij letrare me ndikim të fuqishëm dhe varfërisë së mendimit kritik mbi të.

Në *shekullin XX* shkenca e letërsisë, sidomos ajo e brenda kufijve të Shqipërisë, u formua si pozitiviste, në tri modalitete metodologjike: vështrim sociologjik i fenomenit letrar, metoda biografike e interpretimit dhe pikëvështrimi psikologjist, çka bëri që shkrimet të jenë kryesisht njohëse, informuese. Por, historicizmi i të menduarit nga gjysma e dytë e këtij shekulli rishfaqet nëpër Evropë me një pamje të re, thelbi i së cilës ishte: metodë e bazuar në leximin paralel të teksteve letrare dhe jo-letrare, zakonisht të së njejtës periudhë historike. Në këtë qasje sundon pikëpamja që e sheh letërsinë jo në linjën e vazhdimësisë dhe zhvillimit, por kryesisht nën pushtetin e një force sinkronike, si një forcë produktive, gjenerative. Kështu romantizmi i De Radës u interpretua vetëm nën pushtetin e një force sinkronike: idesë së ndjenjës kombëtare, që karakterizon lëvizjen

shpirtërore të shekullit XIX. Por, përmes edhe *analizës diakronike* u bënë përpjekje të nxirrej në pah kategoria e re estetike, romantizmi i poetit, si dhe shpjegimi se në ç'masë kjo risi letrare modifikoi perspektivën e zhvillimit të letërsisë shqiptare. Studimet mbi De Radën gjatë këtij shekulli janë pafund.

Gjysma e dytë e *shekullit XX* dhe deri në *ditët e sotme*, shënon kthesë të rëndësishme në interpretimin e veprës letrare të De Radës.

Në korpusin studimor shfaqet një orientim i ri: interpretimi i raportit midis *autonomisë semantike të tekstit* dhe vlerësimit *sipas kontekstit, rrethanave të interpretuesit.* Nëse do i referoheshim pikëpamjes së Hajdegerit, sipas së cilës të kuptuarit është një ndërmjetës, përmes të cilit bota vjen te njeriu, i cili në një farë kuptimi karakterizon qënien e tij, apo tezës së Gadamer se çdo epokë duhet ta kuptojë një tekst të transmetuar në mënyrën e vet, do të dilte pyetja: cila do të ishte përmasa e kësaj teze në ristudimin e veprave të kolosit të letërsisë arbëreshe? Nëse një vepër letrare është konsideruar nga teoricienë dhe filozofë jo thjesht si produkt i së shkuarës, por edhe si prodhuese e së ardhmes, kjo do të thotë se gjeneza dhe pozicioni i veprave të De Radës, në koleksionin e kohës së vet, është i pandashëm nga pritja në kohën e sotme. Kodet e lexuesve të mëparshëm (shek. XIX dhe fillimi XX) shihen më pranë me ato të tekstit, ndërsa kodet e lexuesit të sotëm patjetër ndryshojnë më shumë, çka krijon një hendek midis leximit dhe kodit të tekstit. Në këtë kuptim, në aspektin metodologjik, studimet e shekullit XXI nisen për të shkuar më tej, për të përcaktuar se në ç'përmasa kodi letrar i korpusit deradian ka bërë të ekzistojë, madje të thellohet edhe sot e kësaj dite, përmasa e këtij hendeku.

Gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX dhe fillimit të shek. XXI mund të përcaktojmë disa grupime metodologjike të studimeve mbi De Radën, si : - studime / kritika që mbështeten në parimin *mimetik*, - studime / kritika që vlerësojnë karakterin ekspresiv të *imagjinatës romantike* të autorit;- studime/ kritika që synojnë t'i kërkojnë vlerat letrare në cilësitë *gjuhësore formale* të veprave; studime/ kritika, që vlerat e veprave ia nënshtrojnë lirshëm *përjetimeve* të studiuesit. Në këto grupime studiues arbëreshë, nga Shqipëria dhe nga Kosova, shfaqen me pozicionime edhe të ndryshme.

Nga ana tjetër, studimet që kanë ndjekur krijimtarinë e De Radës gjatë dy shekujve, në aspektin tipologjik do të ishin edhe:

- *lexim historik*, që e përvijon veprën për të gjetur pritjen e lexuesit të kohës së vet. Kjo qasje i përket shekullit kur u botua Milosao dhe në vazhdim në shekullin XX.

- *lexim shpjegues dhe të distancuar*, që i ka parë veprat si përgjigje ndaj kuptimit që mendohet se ka dhënë poeti. Kjo mënyrë ka mbizotëruar gjatë shekullit XX.

- *lexim* ku pranohen shumësi interpretimesh, që e gjejmë më shumë nga fundi i shek. XX dhe fillimi shekullit tonë.

- *lexim estetik dhe i drejtpërdrejtë*, që njeh lojën e teksteve, marrëdhëniet strukturore. Siç e thamë kjo është një qasje e sotme.

Kështu, në kalimin nga fundi i shekullit XX dhe fillimi i shekullit tonë përvijohen: **1)** Studime ku, nga njëra anë poetika e poetit interpretohet në drejtimin letrar të romantizmit; nga ana tjetër prirja për të zbuluar tipare të brendshme filozofiko-letrare të papërsëritshme. Përgjithësisht kemi një rrokje të gjerë, ku përfshihen disa aspekte të kontekstit dhe përmbajtjesore… Studiuesit janë të shumtë….

2) Rezultate të reja sjellin studime, më të pakta, që nisen nga koncepti metodologjik që e koncepton veprën si strukturë, si raport dhe marrëdhënie të fjalëve dhe shprehjeve poetike. Koncepti i strukturës së brendshme kuptimore, që rrjedh nga këto marrëdhënie specifike, nxiti debatitn mbi tezën e fragmentarizmit të poemës Milosao. Për herë të parë moderniteti i veprës së poetit shpjegohet edhe me *sistemin e strukturimit* të mesazhit poetik, me prishjen e rrjedhës së perceptimit normal të realitetit, me marrëdhëniet midis rrafshit të jashtëm, sipërfaqësor dhe rrafshit të brendshëm thelbësor. Në aspektin metodologjik ndiqet koncepti i makro dhe mikrostrukturës, duke gërmuar lidhjet e brendshme në gjithë korpusin letrar deradian. Kështu fillimi i shek. XXI (viti 2000) sjell interpretime që vënë në diskutim teza të mëparshme….

3) Fundi i shek. XX, dhe sidomos, fillimi i shekullit tonë, sot që flasim, ka sjellë një qasje të vrullshme gjallëruese të *metodës filologjike-let-*

rare, me rezultate befasuese në kuptimin dhe interpretimin e korpusit letrar të De Radës. Duke thelluar një traditë paraardhëse, studiuesit e sotëm F. Altimari, M. Mandalà, etj. i japin metodës së rindërtimit filologjik të tekstit, të varianteve, një hop cilësor dhe peshë metodologjike të pavlerësuar sa duhet në historinë e studimeve letrare shqiptare. Pas një qasjeje, në dukje filologjike, vjen stabilizimi i teksteve dhe konteksteve, leximet e krahasuara, plotësimet e kuptimeve të brendshme të teksteve…Vijnë provokime për të konceptuar një skemë origjinale të strukturave të veprave në veçanti dhe në makrostrukturë artistike, qasje e re midis varianteve, duke kombinuar metoda sa semiotike-strukturore, aq edhe kontekstuale. Studiuesi Mandalà hedh teza të reja për kuptimin e projektit të vërtetë letrar të De Radës; duke hyrë në makrostrukturën artistike të poetit bëhen përpjekje për të interpretuar thelbin e brendshëm të vetëdijes dhe intuitës së tij krijuese. Kjo qasje e re filologjike-letrare konfirmon një orientim metodologjik të domosdoshëm, kur është fjala jo vetëm për korpusin gjigand të De Radës, por të gjithë autorëve të traditës sonë letrare, jo vetëm arbëreshe.

Nëse ndalemi vetëm në studimet dhe interpretimet e bëra në konferencat, e organizuara në këtë vit përkujtimor, mund të tipologjizojmë tre grupime themelore: së pari vijnë fakte të reja mbi aktivitetin politik të poetit, marrëdhëniet me shkrimtarë e personalitete përtej kufijve të Italisë, si dhe të dhëna që sfidojnë çështje të periodizimit të Historisë së Letërsisë; së dyti vihet re zgjerim i qasjeve tekstologjike, si një metoë e rëndësishme për plotësimin e përfytyrimit të autenticitetit të procesit artistik të De Radës; së treti - depërtime origjinale në sistemin e brendshëm poetik të veprës së poetit, çka dëshmon shkuarjen e studimeve tona letrare në shtratin e vërtetë të interpretimit të letërsisë. Suksesi i vërtetë sot është kapërcimi i gjithpranimit të interpretimeve. Mendoj se jemi në fazën më të rëndësishme dhe më interesante të studimeve deradiane.

* * *

Nëse do të pajtoheshim me pikëpamjen se interpretimi është ‘arti i shmangies së keqkutimeve’, atëhere edhe sot, në shekullin XXI, çdo qasje, në aspektin metodologjik hap para studiuesve një numur supozimesh për *praktikën e interpretimit*. Si *vepra* e De Radës, ashtu dhe *studiuesi* i ditëve të sotme, janë të dy kompleksë: kjo do të thotë se vepra e tij nuk ekziston

vetëm sepse është NJË lojë e caktuar në ndërtimin e një sistemi shenjuesish. Këtë lojë poeti e ka bërë të funksionojë *një herë*, kurse studiuesit e kanë parë dhe e shohin *pafundësisht herë*.Vepra e tij ka me interpretuesit e sotëm një *takim historik*, në rrethana të reja. Ajo është e papërfunduar, sepse çdo interpretim, edhe në konferencën tonë, nuk synon një rindërtim të ardhshëm, të përsosur, të plotë të kuptimit artistik, por, përkundrazi, është një akt ruajtje i së kaluarës në vetëdijet e studiuesit të sotëm, për ta përcjellë *të hapur* edhe për nesër. Për këtë arsye poezia e De Radës do mbetet gjithnjë 'e papërfunduar'...

Sabri HAMITI, Prishtinë

JERONIM DE RADA: MILOSAO, 1836

KDU 821.18' 282.4(450)-1.09

1. Milosao im, 2014

Milosao (1836) i Jeronim de Radës, që po shkon kah mosha dyshekullore, tashmë njihet si kryevepra poetike e autorit dhe një nga kryeveprat e lirikës shqipe. Mirëpo, secili tekst letrar, në çastin e leximit, bëhet bashkëkohor, bile i tashëm. Formulimi *Milosao im* përpiqet të theksojë natyrën e veprës poetike, që është *e lexueshme* dhe *e shkrueshme*, në vështrimin e Rolan Bartit, më tepër se sa të relativizojë evidencat e leximeve të përparshme, të autorit (që shkroi tri variacione të veprës), apo të interpretuesve në shekujt e fundit. Formulimi më tepër mundohet të relativizojë e të personalizojë leximin, që bëhet i ndryshëm dhe i ndryshueshëm nga koha në kohë. Qëkur Lexuesi bëhet aktant i shpalimit të kuptimit të veprës, edhe i larguar nga tendenca e Autorit, ai zbulon që *Milosao* është vepër e shkrueshme dhe e rishkrueshme, si gjithë poezia moderne, që të lodh në lexim e në kërkim. Mendimi është i rëndë, kërkimi është i rëndë; se thellësia është e errët, theksonte Eqrem Çabej duke shkruar për lirikën e Lasgush Poradecit. Atëherë del në pah Lexuesi si Ego (Vete) për ta përvetësuar tekstin, më parë për ta plotësuar sesa për ta arsyetuar. "Ky është Rasini im" u përgjigj Barti, se i thanë që nuk i konsideronte të vërtetat për Rasinin në tekstin e vet interpretues. Në hije të kësaj mund të kuptohet edhe komunikimi poetik ndërmjet *Milosaos* (1836) të Jeronim de Radës dhe *Milosaos* sonë të vitit 2014.

2. Jeronim de Rada: Milosao

Jeronim de Rada mori famën romantike të krijuesit e të protagonistit

të sojit të Bajronit e Ygosë, të Leopardit e të Pushkinit, veçse kërkoi edhe protagonizmin në fushën e kulturës nacionale nëpërmjet letërsisë së shkruar identitare. Këtu na del themelor kërkimi dhe identifikimi i tij në kryeveprën poetike të rinisë, *Milosao*, e jo kërkimi i ideologjisë së tij për protagonizëm nacional. Kërkimi i identifikimit poetik i vë në raport De Radën me Milosaon, Emrin me Pseudonimin, ose Autorin me Personazhin. Në strukturën tekstore të *Milosaos* autori shpesh e më shpesh njëjtësohet me personazhin, emri lidhet me pseudonimin; pra Rada afrohet me Milosaon. Katërmbëdhjetë këngët e para të *Milosaos* rrëfehen alternativisht prej autorit e prej personazhit (heroit). De Rada e Milosao janë aty dy qenie artistike, që alternohen me *Unë* e *Ti* (uni tjetër); pra, nga dysia kthehen në Njësi: prosede ky i shkrimit autobiografik; një diskurs i pastër i dashurisë.

3. Poezia e dialektit

Milosao është shkruar në arbërisht, gati në të folmen e autorit. Kjo nuk është pos veçanti e kësaj vepre, apo e autorit të saj, mbasi poezia shqipe në pesë shekujt e vet të shkruar del në dialekt. Çështja është që shkrimi në dialekt përbën veçori në strukturimin poetik të veprës dhe në komunikimin e saj. Mbasi lirika është thelbi i krijimit, atëherë domosdo lirika është edhe krijimi i thelbit. Elementariteti dhe esencialiteti, që karakterizojnë këtë vepër, mund të përkufizohen si liri (poetike) që përmbys retorikën si bindje dhe detyrimin si ideologji. Paradigma (zgjedhja) e të folmes së krahinës mirëkupton ngushtimin e fjalorit, që zgjerohet në *metaforë*, ashtu edhe sintagmën (kombinimin), që zgjerohet në *figurë*.

*Ljis jetá kish*ë *ndërrúar*

është thelbi, zanafilla e veprës poetike. Thelbi i pjesës së parë të poemës nyjëzohet në vargjet e Kangjéljit I:

*Ljis jetá kish*ë *ndërrúar,*
*uj t*ë *rī ndë dejtit*
kaljthëruar te dit' e rē.

Kangjélji XXX (kënga përmbyllëse e veprës) nis me vargjet:

Friti ēr e máljevet
e rrëzoj hjēn e ljisit:
gjaku im te ljum' i Vodhit.

Kjo gjuhë elementare e formulësuar në gjuhë poetike, nis e sos, e modelon frazën metaforike të vargut të lirë të *Milosaos*, thekson figurat themelore, të Malit e të Detit, duke u lidhur me kryefigurën e binjakëzuar të *Lisit* e të *Hijes së Lisit*, që paraqet jetën (dashurinë) e vdekjen. Në anën tjetër elementariteti i dialektit *arbërisht* do të bëhet çështje e komunikimit të veprës në shqip. Lexuesit shqiptar për ta shijuar gjuhën e *Milosaos* i duhet ta mësojë arbërishten ose të kënaqet me adaptime të tekstit në shqipen standarde, pa njohur vlerën origjinare.

4. Rrëfimi lirik i dyfishtë

"Sajova rrëfimin tim lirik të dyfishtë". Kështu i shkruan De Rada mikut të vet në Maqi, më 1834, lidhur me krijesën e vet poetike, që do të botohej në Napoli, me titullin *Milosao*, dy vjet më vonë, më 1836. Ky rrëfim lirik i dyfishtë, deri më sot ka marrë interpretime të ndryshme. Edhe tani ky venerim mund të provohet në disa nivele. Nëse provohet në nivelin struktural të veprës, rrëfimi i dyfishtë është: rrëfimi autorial e rrëfimi i protagonistit. Nëse kërkohet në nivelin paraqitës, atëherë kjo dyfishsí zbërthehet në dëftimet autobiografike e në dëftimet poetike universalizuese. Nëse shtrohet në nivel të modelit formal krijues, atëherë mund të dallohet shkrimi simbas modelit popullor vendës dhe modelit të kulturës shkrimore. Edhe më tutje, nëse çështja shtrohet në nivelin e cilësimit të subjektivitetit në tekstin lirik, atëherë dyfishsía përfshin atë që në lirikën e këtij lloji quhet *personale* dhe atë tjetrën që quhet *subjektive*. Njëra e veçantë, e jetuar si De Rada; tjetra e përgjithësuar, e imagjinuar, si Milosao. Në 14 këngët e para flet uni (i nënkuptuar) i autorit, duke u bërë një me protagonistin e dashuruar. Rina, si protagoniste e dashuruar, me emër përmendet vetëm në Këngën XIV. Në anën tjetër, Milosao si personazh, me emër, përmendet së pari në Këngën XV, në trajtën e vargut: "*Milosao: Si ja thōn këtij katúndi*". Pastaj në Këngën XVI, Milosao shenjohet tri herë në dialog me Vorean (Veriun – Erën). Në Këngën XXIII,

protagonisti del te vargjet: "*Milosau: Si një rē me shī të shéghur"* dhe "*Milosao: Ç'é këjó fjālj? Ëngjël oj vásh"; "Milosao: S'é volá e t'Înzot*". Në këngën e fundit, XXX, është përfundimi i veprës në formën *"S'é mé e Milosāt*". Pra, emri i protagonistit del vetëm në pjesën e dytë të poemës, atëherë kur imagjinohen ndodhitë e tij, madje përshkruhet vdekja e tij.

5. Poema romantike

Vepra e Jeronim de Radës, *Milosao*, është poezi lirike, e strukturuar në 30 këngë, që të tufëzuara marrin trajtën e poemës romantike. Subjektiviteti i derdhur në shkrim, shkrimi autobiografik, madje heroi autobiografik, emocionaliteti, shpirtësia përpara veprimit fizik, të gjitha janë karakteristika të lirikës romantike, aq sa edhe modeli i krijimit popullor bashkë me mitizimin për zhvendosjen e poezisë në kohë të shkuar. Veçantia e saj është strukturimi lirik, që e bën të hyjë në modelin e këngëve romantike e mesdhetare të dashurisë, që rishfaqen edhe në modernitet. Në këtë pikë ka pasur një moskuptim nga kritika shqipe, që është munduar me çdo kusht të rindërtojë një subjekt, në vështrimin e strukturuar të kësaj tufe lirike. Kësaj mësymje nuk i shpëton as Arshi Pipa, mbase interpretuesi më preciz i lirikës së De Radës deri më sot. Edhe ky, në monografinë e vet *Jeronim de Rada*, përpiqet të rindërtojë syzheun e veprës, duke propozuar një njësi ndodhie për secilën nga 30 këngët e veprës. Është çështje krejt tjetër struktura dramatike e tekstit, ku kënga këndohet apo artikulohet kryesisht nga heroi, monostrofat këndohen nga heroina, kurse këngët që këndon kori marrin edhe karakterin e antistrofës. Mbi të gjitha, karakteristikat e Milosaos janë rrëfimi lirik metaforik, e në kuadër të këtij prosedimi poetik natyra përherë shenjëzuese e gjendjeve shpirtërore të protagonistëve.

6. Fantazitë në kohë e në hapësirë

Milosao i vitit 1836, me të cilin merremi në këto venerime, botohet me titullin *Poezi shqipe të shekullit XV, Këngët e Milosaos, bir i sundimtarit të Shkodrës*, por me titullin vetëm në italisht. As variantet e më-

vonshme nuk kanë titull në shqip. Tradita e përkthimit të titullit në shqip ka vijuar e dyzuar deri më sot: a janë këto *Këngë të Milosaos* apo janë *Këngë të Milosaut*? Dyzimi mbetet hapur: a ndodh kjo për shkak të origjinës gjuhësore të emrit të personazhit, apo për shkak të skajimit të tij në gjuhë të ndryshme. Sado që titulli paraqitës formalisht këmbëngul në një kohë, në një vend e në një origjinë, që këtu nisin fantazitë deradiane në kohë e në hapësirë, që shpërfaqen në tekstin e *Milosaos*. Edhe vetë De Rada (autor i moçëm) kur merr mundin t'i ofrojë referenca kohe e hapësire De Radës (autor i ri) rreth zhvillimeve të *Milosaos*, vetëmsa e shton fantazinë e kohës e të hapësirës. Sepse këto fantazi janë në themel të veprës *Milosao* të vitit 1836. Çështja është që prosedimi themelor poetik i Jeronim de Radës te *Milosao* (e kudo tjetër) është i pastër romantik. Kjo do të thotë, moskuptim me realen, grindje me realen, apo përmbysje e saj. Ky konflikt me realen nuk zgjidhet duke imituar atë, por duke imagjinuar atë. Frymëzuesi i madh i zhvendosjeve në kohë e në hapësirë është shpirti shtegtar, që gati kurrë nuk është aty ku është trupi, është përherë në lëvizje për dikund tjetër. Ndodhia nuk është në realitet, po në ëndërr, në imagjinim. Situatat dhe situimet fundamentale në dramatikën dashurore të Milosaos prosedohen apo shpërfaqen si ëndrra e ëndërrime, formalisht e esencialisht. Pra, vetëm vdekja qenka reale?! Edhe kësaj Milosao i De Radës i përgjigjet me figurën e vet fantastike, mu në fund të veprës:

U m'i ljē si ëndërrëz

7. Ëndrra e Ëndërrimi

Mbasi jeta qenka ëndërr, atëherë krejt *Milosao* mund të jetë ëndërr poetike, edhe dashuria që luhatet në fletë pemësh si në valë deti. Atëherë le të na ndihmojë poetologu frëng Gaston Bashlar që shkroi *Poetikën e hapësirës* e në veçanti *Poetikën e ëndërrimit*. Me ndihmën e tij mund të prodhohet paradoksi binar: Ëndrra i përket atij që është i fjetur i zgjuar, kurse Ëndërrimi i përket atij që është i zgjuar i fjetur. Ëndërrimi e Imagjinimi, madje si fiksim. Romantiku i madh frëng, Viktor Ygo do ta thoshte me vargun e vet *Do të ec me sy të ngulur në mendime*. E tha vetë Je-

ronim de Rada, te *Parimet e estetikës*, që poezia (lirika) është thelbi i artit dhe nuk duron imtësitë, detajet. Prandaj, shpëtimi i lirikës është figura.

8. Mesazhi, Imazhi e Metafora

Milosao është një poezi që lidh në mënyrë asociative mesazhe, imazhe, figura, edhe atëherë kur pretendohet që rrëfen diçka, edhe atëherë kur pretendon që përshkruan diçka. Pamja, gjesti, pasioni, ëndrra, përjashtësia, përbrendësia; të gjitha kthehen në metaforë. Shumica e këngëve nisin me një metaforë përshkruese të pamjes së natyrës, për t'u shoqëruar me një gjendje shpirtërore të heronjve të veprës. Mal e Det, Erë e Ujë, Borë e Ngricë, Blerim e Kaltërsi e, në fillim e në fund, Lisi e Hija e Lisit. Me metaforë shprehet edhe mesazhi final e i tmerrshëm për romanseron e dashurisë, kur e vdes *dashnorin* për të lindur *heroin*, dy herë Milosa.

Ljis jetá kishë ndërrúar,
uj të rī ndë dejtit Kangjélji I
kaljthëruar te dit' e rē.

Vreshtat īn të verdhulóre;
erth kā malji dhéljpëra Kangjélji II
me të ljodhëta të bíljat

Ish e diela menát
e i bir'í zonjës madhe Kangjélji IV
ngjitej tek e búkura
të m'i ljipën një pik uj

Çë të vēn ndë deitit
noerīt zëmëra ime? Kangjélji V

Rā borá ndë dejtit,
e më zbardhi vudhëvet Kangjélji VI
krāghët ë shqitezës

Dreq rahjet é dejtit
gëzoj dita e káljthërëz Kangjélji VII
valévet kopiljevet.

Mnīz e vérës bardhulóre
biu një rē monosáqe Kangjélji VIII
për ndë mest gurëvet

Duró zëmër e duró
sā durój málji me bōr Kangjélji XI

Si suvālj ndë deitit
paru e trubul si një málj Kangjélji XII
nëng rúan mé se anīn

Prā çë dieli i rā te shtrati
m'u patáks mixória, Kangjélji XIV
vū njinjé të véshurat
dúal ka rrīj i bir'i zotit

Airí çë ndéqit mōn
friti kā deiti Kangjélji XVI

Fjetat īn të mbītura
dieli i sqépur rêshit, Kangjélji XX
pā oréks zëmër'e grâvet,
kūr u rroth një shkunduljim

Si një rē me shī të shéghur,
mbī katūnd shumë e bārdh Kangjélji XXIII
çë së dī ku të pushōnj

Dī dit mjégul e shī
verën dójn të na réshtëjin Kangjélji XXV

Friti era prapa shpivet Kangjélji XXVI
motëra ime vógëlja
Ujtë ghumbur, rā vorea,
Malje e shéshe u vshëtin. Kangjélji XXIX

Friti ēr e máljevet
e rrëzoj hjēn e ljisit. Kangjélji XXX

Të gjitha këto pamje të figuruara të jashtme nisin apo sugjerojnë ndodhi e disponime të heronjve të veprës, apo zhvillohen në nivel të dytë të figurës njerëzore.

9. Kangjeli XXX

Kënga XXX e *Milosaos* (1836) është kënga e fundit e veprës poetike. Po kjo këngë është e fundit edhe në tufëzën e Proto-Milosaos, si kënga XX. Del si këngë e fundit edhe në dy variantet e *Milosaos*, të viteve 1847 e 1873, ndonëse si kënga XXXVII. Te Proto-Milosao kjo këngë del në një variantë, kurse në tri variantet e *Milosaos*, kënga përfundimtare ka të njëjtën trajtë, me një dallim të vogël në një varg dhe me një ndryshim të vogël në pikësim. Kjo është kënga më e shkurtër e veprës dhe ka trembëdhjetë vargje.

Friti ēr' e malevet
e rrëzoi hjēn e lisit:
gjaku im te lum' i Vodhit,
ghapni spërvierin
ushtërtōr, u të më shogh
Skutarin e time motër
te finestëra kundrēla.
Më atje së zgjoniem
lulevet çë tundën era
si suvāl' e pa fërnuam.
Mbjidhen shokët mbrëmanet

ndë katund ndë vatërët,
u m'i lē si ëndërrëz.

Duke lexuar këngën XXX të *Milosaos* kërkojmë të shohim funksionimin e saj në strukturën e veprës, provojmë të bëjmë mikroanalizën poetike, duke kërkuar një pikënisje apo model për leximin e veprës në tërësi.

1. Kjo këngë, në vështrimin e strukturës tekstore të veprës, është kënga përmbyllëse. Në vështrimin e të bërave jetësore të personazhit, është kënga e fundit, kënga e vdekjes. Në vështrimin e zhvillimeve dramatike në vepër, është një epilog. Në vështrimin e imazheve, metaforave e mesazheve, është një përqendrim, koncentrat. Në vështrimin e komunikimit, është kënga e lamtumirës.

2. Kënga XXX e *Milosaos* përbëhet nga fraza poetike: fraza e parë merr vargjet 1 e 2, fraza e dytë vargun 3, fraza e tretë vargjet 4,5,6 e 7, fraza e katërt vargjet 8, 9 e 10, fraza e pestë vargjet 11 e 12, fraza e gjashtë vargun 13. Këto fraza lidhen në një tërësi gjuhësore poetike me motivim në ekstrem. Fraza e parë, në dukje neutrale përnga vetja e artikulimit, vetëm sa i prin një artikulimi vetvetor në frazat e tjera, për të arritur te fraza e fundit e cila është e artikuluar me një unë të sipërtheksuar.

Kështu hyjmë në fushën e gjuhës së motivuar, "gjuhës së zjarrtë" që "shkruhet në kartë" të Naimit si dhe në fushën e komunikimit të bukurisë e të llaftarisë të Lasgushit.

Friti ēr' e malevet
e rrëzoi hjēn e lisit

Është një metaforë binjake me ato që u prijnë këngëve të tjera dhe ka trajtën e ligjërimit eliptik: ngrysje, errësim, eklips i diellit, zhdukje e hijes, të cilën e jep vetëm drita e fortë. Shenja e përjashtme pamore, që prodhon tronditjen e përbrendshme, shuarjen, vdekjen. Është një imazh simbolik i natyrës që hyn në botën e kulturës (njeriut). Ky kalim bëhet me artikulim të përvetësuar dramatik:

gjaku im te lum' i Vodhit,

Figura e gjakut te uji, jeta te lumi që rrjedh. Identitet dhe identifikim i thellë, shenjë e të ndodhurës dramatike. Një kumt i zi që shfaqet i qetë pa asfarë klithme. Atëherë zgjidhen fjalët:

ghapni spërvierin
ushtërtōr, u të më shogh
Skutarin e time motër
te finestëra kundrēla

Shfaqet një situatë njerëzore e përkthyer në situim poetik të teatrit jetësor – në pamjen e fundit, ku fiksohen Skutari e motra, vendi e gjaku. Pamja është fantastike edhe ngase është pamje e fundit. Malli e mallëngjimi i pangushëlluar që tashmë dëftohet si vetërrëfim (konfesion) dramatik:

Më atje së zgjoniem
lulevet çë tundën era
si suvāl' e pa fërnuam.

Gjakim dhe tërbim në mes lulesh ku luhet vallja e jetës. Jeta që do të vazhdojë, si mall e mallëngjim, si përherë me pamjet thuaja mitike në nyjat e saj:

Mbjidhen shokët mbrëmanet
ndë katund ndë vatërët,

Dëftesë për vdekjen dhe mall për pavdekësinë e përjetësinë.

Vargu i fundit, ndoshta më i bukuri, më i thelli i artikuluar në trajtë elipse, është thelbi i këngës të lamtumirës:

u m'i lē si ëndërrëz

Jeta një ëndërr, një kalim i shpejtë, një shtegtim i pafré në kohë e hapësirë, një provë personale apo një liri poetike. Kjo është çështja.

3. Kënga XXX, kënga përmbyllëse e *Milosaos* jep një situatë dramatike jetësore, shprehur me një gjuhë poetike të dramatizuar, në fakt është një monolog, kurse struktura e saj funksionale në vepër e artikulon si epilog. Mbas epilogut nuk ka më. Nisur nga këtu mund të shfaqet vetëm ftesa për lexuesin që vepra të rilexohet në tërësi. Imazhet e gjuhës zbuluese të pamjes së parë të habitshme (në vështrimin e Viktor Shkllovskit); ngjye-

rat, e blerta dhe e kaltra, era e detit dhe era e malit, udhëtimi i dashurisë e dhembja e tretjes së saj, shprehja pa klithma e invokacione krijojnë një tekst të kthyer në figurë. Me këtë nuk po themi që kënga XXX është kënga përfaqësuese e veprës *Milosao*, por po përpiqemi të themi që këtu duken cilësitë e stilit të De Radës, botëkuptimi i tij dhe procedimi poetik i heroit autobiografik si dashnor e si dashunues i jetës. Këto shenja duken kudo në këngët e veprës, porse këtu artikulohen në pikën ekstreme, duke përshkruar vdekjen, me mallin e jetës. Sepse e tha vetë Milosao në fund:

U m' i lē si ëndërrëz

Lamtumirë apo Mirupafshim.

10. Kreu i kryeveprave lirike

1. *Këngët e Milosaos* (1836) e Jeronim de Radës, që në titull e përkufizon lirikën si *këngë*, e me varg të lirë ritmik këndon dhembjen e dashurisë e vdekjen, duke dalë në ballë të kryeveprave të letërsisë (lirikës) shqipe. Tani, si u trashëgua kjo në lirikën shqipe të autorëve pasrendës në shekujt në vijim për të krijuar rendin e kryeveprave lirike.

2. Naim Frashëri, në librin *Lulet e verësë* (1890), duke e cilësuar lirikën me metaforën e *Lules*, artikuloi zjarrin e dashurisë në tufën e lirikave *Bukurija*, ku emërtimi emocional është kthyer në emërtim estetik. Me një varg të matur e të rimuar shpërthen uni lirik i përvëluar:

Do të shtrihem
Të venitem

ose

Balt' e pluhur
Do të bëhem

3. Gjergj Fishta te *Nji lule vjeshtet* (1909) këndon lulet e vjeshtës, lulet e varrit. Epiku i bubullimave, tani bëhet lirik i veshur zi për të kënduar mikun, vdekjen e veten. Vajtimi i tij, solemn e i hyjnueshëm, kërkon të pajtojë Egon e Alteregon diku, dikur. Është një vajtim i burrit, që nuk e pajton as Përjetësia, fillim e mbarim:

N'atë rrahe t'dekne mbrenda vorrit t'errshem
Tash plûhen jé

e

...e emni
Sá t'bjere dielli tokës ka me t'u kndue.

4. Ndre Mjedja, në librin poetik me vjersha të rinisë, *Juvenilia* (1917), spikat poemën *Andrra e jetës*, duke paraqitur e figuruar kangën gegnisht për ankthin e jetës si *andërr* në ballafaqim me vdekjen. Drama e Jetës, me aktantë-personazhe-figura: Trina, Zoga e Lokja. Luhet me ritme të reales për të arritur në pamje të metafizikës, me vargun e latuar e metaforën ziplotë:

E n'balkue mbaruene lulet

apo

U shty vjeshta e krisantemi
Vetun vorreve lulzon

5. Zef Skiroi, në veprën *Mino* (1921), poemë e hartuar me vargun polimetrik, me arbërishten e shekullit njëzet shpërthen në vaj e krenarí personale duke kombinuar lavdinë e mallkimin: dashurinë për birin, Minon, e mallkimin për vrasësin e vendlindjes. Thirrja fillestare:

Këngën ta çilni tesh, o Malisorë

për të bërë gjëmën e vdekjes, vijon me mallkimin për vrasjen e identitetit:

O Katund i poshtër, sa më i lart më parë

duke artikuluar dhimbjen personale për identitetin:

Atë që deja të mos deja e dua.

6. Lagush Poradeci, në librin poetik *Vallja e Yjve* (1933) i gjithi i krijuar si metaforë, spikat krijimin si mohim të vdekjes, për të strukturuar poemën mendim-thellë *Vallja e Përjetësisë*. Këtu poezia shqipe (për herë të parë pas Pjetër Bogdanit) shkëlqen fort e ngrihet në lartësinë e Metafizikës shqiptare nëpërmjet figurash konceptuale dhe harmonisë metrike. Ritmi i krijimit ngrihet nëpër shkallët: Lënda dhe Jeta, Fryma dhe Qëllimi, Ndjenja dhe Njeriu, Njeriu dhe Zoti, për të arritur te Përjetësia. Filozofi e njohjes dhe filozofi e poezisë: nga ndjesitë te mendimet:

Jam sot,
Si vjet,
Si mot,
Si Përgjithënjë.

7. Millosh Gjergj Nikolla boton *Vargjet e lira* (1936), me cikle tematike që emërtohen *kangë*, por këngë nuk janë ; cikle që lidhen me situata sociale dhe mosha të njeriut, për t'u përmbyllur me *kangët e fundit*. Shpërthen si shprehje lirike gegnishtja e kursyer si gjuhë në veprim e në kontemplacion, duke nisur me revoltë (që nuk bëhet revolucion) e duke mbaruar me melankoli. Një lirikë kaq tronditëse e poetit të vdekur në rini. U grind me perënditë: *Perëndi ku je ?* E në këtë udhë njohu vuajtjen, frymëzimin, kangën, vetminë, melankolinë, për ta parë, përjetësuar e thirrur Njeriun:

Pak dritë! Pak dritë! Pak dritë, o shok, o vlla.

8. Ali Podrimja, në veprën *Lum Lumi* (1982) krijon një titull metaforik të dyfishtë. Herën e parë si forcim i identitetit (*Lumi i Lumit*). Herën e dytë si dashuri e adhurim (*Lumi i lumturuar*). Këto kuptime zbërthehen poetikisht në ciklin themelor *Me jetue*, në të cilin këndon vdekjen e fëmijës (Lumit), i cili e mëson vdekjen duke imagjinuar jetën. Një edukim më fort tragjik e burrëror sesa sentimental. Podrimja këndon në variacione, me gjuhë që kallëzon, dëfton apo sinkopohet e hesht, deri në mungesë. Fundi, një elipsë:

ike
nga dëshira
për të jetuar

9. Zef Zorba, për dyzet vjet, flet me veten për vetveten, i vetmuar. Dhe lë dorëshkrimin poetik *Buzë të ngrira në gaz* (1994). Në titull dikotomia e vajit dhe gazit të ngrirë, që shpie përfundimisht në ironi dhe autoironi. Poet i esencialitetit dhe elipsës, krijues i *librit poetik*, model i poezisë moderne në Shqipëri, Zef Zorba më herët theksoi: *Ç'më duhen sytë kur është terr?!* Mirëpo, në ciklin e fundit *Në zgrip*, poeti hapet para vetvetes si para botës, si në një rrëfim para Zotit, që i di të gjitha, duke e parë jetën në zgrip me rezignim e me mallëngjim:

O jetë!
edhe në zgrip,

shtegtarët e tu
gjithnjë të dashurojnë!

10. Lirika moderne shqipe që nis me *Milosaon* e De Radës, e parë nëpër kryeveprat e saj, dëshmon që edhe kur niset si himn përfundon me elegji. Kjo ngjet ngase sillet në përmasat e Njeriut që Jetën e Vdekjen i sheh nëpërmjet lakimit të Dashurisë, duke kaluar nëpër kodet e llojit poetik. Me gjasë, në këto përmasa sillen edhe kryeveprat lirike të letërsive të tjera.

Fusnota: Milosao i Torontos

Në fund një kujtesë e vogël se si poezia lirike mund të bëhet ndërgjegje kulturore e brezave.

Në Toronto të Kanadasë e takova Agimin e Kosovës, që ishte bërë Milosao.

Pse Milosao, mendova.

Gjimnazisti i Prishtinës, në vitet ’80, po ikte në Amerikë nëpërmjet një llogori në Napoli. Aty ndërroi emër e vendlindje për t’u bërë Milosao i Fierit, që t’i pranohej emigrimi.

Pse Milosao, këmbëngula.

“Ishte emri i parë që më ra ndërmend, e në të cilin do të përgjigjesha kur të më thërrisnin, edhe pa kaluar katër sekondat që i duhen njeriut për t’u përgjigjur në emrin e ri”, më tha Milosao.

Pranimi i Milosaos së De Radës, si pseudonim, pastaj si emër, pa e ditur hiç, kishte përshkruar identifikimin e tij fantastik me Personazhin letrar; tani edhe me shtegtimet nëpër dherat shqiptare: nga veriu në jug, nga jugu në perëndim (përtej detit), për të mbetur në ujdhesën e largët (përtej oqeanit). Si përsëritet historia: për të mbetur apo për të shpëtuar?

LITERATURA

I. Veprat poetike

1. Jeronim De Rada, *Milosao*, 1836
2. Jeronim De Rada, Vepra letrare I, Tiranë 2014
3. Jeronim De Rada, Vepra letrare II, Tiranë 2014
4. Naim Frashëri, *Lulet e verësë*, 1890
5. Gjergj Fishta, "Nji lule vjeshtet", 1909
6. Ndre Mjedja, *Juvenilia*, 1917
7. Zef Skiroi, *Mino*, 1921
8. Lasgush Poradeci, *Vallja e Yjve*, 1933
9. Millosh Gjergj Nikolla, *Vargjet e lira*, 1936
10. Ali Podrimja, *Lum Lumi*, 1982
11. Zef Zorba, *Buzë të ngrira në gaz*, 1994

II. Veprat kritike

1. Arshi Pipa, *Jeronim de Rada*, 2013
2. Rexhep Qosja, *Porosia e madhe*, 1986
3. Aurel Plasari, *Fishta i dashuruari*, 1996
4. Mark Gurakuqi, *Mbi veprën letrare të Ndre Mjedës*, 1980
5. Eqrem Kryeziu, *Poetika e Skiroit*, 2009
6. Sabri Hamiti, *Lasgushi qindvjeçar*, 1999
7. Arshi Pipa, *Për Migjenin*, 2006
8. Mensur Raifi, *Ali Podrimja*, 2013
9. Sabri Hamiti, "Zef Zorba: alternativa moderne në Shqipëri", 2002
10. Roland Barthes, *Sur Racine*, 1963
11. Roland Barthes, *Critique et Verité*, 1966
12. Gaston Bachelard, *La poétique de l'éspace*, 1958
13. Gaston Bachelard, *La poétique de la rêverie*, 1960

Pajazit NUSHI, Prishtinë

NDJENJAT ESTETIKE NË VEPRËN E JERONIM DE RADËS *PARIME TË ESTETIKËS* DHE NË VEPRËN E UILIAM XHEJMSIT *PARIME TË PSIKOLOGJISË*

KDU 111.852 008(=18:450)
821.18' 282.4(450).0

Mëvetësia e estetikës dhe e psikologjisë në trajtimin e së bukurës

Titulli i veprës së Jeronim De Radës *Parime të estetikës* dhe titulli i veprës së Uiliam Xhejmsit *Parime të psikologjisë* imponojnë drejtimin e mendimit të lexuesit të tyre në gjurmimin e njohjen e parimeve mbi të cilët duhet mbështetur zhvillimin e estetikës dhe të psikologjisë. Në këtë kuadër qëndron edhe mendimi në formë gjykimi konstatues, sipas të cilit në kohën e botimit të këtyre dy veprave, përkatësisht në gjysmën e dytë të shekullit nëntëmbëdhjetë, saktësisht në vitin 1861 dhe më 1891 estetika dhe psikologjia gjendeshin pak a shumë në fazën e konsolidimit konceptual të tyre. Por, këto janë vetëm dy ngjashmëri, madje edhe formale, të këtyre dy veprave. Ndërmjet tyre ka edhe ngjashmëri të tjera megjithëse bëjnë fjalë për parime; lexuesi i kujdesshëm has në vështirësi për të kuptuar natyrën e saktë të parimeve të këtyre dy veprave. Këtë e kanë konstatuar të tjerët para meje: Parimet nuk kanë rend dhe sistem në veprën e Uiliam Xhejmsit[1]. Gati i njëjti gjykim mund të pohohet edhe për veprën e De Radës, kur tashmë është bërë e njohur se përmbajtja e kësaj vepre mbledhur copa-copa dhe janë bërë orvatje për të botuar tërësinë e saj sipas rendit e ngjashmërisë së pjesëve të mbledhura. Megjithëkëtë, përmbajtja e këtyre veprave është paraqitur me koncepte relativisht të shkoqitura; e tëra mund të shërbejë si parim për zhvillimin e estetikë së gysmës së dytë të sh. XIX dhe si të këtillë A. Uçi këtë vepër e ka quajtur ... monument të rëndë-

[1] Gardner Murphy, Historical Introduction to Modern Psychology, London, 1957, f. 57.

sishëm i mendimit estetik të Rilindjes sonë Kombëtare.[2] Këtij gjykimi do t`i shtoja gjykimin vlerësues, sipas të cilit vepra Parime të estetikës e De Radës është vepër dëshmuese për fillet e mendimit psikologjik shqiptar.

Nga përmbajtja e mbarështruar pa rend dhe pa sistem unik parimesh për zhvillimin e estetikës dhe të psikologjisë, kuptojmë se synimiautorëve të këtyre dy veprave disiplinash të ndryshme ishte sqarimi i koncepteve themelore të njerës discipline dhe tjetrës. Kështu, për De Radën estetika e shekullit nëntëmbëdhjetë duhej të merrej me të bukurën, të pandarë nga e mira dhe e vërteta[3]. Ndërkaq, për Uiliam Xhejmsin psikologjia duhej të merrej me studimin vetëdijes e funksionin e saj në zhvillimin e sjelljeve të përshtatëshme të njeriut mjedisit të tij.

Duke konstatuar se dy autorët kanë arritur të argumentojnë mëvetësinë dhe individualitetin e estetikës dhe të psikologjisë në gjysmën e dytë të sh. XIX, autori i kësaj kumtese ka konstatuar se mëvetësia dhe individualiteti i estetikës dhe i psikologjisë, nënkupton edhe lidhjet e disaanshme ndërmjet tyre. E bukura në natyrë dhe në art – lëndë e estetikës, është e pandashme me ndjenjën e së bukurës – lëndë e psikologjisë. Madje, për ndjenja të larta, posaçërisht për ndjenja estetike ka bërë fjalë drejtpërdrejtë De Rada, si dhe Xhejmsi, i cili i ka kushtuar një kapitull të tërë çështjes së ndjenjave dhe përjetimit të tyre. Nga këndvështrimi i ndërlidhjeve të këtilla të estetikës me psikologji, në këtë trajtesë kemi parashtruar dy pyetje: 1. Si janë trajtuar ndjenjat estetike në një vepër estetike? dhe 2. Cili është kontributi i De Radës në zhvillimin e mendimit psikologjik përgjithësisht, me theks të posaçëm në zhvillimin e mendimit psikologjik shqiptar?

Estetika e psikologjia dhe mendimi psikologjik shqiptar

Ndjenjat estetike dhe ato etike janë trajtuar në filozofi, përkatësisht në etikë dhe në estetikë shumë kohë më heret se në psikologji.Trajtimi i këtillë i tyre tashmë është i njohur, kur dijmë se psikologjia i ka fillesat e zhvillimit të saj në filozofi.Psikologjia u pavarësua më 1879, kurse vepra e

[2] Jeronim De Rada, Parime të etstetikës, Përgatitur nga A. Uçi, Globus R., 2003, f. 220.

[3] Jeronim De Rada, po aty f. 54.

De Radës Parime të estetikës u botua më 1861, përkatësisht 18 vjetë para fillimit të zhvillimit të psikologjisë si shkencë e pavarur empirike. Ndërkaq, vepra e U. Xhejmsit Parime të psikologjisë u botua më 1891, ndonëse disa pjesë të kësaj vepre ishin botuar në revista gjatë viteve '80 të shekullit nëntëmbëdhjetë, por vepra e përmendur u botua në tërësi në dy vëllime 12 vjet pas fillimit të zhvillimit të psikologjisë empirike të pavarur. Përmbajtja e dy veprave të përmendura ka ushtruar ndikim në zhvillimin e psikologjisë; mendimi i zhvilluar në veprën estetike të De Radës hyn në rrjedhën e zhvillimit të mendimit psikologjik, sidomos të psikologjisë ndër shqiptarët. Nën ndikimin e tyre psikologjia e mbarimit të sh. XIX dhe e fillimit të shekullit XX dhe më pas i konsideron ndjenjat etike dhe estetike ndjenja të larta dhe të ndërlikuara. Këto ndjenja, ndonëse janë të lidhura ngusht me lëndën e etikës dhe të estetikës, kanë domethënien psikologjike, e cila është e përqendruar në studimin e natyrës, zhvillimit, manifestimit e lidhjes së këtyre ndjenjave me procesin e mendimit e me sjelljet e krijuesit të vlerave estetike si dhe me përjetimin e atyre që i shijojnë këto vlera.

Filologu dhe poeti De Rada në veprën e tij ka shpalosur disa çështje të botës së brendshme të njeriut duke u ndalur posaçërisht në zhvillimin e mendimit dhe të ndjenjave estetike dhe të ndërlidhjeve të këtyre dy proceseve psikike. Studiesit e veprës Parime të estetikës të Jeronim De Radës, por edhe lexuesit e kujdesshëm të saj lehtë mund të konstatojnë se përmbajtja e kësaj vepre ka përmasë dhe strukturë përmbajtësore psikologjike, për të cilën vet autori dhe studiuesit e veprës së tij, me ca përjashtime, as që e kanë përmendur psikologjinë. Këtë provuam ta argumentojmë duke krahasuar përmbajtjen e veprave Parime të estetikës të J. De Radës dhe Parime të psikologjisë të U. Xhejmsit.

Vështrim i shkurtër historik mbi shkrimet në shqipe për artin dhe ndjenjën e së bukurës në veprat e De Radës dhe të Uiliam Xhejmsit

Në vitet ‘80 të sh. XIX estetika dhe psikologjia, pavarësisht se kishin sistemuar e kumtuar gjykime e vlerësime të rëndësishme, ende nuk kishin arritur të konstituoheshin në nivelin e disiplinave me qëllim studimor, me metoda e procedura hulumtuese dhe me sistem gjykimesh, qëndrimesh e

përfundimesh, që do të kishin vlerë të përgjithshme teorike dhe praktike. Me fjalë të tjera, estetika dhe psikologjia gjurmonin parimet e përgjithshme mbi bazën e të cilave do të zhvillonin lendën e tyre. Këtu mendoj se gjendet motivi i autorëve drejtimesh huluntuese dhe vendesh të ndryshme që veprat e tyre t`i emërtonin me formulimin Parime të estetikës dhe Parime të psikologjisë. Në estetikë do të ishin mendime të përgjithsuara dhe të shprehura në formë rregullash mbi themelin e të cilave do të konceptohej në formë më të prerë qëllimi, synimi dhe zhvillimi i disiplinës së filozofisë, përkatësisht i estetikës. Por, duhet përsëritur se nga përmbajtja e veprës Parime të estetikës ato nuk dalin të plota.

Përcaktimi i lartpërmendur për parimet e mirëfillta shkencore vlenë edhe më shumë për psikologjinë, e cila, ndonëse kishte grumbulluar e sistemuar fakte, gjykime e pikëpamje për shpirtin nga filozofia, ende nuk kishte arritur të merrte në formë të prerë të gjitha përmasat fundamentale të një discipline shkencore empirike. Ky konstatim është i verifikuar me faktin se zhvillimi i psikologjisë empirike daton nga viti 1879, kur në Lajpcig mendimtari gjerman Vilhelm Vunt (Wilhelm Wundt, 1832 – 1920) kishte themeluar laboratorin e parë të psikologjisë, kurse në ShBA këtë e kishte bërë Uiliam Xhejmsi (Willim James, 1642-1910) në Universitetin e Harvardit. Kjo lëvizje për themelim laboratorësh gjurmuese është e lidhur edhe me orvatjet e përcaktimit të parimeve mbi bazën e të cilave do të zhvillohej estetika dhe psikologjia empirik**e.** Parimet veprës së De Radës konvergjohen me Parimet e veprës së U. Xhejmsit në një objektiv të përbashkët. De Rada pohon se studimi i jetës së njerëzve ...na zbulon bukurinë tipike të njeriut[4]. Sipas tij, njohja e natyrës së bukurisë së njeriut i përket estetikës, kurse njohja e natyrës shpirtërore, përkatësisht njohja psikike e vetëdijes së njeriut, është e lidhur drejtpërdrejt me psikologji. Lidhur me këtë U. Xhejmsi ka pohuar: na tash jemi përgatitur të fillojmë me studimin e vetëdijes së njeriut të rritur[5]. Pra, në formën e caktuar njeriu e bukuria e tij dhe njeriu dhe vetëdija e tij, përkatësisht njeriu në tërësinë e tij, është

[4] Jeronim De Rada: Parime të estetikës, Globus R. 2003, f. 40.

[5] Mind, 50, f. 167.

objekt i estetikës dhe i psikologjisë. Këtë e ka theksuar edhe N. Abdiu[6]. Mbi këto parime De Rada e ka përkufizuar lëndën e studimit të estetikës teori mbi të bukurën, kurse bukuria qëndron vetëm në shpirtin e njeriut. Ndërkaq, U. Xhejmsi lëndën e psikologjisë e ka përkufizuar po ashtu në bazë të parimeve të tij. Sipas tij Psikologjika është shkenca mbi jetën mentale, mbi dukuritë dhe mbi kushtet e saj[7]. Përmbajtja e veprës Parime të estetikës dhe e Parime të psikologjisë konvergojnë edhe në një aspekt tjetër: të dyja parimet e tyre përpiqen t`i nxjerrin nga qasja e përbashkët duke pasur për pikënisje raportin trup–shpirt, trup–psikikë. Për këtë do të bëhet fjalë më vonë. Por, këtu do theksuar fakti se njohja e parimeve të estetikës dhe e atyre të psikologjisë është e rëndësishme për të kuptuar më saktë ndërlidhjen e estetikës me psikologjinë, sidomos me psikologjinë estetike.

Pas 143 vjetësh prej botimit të veprës së De Radës italisht, 11 vjet pas botimit në gjuhën shqipe shumëçka është thënë për të. Për krijimtarinë e De Radës janë botuar studime, vështrime, kritika, etj. Shumë nga këto botime kanë të bëjnë me çështje letrare, estetike, me gjuhën, poezinë, me folklorin etj. Disa nga këto janë botuar nga J. Kastrati[8], Dh. Shuteriqi[9], Gj. Zheji[10], A. Uçi[11], A. Kondo[12], N. Jorgaqi[13], N. Abdiu[14].

Ndërkaq, për artin dhe ndjenjën e së bukurës më shumë se të tjerët kanë shkruar: A. Uçi[15], N. Jorgaqi[16] dhe N. Abdiu[17]. Për të shënuar 200

---

[6] N. Abdiu: Mbi historinë e mendimit psikologjik shqiptar (deri më 1939), U.F.O Pres, Tiranë, qershor 2010, f. 73.

[7] William James, The Principles of psychology, V. I, Macmillan, 1890, f. 176.

[8] De Rada dhe kritika, Buletini i Institutit Pedagogjik të Shkodrës, nr. 5, 1966.

[9] Letrari i ri, 26. II. 1953.

[10] De Rada dhe Shqipëria, Artisti dhe jeta, Tiranë, 1973.

[11] De Rada mbi artin në Parime të estetikës, Drita, 14. Iv. 1974.

[12] De Rada Jeronim, Flamuri i Arbërit, Tiranë, 1967.

[13] Antologji e mendimit estetik shqiptar 1504–1944, Tiranë, 1979.

[14] Mbi mendimin psikologjik të De Radës, Buletini shkencor i Institutit të Lartë Pedagogjik nr 1, 2, Shkodër, 1984, etj.

[15] Parime të estetikës e J. De Radës – dokument i rëndësishëm estetik i Rilindjes sonë kombëtare, n**ë** Jeronim De Rada: Parime të estetikës, 2003, f. 219-296.

[16] Antologji e mendimit estetik shqiptar 1504 – 1944, Tiranë, 1979.

vjetorin e lindjes së De Radës provuam të analizojmë këto shkrime dhe gjykime të përmbajtjes së kësaj vepre. Por, kësaj radhe këtë e bëjmë në mbështetje të krahasimit të përmbajtjes së kësaj vepre, duke zbatuar një metodë të posaçme: të krahasimit të kësaj vepre estetike me veprën psikologjike të U. Xhejmsit, që ka titullin Parime të psikologjisë.

Për ndryshim nga punimet studimore për De Radën, për U. Xhejmsin, për pikëpamjet e tij mbi jetën psikike dhe zhvillimin e saj, në gjuhën shqipe është shkruar shumë pak, për të mos thënë se nuk është bërë ndonjë interpretim i saj. Sociologu Branko Merxhani[18] e ka përmendur qysh në vitet '30 të shekullit njëzet. Më pas vështirë mund të gjendet në shqipe ndonjë vështrim sado i vogël për njërin nga themeluesit e psikologjisë, për pragmatizmin filozofik dhe për funksionalizmin psikologjik të tij. Nga vitet e fundit të shekullit njëzet emri i Xhejmsit përmendet gjithnjë e më shumë sidomos në librat shkollorë[19]. Ndërkaq, për veprën e tij The Principles of Psychology[20] mbi bazën e së cilës u zhvillua psikologjia sidomos në ShBA, ende mungojnë në shqipe vështrime serioze. Por, emri dhe pikëpamja filozofike e U. Xhejmsit në shqipe përmendet në kuadrin e filozofisë pragmatike, sipas së cilës e vërteta është vetëm ajo që është e dobishme për njeriun. Kjo pikëpamje në vitet '70 të shekullit të kaluar u vlerësua rrymë idealiste subjektive e filozofisë së sotme borgjeze, e përhapur gjerësisht në vendet kapitaliste, sidomos në SHBA[21].

E bukura dhe e shëmtuarja në estetikë dhe në psikologji

E bukura dhe e shëmtuara janë koncepte të ndërlikuara, përkufizohen me vështirësi. E bukura i përket kategorisë së vlerave njerëzore.

---

[17] Nuri Abdiu: Mbi historinë e mendimit psikologjik shqiptar (deri më 1039), f. 106, 118, 135, 160, 192, 211, Tiranë, 2003.

[18] Ndriçim Kulla, Medimi filozofik, sociologjik dhe psikologjik shqiptar (1870-1945), Plejad, 2004.

[19] Terry F. Pettijohn: Psikologjia, Një hyrje koncize, f. 10, 12, 160, 318, 358, Shtëpia Botuese Lilo, Tiranë, 1996.

[20] William James: The Principles of Psychology, Macmillan, 1890.

[21] S. Pëllumbi–F. Spahiu: Fjalor i filozofisë, f. 267, Tiranë, 1974.

Vlera vlen për vetë njeriun, plotëson një ndër nevojat imediate të njeriut. Në këtë kuptim vlerën dhe rëndësinë e saj e përcakton njeriu; vetëm njeriu është në gjendje t`i njohë, shijojë dhe vlerësojë ato. Vlerat janë të lidhura drejtpërdrejt me qenien integrale biologjike, sociale e psikologjike të njeriut; vlerë e njëmendët shpirtërore e njeriut është dhe bukuria natyrore e objekteve (e rrobave, e trupit të njeriut, e shtëpisë, etj.), por edhe e veprave artistike të krijuara nga njeriu. Përcaktimi domethënës i vlerave varet nga qasja që i bëhet vlerës së bukurisë në estetikën objektive dhe në atë subjektive. Në estetikën objektive e bukura cilësohet tërësi e harmonishme e ndërlidhjes së formës me përmbajtjen e një objekti, dukurie, krijimi, etj. Sipas këtij kuptimi e (i) bukur mund të jetë njeriu me raport të harmonizuar të trupit, gjymtyrëve dhe kokës së tij, lulishtja në acar ka bukuri, etj. Por, bukuria e këtillë merr status të vlerës njerëzore vetëm nga njeriu, i cili është në gjendje ta perceptojë, ta kuptojë, ta shijojë dhe ta dëshirojë këtë bukuri të lulishtes, madje edhe në acar. E bukura dhe e shëmtuara kanë përmasë të theksuar subjektive, përkatësisht psikologjike. Karakterin psikologjik të së bukurës e përcakton jo vetëm ndjesia e të bukurës nga ana e njeriut, kur ndaj tij vepron një ngacmues i tërësishëm pamor ose dëgjimor, apo pamor-dëgjimor, por edhe fakti se kjo ndjenjë lidhet ngusht me një ambicie, bindje, interesim, qëndrim, etj. Ndjenjat, përfshirë ndjenjat estetike, etike, atdhetare, etj., i përkasin psikologjisë, me studimin e tyre merret psikologjia. Me to merret psikologjia estetike. Psikologjia estetike në kuptimin e gjerë të saj studion perceptimin estetik, zhvillimin e aftësive perceptuese të së bukurës, të vlerësimit, të përjetimit dhe të krijimit të së bukurës. Në këtë kontekst shtrohet çështja e trajtimit të së së bukurës në veprën estetike të De Radës dhe në veprën e Xhejmsit Parime të psikologjis**ë.**

Metodat hulumtuese

Për t`iu përgjigjur qëllimit tonë studimor, për të dhënë përgjigje në pyetjet Çfarë janë ndjenjat estetike në strukturën përmbajtësore të veprave të De Radës Parime të estetikës dhe të U. Xhejmsit Parime të psikologjisë zbatuam metodën e analizës së përmbajtjes së këtyre veprave. Kjo është metodë objektive e përcaktimit të konceptit kryesor dhe koncepteve të derivuara nga kryesori, e lidhjeve ndërmjet tyre dhe, sidomos, e vlerës sasi-

ore të secilit koncept dhe e rangut që zë secili syresh në përmbajtjen e këtyre veprave. Koncepti kryesor i analizës së përmbajtjes të këtyre veprave është njëkohësisht njësia themelore e analizës së përmbajtjes. Ky është koncepti ndjenja e bukurisë. Analiza sasiore e këtij koncepti dhe koncepteve të varura nga ky bëhet me qëllim të nxjerrjes në pah të karakteristikave të domethënies së këtij koncepti dhe cilësive të porosive të autorit për njohjen e së bukurës dhe të ndjenjave të njeriut, që janë të lidhura me të. Kjo njohje ka rëndësi për zhvillimin e estetikës, por edhe të psikologjisë, të përcaktimit të tipareve të personalitetit krijimtar të konceptit për të bukurën dhe përcaktimit të mundshëm të tipareve të atyre, të cilëve u është drejtuar autori i veprës Parime të estetikës.

Analiza sasiore. Ndjenjat estetike. E bukura dhe e shëmtuarja dhe ndjenja e së bukurës dhe të shëmtuarës në Parime të estetikës

Konceptet e bukura/ e shëmtuara dhe ndjenja e së bukurës/ e s**ë** shëmtuarës, janë konceptet me denduri përdorimi nivelesh të ndryshme. Në përpunimin statistikor të këtyre koncepteve konstatojmë se ato janë përdorur 81 herë. Në këtë shumë të përgjithshme dallojmë përdorimin e drejtpërdrejtë dhe tërthorazi të këtyre dy koncepteve; e bukura me emërtimin e saj u përdor 64 herë dhe e shëmtuara po me këtë emërtim u përdor shprehimisht vetëm 3 herë, duke mos llogaritur faktin se e bukura me domethënien pozitive të saj përjashton të shëmtuarën me faktin se e shëmtuara ka kuptim të kundërt me të bukurën. Kështu ngjet dhe me konceptin ndjenjë e së bukurës/ ndjenjë e së shëmtuarës; numerikisht ky term është përdorur vetëm 3 herë, por tërthorazi ka kuptuar të kundërtën e së bukurës sa herë që është përdorur termi ndjenjë e bukurisë. Autori i veprës që analizojmë ka dalluar me emërtime të veçanta të bukurën në natyrë, në art dhe të bukurën e shpirtit. Madje termin bukuria e shpirtit e ka përdorur 12 herë.

Ndjenjës së të bukurës dhe të shëmtuarës i atribuohen disa emocione. Këtë e paraqet tabela e mëposhtme, ku bri secilit emocion është dhënë dendësia numerike e përdorimit të tyre.

Tabela 1

Ndjenja e së bukurës:	**Ndjenja e së shëmtuarës:**
dashuria 24	neveria 1
kënaqësia 22	hidhërimi 2
lumturia 8	mërzia 2
gëzimi 7	trishtimi 2
madhështia 7	zemërimi 1
krenaria 3	
adhurimi 1	
mahnitja 1	
simpatia 1	

Ndjenjat morale. Virtytet dhe veset e njeriut në veprën Parime estetike

De Rada në Parime të estetikës ka bërë fjalë jo vetëm për ndjenjat estetike, por edhe për moralet. Këtë e dallojmë në disa gjykime, sidomos në gjykimin, sipas të cilit Arti botëror vërteton se thelbi i së bukurës qëndron në drejtësinë, në sinqeritetin[22]. Jo vetëm kaq, por sipas tij ..,kudo që gjendet e bukura, kjo ka kurdoherë karakter moral[23].

Ndjenjat morale polarizohen në virtyte dhe vese njerëzore. Prania e virtyteteve dhe eseve te njeriu është e lidhur me ndjenja përkatëse të tyre, përkatësisht me ndjenja të virtyteteve (ndjenja morale pozitive) dhe ndjenja të veseve (ndjenja morale negative). Virtytet dhe ndjenjat morale positive, si edhe veset e ndjenjat morale negative shfaqen me përjetim llojesh të ndryshme të ndjenjave, si: ndjenja e nderit, e drejtësisë, e fisnikërisë, etj., kurse ato negative shfaqen me përjetim të fajësisë, çthurje ndjenjash morale, me mëri, etj. Secila nga llojet e ndryshme të virtyteteve dhe veseve dhe të ndjenjave manifestuese të tyre në këtë vepër kanë dendësi përdorimi të ndryshme. Këtë e paraqesim në tabelën e mëposhtme

[22] Po aty, f. 74.

[23] Po aty, f. 59.

Tabela 2

Virtytet e ndjenjat morale pozitive	Veset dhe ndjenjat morale negative
ndjenja e drejtësisë 11	ndjenja e fajësisë kundruall pafajsisë 4
e besimit 8	e shthurjes morale 2
e mirësisë 7	e trillimit 1
e dashamirësë 6	e tendenciozitetit (e shpirtanësisë) 1
e dhembshurisë 5	e poshtërsisë 1
e nderit 3	e egoizmit 1
e nderimit 3	e mërisë 1
e mbarësisë 3	e keqëbërjes 1
e çiltërisë 3	e neverisë 1
e dlirësisë 3	
e zemërmirësisë 2	
e fisnikërisë 1	
e bujarisë 1	
e vendosmërisë 1.	

Raporti ndërmjet ndjenjave estetike dhe ndjenjave morale në veprën e Jeronim De Radës

De Rada i ka vështruar ndjenjat estetike në raport të ngushtë me ndjenjat morale të njeriut. Këtë e dallojmë në pohimin: Lloji kryesor i bukurisë është drejtësia (e dreqja), e cila i përngjan dritës, që shtrihet pa cak e kufi dhe perhap kudo gëzim[24] ..., thelbi i së bukurës qëndron në drejtësinë, në sinqeritetin.[25] E bukura..., na bën të mundur të mbajmë qëndrim e t'i vlerësojmë si të mira ose të këqia veprimet e njerëzve nga fakti se këto nderojnë apo fyejnë virtytet e njerëzve të ndershëm[26], etj.. Për këtë shkak gjurmuam ndërlidhjen e bukurisë me virtytet, përkatësisht të shëmtuarën me veset. Këtë raport u përpoqëm ta vlerësojmë në bazë të vlerave sasiore të koncepteve estetike dhe etike të veprës së De Radës. Për këtë qëllim zbatuam procedurën e zakonshme të rangimit të këtyre koncepteve duke vënë përball koncepteve esetike me rang më të lartë konceptet etike po ashtu me rang më të lartë. Në këtë mënyrë përfituam këto proporcione të koncepteve të ndjenjave së të bukurës dhe të ndjejnjave së të mirë**s**të rangut më të lartë, përkatësisht të rangut 1–4.

[24] Po aty, fq. 69 – 70.

[25] Po aty, fq. 74.

[26] Po aty, fq. 97.

Tabela 3

Ndjenjat pozitive

Ndjenja e së bukurës:	**Ndjenja e së mirës:**
dashuria24 (28, 91%)	ndjenja e drejtësisë 11 (16, 66)
kënaqësia22 (26,59%)	besimi8 (12. 12%)
lumturia8(9, 63%)	mirësia7 (10, 60)
gëzimi 7(8, 43%)	dashamirësia6 (9, 09%), etj**.**

Ndjenjat negative

Ndjenja e së shëmtuarës:	**Ndjenja e së keqës:**
hidhërimi 2 (50 %)	fajësia 4 (40%)
mërzia 2 (50%)	çthurja morale 2 (20%)
zemërimi 1 (25%)	neveria 1 (10%)
trishtimi 1 (25%)	poshtërsia 1 (10%), etj.

Koment: të dhënat elementare statistikore tregojnë se autori ka bërë diferencimin e ndjenjave estetike dhe etike sipas kritereve klasifikuese duke pasur për bazë shfaqjen e ndjenjës së të bukurës – të shëmtuarës dhe të mirës – të keqes me anë të ndjenjave të veçanta. Duke u nisur nga kjo ndarje mund të nxierret gjykimi përfundues se ndjenja e bukurisë është përjetuar nga shkrirja e përjetimit të dashurisë, të kënaqësisë, të lumturisë dhe të gëzimit në një ndjenjë cilësish të veçanta, që është quajtur ndjenja e bukurisë. Ndërkaq, ndjenja e së mirës është shkrirje e ndjenjës së drejtësisë, të besimit, të mirësisë dhe të dashamirësisë në një ndjenjë të përbashkët – në ndjenjën e së mirës. Kështu mund të shpjegohen edhe ndjenja e së shëmtuarës dhe ajo e së keqes. Por, dendësia më e lartë e disa ndjenjave pozitive tregon ngritjen e fuqisë tërheqëse të njeriut drejt atyre perceptimeve, që shkaktojnë ndjenja pozitive. Kjo fuqi e këtyre ndjenjave shfaqet në ndjeshmërinë e njeriut që këto ndjenja të kenë kohëzgjatje sa më të madhe, si edhe në nevojën e krijimit të gjendjeve psikike të këtilla të njeriut. Rrjedhimisht, shkalla e ulët e dendësisë së ndjenjave të së shëmtuarës dhe e të së keqes tregon ndjeshmërinë e njeriut ndaj tyre, që shfaqet në gjendje emocionale të padëshirueshme dhe refuzuese të njeriut ndaj këtyre ndjenjave. Këto rezultate janë të ngjashme me rezultatet e disa hulumtimeve të këtyre ndjenjave në mjediset etno-kulturore të tjera.

Analiza cilësore. Ndjenja e së bukurës dhe e së shëmtuarës në Parime të estetikës të Jeronim De Radës

De Rada në Parime të estetikës përmes diskursit eseistik e jo poetik ka parashtruar çështje të rëndësishme për njohjen dhe përjetimin e së bukurës që nga dekada e gjashtë e shekullit XIX. Esetë e parashtruara në librat e tij për pikëpamjen dhe qëndrimet e tij mbi parimet në fjalë janë të kapluara tërësisht me raportin estetikë–psikologji, për të cilin ai nuk ka formulime gjykimesh shprehimisht përkatëse. Këto parime, pra, i përkasin jo vetëm estetikës, por edhe psikologjisë. Mirëpo, në përmbajtjen e veprës Parime të estetikës të De Radës vështirë mund të fokusohen parime në kuptimin e mirëfilltë të tyre, ngase lënda është mbledhur në mënyrë të pjesshme ose fragmentare dhe është paraqitur në botimin e saj sipas rendit të lidhjeve të pjesëve të ndryshme të saj. Kjo qasje ka shkaktuar që parimet estetike të mos dalin të plota. Këtë e thekson edhe studiuesi i estetikës A. Uçi, i cili e ka përgatitur për botim veprën Parime të estetikës.

Në relacionin konceptual trup-shpirt De Rada i përcakton trajtim të posaçëm të bukurës/ të shëmtuarës, ndjenjës së të bukurës/ ndjenjës së të shëmtuarës, duke konsideruar trupin qenie të posaçme, që, siç thotë ai, përveç qenies trupore, që është e shtrirë në gjithë natyrën, ekziston edhe shpirti, i shpërndarë gjithandej mbi tokë... Forca emocionuese e së bukurës dhe vlera e saj në botë nuk duhen kërkuar në jetën trupore, por gjetiu[27]. Kjo gjetiu është shpirti, natyrën e të cilit e përbëjnë besimi, drejtësia dhe mirësia, kurse bukuria është ajo që e rrit dhe e përsos natyrën e shpirtit[28]. Bukura i atribuohet shpirtit, i cili përbën unitet organik me trupin dhe mendjen. Por, për nga funksioni trupi ndryshon nga mendja dhe nga shpirti. Trupi, sipas De Radës, përbën qenien e tij të jashtme materiale, kurse shpirti qenien e tij të brendshme, ndërkaq, mendja zbulon shkakun e qenies së saj dhe vlerën e saj absolute, madje, kjo, përkatësisht mendja, e njeh të bukurën dhe është vazhdimisht në kërkim të saj. Mendja orvatet vazhdimisht të gjendet kundër çdo ndikimi që e shëmton të bukurën duke sy-

[27] Jeronim De Rada, Po aty, f. 27 dhe 37.

[28] Po aty, f. 39-40.

nuar që me të të çlirojë shpirtin nga e shëmtuara dhe nga e keqja, kur këto gjenden brenda nesh. Çlirimin e njeriut nga e keqja e brendshme e tij ai e sheh në synimin e njeriut për ta mbajtur të gjallë tonusin emocional të njeriut për të bukurë**n.**

Dinamika e njeriut dhe e bukura

Përbërësit e jetës së njeriut (trupi, shpirti e mendja) i kanë tiparet e veta. Trupi ushqehet me lëndë unilitare, shpirti ushqehet me bukurinë e objekteve dhe të krijimeve artistike, kurse mendja me shpejtësinë e saj ushqehet me njohjen e së vërtetës. Lidhur me këtë, konstatojmë se De Rada i atribuon njeriut tipare dinamike, kur pohon se zhvillimi i njeriut ka tri lloje kërkesash ndaj botës që e rrethon. Këto kërkesa janë: kërkesat materiale, që i plotëson me sendet utilitare, kërkesat e intelektit a të mendjes, që i plotëson me dije dhe kërkesat e shpirtit, që i plotëson me të bukurën[29]. Mirëpo, De Rada ka pikëpamje të posaçme për raportin trup-shpirt. Sipas tij ...edhe në botë ky (njeriu P. N.) nuk e percepton trupin, por moduset, idenë dhe qëllimin e Mendjes së Perendisë kudo[30], madje, sipas tij: ...e bukura, me dinjitetin e natyrshëm dhe me larminë e pafundme të saj, paraqitet si shembëlltyrë e Zotit, e dhënë permes shpirtit ose e pasqyruar në botën e krijuar prej tij[31]. Sipas tij ideja e bukurisë është baza e ekzistencës reale të saj, kurse trupi, gjësendet, natyra përgjithësisht, janë produkte të ideve; vetëdija për bukurinë është parësore; ekzistimi i botës së jashtme dhe i gjithë gjësendeve fizike e sociale, etj. varet nga perceptimi i njeriut, përkatësisht këto janë kombinime të ndijimeve të njeriut. Për këtë shkak me të drejtë studiuesit e veprës së De Radës e kanë konsideruar krijues me pikëpamje idealiste[32]. Këtë gjykim konstatues e hasim edhe te studiuesi i mendimit psikologjik shqiptar Nuri Abdiu, kur thotë ...De Rada paraqitet idealist në analizën dhe interpretimin që u bën dukurive shoqërore, e si pa-

[29] Po aty, f. 222.

[30] Po aty, f. 26.

[31] Po aty, f. 52-53.

[32] Po aty, f. 243.

sojë, nuk është në gjendje të shpjegojë drejt burimin e ndjenjave estetike[33]. Këtij drejtimi filozofik i përket edhe filozofi dhe mendimtari gati bashkëkohanik, që u mor me studimin e parimeve të një disciplinë tjetër, asaj të psikologjisë, U Xhejmsi, për të cilin do të bëjmë fjalë më poshtë.

Perceptimi i së bukurës dhe përjetimi i saj

Jeronim De Rada perceptimit të së bukurës i ka kushtuar pjesën më të madhe të meditimeve të tij. Sipas tij e bukura ka të bëjë me harmoni, me rregullsi përbërësish të një tërësie dhe me formën të vlerësuar si proporcionalitet raportesh ndërmjet elementeve dhe përmbajtjeve të një tërësie. Në këtë kontekst ai ka konsideruar të bukura posaçërisht ato objekte dhe krijime, që njeriu i merr duke angazhuar shqisën e të parit dhe atë të të dëgjuarit, here-herë edhe të dy këto shqisa. Mbi këtë bazë ai ka konsideruar pozinë, muzikën dhe pikturën ushqim kryesor të shpirtit të njeriut[34]. Por, e bukura e këtyre stimujve harmonikë, me rregullsi dhe proporcionalitet raportetesh ndërmjet elementeve përbërës të së bukurës dhe ndërmjet formës e përmbajtjes së një krijimtarie poetike, muzikore dhe pikturore, është e lidhur drejtpërdrejt me atë që De Rada e ka quajtur konkordim me masën e brendshme të ndjenjave dhe me forcën emocionuese të së bukurës. Vlera e kësaj force emocionuese aktivon shpirtin duke e qetësuar atë, dhe, me këtë rast, njeriu bëhët i vetëdijshëm për ndjenjën e lartë të së bukurës. Ndjenjës së këtillë ai i ka afishuar karakterin individual, sepse sipas tij, nuk e konceptojnë të gjithë njerëzit me të njëjtën lehtësi të bukurën në çdo trajtë që të paraqitet[35]. Megjithëkëtë, e bukura është kombinim i ndijimeve për harmoni, rregullsi dhe proporcionalitet, që buron nga shpirti i njeriut.

Ndjenjat estetike përjetohen të lidhura ngushtë me ndjenjat morale. Për J. De Radën bukuria e shpirtit zbulohet edhe në shikimin, në veprimin, në fizionominë, në të cilat shprehen virtytet e këtyre njerëzve (fjala është

[33] Nuri Abdiu. Mbi historinë e mendimit psikologjik shqiptar (deri më 1939), botimi i dytë, U.F.O Pres, Tiranë, qershor 2010, f. 185.

[34] Po aty, f. 32-36.

[35] Po aty, f. 34.

për Edipin dhe Jokastën në dramën e Sofokliut P. N.)[36]. Ngushtësisht lidhur me këtë gjykim për lidhjen e bukurisë me virtyte morale hasim në disa gjykime pohuese tjera, ndër të cilat dallohet edhe gjykimi ...për shpirtin njerëzor bukuria është pamja e njerëzve me virtyte, që janë të një natyre me shpirtin dhe me ndihmën e të cilave ai zhvillohet e përsoset[37]. Madje, edhe në komentimin e bukurisë së personazheve të veprave letrare ai pohon: Bukuria e personazheve të veprave qëndron, pra, në vlerat morale të këtyre njerëzve të ndershëm, në gjurmët e aspiratave dhe të veprimeve që kanë kryer ose do të kryejnë[38]. Këtu ai ka bërë fjalë për vullnetin, dashurinë, ndjenjën e fajsisë dhe atë të pafajsisë, të ndershmërisë, etj. Sipas tij këto ndjenja shfaqen edhe në fytyrën e njeriut; në ndryshimet e pozicionit të muskujve të saj manifestohen në forma karakteristike ndjenjat e bukurisë,të ndershmërisë, të dashurisë, të fisnikërisë etj.

Fusha psikologjike dhe struktura e saj në Parime të estetikës

Vepra e De Radës përbën një fushë të veçantë dhe një strukturë konceptuale psikologjike të rëndësishme për zhvillimin e mendimit jo vetëm estetik, por, siç përmendëm, edhe atij psikologjik. Koncepti deradian për çështjen e raportit trup–shpirt, materie–shpirt nxiti studimin e këtij raporti duke e shtyrë këtë çështje studimore në gjurmim të raportit trup–mendje–truri i njeriut. Nga mendimi i tij për trupin e njeriut zhvillohet mendimi për trurin e rëndësinë e strukturës dhe të funksionimit të tij për jetën e gjithëmbarshme psikike të njeriut; nga mendja e njohja e së bukurës, më vonë trajtohet kognicioni e proceset e njohjes jo vetëm të së bukurës në natyrë e në art, por i të gjitha dukurive, objekteve, proceseve dhe raporteve objektive; nga veprimi e sjellja e njeriut ndaj të bukurës zhvillohet një spektër i gjerë mendimesh e qëndrimesh për jetën emocionale dhe motivuese të njeriut dhe zhvillimin e saj.

Siç pamë, përjetimi i së bukurës është i pandarë nga rezonanca me

[36] Po aty, f. 42-43.

[37] Po aty, f. 48.

[38] Po aty, f. 42.

shpirtin e njeriut dhe nga ky burim zhvillohen dijenitë për proceset e ndërlikuara psikike si edhe rrymimet e vetëdijes së tij. Në veprën e De Radës lidhja estetik- etikë u shoqërua me qëndrime të psikologjisë, të pathëna nga De Rada, por edhe nga shumë studiues të veprës së tij. Në kuadrin e komentimit të ndërlidhjeve të ndjenjave estetike me ndjenjat morale dallojmë termat e shumë koncepteve të psikologjisë, që me shtrirjen kuptimore të tyre i kalojnë caqet e kësaj ndërlidhjeje. Të këtillë janë: perceptimi i formës, perceptimi artistik, shpirti, dashuria, mendja, mendimi, ndjenja të larta, forca emocionale, vullneti, veprimi, meditimi, krijimtaria, imagjinata, fantazia, dëshira, ëndja trupore, kënaqësia, melankolia, epshi, vuajtja, afshi i shpirtit, simpatia, vëzhgimi, gëzimi, dhembja, pasioni, karakteri, mahnitja, ngazëllimi, kompleksi emotiv, e pavetëdijshmja, krenaria, zemërimi, vegimi, ezaurimi, tendencioziteti, krijimtaria individuale, dhuntia, shpirti i emocionuar, aspirata, besimi, edukata shpirtërore, mençuria, aftësia krijuese, madhështia shpirtërore, pasionet e larta, përkorësia, zgjuarsia, shpresa, egoizmi, neveria, mëria, ankthi, intuita, vetëdija e unit, etj. Megjithë këtë ai pohon se në gjuhën shqipe ... janë të pakta fjalët teknike[39]. Më në fund, ajo që është e re në këtë vështrim, ka të bëjë me konstatimin se në veprën e J. De Radës ndihet ndikimi i filozofisë në zhvillimin e mendimit psikologjik para themelimit të psikologjisë si shkencë empirike. Kjo është koha kur psikologjia si shkencë merrej më tepër me hetim faktesh psikike për të identifikuar strukturën psikike të njeriut, përkatësisht të vetëdijes së tij. Në këtë kuadër konstatojmë praninë e qasjes strukturaliste në trajtimin e unitetit trup-mendje-shpirt. Në përcaktimin e pozicionit të ndjenjës së bukurisë në kuadrin e raportit trup-memdje-shpirt ai është mbështetur në ato fakte psikike, që arriti t'i identifikonte në bazë të vetëvëzhgimit të përvojës personale në procesin e zhvillimit të jetës, të veprimtarisë intelektuale dhe të krijimtarisë poetike të tij.

Qasja strukturaliste e përjetimeve psikike, sidomos e përjetimeve ndjenjore të së bukurës dhe vetëvëzhgimi i këtyre përejtimeve tregon përmasën dhe strukturën psikologjike të veprës Parime të estetikës, si edhe mëvetësinë e esetikës dhe lidhjen e saj me psikologji. Për këto shkaqe vep-

[39] Po aty, f. 133.

ra Parime të estetikës do të sistemohet në kuadrin e veprave, që i kanë paraprirë zhvillimit të mendimit shkencor psikologjik; kësaj vepre i takon pozicioni i veprës filozofike në burimin e fakteve psikike për formim të identitetit të psikologjisë ndër shqiptarët dhe për zhvillimin e saj.

Ndjenjat estetike në Parime të psikologjisë të U. Xhejmsit

Në veprën e U. Xhejmsit, ngjashëm me atë të De Radës, parimet nuk kanë rend dhe sistem. Duke lexuar me kujdes librin Parime të psikologjisë lexuesi dhe analizuesi me vështirësi do të dallonte unitetin strukturor të këtyre parimeve[40]. Në këtë pikëpamje ai nuk ka qenë konseguent. Megjithëkëtë, parimet e këtilla ushtruan ndikim në konsolidimin konceptual të psikologjisë të fundshekullit nëntëmbëdhjetë.

Uliem Xhejmsi pikëpamjet e tij mbi ndjenjat përgjithësisht i ka shtjelluar në kuadrin e gjurmimit të raportit trup-shpirt, ku ka insistuar në largimin nga psikologjia të konceptit shpirt. Këtë ai e ka kërkuar duke e mbështetur studimin e psikologjisë në dy parime themelore: **1. Parimi I tërësisë së individualitetit të njeriut.** Në trajtimin e personalitetit të njeriut tërësi integrale e pacoptueshme, njeriu unin e tij e shfaqë në katër forma: **a. uni lëndor** (trupi i im, rrobet e mia, pasuria e ime, etj); **b. uni shoqëror** (gjithë ajo që ka të bëjë me synimet e njeriut kah prestixhi, miqësi me të tjerët, vlerësim pozitiv i tij nga të tjerët); **c. uni frymor** (proceset e vetëdijes, aftësitë psikike) dhe, më në fund, **d. uni i pastër ose ndjenja e identitetit**, bazën e të cilit e formojnë ndijimet organike (të organeve të brendshme dhe atyre muskulorë) 1 (William James, The Principles of Psychology, vëllimi, New York, 1890).

2. Parimi i rrymimit të vetëdijes së njeriut. Sipas këtij parimi vetëdija e njeriut është gjithmonë në proces të ndryshimit të vazhdueshëm. Në kuadrine procesit të këtillë të vetëdijes ka dalluar këto karakteristika të vetëdijes së njeriut: rrymimi i vetëdijes ka tipare personale; sipas kësaj karakteristike secila gjendje e vetëdijes synon të jetë pjesë e vetëdijes personale (mendimi, ndjenja, dashja, etj. gjithmonë konsiderohen nga ana e

[40] G. Murphy, Historical Introduction to Modern Psychology, London, 1957, f. 165.

njeriut mendimi i im, ndjenja e ime, dashja e imet, etj.). Rrymimi i këtillë i vetëdijes është një proces, i cili nuk mund të ndalet, por ai rrjedhë vazhdimisht siç rrjedhë uji i lumit. Gjatë këtij procesi vetëdija personale përjetohet si proces i pandashëm, i pakëputur në copa ose grimca gjendjesh të vetëdijes; gjendja e vetëdijes që një herë kalon nëpër këtë proces nuk mund të kthehet në vetëdije në mënyrë identike. Karakteristika e katërtë dhe e fundit e rrymimit të vetëdijes së njeriut është funksioni përzgjedhës i vetëdijes në procesin e pakëputur të saj. Me këtë kuptojmë vetëdija zgjedhë, kjo përvetëson ose dhe refuzon pranimin e imazheve për objekte të caktuara. Përzgjedhja ngjet gjithmonë, kur njeriu mendon dhe shfaqet objektivisht në rolin përzgjedhës të vëmendjes dhe në aktet e vullnetit të tij.

Megjithëkëtë, në rrymim të pandërprerë të vetëdijes, U. Xhejmsi ka prekur edhe gjendjen statike të vetëdijes.Këtë e konstatojmë në dallimin e gjendjes substanciale të vetëdijes nga gjendja transitive e saj, qysh ai i ka emërtuar këto gjendje. Sipas tij në rrymimin e vazhdueshëm të vetëdijes dallohen edhe disa gjendje qetësuese të saj: këto i përngjasin vendeve pushuese të vetëdijes, kur funksioni i saj nuk ndryshon përbrenda një kohe të caktuar dhe gjendjet e këtilla janë të mbushura me ndikime shqisore dhe me përfytyrime të përqëndruara në një përmbajtje të caktuar. Gjendjet e këtilla të vetëdijes Uiliam Xhejmsi i ka quajtur gjendje substantive. Ndërkaq, gjendjet transitive të vetëdijes janë kapërcimet e shpejta të vetëdijes, që lidhin një gjendje substantive me gjendjen tjetër substantive. Në gjendjen substantive perceptohet e bukura e një pikture, e vargjeve poetike, e komponimit muzikor të caktuar, e gjimnastikës estetike, etj.

Derisa në veprën Parime të estetikës të De Radës dallohen trupi, shpirti dhe mendja me funksione të veçanta të tyre, në Parime të psikologjisë të Xhejmsit bëhet fjalë vetëm për aktivitetin e vetëdijshëm të njeriut, për gjendjen procesore të funksionit të saj, si edhe për rolin përzgjedhës të vetëdijës në kuadrin e procesit të pandalshëm të funksionit të saj. Nga ky këndvështrim parimet e trajtimit të trupit, të shpirtit dhe të mendjes së njeriut, si edhe ndërlidhjet e funksioneve të tyre nga ana e De Radës janë të pakrahuasueshme me atë të U. Xhejmsit. Megjithëkëtë, në këtë krahasim disa dromca të përbashkëta mund të gjenden.

Emocionet dhe ndjenja e së bukurës në Parime të psikologjisë të U. Xhejmsit

Uiliam Xhejmsi ka ngel i njohur sidomos me qasjen origjinale të studimit të emocioneve. Duke iu përmbajtur vazhdimisht çështjes themelore të psikologjisë dhe të filozofisë përgjithësisht raportit trup – shpirt, ai ka konceptuar një teori të posaçme të emocioneve. Kjo teori në literaturën e psikologjisë është e njohur me emërtimin Teoria Xhejms – Lang e emocioneve. U emërtua me këtë shprehje, sepse si Uiliam Xhejmsi ashtu edhe psikologu danez pothuajse në të njëjtën kohë arritën në përfundime të njëjta. Sipas Ulijam Xhejmsit për të kuptuar emocionet, llojet, përjetimitn e tyre, zhvillimin dhe shfaqjen e emocioneve është e domosdoshme të gjurmohet lidhja e emocioneve me ndryshime fiziologjike të organizmit të njeriut. Duke gjurmuar këtë lidhje në laboratorin psikologjik të tij, ai ka ardhur në përfundim secili emocion nuk është agjë tjetër përpos produkt i ndryshimeve fiziologjike të organizmit të njeriut... Emocionet përgjithësisht nuk mund të ekzistojnë jashtë ndryshimeve fiziologjike. Me fjalë të tjera, përjetimin e emocioneve e shkaktojnë ndryshimet fiziologjiike të organizmit. Ai nuk është marrë posaçërisht me studimin e ndjenjave etstetike, por për të argumentuar teorinë e tij ai ka studiuar emocionet e zakonshme, posaç përfyndimerisht at përfyndime të frikës dhe të zemërimit. Në mbështetje të rezultateve studimore ai ka bërë këtë përshkrim të emocioneve: njeriu e sheh ariun, pas kësaj nuk përjetohet frika e më pas shfaqja fiziologjike e frikës, por ngjet e kundërta: në fillim shkaktohen ndryshimet fiziologjike të organizmit të njeriut (ndryshime në organet e brendshme) në sistemin e qarkullimit të gjakut, të gjëndrave me tajim të brendshëm, në muskuj, në veprime, etj. dhe këto ndryshime janë shkaktare të shfaqjes së frikës. Derisa më parë ndryshimet fiziologjike shpjegoheshin si pasojë e emocioneve, sipas Ulijam Xhejmsit, ngjet e kundërta: më parë ngjasin ndryshimet fiziologjike dhe më pas shfaqet emocioni i caktuar. Sipas kësaj teorie, kur e vëzhgojmë me kujdes një pikturë, e dëgjojmë një komponim muzikor, e lexojmë një poezi, etj.ndjenja e së bukurës shfaqet si rezultat i ndryshimeve fiziologjike në metabolizmin e njeriut, që i paraprijnë përjetimit të ndjenjës së bukurisë. Vërtetë ndryshimet fiziologjike janë të pandara nga emocionet, por vetëm në bazë të ndryshimeve fiziologjike vështirë

mund të përcaktohet lloji i emocioneve. Për këtë shkak mo vonë u paraqiten pikëpamje teorike tjera për raportin ndryshime fiziologjike-emocione. Por, megjithëkëtë esenca e raportit ndryshime fiziologjike-emocione ende nuk është shpjeguar tërësisht.

Diskutim

Në qasjen e përbashkët të studimit të raportit trup – shpirt dallojmë qasje të posaçme të Jeronim De Radës dhe Ulliam Xhejmsit, në gjurmimin dhe përcaktimin e parimeve të estetikës dhe të parimeve të psikologjisë. Derisa Jeronim De Rada i është qasur parimeve estetike mbi bazat e mendimit utilitar, Uiliam Xhejmsi i ka zhvilluar mendimet e tija për parime të psikologjisë mbi bazën e mendimit të pragmatizmit, sipas të cilit bukuria e objekteve, e proceseve, e situatave, etj. është e pandashme nga ndryshimet fiziologjike të organizmit të njeriut e ndjenjat përkatëse, dhe, si e këtillë, përjetohet kur objekti, situata, procesi, etj. janë të dobishme për jetën e njeriut. Nga kjo pikëpamje qëndrimet e Jeronim De Radës për ndjenjat përgjithësisht nuk dallohen nga qëndrimet e Uiliam Xhejmsit.

Në veprën e Jeronim De Radës dallohen parimet estetike të mbështetura në sintezën e ndjenjave estetike-etike. Kjo mbështetje, si edhe përdorimi i shumë koncepteve psikologjike me termat e tyre i ka dhënë kësaj vepre filozofike një përmasë të psikologjizimit. Kjo përmasë bënë të dallojmë se vepra Parime të estetikës përkon me estetikën subjektiviste dhe ka nxit zhvillimin e saj. Këtë pjesërisht e argumenton revolta e Benedeto Kroçes kundër estetikës subjektiviste.

Vepra Parime të estetikës u tregua e rëndësishme për zhvillimin e mendimit estetik dhe njëkohësisht edhe për zhvillimin e mendimit psikologjik në përgjithësi, sidomos ndër shqiptarët. Kjo vepër ushtroi ndikim në formimin e identitetit të mendimit estetik dhe psikologjik shqiptar që nga koha e botimit të saj në italishte, sidomos pas botimit të saj në gjuhën shqipe. Disa qëndrime për shpirtin dhe ndjenjat shpirtërore, të qëruara nga pikëpamja religjioze, kanë bërë që përmbajtja e veprës Parime të estetikës të jetë vepër motivuese në zhvillimin e mendimit psikologjik shqiptar. Në

këtë kuadër Jeronim De Rada është klasiku studimor dhe prirës i psikologjisë estetike ndër shqiptarët.

LITERATURA

Jeronim De Rada: Parime të estetikës, përgatitur për botim nga Prof. Alfred Uçi, Globus R. Tiranë, 2003.

William James, The Principles o Psychology, Macmillan, 1870.

Gardner Murphy, Historical Introduction to Modern Psychology, London, 1957.

Nuri Abdiu, Mbi historinë e mendimit psikologjik shqiptar (deri më 1939), Shtëpia Botuese Universitare U.F.D. Pres, Tiranë, qershor 2010.

M. G. Jaroševski, Psikologija u xx stoljeću, Sarajevo, 1981.

Pajazit Nushi, Psikologjia dhe institucionalizmi i saj mësimor-shkencor ndër shqiptarët, Studime Shoqërore 1, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës – Academia Scientiarum et Artium Kosoviensis, Prishtinë, 2014.

Dhurata SHEHRI, Tiranë

KËNGËT E MILOSAUT, KRIJIMI I SUBJEKTIT LIRIK

KDU 821.18'282.4(450)-1.09

Poema këngët e Milosaut është një metaforë e plotë e kërkimit, metaforë e kërkimit njerëzor të vetvetes e kërkimit të lumturisë, që në nivel shkrimi përkon me metaforën e zbulimit dhe krijimit të subjektit poetik. Vetëm një ngjarje rrëfehet në poemë, më e thjeshta dhe më e ndërlikuara njëhësh: zbulimi dhe krijimi i vetvetes si subjekt.

Loja luhet mes subjektit lirik që ndërtohet duke vështruar, e vepruar mbi objektin e vet me vlerë përmes tre figurave bazë: epitetit, metaforës e similitudës.

Rrugën e tij drejt krijimit të subjektivitetit lirik, subjekti e nis tek bëhet subjekt konteplativ i objektit të tij te kontempluar. Ai, subjekti, sheh dhe tregon. Këtë e arrin përmes epiteteve. Rina (po e quajmë me marrëvishje kështu) pasi si emër na del vetëm një herë në Këngën XIV) na shfaqet vetëm përmes të thënës së subjektit kontemplues. Ajo është objekt, pa emër, po i emërzuar. Emërzimi i saj kalon nëpër të njëjtën rrugë që kalon subjekti për t'u krijuar.

Udhëtimi për të krijuar subjektin lirik, në këngën e parë e shfaq objektin e vet si sensualitet femëror, si similitudë që e përfshin metaforën brenda saj: Subjekti, për të përcaktuar vetveten krahason (pra përshkruan), një ndjesi të paemërtuar ende duke anticipuar kështu objekt/subjektin femëror:

Një ghare m'u rrodh te kurmi
Si gharea e mbrëmjes te shtrati
Kur vajza e ngroghët
Ndjen për të parëzën

Sist cë m'i frighien[1]

Subjekti përshkruan mashkullorësinë e tij duke e krahasuar me sensualitetin femëror që e ka plotës, që e thërret, që e parashikon dhe e krijon.

Vetëm pas pak, në këngën e dytë objekti që ka përcaktuar sensualitetin e subjektit krijohet si objekt viziv:

E përveshurëz e ljart
Me kërshen të pjeksurith
Ndë një jetullëz të bardh…[2]

Ngjashmëria me objektin e kontepluar që do të prodhojë më pas shkrirjen e tij në subjektin lirik duket qartë në epitetin që përdor për vashën:

…gji-frijtur, pjono hje
me të trembur një ghare… (hare e ngjashme me atë që përshkoi subjekti në këngën e parë, duke e krahasuar paraprakisht me këtë këngë të dytë,)

Në dallim me këngën e parë, figura këtu bëhet epitet që ngjarjen, lëvizjen, e përfshin, e fikson jo më si ngjarje por si emërtesë jo dekorative, *gji-frijtur*. Kjo përfshirje fillestare e objektit tek subjekti në krijim e sipër, që do të karakterizojë gjithë poemën, në fund të këngës së dytë merr trajtën përfundimtare:

***Di buz** të qeshëme*
Nji gherie të bardhë
Atë mbrëma dukëshim.[3]

Por nuk ndodh kërshtu me vetë objektin (Rinën). Ajo, në këngën e dytë, duke u shfaqur e emërton e kundërshton përfshirjen duke krijuar fillimisht distancën me subjektin kur e quan: *birë zoti* dhe duke e thelluar kur e përfshin në similitudën *si vandilj i Arbërit* në këngën e tretë.

Një ngjarje tregohet në këngën e katër; personazhet janë po ato, por

---

[1] Jeronim De Rada, Këngët e Milosaut, Shpresa, Prishtinë 2001, f. 62

[2] Po aty, f. 63

[3] Po aty, f. 64

edhe krejt të ndryshëm: *i biri i zonjë s madhe* (tashmë) dhe *e bukura*; thelbi, po ai, një sublimim metaforik i sensuales:

Thomn-je ju të dashurit
Nd'ëmbëlj aqë të puthurit[4].

Ky sublimim, në këngën e pestë, kur foljet janë shndërruar në refleksive, merr trajtën metaforike:

Veç çë sit na rughien
Jeta e të përmiset.[5]

Përdorimi i foljeve refleksive, shoqëruar me dhanoren etike ku i adresuari bëhet aktor në vetë shprehjen, pa qenë aktor në procesin e përmendur në shprehje, përforcon idenë e krijimit të subjektit lirik përmes aktit ilokutiv në marrëdhëniet objekt me vlerë- subjekt gjatë gjithë poemës. Kjo duket në disa shembuj:

...mua m'e sjeljt përparanith; (Kënga 5)
...më zbardhi vudhëvet; (Këng 6)
...më shinej në skemandilj; (Kënga 6)
...atë dit më rri me mal; (Kënga 7)
...priret e më ruan katund; (Kënga 8)
...pra m'i vate nd' ëndërrët; (Kënga 9)
...e më pa të dashurin; (Kënga 9)
...ai zot më të do mir; **(**Kënga 13)
...m'u pataks mixoria; (Kënga14) etj.

Dy pozicione të subjektit lirik shfaqen në këngën e gjashtë; subjekti **thotë** dhe **ka**: ai e emërton objektin së jashtmi si *vasha krie-kështënj; vash zakon bukur*, për të mbërritur tek epiteti afirmues *vaizën dëthina-zemër* që e përfshin subjektin si receptues të vetin. Epitetet nisin me cilësime pa shtesë informative (vajza kryegështenjë) për të mbërritur tek epiteti i domosdoshëm (zemërthithësja) që përforëcohet nga subjekti tashmë veprues: *Ajo mua më ka hije*. Shkallët ngjitëse të epitetit shkojnë përkrah

[4] Po aty, f. 67

[5] Po aty, f. 69

përdorimit të kushtores tipike për ligjërimin e ëndrrës në këngën VII: *but në shtrat **të m'ulenj***. Ndërsa në këngën VIII e IX ëndrra bëhet reale sa ç'bëhet edhe efekti i vashës mbi subjektin:

Noerit më bienith
Sa t'e shoh, e kurmi
Më rrodhët, e së dij të frinj.[6] (që duket si vazhdim i epitetit veprues: *Vajza dëthina-zemër*).

Veprimi i epitetit zemërthithëse, në kuptimin metaforik të përthithjes së subjektit nga objekti për të krijuar ngadalë një subjekt të vetëm: subjektin ontologjik të dashurisë, zgjatet në këngën XI, një nga këngët më të errëta të poemës. A është një ëndërr negative? A e sheh Rina apo Milosau?

Përballja me kolektiven si prani e tretë, në vend ta kompaktësojë subjektin dashuror e ndan atë sërish: vasha bëhët *Vash e nëmur* trimi *bir i zonjës së madhe* në këngën XII, XIII. Subjekti është formalisht i ndarë, Milosau ka ikur larg, por në ëndërr (kënga XIV) ai e fton, e josh, e ndjell, i thotë për herë të parë (dhe të fundit) në emër Rinë. Pastaj, në këngën XX prania e saj është e plotë, me shfaqje, të qenë e veprim: ajo **shihet**: me epitete dekorative *mes- gholëzën; krie-kështënjëzën*; ajo **është** me similitudën që shpjegon metaforën e yllit:

Si më shighet plot ambli
Il cë zemërat oreksën
Il çë thot: Më ruani dritën
Jeta së sholjariet[7].

Subjekti lirik po përshkruan një ngjarje, të pazakonshme e të veshtirë për t'u përshkruar, krijimin e vetvetes pikërisht gjatë aktit të këtij krijimi si ligjërim. Subjekti është edhe krijues edhe i krijuar, edhe akt edhe rezultat i ligjërmit të vet. Që të mund të thotë **unë jam**, atij i duhet më parë të pohojë: unë shoh; unë kam, unë them.

Kënga XXII, kënga e lumturisë, është shprehje e këtij pohimi. Pasi

[6] Po aty, f. 75

[7] Po aty, f. 101

gjendet përpara zërit hyjnor (lutjet për Shën Mërinë); përpara zërit kolektiv (këngët ku flet vallja), lumturia që edhe shfaqet, edhe tregohet edhe është, është lumturia e plotnisë së vetvetes, që përsërit të njëjtën similitudë si në këngën e parë ku, për të shprehur sensualitetin mashkullor referenti është objekti femëror:

...mos e mbulij ti derien,
të ghinj er' e deitit
të më ftoghinj si më ftoghën
vashazit mbë të skajlisur...[8]

Subjekti lirik, tashmë të dashurën e vet **e sheh**:

Vajzën me stan të bukur
Të dashur u më e pata[9] (vajza është e dashur se është me shtat të bukur);

ai **e ka** të dashurën e vet:

Me ghare ndër këto shpi
Ajo tund djepëthin
...ajo shpis i ka hje...[10]

Ai nuk ka më nevojë për ëndrrat që të bëhet një me të dashurën, atë nuk e lodh më gjumi[11], nuk i reshtet kurmi, janë *ditët* (e tij) *fanëmira*: ai sheh, ai ka, ai thotë, ai është:

Uljem por s'ë dua të fje.

Por, plotënia do të zgjasë pak. Rina vdes pasi i ka vdekur i biri (që shfaqet thjesht si pengesë e plotnisë së Milosaos). Ai është vetëm i biri i Rinës, Milosao nuk qan për të:

*S'ë vola e t'**In**zot*

*Djalin grua që **të** rrëmbeu*

[8] Po aty, f. 105

[9] Po aty, f. 105

[10] Po aty

[11] Gjumi mua m'ë ljodhënith/ kurmi vete tue m'u reshtur

Pra cë gjith bota na sqepën

Shenja të qarta të këtij distancimi janë përdormi i përemrave pronorë në në vetën e parë shumës tek ***In****zot*, por i trajtës së shkurtër të vetës së dytë njëjës tek ***të*** *rrëmbeu*).

Subjekti do të kompaktësohet duke u ndarë ndarë pjesët që nuk i ka të vetat e duke vajtuar për ato që nuk i ka më. Ai qan për vajzën shtat bukur që i bëhet grua; qan për gruan që bëhet nënë e do t'i shkojë të birit pas në varr; i lutet ëngjëllit-vashë që të bashkohen sërish, më shumë me trup se më shpirt, ndonëse shndërrimin aseksual të saj e anticipon epiteti ëngjëll-vashë:

Ëngjël oj vash
Jam për tij: kushë të ghuaj
Stan tënd mua të më bënj?[12]

Por çdo gjë ka mbaruar, vasha *gji-fritur*, vasha *me stan të bukur*, vasha *kryekështënjë*, *mixorja*, nuk është më as grua. Ai nuk mund ta ketë më, ajo është bërë femër etikisht e paprekshme, është bërë motër;

Kush t'e thoj se mua më ljëje
E pafan motëra ime[13].

Gjithçka është e kotë, edhe po të mund të realizohej, dashuria do të kishte veç një fund, vdekjen e të gjithëve, por jo të subjektit lirik që nga kjo vdekje lind. Këngët e fundit, nga kënga e njëzet e pestë e deri në fund, përfshirë dhe këngën njëzet e tetë, të famshmen këngë politike sipas Pipës[14] nuk kanë më vlerë për metaforën e krijimit të subjektit lirik tashmë të krijuar. Ato vetëm e shprehin, referentin, ndodhinë: Djaloshi De Rada 20 vjeçar, i biri i priftit e braktisi dashurinë e parë për një vajzë fshati. Ai bëhet gati për t'u larguar, i pafuqishëm për t'u përballur me fatin e vet, në kërkim a shpikje të një detyre. Këngët njëzet e tetë deri tridhjetë e pohojnë krijimin e subjektit lirik duke pasur si program narrativ ndihmës[15] krijimin

[12] Po aty, f. 107

[13] Po aty, f. 108

[14] Arshi Pipa, Jeronim Der Rada, Princi, Tiranë 2014

[15] Koncept i futur në gramatikën narrative nga Algridas Greimas

e antisubjektit, të heroit që ka detyra mbi dëshirat, që i nga kompetencat e mundshme do të performojë vetëm modalitetin *duhet të bëj* pasi *s'mund të bëjë*. Detyra si krijim a shpikje e vetë subjektit lirik është është pafuqi për të dashur, ajo është sublimim i dashurisë reale të pamundur. Poeti De Rada, ndërton alteregon e vet: ideologu De Rada lind kështu nga subjekti i tij lirik i Këngëve të Milosaut.

Shumë vite më pas, vetëm një vit para se të vdesë, pasi ka humbur gjithçka (edhe djemtë që nuk i qau tek poema e tij e parë), edhe dashurinë që nuk e jetoi në rininë e vet të parë, De Rada e përshkruan përvojën e mundësinë e krijimit të subjektit prej subjektit, si akt e si rezultat, si stil e shkrim, ndonëse gabueshëm këtë veti ja njeh një strukture shumë më kolektive, gjuhës shqipe. Është ndoshta shkrimi i tij i fundit *Testamenti politik*:

> *...gjuha…. (shqipe). E pajisur me fleksion dhe tinguj, që shprehin me pasuri të madhe faqat e shpirtit, ndër gjymtyrët e tjera të origjinës së vet hyjnore, ruan në vetvete tri fjalë që dëftojnë gjendjen e lumtur me të cilën u krijua njeriu në tokë: jam, them, kam.*[16]

[16] Jeronim De Rada, Autobiografia, Onufri 2002, f. 145

Luan STAROVA, Shkup

JERONIM DE RADA - FAIK KONICA: DIKOTOMIA E IDENTITETIT SHQIPTAR

KDU 008 (=18) 821.18.09

Kur në muajin tetor (2014) u gjeta në Kalabri, për të marrë pjesë në simpoziumin me temë *Mediterani dhe identiteti* dhe kur, falë mirësisë intelektuale të albanologut tonë Franko Altimarit, një mbrëmje u nisëm për në fshatrat arbëreshe, m'u kujtua viti 2003 dhe dita kur, me rastin e 100 vjetorit të vdekjes së Jeronim De Radës, u gjeta në zemrën dhe shpirtin e Kalabrisë, në Makia Albanese.

Asokohe kisha ndjenjën se takimin midis meje dhe Altimarit e kishin caktuar stërgjyshërit tanë para pesë shekujsh, në çastet fatale të ndarjes. Njëra palë, duke ikur *me hijen e shtëpive në zemër*, tjetra, duke e përjetuar rrënimin e shtëpive në shpirtra. Ka një varg të pavdekshëm në poezinë e Pablo Nerudës, ku thotë se "*liberatori Bolivar kthehet çdo njëqind vjet kur e kërkon popull*". Ndjenjën se ky varg mund t'u përshtatet edhe shqiptarëve në më shumë raste të historisë së tyre, duke filluar prej Skënderbeut, sikur na e sugjeron De Rada. Dhe, me këtë rast, pas njëqind vitesh pavarësie, shqiptarët, përsëri i kërkojnë mesazhet e Jeronim De Radës...

* * *

Viteve të fundit në hapësirat shqiptare, pas çlirimit të Shqipërisë prej izolimit makabër dhe pas pavarësimit të Kosovës, u riaktualizua çështja e identitet shqiptar. Dominuan tezat radikale të absolutizmit mbi identetin shqiptar në kohë dhe hapësirë, duke iu shmangur tezave të relativitetit të çdo identiteti kombëtar ose, më mirë thënë, identitetit të një populli. Problemi i identitetit individual ose kolektiv është mjaft kompleks, delikat dhe shumë domethënës. Në botën e sotme nuk ekziston identitet kombëtar

që nuk i është nënshtruar një kontinuiteti evolutiv. (Identiteti i Francezëve, Amerikanëve... është edhe më tej në një proces evoluimi, si identiteteti i popujve dhe kombeve në kohën e mondializimit).

Identiteti i shqiptarëve nuk bën përjashtim në këtë proces dialektik. Ky identitet kombëtar është rezultat i proceseve historike të cilëve u janë nënshtruar shqiptarët: krishterimi, skizma e vitit 1054 dhe ndarja në ortodoksë dhe katolikë, marrëdhëniet me Bizantin dhe Romën, me Perandorinë Osmane, islamizimi, Rilindja, Pavarësia, diktatura e ideologjisë staliniste e komuniste, Pavarësia e Kosovës e kështu me radhë. S'ka dyshim se në histori identiteti kombëtar ruhet duke u transmetuar prej një brezi në tjetrin, nën ndikimin e rrethanave historike. Ndryshimi, ose evoluimi i identitetit ndër shekuj është efekt normal për një popull, është pjesë e procesit historik. Mbështetur në memorien e dokumentuar historike, shqiptarët ishin të gjithë të krishterë, të ndarë në principata e feude, të lidhur në aleanca të ndryshme me serbët, venedikasit, Vatikanin, Napolin, por veten e quanin *arbër*. Gjatë shekujve XV - XVI këto aleanca morën fund dhe gjurmët e krishterimit brenda identitetit etnik të shqiptarëve filluan të shthuren. Megjithatë, një pjesë e madhe e popullsisë arbërore u zhvendos drejt Italisë dhe pikërisht ajo pjesë, në krye me Jeronim de Radën dhe veprën e tij letrare u bë interpretuesja dhe transmetuesja e vetëdijes së identitetit të shqiptarëve.

Me konsolidimin e pushtetit osman dhe të sistemit të mileteve, ndodhi edhe një tjetër riformulim i identitetit të shqiptarëve, i cili u reflektua në ndërrimin e emrit kombëtar nga arbër në shqiptarë. Natyrisht, kjo ndikoi edhe në integrimin e shqiptarëve në sistemet politike, sociale dhe kulturore të Perandorisë Osmane. Shqiptarët, ngjashëm si popujt tjerë evropianë, kanë jetuar dhe jetojnë me një identitet dinamik. Mjafton ta marrim si shembull Italinë, e cila në shekullin XV e kishte një identitet *kombëtar*, ndoshta më të dobët se Arbëria përballë.

Të bindur se zhvillimi i identitetit nuk mund të mendohet si një vijë lineare, e ndërprerë nga disa si *aksident*, si ideologjizim i historisë, por jo edhe prej një perspektive reale a logjike, na u duk e udhës që tezën e mundësisë së identitetit letrar, të cilin disa e konsiderojnë qëndresë të vërtetë të

shqiptarëve, ta ilustrojmë me dy shkrimtarë emblematikë të letrave shqipe: Jeronim de Radën dhe Faik Konicën.

Identiteti i njeriut është bota e tij e brendshme dhe përbërësit e kësaj bote të brendshme janë aq të shumtë thotë Sigmund Frojdi. Duke marë parasysh se bota e brendshme e njeriut reflektohet në mënyrë eksplicite edhe në kujtesën kolektive, se identiteti, në fund të fundit, mund të konsiderohet edhe si proces i vazhdueshëm në krijimin e konceptimit të ideve asociative, që në mentalitetin tonë i pranojnë vlerat e se kaluarës, në këtë punim, jo rastësisht, ofrojmë dikotominë e identitetit të mundshëm të dy korifenjve të lartpërmendur të letrave shqipe. Si e para, ata nuk e konsideronin përkatësinë etnike si një lloj fitore, kërkim të fitoreve, apo si rezultat i humbjes. Nëse ekziston ndonjë triumf në jetën e tyre, ai është triumfi i humbjes. Gjithë jetën e kalojnë nëpër paradokset e egsilit absolut larg vendit të tyre, në kërkimin të rrugës së kthimit, secili prej tyre krijon fragmentet e identitetit letrar. Shumë përgjigje aktualizohen sot, kur ne shqiptarët akoma gjendemi para miteve të së shkuarës dhe aspiratave të botës së sotme të globalizimit dhe integrimeve, duke kërkuar shpëtimin në mitizime të reja, me animin nga Evropa ose nga Lindja. Jeronim de Rada dhe Faik Konica i kanë sistemuar dhe konceptuar përgjigjet e tyre që në shekujt XIX dhe XX .

As De Rada, as Konica s'kanë qenë peng, të kufijve dhe territoreve shqiptare, por veprimtaria e tyre e imponon filozofinë e egsilit. Edhe veprat dhe veprimet e tyre s'kanë qenë të ngarkuara prej horizontit të kufijve. Jeronim de Rada s'ka qenë kurrë në Shqipëri, kurse Faik Konica, prej 65 viteve të jetës, 60 i kaloi jashtë vendit të lindjes. Të dy e kultivojnë *mitin e kthimit*: Jeronim de Rada besonte se *kthimi* mund të ndodhte vetëm nëse mbrohej identiteti i arbëreshëve në tokën e huaj, si antitezë e heshtjes dhe diskontinuitetit të kulturës, gjuhës, letërsisë shqiptare të *shekujve të humbur*. Edhe Faik Konica, me instrumente gati të ngjashme me ato të De Radës, e kultivoi *mitin e kthimit*.

Në kohërat tona aktualizohen tezat për karakterin evropian të identitetit të shqiptarëve, por sikur harrohet se procesi i evropianizimit nuk është gjë e re te shqiptarët, sepse ai i ka pasur për protagonistë autorë si Jeronim de Rada, Faik Konica dhe Rilindësit tjerë. Në këtë drejtim, njësoj si

rilindësit tjerë: Dhimitër Kamarda, Pashko Vasa, Naim Frashëri, Sami Frashëri..., për të dëshmuar lashtësinë e popullit shqiptar dhe gjenezën evropiane të tij dhe të gjuhës shqipe, e shtjellojnë tezën e prejardhjes pellazge të shqiptarëve, të proklamuar nga arbëreshët qysh në shekullin XVII.

De Rada dhe Konica do ta kultivojnë, secili në kohë dhe rrethana të caktuara, edhe mitin e *kthimit të gjuhës shqipe*. Për të dy kolosët, çështja e gjuhës, me të gjitha amplitudat e mundshme do të mbetet çështje obsesive, rreth së cilës do të shtjellohen angazhimet tjera letrare ose shkencore. Gjeneza e formimit të mitit të gjuhës shqipe, gjer atëherë të ndaluar nëpër shkolla, ishte e para që duhej ringjallur. Duke qenë të dy me kulturë të thellë evropiane, secili sipas kushteve dhe rrethanave të caktuara, do ta kenë të qartë se misioni i *kthimit* mund të realizohet.

De Radës së pajisur me kulturë italiane i shkoi për dore të ofrojë një model të kodifikimit të arbërishtes, që mund të konsiderohej edhe si kodifikim i parë i shqipes. Këtë e arriti me veprat e tij monumentale *Këngët e Milosaos*, *Skanderbeu i pafane*..., në një kohë kur shqipja ishte larg mundësisë së kodifikimit, për shkak të kufizimeve të hegjemonisë osmanturke. Faik Konica që braktisi studimet në liceun Galatasaraj të Stambollit (edhe pse në gjuhën frënge), duke dashur të distancohet prej modeleve osman-turke të mendimit, vazhdoi shkollimin dhe aktivitetet e veta në Francë. Poligraf dhe poliglot, si shumë Rilindës të tjerë, ai e filloi në Evropë „*betejën e madhe të ideve* për t'i njohur dhe kuptuar shqiptarët, për ta universalizuar kauzën e tyre. Ky mision qe gadi i pamundshëm për ato kohëra, njësoj si misioni i Jeronim de Radës, me të cilin ata e filluan dhe e mbaruan jetën e tyre. Alibi e këtij flijimi ishte një lloj *estetizmi evropian*, karakteristik për të dy rilindësit, secili pjesë e një dikotomie të mundshme në kërkim të identitetit të shqiptarëve pas ndarjeve historike, sidomos pas invazionit të Perandorisë osmane.

Së këndejmi, mund të thuhet se veprat e tyre, letrare, shkencore e politike të Jeronim de Radës dhe Faik Konicës, janë në kërkim të identitetit kompleks të shqiptarëve, duke u nisur prej labirintit dhe enigmës gjuhësore. Ndryshe nga Faik Konica, De Rada ndjek rrugën dhe qëndrimin e vet ndaj *estetizmit evropian.* Dilemat e tij nuk janë si ato të dualitetit konician. Faik Konica një pjesë të identitetit të vet burimor do t'ia sak-

rifikojë identitetit evropian, do ta fshehë identitetin e parë, jo vetëm me pseudonimet me te cilët i nënshkruante veprat e tij të shkruara për lexuesit evropianë me pseudonimet Phyruss Bardhyli apo Trank Spiroberg..., por edhe me miqësitë kosmopolite, me frekuentimin në qarqet avangarde të Parisit dhe sidomos me miqësinë dhe bashkëpunimin shumëvjeçar me Gijom Apolinerin.

Është gati rast pa precedent në historinë e letrave që një shkrimtar ta fshehë me aq mjeshtri identitetin e parë me identitetin e dytë, jo me qëllim të eliminimit, por për ta theksuar identitetin e parë. Ky është identiteti i gjuhës shqipe, fondamenti i identitetit të përgjithshëm shqiptar. Në fillim të shekullit të kaluar, kur në Evropë promovohej një lloj *mondializmi*, prej autoriteteve të linguistikës së asaj kohe nisi të promovohet nevoja për dominimin e një gjuhe artificiale, si: esperantoja, golapuku... Faik Konica, asokohe drejtor i revistës *Albania*, me mish e me shpirt, gati me penë te gjakosur, u inkuadrua në polemikë me autoritetet e mëdha të kohës dhe u pozicionua kundër zgjedhjes se esperantos, duke mbrojtur kësisoj gjuhët natyrore me histori mijëravjeçare, gjithnjë duke patur në mendje shqipen, për fatin e së cilës luftonte edhe më *Albanin* e tij. Kësisoj, ai ia doli t'i bëjë për vete tezat e shkrimtarëve të njohur të asaj kohe: Remi de Gurmonit, Gijom Apolinerit dhe të disa kolosëve të tjerë. 20 vite pas polemikës me linguistët e njohur evropianë dhe pas botimit të esesë *Sprovë për gjuhët natyrore dhe gjuhët artificiale*, Faik Konica, në gazetën *Dielli* (18 nëntor 1922), që botohej në Amerikë dhe të cilën e redaktonte vetë, do ta zbulojë sekretin e rinisë militante, do ta çlirojë personalitetin prej pjesës evropiane, duke shkruar:

> *‚Shqipja është një gjuh' e gjallë; s'munt ta përdorim si esperanton ose volapukun, duke e shtrembëruar me ukaze arbitrare... Një gjuhë është si një barishte: do sherbime delikate, që të mos thahet, po të rritet e të japë lule...''*

Është me interes të shënohet në një kontekst evropian, se edhe teza të cilën e mbron Konica gjatë polemikës në Esenë (me te cilën pajtohej edhe Apolineri, ka synuar t'ua japë goditjen e fundit dijetarëve të esperantos), është aktualizuar në kohën tonë në librin e Umberto Ekos *Gjuhet e*

përkryera. Eko vjen po në ato përfundime të Konicës, duke u dhënë përparësi gjuhëve natyrore.

Edhe Jeronim de Rada edhe Faik Konica, pa pretendime që të shkruajnë vepra për lavdinë e tyre letrare, si rallë kush në histori, i shërbejnë kauzës së njohjes, konfirmimit dhe kërkimit të rrënjëve të gjuhës, kulturës dhe letërsisë shqipe. Nisma, qëllimi kryesor dhe *euro-albanizmi* i tyre do të jetë gjuha shqipe, gjurmimi i gjenezës së saj, mbledhja e trashëgimisë folklorike, vendosja e alfabetit, norma kyçe e kodifikimit.

Me vargjet e para të shkruara në gjuhën italiane do të hetohet tendosja e De Radës së gjendur ndërmjet traditës dhe klasicizmit italian dhe traditës së letërsisë popullore arbëreshe. De Rada ishte i bindur se poezia popullore shqipe me vlerat e saj të mirëfillta, mund të luajë rol të konsiderueshëm në raport me letërsitë evropiane të shekullit XIX . De Rada besonte në vlerat estetike të kësaj poezie, që tërhoqi vëmendjen e Evropës në epokën e romantizmit. Edhe Konica, i cili në shkrimet në prozë, të botuara në frëngjishte në revistën e mikut të tij Gijom Apoliner *Le Festin d' Esope,* iu afrua modernitetit evropian, surealizmit dhe rrymave avangarde evropiane, duke filluar që nga *Albania* e gjer te *Dielli,* u përpoq të mbrojë natyrshmërinë e gjuhës së popullit. Me betejën e berë te gazeta *Dielli* kundër gjuhëve artificiale, Faik Konica në të vërtetë e mbrojti *shqipen e popullit*: *…një gjuhë letrare formohet duke studiuar mirë gjuhën e popullit….*

Më 1861 De Rada botoi traktatin *Principi di estetica (Parimet e estetikës*), kurse më 1904 Faik Konica botoi esenë *Essai sur le langues naturelles et les langues artificielles (Sprovë për gjuhët natyrore dhe gjuhët artificiale*). Të dy veprat estetiko-teorik-letrare, edhe pse të shkruara në një hark kohor prej 41 vitesh, plotësojnë njëra-tjetrën me çështjet identitare, gjuhësore dhe letrare shqiptare. Me *Parimet e estetikës* dhe me një pjesë të madhe të veprës me qëndrime teorik-estetike, Jedonim de Rada depërtoi thellë brenda shtresimeve të mendimit filozofik evropian të kohës kur jetoi. Ai nuk iu shmang misionit të theksuar pragmatik dhe kërkimit të zgjidhjes së çështjeve të lidhura me jetën e arbëreshëve, para së gjithash me identitetin, gjuhën, lashtësinë..., me qëllim të dëshmimit, nëpërmjet veprave letrare të traditës më të mirë romantike, përkatësisë

arbëreshe brenda familjes së madhe evropiane. Edhe në këtë vepër, njësoj siç vepron pak më vonë Faik Konica me veprën *Sprovë për gjuhët natyrore dhe gjuhët artificiale*, por secili me instrumente të ndryshme, shpreh kultin ndaj gjuhës. Ja çfarë shkruan Ai në kapitullin e shtatë të librit *Parimet e estetikes*:

> *Fillimi dhe baza e çdo dijeje është gjuha, e cila njëkohësisht e mban në jetë identitetin e vlershëm të popujve! Sepse, shtetet mund të përmbysen dhe të zhduken..., por gjuha mbetet më kryesorja që një popull e bën të njohur, pa marë parasysh brigjet në të cilët i ka hedhur dallga e jetës.*

Për De Radën, ashtu si edhe për Faik Konicën, gjuha mbetet shpirti më i ndejshëm i populllit.

Figurat e Jeronim de Radës dhe Faik Konicës janë poliedrike dhe komplekse. Ata jetojnë në kohëra të ndryshme, me një distancë prej 60 vitesh. Me botimin e *Këngëve të Milosaos* në vitin 1836, De Rada mund të konsiderohet nismëtari i letërsisë moderne shqiptare, protagonisti i evropianizimit të saj. Proceset e evropianizimit të kulturës dhe letërsisë, njohja e identitetit shqiptar që fillon me Jeronim De Radën, në një farë mënyre vazhdon me Faik Konicën. Këtë mision Jeronim de Rada e filloi me të përkohshmen *l' Albanese d' Italia*, që nisi botimin në vitin 1848, në Napoli dhe që sillte artikuj në italisht dhe shqip, kurse Faik Konica e vazhdoi me botimin e revistës enciklopedike *Albania* (1897-1909).

Dy korifenjtë e letrave shqipe veprojnë në një periudhë kohore prej gati dy shekujve, ndoshta vendimtarë për identitetin e shqiptarëve. Me autoritetin letrar dhe shkencor, ata bënë për vete autoritete evropiane të rangut më të lartë. Kështu, *Këngët e Milosaos* Viktor Ygoi i vlerësoi si një *vepër e përkryer romantike*; Alfons de Lamrtini, po të njëjtën vepër e konsideroi *monument të atdheut të tij*; nobelisti, poeti oksitan Frederik Mistral, Aleksandër Dyma (ati) dhe, në kohën e Faik Konicës: Remi de Gurmon, Gijom Apoliner, Maks Myler, Mishel Breal, Leon Kayn e shumë të tjerë.

* * *

Me këtë nuk merr fund krahisimi i mundshëm midis dy korifejneve

të letrave shqipe, as plotësohet dikotomia e identitetit letrar shqiptar dhe më gjerë. Në këto raporte imponohet edhe një simbol tjetër, që mund të jetë nismë për një punim tjeter. Faik Konica, më 27 mars 1897 i shkruante Jeronim de Radës nga Brukseli, ku vazhdonte botimim e *Albanisë*:

> *Recevez ici les hommages d'un homme qui vous admire, qui vous aime: qui voudrais vous imiter, c'est--dire consacrer la vie une cause grande – celle de l'affranchissement de deux million d'homme qui ont soif de liberté.*
>
> *Que de fois j'ai voulu vous écrire mais l'occasion ne m'est jamais présentée propice. En vous envoyant le premier nombre d'une publication que je viens d' entreprendre il m' est doux vous envoyer également l' expression de ma piète filiale pour le grand Albanais de Macchia.*
>
> *F. b. Konitza*

Alfred UÇI, Tiranë

JERONIM DE RADA PËRBALLË RILINDJES KOMBETARE

KDU 821.18'282.4(450).09
94(496.5).081/.084

Diskutimet në sesionet shkencore të Akademive tona të Shkencave janë një dukuri, që vlen të përshëndetet, sepse vërej që ka nisma për të mbështetur *kërkime të reja shkencore* të historisë së letërsisë shqipe të gjithë degëve të saj, të Kosovës, Shqipërisë, arbëreshëve të Italisë dhe të diasporës të shumanshme, për të njohur më mirë si zhvillimet bashkëkohore të letërsisë kombëtare, por edhe të fazave, burimeve dhe tendencave të saj historike. Sado të shumta janë studimet albanologjike të historisë së letërsisë shqipe, nuk bën të pajtohemi me një mendim dogmatik, që i quan të zgjidhur dhe të sakta gjithë problemet dhe interpretimet e dukurive të letërsisë sonë. Përkundrazi, kombi ynë ka shumë kohë që ndodhet në një zhvillim të shpejtë e të shumanshëm, që sjell probleme të reja të pazgjidhura jo vetëm të së sotmes të gjithë degëve të letërsisë dhe të kulturës kombëtare, por edhe të së kaluarës së tyre. Diskutimet që po bëjmë, sigurisht, na dëshmojnë se ka edhe mjaft studime të cekëta, thjesht vitrinore e përsëritëse idesh të mirënjohura e të mërzitshme, siç duket edhe gjatë *dhjetëminutshit të detyruar*, që i bën *formale* ca sesione, që quhen së koti *shkencore,* kurse kemi nevojë për diskutime krijuese mbi ide, interpretime dhe hipoteza *të reja e serioze,* që janë më të pakta, por ka edhe të tilla edhe kur botohen jashtë sesioneve shkencore, siç qe studimi i Gjovalin Shkurtajt *Gjuha shqipe dhe shpirti i Arbërit në jetën dhe veprimtarinë e De Radës.*

Sidoqoftë, unë do t'i përmbahem normës dhjetminutëshe, duke

përmendur disa nga problemet që i quaj se meritojnë të trajtohen më thellë. Këtë mundësi na e dha edhe kremtimi i dyqindvjetorit të poetit gjithnjë të ri, me vlerat e tij të hershme të njohura e me ndonjë problem, të cilit i kushtohet edhe tema e diskutimit tim***:*** *De Rada përballë Rilindjes sonë Kombëtare.* Kjo është një temë, titulli i së cilës përmendet gati nga çdo diskutues, por ka aspekte ende të papërcaktuara saktësisht, ndoshta për faj ekuivokesh gjuhësore midis italishtes e shqipes. Unë kam përdorur tri fjalë, tre terma: *Rilindje, Risorgimento, Renesansë.* Kam vënë re se disa studiues i përdorin këto tri fjalë herë me kuptim të njëjtë, herë të ndryshëm ose të kundërt. Por kam vënë re që termi rilindje identifikohet ndonjëherë edhe vetëm me një fazë, një fakt, një ripërtëritje, një kyç, **ose** vatër pikënisje apo kthesë, duke i ngatërruar kuptimet e tyre. Vetë përpiqem të aktivizoj, duke i dalluar Rilindjen nga Renesansa italiane, nga Risorgimentoja e unitetit të shtetit italian dhe nga Rilindja Kombëtare Shqiptare, duke përfshirë në Rilindjen Kombëtare Shqiptare De Radën e të tjerë shkrimtarë e personalitete italo-arbëreshë. Sepse koncepti i Rilindjes Kombëtare në përgjithësi nënkupton një epokë të tërë historike, me veprimtari të shumanshme e të pandërprera politike e ushtarake, historike e kulturore, arsimore e gjuhësore të një kohe të gjatë, të një kthese të thellë të historisë së gjithë kombit**.** E them këtë sepse Rilindja Kombëtare nuk është një fakt i vetëm, por është një epokë historike që nis pak a shumë në fillimet e shek**.** XIX dhe vazhdon konvencionalisht, deri më 1912, me shpalljen e pavarësisë dhe krijimin e shtetit shqiptar. Ky përcaktim, nuk e përjashton faktin se De Rada ka punuar e jetuar, njëkohësisht, në kushtet e veçanta specifike të Italisë, e zhvillimit të Risorgimentos, si lëvizje e krijimit të unitetit të shtetit italian.

Unë mendoj se cilido studiues shqiptar ose arbëresh do të gabonte po të mos e përfshinte De Radën në Rilindjen Kombëtare të Shqipërisë në përgjithësi, sepse kjo nuk ka qenë e nuk është jetë e një shqiptari, por është *e gjithë* shqiptarëve, pavarësisht ku jetojnë në Bu-

kuresht apo në Stamboll, në Korçë apo në Shënmitër, në Kalabri apo Sicili, Prishtinë apo Prizren, Shkup apo Mal të Zi, në Çamëri apo Greqi, etj., që kanë bashkëpunuar midis tyre edhe kur janë ndodhur larg me njëri tjetrin, si për shembull, Samiu, Naimi dhe J. Vretua me De Radën. Samiu e njoftonte De Radën se *"Dhjetë mijë shqiptarë kanë zënë Ysqypin dhe dhjetëmijë të tjerë bëhen gati të zbresin në Toskëri"*. Njëkohësisht, Jani Vreto i shkruante Poetit arbëresh *"Të përshëndes vëllazërisht dhe të dërgonj edhe një këngë atdhetare të vëllajt tonë Pashko Vasës: O mori Shqipëri, e mjera Shqipëri"*. De Rada komunikonte me Abdyl Frashërin, Dora d'Istrian, Thimi Mitkon, i cili *i* pohonte De Radës se Për mua elenët janë të pabesë dhe gënjeshtarë.Të shkruajta para ca ditësh e të dërgova edhe llogarinë se sa franga kam mbledhur për Flamurin e Arbrit.

Madje Rilindja Kombëtare është ajo fjalë që na e ka mësuar vetë J. De Rada, i cili në kryeveprën e tij teorike Parime të Estetikës (1861) ka futur mendime, të thëna në prag të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878): *"Nuk ka ndonjë komb tjetër, që t'i ketë shprehur aq bukur në poezitë popullore bëmat e tij trimërore se sa Atdheu ynë i rrëzuar, poezitë e të cilit janë këngë të thjeshta, por plot* frymë shqiptare *e dashuri të fortë. Bukuria e këtyre poezive të atij populli, që qëndroi si mburojë e Europës të kanosur nga osmanët."* De Radës nuk i humbi besimi në të ardhmen e Shqipërisë edhe pas disfatës të Lidhjes të Prizrenit, kur shkruante: "Për *Shqipërinë, kah e cila janë drejtuar gjithmonë sytë tanë, edhe vepra me poezitë arbëreshe kanë qenë gjithmonë të gatshme sa herë kur vendi i tyre sulmohet nga armiqtë, nxiteshin ata të hidheshin të fuqishëm dhe krenarë në luftë, duke pasur bekimin e fisit të tyre"*. Më 1866 De Rada botonte betimin e shenjtë të arbëreshëve si pjesë të pandarë të Platformës të Rilindjes Kombëtare të shqiptarëve; "edhe *sikur të na falnin tërë botën/ ne nuk u shërbejmë interesave të huaja në dëm të kombit, bij të të cilit jemi"*. Ky ishte koncepti i De Radës për Rilindjen Kombëtare të Kombit shqiptar, që bashkon në lidhje të natyrshme e të pamohueshme Rilindjen Arbëreshe të shek. XIX me fatet e gjithë kombit shqiptar. Frymëzuese kanë qenë fjalët e shenjta : Prandaj më 1897 Komisioni

drejtues i Lidhjes së Prizrenit, ju drejtonte një thirrje gjithë shqiptarëve, kudo ku ishin, pra edhe italo- arbëreshëve: "Sa *jemi shqiptarë në botë, jemi të gjithë nga një gjak e një farë, fjalosemi të gjithë në një gjuhë, kemi të gjithë të njëjtat trashëgime dhe dëshira. Për neve është tashti nevoja për bashkim të përgjithshëm në çdo vend të botës që të ndodhemi, në qoftë se duam vërtet shpëtimin e mëmës Shqipëri"*. Ideali i Rilindjes kombëtare nuk ra nga qielli, por u përpunua nga personalitete të shquara të atdhetarisë arbërore: Jeronim De Rada **(**1814-1903), Dara Plaku dhe Gavril Dara I Riu, Zef Serembe, F. A. Santori, Zef Skiroi, Naum Veqilharxhi (1797-1846), Thimi Mitko, Jani Vreto, Dora d'Istria, Pashko Vasa, vëllezërit Sami, Abdyl e Naim Frashëri, Ismail Qemali, Zef Jubani, P. N. Luarasi, Gj. Fishta, Faik Konica, Filip Shiroka, Ndre Mjeda, Fan Noli dhe shumë të tjerë si këta, që përgatitën platformën e përbashkët të Rilindjes Kombëtare jo vetëm të shqiptarëve por edhe të arbëreshëve dhe i përgatitën të luftonin për lirinë e të drejtat e tyre, për arsimin, shkollat me gjuhën shqipe dhe kulturën e letërsinë e kultivuar kombëtare, me *shqiptarizëm*, pavarësisht nga dallimet fetare. Sepse zgjimi i shqiptarëve varej si nga zhvillimet e brendshme kombëtare të popullit shqiptar, por edhe ato të Italisë, madje edhe të Europës progresiste. Tek ne kur flitet për Rilindjen arbëreshe përfillet jo vetëm interesimi i De Radës, por edhe i gjithë arbëreshëve, që interesoheshin se **si** dhe **kur** zhvilloheshin kryengritjet antiosmane të shqiptarëve, dhe ç' bëhej në Itali dhe si arbëreshët luftonin e bashkoheshin me italianët, me garibaldinët për unitetin e lirinë e Italisë, kundër pushtuesve të huaj dhe kërcënimeve të Perandorisë Osmane. Të përbashkëta kanë qenë edhe përpjekjet për zhvillimin e arsimit, e shkollave në gjuhën shqipe, që ndriçonin mendjet e fëmijëve arbëreshë e shqiptarë. Vetmohuese kanë qenë përpjekjet sidomos të De Radës, por edhe të intelektualëve të tjerë arbëreshë për ta mbrojtur arsimin në gjuhën shqipe të arbëreshëve, e të cilën u krijua një letërsi e re, që u bë e njohur edhe jashtë Italisë në Europë. Dhe po kështu vetmohuese kanë qenë edhe përpjekjet e Papa Kristo Negovanit dhe Petro Nini Luarasit për të çelur shkolla shqipe dhe për të përdorur jo vetëm në shkolla, por edhe në istitucionet fetare gjuhën shqipe. Kur Petro Ninin klerikët dhe

armiq të therë e kërcënonin për ta vrarë, ai u përgjigjej: *"Në qoftë se më vrisni, ruajeni gjakun tim, që me të të shkruajnë gjuhën shqipe fëmijët tuaj"*; kurse atdhetarët i mësonte*: "Edhe 99 herë të rrëzohemi, përsëri duhet të ngrihemi!"* Krijimi i arsimit shqip s'ka qenë dëshirë e pak mësuesve atdhetarë, por ishte një nga kërkesat kryesore të Rilindjes Kombëtare, e gjithë shqiptarëve dhe e arbëreshëve, që luftonin për lirinë e të drejtat e tyre, që i bashkonte ata, ortodoksë, katolikë, myslimanë e bektashinj, besimtarë e laikë në unitet rreth kulturës kombëtare, shqiptarizmës të evropianizuar.

***

Nuk janë të pakta studimet shkencore të historisë së Rilindjes Kombëtare, që janë kryer këtej e përtej Adriatikut, por mbeten edhe mjaft aspekte të panjohura, prandaj i çmoj fort nismat e kohës sonë për t'i zhvilluar më tej studimet albanologjike, për të mbështetur kërkime të reja shkencore në shumë drejtime dhe aspekte të historisë së kulturës dhe të letërsisë shqipe. Veçse që të tilla kërkime të jenë të frytshme, duhet të mbështeten në fakte domethënëse dhe në interpretime të sakta teorike e metodologjike, që të mund të nxirren prej tyre edhe konkluzione të vërteta, që t'i begatojnë e plotësojnë arritjet pozitive të mëparshme të studimeve albanologjike, duke shmangur nihilizmat, subjektivizmin, sociologjizmin vulgar dhe ideologjizimet tjetërsuese. Prandaj dua fare shkurt të shfaq mendimin se kërkimet e reja do të duhej të orientoheshin jo në cikërrima, por në tema të rëndësishme. Unë po përmend disa nga këta tema:

Në studimet letrare, meritojnë të studiohen fazat kryesore, ndërlidhjet midis tyre nga fillimet e letërsisë artistike të hershme letrare para e pas epokës së Rilindjes Kombëtare dhe më vonë deri në kohën e sotme, duke zbuluar vazhdimësinë e fazave kryesore dhe kthesat, çarje të mirëfillta artistike me ato të epokës së Rilindjes Kombëtare dhe më vonë, deri në atë cak kur kemi të bëjmë me modernitetin e tyre. Ideali estetik i vlerave estetike të lidhet me jetën e shqiptarëve dhe me frymën e mirëfilltë të shqiptarizmës, pa lëvdata e teprime nacionaliste përballë proceseve kulturore të globalizimit.

Të respektohen si kriter themelor i studimeve historike letrare vlerat e mirëfillta estetike të krijimeve individuale origjinale, që të shmanget përzierja e tyre me dukuri të tjera - sociale, kulturore, ekonomike, politike

etj., domethënë të kultivohet *karakteri estetik* i përmbajtjes së historisë së letërsisë artistike dhe të mënjanohen ndikimet e sociologjizmit vulgar dhe të ideologjizimeve e politizimeve, filozofizmat vulgare.

Historia e letërsisë të jetë histori e vlerave estetike dhe problemeve të zhvillimit të saj si histori globale e gjithë pjesëve të kombit, me specifikat historike, origjinalitetin, vlerat estetike dhe ndikimet e ndërsjella midis gjithë degëve të lisit arbëror, shqiptar dhe me interpretime krahasimtare me letërsitë ballkanike, europiane dhe botërore. Ka rëndësi të shmanget prirja e mbivlerësimit të ndikimeve të jashtme të pavërteta dhe e mbështetjes së njohjes së vlerave më të përsosura të letërsisë sonë kombëtare në vendet e tjera.

Kështu mund të vazhdojmë të përcaktojmë edhe shumë tema të tjera, trajtimi i të cilave mund të ndihmojë pasurimin e kërkimeve të reja shkencore të historisë së letërsisë e të kulturës shpirtërore të shqiptarëve kudo ku janë e veprojnë... Ka rëndësi të trajtohet edhe pozita sociale e letrarëve, krijuesve dhe studiuesve të albanologjisë në shoqëritë tona, të cilat në përgjithësi nuk japin atë ndihmë materiale e kulturore gjuhës dhe letërsisë shqipe, lulëzimit të tyre, siç nevojitet. Ka edhe të tjera, por po respektoj dhjetminutëshin dhe po i le për t'i parashtruar në botime të ardhshme. Faleminderit për vëmendjen!

Matteo MANDALÀ, Palermo

JERONIM DE RADA DHE ARBËRESHËT E SICILISË

KDU 821.18'282.4(=18:450).09

1.– Letërsia shqipe e romantizmit është e lidhur pazgjidhshëm me emrin e Jeronim De Radës dhe veprën e tij *Këngët e Millosaut*, botuar në vitin 1836. Ky fakt është pranuar sot nga të gjithë studiuesit që i janë kushtuar analizës së ndikimeve që "romani lirik i dyfishtë" deradian ka ushtruar mbi të gjitha fazat e mëvonshme të letërsisë arbëreshe dhe veçanërisht asaj që u zhvillua në mjediset e arbëreshëve të Sicilisë. Në lidhje me këtë aspekt në historiografinë e letërsisë dhe kritikën letrare vihen re shumë mangësi dhe shtrembërime që ende presin të ndreqen. Në këto radhë do të prek shkarazi disa nga këto probleme, që gjithsesi njihen dhe janë vënë në dukje nga studiuesit. Do të ndalem në veçanti në një çështje që sipas meje zë një vend qendror në kritikën deradiane e që mund ta përmbledh në këtë mënyrë: a është e mundur të vlerësohet në një këndvështrim diakronik ndikimi i poetikës së De Radës? Në cilat aspekte vihet re ndikimi estetik i kësaj poetike?

Gjatë kërkimeve që i kam kushtuar historisë së letërsisë arbëreshe, duke ndeshur shpesh në vepra që rimarrin formën narrative që futi për të parën herë në vitin 1836 De Rada, më ka lindur natyrshëm ideja për t'i ballafaquar këto tekste që u përkasin kohëve të ndryshme dhe autorëve që kanë jetuar e shkruar në epoka dhe kontekste të ndryshme historike. Kjo ide që më ka tërhequr edhe nga pikëpamja e teorisë së letërsisë erdhi duke u konkretizuar përmes krahasimit të strukturave, të stileve, të diskurseve narrative, duke dhënë kështu një kuadër të ri për studimin e historisë së letërsisë shqipe. I vetmi kufizim kishte të bënte me mungesën a pamjaftueshmërinë e të dhënave jashtëtekstore që do të mund të mbështetnin spekulimet hermeneutike që rridhnin nga dëshmitë ndërtekstore. Kjo mangësi ka filluar të mbushet në këto vitet e fundit, sidomos nga kremtimet me

rastin e njëqindvjetorit të vdekjes së poetit në vitin 2003, falë hulumtimit të plotë të veprave të De Radës në funksion të botimeve kritike nën drejtimin e prof. Francesco Altimarit, por edhe falë materialeve të pabotuara arkivore që kam mundur të shqyrtoj gjatë punës për botimin kritik të veprave të autorëve të ndryshëm arbëreshë të Sicilisë, thuajse të gjithë bashkëkohës të De Radës. Këtej rrjedh shtysa për t'iu përgjigjur pyetjeve të mësipërme duke nderuar kështu edhe figurën e De Radës përmes analizës së veprave të ithtarëve të tij në Sicili.

Për lehtësi shtjellimi, mendoj se është më e volitshme ta ndajmë në dy faza historinë e marrëdhënieve që De Rada dhe vepra e tij kanë mbajtur me arbëreshët e Sicilisë.

2.– Faza e parë që mbulon periudhën nga 1834 deri në 1860, u zhvillua në Napoli, ku, për një sërë arsyesh historike dhe politike që nuk është vendi të trajtojmë këtu, u mblodhën shumë intelektualë arbëreshë që vinin nga Kalabria dhe nga Sicilia. Në këtë kryeqendër De Rada hyri në kontakt me të tjerë intelektualë arbëreshë, disa prej të cilëve lozën një rol vendimtar në karrierën e ardhme të poetit dhe patriotit si edhe në peshën që ai zuri në lëvizjen e Rilindjes kombëtare. Vetë De Rada në autobiografinë e tij pranon se krizën e identitetit që e mbërtheu gjatë muajve të parë të qëndrimit në Napoli e kaloi falë ndihmës dhe përkrahjes morale që i dhanë dy arbëreshë të shquar, të dy të njohur dhe të vlerësuar në mjediset e rafinuara intelektuale të Napolit: njëri është Vincenzo Torelli (1805-1884) nga fshati arbëresh Barile, i cili i vuri në dispozicion faqet e së përkohshmes që drejtonte *Omnibus* ku De Rada botoi disa rapsodi[1]; tjetri është Giovanni

[1] "A Gennajo del 1836 mi recai una mattina all'ufficio dell'*Omnibus*, Giornale letterario, primo che si fondasse in Napoli. Trovai il Direttore Vincenzo Torelli, solo nello studio e gli parlai così: "Ho dei canti popolari di fisionomia peregrina, i quali starebbero forse come una novità nel suo Giornale. Non imputi ad imprudenza presuntuosa il presentarmele e senza raccomandazioni di sorta, perché non fu possibile averne a me Albanese sconosciuto". Udendo egli si levò commosso e strettami la mano profferse "Gjàku iin i shprìsht" (*il sangue nostro disperso !*). Era anch'egli albanese di Barile in Basilicata. L'Omnibus comparve enunciando la mia visita e riportando le poesie che parvero originalissime; e fu dappoi sempre aperto alle mie prove": Girolamo De Rada, *Autobiologia. Primo Periodo*, Cosenza, Tipografia municipale di F. Principe, 1898, p.

Emanuele Bidera[2] (1784-1858), arbëresh nga fshati Palazzo Adriano në Sicili, figurë poliedrike që kujtohet edhe sot si libretisti i kompozitorit të shquar Donizetti (shkroi për të libretin e operës *Gemma di Viergy*), i cili e pranoi në shkollën e recitimit që drejtonte ku De Rada u njoh e u miqësua veç të tjerësh edhe me Francesco de Sanctis[3]. De Rada i kaloi turbullimet e para rinore që e pengonin të botonte *Këngët e Millosaut* falë nxitjes dhe këmbënguljes së Biderës i cili, i ngazëllyer prej atyre vargjeve, sikurse na thotë vetë poeti "nuk kurseu asnjë arsyetim […] për të më nxitur t'i nxirrja në dritë. E ma gjeti vetë ai shtypshkronjën, ndërkohë që unë prisja të më dërgonin nga shtëpia paratë për ta shtypur"[4]. Sapo u botua poema *Këngët e Serafinës*, të parin recension për të e shkroi një tjetër arbëresh nga Sicilia Francesco Crispi[5] (1818-1901), nipi i albanologut dhe helenistit të shquar Giuseppe Crispi, autor i disa veprave gjuhësore mbi prejardhjen e shqipes, edhe ai sikurse Bidera, me origjinë nga Palazzo Adriano. Marrëdhënia me Crispi-n kishte rëndësi të veçantë, siç dëshmon vetë De Rada në *Autobiologjinë* e tij, ku përmend se merrte dhe lexonte gazetën politike *L'Apostolato* që Crispi, ai që më pas do të bëhej kryeministri i parë i Italisë së

20, ribotuar në Girolamo De Rada, *Opera Omnia*, vol. VIII, *Autobiografia*, edizione e introduzione di Michelangelo La Luna, Classici della Letteratura Albanese, Rubbettino Editore, Soveria Mannelli, 2008, f. 61-62.

[2] Shih S. Sallusti, "Giovanni Emanuele Bideri (Bidera)" në *Dizionario biografico degli italiani*, Istituto della Enciclopedia Italiana fondata da Giovanni Treccani, Roma, f. 361.

[3] Shih Francesco De Sanctis, *La giovinezza. Memorie postume seguite da testimonianze biografiche di amici e discepoli*, a cura di Gennaro Savarese, Giulio Einaudi, Torino 1961, f. 85 e 183.

[4] "Il vecchio rispettabile allora mi si piantò davanti e consideratomi, com'ebbe poi sciolta la scuola a sé mi rattenne; e uscimmo insieme. E come gli dissi de' miei esercizi in nostra lingua ed udì qualche ode del *Milosao*, non lasciò ragionamento che non usasse per indurmi a metterle in luce. E mi trovò ei stesso il tipografo, intanto ch'io facevamo venir da casa i denari per la stampa. Si pubblicò nell'agosto del 1836…": Girolamo De Rada, *Autobiologia. Primo Periodo*, cit., p. 20, ribotuar në Girolamo De Rada, *Opera Omnia*, vol. VIII, *Autobiografia*, cit., f. 63.

[5] Shih Francesco Crispi, "Recensione ai *Canti di Serafina Thopia*", në *Oreteo*, n. 5, a. I, 7 ottobre 1839, Palermo, 1839.

bashkuar, kishte themeluar në Palermo në janar të vitit 1848[6], në prag të kryengritjeve revolucionare që do të tronditnin Sicilinë. Kjo rrethanë ndihmon për të ndriçuar kontekstin historik dhe politik ku u poq projekti editorial i botimit të gazetës *L'Albanese d'Italia* ("Arbëreshi i Italisë") që De Rada themeloi në Napoli fill pas "ngjarjeve siciliane" që aq shumë tronditën poetin e ri dhe "mentorin e tij plak Emmanuele Bidera". Gazetaria napolitane e ndikoi shumë të riun De Rada, sikurse do të kujtojë vetë ai më vonë:

> *"In quelle settimane perplesse Bellelli mi chiese per lettera, profferendomi la metà degli abbonati, la fusione dell'Albanese nel Costituzionale, di cui sorgeva un potente rivale nel Tempo, organo del Troya. Io risposi semplicemente non volere sopprimere da me la patria Bandiera, né potere la indole mia selvatica ottemperare ad opinioni ed intenti di comitati, ed in generale ad altrui. E rimase il mio Giornale indipendente, e seco indipendente pur l'Omnibus, di proprietà del mio connazionale ed amico Vincenzo Torelli di Barile, in Basilicata. Non ricordo precisamente se prima o dopo questi fatti […] vennemi spedito l'Apostolato di Francesco Crispi, della Colonia nostra di Palazzo Adriano. Gli mandai allora tutti i numeri dell'Albanese e lo scambio durò fino a tanto che le tempeste sopravvenute sommersero ad un'ora i due Periodici. Mentre poco dopo i successi sopranarrati, si fece chiara l'aspirazione della Sicilia alla propria Autonomia amministrativa.*

[6] Shih M. D'Aprile, *"L'Apostolato" di Francesco Crispi, giornale della rivoluzione siciliana del 1848-49*, "Rivista letteraria", a. X, n. 2, 1938, f. 36-41; Niccolò Domenico Evola, "Crispi giornalista nel '48", in Eugenio di Carlo e Gaetano Falzone (a cura di), *Atti del Congresso di studi storici sul '48 siciliano*, Palermo, Priulla, 1950. Mbi shtypin napolitan shih E. De Chiara, "Il giornalismo politico a Napoli nel 1848" në *Rassegna storica napoletana*, Napoli, 1941, f. 299-315; Alfredo Zazo, "Il giornalismo politico a Napoli nel 1848-49" në *Archivio storico per le province napoletane*, a cura della Società di Storia Patria, nr. LXX, 1947-1949, f. 245-292. Për një trajtim më të hollësishëm mbi gazetarinë gjatë kryengritjeve revolucionare shih Franco Della Peruta, *Il giornalismo italiano del Risorgimento. Dal 1847 all'Unità*, Franco Angeli, Milano, 2011.

Essa divenne all'imprevista l'incubo del vecchio mio Mentore Emmanuele Bidera, nativo esso pure di Palazzo Adriano, e pure a me sembrava giusta. Per reminiscenza della vita ellenica di cui mi avevano imbevuto i classici, io in cuore era Federalista. Non pertanto in quanto a forme di Stato – su le quali poscia appresi a non fondarci troppo – difesi con animo schietto le accettate dal paese e sempre. Nella questione Siciliana la pretesa che parevami di Napoli a dominare l'isola sembravami da volontà iniqua. Però non ne feci oggetto di ripetute discussioni nel Giornale, evitando di fermo proposito ogni nostro intervenire, inasprendo i dissidî civili nell'Italia che ci aveva ospiti sì cari. Invece altri Giornali, senza pur avere inclinazioni per la Sicilia, perciò solo che le prime avvisaglie felici degl'insorti rianimavano i clamori degli speranzoni e dei malcontenti, o che ambiziosi, o che nemici, essi animavanli alla lotta dandole ragione"[7].

L'Albanese d'Italia vendosi një primat të dyfishtë, posaqë nga njëra anë, i dha jetë historisë së shtypit shqiptar, nga ana tjetër, i dha një kontribut çështjes kombëtare italiane tashmë nga pikëpamja e arbëreshëve. Në editorialin që shkroi me titull "Programma" për herë të parë De Rada shtjellon dhe shpall qëndrimin e arbëreshëve ndaj çështjes italiane: "As

[7] Girolamo De Rada, *Opera Omnia*, vol. VIII, *Autobiografia*, *Quarto Periodo* cit., f. 128-129. Është me interes të vihet re, edhe në hullinë e pohimeve të Franco Della Paruta-s, kovergjenca e ideve politike të Crispit, Biderës dhe De Radës, të cilët gjatë asaj periudhe anonin nga një zgjidhje "federaliste" që i binte ndesh asaj mazziniane. Della Paruta shkruan: "Il 27 gennaio apparve l'*Apostolato*." (fino al 15 maggio 1848; e poi ripreso dal 16 febbraio al 3 marzo 1849; trisettimanale), fondato e diretto da Francesco Crispi, che ebbe sin dall'inizio una ispirazione democratica e che affermò risolutamente lo stretto collegamento tra questione siciliana e questione nazionale: "Cittadini d'Italia – scriveva nel numero iniziale – abbiam manifestato che noi vogliamo e meritiamo far parte della federazione italiana, che sarà il termine dei nostri voti". Edhe pse e hapur ndaj ideve të Mazzini-t, gazeta "Apostolato", indipendentiste sikurse shumica e gazetave siciliane, iu kundërvu unitarizmit të tij duke kërkuar një bashkim federal që duhej të mbante parasysh dallimet dhe veçantitë e pjesëve të ndryshme të Italisë": Franco Della Peruta, *Il giornalismo italiano del Risorgimento*, cit., f. 175.

liria aq e dashur për ne arbëreshët nuk do të mund të fashitë mes nesh ndjenjat e larta që mikpritja dhe qytetaria e këtij vendi na ka dhuruar me aq dashuri"[8]. Një ishte sigurisht një deklaratë mirënjohjeje, por njëherazi shprehte edhe vetëdijen se "ky fat i bardhë na mbush sot me shpresë për të ardhmen e Shqipërisë"[9]. Me fjalë të tjera kemi të bëjmë me shenjat e para të angazhimit të ardhshëm politik të De Radës: me t'u mbyllur çështja italiane do të hapej ajo shqiptare, për të cilën ndërkohë arbëreshët e vendosur në Napoli që vinin nga vise të ndryshme të Italisë së Jugut[10] kishin zënë të jepnin kontributet e para duke filluar nga krijimi dhe përhapja e miteve ku do të mbështetej doktrina e nacionalizmit shqiptar. Mes këtyre të fundit vlen të përmendim atë që "u importua" në Napoli nga Sicilia prej Biderës.

Lidhja e ngushtë me Biderën krijoi kushtet për njohjen dhe shkëmbimin e të dhënave mes dy komuniteteve arbëreshe të Kalabrisë dhe të Sicilisë. Bidera përfaqësonte hallkën lidhëse, që deri më sot është injoruar nga studiuesit e historisë së letërsisë dhe të kulturës të kësaj periudhe kyçe të Rilindjes kombëtare. Në fakt përmes kësaj ure të re komunikimi kaluan

---

[8] Girolamo De Rada, "Programma" in *L'Albanese d'Italia. Giornale politico morale letterario*, anno I, num. 1, 23 febbraio 1848, Napoli, f. 1. Gjetja këto kohët e fundit e një kopjeje thuajse të plotë të koleksionit të *L'Albanese d'Italia* bëri të mundur një njohje më të mirë të periudhës napolitane të De Radës. Falë nismës së mikut dhe kolegut Francesco Altimari, me rastin e 200 vjetorit të lindjes së poetit doli në dritë botimi anastatik i kësaj gazete: shih *L'Albanese d'Italia. Giornale politico morale letterario*, Napoli 1848, Ristampa Anastatica, Edizione curata dalla Fondazione Universitaria Francesco Solano, Dall'Ambasciata Italiana a Tirana, dall'Istituto Italiano di Cultura a Tirana con una presentazione di Francesco Altimari, Rubbettino editore, Soveria Mannelli, 2014.

[9] Po aty, f. 2.

[10] Ndryshe nga Crispi që udhëhoqi kryengritjen siciliane, Torelli me gazetën e tij *Omnibus* (sikurse edhe Bidera) ishte kundër kërkesave indipendentiste dhe separatiste të shfaqura në vitin 1848: shih Franco Della Peruta, *Il giornalismo italiano del Risorgimento*, cit., f. 160. Mbi mendimin politik të De Radës shih Gëzim Gurga, *De Rada politicus - vështrim mbi idetë dhe qëndrimet politike të poetit*, kumtesë e mbajtur në konferencën ndërkombëtare me rastin e 200 vjetorit të lindjes së poetit, organizuar nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë, 11 nëntor 2014, Tiranë, në proces shtypi.

idetë e zhvilluara në mjediset arbëreshe të Sicilisë, fillimisht në veprën e De Radës, e përmes tij u bënë pronë ideologjike e mbarë lëvizjes së rilindjes. Mes këtyre ideve po kufizohem të përmend atë mbi prejardhjen e hershme të gjuhës shqipe, që Bidera dhe De Rada e lidhën me Pellazgët e lashtë, popullin paragrek ku Nikollë Keta (1742-1803), arbëresh nga Contessa Entellina në Sicili e një nga intelektualët më prodhimtarë gjatë shekullit XVIII, kishte gjetur më parë paraardhësit e shqiptarëve[11].

3.– Një takim tjetër i rëndësishëm i De Radës në Napoli ishte ai me Dhimitër Kamardën (1821-1882), gjuhëtarin arbëresh nga Hora e Sicilisë, që ishte syrgjynosur në Napoli për shkak të ideve të tij patriotike liberale[12]. Marrëdhënia e tyre ishte shumë e ngushtë dhe e frytshme, sikurse kujton vetë De Rada:

> *"L'anno seguente venne da Sicilia in Napoli, a Parroco della Chiesa Greca de' Fiorentini, Demetrio Camarda, albanese vero di cuore e di mente. Mi trovava Egli costantemente alla Villa nelle ore del passeggio e conferivamo intorno al risorgimento intellettuale e morale della nazione nostra, derelitta fra le patrie degli uomini"*[13].

Ky takim shënoi një këmbim të mëtejshëm idesh që përforconim ato që De Rada kishte marrë nga mentori i tij Bidera. Për më tepër Kamarda i dha De Radës mundësinë të lexonte e të kopjonte tekstet e këngëve popullore që në vitin 1700 kishte mbledhur bashkëfshatari i tij Gian

---

[11] Nuk është rasti të ndalemi në këtë dukuri delikate bashkëndikimesh kulturore dhe ideologjike, që e kemi trajtuar gjerësisht në një punim tjetër: shih Matteo Mandalà, "Alle origini del mito pelasgico: Girolamo De Rada e Giovanni Emanuele Bidera" në Girolamo De Rada, *Opera Omnia*, vol. XI, *Opere filologiche e storico-culturali e Fiamuri Arbërit (1883-1887)*, Rubbettino Editore, Soveria Mannelli, 2009, f. 9-24 ribotuar në shqip në Matteo Mandalà, *Studime filologjike për letërsinë romantike arbëreshe*, Shtëpia Botuese e studio letrare "Naimi", Tiranë, 2013, f. 61-91.

[12] Mbi jetën dhe veprën e Dhimitër Kamardaës shih Antonino Guzzetta, "Demetrio Camarda, uomo di fede, patriota, scrittore, linguista" në *Demetrio Camarda e la linguistica albanese*. Atti dell'XI Congresso Internazionale di Studi Albanesi, Palermo, 20-22 aprile 1983, a cura di Antonino Guzzetta, Palermo, 1984, f. 9-16.

[13] Girolamo De Rada, *Opera Omnia*, vol. VIII, *Autobiografia*, cit., f. 105.

Francesco Avati (1717-1800) ia kishte dërguar në shenjë nderimi at Gjergj Guxetës[14]. Falë këtyre dëshmive të shkruara të traditës poetike gojore në mendjen e De Radës u përvijua projekti asaj ndërmarrjeje madhështore që u botua në vitin 1866 me titullin *Rapsodi të një poeme shqiptare*[15].

3.– Nëse këto takime të fazës së parë dëshmohen nga vetë të dhënat autobiografike të De Radës, të tjera dokumente dëshmojnë marrëdhëniet me intelektualë arbëreshë të Sicilisë gjatë periudhës nga viti 1860 deri në vitin 1903, kur vdiq poeti. Kjo fazë e dytë është e pasur me një letërkëmbim që na lejon të rindërtojmë marrëdhëniet me shumë intelektualë dhe shkrimtarë arbëreshë të ishullit. Nga leximi i këtij burimi të rëndësishëm del jo vetëm roli qendror dhe ndikimi që De Rada ushtroi mbi bashkëbiseduesit e tij, por edhe forca e jashtëzakonshme me të cilën ai, edhe pse jetonte në një zonë periferike, ia doli të nxiste e të bashkërendiste veprimtaritë kulturore, letrare e patriotike të intelektualëve që, ndryshe prej tij, jetonin në kryeqendrat e mëdha të Jugut të Italisë.

Një burim me interes të jashtëzakonshëm për të rindërtuar këtë fazë të marrëdhënieve mes De Radës dhe arbëreshëve të Sicilisë përbëhet nga një sasi e madhe dokumentesh, kryesisht të pabotuara, që përfshin edhe letërkëmbimin. Veçojmë këtu letrat e shkruara nga arbëreshi i Palazzo Adriano-s, Pietro Chiara (1840-1915), që kanë vlerë qoftë nga pikëpamja

---

[14] "Portava Camarda di Sicilia un manoscritto di canzoni albanesi preziosissimo e qualche lettera di Gian Francesco Avati, nativo di Maqi nel Secolo XIX e morto Cattedratico in Urbino. Da Urbino erano datate più lettere sue che si conservavano in Maqi in casa di mia ava materna. Nella visita in San Cosmo, di cui parlai nel *II Periodo* di mia Vita, vidi anche un suo stampato rinvenuto nella libreria di Don Flaminio Tocci. Constava di due temi: la Leggenda del transito per aere della Imagine di nostra Donna del Buon Consiglio da Scutari d'Albania in Genazzano;[14] ed una lettera di accompagnamento d'un plico di antichi canti albanesi *raccolto dalla bocca* del popolo, che Egli spediva al Rettore de' Padri Olivetani di Palermo. Questa notizia mi accertò del fatto che il manoscritto, di carattere e del dialetto di Avato, era la Collezione di Lui che da Palermo per Camarda a noi riveniva": Girolamo De Rada, *Opera Omnia*, vol. VIII, *Autobiografia. Terzo Periodo*, cit., f. 105-106.

[15] Shih Girolamo De Rada, *Rapsodie d'un poema albanese raccolte nelle colonie del napoletano*, tradotte da Girolamo de Rada e per cura di lui e di N. J. de Coronei ordinate e messe in luce, Firenze, 1866.

historiografike politiko-kulturore, qoftë edhe ajo letrare. Deputet në parlamentin italian dhe militant në partinë e të kushëririt Francesco Crispi, nga i cili më vonë do të largohet, Chiara ishte gazetar i së përkohshmes *La Riforma*. Në cilësinë e të dërguarit të veçantë në Shqipëri, ai shkroi një reportazh mbi shqiptarët e Ballkanit dhe më vonë botoi edhe dy vëllime[16] që patën një ndikim të madh në opinionin publik italian. Falë kësaj fame ai hyri në kontakt edhe me De Radën, të cilit i tregoi përshtypjet që pati gjatë vizitës në Shqipërinë që dergjej nën sundimin osman, por edhe e informoi mbi prodhimin letrar të arbëreshëve të Sicilisë. Mes të dyve lindi një miqësi dhe bashkëpunim i frytshëm, sikurse e dëshmon fakti që në faqet e *Fiamurit të Arbrit* De Rada botoi poemën "*Il guerriero di Skanderbeg*" hartuar nga Pietro Chiara[17].

Me vlerë të veçantë për historiografinë letrare është edhe e dhëna që përmbahet në letrën e datës 12 korrik 1870, dërguar nga Roma e shkruar mbi një letër me një *intestatio* "Camera dei Deputati", që na ka mbërritur e paplotë, sepse i mungon fleta e mesit. Me këtë letër, që ruhet në Arkivin e Shtetit në Tiranë, Chiara i premton de Radës se do t'i fliste "in altra lettera del poema di mio cugino Ga-"[18], frazë kjo që megjithëse ndërpritet, lë të nënkuptohet se e kishte fjalën për "Gabriele Dara" e se, për pasojë, poema në fjalë ishte *Kënka e sprasëme e Ballës*. Meqenëse në këtë letër bëhet fjalë për një *poemë*, kemi të drejtë të besojmë se në vitin 1870 vepra ose ishte kryer plotësisht ose shumë-shumë poeti po i jepte dorën e fundit.

4.– Me siguri në mars të vitit 1884, sipas dëshmisë së Federico Ferriolit, nipit të De Radës, Gavril Dara i Riu (1826-1885) ishte "thuajse duke përfunduar shkrimin e një poemthi shqip, që rrëfen, me gojën e njëfarë Balle, i mërguar në Palazzo Adriano dhe bashkëluftëtar i Skënderbeut,

---

[16] Shih Pietro Chiara, *L'Albania*, Tipografia del Giornale di Sicilia, Palermo, 1869; Pietro Chiara, *L'Epiro gli Albanesi e la Lega: lettere di Pietro Chiara alla Riforma*, Tipografia di Pietro Montaina e C., Palermo, 1880.

[17] Shih *Fiamuri Arbërit*, "La Bandiera dell'Albania". Pubblicazione periodica mensile per cura d'un comitato di signori d'Albania e delle sue colonie, anno I, n. 12, 30 ottobre 1884, f. IV-V.

[18] Arkivi i Shtetit i Tiranës, Fondi De Rada, *Lettera di Pietro Chiara a Girolamo De Rada del 12 luglio 1870*, f. 24, d. 54/3, fl. 180.

betejat e fundit dhe rënien e atdheut tonë". Vetëm një vit më vonë Pietro Chiara në një letër të datës 24 prill 1885, që i dërgonte De Radës, saktësonte: "kushëriri im i shquar komendador Gavril Dara ka gati një poemë shqiptare që së shpejti do të shohë dritën e botimit. Është një vepër që do t'i bëjë nder autorit dhe gjithë shqiptarëve"[19]. Vdekja e Gavrilit disa muaj më pas e vonoi për pesëmbëdhjetë vjet të tjera botimin e poemës, që pa dritë vetëm më 1906[20] falë interesimit dhe nxitjes së më të shquarit rilindas arbëresh, Jeronim de Radës.

Kjo letër dhe dokumente të tjera të shumta hedhin poshtë përfundimin e Ignazio Parrinos sipas të cilit "marrëdhënia e drejtpërdrejtë mes Darës dhe De Radës deri më sot mbetet vetëm një supozim", sikundër nuk është e vërtetë se "ka vetëm të dhëna për disa letra që de Rada shkëmbeu me Darën, këshilltar i Prefekturës së Katanxaros"[21]. Të tilla pohime mund të shmangeshin, po të shqyrtoheshin më me kujdes, nuk them të dhënat arkivore, por vetëm burimet e shtypura që vetë Parrino i citon. Që marrëdhëniet mes dy poetëve qenë të ngushta e të vazhdueshme, e vërteton fakti se në vitin 1884 në revistën *Fiamuri Arbërit* Jeronim de Rada botoi një histori të shkurtër në shqip të ngulimit arbëresh Palazzo Adriano[22], shkruar nga Dara, dorëshkrimi autograf i së cilës gjendet në Arkivin e Shtetit të Tiranës[23]. E megjithëse nuk përjashtohet që të dhëna të tjera mbi marrëdhëniet me De Radën të gjenden në letërkëmbimin me Andrea Darën dhe

---

[19] Arkivi i Shtetit Tiranë, Fondi De Rada, *Lettera di Pietro Chiara a Girolamo De Rada del 24 aprile 1885*, f. 24, d. 54/3, fl. 201.

[20] Shih Gabriele Dara, *Il canto ultimo di Bala: poema inedito*, Tipografia di Giuseppe Caliò, Catanzaro, 1906. Do kujtuar këtu se tipografia Caliò ishte po ajo që shtypte të përkohshmen *La Nazione Albanese* drejtuar nga Anselmo Lorecchio.

[21] Ignazio Parrino, "Gabriele Dara", në *Il contributo degli Albanesi d'Italia allo sviluppo della cultura e della civiltà albanese. Atti del XIII Congresso Internazionale di Studi Albanesi*, a cura di Antonino Guzzetta, Palermo, 1989, f. 41 shën. 141

[22] Shih Gabriele Dara, "Monografia di Palazzo Adriano – *Monografii e Palàz-Adrianit*", në *Fiamuri Arbërit* "La Bandiera dell'Albania". Pubblicazione periodica mensile per cura d'un comitato di signori d'Albania e delle sue colonie, anno I, n. 7, Corigliano Calabro, 30 aprile 1884, f. V-VIII.

[23] Shih Fondi De Rada, *Lettera di Pietro Chiara a Girolamo De Rada del 24 aprile 1885*, f. 24, d. 54/1, fl. 50-51.

Pietro Chiara-n, disa fakte të tjera përgënjeshtrojnë pohimet e Parrinos. Për shembull, tregues të shumtë gjenden në jetëshkrimin e Darës, hartuar nga Ermina Tuttolomondo, ku autorja e quan poetin "një të madh në hije"[24]. Në këtë vepër sillen shumë dokumente dorëshkrim, që dëshmojnë admirimin e madh të autorit të *Kënkës së sprasëme të Ballës* për Jeronim De Radën. Ndër të tjera, Tuttolomondo thotë se Gavril Dara "në Lugo, në maj të vitit 1864, hartoi poemën e tij të parë me temë shqiptare, në vargje italisht". Në të vërtetë, po të analizohen me kujdes përshkrimet që na jep Tuttolomondo:

> *"është gjithçka e pabotuar, dhe paraqet si sfond kushtet në të cilat gjendej Shqipëria nga 1460 në 1485 dhe e merr frymëzimin nga historia e një princeshe fatkeqe "Anna Maria" që i jep titullin poemës. Kjo ishte bija e dytë e Aranit Comniatit, princit të Kotorrit, dhe motra Donikës, që u martua me Gjergj Kastriot Skënderbeun, heroin kryesor të luftës së ashpër për pavarësinë e Shqipërsië. Poema përbëhet nga një mijë e treqind vargje njëmbëdhjetërrokësh dhe ndahet në dy pjesë të pabarabarta: pjesa e parë numëron vetëm treqind e dyzet vargje, që i këndojnë sidomos bëmave të Bosdar Stresit nga Arta (i biri i Gjelës, motrës së Skënderbeut), prijësit ushtarak që çliroi Kotorrin nga turqit",*

dalin të dhëna krejt të ndryshme. Në të vërtetë nga ky fragment del qartë se protagonistja e poemës është marrë nga personazhi eponim i njërës prej *Rrëfymet e Arbërit* të Jeronim de Radës, pikërisht nga "Anna Maria Cominiate"[25] përkthimin e të cilës vepër Dara e përmend në përshëndetjen e ngrohtë në fund të letrës së lartpërmendur që i nipi Ferrioli i dërgoi De Radës:

---

[24] Shih Erminia Tuttolomondo, *Un grande nell'ombra. La vita e le opere di Gabriele Dara*, Tip. C. Formica, Girgenti, 1921.

[25] Shih *Poesie Albanesi di Girolamo De Rada. Seconda parte. L'Albania dal 1460 al 1485*, Napoli, Stamperia del Fibreno, 1847 ribotuar në Girolamo De Rada, *Opera Omnia*, vol. IV, *Storie d'Albania*, Edizione critica a cura di Fiorella De Rosa e traduzione italiana di Vincenzo Belmonte, Rubbettino Editore, Soveria Mannelli, 2010, f. 31-127.

Zoti im i shkluam,

U të lus të më ndëljesh pse pata forën të shprirja italisht të bukurën kënk tënde e Ann-Maries. Po t'e paç si shëmbëlltir e të moçmes ponis sime prej një burrë çë njoh e nderonj çë dizet vjet prapa me t'ëmblat kënka e Millosaut.

It vlla nd'Arbrit

Gavrili i Darënjëvet

Është e qartë se këtu kemi të bëjmë me një version italisht të veprës së de Radës dhe jo, siç thotë Erminia Tuttolomondo, së cilës i falet mosnjohja e veprës deradiane, të një vepre origjinale të Darës. Nga citimi i mësipërm del jo vetëm se Dara e njihte mirë dhe e adhuronte veprën letrare të De Radës, por ai ia kishte hyri përkthimit në vargje njëmbëdhjetërrokëshe në italisht, të poemës së De Radës. Krahas këtyre konsideratave të rendit historiografik, duhen shtuar disa vlerësime të tjera të natyrës letrare dhe ideologjike. Në parathënien e veprës së vet Dara i referohet *Motit të madh*, pra metaforës me të cilën De Rada quajti periudhën historike kur u shfaqën ato virtyre "kombëtare" që do ta shtynin popullin shqiptar të ngrihej në luftë për çlirim kombëtar dhe pavarësi. Mesjeta e Skënderbeut, e heroit dhe e besimit të të parëve, e dashurive dhe e tragjedive, u bë jo vetëm epoka e idealizuar na romantikët arbëreshë, por edhe ideologjema që, nga viti 1836 kur De Rada botoi *këngët e Millosaut*, do të kishte kushtëzuar dhe frymëzuar të gjithë shkrimtarët arbëreshë të Sicilisë, mes të cilëve, përveç Gavril Darës, përmendim edhe të riun Zef Skiro.

5.– De Radës i shkruante plot admirim Cristina Gentile Mandalà (1856-1919), e vetmja grua që iu kushtua mbledhjes së përrallave popullore[26]. Nga letërkëmbimi[27], përveç të dhënave të shumta mbi veprimtarinë

[26] Ja portreti i së kushërirës përshkruar nga Schirò: «La signora GENTILE CRISTINA [...] venne educata nel Collegio di Maria del nativo paese, e fin dalla sua prima giovinezza, oltre che all'arte del ricamo in oro, di cui riuscì insuperabile cultrice, dedicossi tutta allo studio della lingua albanese, giovandosi delle opere di D. CAMARDA e dei pochi libri di cui allora si potea disporre, fra i quali qualcuno di GIROLAMO DE RADA, il grande e venerando pioniere dell'idea albanese, col quale essa ben presto si mise in relazione epistolare, aiutandolo anche nella diffusione del Fjamuri. Dalla bocca del popolo

e saj si etnografe, del hapur edhe angazhimi patriotik i "Dora D'Istrias së Horës së Arbëreshëve" e mbi të gjitha roli i mecenatit qe Jeronim De Rada luante në të mirë të të rinjve të talentuar arbëreshë. Duke iu drejtuar atij Cristina Gentile Mandalà i rekomandoi kushëririn Zef Skiro (1865-1927), i cili më vonë do të ndiqte gjurmët e poetit të madh:

> *"Një kushërī jimi një djalj çë studharën Palerm, shërben se t'i japë gluhës shqipe të vjetërën dëljim. Më bëri të djovasë ca shërbise të tīj (valle, kangjele e të tjēr vjershe) çë mua, për sa mund gjukonj, më duken të mira. I dërgonj gjagjë, sa Zotëria jote çë ndër këto punë dëgjohet më se gjith të tjerët, të më thuash si të duken: pse një fjalj e Zotëris sate munt rrīnj tek ai zëmbrën e vuljemën t' ecinj te dhromi i mārr. Kī djalj me gjith se shūm i rī (nkë kā edhe një zet vjet) kā shtiposur për një Ditare, ca kënka italishte çë kān pëlqier"*[28].

Letrës i bashkëngjiti disa poezi që në vitin 1885 De Rada i botoi në gazetën e tij *Fiamuri i Arbrit*[29]. Botimin e poezive De Rada e shoqëroi me lëvdata dhe komente pozitive për poetin e ri:

> *"Delle poesie mandate insieme con questa lettera – e donde noi presaghi e certi possiamo dire al giovane: "Or Voi*

---

raccolse varie novelline popolari»: Giuseppe Schirò, *Canti tradizionali ed altri saggi delle colonie albanesi di Sicilia*, Napoli, 1923, (rist. anast. Piana degli Albanesi – Palermo, 1985), f. CXIII.

[27] Mbi letërkëmbimin De Rada - Gentile Mandalà shih Francesca Maria Di Miceli, "La corrispondenza fra Girolamo DE Rada e Cristina Gentile Mandalà" në *Omaggio a Girolamo De Rada*, Atti del V Seminario Internazionale di Studi Italo-Albanesi (2-5 ottobre 2003) e altri contributi albanologici, a cura di Francesco Altimari e Emilia Conforti, Albanologia 7, Università della Calabria, Cosenza, 2008, f. 165-174 ribotuar në Francesca Maria Di Miceli, *L'epistolario De Rada - Gentile Mandalà*, Studi e testi albanesi nr. 7, Mirror, Palermo, 2007.

[28] *Fiamuri Arbërit*, a. II, n. 6, 20 ottobre 1885, Cosenza, f. V-VI, (r. a., Arnaldo Forni Editore, Bologna, 1975). Letra u ribotua nga De Rada në Girolamo De Rada, *Appendice alla grammatica: antologia albanese tradotta fedelmente in italiano*, Napoli, stab. Tipo-Stereotipo del Cav. A. Morano, 1896, f. 33-34.

[29] Shih *Fiamuri Arbërit*, a. II, n. 6, 20 ottobre 1885, cit., f. VII.

> *svolgete con mano, il dì e la notte, gli esemplari greci" – delle poesie, perché troppo poco spazio abbiamo, troppo poco mostrar possiamo. Anche perché basta quel poco, da cui folgora alcun che di nuovo, riflesso d'una anima nativamente osservatrice, e donde la nazione nostra gratulando gli dirà: "Macte virtute" etc"*[30].

Ky ishte fillimi i një marrëdhënie të gjatë mes plakut De Rada dhe të riut ambicioz Skiro, marrëdhënie e cila qysh në fillim u karakterizua njëherazi nga dashamirësia dhe bujaria e poetit të madh dhe nga ndjeshmëria kryeneçe e "bardit të ri" nga Hora e Arbëreshëve. Në të vërtetë fillimet letrare të Skiroit jo vetëm që janë tipike për mjediset letrare *fin de siècle*, por dëshmojnë edhe se fatet e tij letrare dhe intelektuale, të lidhura ngushtë me dinamikat e lëvizjes kombëtare shqiptare, do të ndikoheshin nga De Rada.

Në një studim monografik për veprën poetike të Skiroit[31] kam dëshmuar se gjurmë të ndikimit të poemës *Rapsodi të një poeme shqiptare* të De Radës hasen në titullin, në strukturën dhe në brendinë e veprës *Rapsodie Albanesi*[32], e para vepër poetike në gjuhën shqipe që botoi Skiro e që i siguroi menjëherë suksesin. Në veprën e tij të dytë *Milo e Haidhe* ndikimi i De Radës qe edhe më i madh. Ky idil paraqet përkime të shumta me *Këngët e Millosaut* të De Radës[33] sidomos në aspektet stilistiko-estetike, përkime që kanë tërhequr vëmendjen e kritikëve[34]. Pa hyrë në detaje mbi tezat e ndryshme e të papajtueshme mes tyre (imitim i rëndomtë apo vepër origjinale), është rasti për të theksuar se pikërisht në këtë vepër duhen përqendruar analizat e krahasuara për të nxjerrë në pah ato të dhëna

---

[30] *Fiamuri Arbërit, po aty*, ff. VI-VII.

[31] Matteo Mandalà, *La Diaspora e il Ritorno. Mito, storia e cultura tradizionale nell'opera di Giuseppe Schirò,* Albanica 4, Istituto di Lingua e Letteratura Albanese, Palermo, 1992, f. 39-41

[32] Giuseppe Schirò, *Rapsodie Albanesi*, Palermo, 1887. Sulla storia dell'opera cfr. Matteo Mandalà, "Introduzione" a Giuseppe Schirò, *Opere*, vol. I, *Kroja, Rapsodie Albanesi*, Rubbettino, Soveria Mannelli, 1998.

[33] Mbi historinë e shkrimit të këtij idili shih Matteo Mandalà, "Introduzione" a Giuseppe Schirò, *Opere*, vol. II, *Milo e Haidhe*, Rubbettino, Soveria Mannelli, 1998.

[34] Matteo Mandalà, *La Diaspora e il Ritorno*, cit., f. 99-111.

ndërtekstore që japin dorë për vlerësimin kritik në perspektivën hermeneutike që cekëm në paragrafin e parë.

6.– Duhet kujtuar këtu edhe një tjetër arbëresh i Sicilisë. E kemi fjalën për Francesco Crispi Glavianon (1852-1933), shkrimtarin dhe poetin që na ka lënë një numër të madh veprash, shumë prej të cilave ruhen, ende të pabotuara, në fondin *Albansk Sammling* të Bibliotekës Mbretërore të Kopenhagës. Edhe ai iu drejtua De Radës duke i kërkuar mbështetjen që zakonisht të rinjtë i kërkojnë mjeshtrit. Kështu, edhe e ardhmja letrare e këtij arbëreshi nga Palazzo Adriano, kushëri Crispin dhe Darën, u shenjua nga ndërhyrja e De Radës, që e trajtoi pak a shumë si Skiroin. Në vitin 1886 nga faqet e *Fiamurit të Arbërit*[35] De Rada i uroi mirëseardhjen poetit të ri duke i botuar një elegji kushtuar Gavril Darës së Ri, që sapo kishte vdekur.

Pagëzimi letrar prej De Radës pati efekte shumë pozitive te Glaviano, mirëpo deri më sot, me gjithë vlerësimet e personaliteteve të kohës, mes të cilëve ishte edhe Giuseppe Pitrè, vepra letrare e Glavianos ende nuk njihet dhe nuk është studiuar sa duhet. Po të lëmë mënjanë disa tekste të botuara nga vetë autori në gjallje dhe një poemë të botuar pas vdekjes së tij nga Matteo Sciambra mbi bazën e një dorëshkrimi të paplotë[36], asgjë tjetër nuk njihet nga vepra e gjerë letrare, gjuhësore dhe etnografike e këtij autori. Kjo mangësi që është vënë re nga studiuesit e historisë së letërsisë[37], ka

---

[35] Shih Girolamo De Rada, "Vaitìmme - Nenie" në *Fiamuri Arbërit*, anno III, 20 aprile 1886, n. 12, Cosenza, 1886, f. III.

[36] Francesco Crispi Glaviano, *Mbi Malin e truntafilevet. Sul monte delle rose*, Testo e traduzione dell'autore con introduzione commento e note di Matteo Sciambra, Salesiana, Palermo 1963.

[37] Khs. pohimet: "Di questo poeta siculo-albanese ben poco si conosce, essendo quasi tutta inedita la sua produzione": Gaetano Petrotta, *Popolo, lingua e letteratura albanese*, Palermo, 1932. f. 190 tani në Gaetano Petrotta, *Studi di storia della letteratura albanese*, I. vol. *Popolo, lingua e letteratura albanese*, a cura di Matteo Mandalà, Albanica 18/1, Palermo, 2003, f. 187. "Frano Krispi, sipas të thënave të bashkëkohëtarvet të tij, duhet të ketë shkruar shumë, qoftë në vargje, qoftë në prozë, por pjesa më e madhe e prodhimit të tij letrar ka mbetur e pabotuar; e kjo e pakët që kemi, ndodhet e shpërndarë andej e këndej, dhe e botuar në revista tanimë të ralla e që s'gjenden gjëkundi": Rosolin

penguar shqyrtimin e mëtejshëm të disa ideve të Francesco Altimarit mbi bashkëpërkimet me modelet "liriko-narrative" që inauguroi De Rada. Me të pasur në dorë këto materiale që ruhen në fondin e lartpërmendur *Albansk Sammling* pranë Bibliotekës Mbretërore të Kopenhagës, idetë i Altimarit jo vetëm që kanë fituar vlerë hermeneutike, por tingëllojnë si një konfirmim i ndikimit të jashtëzakonshëm që paradigma romantike e De Radës ka ushtruar mbi poetët sicilianë, duke ofruar njëherëzi argumente të mëtejme për një analizë të plotë ndërtekstore.

7.– Faza e fundit është ajo që shkon nga vdekja e De Radës deri në ditët tona e që dallohet nga dy fazat e para prej faktit që perceptimi i poetikës deradiane nuk bëhet më me ndërmjetësinë e figurës së vetë autorit. Nuk do të ndalem në këtë fazë të fundit sepse konsideratat eventuale, përveçse do të dukeshin të stisura në raport me vlerësimin kritik të receptimit të poetikës deradiane, nuk hyjnë në objektin e këtyre radhëve. Po ia lë poetit arbëresh nga Sicilia, Giuseppe Schirò Di Maggio, e të shprehë me vargje ndjenjat e arbëreshëve të Sicilisë për De Radën

JERONIM DE RADËS

Na djem arbëreshë nga Sicilia
te seminari greko-shqiptar
i Grottaferratës Të njohëm
militant të palës kundërshtare.
Mbrojtësit e Tu arbëreshë nga Kalavria
shokë tanë në studime
në emrin Tënd kundërshtonin
neve mbrojtësit e tënit

Petrotta, "Frano Krispi Glaviano (1852-1933)" në *Shkrimtarët Shqiptarë*, Pjesa II. *Prej Lidhjes së Prizrendit deri sot*, Botim i Ministris s'Arsimit, Tiranë, 1941, f. 492. "Prodhimi poetik i Frano Krispi Glaviano nuk njihet mirë për arsye se poezitë, kangët e poemat e tij nuk i kemi të botueme": Kolë Kamsi, "Frano Krispi Glaviano (1852-1933) në *Shqiptarët e Italisë*, Shkodër, Phoenix, 2006, f. 431.

Zef Skjiro. Çmimi
dafina e Poetit më të Madh.
S' dinim për stafetë
o për pasardhës letrarë, vetëm
për diskutime të nxehta, nxehtësi
të natyrshme, për mburrje abëreshe.
Në emrin Tënd pasardhësit
kryen bukuri;
nga ana jonë pasardhës
kryem bukuri:
të pjekur nga mosha kuptuam
lodrat djaloshare e përleshjet,
një Emër vetëm duke qënë për Tyj
- si për ne të gjithë - Ungjillor
"Arbëria" qëmoti e përgjithmonë.

8.– Në këtë pikë, para se të shtroj përfundimet, dua të ndalem shkurt në një tjetër aspekt për të theksuar një të dhënë intertekstore që ka të bëjë me rrafshin kohor horizontal. Është fjala për marrëdhëniet mes këngëve të Milosaos dhe disa teksteve të autorëve bashkëkohës të tij si ato të Pushkinit, Lord Byron-it, Lamartine-it, Ugo Foscolo-s, në të cilat tekste ku më pak e ku më shumë, ku në mënyrë të drejtpërdrejtë e ku tërthorazi, mund të vëmë re disa struktura që përbëjnë precedentin historik prej të cilit De Rada mori frymën e kohës së tij. *Këngët e Milosaos* që jo më kot Ismail Kadare[38] i quan të denja të maten me veprat e autorëve të sapopërmendur, vihen në qendër të vëmendjes së ithtarëve të De Radës falë karakterit të tyre risor dhe frymës modernizuese që sollën në letërsinë shqipe, po të mbajmë parasysh këtu traditën e vakët të shekullit XVIII. I ashtuquajturi

[38] Ismail Kadare, "Duke lexuar *Milosaon*" në Drita, 24 shkurt 1963, cituar sipas ribotimit në *De Radës në 100-vjetorin e vdekjes,* Akademia e shkenceve e Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2003, f. 121.

fragmentarizëm që nga klasicistët fanatikë konsiderohej si shenjë dobësie e impiantit stilistik, rivlerësohet në perspektivën e një konceptimi të ri të strukturimit të gjuhës poetike, asaj gjuhe që Kadare e ka quajtur "forca e tij [e De Radës] e madhe sintetizuese[39]. Për të mos folur pastaj për arkitekturën e "romanit të dyfishtë lirik" mbi të cilën nuk po ndalem këtu sepse e kam trajtuar gjerësisht në një studim tjetër të botuar[40]. Më të njohura e më të pranuara janë të tjera tipare, si p.sh. përdorimi e tetërrokëshit si varg më i përshtatshëm për të shprehur lirizmin që gjuhë të tjera e shprehin më mirë me vargun njëmbëdhjetërrokësh, atë *celeberrimum carmen* të Dantes që Leopardi në Itali e ngriti në nivelet më të larta të artit romantik. De Rada e bëri zgjedhjen e tij jo pa vështirësi. Ai u rrek t'i ndërthurte bashkë dy sistemet, atë sasior me atë cilësor, sikundër e dëshmojnë edhe tekstet e botimeve të ndryshme të veprave të tij, sidomos të *Këngëve të Milosaos* që Francesco Altimari po i përgatit në botim kritik. Në hullinë e ndikimit nga poezia popullore që De Rada e mblodhi me dashuri dhe pasion të veçantë, gjejnë shpjegim edhe vargje të tëra që u morën ashtu siç ishin dhe u ngërthyen në indin poetik të veprës të tij. Një tjetër vërejtje tipologjike: vëllimi i kufizuar poemës, që përbëhet nga disa dhjetëra vargje, si për të dëshmuar imitimin e rapsodive të shkurtra popullore. Poema e De Radës dallohet nga strukturat e gjata e të ndërlikuara neoklasike, përdor një figuracion tipik popullor, ekzalton lirikën e fluturimit pindarik, kërkon përfaqësimin jo-pasiv të metaforës së jetës. Të gjitha këto tipare përbëjnë thelbin e modelit letrar që do të ndiqet nga poetët e tjerë arbëreshë ithtarë të De Radës dhe poetikës së tij.

Në disa raste, falë edhe kërkimeve që kemi ndërmarrë për të gjetur të dhëna të vlefshme hermeneutike, dëshmitë tekstore i kemi të qarta: kujtojmë këtu, p.sh. poemthin *Milo e Haidhe* të Zef Skiroit, që deri edhe në emërtimin e personazheve vendos marrëdhënie dialogu bachtinian me *Këngët e Milosaos*. Po ç'të themi për veprën e Gavril Darës të Riut, që e deklaroi hapur varësinë nga poezia popullore, e që imitoi me vetëdije të plotë artistike të gjitha karakteristikat stilistike e strukturore të *Këngëve të*

[39] Po aty, f. 124.

[40] Shih M. Mandalà, *Studime filologjike për letërsinë romantike arbëreshe*, cit., f. 19-59.

Milosaos? Përmendim këtu edhe vëllimin poetik të Francesco Crispi Glaviano-s, *Mbi malin e trundafilevet*, që po të lëmë mënjanë nivelin artistik modest, përbën edhe ai një provë të pakundërshtueshme të ndikimit të modelit deradian. Këto konsiderata që meritojnë të zgjerohen, të shtjellohen më hollësisht e të ilustrohen me shembuj konkretë, çka do ta bëjmë në një studim të ardhshëm, besoj se mjaftojnë për të pohuar se analiza diakronike e intertekstorësisë është jo vetëm e mundur, por edhe e domosdoshme për të rishkruar historinë e letërsisë shqiptare. Vetëm në këtë mënyrë, për të përdorur një figurë poetike të De Radës, kritika letrare do të mund të jetojë "net me fate të mëdha" dhe poetika deradiane do të arrijë ato kushte që për të kishte parashikuar Mistrali: "freski dhe paqe ungjillore".

Bibliografi

Chiara Pietro, *L'Albania*, Tipografia del Giornale di Sicilia, Palermo, 1869.

Chiara Pietro, *L'Epiro gli Albanesi e la Lega: lettere di Pietro Chiara alla Riforma*, Tipografia di Pietro Montaina e C., Palermo, 1880.

Crispi Francesco, "Recensione ai *Canti di Serafina Thopia*", në *Oreteo,* n. 5, a. I, 7 ottobre 1839, Palermo, 1839.

Crispi Glaviano Francesco, *Mbi Malin e truntafilevet. Sul monte delle rose*, Testo e traduzione dell'autore con introduzione commento e note di Matteo Sciambra, Salesiana, Palermo 1963.

D'Aprile M., *"L'Apostolato" di Francesco Crispi, giornale della rivoluzione siciliana del 1848-49*, "Rivista letteraria", a. X, n. 2, 1938.

Dara Gabriele, *Il canto ultimo di Bala: poema inedito*, Tipografia di Giuseppe Caliò, Catanzaro, 1906.

De Chiara E., "Il giornalismo politico a Napoli nel 1848" në *Rassegna storica napoletana*, Napoli, 1941.

De Rada Girolamo, "Vaitìmme - Nenie" në *Fiamuri Arbërit*, anno III, 20 aprile 1886, n. 12, Cosenza, 1886.

De Rada Girolamo, *Appendice alla grammatica: antologia albanese tradotta fedelmente in italiano*, Napoli, stab. Tipo-Stereotipo del Cav. A. Morano, 1896.

De Rada Girolamo, *Autobiologia. Primo Periodo*, Cosenza, Tipografia municipale di F. Principe, 1898.

De Rada Girolamo, *Fiamuri Arbërit*, r. a., Arnaldo Forni Editore, Bologna, 1975.

De Rada Girolamo, *L'Albanese d'Italia. Giornale politico morale letterario* (Napoli, 1848), Ristampa Anastatica, Edizione curata dalla Fondazione Universitaria Francesco Solano, Dall'Ambasciata Italiana a Tirana dall'Istituto Italiano di Cultura a Tirana con una presentazione di Francesco Altimari, Rubbettino editore, Soveria Mannelli, 2014.

De Rada Girolamo, *Opera Omnia*, vol. IV, *Storie d'Albania*, Edizione critica a cura di Fiorella De Rosa e traduzione italiana di Vincenzo Belmonte, Rubbettino Editore, Soveria Mannelli, 2010.

De Rada Girolamo, *Opera Omnia*, vol. VIII, *Autobiografia*, edizione e introduzione di Michelangelo La Luna, Classici della Letteratura Albanese, Rubbettino Editore, Soveria Mannelli, 2008.

De Rada Girolamo, *Poesie Albanesi di Girolamo De Rada. Seconda parte. L'Albania dal 1460 al 1485*, Napoli, Stamperia del Fibreno, 1847.

De Rada Girolamo, *Rapsodie d'un poema albanese raccolte nelle colonie del napoletano*,

tradotte da Girolamo de Rada e per cura di lui e di N. J. de Coronei ordinate e messe in luce, Firenze, 1866.

De Sanctis Francesco, *La giovinezza. Memorie postume seguite da testimonianze biografiche di amici e discepoli*, a cura di Gennaro Savarese, Giulio Einaudi, Torino 1961.

Della Peruta Franco, *Il giornalismo italiano del Risorgimento. Dal 1847 all'Unità*, Franco Angeli, Milano, 2011.

Di Miceli Francesca Maria, "La corrispondenza fra Girolamo DE Rada e Cristina Gentile Mandalà" në *Omaggio a Girolamo De Rada*, Atti del V Seminario Internazionale di Studi Italo-Albanesi (2-5 ottobre 2003) e altri contributi albanologici, a cura di Francesco Altimari e Emilia Conforti, Albanologia 7, Università della Calabria, Cosenza, 2008.

Di Miceli Francesca Maria, *L'epistolario De Rada-Gentile Mandalà,* Studi e testi albanesi nr. 7, Mirror, Palermo, 2007.

Evola Niccolò Domenico, "Crispi giornalista nel '48", in Eugenio di Carlo e Gaetano Falzone (a cura di), *Atti del Congresso di studi storici sul '48 siciliano*, Palermo, Priulla, 1950.

Giuseppe Schirò, *Opere*, vol. I, *Kroja, Rapsodie Albanesi*, a cura di Matteo Mandalà, Rubbettino Editore, Soveria Mannelli, 1998.

Guzzetta Antonino, "Demetrio Camarda, uomo di fede, patriota, scrittore, linguista" në *Demetrio Camarda e la linguistica albanese*. Atti dell'XI Congresso Internazionale di Studi Albanesi, Palermo, 20-22 aprile 1983, a cura di Antonino Guzzetta, Palermo, 1984.

Kadare Ismail, "Duke lexuar *Milosaon*" në cituar sipas ribotimit në *De Radës në 100-vjetorin e vdekjes*, Akademia e shkenceve e Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2003.

Kamsi Kolë, "Frano Krispi Glaviano (1852-1933)" në *Shqiptarët e Italisë*, Shkodër, Phoenix, 2006.

Mandalà Matteo, "Alle origini del mito pelasgico: Girolamo De Rada e Giovanni Emanuele Bidera" në Girolamo De Rada, *Opera Omnia*, vol. XI, *Opere filologiche e storico-culturali e Fiamuri Arbërit (1883-1887)*, Rubbettino Editore, Soveria Mannelli, 2009, f. 9-24 ribotuar në shqip në

Mandalà Matteo, *La Diaspora e il Ritorno. Mito, storia e cultura tradizionale nell'opera di Giuseppe Schirò*, Albanica 4, Istituto di Lingua e Letteratura Albanese, Palermo, 1992.

Mandalà Matteo, *Studime filologjike për letërsinë romantike arbëreshe*, Shtëpia Botuese e studio letrare "Naimi", Tiranë, 2013.

Parrino Ignazio, "Gabriele Dara", në *Il contributo degli Albanesi d'Italia allo sviluppo*

della cultura e della civiltà albanese. Atti del XIII Congresso Internazionale di Studi Albanesi, a cura di Antonino Guzzetta, Palermo, 1989.

Petrotta Gaetano, *Popolo, lingua e letteratura albanese*, Palermo, 1932.

Petrotta Gaetano, *Studi di storia della letteratura albanese*, I. vol. *Popolo, lingua e letteratura albanese*, a cura di Matteo Mandalà, Albanica 18/1, Palermo, 2003, f. 187.

Petrotta Rosolin, "Frano Krispi Glaviano (1852-1933)" në *Shkrimtarët Shqiptarë*, Pjesa II. *Prej Lidhjes së Prizrendit deri sot*, Botim i Ministris s'Arsimit, Tiranë, 1941.

Sallusti S., "Giovanni Emanuele Bideri (Bidera)" in *Dizionario biografico degli italiani*, Istituto della Enciclopedia Italiana fondata da Giovanni Treccani, Roma.

Schirò Giuseppe, *Canti tradizionali ed altri saggi delle colonie albanesi di Sicilia*, Napoli, 1923, (rist. anast. Piana degli Albanesi – Palermo, 1985.

Schirò Giuseppe, *Opere*, vol. II, *Milo e Haidhe*, a cura di Matteo Mandalà, Rubbettino Editore, Soveria Mannelli, 1998.

Schirò Giuseppe, *Rapsodie Albanesi*, Palermo, 1887.

Tuttolomondo Erminia, *Un grande nell'ombra. La vita e le opere di Gabriele Dara*, Tip. C. Formica, Girgenti, 1921.

Zazo Alfredo, "Il giornalismo politico a Napoli nel 1848-49" në *Archivio storico per le province napoletane*, a cura della Società di Storia Patria, nr. LXX, 1947-1949.

Ymer ÇIRAKU, Tiranë

QASJE RIVLERËSIMI RRETH OPUSIT KRITIK MBI VEPRËN DERADIANE

KDU 821.18.09

De Rada rezulton të jetë mbase autori më i vërejtur dhe më i interpretuar prej kritikës letrare dhe kjo është në harmoni me përmasat e pazakonta të kësaj figure. Gjer më sot për të, si rrallë për ndonjë autor tjetër, kemi një bibliografi që i kalon 300 shkrime, shkrime kritike këto që janë të të niveleve të ndryshme: akademike, mediatike, popullarizues, si dhe mjaft nga ato me funksion normativizues për tekstet e shkollave. Janë 2 përmbledhje të zgjeruara studimesh, të cilat vijnë prej materialeve referuese në konferencat shkencore, të organizuara në përkujtim të 150 vjetorit të lindjes (1964) dhe 100 vjetorit të ndarjes nga jeta (2003). Ndërkohë, gazeta e revista letrare në Shqipëri, në Kosovë e në komunitetin arbëresh në Itali, i kanë kushtuar këtij personaliteti nëpër vite numra të veçantë komemorativë. Kujtojmë se revista *Shêjzat,* e drejtuar nga Koliqi në Itali, numrin VIII (1964) të saj e pati tërësisht me shkrime kushtuar figurës së poetit arbëresh, ku vrehen nga ato të shkruara nga vetë Koliqi, pastaj një varg shkrimesh nga Karl Gurakuqi, Zef Valentini, Giuseppe Gradilone, Martin Camaj, Luca Perrone, Ekrem Vlora, Vorea Ujko, Dom Zef Oroshi, papas Emmanuele Giordano, madje në faqet e revistës përfshihen dhe 2 shkrime të kahershme të Faik Konicës, botuar në frengjisht me titujt respektivë *Pauvre Rada!* dhe *La bontè de Girolamo De Rada*, marrë prej revistës së tij *Albania*. Sikundër shihet, figuron një plejadë emrash me vokacione potente, fort të dalluar/të shquar me kontributet e tyre ndaj botës shqiptare.

Në rendin e këtyre botimeve përfshihen gjithashtu disa monografi mbi këtë autor, ku mund të përmendim atë të Giusepe Gualtieri-t (1930), Michele Marchiano-s (1902), Jup Kastratit (1962), Klara Kodrës (1988), Arshi Pipës (1975), Emin Kabashit (1994), Anton Nikë Berishës (2001).

Këto monografi, sipas synimeve të tyre prezantojnë specifikisht: këndvështrime analitike e klasifikuese të veprës së poetit - në kontekstin e letërsisë shqipe, apo shqyrtime rreth origjinalitetit që ajo vepër ka përcjellë përmes romantizmit, rreth ideologjisë e stilit, mbi ndikimet e afërta e të largëta të drejtimeve të ndryshme letrare në veprën e poetit, mbi statusin/ hierarkinë estetike të varianteve të këtyre veprave – vështruar në raporte stilistike e filologjike. Në këto studime monografike ka pasur vëmendje dhe qëndrime debatuese e polemiste edhe ndaj problemit të ruajtjes me besnikëri të teksteve origjinalë - apo praktikave të modeleve të përshtatura, duke nxjerrë në pah shqetësimin se nuk kanë munguar nga ato raste, kur janë bërë ndërhyrje jo profesionale, madje që kanë çuar në rrënimin apo gjymtimin/ deformimin e domethënies së atyre veprave.

De Radës i janë drejtuar në kohë të ndryshme me një varg tekstesh kritike, studiues e shkrimtarë/personalitete të ndryshëm, ku krahas atyre të përmendur më lart, vijojnë dhe mjaft të tjerë si: Namik Ressuli, Eqrem Çabej, Ismail Kadare, Françesko Altimari, Ziaudin Kodra, Dhimitër Shuteriqi, Rexhep Qosja, Ali Aliu, Sabri Hamiti, Matteo Mandalà, Italo Fortino, Alfred Uçi, Elio Miracco, Ali Xhiku, Gjergj Zheji, Jorgo Bulo, Gjovalin Shkurtaj etj.

Por autorë të mëdhenj, sikundër është De Rada, nuk mund të eksplorohen dot lehtë. Për vlerat komplekse që përcjellin, duke pasur prej këtij fakti, një marëdhënie e raport të pandalur për të ruajtur kontaktin me *horizontin e pritjes*, veprat e tij, posi ato planetet në lëvizje galaktike, u shfaqin/ rezervojnë lexuesve nëpër qerthujt e kontakteve të brezave përherë pamje të tjera/të reja, prandaj dhe aq grishëse për t`u zbuluar.

Me De Radën kritika aktualisht ndodhet në një proces problematik/ dinamik rizbulimi e për pasojë, *ri-interpretimi*. Ndonëse jemi duke folur në këtë rast për De Radën, por argumenti përfshin dhe autorë të tjerë, madje tërë rrjedhën e letërsisë arbëreshe, atë të rrafshit të traditës dhe atë vijuese. Problemi nuk shtrohet se ka qënë i munguar vlerësimi, i cili rezulton të ketë shkuar kohëve të ndryshme madje përplot emocion e deri në venerim. Por fjala është për jo pak vlera të tjera substanciale, ende të pakaluara ndër duarsh studiuesish, pra, të mbetura në hije.

Le të ndalemi tek romantizmi i veprës deradiane. Çabej në esenë e tij *Vatra dhe bota në poezinë e De Radës*, njofton shkoqur tiparin *dikotonomik* të kësaj krijimtarie, e cila sillte si pasuri drejt letërsisë shqipe jo vetëm substratin e pacënuar *autentik*, por edhe një bagazh ndikimesh e influencash prej letërsive të tjera. Mirëpo në tekste e manuale normative, ky dimension vazhdon të transmetohet/ përcillet i zbehur maksimalisht, nga shkaku se pandehej që nga kjo evidencë pastaj do të humbte/ devijonte/ kompromentohej orientimi i përkatësisë së kësaj vepre si *etnikum* letrar shqiptar. Në këtë ese, Çabej hedh hipotezën se në veprën e poetit arbëresh madje duket një horizont letrar edhe më i gjerë se ndikimet nga poezia romantike e kohës, pasi poeti i Maqit mundi të gjejë burime frymëzimi në literaturat klasike e në ato moderne. Kështu, studiuesi pikas reminishenca motivesh e konceptimesh poetike prej poemave italiane të Renesancës, prej botës klasike nga Apuleius e Sofokliu, nga Bibla, madje dhe nga poezia klasike indase - prej veprës në dramë të Kalidasës (*Sakuntala)* apo dramës (*Mrhakatika*) të Dandinit – prej të cilave ka rimarrë motive, episode, deri dhe emra personazhesh, sidomos tek poemat *Skanderbekku i pafaan* e *Serafina Topia.*

Por këto ide të hedhura jo pak guximshëm e me akribi hulumtuese mbetën këtu. Autori i tyre, për arsye të kuptuara, nuk e pati më rastin të merrej me argumentime më të holla të tyre. Në dijeninë tonë rezulton se ndërkaq, më tej, askush tjetër nuk ka ndërmarrë ndonjë studim për të depërtuar në brendësinë e këtyre kontakteve e ndikimeve, që me siguri do të mund të formatonin një përmasë tjetër të këtij krijuesi unikal (*sui generis*), e cila do të qarkullonte doemos si vlerë e shtuar e gjenisë së tij krijuese.

Është hedhur në ndonjë rast teza se De Rada arrin të krijojë një *shkollë poetike*, por nuk është arritur të hulumtohet më tej në ato premisa që realisht mundësojnë funksionimin e një shkolle letrare. Dhe këto premisa pasi egzistojnë realisht, duhet që të cilësohen si të tilla: De Rada ka autoritetin e personalitetit letrar, ka ndjekësit/dishepujt e tij, ka të elaboruar një doktrinë estetike (konkretisht traktatin *Parime të estetikës 1861*, ku shkon dhe përtej temave kanonike, duke administruar posaçërisht realitetin e arbërishtes si precedent të rizgjimit të gjuhëve të ashtuquajtura të *fjetura*, por me kapacitete potenciale për të realizuar/përballuar dhe deri kryevep-

ra), ka revistën *Fiamuri i Arbërit*, ka gjithashtu karizmën e lëvruesit aq gjatë të letërsisë - gjer në çastin e mbramë, kur u nda prej jetës që e kishte shkuar si në endërr duke mbledhur (si lulen më të bukur) *gjakun e shprishur të Arbërit*.

Po kështu, pikëpamja se De Rada mbetet kontributori i parë që e nxorri letërsinë shqipe nga periferia drejt qendrave të metropoleve letrare, vetëm sa përmendet e me mjaft ndrojtje. Çabej në esenë e tij të koncetruar, pohonte pa mëdyshje se poema *Këngë të Milosaos* për soliditetin artistik që manifeston, *mbetet një nga ato fort të pakta vepra të literaturës shqiptare që e bëjnë këtë të përfaqësohet në literaturën botërore*… Kadare nga ana e tij e klasifikon këtë vepër në zhanrin e romanit në vargje, si i pari model i këtillë në letërsinë shqipe i njëkohshëm me këso modelesh me autorë të mëdhenj romantikë si Hygo, Pushkin e të tjerë. Ky fakt do ta rrëzonte atë pikëpamje, e cila që vazhdon të qarkullojë ende nëpër tekste shkollash për gjasme *romantizmin e vonuar shqiptar*, kur ai rezulton të jetë jo vetëm i njëkohshëm kronologjikisht me atë europian, por edhe i denjë për t`u krahasuar, si në rastin e veprës së De Radës. Ky qëndrim i mbajtur gjer më sot ka të bëjë me sindromin e logjikës përjashtuese – pikërisht ndaj gjymtyrëve natyrale të letërsisë e kulturës shqiptare, sikundër është ajo arbëreshe. Sindrom që vazhdon të ndihet ende, si inerci e atyre kohëve të kaluara, karakterizuar nga gjykime të indoktrinuara politikisht.

Mbeten po ashtu një varg argumentesh/tezash që kërkojnë shqyrtime të përvijuara, sikundër janë: prezantimi koherent/sistematik i letërsisë arbëreshe e kuptohet dhe i veprës deradiane e përcaktuar *si lëndë ballkanike* (do të thotë shqiptare) me *formë romane*, po kështu roli i veprës së De Radës si referencë estetike e për pasojë si faktor stabilizues për letërsinë shqipe në rrjedhat e saj, apo roli dhënës e marrës i këtij qarku letrar në raport me polisistetmin letrar.

Sfidë mbetet dhe qarkullimi i veprës deradiane për tek lexuesi i sotëm. Na duket se, ashtu si në moralin e përrallës së mbretit të zhveshur, njohja e lexuesve me këtë vepër mbetet më së shumti e kufizuar përgjithshëm, brenda ideve komentuese të studiuesve - se sa të jetë njohje që vjen prej kontakteve të drejtpërdrejta të këtyre lexuesve me shijen e teksteve, gjë që e ka krijuar doemos dhe vështirësia e receptimit përmes dialektit të

arbërishtes. Janë hedhur ide të ndryshme për ta zgjidhur këtë situatë dhe zgjidhje për ta kapërxyer këtë sigurisht që mund të gjendeshin, sidomos përmes teksteve të shkollave, që e kanë për mision esencial orientimin për edukimin gjuhësor dhe të stërhollimit të shijes së leximit. Janë shfaqur dy palë të kundërta: njëra me insistimin që të qendrojnë vetëm variantet arbërishtes dhe tjetra që të përcillen tek shkollarët ato të përshtatura. Por me të drejtë thuhet se ekstremet p0uqen. Në të dyja rastet nuk do të bënim tjetër veçse do t`i hiqnim/privonim kësaj vepre lexuesin e saj të pritshëm, që do të ishte dhe dënimi më i rëndë për të. Në rastin e pare, lexuesin do ta kishim tepër të kufizuar, kurse në rastin e dytë do të kishim mbase më shumë lexues, por që do të lexonin vepra të tjera e jo ato ekzaktësisht të De Radës apo të tjerëve autorë arbëreshë. Pasi dihet se variantet e përshtatura (apo të përkthyera) nuk mund të jenë asnjëherë origjinali vet.

Më e udhës do të ishte që tekstet të jenë përkrah: ata origjinalë dhe ata të përshtatur. Por ndërkaq, krahas origjinalit, të ketë aparate me kompetencën e nevojshme filologjike, që përmes tyre, nxënësit të fitojnë një raport aktiv me fondin gjuhësor të arbërishtes, që mbetet pjesë e pandarë e thesarit të shqipes. Kompetencën për këtë ndërmarrje do ta kishin njohësit e mirë të arbërishtes e të shqipes, siç mund të ishin p. sh. studiuesit arbëreshë. Në këtë proces, jo vetëm që do të shijoheshin më mirë veprat, por ky fond gjuhësor i arbërishtes do të aktivizohej dhe do të krijonte mundësi për pasurimin e shqipes, që është proces i pandalur për çdo gjuhë në maredhëniet e saj pritëse, prej dialekteve e prej periferive të tjera gjuhësore. Kështu, De Rada do të hynte në mënyrë më të pushtetshme në rolin e shkrimtarëve të mëdhenj të letrave, të cilët, përmes letërsisë së tyre krijojnë gjuhë, e që përmes gjuhës shqipe - krijojnë pastaj Shqipërinë, në tërë dimensionet/ hapësirat natyrale të saj.

Zejnullah RRAHMANI, Prishtinë

JERONIM DE RADA: ESTETIKA SI TEORI E ARTIT ROMANTIK

KDU 821.18.02
821.18’282.4(450)

Poeti ynë i madh i romantizmit J. De Rada ishte figura më e kompletuar e Rilindjes Kombëtare, njëkohësisht edhe më kompleksja, ndoshta edhe në gjithë historinë e letërsisë shqipe. Kur e them këtë, kam parasysh veprën e tij letrare, unikate në letërsinë tonë të romantizmit, faktin që shumë vjet ishte mësuesi dhe themeluesi i studimeve të larta shqiptare, themelues dhe penda kryesore e revistës *Flamuri i arbërit*, ndër më të më shquarat në shqip në të gjitha kohët; ishte mbledhës folklori, gramatikan dhe autor i të parit traktat estetik *Parimet e estetikës*, megjithëse i shkruar në italisht. Vepra e tij e pasur, si dhe veprimtaria e tij, që shtrihet në pjesën më të madhe të shekullit XIX, kanë ushtruar ndikim të pakontestueshëm në zgjimin dhe formimin e vetëdijes nacionale shqiptare në tërësi. Shikuar nga realiteti arbëresh, do të shtonim edhe se duke punuar, duke shkruar verën e tij letrare e të dijes, duke zhvilluar e përhapur arsimin në arbërisht, J. De Rada e ka përjetësuar qenien arbëreshe dhe kontributin arbëresh në historinë e kulturës shqiptare. Dyqind vjet më vonë, personaliteti i tij vazhdon të rrezatojë në këtë kulturë. Veprimtaria e tij përbënë një fakt historie, që shtohet në peshë sa më shumë kohë që kalon, ndërsa letërsia e tij tregon cilësitë që e karakterizojnë një letërsi të madhe: qëndron përkundër kalimit të kohës si letërsi aktuale dhe *lexohet* duke i ofruar lexuesit të secilës kohë një fytyrë të re. Natyrisht që kjo mund të thuhet për *Këngët e Milosaos*, ndoshta edhe për *Këngët e Serafina Topisë* si vepra që ndërtohen mbi dy heronjtë romantik trimi dhe vasha, po të shpreheshim me fjalë arbëreshe, por edhe vepra mbi heroin romantik - historik *Skenderbeu i pafanë*, i pikturuar me *mjete të romantizmit* (këtu e kam parasysh *fragmentarizmin, zhytjen në natyrën kontradiktore të heroit*, përdorimin *e alegorisë*, ndërtimi i personazhit që ka një anë të panjohur , të errët

të karakterit, dualitet në të cilin individi nuk mund të ketë kontrollin e plotë të veprimit, etj.).

Spektri i veprës së tij, duke lënë mënjanë shkrimet e ndryshme publicistike, do të përmbledhë krijimtarinë gojore të arbëreshëve në veprën *Rapsodi të një poeme shqiptare* (1866), poemat *heroike – romantike*, veprën dramatike (*Sofonizma*, 1891) dhe kurorën mendimtare të përmbledhur nën titullin *Parime të estetikës* (1861), e shkruar në gjuhën italiane, por tashmë e pakalueshme për ata që kërkojnë ta njohin veprën e tij.

Titulli i kësaj vepre dhe çështjet e shumta të estetikës që trajtohen aty, i japin asaj karakterin e traktatit estetik dhe kjo u jep dorë studiuesve të kësaj fushe të vlerësojnë vlerën e koncepteve dhe të ideve estetike që autori ynë ka trajtuar aty, mirëpo hap padiskutueshëm edhe mundësinë për ta shikuar veprën në dritën e parimeve të romantizmit, sidomos atij evropian, pra si teori e artit të romantizmit. Është i njohur fakti që romantizmi në përgjithësi mbështetet mbi forcën ekonomike të klasës së re borxheve dhe në planin e ideve janë të zhytur në *praktiken estetike* që ka dalë nga filozofia idealiste. Argumentin e parë De Rada nuk e ka të theksuar, sigurisht edhe pse komuniteti i tij nuk paraqet një forcë të tillë kapitaliste, ndërsa të dytën e shpreh haptas. Kjo hapësirë estetike, mundësia që ta shohim veprën e tij në relacion me *parimet e romantizmit*, na shpie në përafrime me ato diskutime qysh se u shfaqën në letërsitë evropiane. Natyrisht që kjo kërkon një punë të gjatë e të vështirë krahasimtare, por le të na lejohet vetëm të përmendim disa argumente të kësaj natyre.

De Rada e botoi këtë vepër më 1861, në kohën kur *romantizmi* kish dhënë arritjet më të larta në letërsinë e disa vendeve (Foskolo vdiq 13 vjet pas lindjes së De Radës, Leopardi kur i kishte De Rada 23 vjet) ose për shumë kohë bashkëjetonte me realizmin dhe kish përfunduar kaherë në letërsitë e zhvilluara evropiane (Angli, Gjermani, Francë, Itali), të përmendim që në Francë është përafërsisht koha e *natyralizmit* (Zola disa vite ma vonë fillon botimin e serisë së njohur *Les Rougon-Macquart*), por edhe disa nga veprat e Balzakut p.sh. *Lëkura e shagrenit*, ose *Manastiri i Parmës* i Stendalit, mund të konsiderohen fare të afërta me romantizmin. Këto rrethana kohore i përmendi vetëm për të thënë që De Rada kish mundur të bënte zgjedhjen dhe vepra e tij na e dëshmon këtë: në harmoni me natyrën

dhe pikëpamjet romantike, që do t'i shtronte, kish zgjedhur *romantizmin*, e sigurt që këtë e kish bërë edhe për shkak të idesë kombëtare edhe për shkak të thirrjes së shpirtit romantik të tij..

Pjesa e katërt e veprës së De Radës ka një shtojcë në të cilën ka trajtuar afrinë e emrave të disa *perëndive greke* me fjalë të shqipes, të cilën ka synuar ta trajtojë në një kapitull të veçantë, duke dashur të dëshmojë kështu për lidhjet e hershme të kësaj gjuhe me kulturën e lashtë, ndoshta edhe paragreke (pellasgjike), diskutim të cilën do ta hap edhe kur flet për poezinë e lashtë popullore shqipe, në lidhje me të cilën ka hapur e diskutuar disa nga çështjet e rëndësishme siç është lashtësia e motiveve, karakteri metrik i vargjeve të *poezisë epike* me tetë masë (rrokje) dhe ai i lirikës njëmbëdhjetë masë; një tezë që ka zënë jo pak vend studimet e mëvonshme të kësaj krijimtarie e të metrikës së saj.

Çdo popull ashtu siç e ka të folurit e vet, që i shfaq disa pjesë të gjithësisë, ashtu e ka edhe këngën kombëtare, e cila del nga vetë jeta, duke qetësuar në përsosmëri me ndjenja të dhembshme apo të gëzuara. Kënga kombëtare, duke ndjekur të folurit e çdo populli, vazhdon të jetojë me të në kohë.,- thotë ai.[1]

Teza e De Radës mbi lidhjen e fjalëve të shqipes me emrat e perëndive të lashta greke, studimet e tij të gramatikës si dhe studimet e folklorit, na shpien, pos të tjerash, në fushën me interes të bindjeve kombëtare të De Radës dhe të pikëpamjeve mbi artin nacional. Filli i kombëtares e përshkon veprën e De Radës në mënyrë të organizuar, të vetëdijshme, në këtë çështje pajtohen të gjithë studiuesit e veprës së tij. Parimi i letërsisë kombëtare është një lloj programi i tij jetësor.

Parimet e estetikës e vendosin në themel të diskutimit gjithashtu *botëkuptimin e krishterë* të këtij autori mbi njeriun në përgjithësi, botëkuptim të cilin ai e ka shprehur edhe në *Autobiografi*, duke e vendosur atë si pjesë të botëkuptimit të familjes së tij dhe të atij vetë, madje duke treguar se ka kërkuar nga i ati që të niste jetën e misionarit të krishterë. Ky element autobiografik i tij si person dhe e vërtetë familjare prej disa brezash, në

[1] Parime të estetikës, *Vepra*, Vëllimi 7, f. 240, Prishtinë.

fakt koincidon frymën e krishterë që e përshkon dhe që mund të konsiderohet si njëri ndër parimet e romantizmit evropian në përgjithësi, e sidomos në letërsinë frënge dhe letërsinë gjermane. Në të parën le ta përkujtojmë Shatobrianin me *Gjeniu i krishterimit* (Le genie du Christianisme) dhe Madam de Staël, që insistonte se origjina e poezisë romantike duhet të kërkohet në *unisimin e poezisë kalorësiake me krishterimin*; kurse në letërsinë gjermane një varg autorësh duke filluar nga vëllezërit Shlegel e deri tek Hegeli i cili krishterimin e sheh si esencë të shpirtit dhe në këtë kuadër poezinë romantike si shprehje të një skepticizmi të vetëdijes së dëshpëruar nga tëhujsimi prej atij shpirtit[2]. Romantizmi, sipas këtij koncepti, shfaqet si shkalla e parë e krijimit të artit idealist si konstituens i shpirtit. Në Gjermani romantizmi do të shkëpusë kontaktet me *iluminizmin* dhe *racionalizmin* dhe do të jetë pranë *filozofisë idealiste* të Kantit dhe *subjektivizmit idealist* të Fihtes (Johann Gotlieb Fichte). Në kuptim poetik këtë lloj poezie Shlegeli do ta quajë *poezi transcendentale* Aty kemi një lloj poezie, esenca e të cilës qëndron në relacion midis ideales dhe reales, të cilën prandaj, sipas analogjisë me zhargonin filozofik, do ta quajmë *poezi transcendentale* (*Schriften*, 98). Skajin e botëkuptimit të tillë do ta artikulojë Shlejmaher (Friedrich Daniel Ernst Schleiermacher 1768 – 1834) teolog, filozof, studiues biblik, i cili unitetin esencial që mundëson çfarëdo relacioni midis *mendimit* dhe *qenies*, siç është *vullneti për të qenë*, e sheh të pranishme në *qenien religjioze*. Në këtë kuptim aktualitetin historik botëror e përcakton, sipas tij, ligji *absolut hyjnor sumum bonum*, dhe fuqia e realizimit të këtij ideali qëndron në *vetëdijen religjioze*.

Kjo është porta e hapur që e shpie letërsinë në teologjinë e drejtpërdrejtë, mirëpo të cilën letërsia gjermane, dhe letërsia romantike evropiane në përgjithësi, nuk e ka kaluar edhe kur ka artikuluar ide religjioze në nivele të ndryshme, siç ka bërë gjithë letërsia evropiane e romantizmit. Fatbardhësisht idetë e përafërta të shprehur në estetikën e De Radës, gjithashtu nuk e kanë nënshtruar në këtë shkallë artin poetik të tij në, sado që idetë e krishtera reflektojnë nëpër atë vepër.

Afërsisht kështu do të artikulohet edhe poeti ynë në traktatin e tij

[2] Paul H. Fry, *The Cambridge History of Literary Criticism*, v. V; *Romanticism*, f. 26.

Parime të estetikës duke diskutuar në shumë vende, qenien njerëzore dhe mënyrën e paraqitjes së tij në artin letrar: një individ kompleks për nga natyra e tij, ku bashkëjetojnë dhe koordinohen ana fizike, shpirtërore dhe racionale dhe duke vepruar si individ në kuadër të univerzalitetit njerëzor. Natyrisht që në teorinë e De Radës arti në përgjithësi, dhe poezia gjithashtu, i referohen *shpirtit*, i cili komunikon me botën reale përmes shqisave. Ndërkaq, bukuria e plotë e shpirtit realizohet tek personat ku dobësitë dhe cilësitë janë në harmoni dhe të patepruara brenda një jete superiore, thotë ai në fragmentin Bukuria e plotë e shpirtit[3]. Madhështia e shpirtit të qëndrueshëm shfaqet në veprat e kohës, që ndikojnë në botën e jashtme duke qenë krijime artistike. Ato pasqyrojnë gjendjen e shpirtrave të mëdhenj (Kapitulli III i Librit II,) është fragmenti që na e kujton diskutimin me principin e *gjeniut romantik*, të diskutuar në të gjithë letërsinë evropiane prej atëherë e deri në ditët tona. Në këtë kuptim edukimi estetik është i domosdoshëm për ta kuptuar artin romantik dhe në kuptim zyrtar është shteti që duhet të përkujdeset për këtë. Në këtë përkujdesje ai ka veçuar funksionin e *shkollës së krishterë* si institucion kishtar dhe shtetëror pasi që ai këto të dyja i kërkon të njësuara.

E treta çështje që shtrohet këtu është parimi i *fragmentarizmit*, si parim i poetikës së romantizmit. Kjo mënyrë e paraqitjes së artit kërkon qasjen e re të edhe të lexuesit ndaj veprës. Vepra me strukturë fragmentare i mundëson lexuesit të participojë aktivisht në estetikën e re, për shkak se kjo formë krijuese paraqet më së mirë natyrën fragmentare të ekzistencës.. Veprat si *Lyceum* dhe *Fragmente* të Shlegelit janë vepra që hapin rrugë në këtë lloj paraqitjeje. Në fakt, fragmentet e tilla përmbajnë aspektin e sistematikës dhe të josistematikës, sepse për mendimin romantik të kesh sistem në vepër dhe të mos kesh sistem është njësoj vdekjeprurës për mendjen. Lexuesit i mbetet të ndërtojë një sistem për veten e tij nga ai pasistem: kjo është njëra nga paradigmat e romantizmit në përgjithësi. Krijimi i poezisë romantike që në vete përmban dualizmin kuptimor dhe fragmentaritetin e kontinuitetit të saj ka bërë që Shlegeli ta quaj këtë *poezi transcendentale* dhe për ta kuptuar atë lexuesi duhet të ketë një formim

[3] *Parimet e estetik*ës...Vepra, Rilindja, Prishtinë, 1983, f. 230.

intelektual me orientim estetik. Për këtë arsye kërkohet që në sistemin e edukimit të insistohet në formimin e njeriut i cili do të jetë në gjendje ta kuptojë artin e tillë, tekstin dhe kontekstin, gjë që presupozon një *hermeneutikë letrare*. De Rada, në fakt, në *Parimet e estetikës*, insiston pak a shumë pikërisht në kërkesat e këtilla, sidomos në pjesët që kanë të bëjnë me institucionin e shkollës, përfshi edhe atë të *shkollës së krishterë*. Jashtë koncepteve të këtilla do të ishte e pakuptueshme përse ka inkuadruar në një vepër të kësaj natyre disa pjesë që duken të largëta me estetikën në përgjithësi.

Çështja e parimit të *fragmentaritetit* edhe ka qenë çështja e vështirë në interpretimet e veprës së tij poetike. Shumicën e herëve konstatimi se shumica e veprave të tij janë vepra me një strukturë të dallueshme fragmentare, është interpretuar si shenjë dobësie, apo mangësi artistike në ndërtim të veprimit themelor të veprës. Ani pse De Rada jo njëherë ka folur për këtë parim letrar: në *Parathënie* (1873) të veprës *Skenderbeu i pafanë* ka sqaruar se Brendia dhe trajta e veprës u krijuan më vonë, në kushte të shpirtit dhe të kohës. As nuk kanë si epopeja e vjetër, një fabul simbolike e cila përmban një mendim kryesor.. (....) por përmban fenomene dhe veprime, të cilat duke u lartësuar, kanë rrëmbyer, nga çdo anë, zemrën time, qëndrojnë si trupore të njëtrajtshme ndër galeri të njëpasnjëshme, të rreshtuara për të përfytyruar ndonjë pamje të botës. *(...)* Duket e pabesueshme se sa shumë nocione themelore të romantizmit janë përdorur dhe janë ngritur në parime në këtë paragraf prej disa rreshtash dhe që shpjegojnë për këdo në *kontekst të romantizmit* veprën e tillë letrare. Përsosmëria në kuadër të atij parimi do ta konsiderohej vlerë e jo metë. Por le të shpresojmë, siç ka shpresuar edhe ai vetë, në leximin e ri të veprës së tij, një kohë kur ai lexues do të ketë përgatitjen e duhur estetike bashkë me gjerësinë për ta zënë idealin e artit klasik (adhurues i padiskutueshëm i të cilit ka qenë De Rada) që mbështetet në parimin e qartësisë dhe maturisë, dritës dhe harmonisë si dhe artin romantik që del prej pendës së gjeniut të natyrshëm, ku pamja del me dy fytyra: me të ndritshmen dhe të errëtën njëkohësisht. Poezia e De Radës është një përzierje e poezisë klasike me poezinë romantike, prandaj lexohet edhe sot, përtej romantizmit dhe vazhdon ta shfaq anën e saj të ndritshme me imazhet e shkëlqyeshme të

heronjve romantik, heronjve nacional dhe me anën e errtë të tyre, ku vetëm fantazia dhe kërkimi shpirtëror i lexuesit mund të depërtojë.

Përfundim

Pa dashur të ndalem në të gjitha çështjet e shqyrtuara në Parimet e estetikës e që mund të quhen edhe *parime të artit romantik*, e që në pjesë të caktuara dalin edhe si diskutime të rëndësishme filozofike e ndonjëherë edhe shoqërore, pa dashur të merrem me atë që lehtësisht mund të pajtohet me shkrimet e Aristotelit në poetikë, dhe pjesërisht me poetikën e klasicizmit, mund të konstatohet që vepra e De Radës sjell për herë të parë në literaturën shqipe një mori konceptesh estetike e teorike dhe hap një fushë studimesh që ka mundur të zhvillohej, por që për fat të keq, kanë mbetur të panjohur deri tash vonë, edhe për arsye gjuhësore. Vepra e tij, e para në studimet estetike në përgjithësi, ka mbetur një ishull dhe trajtimet e sotme, vetëm sa përpiqen t'i njohin një vend historik, në ndërkohë që interesimet estetike – letrare shqipe sot kanë synime të tjera dhe situohen kohësisht tek letërsia moderne shqipe.

Ardian MARASHI, Tiranë

VENDI I MILOSAOS NË ROMANTIZMIN EVROPIAN

KDU 821.18'282.4(450).09

Po e hapim këtë komunikim me një hipotezë, me të cilën shumica e kolegëve këtu të pranishëm nuk duket se kanë kundërshtim. Të mbledhur në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës për të shënuar 200-vjetorin e lindjes së De Radës, ashtu si para një jave në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, studiuesit shprehin përgjithësisht shqetësimin se De Rada ende është i pastudiuar *sa duhet* dhe *si duhet.*

I nxitur nga rizbulimi i origjinalitetit të tekstit deradian në formën e tij të drejtpërdrejtë arbërishte, veçanërisht përmes projekteve Besa dhe Opera omnia të realizuara në vitet e fundit nga kolegu Francesco Altimari, hipotezën po e formulojmë në këtë mënyrë:

> *De Rada është autori shqiptar pionier, të cilin e kemi keqkuptuar qysh në krye, dhe kështu të keqkuptuar ua kemi përcjellë brezave, duke e dashur, duke e studiuar dhe duke e nderuar më tepër për traditë e për rutinë, sesa për meritat e plota të një vepre letrare origjinale e të pazakontë, që mbeten për t'u zbuluar.*

Rutina, pastaj, e kemi parë se bën të vetën. E kthen atë që duhej të ishte një dukuri pioniere që hap udhë, në një gjësend të rëndomtë, që mund të jetë gjithçka, përpos ftesë për udhëtim poetik.

Imazhi i plakut thatim e të vetmuar, aq gjynahqar sa paska vdekur me një cironkë të thatë në xhep, ka zënë deri më sot kryet e vendit në imagjinatën e brezave të shkollarëve shqiptarë, madje është fiksuar deri edhe në logon e 200-vjetorit, të përzgjedhur nga Ministria e Kulturës e Shqipërisë. Vërtet që te logoja mungon cironka, po portreti mbetet aq i përvuajtur, sa nuk është e vështirë ta imagjinosh bishtin e cironkës duke shpuar pllakatin. Ky keqkuptim, i kthyer tashmë në një scoop edukativ të arsimit

shqiptar, është ngulitur në mendjet e virgjëra të shkollarëve me aq forcë, sa thuajse e ka paralizuar tek ata kureshtjen për të shkuar përtej vargut slogan Erdhi ditë e Arbërit!

Rezultati i këtij gjymtimi letrar është ai që u përmend në krye: De Rada admirohet si portret i përvuajtur stërgjyshi fisnik, si nismëtar i Rilindjes Kombëtare në rang lokal për Arbëreshët, dhe është harruar se ai është Poeti, se me të fillon e vazhdon letërsia shqipe moderne, se ai ende nuk është tejkaluar si fenomen!

Ndërsa pohojmë se De Rada është autor pionier, kemi parasysh se për letërsinë shqipe ai është i tillë në po atë masë sa Buzuku, veçse me hapje e diapazon shumë më të gjerë. Themelvënës i letërsisë dhe i kulturës së re arbëreshe, me veprën e vet të gjithanshme si poet, folklorist, etnolog, publicist, studiues e mësues, De Rada e përtëriu traditën e letërsisë më të hershme shqipe në të gjithë përbërësit, duke e modernizuar dhe duke e ngritur këtë letërsi nga faza parakombëtare në fazën e re kombëtare, si dhe duke e rilidhur me trungun e letërsisë europiane. Mes të gjithë krijuesve të tjerë, De Rada u dallua për një konceptim krejtësisht modern të dukurisë letrare. Nuk është, pra, e rastit që tradita e krijuar prej tij shërben ende sot si frymëzim e referencë për autorët arbëreshë dhe ata shqiptarë.

Në këtë komunikim do të ndalemi tek dukuria Milosao, e cila mendojmë se ngërthen përmasën më të plotë europiane të veprës së De Radës.

Për të përcaktuar vendin e Milosaos në romantizmin europian, do të shqyrtojmë tre argumente: së pari, *si shfaqet ndikimi romantik europian tek De Rada dhe vepra e tij;* së dyti, *si paraqitet përfaqësimi letrar gjinor i Milosaos,* dhe së treti, *si shprehet moderniteti poetik i Milosaos?*

Ndikimi romantik europian tek De Rada dhe vepra e tij

Literatura studimore deradiane citon një letër që një kritik francez i shkruante De Radës në maj të vitit 1948, nga e cila mësohet se ky kishte dëgjuar lëvdata për De Radën prej gojës së tre autorëve më të shquar të romantizmit francez, Viktor Hygo, Alfons de Lamartin dhe Aleksandër Dyma. Hygoi, duke çmuar aspektin modern të shkrimit të De Radës, qe

shprehur: Kush dëshiron të shohë përmbushjen e poezisë romantike moderne, le të lexojë *Këngët e Milosaos* të zotit Jeronim De Rada.[1] Tashmë është konfirmuar se vetë De Rada pati letërkëmbim të gjerë me personalitete të kulturës italiane e europiane, po aq sa edhe me figurat kryesore të Rilindjes shqiptare, disa prej të cilëve po i përmendim pa rend: Frederik de Mistral, Alfons de Lamartin, Gustav Majer, Dora D'Istria (Elena Gjika), Gavril Dara i Riu, Zef Serembe, Anton Santori, Dhimitër Kamarda, Sami Frashëri, Zef Jubani, Thimi Mitko, Spiro Dine, Mithat Frashëri, Faik Konica, Preng Doçi, Luigj Gurakuqi, etj.

Po çfarë i lidh tjetër De Radën dhe veprën e tij me romantizmin europian përgjithësisht?

De Rada qe i pari shkrimtar i kohës së re i cili, në përputhje me frymën që po krijonte romantizmi europian, i këndoi lavdisë së moçme shqiptare, duke ngritur në kult figurën e Skenderbeut dhe qëndresën ndaj pushtuesit osman. Ai u bë kështu rilindësi i parë që solli në letërsinë romantike shqipe motin e madh, epokën e lavdishme para pushtimit turk, si pasqyrë të modelit të lirisë, bashkimit e vëllazërisë për bashkëkombasit që vuanin nën zgjedhën e pushtuesit, e njëkohësisht si shembull atdhedashurie e qëndrese, një shembull kuptimplotë, që zgjonte tek mbarë shqiptarët dinjitetin e humbur kombëtar.

De Rada dha në këtë mënyrë kontributin e vet të çmueshëm për krijimin e miteve kombëtariste (Skenderbeu, qëndresa antiosmane, vjetërsia e kombit shqiptar, lashtësia e gjuhës shqipe, identiteti dhe uniteti kombëtar), që u përvijuan dhe u pasuruan më tutje nga përfaqësuesit e tjerë të Rilindjes shqiptare. Njëkohësisht, me veprën Rapsodi e një poeme arbëreshe (1866) De Rada, ashtu si shumë nga romantikët e mëdhenj europianë, solli në vëmendje krijimin e pasur popullor dhe i hapi rrugë traditës së frymëzimit nga gurra e gjallë e popullit. Së fundi, me të përkohshmet L'Albanese d'Italia (1848) dhe Fjamuri i Arbërit (1883), De Rada themeloi shtypin shqiptar, kurse me përkushtimin e tij të mirënjohur për shkollën

[1] Për këtë çështje kritika deradiane ka shkruar qysh herët, diku me sigurinë e konfirmimit e diku me pasigurinë e hipotezës, duke nisur nga Dorsa, duke vazhduar me Gualtieri-n e Markiano-n, e duke përfunduar me D.Kokonozin e M.Zeqon.

dhe arsimin, ai holli themelin më të qëndrueshëm mbi të cilin do të mund të ngrihej e të mbrothësohej kultura kombëtare. Në këtë linjë, nuk duhet harruar gjithashtu fakti se me modelin e poetit romantik europian përputhet edhe një ndër periudhat më aktive të jetës së De Radës, periudha e Napolit dhe e angazhimit të tij të drejtpërdrejtë në lëvizjen revolucionare të kohës. Autori romantik europian duhej të ishte në simbiozë jo vetëm me idealin liridashës dhe me heronjtë realë të epokës – Garibaldi në rastin e De Radës, – por patjetër edhe me heronjtë e penës e të frymëzimit të vet, – në rastin e De Radës, Milosao.

Në këtë mënyrë, mund të thuhet se gjesti europian i De Radës është se ai nuk krijoi thjesht një vepër letrare, por, ashtu si prijësit e mëdhenj të romantizmit europian, ai arriti të krijojë në gjirin e kulturës kombëtare një frymë të re, ta zgjonte ndërgjegjen e bashkëkombësve dhe të sillte një frymëzim rrënjësor në jetën arbëreshe dhe atë shqiptare përgjithësisht, paçka se në sintoni kohore asimetrike, për vetë rrethanat që kalonte Shqipëria osmane e kohës.

Përfaqësimi letrar gjinor i Milosaos

Për tipologjinë gjinore të Milosaos (1836) është folur; shkollarëve u mbetet vetëm të numërojnë karakteristikat e jashtme e të brendshme të poemës liriko-epike, duke e përforcuar këtë argument edhe me të dhëna nga Serafina Topia (1840) dhe nga Skenderbeu i pafaanë (1843). Pas kësaj, mbetet të argumentohet se me këtë cikël poemash De Rada u afirmua si një nga romantikët më të ndritur jo vetëm në letërsinë shqipe, por edhe në atë europiane.

Një linjë e këtij argumentimi është edhe përfaqësimi letrar gjinor i poemës Milosao në kontekstin e poetikës romantike. Shprehim bindjen se, në kontekstin e lëvizjes romantike europiane, poema Milosao lidhet drejtpërdrejt me dukurinë e cila kohë më pas u emërtua me termin bajronizëm. Vetë ky term, siç e dimë, lidhet me emrin e poetit anglez Xhorxh Bajron, i cili ushtroi një ndikim të fuqishëm dhe të gjatë në lëvizjen e romantizmit europian. Ky ndikim i dedikohet jo vetëm veprës së larmish-

me e voluminoze të Bajronit, po edhe personalitetit të tij krejtësisht të veçantë: aristokrat anglez me shpirt revolucionari, lord kryelartë e rebel, djalosh energjik dhe zemërtrazuar, dashnor i paqëndrueshëm por mik besnik, e mbi të gjitha poet i pashoq i hoveve epike, lirike e satirike, Bajroni nisi mjaft shpejt të imitohej dhe të merrej si model nga tërë brezi i poetëve të rinj anembanë Europës.

Fama e Bajronit i kaloi kufinjtë e Aglisë qysh më 1812, me botimin e dy këngëve të para të poemës Çajld Harold. Bajroni u shqua veçanërisht në llojin e poemës tregimtare, lloj i njohur edhe si roman në vargje. Një seri poemash të tilla, ku bëjnë pjesë Kaurri (1813), Nusja e Abidosit (1813), Lara (1814), Korsari (1814), Rrethimi i Korintit (1816), Parizina (1816), ai i grupoi në ciklin e titulluar Poemat e Lindjes, meqenëse ngjarjet, heronjtë, peizazhet, huazohen nga vendet e Lindjes europiane, e kryesisht nga Ballkani juglindor. Poema të tjera, si I burgosuri i Shilonit (1816), Mazeppa (1819), e në fund poema e pambaruar Don Zhuani, i siguruan Bajronit lavdinë.

Dalja në librari e dy këngëve të para të poemës Pelegrinazhet / Shtegëtimet e Çajld Haroldit më 1812 përuroi, në kontekstin e luftërave napoleoniane dhe të shembjes së monarkive, fillimin e një ere të re letrare, që do ta përtërinte letërsinë europiane si në përmbajtje, ashtu edhe në formë. Me Çajld Haroldin Bajroni dha një shembull të përkryer të poemës liriko-epike, ku bashkohen forca e mendimit iluminist me patosin e pasionin romantik. Menjëherë pas luftrave napoleoniane, veprat e Bajronit filluan të përkthehesin në shumë vende të Europës dhe Bajroni u njoh njëzëri si prijës i romantizmit europian.

Poema Çajld Harold dhe cikli i Poemave të Lindjes krijuan në letërsinë romantike një tip heroi karakteristik, vetmitar e melankolik, kryelartë e rebel, i zvjerdhur nga shoqëria dhe mjedisi i vet, disi i mistershëm, por gjithmonë pasionant dhe i prirur ta shfaqë lartësinë shpirtërore në veprime sublime. Me vdekjen e tij, më 1824, në krah të suliotëve që luftonin për pavarësinë e Greqisë nga otomanët, Bajroni u bë edhe vetë një hero i tillë, duke ngjallur admirimin e bashkëkohësve të etur për bëma të larta dhe për heronj të pazakontë. Sipas shembullit të Çajld Haroldit, të heronjve të tjerë bajronianë dhe të vetë Bajronit, në letërsinë romantike

europiane u krijuan poema që sillnin në skenë heronj me karakteristika të ngjashme, të quajtur Eugjen Onjegin (1833) tek poeti rus Aleksandër Pushkin, Konrad Valenrod (1828) tek poeti polak Adam Mickieviç, apo Milosao (1936) tek romantiku ynë De Rada. Të gjithë këta heronj dallohen për shpirtin shumë të ndjeshëm, por heroik e të paepur. Inteligjenca e lartë dhe vetitë shpirtërore i veçojnë nga të tjerët, duke i bërë të mbyllen në një vetmi krenare.

Nga ndikimi i dyfishtë i jetës së vetë Bajronit dhe i heronjve të tij, krijohet kështu një frymë romantike e veçantë, që u quajt bajronizëm. Bajronizmi gjeti terren të përshtatshëm për t'u përhapur në mënyrë të rrufeshme, qoftë nëpërmjet përkthimeve të shumta e të menjëhershme të veprave të Bajronit në gjuhët kryesore të kontinentit, qoftë nëpërmjet admirimit që patën për Bajronin mjeshtrit e mëdhenj të romantizmit europian: Gëte, Hajne, Lermontov, Leopardi, Hygo, Myse, e qoftë nga interesi që ngjalli vepra e tij ndër piktorët e mëdhenj romantikë, si Eugjen Delakrua, Ari Shefer, Eduard Lir, Leon Zherom, të cilët u frymëzuan për tablotë e tyre me motive nga Lindja.

Për t'u kthyer te De Rada, rikujtojmë se ai e botoi Milosaon kur ishte vetëm 22 vjeç, që mund ta quajmë një moshë bajroniane, ku ideali i jetës dhe vrulli rinor ushqejnë dhe forcojnë njëri-tjetrin. I gjithë vrulli rinor i De Radës, i gjithë frymëzimi i tij romantik, të gjitha ëndrrat, zhgënjimet, melankolitë dhe idealet e tij djaloshare janë jetësuar në këtë poemë. Gjejmë tek Milosao idealin e poetit për jetën familjare, për lirinë e barazinë shoqërore, për moralin qytetar e ndjenjën atdhetare, për lumturinë dhe detyrën. Gjejmë soditjen e natyrës, meditimet për jetën, kuptimin e shpirtërores dhe besimin te njeriu. Nga këngët e Milosaos buron një urtësi melankolike, përmes së cilës zbulohet kuptimi i jetës, që për De Radën qëndron te ndërtimi i mardhënieve harmonike mes ndjenjës dhe detyrës, individuales e kolektives, njeriut dhe shoqërisë.

Si natyrë heroi lirik, Milosaoja i De Radës ka sivëllezër heronjtë e poemave të Bajronit: njëlloj si këta, Milosaoja ka botë shpirtërore të pasur dhe një temperament melankolik, çka e veçon prej ambientit rrethues, me të cilin ndihet në konflikt. Dhe, ashtu si heronjtë e Bajronit, Milosaoja

arrin ta tejkalojë vetminë e vet, të dalë nga qarku i mbyllur i saj, duke u bërë protagonist i ngjarjeve të mëdha shoqërore.

E parë në ndërlidhje të drejtpërdrejtë me dukurinë e bajronizmit nga njëra anë, kurse nga ana tjetër me ciklin bajronian Poemat e Lindjes, si dhe me një seri veprash poetike të romantizmit europian, poema Milosao e De Radës pasurohet me ndërtekstin e domosdoshëm të poezisë europiane të kohës, çka na lejon të kuptojmë në mënyrë më të sigurt se cila është rëndësia e Milosaos dhe cili duhet të jetë vendi i kësaj poeme jo thjesht në letërsinë romantike europiane, por në letërsinë europiane përgjithësisht. Një dritësim të parë për këtë çështje po përpiqemi të sjellim në argumentin në vijim.

Moderniteti poetik i Milosaos

Kujtojmë se Milosao ka gjithsej 30 këngë, të cilat janë të lidhura mes tyre prej figurës së protagonistit, por njëkohësisht funksionojnë edhe si poezi më vete, të vetëmjaftueshme, përtej kuadrit të përgjithshëm të subjektit. Në plan të parë të poemës, siç e sugjeron vetë titulli, vendoset Milosaoja, hero lirik i cili i paraqitet lexuesit jo aq përmes veprimit, sa përmes ndjenjave, përjetimeve, emocioneve dhe meditimeve të veta. Mbasi e kemi kuptuar këtë, kuptojmë edhe mekanizmin kryesor të teknikës poetike të De Radës: tek Milosao rrëfimi është vetëm një pretekst për të na e paraqitur heroin në situata përjetimesh të shumëllojshme; subjekti është vetëm një shkak për të na dhënë gjendjet e ndryshme emocionale të heroit; ngjarja është vetëm një pikënisje që shërben për të zbërthyer personalitetin lirik të Milosaos. De Rada nuk rrëfen në mënyrë kronologjike ndodhi të caktuara të jetës së Milosaos, ai nuk jep detaje jetësore të heroit të vet, këto ne i kuptojmë në radhë të parë nga përjetimet e Milosaos dhe nga ndikimi që kanë tek ai ngjarjet e ndryshme dhe rrethanat nëpër të cilat ai kalon. Pra, jemi në një rast atipik për poezinë e asaj kohe, kur veprimi i poemës nuk ecën përmes ngjarjes, meqenëse përjetimi lirik përjetohet këtu si ngjarje e cila e zhvillon subjektin.

Kjo zgjidhje kompozicionale ka bërë që kritika shqiptare ta

konsiderojë Milosaon një *'poemë fragmentare'*, në kuptimin që poema paraqet dobësi në lidhjen e kompozicionit. Në të vërtetë, mund të pohohet se pikërisht në këtë pikë, në shmangien e kompozicionit klasik, i cili rrudhet për t'i lëshuar vend unit lirik dhe shprehjes lirike, qëndron një pjesë e mirë e origjinalitetit dhe e modernitetit të poemës së De Radës.

Por poema Milosao ka gjithashtu të tjera zgjidhje origjinale, siç është mungesa e rimës dhe përdorimi i asonancave në tetërrokësha të bardhë ndërthurur me gjashtërrokësha. Edhe kjo konsiderohet si një prurje poetike origjinale në një moment kur poezia pa rimë ende nuk konceptohet si një poezi me të ardhme.

Në vijim, gjallëria e figuracionit, pasuria e detajeve dhe e nuancave, shoqëruar me një lakonizëm karakteristik të shprehjes gjuhësore, e rrisin forcën shprehëse të lirizmit, duke i dhënë poezisë tone mjaft moderne. Për nga modeniteti i shprehjes dhe i teknikave poetike, Milosaoja në letërsinë shqipe mund të krahasohet me krijimet më të mira të Martin Camajt, kurse në letërsinë botërore është i krahasueshëm me poezinë simboliste të fundshekullit XIX e fillimit të shekullit XX, si dhe me krijimtarinë e poetëve hermetikë italianë të messhekullit XX. Në këtë mënyrë, mund të pohojmë me siguri se De Rada u paraprin zhvillimeve moderne në poezinë europiane me të paktën gjysmë shekulli. Ndërkaq, Milosao i tij i paraprin me një shekull poezisë moderne italiane të Ungaretit, Kuazimodos e Montales, dhe po kaq në pararojë është ai në raport me poezinë simboliste shqipe të Poradecit. Mjafton që tekstit të Milosaos t'i qasemi nga pikëvështrimi i poezisë simboliste, për të kuptuar atypëraty se kjo është qasja më e arsyeshme kritike që mund t'i bëhet kësaj poeme.

Milosao nuk lexohet dot fjalë pas fjale e varg pas vargu: ai duhet lexuar me sytë e mendjes, ose, le të shprehemi më qartë: ai duhet lexuar pikturalisht – imazh pas imazhi dhe në vijimësinë e ndërlidhjeve korrësponduese që krijojnë zinxhirët e imazheve. Nëse arrijmë t'i zbërthejmë bindshëm korrespondencat simbolike mes elementeve të ndryshme të poezisë deradiane, jo vetëm ato që lidhen me imazhin, po edhe ato që lidhen me funksionet vokale të poezisë, atëherë cilësimi i dhënë për Milosaon si poemë fragmentare duhet ripërcaktuar urgjentisht, duke e

konsideruar fragmentarizmin deradian si mjet poetik dhe si efekt të kërkuar me vetëdije nga autori estet i Parimeve të Estetikës.

De Rada i ka kushtuar vëmendje të pandërprerë Milosaos, duke e punuar, ripunuar e ribotuar disa herë këtë poemë. Madje, në vitet e fundit të jetës, ai e kishte rimarrë në dorë Milosaon, ku parashikonte të bënte ndërhyrje, shtesa e ndreqje të mëtejshme. E gjitha kjo nuk mund të shihet thjesht si një dobësi e një autori për krijimin e vet të parë, por si një rikthim i vazhdueshëm për tek përsosmëria i poetit të vetëdijshëm për rolin e vet pionier.

Fatmir SULEJMANI, Tetovë

JERONIM DE RADA - THYES KONVENCASH ROMANTIKE

KDU 821.18'282.4(450)-1.09

Rrëfime të Arbrit bën pjesë ndër poemat më pak të njohura të Jeronim de Radës - krijuesit me autoritetin më të madh ndërkombëtar në mesin e rilindësve tanë. Studiues të ndryshëm, ngjashëm si poemat tjera të Tij, e quajtën atë: *rapsodi, novelë lirike…*

Ngjarjet e poemës zhvillohen në gjysmën e dytë të sh. XV dhe fillimin e sh. XVI, por, përmes aludimesh të qarta, lavdia e së shkuarës lidhet fuqishëm me Shqipërinë e fundit të sh. XIX, me gjendjen e pashpresë të saj, të cilën poeti përpiqet ta meremetojë. Për rrjedhojë, nën një kulm kompozicional në vepër bashkejetojnë rrëfimi epik me atë lirik e dramatik, elementet e jetës reale me ato fantastike, të huazuara nga balada e këngë të lashta arbëreshe.

Poemën e karakterizon fryma folklorike, atdhetarizmi i palëkundur, narracioni me masë dhe vargu sugjestiv. De Rada i stis mendimet dhe ndalet në detajet më përfaqësuese të një ngjarjeje a fenomeni, duke ia lejuar lexuesit kënaqësinë e të qenit bashkautor i veprës. Parë nga ky prizëm, vepra e Tij kërkon lexues të kultivuar që di të vazhdojë rrëfimin e kursyer, të plotësojë hapësirat boshe kompozicionale, të lexojë shtresat e nëntëshme kuptimore, të zbërthejë drejt metaforat e krijuesit të madh.

Pikërisht këtë u përpoqa ta bëj dhe unë, i shtyrë nga dëshira për të mos e përsëritur atë që është thënë e shkruar për poemat e De Radës, duke u ndalur në motive të pavërejtura nga studiuesit që janë preokupuar me to. Është fjala për rezultatet e një leximi ndryshe të këngës së tretë të poemës *Rrefimet e Arbrit*, me titullin *Dina Zënëbisha*, në të cilën kam gjetur dy histori dashurishë të pazakonta, jo vetëm për kohën e De Radës. Janë këto dy dashuritë e Dinës së re, që bien ndesh me moralin e idealizuar

kombëtar dhe me konvencat e romantizmit. Të dy dashuritë janë të dënueshme për krenarinë e pathyeshme arbëreshe, të theksuar kudo në poemat e De Radës, i cili, me këtë këngë, sado e pabesueshme që duket, theu tabu-të e drejtimit letrar të cilin e inauguroi vetë.

Në vijim, do të përpiqem të argumentoj dy dashuritë e Dinës: të parën me një djalosh turk, kurse të dytën me një vashë arbëreshe.

Ja përmbajtja e stisur e këngës:

Dina, e bija e Vlladan Zënëbishës – prijësit të Delvinës së posapushtuar nga ushtria osmane, takon në rrugë të birin e pashait, i cili, i magjepsur nga bukuria e vashës, rëxohet nga kali. Në këtë moment, asaj i shpëton një klithmë dhembshurie që i jep shkas të riut ta dërgojë të ëmën t'ia lypë për nuse. E gjendur mes ndjesishë të paprovuara më parë dhe obligimeve ndaj atdheut e ndaj kujtesës së babait të rënë martir për lirinë e Arbrit, ajo e rrefuzon ofertën e fejesës, përkundër të gjitha lirive të premtuara në rast pajtimi. Për pasojë turqit ia konfiskojnë pasurinë dhe e burgosin në një manastir burg, ku do të takohet me Nushën - vashën po aq të bukur, me të cilën do të hyjë në një lidhje të re dashurie të pamundur, që do të bëhet shkas i vuajtjeve torturonjëse shpirtërore dhe i vdekjes së saj të parakohshme.

*

Këngën në fjalë, ndryshe prej tri këngëve të tjera të poemës, poeti e nis me vargje që paralajmërojnë ditë të bardha për arbëreshët dhe Dinën kryeprotagoniste:

Një puhi e lehtë, e ngohtë/ gjithë qiellin mugëlloi/ të dielën e luleve.

Çuditërisht, të dielën e luleve (a thua vetëm për rastësi?!) po kaq diellor është dhe disponimi i Dinës:

…na u gdhi e ngazëlluar. (…) Në vetvete thellë ndiente/ se diçka të madhe priste.

Por, krahas ndjenjës së gëzimit, Dina nisi të ndiejë edhe njëfarë kobi, sepse njeriu, thotë poeti:

…sa më lart ngre shtëpinë/ aq më shpejt ia shemb lëkundja./ Kështu

vashës më të bukur/ aq më shpejt na i vjen e keqja.

Gjer këtu De Rada parapërgatit lexuesin me atë që do të ndodhë më vonë, kur shfaqet në skenë djali i pashait turk. Ai sikur ka njefarë admirimi për të, ndaj e paraqet me vargje të denja vetëm për një trim arbëresh:

…përmbi kalin trokëllimëgjatë,/ si në ninull i përkundur,/ përmbi kalin fluturor…

Dina është aty për t'i dhënë shkas asaj që do t'ia ndryshojë rrënjësisht jetën:

…e vasha e urtë/ me një vështrim pa të keq/ dhe plot hir e mirësi,/ ia rëmben zemrën dhe kali/ sa ndien veten si pa fre/ rend më shpejt dhe djali i pashës/ krejt i mahnitur pas vashës,/ befas bie shakull përdhe.

Në këtë moment ajo klith pavetëdijshëm. Është ky çasti kur vasha arbëreshe ndjen diçka të papërjetuar më parë:

Dhe, padashur, vasha klithi/ por mbledh veten dhe e penduar/ shpejt hyn brenda duke thënë: Mbase nuk e vuri re!/ S'di si m'iku vetvetiu!

Dëshminë e tronditjes së saj e gjejmë edhe në tre vargjet pasuese:

Po dhe brenda ajo fytyrë/ nuk i largohej nga mendtë/ dhe iu drithërua kurmi!

E qartë: Dina e pëlqeu në shikim të parë të riun turk, por, e shtyrë nga detyra e ruajtjes së dinjitetit njerëzor dhe arbëror, përpiqet ta mund tundimin dhe ta harrojë atë sa më parë. Ndjenja e dashurisë mposhtet nga ndjenja për atdheun dhe ajo e rrefuzon ofertën për martesë nga i huaji. Mbështetur në teoritë aristoteliane, ndrydhja kategorike e ndjenjave vullkan nga ana e një gjashtëmbëdhjetëvjeçareje tingëllon e pagjasshme, por, De Rada, i njohur me projektimet e ideve personale te heronjtë e tij dhe i shtyrë nga vijat identitare të letërsisë që përfaqësonte, e bën atë me tipare burrnore…

Ky rrefuzim i Dinës përfaqëson njërin prej çelësave të sqarimit të asaj që do të ndodhë në manastirin burg, ku ajo do ta bëjë herezinë e dytë duke u dashuruar në një vajzë.

*

E mbyllur në manastir, vasha ka pasur kohë të reflektojë për të shkuarën. Sa ishte e lirë, shpirti i saj i njomë nuk qe lodhur:

…as kur çonin me vajtime/ arkivole me të vdekur./ as kur me këngë e me valle/ vasha nuse po përcillnin, por: *…tani brenda këtij burgu./ një mejtim i vagëlluar,/ prej trurit të sajë i çohej,/ dhe i tretej hapësirës/ e të shkretë ia linte shpirtin.*

Pra: është vonë dhe Dinës i kishin mbetur vetëm *mejtimet e vagëlluara* të së shkuarës dhe mundësia e kompensimit të humbjeve të pakthyeshme në shtjellat e një kohe, që për kryeZot kishte krenarinë kolektive.

Në zgafellën prej ferri plot me gra-murga, Dina takon Nushën - vashën *buzëmjaltë e flokgështenjë* nga Cërriku, që mund: *të zilipste* e ta bënte për vete çdo *trim.*

Të dyja janë të bukura dhe në moshën e dashurisë, por, në mungesë rastesh normale për të dashuruar dhe për të qenë të dashuruara, orientohen drejt njëra-tjetrës, jo si shoqe, po si diçka më shumë.

Fillimisht, ato hezitojnë të afrohen, kanë drojë të çuditshme dhe, mbi të gjitha, e ruajnë kryelartësinë, shprehet De Rada. Por, ç'kryelartësi mund të cënohet nga takimi i rëndomtë i dy të burgosurave brenda mureve të një manastiri?!

Siç duket, ka diçka mëkatare ndërmjet tyre, sepse:

…kur njëra hynte brenda/ edhe tjetra mbyllte perden,/ sikur më nuk donte asgjë.

Autori e dekonspiron vetë vuajtjen e heshtur të vashave për shkak të komunikimit të munguar ndërmjet tyre:

Miqësi, flakë e pashuar,/ ashtu si edhe drita e ditës/ ti m'i jep hir vetë jetës/ dhe nga guri më nxjerr ujë!

Të dhënat që kumtojnë vargjet e posalexuara më duken të mjaftueshme për ta kuptuar se këtu vërtet bëhet fjalë për lindjen e dashurisë ndërmjet Dinës dhe Nushës, pa çka se ajo është e panatyrshme dhe bie ndesh me konvencat arbëreshe, të rrepta jo vetëm për kohën e autorit.

Vargjet në vijim eliminojnë akoma më mirë skene përrallën e treguar nga shumëkushi për miqësinë e tyre:

…dhe si shpuza ndënë hi,/ miqësia i digjte vashat./ …/ …kur retë ikën e ato dolën/ pas mesditës edhe pane/ hiret, nuret e shoi-shoqes/ dhe të dyja u përjoshën/ plotësisht, edhe u ulën/ përmi vjollcat q'ishin tretur/ pranë e pranë në një hije./ Kështu gjithë vera e kthjellët,/ si një ditë agimzgjatur/ gaze tatilla u solli/ sa rrallherë ndodh mbi dhe.

Vazhdojmë edhe pak me vargje lehtësisht të zbërthyeshme, pa dyshim, të denja vetëm për poezi dashurie:

Dhe në stinën e qershive/ nëpër degë e fletë pemësh/ ngjiteshin dhe fshiheshin/ aqë lehtë e guximtare,/ jo si vasha, po si vida./ Njëra bënte anak për shoqen/ tjetra vathë për të parën/ e plot mall na u stolisnin/ brenda asaj foleje fletësh.

Dhe sërish imponohen pyetjet:

Ç'simbolizon këtu stina e qershive, në të cilën vashat fshihen me guxim dhe stolisin me mall njëra-tjetrën në fole fletësh, madje puthen në buzë… Ç'është kjo lojë magjike, të cilën e ndërpret vetëm koha kur ato futen n'odat burgje të manastirit dhe vuajnë tmerret e ndarjes nga njëra-tjetra:

…larg shoi-shoqes e më kot/ ftonin gjumin që t'u vinte/ n'errësirë përmbi sytë/ gjithë dritë e përmbi faqet,/ ku të kuqtë e saj kish lënë/ dita plot qershi e mollë,/ edhe ndënë gjinjtë e fryrë,/ ëmbël zemra atyre u rrihte.

De Rada thotë: *dita plot qershi e mollë…*, po a piqen qershitë e mollat në të njëjtën stinë, apo poeti i përdor ato si simbole dëshire e kënaqësie, njohje e lirie, gëzimi e rrinimi… Sqarim tjetër s'besoj të ketë, sepse De Rada nuk ishte krijues naiv që mund t'ia lejonte vetes të shkruajë kuturu, pa matur secilin varg, secilën fjalë.

Të rimarrim tani bashkë dy vargjet, ku përmbi faqet e vashave … *të kuqtë e saj kish lënë/ dita plot qershi e mollë…*, për të tërhequr paralelen

mes tyre dhe vargjeve të këngës popullore arbëreshe *Lart te çuka e një mali*, që flet për momentin kur një trim puthi vashën dhe kur ajo,

> *e pezmatuar*: *…shpejt në uj' vërviti faqen/ dhe të puthurën e lau/ po m'atë e skuqi ujët./ Nga qyteti atje poshtë/ dolën gratë t'lajnë teshat./ Nuk zbardhohen porse skuqen/ të lintat që ato lanin;/ edhe kopshtet që ujiteshin/ bënin fletëzat e kuqe…*

Ky të kuq që lë gjurmë të pashlyeshme në gjithçka përreth, pa dyshim, ka të njëjtin kuptim me *të kuqtë e ditës plot qershi e mollë* të poemës autoriale të De Radës. Është i njëjti motiv, e njëjta simbolikë…

De Rada nuk mjaftohet me kaq. Ai jep në vargje edhe arsyet e vërteta të dyshimeve të murgeshave të tjera lidhur me miqësinë dhe sjelljen e pazakontë të vashave. Ato, thotë poeti, përgojojnë

> *këtë dashuri prej motrash,/ në mes Dinës edhe Nushës*, sepse askush: *…kur na kishin qenë vasha/ nuk u ishte qasur kurrë/ me një ndjenjë dashurie…*

Siç shihet, autori më në fund përdor fjalën *dashuri* në vend të fjalës *miqësi*, duke u vënë në anën e murgeshave që i konsideronin vashat mëkatare. Duke e zëvendësuar pikërisht në këtë pjesë të poemës fjalën *miqësi* me fjalën *dashuri*, De Rada përligj me fund të vërtetën e pamohueshme të lidhjes së dy vashave, pavarësisht se murgeshat i quan *të pakripta*.

Edhe kur vashat i ndanë për shkak të sjelljeve që binin ndesh me kanonet kishtare, ato ëndërrojnë tek rrinë të mbështetura në njëra-tjetrën, në cepin e shtratit të një dhome… *Zoti tatë* kërkon ta martojë Nushën me një bujar, me çka pamundësohej përfundimisht takimi i saj i sërishëm me Dinën, si *në kohën e parë*:

> *Zoti yt atë ne na ndau/ dhe ka javë që humba shpresën/ se s'do kthehet koha e parë./ Por unë me kë të rri/ dhe kë të dua pas teje? (…) ti zemërgure më shkon?*

Vuajtja e Dinës s'ka kufi, por gjen aq forcë sa ta urojë Nushën: *Qofsh e lumtur dhe pa mua!*, që, sigurisht, si urim i shkon më shumë ndarjes së dy të dashuruarve.

Në këtë pjesë të këngës, autori ndërhynë me elemente fantastike: me zogj që flasin, me heroina që shndërrohen në zogj, duke e ngritur kësisoj dramaticitetin e ndarjes së dy vashave të dashuruara marrëzisht në njëra-tjetrën.

Çastet më tragjike të kësaj dashurie të pamundur, kur Dina e thyer shpirtërisht vetëm sa nuk ka ikur nga jeta, autori vendos t'i mbyllë me vargje trishtimndjellëse si ato të *Korbit* të Edgar Alan Po-së:

Vasha e mjerë, e këputur,/ një mëngjes, sa e mposhti gjumi/ ndjen në veshët: 'dang, dang, dang'./ Brof tronditshëm: 'dang, dang, dang'… (…) Kur erdh nata, kotullohet./ Prapa froneve hyllnari/ hidhte hije si të gjalla/ dhe te dera ndien trokitje. / Ndjeu e s'foli… Prap' trokitje (…) Pranë e përgjumur në fron,/ rri Dilina e fundosur/ si në qetësinë e madhe/ të një varri ndënë tokë,/ ku nuk ndihet asgjë më…

*

Ky pra është rezultati i leximit/ interpretimit ndryshe të këngës *Dina Zënëbisha*. Lexuesit të painformuar për filozofinë jetësore të poetit me disponim të palëkundur antiosman i lejohet paragjikimi, sipas të cilit De Rada nuk do t'i qasej kurrë një temeje të tillë, veçmas jo De Rada romantik. Por mua më rezulton të jetë ndryshe, më del se dy dashuritë e Dinës janë të pranueshme për artistin humanist e demokrat, veçmas kur të merren parasyshë rrethanat në të cilat zë fill njëra prej tyre dhe rritet në nivel dhemjbesh vdekjendjellëse tjetra.

Mos të harrojmë se Jeronim de Rada dallohet nga romantikët tjerë edhe me sfidat e hapura kundër aristokratëve shqiptarë të kohës, kundër padrejtësive klasore brendashqiptare, kundër miqësisë kurtoaze të fuqive evropiane, kundër fqinjëve nëpërka... Ai ka sfiduar edhe familje të respektuara shqiptare si atë të Arianit Komnenit, duke ia nxjerrë në shesh koketimet me pushtuesit. Parë nga ky kënd, përse të mos ishte e pranueshme simpatia, përkatësisht dashuria atipike ndërmjet personazhësh të poemës në fjalë, kur dihet se për *mëkate* të ngjashme të së shkuarës ka kënduar edhe rapsodi popullor? Këto sigurisht i dinte poeti erudit De Rada. Shi për këtë, do të duhej të habiteshim më fort po të lejonta ta humbë pakthyeshëm rastin për t'u vënë edhe në këtë plan mbi krijuesit tjerë romantikë, duke thyer, qofte edhe vetëm një herë, tabu-të e një letërsie himnizuese, të cilën e përqafoi i pari ndër arbëreshët/ shqiptarët.

Mark MARKU, Tiranë

NARRATIVA E DE RADËS: NGA NARRATIVA PERSONALE TEK METANARRATIVA

KDU 82.18'282.4(450).091

Autori personazh dhe identiteti narrativ i De Radës.

Nëse e analizojmë identitetin narrativ të personazheve të De Radës, vemë re se në të gjitha veprat e tij kemi të njëjtin personazh: autorin. Edhe Milosao, edhe Bozdari, edhe Skëndërbeu, madje edhe personazhet femërore janë personazhe-autor. Natyrisht kjo që sapo thamë ka kuptim nëse për identitet narrativ kuptojmë atë që kishte parasysh Ricoer pra atë formë identiteti të fituar nga qenia njerëzore nëpërmjet funksionit narrativ[1].

Prej këtej mund të kemi një qasje kritike ndaj përpjekjeve për ta trajtuar veprën e De Radës si një vepër që rrëfen para së gjithash e mbi të gjitha jetën e komunitetit imagjinar: kombit. Në nivelin e parë ajo është thjeshtë një narrativë personale, *una storia di vita*, e jo *una storia della nazione*.

Sidomos në fazën e pare, vepra e tij është e shenjuar nga përpjekjet për të ndërtuar përmes narratives, një identitet vetjak. Për këtë arsye, narrativa e tij i ka të gjitha karakteristikat e narrativave vetjake, domethënë të historive që ndërton çdo qenie njerëzore për të përcaktuar identitetin e tij vetjak dhe për t'i dhënë kuptim botës së vet. Edhe pse të ndryshme sipas subjekteve që i krijojnë, narrativat kanë një qëllim të vetëm: kërkimin ose krijimin e identitetit të autorit në funksion të një statusi shoqëror. Duke

[1] Ricoer, P. Identitè narrative, Revue des sciences humaines, LXXXXV, 221, janar-mars 1991, f. 35

pasë në fillesë qëllimësinë, narrativat ndërtohen edhe përkundër fakteve jetësore, domethënë, ndërtohen jo mbi të vërtetën, por mbi atë që ngjashn si e vërtetë.

Evoluimi i narrativës së De Radës shpreh evoluimin identar të De Radës në rrafsh personal, në një dialektikë mes ndryshueshmërisë dhe pandryshueshmërisë. Sepse termi identitet i shpreh njëherësh edhe të pandryshueshmen edhe të ndryshueshmen. Në origjinë e tij, pra në latinisht, thotë Ricoer termi identitet shprehej me dy fjalë *idem* dhe *ipso*. Idem, identik ose jashtëzakonisht i ngjashëm me vetveten dhe ipso (vetvetja)[2]. Termi i dytë përmban edhe ndryshueshmërinë, pasi siç e dëshmon gjithë përvoja njerëzore por, edhe eksplorimi shkencor i psikës njerëzore është i ndryshueshëm.

Keqkuptimet për sa i përket karakterit identitar të veprës së De Radës shtrihen në disa nivele. Keqkuptimi më i madh ka të bëjë me faktin se në studimet tona letrare identiteti konceptohet në njëjës ndërkohë që individi shoqëror, qoftë ai edhe shkrimtar është rezultante e disa identiteteve: kulturore, gjuhësore, etnike, fetare, krahinore, ideologjike, politike, shoqërore, gjinore, profesionale etj. Kjo shumësi identitetesh e bën atë të ngjashëm dhe të ndryshëm nga të tjerët dhe zbulohet vetëm përmes komunikimit. Në ndërveprimin komunikues me tjetrin, individi e zbulon atë çfarë e bën të ngjashëm dhe të dallueshëm nga të tjerët. Pikërisht në këtë konfrontim me tjetrin ai zbulon vetveten.

Keqkuptimi i dytë ka të bëjë me faktin se në studimet tona letrare ne e shikojmë identitetin jo si një proces, por si një shenjim, të kryer në një moment të caktuar të jetës së individit dhe të kryer njëherë e përgjithmonë, të pandryshueshëm, si një lloj fataliteti që i është përcaktuar individit. Ky keqkuptim a paragjykim projektohet kryesisht në studimet e veprave të autorëve të Rilindjes, vepra e të cilëve është kryesisht e orientuar në formimin e identitetit kombëtar të shqiptarëve. Qëllimësia dhe rezultantja e disa prej veprave të autorëve të Rilindjes, pra, krijimi i identitetit kombëtar, merret si e dhënë a priori për vetë autorët e këtyre veprave, duke harruar se

[2] Po aty, f. 37

vetë autorët e kanë fituar këtë identitet bashkë me krijimin e veprës së tyre. E thënë ndryshe, autorët e parë të Rilindjes e kanë zbuluar identitetin kombëtar duke e zbuluar dhe krijuar për komunitetin që po krijohej njëherazi.

Keqkuptimi i tretë ka të bëjë me faktin se ne, pas ardhësit, atë që është rezultat i një procesi të gjatë historik ia veshim gjithë procesit dhe më pas vetë procesin e intepretojmë, analizojmë transformojmë deri në deformim. Më duket se vepra e De Radës, por edhe e Naim Frashërit apo Sami Frashërit është shembulli më i mirë për këtë. Ideologjia e Rilindjes Kombëtare një formë tejet e pluralizuar e krijimit të identitetit kolektiv të shqiptarëve, ashtu siç e njohim ne sot është një konstrukt ideologjik mjaft i ndryshëm nga forma dhe përmbajtja që ajo kishte përgjatë gjithë procesit. Si e tillë, ajo është institucionalizuar dhe e legjitimuar prej institucioneve kulturore e politike të shtetit kombëtar shqiptar të krijuar pas 1912-ës duke u shndërruar në një metanarrativë mbizotëruese, rrafshuese, skematizuese. Fuqia e ideologjisë bën që të gjithë veprat e autorëve shqiptarë të Rilindjes përfshi këtu edhe De Radën, t'i nënshtrohen një tjetërsimi ideologjik.

E parë përtej këtyre paragjykimeve dhe keqkuptimeve, na rezulton se identiteti narrativ i fazës së parë krijimtarisë së De Radës është identiteti tipik i heroit romantik, arketip i njeriut në konflikt me ambientin shoqëror, i cili e kërcënon shoqërinë me një braktisje në hapësira të tjera dhe kohë të tjera, në një botë imagjinare, ose të shkuar. Odisse (1832), Këngët e Milosaut (1836) I Numidi (1842), si struktura narrative theksojnë pikërisht identitetin e heroit romantik në kërkim të një marrëdhënieje me botën që e rrethon. Më shumë se histori e një bote, një komuniteti, ato janë histori e një jete (*storia di una vita*). Nëpërmjet diskursit narrativ De Rada shpalos unin e vet poetik, pasionin erotik. Është pikërisht ky diskurs ku reflektohet tensioni mes qëndrueshmërisë dhe ndryshueshmërisë si dy elementë konstitutivë të krijimit të identitetit. Identiteti narrativ i De Radës duhet kërkuar pikërisht në thurjen e intrigës dhe diskursin narrativ e jo tek personazhet-autor.

Këtu lidhet narrativa e tij me narrativën kombëtare shqiptare. Por, në momentin që ndodh ky pikëtakim, narrativa e tij vetjake ka përfunduar.

1. Poeti, atdheu imagjinar dhe komuniteti imagjinar

Kombi si konstruksion ideologjik ndërtohet vetëm pjesërisht prej poetëve. Poetët kanë një rol mbizotërues në ndërtimin e komunitetit imagjinar ose të një atdheu imagjinar. Dhe këtu natyrisht De Rada ka një rol të padiskutueshëm.

Imazhet dhe fjalët e veprës së tij krijojnë kështu një botë ku individët ndërveprojnë mes tyre, ndjejnë praninë e tjetrit, krijojnë një marrëdhënie të re. Imagjinari kolektiv formësohet jo vetëm prej përmbajtjeve por, edhe përmes imazheve. Të dyja bashkë, përmbajtjet dhe imazhet lindin një botë të re, ose më saktë një botë zëvendësohet me një tjetër. Në këtë botë të re *uni* bëhet *ne*, *tjetri* nuk është më *tjetri* por, i ngjashmi yt, sjellja individuale ia lë vendin sjelljes kolektive. Diskurset përfaqësuese - siç quhen në shkencat e komunikimit - kanë një qëllim përbashkues: t'i paraqesin rolet dhe funksionet shoqërore të individëve sipas raporteve logjike dhe t'i vendosin ato në një kontekst koherent. Individët dhe qëndrimet e tyre duhet t'i nënshtrohen rregullave të sistemit shoqëror homogjen ku të gjithë pa përjashtim duhet t'u shërbejnë të njëjtave qëllime dhë të njëjtave interesa.

Sipas studiuesit Castoriadis çdo shoqëri përpunon një imazh të botës natyrore, të universit ku kjo shoqëri jeton, duke tentuar gjithherë drejt një tërësie domethënëse në të cilën duhet të gjejnë vendin e tyre objektet dhe qeniet natyrore të cilat kanë shumë rëndësi për jetën e bashkësisë, bashkësi që paraqitet tek e fundit si njëfarë rendi i botës. Ky vizion pak a shumë i strukturuar i botës nuk krijohet nga racionalja por, nga imagjinarja. Krijimi i botës origjinale (në rastin e De Radës shqiptare) ka një funksion të trefishtë:

a. Strukturon vizionin e përgjithshëm për botën;

b. Përcakton finalitetin e veprimit duke na imponuar se çfarë duhet dhe të bëjmë dhe çfarë s'duhet të bëjmë;

c. Përcakton një tip afeksioni karakteristik.

Vepra e De Radës, si tërësi simbolike e botës shqiptare e realizon këtë funksion të trefishtë. Ajo i ofron botës shqiptare një strukturim kohor sinkronik dhe diakronik. Ka një kohë, mot të lavdishën dhe një mot të

palavdishëm. Ka një kohë të shkuar me atdhe dhe një kohë të tashme pa atdhe. Ka një kohë në dheun tonë dhe ka një kohë në dheun e huaj. Është e çuditshme se si për De Radën ka gjithnjë një atdhe të humbur por, jo dhe një atdhe të gjetur: Ah, s'ka asgjë më njeriu që nuk ka atdhe vajton De Rada tek poema Oidseu dhe më tej: Dhe s'do quhet kurrë më, kurrë më i gjallë atdheu ynë. Italia vendi i pritjes shfaqet vazhdimisht si dheu i huaj. Por mbi të gjitha De Rada përcakton finalitetin e veprimit të shqiptarit të shekulit të 19-të: rigjetjen, rikrijimin, ringritjen e atdheut.

2. Marrëdhënia narrativë –metanarrativë.

Lyotar në librin e tij Kushti postmodern shprehet se metanarrativat e injorojnë shumëllojshmërinë e shprehjes njerëzore. Më duket se e njëjta marrëdhënie vendoset edhe me marrëdhënien mes narrativave vetjaje të shkrimtarëve tanë të Rilindjes Kombëtare dhe metanarrativës sonë kombëtare. Siç e theksuam më sipër, metanarrativa kombëtare e Rilindjes u mbivendoset narrativave vetjake të shkrimtarëve të Rilindjes kombëtare shqiptare duke i deformuar ato. E institucionalizuar kulturalisht, politikisht dhe ideologjikisht, ajo bëhet e pakundërshtueshme, madje, në ndonjë rast, e dëmshme, sepse shndërrohet në dogmë. Po marr vetëm një rast. Është thënë e thuhet vazhdimisht se lëvizja kombëtare shqiptare përkon me Rilindjen Kombëtare. Kjo përkon edhe me një konsideratë të përgjithshme të mbështetur edhe nga studiuesit me emër të dukurisë së nacionalizmit si Hobsbaum, sipas së cilës kombi është një dukuri e modernitetit. Benedict Anderson, autori i komuniteteve imagjinare mendon ndryshe: ai e gjen origjinën e kombeve në mesjetë, pikërisht në momentin e rënies së latinishtes dhe shfaqjes së gjuhëve të veçanta të bashkësive të ndryshme evropiane si gjuhë kulture.

Nëse e shohim në këtë këndvështrim atëherë i takon të mendojmë pak edhe për Buzukun, Frang Bardhin, Matrëngën, Budin, Bogdanin dhe gjithë shkrimtarët paraardhës të rilindasve.

Duke u kthyer tek De Rada, do të thoja se ai pjesëmarrjen më të madhe në atë që quhet narrativa kombëtare e ka jo nëpërmjet veprës së tij poetike, por nëpërmjet krijimeve të tjera veçanërisht nëpërmjet: *L'Anti-*

chita della nazione Albanese, *Il testamento politico*, deri diku nëpërmjet *Autobiografisë* dhe sidomos nëpërmjet *Flamurit të Arbërit*.

Nëpërmjet këtyre veprave, De Rada, pasi ka identifikuar vetveten, kërkon të realizojë identifikimin e komunitetit të të ngjashmëve të tij. Në fund të udhëtimit të tij imagjinar ai i zbulon vetes dhe komunitetit thelbin e tij dhe të botës së tij të rrëfyer gjurmët e origjinës së tij.

Kujtim M. SHALA, Prishtinë

MËSIMET E DE RADËS E KURORA E POETIT

KDU 821.18'282.4(450)-1.09

I

Formulimi *Mësimet e De Radës* ka parasysh shenjën moralizuese të veprës së De Radës dhe De Radën mësues apo përfaqësues, *skajime* që shenjonë veprën që do funksion përtej fushës së vet të parë, përtej estetikës, te moraliteti i gjallë. Shenjat e tilla shtrihen në veprën e De Radës si *konstanta* poetike e nyja të forta ideologjike, ndërsa *shkrimtaria* e tillë është e identifikueshme me një *mision*, edhe kur nuk shpallet. Kjo e provon skemën e njohur të letërsisë shqipe që shkrimtarët i bën misionarë e misionarët *autoritete letrare*, të cilët, një shkallë më tej, bëhen veprimtarë e prijës.

Me këto shenja, De Rada mësues shenjon një fenomen letrar e kulturor, të provuar me vepra e të dhënë si *mësim*. Kemi vetwdijen se mësimi që jep letërsia lidhet në rrjetin e fiksionit dhe hapet si *sugjerim*, ndërsa tendenca e veprës sprovohet përmjet leximit dhe *shkrimtari* bëhet *mësues*, kur leximi e njeh të tillë. Po, se një vepër letrare që do funksion përtej letërsisë, bëhet vepruese kur hapet e lexohet nën shenjën e *mësimit*.

II

Me vepër e veprim, De Rada jeton në skemën (e provuar historikisht) të mbrojtjes së qenies (etnisë) me kulturë, që merr shenjat e mbrojtjes së identitetit. Provohet si nyjë e madhe e jetës së tij përpjekja për të ruajtur ortodoksinë e arbëreshëve, në mjedisin katolik italian. Ai e dinte se po mbronte etni, kulturë e përkatësi, meqë një *besë* e përbashkët me italianët, përballë një arbërishteje që po lihej, do të prekte identitetin arbëresh në të gjitha kuptimet.

Evidencat thonë se De Rada themeloi revistën arbëreshe, *Fjamuri arbërit*, drejtoi shkolla në arbërishte, edhe kur shkruante tekste në italisht. Ai mblodhi kujtesën arbëreshe, e lidhi në vepër letrare, apo e imagjinoi atë, për t'ua dhënë arbëreshëve si kulturë të vjetër, të rrënjëve, të Arbërisë. De Rada kërkonte një epos arbëresh të lidhur me Skënderbeun dhe kjo e provon se eposi lexohej si shenjë identiteti, si trezor e si memorie. Është ky eposi i heroit nacional, i shenjës mbretërore të ekzistencës e të identitetit, ashtu si e *skajon* shkolla deradiane. Por, De Rada nuk e gjeti atë, kujtesa arbëreshe s'e kishte, dhe e thuri vetë nga fillimi, në vargje e poema, në ciklet e tij epike, si dëshmi e si kujtesë, që do të thotë si *mësim*. Kështu, edhe heroi nacional i tij, Skënderbeu i tij, vjen nga letërsia e tij, pra nga kultura e imagjinimeve, përgjasueshëm me Skënderbeun e Naimit më vonë.

De Rada që argumentoi për ortodoksinë në jetën e gjallë të arbëreshëve, u dha atyre jo një hero religjioz, por një hero nacional, edhe pse përftesat religjioze jetojnë ngado faqeve të veprës së madhe të tij.

Vepra e De Radës, e shkruar në dy gjuhë, e provon dramën e vjetër të *autentikes* me *alteritetin*, në të cilën *gjuha* bëhet përcaktuese identitare e nacionale.Vepra në gjuhën shqipe është *mësim* për *origjinën*, *kalesën* e *trashëgiminë*, vepra në italishte shenjon vetëdijen për përkatësinë e ambientit, kulturën e tjetrit e dramën e *personës* që *kujton*.

III

Në diskursin e njohur të Çabejt, De Rada shenjohet si autor themelor i letërsisë romantike, përfaqësues i romantizmit perëndimor (arbëresh), përballë Naimit romantik juglindor (shqiptar). Romantizmi deradian lidhet pazgjidhshëm me subjektin, me fillin autobiografik të tij, por edhe me idetë nacionale, i hapur për oralitetin, përballë romantizmit naimian, ideologjik, pa lidhje të provuar në diskurs apo frymë me oralitetin, por që të dy religjiozë.

Skajimi i tillë letrar bën që *mësimi* i De Radës të lexohet me shenjat e poetikës së tij, që moralitetin e thotë si figurë e rrëfim, ndërsa e provon si veprim. Ky është dhe një mësim letrar, meqë shenjon shkollën letrare të De Radës dhe do të bëhet metodë leximi, shoqëruar me shenjat e një vizure.

Një romantik i tipit të De Radës kryqëzon poetikën universale me mësimet nacionale, ndërsa kurora e tyre ka trajtën e veprës, madje të krye-veprës letrare shqipe. Mësimi s'merr trajtë ideologjie, por bëhet mesazh i lidhur me narrativën e rrallë poetike, me ndodhitë e heronjtë, si shenja të një moraliteti.

IV

Mësimi i De Radës provohet thellë te temat nacionale, qoftë kur hapen mjegullat e mitologjisë së etnisë apo kur kapet historia e nacionit. Kjo e dyta merr shenjë përfaqësimi si temë e heroit nacional, që shoqërohet me diskursin moralizues, i cili bëhet një diskurs karakterizues.

Në rrafshin e diskursit e të tematikës, De Rada është personal te *Milosao* (1836) e impersonal te poemat narrative. Narrativa deradiane përgjason të shkuarën heroike e fatlume që lidhet me heroin nacional, Skënderbeun, ndërsa *mësimi* themelor i saj merr trajtën: E tashmja është e nxirë, e shkuara hapet plot dritë e madhështi.

Mësimi letrar i lidhur me Skënderbeun buron nga vepra heroike e tij, por vetë heroi është zbulim i shekullit XIX, më shumë figurë kulturore e letrare, sesa historike. Ndërsa, i shenjuar si emblemë e epokës, Skënderbeu bëhet përfaqësues fatlum; të gjitha këto shenja të një *figure morale*. Kështu, Heroi nacional dhe Heroi moral bëhen një dhe prodhojnë një *mit letrar*, si shenjë të *ideologemës nacionale*. Diskursi bëhet fytyrë e mitit dhe ka të gjitha ngjyrat e himnizimit e të moralizimit. Diskursi i tillë, bashkë me ideologemën, i bëjnë autorët *mësues*. Kjo s'është kryekëput një estetikë, po dhe një tendencë e veprës për funksion në jetën nacionale.

Por, De Rada shenjoi *mësimin* e madh te vepra e parë, *Milosao*, tek e cila skema lë individin e vepra mbyllet si himn për atdheun. Vërtet, ky është mësimi i madh deradian.

V

I lidhur në dyshe me *mësimin* e Naimit, De Rada duket më fort. Që të dy kërkues të epit nacional, të provuar edhe përtej shqipes, veprimtarë e misionarë, De Rada e Naimi e bëjnë dyshen e madhe kulturore e letrare të shekullit XIX. Kurora e Poetit nacional kalon nga njëri te tjetri, ndërsa historia letrare shqipe i mban bashkë për të shenjuar e përfaqësuar një epokë të kulturës e të letërsisë shqipe.

Diskursi i sotëm për Naimin thotë se: Naim Farshëri është aurori i parë i madh i lexuar dhe se pa të nuk do të kishte letërsi shqipe, ndërsa ky konstatim bëhet vlerësim *a posteriori*, që buron nga leximi i letërsisë shqipe sot përkrah shqipes e veprës së tij. Por, ky konstatim na kthen te leximi krahasues i De Radës si autor e përfaqësues, që do të thotë si *autoritet*. Njëri arbëresh i krishterë/ortodoks, tjetri shqiptar mysliman/bektashi, kapin cepat e ekzistencës e të historisë letrare shqipe.

Të lidhur me fenë e me gjuhën shqipe si me *njësi* që bëjnë e mbajnë identitet, De Rada e Naimi zbulojnë e provojnë nga fillimi fuqinë e tyre në jetën etnike e shpirtërore të arbëreshëve/shqiptarëve.

Por, që të dy hapen në nyjat autentike në veprën e tyre, që lakon personalen (universalen) e nacionalen si dy faqe të një letre. Veprimet e heroit nacional kryqëzohen me *besën* e tij, e cila, vërtet, është një *kulturë*. Heroi i De Radës është *i pafan*, ndërsa ai i Naimit nuk vdes, po shkon, jo vetëm pse kultura e tij e njeh vetëm *kalimin*, por pse është Hero. Ky është një *mësim* që shenjon historinë, bashkë me epokën e De Radës, meqë *mësimi* do të bëhet veprim.

De Rada është poet, rob i ndjesisë e mbret i fiksioneve, ndërsa mësimet e tij burojnë nga fiksioni dhe dallojnë nga ai në shkallë e jo në tipologji. *Mësime* të diskursit letrar, që s'është kolokvial apo të diskursivitetit doktrinar. Kështu thuren *mësimet kratilike*, që do të thotë të motivuara, përfundimisht të këndshme, për t'u hapur rishtas nën shenjën e estetikës së parë.

VI

Çështja e kurorës së Poetit nacional kaloi shekullin e De Rdaës e të Naimit dhe hyri në shekullin XX si temë e madhe letrare e kulturore dhe tashmë ngadalë po kalonte nga politika e nacionit te poetika e modernitetit, kur përballë Fishtës vihej Lasgush Poradeci. Por, përballë De Radës e Naimit kërkohet më parë formati i Fishtës veprimtar e shkrimtar, sesa vepra e ëndërrimeve dhe e imagjinimeve personale të Poradecit.

Paradigma shqiptare e jetës (veprimtarisë) dhe e veprës (kulturore) të etërve tanë farnçeskanë, Atmé e Fe, shtrirjen më të gjerë e manifeston tek Át Gjergj Fishta, i përcaktuar e i kurorëzuar si Poet kombëtar, që do të thotë Hero e Misionar. Një hero i tillë përherë, përpos veprës letrare, ka dhe veprën nacionale, të përthyer në veprime kulturore e politike.

Vepra e Fishtës e provon përherë dyshen Atmé e Fe. Në librat lirikë, në melodramën për Jerinën, në polemikat e pashoqe për energjinë e forcën e argumentimit, te më e buta, *Nji lule vjeshtet*, po dhe të më epikja, *Lahuta e Malcís*, epi i shqiptarëve. Në veprën e Fishtës ka besë, nder e burrni, si përjetë ndër Lekët e shqiptarët. Vlim gjaku, trimëri e derdhje gjaku, si në çdo luftë për liri. Fishta ka dhënë universin shqiptar, të lidhur me nyjat etnike, të cilat, të lidhura edhe ato, i mban formula Atmé e Fe, të cilën, qoftë dhe përmjet Fishtës, e njohim si një paradigmë shqiptare.

Për ta provuar këtë paradigmë identitare të Fishtës, do të rihapim shpejt *Lahutën e Malcís*, veprën më të madhe të tij.

Në një rast, e kemi quajtur *Lahutën…* një ep të (frymws sw) krishterë dhe jemi kritikuar menjëherë. Po të hapeshin letrat diskursive të Fishtës, do të kuptohej se *i krishterë* është term vlerësues dhe ka parasysh vlerësimin e vetë Fishtës për artin e krishterë. Po *Lahuta…* është dhe përplot frymë krishtere, që përthyhet në dashuri për shtëpi e fis, për Atmé, në pastërti virgjërore të Tringës, në figurën e Patër Gjonit, para të cilit ulen shpatat e këputet beteja e heshtin luftëtarët.

Në *Lahutë…* rrëfehet lufta për atdhe, kundër sllavëve e për atdhe lufton atdhetari dhe *atdhetar* është ai që ka *besë*. Jemi te paradigma Atmé e Fe. Atmé-ja është një, Feja jo, meqë para na del Osoja mysliman, që

digjet për atdhe, Marash Uci a Dedë Gjo Luli, shqiptari i madh i krishterë, Patër Gjoni, prijës shpirtëror e atdhetar.

Lahuta… njeh *identitetet* shqiptare, ndaj është një vepër (e madhe) shqiptare. Këtë kishte kapur shqiptari e dijetari Krist Maloki te Fishta Poet Nacional.

Po, Fishta e dinte se një hero i krishterë nuk do të njihej si heori i shqiptarëve në shumicë myslimane, ndaj e gjeti edhe Oso Kukën mysliman.

Lahuta…, e lidhur me jetën autentike shqiptare e shpirtërore, me palcin ethnik (Koliqi), me sprovat e imagjinimet, me gjuhën e vendit, ka të gjitha shenjat e Shkollës letrare të françeskajvet shqiptarë (Koliqi), të shkollës së temave e të gjuhës së vendit.

Kështu lidhet *mësimi* i Fishtës dhe hapen shenjat e tij si Poet, përkrah a përballë De Radës e Naimit, të lidhur në treshen përfaqësuese letrare, kulturore e nacionale shqiptare, që do të thotë me treshen e mësimeve identitare.

Mehmet KRAJA, Prishtinë

PAS NJË RILEXIMI TË RAPSODIVE… TË DE RADËS

KDU 821.18'282.4(450).09

Pa asnjë pretendim studimi, vetëm për kënaqësi artistike, së fundi kam lexuar për të tretën ose të katërtën herë Rapsodi të një poemi arbëresh ose Rapsodi të një poeme shqiptare të De Radës (për mendimin tim njërën nga veprat poetike më të rëndësishme të mbarë letërsisë shqipe) dhe u përpoqa të sjell ndër mend një për një të gjitha ato studime historiko-letrare për këtë vepër, si lindi ajo, kur u botua, ç'e shtyri autorin të mblidhte e të rishikonte këngët e mbledhura, ç'iluzione romantike ushqente ai për mundësinë e rikëndimit të një Iliade shqiptare dhe gjëra të këtilla, më pak ose më shumë esenciale. Ndër ato studime, pa dyshim me vlerë, mund të mësohen shumë gjëra rreth kësaj vepre, vetëm se nuk e di përse me kohë kisha krijuar një bindje se kjo vepër e De Radës, pa të drejtë, ishte zhvendosur nga letërsia në histori. Pra, ishte shtyrë disi matanë artit, ishte kthyer në data, në fusnota, në shënime bio-bibliografike dhe gjëra të këtilla, me të cilat zakonisht merret shkenca. Kisha idenë se kjo shkencë e historisë së letërsisë krijonte një mur të pakalueshëm ndërmjet veprës dhe lexuesit dhe e ndërpriste atë komunikimin e domosdoshëm, të lirë e të papenguar, të cilin e supozon çdo lexim i letërsisë.

Pastaj krijova bindjen se kjo shkencë e historisë së letërsisë, duke u marrë me gjëra dytësore rreth kësaj vepre, i kishte bërë asaj shërbimin më të keq që mund t'i bëhet letërsisë, sepse nga një vepër që *mundet* dhe *duhet* të lexohet në mënyrë aktive, e kishte kthyer atë në një *lëndë studimi*, që domethënë se e kishte larguar nga lexuesi dhe e kishte arkivuar në një mësim pasiv, në lexim për qëllime të tjera, ndoshta shumë të rëndësishme, por që në një masë të madhe përjashtojnë leximin e saj si vepër arti. Të më lejohet që këtu të hap një parantezë dhe të them se po në këtë mënyrë është vepruar me letërsinë arbëreshe në tërësi dhe në këtë pikë ajo krejt gabi-

misht është vendosur në të njëjtin kontekst leximi dhe në të njëjtin rrafsh komunikimi me letërsinë e vjetër shqipe. Nuk mund të përfshihen në një diagramë komunikimi Budi, Bogdani, Matranga e Variboba, njësoj si De Rada, Dara dhe Serembe. Autorët e letërsisë së vjetër mësohen dhe studiohen dhe janë të rëndësishëm për shumë arsye, por ata nuk lexohen dhe nuk shijohen së mënyrë aktive, së paku jo në masë të tillë siç mund të lexohet De Rada ose Serembe. Në planin e leximit dhe të përjetimit artistik nga ana e lexuesit, këta autorë duhet të qëndrojnë pranë Naimit dhe të rilindësve të tjerë, jo më në planin e vlerësimit dhe të vendit që u është caktuar në trashëgiminë tonë letrare, por në planin e leximit aktiv dhe të njohjes së themeltë të krejt asaj që përbën nukleusin e vlerës artistike të veprës së tyre.

Arsye themelore që këta autorë i ka bërë *objekt studimi* dhe jo *objekt leximi*, përmendet ose vetëkuptohet se ka qenë gjuha, që domethënë vështirësia e leximit të një dialekti, i cili me kohë është larguar nga trungu gjuhësor i shqipes. Mirëpo, nuk mund të thuhet me aq bindje se ky faktor ka qenë vendimtar, sepse ka kohë që veprat e De Radës, Darës dhe Serembes janë rikënduar ose transliteruar në gjuhë të sotme shqipe, ndërkohë që shkalla e komunikimit aktiv me këtë letërsi ka mbetur po ajo. Prandaj jam i prirë të besoj se këtë shërbim të keq letërsisë sonë ia ka bërë historia e letërsisë dhe studimet tona tepër inkonsekuente dhe perifrazuese, në të cilat thuhet çdo gjë që është e dorës së dytë, por fare pak flitet për artin dhe për vlerat e tij. Mua, ta zëmë, fare pak më intereson nëse De Rada i mblodhi Rapsoditë... në këtë vend apo në atë vend, i botoi dhe i ribotoi në këtë datë ose në atë datë, me këtë titull ose me atë titull; nëse rreth tyre kishte këtë ide mistifikuese ose demistifikuese. Për mua është i rëndësishëm fakti se ai bëri një vepër letrare artistike nga më të mirat të poezisë shqipe, që në shumë pika edhe sot shfaqet e mrekullueshme. Për mua, gjithashtu, është për keqardhje fakti se një pjesë e mirë e poezisë shqipe e shekullit XX, u shkrua pa e njohur, pa e lexuar dhe pa e asimiluar një vepër të këtillë, së paku jo në shkallën që do të duhej.

Pra, cilat qenkan këto esenca artistike, që këtë poezi, këtë libër, këto Rapsodi... i vendosin në themelet e artit? Së pari janë motivet, të cilat, njësoj si tërë letërsia antike, shprehin raportet themelore të njeriut me

enigmat e ndryshme të jetës e të ekzistencës, siç është raporti ndaj jetës dhe vdekjes, dashurisë, fatit, dhembjes njerëzore etj. Janë këto motive të përjetshme, gjithmonë të përsëritura në artin e letërsisë. Këto motive universale në Rapsodi... gërshetohen në mënyrë krejt të natyrshme me situata dhe rrethana jetësore të botës arbëreshe, pastaj me historinë e dhembshme dhe tragjike të një entiteti që është i mbyllur në rrethin e pamundësisë. Tragjikja e pamundësisë në këtë rast është fatale, e para, sepse njeriu nga vetë natyra e qenies së tij është i dënuar të mos arrijë të zgjidhë enigmat themelore të jetës dhe vdekjes, pra edhe të fatit të vet; dhe, e dyta, kësaj rrethane tragjike ia shton peshë vetë fakti i të qenit arbëresh. Arbëreshi, për shkak të rrethanave historike, për shkak të pamundësisë për t'i ndryshuar këto rrethana, vetë është një tragjedi e mbaruar, të thuash e përsosur, me të gjitha aktet e saj. Njësoj si heronjtë e antikës, për shkak të këtyre dy rrethanave konkrete dhe universale, arbëreshi është i dënuar me dhembje të përjetshme, me pësime dhe fatalitet. Në këtë rreth motivor sillen thuaja shumica e këngëve të Rapsodive.... Prandaj, shikuar nga ky prizëm, arti i tyre është esencial, sepse shpreh një gjendje pafundësisht të përsëritshme për vetë njeriun dhe qenien e tij në këtë botë, sikundër që shpreh edhe kompleksin e rrethanave gjithashtu të përsëritshme të fatit tonë kolektiv. Rrallë do të gjendet një histori kaq artistike dhe kaq e plotë e një kolektiviteti që jeton midis kujtesës për ndodhi të largëta dhe ëndrrës se ky iluzion mund të bëhet realitet. Arbëreshi i Rapsodive... ka bërë veprimin më artistik, të cilin arti e ka synim të vetin në përgjithësi: braktis dhe anashkalon një realitet të zymtë, të pamundshëm, dhe e zëvendëson atë me botën fiktive. Ai krijon botën e ëndrrës dhe të kujtesës dhe asaj i jep përmasat e një hapësire ku jeta është e mundshme, e durueshme, ku ajo ka një kuptim. Ky shndërrim i botëve është vetë arti, sepse që në zanafillën e tij ky art nuk ka synuar gjë tjetër, pos që t'i japë dimensione reale botës së ëndrrës dhe të fiksionit.

Së dyti, Rapsoditë... i bën art të lartë dhe të papërsëritshëm një tjetër esencë: kondensimi i madh i figurave, pra, të kënduarit dhe të rrëfyerit përmes figurshmërisë, e cila nuk shtrihet vetëm në rrafshin e gjuhës, por në shumicën e rasteve është qenësi e ligjërimit. Pra, metafora, në shumicën e këngëve të Rapsodive..., por në disa syresh në mënyrë të veçantë, nuk ka

vetëm funksion të jashtëm, ta themi kushtimisht, stolisës dhe zbukurues, por vihet në funksion të krijimit të situatave rrëfimore, të cilat në këtë mënyrë bëhen poezi e mbaruar. Trimi e puth vashën arbëreshe, ajo skuqet dhe e lan faqen në lumë, dhe rrobat që i lanin gratë poshtë rrjedhës, nuk zbardheshin, por skuqeshin. Metafora të këtilla, t'i quajmë rrethanore, do t'i gjejmë me shumicë në këngët e Rapsodive..., veçmas të atyre që kanë tingëllimë elegjiake ose baladike. Përveç kësaj, në ligjërim hetohet një saktësi e madhe në përdorimin e fjalës, që quhet ndryshe kondensim i shprehjes: vargu është i shkurtër dhe, jo rrallë, me lëvizje të shpejta të panelit gjuhësor dhe figurativ, krijohen imazhe të papërsëritshme.

Për mendimin tim, një prurje e veçantë e këtyre Rapsodive..., bashkë me një pjesë të mirë të letërsisë arbëreshe në përgjithësi, është tematika kalorësiake dhe aristokrate, e cila në këto vepra dimensionohet përmes personazheve, situatave dhe të një fondi fjalësh e shprehjesh që vihen në përdorim. Për shkak të rrethanave socialkulturore dhe historike të krijuara më vonë, kjo frymë *aristokrate* e letërsisë shqipe nuk do të përsëritet më në letërsinë shqipe, madje do të harrohet shpejt, bashkë me depërtimin e fuqishëm të frymës *plebeje* në poezinë dhe përgjithësisht në letërsinë tonë. Duke marrë për bazë faktin se sot letërsia në përgjithësi është sinkretike, që domethënë se asimilon në mënyrë të pakufizuar përvoja të ndryshme, një rishikim i kësaj tradite nga ana e letërsisë sonë bashkëkohore do t'i ndihmonte asaj të rivendoste një kod të ri komunikimi me këtë përvojë dhe, që është po kaq më rëndësi, përveçqë do të mbushte një vakuum historik, do t'i jepte poezisë sonë, por edhe letërsisë në përgjithësi, shtysën për t'u kthyer te esencat e saj, për t'u bërë art i pastër, i lartë dhe fisnik, një art që diferencohet vetvetiu nga prurjet tepër të dyshimta të asaj poezie që mund të shkruhet nga të gjithë.

Prandaj, konsideroj se rileximi aktiv i Rapsodive... vetvetiu krijon shije të kultivuar letrare dhe njëkohësisht krijon ndjenjë refuzimi ndaj kooperativizmit letrar, që ene është i pranishëm fuqishëm në mbarë letërsinë tonë.

STUDIME, ARTIKUJ

PAPERS

Shaban SINANI, Tiranë

ALFABETET SI KUFI: KUR DHE SI U SHTHURËN QARQET

KDU 811.181’351-112(093.2)
811.18-112(093.2)

(Përmes historisë së dorëshkrimeve)

Në studimin monografik *Për gjenezën e literaturës shqipe* (1938-1939) E. Çabej pati shprehur mendimin se letërsia shqipe për afro katër shekuj me radhë është zhvilluar në formën e qerthujve letrarë, që nuk e nji njëri-tjetrin, që funksiononin si nënsisteme, të cilët nuk arrinin të bëheshin pjesë e një sistemi letrar kombëtar:

> *Studimi literar duhet të fillojë te kontributi i fisit, sepse ky përbën një komponente me rëndësi të literaturës shqipe ... Më është mbushur mëndja prej vjetsh që një ndarje e drejtë e literaturës shqipe nuk duhet të dahej prej periudhash historike... Brenda literaturës shqipe un shoh të jenë formuar katër qarqe kulturore e literare. Janë kto: Qarku katolik i Shqipërisë Veriore, Qarku italo-shqiptar, Qarku ortodoks i Shqipërisë Jugore, dhe së fundi Literatura kombëtare e shekullit të XIX*[1].

Çabej argumenton se këto *qarqe parakombëtare* më në fund *derdhen të gjitha në lumin e përbashkët të literaturës nacionale të shekullit XIX*.

Teza e qarqeve dhe e qerthujve letrarë është përkrahur prej shumë studiuesish dhe i përgjigjet një gjendjeje historiko-letrare analoge me të. Ndërkaq, pyetja se kur dhe me çfarë rendi këto qarqe nisën të komunikojnë me njëri-tjetrin, duke kuptuar me këtë historizimin e procesit, nuk është shtruar.

---

[1] E. Çabej, *Për gjenezën e literaturës shqipe*, në *Hylli i Dritës*, vjeta XV, 1/1939, f. 134-135.

Jashtë çdo dyshimi, ishte romantizmi i Rilindjes Kombëtare ai faktor kulturor e letrar që homogjenizoi zhvillimin e letërsisë shqipe. Por a kanë qenë gjithnjë qarqet letrarë ishuj të fortifikuar, pa asnjë dritare komunikimi mes tyre? Dhe a ishte përgjegjësi përjashtimore e letërsisë vetë, që ndër shekuj u trashëgua ky zhvillim i ishullzuar? Më së paku projektimi i qarqeve si fytyrë e procesit historik të letërsive shqipe relativizohet vetvetiu prej faktit që hapësira shqiptare nuk ekzistonte si e tillë deri në shekullin XX, për shkak të ndarjes së saj në katër vilajete, ndarje që mbitheksohej prej sistemit përdallues të mileteve. Madje dhe brenda *miletit gjaur* (*gavur milliyet*) politika perandorake kishte zyrtarizuar një hierarki të dyfishtë: bashkësia ortodokse e kishte qendrën në Konstantinopojë dhe ishte pjesë e protokollit shtetëror zyrtar të perandorisë, kurse bashkësisë së të krishterëve romanë i pengohej lidhja tradicionale e jashtëvartësisë hierarkike dhe kanonike me Selinë e Shenjtë.

Jo rastësisht, në emërtimin e qarqeve, E. Çabej përdor terma të dyfishtë, me një përbërëse gjeo-rajonale dhe me një përbërëse fetare. Këtyre faktorëve kufizues u shtohej dhe një kufi i ri: ai i alfabeteve. Së paku tre prej tyre luanin rol të dyfishtë: përbashkues brenda një komuniteti dhe largues e përjashtues ndaj të tjerëve. Hegjemonia e ideologjisë romantike, me përcaktimet e vetë E. Çabejt, erdhi jo nga ndonjë proces kulturor që ndodhi brenda Shqipërisë, por së jashtmi, atje ku multialfabetizmi ishte dukuri historike, sepse *letërsia shqipe e Rilindjes u zhvillua si letërsi mërgimi*. Këto argumente E. Çabej i ka rivizituar edhe në studimin *Romantizmi në Evropën Lindore e Juglindore dhe në literaturën shqiptare*, shkruar në vitin 1945 dhe botuar më 1994.

Është pikërisht tradita e dorëshkrimeve, kodikë ose të afërta me to, që mund të ofrojë të dhëna se kur qarqet letrare në Shqipëri nisin të interesohen për njëri-tjetrin. Çështja e multialfabetizmit që sundon në këto dorëshkrime dhe e tejkalimit të tij është njëherësh dhe çështje e kalimit prej nënsistemeve autonomë të letërsisë shqipe në letërsi kombëtare.

1. Shkrimet dhe dorëshkrimet e shekujve XVI-XVIII provojnë se kufijtë e qarqeve u dobësuan e u thyen shumë kohë para se të vinte shekulli i romantizmit. Në pikëpamjen kronologjike, qarqet që e kanë njohur më herët njëri-tjetrin janë ai i shkrimtarëve katolikë të Veriut dhe i shkrimta-

rëve italo-shqiptarë. Kjo ka të ngjarë të ketë ndodhur shumë më herët se sa zakonisht mendohet. Prej kohësh janë vënë re bashkëpërkime jorastësore morfologjike, që lartësohen deri tek shenja të sistemit, midis *E mbsuame e krështerë* të L. Matrangës dhe veprave të P. Budit e të shkrimtarëve të tjerë katolikë veriorë: grupi *ua* i alternuar herë-herë me grupin *uo*; dy format e së ardhmes analitike me ndihmëset *kam* dhe *do* etj.[2] Deri vonë këto përtakime janë konsideruar si shenja të konvergjencës së brendshme gjuhësore të shqipes, më të forta në shekujt paraosmanë se më vonë. Por tashmë janë parashtruar hipoteza që i japin rëndësi më shumë kontaktit historik midis autorëve/ shkrimtarëve të këtyre dy qarqeve se gjendjes hipotetike gjuhësore të shqipes paraosmane.

Ndër të tjera merr rëndësi fakti që italo-shqiptarët e Sicilisë e të Kalabrisë, duke themeluar kishën e tyre, kishë e të krishterëve uniatë, gjendeshin nën të njëjtën varësi me të krishterët romanë të Shqipërisë, nën autoritetin e Selisë së Shenjtë, e cila, për qëllime pragmatike, për të lehtësuar punën e vet, mund të përdorte klerin e njërës bashkësi edhe tek bashkësia tjetër, çka provohet në mënyrë të katërciptë në shekujt XVII-XVIII (në këta shkekuj madje edhe mes tyre dhe të krishterëve ortodoksë). Pjesë e kësaj lidhjeje jo vetëm të mundshme, por dhe të vërtetueshme, është njohja e drejtpërdrejtë e klerikëve gjatë vizitave të tyre ordinare në Romë, sidomos ngarkimi i tyre me detyra që kanë të bëjnë posaçërisht me shkrimin. Është i njohur fakti që meshtarë shqiptarë, duke përfshirë shkrimtarët katolikë të Veriut, janë ngarkuar me përgjegjësi që lidhen me procesin e kanonizuar të lejimit të letërsisë ungjillore-liturgjike, *usus scribendi*, prej fazës së mbikëqyrjes, deri tek *aprobbatur* e *imprimatur*. Rasti i Frang Bardhit, si njeriu i ngarkuar nga *Propaganda Fide* për autorizimin e një botimi, nuk duhet të jetë i vetëm.

E guximshme, por jo pa një bazë agrumentimi, është hipoteza e parashtruar së fundmi nga A. Omari, që sheh në njërin prej dorëshkrimeve të *E mbsuame e krështerë* të Lekë Matrangës, pikërisht në *Dorëshkrimin A*

[2] Shih B. Demiraj, *E ardhmja e tipit do + lidhore si dukuri mbarëgjuhësore, dialektore dhe ballkanike në shqipe*, në *Shqipja dhe dhe gjuhët e Ballkanit*, AShAK, Prishtinë 2012, f. 37 e vijim.

(që, siç ishte në praktikën e botimeve të lejuara prej *Propaganda Fide*-s, iu dha për revizionim rishikuesit Tommaso Raggio), disa kompetenca gjuhësore që nuk mund të ishin të një alogloti, për më tepër të një alogloti që s' ka lënë ndonjë shenjë se kishte njohuri qoftë dhe minimale për shqipen:

> *Meqenëse Raggio nuk del ta ketë njohur shqipen, ai mund të jetë ndihmuar nga ndonjë prift që e njihte këtë gjuhë, pas gjase edhe nxënës i Kolegjit grek, ku kishte mjaft shqiptarë të ardhur nga bregu tjetër i Adriatikut e sidomos nga Himara*[3].

Nëse kjo hipotezë do të provohet, kjo mund të konsiderohet pika zero, më e hershme, e kontakteve të qarqeve parakombëtare me njëri-tjetrin.

Duke tentuar që, nëpërmjet analizës historiko-gjuhësore, të ndërtojë profilin gjuhësor të redaktorit anonim të ngarkuar nga T. Raggio për rishikimin e dorëshkrimit tjetër të Matrangës, të cilësuar si *Dorëshkrimi B*, Matteo Mandalà arrin në përfundimin se *ai ka qenë njohës i dialektit gegë të shqipes dhe se vinte nga krahinat veriore të Shqipërisë*. Në këtë përfundim e shpien disa të dhëna gjuhësore që paraqesin karakteristika të fazës së vjetër të gegërishtes, si p. sh. ndërtimi i infinitivit me *me* dhe me pjesoren e foljes, siç dëshmohet në fjalinë *duhetë për me e dijturë*, më pas të prishur me penë; pastaj mungesa e shurdhimit të bashkëtingëlloreve fundore si *erdh*, *të madh*, tipike për të folmet gege, kundrejt trajtave të Matrangës *erth* e *të math* etj. Përveç kësaj në *Dorëshkrimin B* gjenden edhe disa drejtshkrime që të kujtojnë grafinë e Buzukut me ‹*e*› para ‹*nd*-› nistore: *endë krahët, endë kriqt, endë të sosurit*.

Është interesante të vërejmë se këtë veçori drejtshkrimore, që e ka edhe Budi në formë mbeturinore, e rigjejmë edhe te Dhimitër Kamarda, i cili asokohe nuk e njihte veprën e Buzukut. Duket se këto grafi, që hasen edhe në copëza të shkrimeve të hershme shqipe, janë relikte drejtshkrimore të cilat mund të kenë pasqyruar një veçori shqiptimore[4].

---

[3] Anila Omari, *Matteo Mandalà, Lekë Matranga Njeriu, koha, vepra*, Ombra GVG, Tiranë 2013, në *Hylli i Dritës*, Shkodër 2014, nr. 1.

[4] Shih Anila Omari, art. cit., po aty.

Letër shqip e Zef Skiroit, *Arkipeshkv i Durrësit dhe Vikar Apostolik i Himarës në Arbëri*.



· SCIUM ILUMURI AT.

ELumura Caterinæ tæ Riccevet Eberꝛ zaſc e Kalogree e ſceitit Domenikæ, gnera ſaa roi mbaiti ſert, fakienæ, e ſcemæliynæ ætun ſoti Kyè Kriivoi, me paſtriminæ eſaayæ. Pashiſi, eumændua ſaa mænbi tæ ſcæmæteneg ede ſotit Chriſtæ Kyæ na ſcpræblei me vet mundimet etiv. Ma pte me fukiynæ eſay nænc mundi tæ Kiſcktæ te Maꝛe hiir. Yia ꝛuroi vet Chriſëti ſotun me ſcegnet e mundimevet kyæ itipoſi mbæ tæ kriominæ Kuſomæ tæ aſay Aꝛa gnæ vaſc aſëtù ekriumæ, aſëtù e munduaræ, eꝛe kakoe ſcium edæſciuræ caa ſotun, eꝛe aſëti e nderturoe me ſcium ſeegnc tæ ſceitæ riis. Iſët e ggiiggſæ tæ ndeerſc eꝛe ti ſcium Ilumuri At. E tæ ſcruaſc embrin eſaay me tæ tierat ſcietæra vaſcia. Aſëtù ſe tæ yeet, embri e ſe maꝛes ſciet Katerinæ kaa Siena, eꝛe ay i aſay, kiæ iſët caa Fiorenza.

Joſefi Schirò Arçbiſcupu i Durrſit, eꝛe Vicar Apoſtolycu i Hymarrs ndæ Arbænit.

Në këtë kontekst, merr rëndësi pohimi i G. Crispi-t se dy dorëshkrimet që kishte gjetur në bibliotekën e seminarit arbëresh të Palermos, i pari një fjalor italisht-shqip dhe shqip-italisht prej Nilo Catalanos-s dhe i dyti një fjalor i ngjashëm prej N. Chetta-s, *sono scritti con alfabeto italiano moderno, secondo l'uso di Propaganda, dove nel 1635 pur fu stampato un vocabolario titolato 'Dictionarium Latino-Epiroticum una cum nonnullis usitatoribus loquendi formulis'*[5]. Ky njoftim i hershëm i G. Crispi-t në fakt na bën të ditur se prej këtyre dy autorëve ishte përdorur alfabeti latin i shqipes së vjetër dhe që alfabeti i lejuar nga *Propaganda Fide* për shkrimtarët klasikë veriorë kishte një autoritet lejimi (*approbatur*) edhe tek arbëreshët. Për fat të keq dy dorëshkrimet nuk janë gjendur; ato njihen prej burimesh të tërthorta.

Duke iu referuar rendit gjuhësor në procesin e të shkruarit, studiuesit kanë shënuar një vijimësi grafematike prej Buzukut te Budi, Bardhi e Bogdani. Kjo vijimësi kupton jo një afëri intuitive, por prej njohjes së njëri-tjetrit. Pas botimit të fjalorit të Bardhit mund të ketë ndikuar autoriteti i një alfabeti të pranuar nga Propaganda Fide. Por Budi shkroi më parë se boti-

[5] Giuseppe Crispi, *Memoria sulla lingua albanese*, Palermo 1831, p. 5.

mi i këtij fjalori. Një hipotezë mund të jetë që Budi njohu *Mesharin* gjatë pesë vjetëve që ishte sa në Romë, aq në vendlindje. Sa i takon ndikimit *jashtë qarkut* të alfabetit të shkrimtarëve katolikë të Veriut, dihet mirë se ai u përdor në katër letrat që G. Schirò prosenior i pati drejtuar në shqip Selisë së Shenjtë gjatë kohës që ishte arkipeshkëv i Durrësit dhe vikar apostolik në Himarë, në gjysmën e parë të sh. 18. Misionarët arbëreshë e konsideruan atë një alfabet zyrtar, të njohur nga *Propaganda Fide*, dhe e zgjodhën mes mundësish të tjera atëherë kur erdhi momenti historik që shqipja të paraqitej si gjuhë zyrtare. Kjo është data më e hershme që mund të njihet si pika e fillimit të përdorimit të shqipes në funksione zyrtare[6].

Zgjidhjet grafematike për tinguj e vlera fonologjike të shqipes që nuk kanë shenja gjegjëse në alfabetin e latinishtes, që afrojnë jo vetëm shkrimtarët katolikë të Veriut mes tyre, por dhe këtë qark me shkrimtarët italo-shqiptar, deri vonë janë konsideruar gjithashtu të shpjegueshme me natyrën e gjuhës vetë. Por gjithnjë e më e shqiptuar rezulton tashmë prirja e vërtetimit të një prekjeje historike të drejtpërdrejtë të dy stilemave të të shkruarit. Këtu nuk është fjala për kohën e misionarëve basilianë në Shqipërinë bregdetare, prej Durrësit deri në Himarë; për mënyrën si shkruan në shqip G. Schirò prosenior në katër letrat e tij të njohura drejtuar Selisë së Shenjtë[7]; apo për rishfaqjen e grafemave specifike të shkrimtarëve veriorë edhe tek shkrimtarë arbëreshë të periudhës romantike, por për një kohë më të hershme. Mjetet grafematike që kanë përdorur disa autorë të qarkut katolik verior, si Gj. N. Kazazi, provojnë se ky e kishte njohur veprën e Matrangës, sepse përdor pikërisht grafemat e tij edhe për një tingull shumë problematik në stabilizimin alfabetik si zanorja *ë*. Madje edhe F. Bardhi e përdor dy herë shkronjën e Matrangës për *ë*-në. Kurse Budi nuk e dallon fare grafematikisht zanoren *ë* në shkrim.

Kemi pasur rastin të sjellim në vëmendjen e dijes njoftimin që pati bërë të ditur Miroslav Vanino në vitin 1927, *për shtypjen në Romë, në vitin 1584, të 500 katekizmave në gjuhën shqipe*, në monografinë e tij për Aleksandar Komulović-in. M. Vanino shenjon për saktësi se A. Komulović qe

---

[6] Në *Papa Benedictus XIV, Opera Omnia*, Roma 1767, p. 81, 121, 143v., 166v., 190.

[7] Bardhyl Demiraj, *Zef Skiroi dhe shkrimet shqip*, në *ANASH*, nr. 2/2006, f. 7-14.

i shoqëruar në këtë mision nga një *nxënës i Kolegjit Ilirik*[8]. Dihet mirë se katekizmi i përkthyer prej P. Budit u shtyp në vitin 1618, d.m.th. 32 vjet më vonë. Por a mund të kishte qenë ky nxënës i Kolegjit Ilirik pikërisht Pjetër Budi, siç pati hamendësuar herët G. Valentini? Dihet mirë se nuk pati ndonjë botim katekistik në shqip në vitin 1584, siç dihet, prej letrave të vetë P. Budit, se botimi i veprave të tij gjithnjë ka ndodhur me mjaft vonesë. Tash së fundmi M. Mandalà shton argumentin se ndoshta Pjetër Budi mund të ketë qenë *nxënësi i Kolegjit Ilirik* që shoqëroi A. Komulović-in dhe Tommaso Raggion në vizitën e tyre apostolike në Shqipëri[9].

Të dhënat për jetën e Budit, mbështetur nga parathëniet e pasthëniet shqip të veprave të veta, nga letra italisht drejtuar kardinalit Gozzadini, si dhe nga një shenjim i Daniele Farlatit në *Illyricum Sacrum*, janë bindëse për të menduar se në vitin 1621 ishte rreth 55 vjeç. Për vendlindjen e tij, Guri i Bardhë i Matit, vetë Budi, në letrën Gozzadini-t, thotë se është *fortesë e Matit*. Po në këtë letër ai thotë se është *nga shtëpia e Budëve të vjetër*. Duke qendruar pranë dhe në shërbim të disa ipeshkvinjve të dioqezave shqiptare, Budi mori njohuritë e domosdoshme për të marrë sakramentin e

---

[8] Miroslav Vanino, *Aleksandar Komulović (1548-1608)*, Hrvatsko kulturno društvo, *Napredak*, Sarajevo 1935, st. 44: Në fillim të vitit 1584 vizitatorët u nisën nga Roma përmes Ankonës, Hvarit dhe Dubrovnikut për në Shqipëri, duke sjellë me vete bashkë me mesharët e libra të ndryshëm edhe objekte të shumta sakrale, të cilat do t'ua dhuronin priftërinjve dhe popullit. Në Romë shtypën 500 katekizma në gjuhën shqipe. Ata u shoqëruan nga tre shqiptarë: prifti Duka Armani, i cili në vitin 1590 u bë peshkop i Shkodrës, një nxënës i Kolegjit ilirik dhe një tjetër shqiptar i shkolluar, i cili do të ndihmonte këtë nxënës në mësime: *Na poćetku g. 1584 krenuše vizitatori iz Rima preko Ancone Jakina, Hvara i Dubrovnika u Albaniju, ponešavsi uz misale i razne knjige još mnogo nabožnih predmeta, kojima ce darivati svećenike i narod. U Rimu su dali otisnuti 500 katekizama na albanskom jeziku. Pratila su ih tri albanca: svećenik Duka Armani, koji je g. 1590 postao skadarski biskup, jedan djak Ilirskog Kolegija i još jedan školovani albanac, koji će toga daka pomagati u poućovanju*, st. 44, vep. cit. Sh. Sinani, *Një Shqipëri tjetër*, Tiranë 2006, f. 194-195. Të njëjtin fakt e përmend edhe L. Tacchella, në *Il cattolicesimo in Albania nei sec. XVI e XVII*, Verona, 1984, f. 76, me citim tek *Archivum Rom. Soc. Jesu*, ital. 171, fol. 398.

[9] Matteo Mandalà, *Lekë Matranga: njeriu, koha, vepra*, Tiranë 2013.

priftërisë[10]. Kjo ishte një praktikë e përhapur ndër viset e pushtuara prej ushtrive osmane. Ndoshta Budi thjesht është regjistruar në kolegj në Romë, fakt që e përmend Farlati, por, kur u dorëzua prift, në vitin 1587, duhet të jetë marrë në vlerësim vetëformimi i tij pranë ipeshkvinjve[11]. Për 12 vjet shërbeu si meshtar i thjeshtë në *dioqezën e Serbisë* dhe për 17 vjet të tjerë si zëvendës i përgjithshëm (*vicario generale*) i arkipeshkvit të Tivarit. Marin Bici, vizitator apostolik i atyre dioqezave në vitin 1610, e ka njohur Budin dhe e ka vlerësuar si *prift mjaft të mençur e me veti të mira*. Në Romë ai ka qenë në vitet 1616-1621, për të shtypur libra shqip, por edhe për të siguruar përkrahjen e jashtme për planin e një kryengritjeje shqiptare kundër turqve. Pikërisht sa ndodhej ende në Romë, më 10 korrik 1621, Budi emërohet ipeshkëv i Zadrimës (Sapës). Por në kohën kur Budi gjendej në Romë, Tommaso Raggio ishte ndarë nga kjo jetë (1609).

Një mundësi takimi mes tyre mbetet në kohën kur T. Raggio erdhi në Ballkan si vizitator apostolik, kohë kur ai mund të ketë shkuar dhe në Shkup, për hapjen e një shkolle fetare. Dh. Shuteriqi përmend një shkollë *në formë kolegji* të hapur nga kleri katolik në fshatin Letnicë në Mal të Zi të Shkupit në vitin 1584, si fakt që mund të ketë lidhje pikërisht me vizitën apostolike që bëri në Shqipëri e Bullgari T. Raggio me A. Komulović-in nga viti 1584 deri në 1587[12]. Por nuk përjashtohen dhe mundësi të tjera të njohjes së Budit me meshtarët arbëreshë e shkrimet e tyre.

Në vitin 1621, në vjeshtë, imzot Pjetër Budi, nësa Turqia ishte e xânë në luftë me Poloninë, përgatiti një kryengritje të përgjithshme

---

[10] Krhs R. Ismajli, *Pjetër Budi dhe vepra e tij*, në *Pjetër Budi, Poezi* (parathënia, tejshkrimi dhe komentet nga R. Ismajli), AShAK, Prishtinë 2006, f. 14-15.

[11] Pjetër Budi, në pasthënien e *Pasëqyrës së t'rrëfyemit* (1621), shkruan: *Posikundërse sā tjerë shok të e tu, ende u me ta, që Zotȳnë mā di se shkollënë e kolegjënë veçëse nda kam pām n cë lerg ō gjegjunë emënit, ndish asndonjë fjalë të vetëme ndër to xanë s'e kam, as gjegjunë, mā gjā p'r ata s'mun i pronem fajt ... tue pasunë gjithërherë gjegjunë, e pam, e xan, e pyetunë ndaj sā upeshkëpinj, e fratënë*. Citohet sipas R. Ismajlit, *Pjetër Budi*, *Poezi* (parathënia, tejshkrimi dhe komentet), AShAK, Prishtinë 2006, f. 14.

[12] Dh. Shuteriqi, *Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800*, AShSh, IGjL, Tiranë 2005, f. 118; S. Riza, *Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe*, Vepra I, Prishtinë 1996.

kundër Turqisë dhe shtroi planin e luftës për çlirimin, tue përcaktue edhe numrin e luftarëve që përmblidheshin në 30.000 vet, dhe i njoftoi Vatikanit me letër se asht marrë vesh me krenët e vendit, myslimanë e të krishtenë. Pesë herë shkoi në Romë, për t'i kja hallin Shqipënisë dhe me kërkue ndihmë, po t'mos ishte vdekja e papritun, qe mbytë në Dri në vitin 1623, ndoshta Shqipnia do të ishte shkëputë që asokohe nga zgjedha turke[13].

Sipas një njoftimi të hershëm të G. Crispi-t, gjatë shërbimit të tij si misionar në Himarë, murgu basilian *Nilo Catalano* kishte përgtitur *një fjalor shqip-italisht e italisht-shqip* (*Vocabolario albanese-italiano ed italiano-albanese*), me një sprovë gramatike të shqipes (*con un saggio di grammatica in fine*), që ruhej deri në vitin 1831 në bibliotekën e seminarit arbëresh të Palermos[14]. Në këtë fjalor një shumicë fjalësh paraqiteshin në formën gege. Në fund fjalori shoqërohej me pjesë të zgjedhura folklorike e letrare (*sono inserite alcune canzoni albanesi, ma con l'alfabeto greco*), midis të cilave *një variant i këngës së Pal Golemit*[15] dhe dy vjersha tetëvargëshe prej veprës *Cuneus prophetarum* të P. Bogdanit.



Vula e thatë e Dom Nikollë Kazazit në letrën drejtuar At Giorgio Guzzetta-s.

Nuk mund të jetë rastësi fakti që zbulimin e *Mesharit të Gjon Buzukut* më 1740 ipeshkvi i Shkupit Gjon Nikoll Kazazi prej Gjakove ia

[13] Gjush Sheldija, *Kryeipeshkvia metropolitane e Shkodrës dhe dioqezat sufragane* (*shënime historike*), Shkodër 1958, f. 6.

[14] Giuseppe Crispi, *Memoria sulla lingua albanese*, Palermo 1831, p. 5.

[15] Anton N. Berisha, *Interpretime të letërsisë së arbëreshëve të Italisë*, Pellegrini editore, Cosenza 2008, p. 39.

bën të ditur menjëherë dhe me entuziazëm At Giorgio Guzzetta-s, themeluesit dhe rektorit të parë të kolegjit arbëresh të Palermos[16]. Letra e Kazazit për Guzzetta-n deri në vitin 1967 ruhej në arkivin e seminarit në Palermo. Më pas, origjinali, bashkë me shumë dorëshkrime shqip, u zhvendos në fondin *Albansk Samling* të Bibliotekës Mbretërore të Kopenhagës, ku gjendet dhe sot[17]. Matteo Mandalà, duke iu referuar disa burimeve arkivistike, mendon se bashkë me këtë letër duhet të ketë qenë dhe një relacion për gjendjen kishtare në Shqipëri[18]. Një njoftim i fundmë i studiuesit B. Demiraj, me referim në veprën e N. Chetta-s, se në seminarin arbëresh të Palermos *ruhet një dorëshkrim ritual në gjuhën tonë, kopjuar nga origjinali i Propaganda Fide prej imzot Zassi-s, e hartuar nga Donich Buzuku*, mund të ndryshojë në mënyrë të rëndësishme kalendarin historik të njohjes së librit të parë shqip[19]. Filoteo Zassi, për një kohë misionar basilian në Shqipëri, jetoi në një periudhë më të hershme se viti 1743, kur Kazazi zbuloi për herë të parë *Mesharin*[20]. Letra e N. Kazazit drejtuar

---

[16] Matteo Mandalà, *La lettera inedita (1740) di Mons. Nicola Kazazi a P. Giorgio Guzzetta*, në *Βίβλος*, nr. 4/1994. Ndër të tjera Mandalà sjell në vëmendje pohimin e Nicolò Chetta-s, në *Tesoro di notizie su de'Macedoni* (a cura di Matteo Mandalà e di Giuseppa Fucarino, Palermo-Contessa Entellina 2002, f. 508-509: *In Seminario abbiam un ritratto con quest'elogio: Joannes Battista Nicolovich Casasi Scuporum, seu Scopiensis, et totius regni Serviæ ahministartor, nec non visitator apostolicus in regno Bulgariæ, genere Albanensis, natus Jacovæ in Servia, consacratus Romæ 29 settembre 1743. aetatis suo ann. 42 prë sciùmë vièt. In Roma egli divenne amico del p. Giorgio Guzzetta, che fe fare il sudetto ritratto.*

[17] M. Sciambra është një prej studiuesve që pati mundësinë ta këshillojë vetë këtë letër në *Albansk Samling*, pa fletën e parë, në të cilën duhej të gjendeshin dy fragmentet e kopjuara nga *Meshari*. Shih nga M. Sciambra: *Paolo Maria Parrino, scrittore siculo-albanese*, në *Shêjzat*, nr. 5-8/1967, Romë 1967, f. 296.

[18] M. Mandalà, *Meshari i Buzukut në Sicili*, në *Milosao*, 18 maj 2014.

[19] B. Demiraj, *Jeta dhe veprimtaria e Gjon Pagëzues Nikollë Kazazit (në materialet e Arkivit Historik të Kongregatës së Shenjtë)*, në *Studime*, nr. 11, AShAK, Prishtinë 2005, f. 359-361.

[20] M. Mandalà, art.. cit.: *Filoteo Zassi, i cili lindi më 1654 në fshatin arbëresh të Mezzoiuso-s në Sicili, vdiq në Romë më 1726, pra, shumë vjet më përpara se Kazazi t'i shkruante letrën at Guxetës. Sikur të konfirmohej njoftimi i Ketës, gjithë historia e zbulimit të Mesharit do të duhej rishikuar*.

Guzzetta-s ka qenë e përmendur prej shumë kohësh. Ishte pikërisht G. Crispi ai që jo vetëm e citoi këtë letër i pari, por dhe botoi dy fragmente prej *Mesharit* tejshkruar prej Kazazit me alfabetin e tij[21], duke qenë kështu botuesi i parë i fragmenteve të tekstit të librit të parë shqip. Në studimin monografik hyrës kushtuar *Mesharit* të Gjon Buzukut Eqrem Çabej paraqistorinë e njohjes së librit të parë shqip prej dijetarëve dhe klerikëve arbëreshë (N. Chetta, F. Zassi) nuk e përmend[22].

Po aq e përjashtueshme është rastësia e rizbulimit të librit të parë shqip prej P. Schirò-it, në vitin 1907, dhe mbi të gjitha transkriptimi tërësor i tekstit të *Mesharit* prej tij, një dorëshkrim mbi 800 fletësh i zbuluar së fundmi nga M. Mandalà; duke qenë kështu e para përpjekje për ta riintegruar atë sërish në bibliotekat shqiptare, shumë më e hershme se botimet kritike të E. Çabejt, N. Ressulit dhe sprova të ndonjë tjetri[23]. Paolo Schirò *iu vu studimit të veprës së Buzuku me qëllim që të përgatiste një rishtypje, duke njoftuar për këtë gjetje të rëndësishme gazeta dhe periodikë të ndryshëm shqiptarë të kohës e duke botuar një artikull me gërma të prera enkas, të ngjashme me ato të origjinalit.* Schirò-i botoi qysh në vitin 1935 një studim hyrës për *Mesharin,* duke pasur dhe bashkëpunimin e papas Gaetano Petrotta-s[24]. Dorëshkrimi i Schirò-it mban titullin *I testi biblici in lingua albanese di dom Gjon Buzuku, messi in ordine, con traduzione italiana e note* dhe përfshin qindra fletë dorëshkrim të mbledhura në tre fa-

---

[21] Giuseppe Crispi, *Memorie storiche di talune costumanze appartenenti alle colonie greco-albanesi di Sicilia,* në *Studi Albanesi: storici, folklorici, linguistici* (a cura di Matteo Mandalà), *Studi e testi albanesi* 3, A. C. Mirror, Palermo, 2003, f. 128-129.

[22] *Zbulimi i parë i këtij libri i detyrohet Dom Nikollë Kazazit prej Gjakove, kryepeshkop i Shkupit, në vitin 1740. Ky kopjoi një copë të këtij 'antichissimo Missale per antichità tutto strachiato' dhe ia dërgoi si peng nderimi At Gjergj Guzetës, themeluesit të Seminarit arbëresh të Palermos.* Citohet nga E. Çabej, *Gjon Buzuku dhe gjuha e tij*, në *Studime gjuhësore*, vëll. VI, Rilindja, Prishtinë 1977, f. 5.

[23] Matteo Mandalà, art. cit., *Milosao*, maj 2014.

[24] Gaetano Petrotta, *Gaetano Petrotta e Paolo Schirò* (prefazione), në *Il più antico testo di lingua albanese: Gjon Buzuku (1555)*, botuar në *Rivista indo-greco-italica di filologia, lingua e antichità*, 1935, f. I.

shikuj të trashë. Kjo vepër, e ruajtur në arkivin e familjes Schirò, u bë e njohur për herë të parë nga M. Mandalà, i cili iu drejtua mjediseve shkencore me thirrjen për mundësimin e botimit të saj, si një ndihmesë filologjike e patejkaluar, qoftë në tejshkrim, qoftë në pjesën studimore.

"*Nisur nga hamendja se grafia e Mesharit paraqiste tipare johomogjene dhe zgjedhje alfabetike që nuk kishin lidhje me traditën tipografike perëndimore, Skiroi vendosi të vinte përkrah transkriptimit normal të tekstit, edhe një riprodhim në kufijtë e besnikërisë mekanike që sot sigurohet vetëm nga makinat, përmes një rishkrimi diplomatik të tekstit*[25].



Fleta e parë e dorëshkrimit prej mbi 700 fletësh të 'Mesharit të Gjon Buzukut', transkriptuar me parime shkencore filologjik nga G. Schirò, ende i pabotuar.

[25] Matteo Mandalà, art. cit., *Milosao*, maj 2014.



Dorëshkrimi i Piana degli Albanesi, 1924, kopjim i stilizuar i Ungjillit sipas Mattheu-t përkthyer nga Vangjel Meksi, Korfuz 1924

Me një rëndësi kohëndryshuese janë të dhënat e ofruara nga Lucia Nadin për praninë e shqiptarëve në Venetik menjëherë pas pushtimit osman, për shkollën e tyre dhe mbi të gjitha për mundësinë e shtypjes së *Mesharit* atje[26], të dhëna që e kanë çuar studiuesin Matteo Mandalà në përfundimin se libri i parë shqip ndoshta nuk iu drejtua asnjëherë një mjedisi këndej Adriatikut. Nuk kishte nevojë që dikush ta sillte librin në Itali nga Ballkani, sepse libri ka qenë gjithmonë në Itali, shkruan Mandalà, duke vijuar me pyetjen: a e ka kapërcyer ndonjëherë *Meshari* i Buzukut Adriatikun? A është përdorur ndonjëherë në Shqipëri? Pra, kërkimi duhet të nisë jo me pyetjen se si mbërriti *Meshari* në Romë dhe pse nuk gjendet i listuar në *index librorum prohibitorum*, por anasjelltas, a u përkthye ai për dhjetëra meshtarë katolikë që kishin ndjekur pas grigjën e tyre dhe ishin

[26] Lucia Nadin, *Proposta di rilettura delle pitture di Paolo Veronese in San Sebastiano a Venezia: Scanderbeg Miles Christi, e la Chiesa di Albania*, në *Ateneo Veneto*, anno CXCVIII, 10/II, 2011.

vendosur në Venetik, duke themeluar shumë shpejt madje dhe një shkollë të tyre, *Scuola degli Albanesi*, ku supozohet që mësimi i edukimit kishtar (katekizmit) të jetë bërë përmes librit të parë shqip[27].

Roli që luajtën kolegjet italo-shqiptare në Kalabri e në Sicili për formimin e klerit katolik shqiptar është më se i njohur. Veprimtaria e këtyre kolegjeve i shprishi muret midis dy qarqeve gjeorajonale e fetare që përshkruan E. Çabej shumë më herët se fillimet e Rilindjes Kombëtare.

2. Në rend të dytë tejkalimi i kufijve që shkrimet dhe dorëshkrimet e shqipes dhe të shqiptarëve i kishin trashëguar edhe prej alfabeteve, në pikëpamjen kronologjike, sërish lidhet me qarkun e shkrimtarëve italo-shqiptarë. Këto lidhje i lehtësoi shumë fakti që në kishat e arbëreshëve zbatohej liturgjia bizantike dhe kjo e bënte gjuhën greke dhe alfabetin e saj të afërt me të. Për më tepër, një pjesë e shkrimtarëve dhe studiuesve të qarkut italo-shqiptar, duke përfshirë D. Camarda-n, kishin në përdorim alfabetin e greqishtes.

Se cili ka qenë roli i klerikëve italo-shqiptarë në shekujt XVII-XVIII në viset jugore të Shqipërisë, sidomos në Himarë, nga popullsia e së cilës kërkohej, përmes letrash që zgjatën disa shekuj, njohja prej Selisë së Shenjtë si të krishterë uniatë, kjo çështje është certifikuar plotësisht prej N. Borgia-s në librin e tij *I monaci basiliani d'Italia in Albania*, botuar në dy pjesë në Romë më 1935-1937 dhe më 1942[28]. Misionarët basilianë *ishin kryesisht italo-shqiptarë*[29], shkruan N. Borgia, domethënë arbëreshë. Ata

---

[27] Matteo Mandalà, art. cit., *Milosao*, maj 2014.

[28] Krhs dhe Giuseppe Schirò, *La missione del monaci basiliani d'Italia in Albania*, në *Roma e I'Oriente*, nr. 26, dicemb. 1912, pp. 97-117; po aty, nr. 27, genn. 1913, pp. 159-166; po aty, nr. 34, sett. 1913, pp. 209-231.

[29] Nilo Borgia, *Murgjit bazilianë në Shqipëri*, bot. *Naimi*, Tiranë 2014, f. 21: ... do t'i japim plotësisht të drejtë Shenjtërisë së Tij, Papa Pio XI (*Enciklikë e shkurtit 1926*), për kriteret e mençura në përzgjedhjen e misionarëve, duke ua besuar shërbimet apostolike edhe vendësve: *meqenëse prifti vendës ... për shkak të origjinës, karakterit, ndjenjave dhe prirjeve, përshtatet lehtë me të vetët.* Misionarët ishin shqiptarë. Misioni i Himarës lulëzoi për aq kohë sa iu dha mundësia murgjve italo-shqiptarë të merrnin pjesë në to.

jo vetëm inkurajuan kishën uniate në këto vise, por dhe hapën shkolla e vepruan si njerëz të kultit e të kulturës. Këtyre fakteve u shtohet ekzistenca e një dorëshkrimi të *Ungjillit sipas Matteut*, që ruhet prej vitit 1824 tek arbëreshët dhe që filologjikisht mund të vërtetohet si një *kopjim i stilizuar* i tekstit të përkthyer prej Vangjel Meksit, një prej përkthimeve më të hershme ungjillore. Ngjashmëritë midis *Anonimit Epirot*, siç e pati quajtur G. Schirò dorëshkrimin e *Piana degli Albanesi*, me përkthimet asokohshme të Biblës (V. Meksi, 1824; G. Gjirokastriti, 1827)[30], janë të karakterit sistemor dhe vërtetojnë kopjimin e tij të lirë prej të njëjtit tekst të përkthyer. *G. Schirò-i, sipas fjalëve të tij, ka pasur në zotërim një dorëshkrim të Ungjillit të Mateut, hartuar toskërisht aty nga viti 1700, si dhe një Doktrinë kristiane të vitit 1755, gjithashtu toskërisht*[31]. Po nga Schirò kemi njoftimin se kishte pasur në duar një tjetër *Doktrinë kristiane*, të shkruar nga një himariot në vitin 1637, mbetur pa botuar me sa duket për shkak se një vepër katekistike me të njëjtin titull në shqip ishte botuar më herët nga P. Budi. Si ra në duar të kopjuesve arbëreshë përkthimi i G. Gjirokastritit; si u gjendën tekstet e hershme të letërsisë ungjillore-katekistike midis arbëreshëve, është një prej çështjeve më interesante për vërtetimin e lidhjeve midis qarkut italo-shqiptar dhe qarkut ortodoks të Jugut të Shqipërisë shumë kohë para shpalljes së programeve të Rilindjes Kombëtare. Studiuesi Gëzim Gurga, në një varg artikujsh dhe në studimin monografik të doktoratës, ka arritur të provojë pajtimin filologjik të dy teksteve, duke shtuar argumentet për një komunikim mbiqarkor qysh në periudhën pararomantike[32]. Një si-

---

[30] Giuseppe Schirò: *Della lingua albanese e della sua letteratura anche in rapporto alle colonie albanesi d'Italia*, në *Annuario del Reale Istituto Orientale di Napoli*, Napoli 1917-1918, ribotuar nga M. Mandalà, *Giuseppe Schirò, Opere*, vol. VIII, 1996, p. 108.

[31] E. Çabej, *Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre*, në *BSHSH*, 2, Tiranë 1959. Këtu pas ribotimit në *Studime gjuhësore*, VI, *Rilindja*, Prishtinë 1977, f. 332.

[32] Gëzim Gurga, *Il Vangelo di San Matteo: Variante inedita del manoscritto di Piana*, edizione critica, tezë doktorate, Università degli Studi della Calabria, Cosenza 2006. Idem, *Aspetti linguistici del manoscritto dell'Anomino Epirota*, në *Atti del XXVIII Congrèsso Internazionale di Studi Albanesi, 16-19 Maggio 2002* (a cura di M. Mandalà), Università degli Studi di Palermo, Palermo 2003, pp. 281-289; gjithashtu *Do-*

metri tjetër kohore vërtetohet me përkthimin e *Ungjillit sipas Matthew*-t arbërisht nga Giuseppe Camarda (botuar në Londër më 1868), thuajse paralel me *Dhjatën e Re* të Kristoforidhit (1879)[33]. Brenda këtij interesimi është gjithashtu krahasimi filologjik i tre fragmenteve të ungjijve, shqip (arbërisht) e *epirotisht* (toskërisht) botuar prej Louis-Lucien Bonaparte-s.

Frontespici i Ungjillit sipas Mattheu-t, përkthim i V. Meksit, Korfuz 1924.



ΤΟ ΚΑΤΑ ΜΑΤΘΑΙΟΝ

ΕΥΑΓΓΕΛΙΟΝ

ΤΟΥ ΚΥΡΙΟΥ ΚΑΙ ΣΩΤΗΡΟΣ ΗΜΩΝ

ΙΗΣΟΥ ΧΡΙΣΤΟΥ,

ΔΙΓΛΩΤΤΟΝ

ΑΠΛΟ-ΕΛΛΗΝΙΚΟΝ ΚΑΙ ΑΛΒΑΝΗΤΙΚΟΝ.

ΟΥΓΓΙΛΛΙ

I IHSOY XPISSTOÏ T

ZOTIT SËNË KIË NA SSPËTOÏ

SI KOUNTRË SSKROTAN SSËNT MATHAIOTA

MPË ADI GJIOTHË

GKRRKISSTË ELË SO KPË

ΚΟΡΦΟΙ,

ΕΝ ΤΗ ΤΥΠΟΓΡΑΦΙΑ ΤΗΣ ΔΙΟΙΚΗΣΕΩΣ.

1824.

Η ΚΑΙΝΗ

ΔΙΑΘΗΚΗ

Του Κυριου και Σωτηρος ημων

ΙΗΣΟΥ ΧΡΙΣΤΟΥ

ΔΙΓΛΩΤΤΟΣ,

τουτέστι

ΓΡΑΙΚΙΚΗ και ΑΛΒΑΝΗΤΙΚΗ.

ΔΓΙΑΤΑ

E RE

E Zotit sonë kë na Ëpërtoï

I H S O Y X R I S T O Ï T

MPË DI FIOYKË,

Ç' më thë

FËRKISTE, e dë SKIPËTARTZE.

ΕΠΙΣΤΑΣΙΑ

ΓΡΗΓΟΡΙΟΥ

Αρχιεπισκόπου τῆς Εὐβοίας.

ΚΟΡΦΟΙ

ΕΝ ΤΗ ΤΥΠΟΓΡΑΦΙΑ ΤΗΣ ΔΙΟΙΚΗΣΕΩΣ.

1827.

Frontespici i *Dhjatës së Re* shqip, përkthim i Grigor Gjirokastritit, Korfuz 1827.

rëshkrimi i pabotuar i Anonimit Epirot, në *Studi in onore di Antonino Guzzetta* (a cura di Francesca di Miceli e M. Mandalà), Università degli Studi di Palermo, Palermo 2002, pp. 203 -217.

[33] Louis-Lucien Bonaparte, në veprën e tij frëngjisht *Le Saint Évangile de Jésus-Christ selon Saint Mathieu*, botim privat, 1857, midis 72 gjuhëve në të cilat koleksionoi përkthimin e Ungjillin sipas Mattheu-t, bashkoi dhe versione arbërisht e shqip. Shih dhe Giussepe Camarda, *Il Vangelo secondo Matteo nel dialetto albanese di Piana*, Londra 1868. Gjithashtu: Maria Teresa Borgia, *Ungjilli i Shën Mateut* i përkthyer në arbërisht nga Giuseppe Camarda, botim kritik, tezë doktorate, Università degli Studi della Calabria, Cosenza 2006.

Të tjera argumente vijnë po prej dorëshkrimeve si prova të ekzistencës së këtyre urave. Vërejtja e mençur e studiuesit grek Titos Jochalas, se në fjalorin e Marko Boçarit, hartuar në dhjetëvjetëshin e dytë të shekullit të 19-të, dallohen tri shtresa leksikore: të Sulit, të arvanitëve të Atikës dhe të arbëreshëve të Italisë, meriton më shumë vëmendje dhe më tej[34]. Nuk mund të mbeten gjithashtu pa vëmendje fakte të tilla, si përfshirja e 26 këngëve popullore lirike të Shqipërisë jugore (*canzone toske*); e 9 këngëve historike gjithashtu jugore (*canzone storiche*) - ndër to dhe *Mbeçë more shokë mbeçë;* e 13 këngëve dhe e një kanisku proverbash gege (*qualche canzone ghega - centrale*); të gjitha këto prej koleksionit të Johann Georg von Hahn-it; për të vijuar më tej me një përzgjedhje këngësh lirike të arvanitëve të Greqisë (*alcuni saggi dell'albanese di Grecia*), gjithësej 26, me burim nga koleksioni i këngëve të popullore të mbledhura nga Carl E. Reinhold, në *Appendice al saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese* të D. Camarda-s, më 1866. D. Camarda zgjodhi e bashkoi në librin e tij gjithashtu dy pjesë ungjillore, një prej Lukës dhe një prej Matteo-s, sipas botimit të *Dhjatës së Re* shqip nga Grigor Gjirokastriti më 1927 në Korfuz[35].

Këtyre fakteve u shtohet sprova e parë e Thimi Mitkos me *Bletën shqiptare* (*Αλβανική Μέλισσα*), përgatitur përfundimisht për botim dhe mbetur në formatin e parashtypit (bozze), ende dhe sot e pabotuar, në parathënien e së cilës shenjonte se një pjesë të këngëve i kishte kopjuar e përshtatur nga botimi i D. Camardës (në botimin e vitit 1878 ky pohim nuk gjendet më)[36].

---

[34] Titulli i dorëshkrimit: *Λεξικόν της Ρωμαϊκοις και Αρβανητηκής Απλής*. Për raportet ndërdialektore të leksikut shih Τίτος Π. Γιοχάλας, *Το Ελληνο-Αλβανικόν Λεξικόν του Μάρκου Μπότσαρη*, Φιλολογική έκδοσις εκ του αυτογράφου, εν Αθήναις 1980, σ. 53.

[35] Demetrio Camarda, vep. përmend., Prato 1866: *Dal Vangelo di S. Luca*, p. 1-3; *Di S. Matteo*, p. 14-15 (edizione del 1827, Corfù); *Canzoni toske*, p. 24-36; *Canzoni storiche*, p. 36-44; *Qualche canzone ghega* (*centrale*), p. 44-60 (di J. G. Hahn); *Alcuni saggi dell'albanese di Grecia*, p. 74-90 (di C. E. Reinhold).

[36] Studiuesi Dhori Qiriazi prej kohësh punon për botimin e plotë të trashëgimit letrar të

Ndërkomunikimi midis arbëreshëve dhe arvanitëve; pastaj midis arbëreshëve dhe qarkut ortodoks tosk, lehtësoi promovimin e gjuhës shqipe në mjedisin ndërkombëtar. Ishte koha e ideve romantike të Leibniz-it, e mitit të gjuhëve të krahasuara dhe e fillimeve të kulturës së multilinguizmit. Në koleksionin e tij prej 72 variantesh të shembëlltyrës së farëmbjellësit të Ungjillit sipas Matthew-t, përkthime në gjuhë të ndryshme të popujve të Europës e të botës, botuar vetëm në 250 kopje në vitin 1857, Louis Lucien Bonaparte, përfshiu dhe një variant në *lingua epirotica*, të cilin e renditi të parin ndër variantet e gjuhëve greko-latine[37]. Vështruar në pikëpamjen dialektore, dorëshkrimi në *lingua epirotica* duket se është i njëjti me atë që Schirò e pati quajtur *Anonimi Epirot*[38].

Louis Lucien Bonaparte, vëllai i pabindur i perandorit, kishte koleksionuar dhe disa variante të tjera të kësaj shembëlltyre, që ruhen edhe sot në arkivat e tij dhe që shenjojnë në mënyrë përpjesëtimore thuajse gjithë hapësirën ku flitej shqip, duke përfshirë një tekst ungjillor të Piana degli Albanesi, një tekst tjetër të arbëreshëve të Frascinetto-s - *Ungjilli sipas Matthew*-t, që u përkthye nga Giuseppe Camarda dhe redaktuar prej vëllait të tij D. Camarda (u botua në vitin 1869 po në Londër)[39] dhe një tjetër të porositur prej abatit të Mirditës Preng Doçi, i cili ishte i ndërlidhur me

---

Mitkos dhe së afërmi do të paraqesë të dhëna të reja rreth kësaj çështjeje.

[37] Louis Lucien Bonaparte, *Parabola de seminatore ex Evangelio Matthæi, in LXXII Europæas linguas, ac dialectos versa, et romanibus characteribus expressa*, Londini 1857, p. 69.

[38] Giuseppe Schirò, *Della lingua albanese e delle sua letteratura*, botuar në *Annuario del Reale lnstituto Orientalo di Napoli*, 1917-1918.

[39] Dy dorëshkrimet arbëreshe renditen me nr. 209 dhe 210 në inventarin e përgjithshëm të dorëshkrimeve të Louis Lucien Bonaparte-s, me shënimet për gjuhët: *dialect* dhe *calabro-albanese*. Versioni i cilësuar *calabro-albanese* është pikërisht përkthimi i vëllezërve Camarda. Shih për inventarin e dorëshkrimeve të L. L. Bonaparte-s: P. Garmendia, *La colección de manuscritos del Príncipe Luis Luciano Bonaparte en la Diputación de Guipúzco*a, në *Riev. nr. 24*, España 1933, 147. Katalogu i versionit shumëgjuhësh të shembëlltyrës së farëhedhësit u botua shumë shpejt në disa vende të Europës.

botën arbëreshe edhe përmes bashkëpunimit me *Fiamurin e Arbërit* të Jeronim De Radës, ku pati nënshkruar me heteronimet *Primo Doçi* e *Nji djalë Shqypnije*. Kohët e fundme një pjesë e leksikut të këtyre dorëshkrimmeve është bërë e ditur[40], por mungon ende një studim krahasues filologjik-kritik për mënyrën si kanë komunikuar tekstet ungjillore të qarkut ortodoks tosk (Vangjel Meksi, Grigor Gjirokastriti) me botën arbëreshe.

PARS QUARTA.

LINGUÆ GRÆCO-LATINÆ.

24. Epirotice.
25. Græce.
26. Neo-Græce.
27. Latine.
28. Italice.
29. Dial. Pedemontana.
30. Hispanice.
31. Dial. Hispanica Curassoæ.
32. Lusitanice.
33. Dial. Lusitanica Ceilanensi.
34. Gallice.

PARABOLA

DE SEMINATORE

EPIROTICÆ.

GIÀ, kè dóli aì kè mpiel tè mpgiéle.

E tèk mpílete aì tzà fárrhe rhà mpáne údese, e érde zóïgkt' e echágkre.

E tgiáter rhà mpì vént kè kéne gúrrhe, atgè kè skè šúme báïgte, e áte tzàst bíu, sè psè núke kè déu i théle.

E póke dóli léu Dìeli u dòkgk, e sè psè núke kiš rhéne u thá.

E tgiáter rhà mpè gémpa, e sì u rhítne gémpate, empítne até.

E tgiáter rhà mpì dè tè mírrhe, e hípte fárrha pgiése, nè ñekínt, e nè giaštedgiéte, e nè tridgiéte.

Kùš kà véše pèr tè digúare, lè tè digióge.

Parabola e farëhedhësit në *lingua epirota*, botim i Louis Lucien Bonaparte-s[41]

Transliterimi i fragmentit	**Transkriptimi**
Già, kè dóli aì kè mpiel tè mpgiele.	Ja ke doli ai që mbiell të mbiellë.
E tèk mpílete aì tzà fárrhe rhà mpáne	E tek mbillëte ai, ca farë ra mbanë
údese, e èrde zóïgkt' e echágkre.	Udhësë, e erdhë zogjt' e e hangrë.
E tgiáter rhà mbì vént kè kene gúrrhe,	E tjetër ra mbi vent që kenë gurë
atgè kè skè šúme báïgte, e áte tzàst bíu,	atje ke s'qe shumë baltë, e atë çast biu,
sè psè núke kè déu i théle.	sepse nukë qe dheu i thellë.
E póke dóli léu Dìeli u dòkgk, e sè	E posa doli, leu dielli u dogj, e se

[40] B. Destani (edit.), ***Albanian Dialects*** **-** *Prince Louis-Lucien Bonaparte***,** London 2014.

[41] *Ungjilli sipas Matthew*-it, kreu 13, 4-9.

psè núkę kiš rhéṅę u thá.	pse nuk kish rënjë u tha.
E tgiáter rhà mpè ġémpa, e sì u rhítnę	E tjatër ra mbë gjemba, e si u rritnë
ġémbatę, empítnę até.	gjembatë, e mbitnë atë.
E tgiáter rhà mbì dè tè mírrhę,	E tjatër ra mbi dhe të mirë,
e hípte fárrha pgiésę, ṅè ṅękínt, e ṅè	e ipte fara pjesë, një njëqind, e një
ġiaštedgiétę, e ṅè tridgiétę.	gjashtëdhjetë, e një tridhjetë.

Kùš kà véšę pèr tè diguarę, lè tè digióge. Kush ka veshë për të digjuar, le të digjojë.

Letër e K. Kristoforidhit drejtuar Nikolla Naços për punën e tij me *Fjalorin* dhe për mundësinë e botimit, 25 dhjetor 1888.



1888, mbë 25 në Kalëndinar (ose Janarjoi) në Elbasan

Zoti i ndershëmë Nikolë Naço, në Bukuresht.

Kartën' e Zotërisë'të shkruarë mbë 16 të
vjeshtësë tretë e prita me gas të math, baskë me
atë mora edhe letën' nga të Shqipërisë për t'i
përndarë, po atá diet' Abetarë që më shkruan se po
t'i dërgoń, s'më kanë rëndë ndorë ngher mbë sot
as shkanë për të më rënë, sepse mërretë veç se e
ka ndaluarë ghymrykut i Stambolit, a ghymrykut
i Selanikut. Zoteria jote, kur do të më shkruajş, a të
më dërgojş ndońë vivli, a tietërë ghë, të m'i dërgojş
me ane të Triestësë nga Austria me udhë të
hekurit, që të daléńë në Durrës të Shqipërisë pas
adresësë që po ta mbúl brenda në kartët t'ime.
Sot shtatë letë viet, kur gesë unë sëmurë në
Stambol, dërgova Jano-Vretonë në Vlahit e në
Misir për të kërkuarë ndihmë mb'emërit tim
(ir ővopalé μov) që të shtenetë leksikoja e ghuhës
Shqipesë që jam munduarë 20 viet për të pun
edhe kam mbëledhurë 40,000 fjalë Shqip: edhe
umbëlothnë katërë gjint Napoleona t'artë
(400 Napoleónia χρυσᾶ) m'b'emërit tim, edhe unë
në banket të Bukureshtit sepse nuke dilinagë
para për të shtypurë leksikonë: atëherë pa pjesëtur
mua, pa shkruarë mua, pa dhënë zë mua,

3. Sa u takon lidhjeve midis shkrimtarëve të qarkut katolik verior dhe atyre të qarkut ortodoks jugor, veçojmë faktin se përkthimi i *Dhjatës së Re* shqip prej K. Kristoforidhit u autorizua për herë të parë si tekst kanonik i vlefshëm për shërbesë prej një kleriku katolik, për të përmendur një prej fakteve më domethënës. Është fakt që, megjithëse Visarioni i mallkoi ungjijtë e Kristoforidhit dhe e ndaloi përdorimin e tyre në kishën ortodokse, pati besimtarë, si Beniamin Nosi e Losh Papamihali, të cilët i mbajtën fshehtas[42]. Disa kohë më vonë, por jo shumë, pikërisht në arkipeshkvinë e Shkodrës, që administronte kishën e ritualit roman, lejohej me shkrim që të praktikohej leximi i *Biblës* shqip të Kristoforidhit. Arkipeshkopi i Shkodrës Pasquale Gerasim, shkruan më 18 pill 1909: *I nënshkruari, mbështetur në vullnetin apostolik që më lejohet, i jap të drejtë të riut Zef Melgushi nga Shkodra të mbajë dhe të lexojë 'Biblën e shenjtë' përkthyer në shqip prej Kristoforidhit*[43]. Sigurisht, lidhje të tilla nisën shumë kohë më parë, por jo më parë se fillimet e Rilindjes Kombëtare.

4. Kur nis interesimi i anasjelltë, sjellja e letërsisë arbëreshe përmes alfabetit të përdorur nga shkrimtarët toskë-jugorë? Është për t'u përmendur si fakt me rëndësi kalendarike se përpjekja e parë për komunikim ndërletrar përmbi Adriatik u takon arvanitëve të Greqisë. Kjo meritë i takon Panajot Kupitorit, autor i disa veprave të njohura për gjuhën shqipe dhe dialektet e saj, për shqiptarët si komb dhe diasporat e hershme të tyre[44]; i një gramatike elementare të shqipes, i një sprove për një fjalor

---

[42] *Konstandin Kristoforidhi erdhi herën e parë për ungjijt e i përndau. Pastaj e mallkoi Visarioni e i dogjën. Beniamin Nosi, Losh Papamihali e dy të tjerë si dogjën e i këngojshin. Kujtime të Grigor Nosit*, ruajtur në AQSH, Fondi i Kristoforidhit, viti 1933. Shih tek Shaban Sinani, *Fondi Kristoforidhi në arkivat shqiptarë*, në *Studime për Konstandin Kristoforidhin*, Universiteti i Elbasanit, Elbasan 2002.

43 Pasquale Gerasim, Archieviscovo di Scutari, 18.04.1909*: Il sottoscritto, in base alle apostolica facolta che tiene, accorda al giovane Giuseppe Melgusci di Scutari che possa tenere e leggere La Sacra Bibbia tradotta in albanese dal Kristoforidi.* AQSH, Fondi 132, Viti 1909, Dosja 32, fl. 1.

[44] Nga veprat e Panajot Kupitorit (Παναγιώτης Κουπιτώρης) veçojmë: *Αλβανικαί Μελέται - Πραγματεία ιστορική και φιλολογική περί της γλώσσης και του έθνους των Αλβανών*

etimologjik të shqipes që ende nuk është botuar dhe i përshtatjes më të hershme të poemës *Këngët e Milosaos* të Jeronim De Radës në të folmen *arvanitikà* të ishullit të Hidrës (Hydra). Kupitori jo vetëm bëri përshtatjen e parë në një prej të folmeve të arvanitëve, por, me këtë rast, siç ishte në sjelljen e rilindësve, e purifikoi gjuhën e De Radës, duke zëvendësuar italianizmat me fjalë të gjuhës së vendit. Kjo vepër e Kupitorit pritet të bëhet e njohur së shpejti me një botim filologjik-kritik për herë të parë prej albanologut grek Titos P. Jochalas (**Τίτος Γιοχάλας**)[45].

Ende nuk është bërë një kërkim i rrafshit tekstologjik-kritik për të provuar ose përjashtuar një tezë të hershme të E. Çabejt, sipas të cilit strofat e poezisë së Budit, *me ndërtimin e kadencën e tyre, të kujtojnë shpesh-herë strofat e poemave të Naimit. S'është çudi,* përmbyll Çabej, *që poeti i Frashërit t'i ketë ditur poezitë e 'Doktrinës' e të ketë gjetur frymëzim në vargjet e autorit të moçëm të Veriut*[46].

Sa i takon ardhjes së letërsisë arbëreshe tek lexuesi shqiptar, me sa duket kjo ndodhi shumë vonë, vetëm në periudhën e Rilindjes Kombëtare, kur K. Kristoforidhi vendosi të përshtasë në shqipen e kohës disa prej kangjeljeve të veprës *Rapsodie d'un poema albanese* të Jeronim de Radës, siç e gjejmë në fondin e tij në Arkivin Qendror Shtetëror, me shenjimin njoftues të mëposhtëm: *Ndreqje në dialekt toskërisht të Shqipnis të kangëvet I gjer XIII të librit të De Radës 'Rapsodie d'un poema albanese', Firenze 1866. Këto dorëshkrimet ndodhet në dorë të z. Lef Nosi e firmosur nga*

(*Studime shqiptare - Studim historik dhe filologjik mbi gjuhën dhe kombin e shqiptarëve*), Αθήναις 1879; *Διατριβή της παρ' Αλβανοίς αντωνυμίας του τρίτου προσώπου κατά την διάλεκτον των εν Ελλάδι Αλβανών, μάλιστα την των Υδραίων* (*Studim mbi përemrin e vetës së tretë ndër shqiptarë, sipas dialektit të shqiptarëve në Greqi, sidomos të arvanitëve të ishullit të Hydrës*), Αθήναις 1879.

[45] Njoftimin e parë për këtë Titos Jochallas e jep në *Hidra, gjuha e harruar* (**Τίτος Γιοχάλας,** *Ύδρα, λησμονημένη γλώσσα*), në dy vëllime (τόμ. Α/-Β/), Αθήνα 2006.

[46] E. Çabej, *Ai vuri një gur themeltar në ndërtesën e kulturës shqiptare*, artikull i botuar në *Drita*, 2 tetor 1966. Citohet sipas *Dr. Eqrem Çabej, Studime gjuhësore*, vëll. VI, bot. *Rilindja*, Prishtinë 1977, f. 328.

(*nënshkrim i palexueshëm*)[47]. Me sa duket, kjo qe një tjetër përpjekje e tij për të provuar se të folmet e shqipes ishin shumë të afërta me njëra-tjetrën, një veprim i ngjashëm me zgjedhjen e Nikollë Serreqit si redaktor të *Abetār*-it *Škĭp*, gjurma e të cilit vërehet shumë qartë në botimin e parë të saj[48]. Jo i rastit është qendrimi i Kristoforidhit midis arbëreshëve përgjatë tre muajve të vitit 1874, kohë kur u njoh për së afërmi me Pietro Chiara-n[49], i cili, i entuziazmuar prej *Gramatikës* së tij (1882), pak më vonë, i shkruante Jeronim de Radës se ajo ishte *një vepër me të vërtetë kombëtare, kushtuar bazave të letërsisë sonë shqipe*, dhe se *ne tashmë nuk shkruajmë vetëm për shqiptarët e Italisë, përpjekjet tona duhet të jenë për t'u bërë të njohur në dheun mëmë*[50].

Vepra e K. Kristoforidhit paraqet një dëshmi provuese të konvergjencës së dialekteve dhe të folmeve të shqipes prej gramatikës, fjalorit deri tek abetarja e ndaj alfabeti. Ai provoi ta shkruante shqipen me *grafema latine dhe me grafema të greqishtes*, duke demonstruar se alfabeti nuk mund të kthehej në kufi ndarës brenda shqipes. Në të dyja rastet ai vërtetoi se, për vetë karakterin e shqipes, ishte e domosdoshme *të zbatohej shkrimi*

---

[47] AQSH, *Fondi K. Kristoforidhi*, nr. 29, Dosja 13, fl. 4-5.

[48] Në *Abetarin* e Kristoforidhit gjenden katër pjesë për leximi, zgjedhur nga teksti i *Dhjatës së Vjetër*. Krahasimet filologjike kanë provuar se pjesët janë zgjedhur e përkthyer jo nga teksti biblik drejtpërsëdrejti, por nga një *Histori e Shkrimeve të Shenjta* në anglisht. Titulli i pjesës së parë është *Të kriumit*. Kjo trajtë vjen për shkak të ndikimit nga redaktimi i shkodranit N. Serreqi. Në botimin e dytë më 1872 Kristoforidhi e ka bërë *Të Krijuemitë*. Në dorëshkrimin e vitit 1872 kjo fjalë fillimisht ka qenë në formën *Të Kriuemitë*, kurse më pas është redaktuar, gjatë rishikimit, në formën *Kriesa*. Shih Xhevat Lloshi, *Bibla në gegërisht*: *Krijesa. Të dalëtë*, 1872, botim i Shoqërisë Biblike (teksti i transkriptuar nga Xhevat Lloshi), Tiranë 2009.

[49] AQSH, *Fondi De Rada*, letër e P. Chiara-s nga Roma për J. de Radën, datë 4 prill 1874.

[50] … *Gia e completata la Grammatica Albanese, opera veramente nazionale, destinata a base della nostra letteratura albanese. Noi non scriviamo soltanto per gli albanesi d'Italia, i nostri sforzi devono essere riacolti alla Madre Patria.* Letër e Pietro Chiara-s për Jeronim De Radën. AQSH, Fondi 29, Dosja 2, fl. 3-4. Për më shumë: Shaban Sinani, *Fondi Kristoforidhi në arkivat shqiptarë*, në *Studime për Konstandin Kristoforidhin*, Universiteti i Elbasanit, Elbasan 2002.

fonematik dhe jo ai silabik. Kristoforidhi nuk gaboi as në parimin e shkrimit, as në vlerësimin e pasurisë fonologjike të shqipes. Veprimtarët e Rilindjes, vite para themelimit të *Shoqërisë së të shtypurit shkronja shqip,* konstatonin se *alfabeti i zbatuar nga Kristoforidhi në përkthimin e Biblës shqip mund të shërbejë si bazë e një alfabeti të njësuar të shqipes*[51]. Gjuhëtari Aleksandër Xhuvani, duke iu referuar letërkëmbimit të Kristoforidhit me Nikolla Naçon, shkruan se *Fjalori* i tij *asht i gjithë gjuhës Shqipnisë. Nuk asht pra Fjalori i nji dialekti të vetëm, por i gjithë dialektevet të shqipes,së pari i të dy dialektevet kryesorë,të gegënishtes e të toskënistes, mbasandaj edhe i dialektevet të tjerë, të çamërishtes e të labërishtes. Si e thotë vetë n'atë letër, Kristoforidhi ka mbledhë fjalë anë e mb 'anë e kant mbë kant*[52].



Alfabetet e *Abetārit Šḱip prei Konstantinit Kristoforidit Elbasanasit,* 1872.

5. Shumë më vonë vërtetohen kontaktet e drejtpërdrejta njohëse dhe rilexuese midis letërsisë së qarkut mysliman të njohur ndryshe si shkrimtarë bejtexhinj, që shkruan me alfabete orientale: të osmanishtes, të arabishtes dhe të persishtes. Ndër të parët që bënë të njohur ekzistencën e kësaj tradite qenë shkrimtarët rilindës, në fi-

[51] Më gjerësisht tek Shaban Sinani, *Fondi Kristoforidhi në arkivat shqiptarë,* në *Studime për Konstandin Kristoforidhin,* Universiteti i Elbasanit, Elbasan 2002.

[52] Konstantin Kristoforidhi, *Fjalor shqip-greqisht,* botim i USHT dhe Institutit të Gjuhësisë e Letërsisë, Tiranë 1961. Botimi shoqërohet me një *Parathënie* nga Aleksaandër Xhuvani, f. 10.

llim Naim Frashëri, kritik i rreptë ndaj infektimit të gjuhës shqipe prej fjalëve barbare, dhe pastaj Faik Konica, i cili, përkundrazi, kishte vlerësim të lartë ndaj tyre, sidomos ndaj *Zykë Kolonjarit*, siç e quante Hasan Zyko Kamberin, prej të cilit pëlqente më së shumti poezitë satirike, në trajtë epigrami, si Paraja, për të cilën shprehej se është nga ato poezi që rron sot e mot në gojën e popullit[53]. Naim Frashëri e veçonte Hasan Zykon prej bejtexhinjve të tjerë dhe shprehej për të se *ka zënë kryenë në mest të vjershëtorëve të Shqipërisë*[54].

Për herë të parë poezitë e bejtexhinjve dolën jashtë *burgut* të alfabeteve orientale kur një dijetar i huaj, Johann G. Hahn, vendosi të botojë disa vjersha të Nezimit të Frakullës, të cilin e quante *Anakreont shqiptar* (1854). I pari qark gjeo-rajonal, fetar dhe alfabetik vendës që shenjon hapjen ndaj qarkut të shkrimtarëve bejtexhinj është ai i shkrimtarëve toskë jugorë. Në vitin 1878 Thimi Mitko provoi të rishkruante me alfabetin e greqishtes katër poezi të Hasan Zyko Kamberit dhe t'i përkthente e t'i botonte për lexuesin grek, nga të cilat rezultojnë të ruajtura vetëm tri. Poezitë u gjetën në arkivin e Thimi Mitkos në Aleksandri dhe u sollën në Arkivin Qendror Shtetëror nga studiuesi Jorgo Bulo në vitin 1986. Ato gjenden në një bllok të formatit të madh dhe zënë fletët e numërtuara 332-353. Me shkrimin e dorës të Mitkos, nën titullin *Poezi nga Hasan Zyko Kolonjari* (*Ποιήματα εκ τον του Χασάν Ζυγκό Κολωνιωτου*), gjenden vjershat e njohura *Për gratë e veja - Graat e vaa* (*Περι των χηρων γυναικων*), *Për fatin e vet - Bahti im* (*Περι της τύχες του*) dhe *Për paratë - Paraja* (*Περί χρημάτων*)[55]. Në të njëjtin fond të Mitkos gjenden dhe letra e dokumente që dëshmojnë se ai nuk i kishte mbledhur si këngë popullore, por ia kishin dërguar miq e të afërm korçarë.

Kështu, më së fundi, kufijtë e qarqeve dhe të alfabeteve, bien. Për të

---

[53] Faik Konica, *Vepra* (përg. N. Jorgaqi e Xh. Lloshi), Tiranë 1993, f. 485.

[54] Naim Frashëri, *Vepra të zgjedhura* (përg. F. Agalliu), vëllimi I, Tiranë 1980, f. 409.

[55] Jorgo Bulo, *Tri tekste poetike të Hasan Zyko Kamberit*, në *Shpirti i fjalës*, Tiranë 2014, f. 219-252.

ardhur deri tek njësimi i sistemit letrar shqiptar rrugën e përgatiti tradita e dorëshkrimeve, me një qarkullim shumë më të kufizuar, por me vetëdijësimin për ekzistencën e disa formave të të shprehurit të shqipes dhe të nevojës së ndërlidhjes mes tyre.



Fleta e parë e radhoit të Thimi Mitkos, me shenjimin greqisht *Poezi nga Hasan Zyko Kolonjoti* (*Ποιήματα εκ τον του Χασάν Ζυγκό Κολωνιωτου*).

Shaban SINANI, Tirana

ALPHABETS LIKE BOUNDARIES: WHEN AND HOW THE CIRCLES COLLAPSE?

Summary

The author of this study bases his observations on the book *Per Gjenezen e Literatures Shqipe* [On the Genesis of the Albanian Literature] by Eqrem Qabej, who opined that for over four centuries, the Albanian language developed in the form of the literary stronghold that did not recognize one another and functioned as subsystems, which did not manage to become part of a national literary system. The thesis about the circles and literary strongholds is supported by many scholars and it coincides with analogous historic-literary reality. On the other hand, the question as to when and according to what an order these circles started to communicate among one another, by understanding this chronology of the process, has not been addressed.

According to him, the cultural and literary factor that caused the homogenization of the developments of the Albanian literature was the romanticism of the National Reawakening. But, have the literary circles been always fortified islands, without any window of communication among one another? And, was literature exclusively responsible that this heritage was kept as in form of islands through the centuries? These aspects are examined further in this paper.

According to the author, it is the tradition of manuscripts, either codified or close to them that offer evidence as to when the literary circles in Albania started showing interest in one another. The issue of multi-literacy, which prevails these manuscripts, and going beyond this involves the aspect of moving from the autonomous subsystems in the Albanian literature to the national literature.

For the first time ever, the poems of Bejtexhi poets break out of the *confinement* of Oriental alphabets, when a foreign scholar, Johan G. Hahn, decided to publish some poems of Nezim of Frakulla, which he called *Anakreonat Shqiptar* (1854). The first georegional, religious, and alphabetic circle, which marks the opening to the circle of Bejtexhi writers is that of the authors of southern Tosks.

Hence, finally, the boundaries of the circles and alphabets collapsed. It was the tradition of the manuscripts, with a very limited circulation, that led to the unification of an Albanian literal system, causing the awareness on the existence of some forms of Albanian expression and the need of interconnection between them, the author opines.

Bibliografi**:**

BERISHA, Anton N., *Interpretime të letërsisë së arbëreshëve të Italisë*, Pellegrini editore, Cosenza 2008.

BONAPARTE, Louis-Lucien, *Le Saint Évangile de Jésus-Christ selon Saint Mathieu*, s.l., 1857. CAMARDA, Giussepe, *Il Vangelo secondo Matteo nel dialetto albanese di Piana*, London 1868.

BONAPARTE, Louis-Lucien, *Parabola de seminatore ex Evangelio Matthæi, in LXXII Europæas linguas, ac dialectos versa, et romanibus characteribus expressa*, Londini 1857.

BORGIA, Maria Teresa, *Ungjilli i Shën Mateut* i përkthyer në arbërisht nga Giuseppe Camarda, botim kritik, PhD thesis, Università degli Studi della Calabria, Cosenza 2006.

BORGIA, Nilo, *Murgjit bazilianë në Shqipëri*, bot. *Naimi*, Tiranë 2014.

BULO, Jorgo, *Tri tekste poetike të Hasan Zyko Kamberit*, në *Shpirti i fjalës*, Tiranë 2014.

ÇABEJ, Eqrem, *Ai vuri një gur themeltar në ndërtesën e kulturës shqiptare*, në *Drita*, 2 tetor 1966; ribot. në *Studime gjuhësore*, vëll. VI, bot. *Rilindja*, Prishtinë 1977.

ÇABEJ, Eqrem, *Gjon Buzuku dhe gjuha e tij*, në *Studime gjuhësore*, vëll. VI, bot. *Rilindja*, Prishtinë 1977.

ÇABEJ, Eqrem, *Për gjenezën e literaturës shqipe*, në *Hylli i Dritës*, vjeta XV, nr. 1/1939.

ÇABEJ, Eqrem, *Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre*, në *BSHSH*, nr. 2, Tiranë 1959; ribot. në *Studime gjuhësore*, vëll. VI, bot. *Rilindja*, Prishtinë 1977.

CRISPI, Giuseppe, *Memoria sulla lingua albanese*, Palermo 1831.

CRISPI, Giuseppe, *Memorie storiche di talune costumanze appartenenti alle colonie greco-albanesi di Sicilia*, në *Studi Albanesi: storici, folklorici, linguistici* (a cura di Matteo Mandalà), *Studi e testi albanesi* 3, A. C. Mirror, Palermo 2003.

DEMIRAJ, Bardhyl, *E ardhmja e tipit do + lidhore si dukuri mbarëgjuhësore, dialektore dhe ballkanike në shqipe*, në *Shqipja dhe dhe gjuhët e Ballkanit*, AShAK, Prishtinë 2012.

DEMIRAJ, Bardhyl, *Jeta dhe veprimtaria e Gjon Pagëzues Nikollë Kazazit (në materialet e Arkivit Historik të Kongregatës së Shenjtë)*, në *Studime*, 11, AShAK, Prishtinë 2005.

DEMIRAJ, Bardhyl, *Zef Skiroi dhe shkrimet shqip*, në *ANASH*, nr. 2/2006.

DESTANI, B. (red.), ***Albanian Dialects*** *- Prince* ***Louis-Lucien Bonaparte*****, London 2014.**

FRASHËRI, Naim, *Vepra të zgjedhura* (përg. F. Agalliu), vëllimi I, Tiranë 1980.

GARMENDIA, P., *La colección de manuscritos del Príncipe Luis Luciano Bonaparte en la Diputación de Guipúzco*a, në *Riev. nr. 24*, España 1933.

GURGA, Gëzim, *Aspetti linguistici del manoscritto dell'Anomino Epirota*, në *Atti del*

XXVIII Congrèsso Internazionale di Studi Albanesi, 16-19 Maggio 2002 (a cura di Matteo Mandalà), Università degli Studi di Palermo, Palermo 2003.

GURGA, Gëzim, *Dorëshkrimi i pabotuar i Anonimit Epirot*, në *Studi in onore di Antonino Guzzetta* (a cura di F. di Miceli e M. Mandalà), Università degli Studi di Palermo, 2002.

GURGA, Gëzim, *Il Vangelo di San Matteo: Variante inedita del manoscritto di Piana*, edizione critica, tezë doktorate, Università degli Studi della Calabria, Cosenza 2006.

ISMAJLI, Rexhep, *Pjetër Budi dhe vepra e tij*, në *Pjetër Budi, Poezi* (parathënia, tejshkrimi dhe komentet nga R. Ismajli), botim i AShAK, Prishtinë 2006.

ΓΙΟΧΆΛΑΣ, Τίτος Π., *Το Ελληνο-Αλβανικόν Λεξικόν του Μάρκου Μπότσαρη*, Φιλολογική έκδοσις εκ του αυτογράφου, εν Αθήναις 1980.

ΓΙΟΧΆΛΑΣ, Τίτος Π., *Ύδρα, λησμονημένη γλώσσα*), τόμ. Α/-Β/ (*Hidra, gjuha e harruar*), Αθήνα 2006.

KONICA, Faik, *Vepra* (përg. N. Jorgaqi e Xh. Lloshi), Tiranë 1993.

ΚΟΥΠΙΤΩΡΗΣ, Παναγιώτης, *Διατριβή της παρ' Αλβανοίς αντωνυμίας του τρίτου προσώπου κατά την διάλεκτον των εν Ελλάδι Αλβανών, μάλιστα την των Υδραίων* (*Studim mbi përemrin e vetës së tretë ndër shqiptarë, sipas dialektit të shqiptarëve në Greqi, sidomos të arvanitëve të ishullit të Hydrës*), Αθήναις 1879.

LLOSHI, Xhevat (transkript.), *Bibla në gegërisht*: *Krijesa. Të dalëtë*, 1872, botim i Shoqërisë Biblike, Tiranë 2009.

MANDALÀ, Matteo dhe FUCARINO, Giuseppa, *Nicolò Chetta, 'Tesoro di notizie su de'Macedoni'*, Palermo-Contessa Entellina 2002.

MANDALÀ, Matteo, *La lettera inedita (1740) di Mons. Nicola Kazazi a P. Giorgio Guzzetta*, në *Βίβλος*, nr. 4/1994.

MANDALÀ, Matteo, *Lekë Matranga: njeriu, koha, vepra*, Tiranë 2013.

MANDALÀ, Matteo, *Meshari i Buzukut në Sicili*, në *Milosao*, 18 maj 2014.

NADIN, Lucia, *Proposta di rilettura delle pitture di Paolo Veronese in San Sebastiano a Venezia: Scanderbeg Miles Christi, e la Chiesa di Albania*, në *Ateneo Veneto*, anno CXCVIII, 10/II, 2011.

OMARI, Anila, *Matteo Mandalà, Lekë Matranga Njeriu, koha, vepra*, në *Hylli i Dritës*, Shkodër 2014, nr. 1.

PAPA BENEDICTUS XIV, *Opera Omnia*, Roma 1767.

PETROTTA, Gaetano, *Gaetano Petrotta e Paolo Schirò*, në *Il più antico testo di lingua albanese: Gjon Buzuku (1555)*, në *Rivista indo-greco-italica di filologia, lingua e antichità*, 1935.

RIZA, Selman, *Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe*, Vepra I, Prishtinë 1996.

SCHIRÒ, Giuseppe, *Della lingua albanese e della sua letteratura anche in rapporto alle colonie albanesi d'Italia*, në *Annuario del Reale Istituto Orientale di Napoli*, Napoli 1917-1918, ribot. nga M. Mandalà, *Giuseppe Schirò, Opere*, vol. VIII, 1996.

SCHIRÒ, Giuseppe, *La missione del monaci basiliani d'Italia in Albania*, në *Roma e I'Oriente*, nr. 26, dicemb. 1912; nr. 27, genn. 1913; nr. 34, sett. 1913.

SCIAMBRA, Matteo, *Paolo Maria Parrino, scrittore siculo-albanese*, në *Shêjzat*, nr. 5-8/1967, Romë 1967.

SHELDIJA, Gjush, *Kryeipeshkvia metropolitane e Shkodrës dhe dioqezat sufragane* (*shënime historike*), Shkodër 1958 (dorëshkrimi ruhet në Muzeun Historik të qytetit të Shkodrës).

SHUTERIQI, Dh. S., *Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800*, ASHSH, IGJL, Tiranë 2005.

SINANI, Shaban, *Fondi Kristoforidhi në arkivat shqiptarë*, në *Studime për Konstandin Kristoforidhin*, Universiteti i Elbasanit, Elbasan 2002.

SINANI, Shaban, *Një Shqipëri tjetër*, Tiranë 2006.

TACCHELLA, L., *Il cattolicesimo in Albania nei sec. XVI e XVII*, Verona 1984.

VANINO, Miroslav, *Aleksandar Komulović (1548-1608)*, *Napredak*, Sarajevo 1935.

Ali ALIU, Prishtinë

VIZION SHUMËSHTRESOR KOMUNIKIMI

KDU 821.18-0.09

1.

Të ndryshëm, të papërsëritshëm dhe të pangjashëm janë lexuesit e letërsisë, njësoj si shkrimtarët, si njerëzit, fundja. Nisur nga përvoja dhe perspektiva personale e lexuesit, ka vepra dhe autorë të cilëve u besoj pa hezitim dhe atëherë i dorëzohem dorës së sigurt, ngjashëm me rastet kur e shijojmë lojën e aktorit në skenë, pa pasur frikë se mund të pengohet dhe rrëzohet, se mund ta harrojë tekstin, etj. dhe atëherë përjetohet kënaqësia e të shijuarit të artit. Natyrisht ka vepra dhe autorë që nuk ta ofrojnë këtë besueshmëri dhe bindshmëri, ose nuk ta ofrojnë atë pa hamendje dhe dilema.

Në krye të këtij teksti për vëllimin me tregime të Eqrem Bashës, po e theksoj një veçori të rrallë të prozës së këtij shkrimtari: asnjëri nga të tridhjetë e më shumë tregimet e përfshira në këtë botim, nuk rrëfen një ngjarje reale nga përditshmëria, nuk sjell asnjë personazh me emër e mbiemër të plotë, nuk vendos korniza të sakta as për hapësirën dhe as për kohën e asaj që rrëfehet dhe çdo gjë në të është në kufij të reales dhe ireales, mes ëndrrës dhe zgjimit, të gjitha lëvizjet në mjegull a gjysmëmjegull, e megjithatë thellësisht të besueshme, bindëse për atë që thonë, për të vërtetën e plotë që sjellin, për atë që e jetoni dhe përjetoni, e ndjeni frymëmarrje të pranishme në jetë, në përditshmëri... Për arsyen e vetme se besimi e përshkon vetë tekstin: nga andej vjen i brendshëm, vjen si frymë e përgjithshme, universale, e përhershme, e përjetshme, nga një arsye e pranuar botërisht si normalitet, si natyrshmëri dhe botëqëndrim.

Veçanti tjetër, e njohur për natyrën krijuese të Eqrem Bashës është spontaniteti dhe natyrshmëria me të cilën ai i zotëron mundësitë zhanrore

në krijimtarinë letrare. Edhe në letërsinë tonë sot, thuaja se është modë, trend që shumica e krijuesve të sprovojnë mundësitë e tyre në më shumë zhanre letrare paralelisht, por vetëm një numri të kufizuar u vjen ngasje e brendshme, domosdo e një dhuntie krijuese. Eqrem Basha edhe në poezi, edhe në roman, edhe në prozën tregimtare është zë i vetvetes. I tillë, i veçantë është edhe në eseistikë, veçmas tek përsiatjet nga artet pamore. Edhe pse poezia tenton të ecë nga e përgjithshmja drejt personales, duke e gdhendur dhe ngjeshur lëndën e duke e ngushtuar kornizën e vendosjes së saj, ndërsa proza në drejtim të kundërt, në botën krijuese të Eqrem Bashës të dy zërat qëndrojnë pranë e pranë dhe spontanisht e natyrshëm derdhen tek njëri-tjetri. Mbështetësi kryesor i prozës është mimezisi, reflektimi, përshndërrimi i botës reale, dhe tek poezia refleksi i qëndrimit ndaj atij realiteti, e ndërkaq në tërësinë krijuese letrare të Eqrem Bashës, jo vetëm që shmanget rreptësia e ndarjeve, e kufijve, por, edhe në frymën e prirjeve moderne dhe postmoderne, ato ndërkomunikojnë, japin dhe marrin njëkohësisht nga natyra dhe nga mundësitë e veta. Në këtë mënyrë, me këtë rast, në krijimtarinë letrare të Eqrem Bashës arrihet një formë organike e simbiozës mes tyre, që është gjithashtu veçanti e rrallë origjinaliteti kreativ. Dhe në të gjitha rastet, tekstet letrare të tij reflektojnë besueshmëri të natyrshme, thjeshtësi dhe jopretenciozitet, vërtetësi dhe sinqeritet, thjeshtësi spontane, formim elitar kulturor dhe letrar, bukuri rrëfimi dhe, që të gjitha së bashku, ofrojnë kënaqësi të veçantë estetike.

2.

Pos kompaktësisë narrative të vëllimit me tregime të zgjedhura, me titull Nyje në krye të Eqrem Bashës, vepra profilohet në frymën e varianteve procedurale. I pranishëm është grupacioni apo cikli i tregimeve që e përshkon shija e hollë e absurdit, tregimet e atmosferës lirike-poetike, tregimet e refleksit metaforik, ato të portretit hapësinor dhe kohor përmes personazheve anonimë, tregimet e bëmave dhe sjelljes së tyre, tregimet e ankthit mes ëndrrës dhe zhgjëndrrës, tregimet me disponim dhe frymë anekdotike, fantastike, etj., dhe, në fund tregimet e terrorit mbi Kosovë të fundshekullit të kaluar, - vijnë kompakte, unike për nga poetika narrative që identifikohet lehtësisht, që në fjalitë e para të tekstit si krijimtari letrare

vetëm e Eqrem Bashës tek ne. Të pranishme, por të gatuara në studion e autorit, janë përvoja narrative universale, ku gërshetohen e pleksen shkolla të njohura, poetika narrative të kombinuara, të ndërfutura, shquhen hapje tregimesh me fjali të llojit – shtëpia ishte buzë shkëmbit malor, ose, spitali ndodhej buzë detit, tekst nismëtar përmes të cilit qysh në fillim vjen goditja e përshtypjes që bën imazhi dhe më pas përshkrim-shpalimi i shtyllës përmbajtjesore, përvoja narrative antike, homerike, përvoja dhe shkolla rablejane, orveliane, moderne dhe postmoderne, dhe, ta përsërisim, që të gjitha të zotëruara në studion e vet krijuese. Pleksje shkollash poetike dhe pleksje gjuhësh narrative – solemne, zyrtare, publicistike, ideologjike, retorike, sociale, biblike, filozofike, që së bashku sjellin diskursin narrativ aq të veçantë në reliefin e saj të pleksur, të dukshëm dhe të mjegullt, e në prozën e Bashës vinë si vizion shumështresor postulimi dhe komunikimi.

3.

Në prozën tregimtare të Bashës, ngjyrimi i përqeshjes, i ironisë dhe vetironizimit, në momente në kufij të cinizmit, vjen i brendshëm që mezi jep shenjat diskrete në sipërfaqe. Është ngasje që vjen reagim i autorit përballë thatësisë shpirtërore të ambientit, bartur përmes personazheve anonimë dhe gjysmëanonimë, përballë zhvlerësimit, degradimit të vlerave. E vërteta e botës që sjell proza e Eqrem Bashës duket e përmbysur, e nxjerrë për një çast jashtë hapësirës dhe jashtë kohës, e tjetërsuar dhe e traumatizuar, e pakuptimtë deri në absurd. Personazhet-zëra që sjellin dhe përhapin këtë ndjesi dhe krijojnë ambient me të tillë atmosferë, janë gjithashtu të fragmentuar, të pavetëdijshëm pse janë, ku janë, përse janë aty ku janë, për ku shkojnë dhe prej nga vijnë. Tërë kjo poetikë rrëfimtare, siç u tha, është dëshmi se Basha i njeh matricat narratologjike të rrjedhave bashkëkohore letrare. Bota që sjell ai në prozë, në të parë, shfaqet si një imazh i izoluar, i mbyllur në rreth e që e nxit, e ndez shkëndijën shpaluese nga brenda, në vetvete, si një rreze drite të sapodukur, përkatësisht të sapofshehur, e që, vetëm në fund të tregimit - shpesh edhe të pasusit të fundit, diskretshëm e shkallë-shkallë përhapet mbi tërë hapësirën dhe kohën. Zërat ngasës të kësaj flake-drite, sado të personalizuara, jehojnë perspektiva dhe qasje alternative, të ndryshme, vijnë në funksion të përkapjes më të besuesh-

me të realitetit që është objektiv i tyre. Pleksja, polifonia e zërave në prozën tregimtare të Bashës, jo rrallë shtrihet edhe brenda më shumë tregimeve, veçmas brenda grupimeve me intonim të njëjtë apo të përafërt përmbajtjesor. Për më shumë, pas leximit të tregimeve të kësaj përzgjedhjeje, bart përshtypjen e një mozaik zërash të vetmuar, të shndërruar dhe tjetërsuar, të dëshpëruar a depresiv që mbulojnë hapësirën tonë të përditshme, që mbulojnë hapësirën universale dhe të gjithëkohëshme, një mozaik të hapur në të cilin secili nga ata vendos katrorin e vet, kufijtë e vet. Përmes kësaj matrice narrative të vet synon dhe ka për objektiv të përkapë qytezën e vet emblematike, të lëvizë rrugëve dhe sokakëve të tij, bëmave anekdotike e fantastike, ëndrrave dhe skutave shpirtërore të tij, rrudhjes nga stuhitë dhe terrorët, vënies përballë tyre të gjallërisë dhe dhuntisë për humor dhe vetironizim, për të kërkuar dhe për të gjetur, për të shpaluar tërë nishanet e një bote në vete, të një universi njerëzor që nga fillimet e tij; synon të sjellë portretin e brezit të vet, të gjuhës, komunikimit të tyre, përkatësisht praninë përsëritëse, vajtje-ardhjen e tyre në këtë botë, të sjellë zëra me origjina dhe prejardhje të ndryshme, hapësira kulturore të ndryshme, të pleksura, plotësuese e përjashtuese, zëra gulçues, belbëzues dhe klithës njëherësh, jehona brezash e zërash të kohës e gjithëkohësh, ëndërrimtarësh, iluzionistësh dhe dëshpërimtare, duke thurur kështu një prozë tregimtare të ndryshme dhe fare të veçantë, të përsosur artistikisht në letërsinë shqipe.

4.

Në kapitullin-ciklin e dytë të këtij vëllimi, tregimi Çelësi i ëndrrës, që njëherësh është titull edhe i ciklit, tek i cili fshihet, mbase njëri nga çelësat, apo portat përmes së cilës mund të hyhet më lehtë në botën e shtresuar, por me perden e distancës përherë të pranishme, çelësi pakashumë është edhe i studios krijuese, edhe i mjeshtërisë dhe natyrës krijuese të Eqrem Bashës. Nga rrëfimi i zënë ngoje, shquhet, ndër të tjera prirja e autorit për të përkapur mekjen, tharjen shpirtërore të mjedisit, të ambientit ku ngjizet dhe thuret rrëfimi dhe që është njëherësh ngasësi i parë krijues i Bashës, në prozë e poezi, që nga hapat e parë nga fillimi i viteve shtatëdhjetë të shekullit të kaluar. Është ambient, tokë me njerëz-personazhe koti, që sillen kot brenda një rrethi të mbyllur, që e shohin e s'e dinë apo shtiren. Që në hyrje shfaqet mundësia e parë: *Në këtë botë ka aq shumë*

përsëritje, sa shpesh na duket se jetojmë të jetuarën, përtërijmë vuajtjet e tjetrit, pësojmë fatin që e ka kaluar dikush para nesh, marrim mësimin e përsëritur sa herë, që s'e kuptuam dhe s'e mësuam që s'e mësuam… Dhe tjetri na ka faj që gjithnjë e zëmë nga e prapa, se e prapa, prapëseprapë, na ndjek, ngado që sillemi, se prapë gjithë jeta na shkon - mbarë e mbrapsht. Por kanë rrojtur dhe para nesh të tjerë që s'kanë pushuar të sillen në rreth dhe kjo na ngushëllon. Dhe më pas: *Edhe këtë që dua t'ju rrëfej tash më duket se ju kam rrëfyer më parë… sepse prapë të njëjtat gjëra më dalin parasysh dhe po ata njerëz që i kisha varrosur një herë, që i kisha parë duke perënduar dhe ua dija varrin, i takoja sërish në skajin e udhës, në mes të udhëkryqit, te rruga rreth si zero….* Edhe ky tregim çelës, së bashku me tregimet e tjerë, bartës të ciklit por edhe të vëllimit në tërësi, si ai i dy personave te rruga rreth si zero, kryetregimi i librit, Baladë dashurie, Piktori, Vdekja e plakës, Kukulla, Funerali i një pasditeje, Marshi i kërmillit, etj., janë kryerealizime artistike që qëndrojnë në krye të prozës së shkurtë të letërsisë shqipe.

5. **Nga shënimet në margjina**

Çelësi i ëndrrës

Në variante të ndryshme shfaqet i njëjti shqetësim ngasës në krijimtarinë e Bashës: prirja përherë potencialisht e pranishme e njeriut, e njerëzimit drejt së keqes, drejt tjetërsimit dhe tharjes shpirtërore, drejt kotësisë dhe të qenit kot…. Tipar thelbësor gjithashtu i tij: nuk e mësoi që nuk e mësoi leksionin për të mos e përsëritur prirjen drejt së keqes, s'e aftësoi prirjen për t'u pastruar nga ajo farë e pranishme në qenien e vet, as ngasjen ëndërrore për t'u përsosur… Mbeti në prag të iluzionit donkishotesk. Dhe, mbase, nuk do pushojë së qeni i tillë, iluzionist i papërmirësueshëm…

Baladë dashurie

Vizion dhe ndjesi baladike për dashurinë: mos po e braktis njeriu atë, dashurinë, apo ajo njeriun? Vlon nga reflekse të tilla, ky tregim i përsosur dhe mbresëlënës me fund të fuqishëm. Lundërtari (vërtet mbetur fillikat), pa asgjë, nga të gjithë i dëbuar, i harruar, por jo edhe nga nevoja për t'u ardhur në ndihmë të tjerëve, sidomos të vetmuarve, të dëshpë-

ruarve…, vjen si një rreze drite mirësie që, megjithatë, nuk jepet, nuk dorëzohet, nuk shuhet, sado që bota rreth tij, e kërcënon atë fanar të brendshëm ende të gjallë... Një tregim majash antologjike në letërsinë shqipe.

Kukulla

Tregim që s'harrohet, që të ndjek dhe nuk të shkoqet. I vendosur brenda dy eseve, fillim e mbarim, si hapje dhe mbyllje portash të mjegullta, të jashtme dhe të brendshme, vjen strukturë estetike e përsosur. Kukull, një zë-jehonë e brendshme që zgjon dhe trazon thellësi deti, që shkund dhe mbërthen së brendshmi njeriun në situata të caktuara, zë jehonë ndërgjegjeje që të paralajmëron, përkatësisht të vë përpara rënien, mundësinë, -ecjen drejt tyre, një zë vigjilues që mban nën peshojë lëvizjet e ndërgjegjes, asaj të zgjuar dhe asaj të përgjumur… Ese e fuqishme për mjegullën, për mjegullën – fenomen i natyrës dhe mjegullën – metaforë, mjegullën lidhur Nyje në Krye – të mirënjohur në prozën e Eqrem Bashës, – mjegullën e syve dhe mjegullën e shpirtit.

Vdekja e plakës

Titull jo sfidues, përkundrazi, zbutës, qetësues…Plakat vdesin, -vdekje e natyrshme, mirë që vdesin plaka, jo të reja… Por ama, atmosfera që thuret përmes rrëfimit, të fut në një tjetër botë, në një botë ndryshe dhe, përvidhesh këndeve dhe sferave të prekura – të paprekura, në përjetime që i ke ditur e s'i ke ditur, i ke jetuar a s'i ke jetuar në udhën tënde jetësore.

Ligaçët

Prapë qyteza univers, e mirënjohur në krijimtarinë letrare të Eqrem Bashës, qyteza me sëmundje epidemike, si kruarja e madhe, zgjebosja kolektive, si skuqja e veshëve dhe surratit, si ushtima e lemzës së famshme, si vërshimi cunamik i qeshjes, etj. dhe ja tani edhe ligaçët, bota e të përjagurve, të përqururtëve… sëmundje epidemike në hapësirën tonë, arbërore, njerëzore, që nga ato antike me të cilat i ndëshkonte Zeusi mëkatarët… Epidemi mekanizmash për të përcjellë shenja, porosi, përkatësisht mekanizma mbrojtëse, zëvendësim heshtjesh të dhunshme, sfida ndëshkimit… të përjargurit si racë më e neveritshme e hapësirës, e ambientit.

Funerali i një pasditeje

Një ushtrim maestral narrativ i mendjes në heshtje, në prehje relaksuese që beson se s'ka asgjë për të thënë, për të shqiptuar, të paktën asgjë të rëndësishme… Ndërsa, këndej, mbushen 6-7 faqe tekst të rrastë, pa asnjë kryerresht, që, në s'gaboj, është rast i vetëm në prozën tregimtare të Bashës… Thurje e përsosur narrative që ecën me hapat e njërit, si zakonisht folës anonim, në mesin e një funerali që mat dhe çmat asgjënë dhe që si lexues të ndjell ta ndjekësh si një i uritur.

Fifi

Rrëfim që rëndom, shkrimtarët e thurin për t'u çlodhur, si prehje pas punës së rëndë, përkatësisht para punës që i pret. Thjeshtë, për të bredhur imazhit të qetë, pa obligim- për vete dhe për lexuesin… Rëndom, duke e shkoqur përqendrimin nga një fiksion i apasionuar, autori, në raste të tilla, bën një shëtitje për kënaqësinë e vet, për shpirtin e vet, dhe, shpesh, nga këto bredhje lindin tekste, vepra të përsosura, siç është rasti edhe me Fifin, pakashumë ngjashëm edhe me përsiatjen narrative të njeriut anonim në funeralin e një pasditeje.

Një njeri në trotuar

Rrëfim nga i cili rrezaton një tjetërsim i ftohtë, trishtues… Ftohtësi që qëndron pezull, që e shohim dhe s'e ndjejmë, e që mësohemi të bashkëjetojmë… Një rrëfim që përmes diskursit të njohur të Bashës, na e sjell të shtrirë thatësinë Saharë në hapësirën dhe përditshmërinë tonë, si në një pëlhurë pa fund, si në një skenë absurdi, me mjete narrative groteske që gërryejnë nga brenda me ironi therëse, me buzagazin helm, që të pushton lehtë dhe pa e ndjerë…

Piktori

Njëri nga tregimet shtyllë të vëllimit… Mbi krijuesin dhe mbi krijimtarinë, mbi gjykimet për ta zënë të plotë imazhin e ngjizur në frymëzim, në ngasje, për ta pushtuar, nënshtruar, për ta vënë në dorë figurën që nxit, që sfidon trazueshëm, përvuajtshëm, gërryeshëm shtruar këmbëkryq, nga brenda. Ai, imazhi, figura, rrëfimi ndërsa përherë rrëshqitës, i pakapshëm në plotninë e vet… betejë për jetë-a-vdekje dhe, duket asnjëherë e fituar nga krijuesi, përkatësisht asnjëherë i pashpresë drejt këtij caku…

Ali Aliu, Prishtina

A MULTILAYERED COMMUNICATION VISION

Summary

The author, in this study, treats critical and interpretative presentation of Eqrem Basha's overall short story work, who is ranked by him among the best narrators in Albanian literature. His analyses present literary criticism that treats short stories and different communication themes and layers that can be found in the tales of this author.

Kujtim M. SHALA, Prishtinë

DISKURSET E KRIST MALOKIT

KDU 821.18.09
008(=18)

I. DISKURSET

Dijetari shqiptar i shkollës kulturore gjermane, Krist Maloki, i rritur në filozofi dhe i provuar në kritikën letrare, teoricien i *kombit* e *skajues* i oksidentalizmit, me diskurset e tij përqendron dhe provon temat e mëdha shqiptare të modernitetit. I lidhur në këto nyja e i hapur në diskurset e tij, portreti ditunor i Malokit shenjon një pamje të kulturës shqiptare moderne, me gjenezë *kritikën* e me kulm *ideologjinë*.

Insistimet e forta te metoda, temat themelore, bashkë me diskursin, e shenjojnë Malokin një dijetar të zgjedhur, kritik letrar të kultivuar e teoricien të identitetit shqiptar. Të hapura në analizë, diskurset e Malokit shenjojnë e përfaqësojnë autorin e tyre, temat e tij të zgjedhura; shenjojnë e provojnë debatin shqiptar për jetën e gjallë, për heronjtë a prijësit e literaturës e të kulturës. Me një fjalë, nga diskurse të Malokit, ato bëhen diskurse që përfaqësojnë një *kulturë*. Si të gjithë autorët *e shenjuar*, edhe Maloki shkon përtej vetes e bëhet një figurë e epokës, që merr e jep shenja të kulturës së tij, të ëndërrueshme si të kulturës shqiptare, dhe shenja të kulturës së vendit, në zjarrminë e në shpërthimet e modernitetit shqiptar.

Diskursi i Malokit është me rrënjë në filozofi e në kulturologji që, së bashku, e bëjnë konceptual edhe kur përshkruan e paraqet. Kjo është shenjë për diskursin substancial dhe, më tej, për dijetarin metodik. Në fund a në fillim, substancialiteti bëhet sistematikë kërkimore, të cilën e provon përherë metoda e Malokit. Kur lidhen këtu pikëpamjet, diskurset e Malokit bëhen *programatike*, ndoshta *mësime* për kulturën e për jetën shqiptare.

I lidhur me temat e mëdha, diskursi i Malokit kap problemet e mëdha të kulturës e të jetës së shqiptarëve. Oriental apo oksidental? Si

jeton Ideja shqiptare? Esencë është shtetit apo kombi? Cili është Heroi kulturor, d.m.th. Prijësi shpirtëror i shqiptarëve? janë pyetjet e mëdha, që bëhen tema të mëdha në diskurset e Malokit, nyja që do t'i zgjidhë kur bën *kritikën* apo kur e thotë *mësimin*.

Kritika letrare e Malokit, e lidhur në tekstet për Naimin e Poradecin, e provon dijetarin e letërsisë, kritikën me rrënjë në filozofi, teori të kulturës e psikanalizë, që do të thotë në diskursin për *gjenezën* e veprës, të artikuluar me shenja programatike. Këto shenja së bashku e *skajojnë* diskursin analitik të Malokit e bëhen dhe shenja themelore të profilit të tij si kritik letrar. Me këto shenja, kritika letrare e Malokit hapet në funksion të diskurseve kulturore, që shkojnë përtej letërsisë, te temat e mëdha të jetës shqiptare. Në diskursin e tillë, Naim Frashëri e Lasgush Poradeci *skajohen* si fenomene letrare e kulturore. Ndërsa, nga letra që i dërgonte Nolit, mësojmë se Maloki edhe atë e *skajonte* si një fenomen. Në krye të pemës së fenomeneve letrare-kulturore shqiptare vihet Gj. Fishta, i kurorëzuar Dichter.

Diskursi i Malokit është i lidhur, i përqendruar, veti e cila e çon në substancialitet diskursiv. Derisa, saktësia dhe argumentet çojnë në diskursivitet e figurat bëhen *exemplum*-e që shoqërojnë e provojnë argumentet. Së bashku me ngjyresat e nuancat polemike, këto veti e determinojnë stilin dhe bëhen shenja të retorikës së diskursit të Malokit.

II. ORIENTAL APO OKSIDENTAL?

Eseja e njohur *Oriental apor Okcidental* (1937) lidhet në temën e madhe, madje në debatin e madh shqiptar për identitetin oriental apo oksidental. Siç e provon me luciditet të thellë Maloki, orientalizmi e oksidentalizmi shqiptar s'kanë të bëjnë me mosha e breza, por me mënyrën e jetës e të sjelljes, që reflektojnë mendësi, madje një filozofi. Ky tekst pason debatin ndërmjet pleqve dhe të rinjve,, të cilin Maloki e njeh si të kotë, meqë vetë debati e provoi se nuk ka pleq e të rinj, por *orientalë* e *oksidentalë*.

Orientalizmi shqiptar identifikohet me kotësinë e me dembelinë, që burojnë nga papërgjegjësia. Atë Maloki e mendon një faj e trashëgimi të

kristianizmit evro-aziatik, pasojë të administratës bizantine, me rrënjë në bizantinizmin historik. Prapa këtyre shenjave e përcaktimeve, lexohet orientalizmi si markë e egos që s'e njeh jetën kolektive, që s'mund të shkojë përtej vetes, që s'e bën detyrën si/për detyrë dhe që do të përfitojë nga veprimi i tjetrit. Kështu, Maloki përfton shenjën e karakterit të orientalit dhe vë përballë socium-in që pret veprat në dobi të përbashkët.

Përballë orientalizmit, oksidentalizmi është mënyrë sjelljeje që buron e rritet nga përgjegjshmëria, nga detyra që bëhet si/për detyrë, pa ndonjë zor e pa pasur në mend përfitime individuale. Një detyrë e tillë lidhet përherë me një ideal e ide të përbashkët/sociale që mbështillet me moral. Vërtet, këto janë shenja veprimi, ndërsa ndjenjat që *skajojnë* oksidentalin janë dhimbja e mëshira, si marka të shpirtit fisnik. Vetëm shpirti e mbron njeriun, humanen, e thotë filozofia dhe e provon jeta e gjallë. Në këtë kapërcim, diskursi i Malokit do *sjellje* me burim shpirtin, si kategori humane universale.

Mësimi i Malokit, në fillim e në fund, lidhet në vlerësim e *skajim* të detyrës së bërë me përgjegjshmëri, si shenjë oksidentalizmi.

> *Sepse kjo pikëpamje âsht e saktë: okcidentalizma e vertetë përmblidhet në kryemjen e perplotë së një detyre të pershtatshme shejtnisht me vetflijimin per një idé të naltë shoqnore... Nga kjo pikëpamje âsht mâ okcidental xhandari shqiptar i detyrës, ushtari biles i rojes kufitare dhe bulku i shkretë dhjetarak... sesa nëpunësi e zyrtari i kafehaneve me një çarçaf diplome 'bon pour l'Orient'....*[1]

III. IDEJA SHQIPTARE

Por, në cilat nyja lidhet *autentikja*, si jeton e si manifestohet ajo në jetën e gjallë shqiptare?

Krist Maloki, shqiptari me kulturë evropiani, shqiptarëve u jep *mësimin* mbi *autentiken*, të formuluar si *Ideja shqiptare*. Bashkimi është shpëtimi, ligjëron ai, dhe bëhemi bashkë kur bëhemi Shqiptarë. Saktëson fort,

---

[1] Krist Maloki, *Refleksione*, Faik Konica, Prishtinë, 2005, f. 158.

Shqiptarë dhe s'e ka fjalën për kombëtarët, meqë ideja kombëtare është punë e mendjes, ndërsa ajo shqiptare buron nga zemra. Maloki vijon argumentimin për kombëtarinë e mësuar e shqiptarizmën e (për)jetuar, kur përballë kombëtarëve, që s'ishin e s'u bënë Shqiptarë, vë malësorët, që kurrë s'kanë dëgjuar për ide kombëtare, por përherë kanë qenë shqiptarë.

Dijetari ynë, në terma të tjerë, e lakon idenë për kombëtaren, këtu të identifikueshme me nacionalen, si kategori politike, e shqiptarizmën si esencë që nuk tretet kurrë. Do ta quanim këtë një etnopolitikë, po së pari është etnoetikë, me shenja të një etnoantropoetike.

Në diskursin e tillë, Ideja shqiptare karakterizohet nga tri cilësi të shpirtit të vërtet shqiptar: Besa, Nderi e Burrnija.[2] I lidhur me këto veti, shqiptari në shekuj e ka ruajtur Idenë shqiptare. Këto veti e kanë bërë atë luftëtar e hero, i kanë mbajtur gjallë e bashkë shqiptarët. Nga ruajtja e shpërthimi i tyre, u mbërri edhe Rilindja kombëtare.

Qoftë dhe nga termat e *skajimet* e gjejmë *mësimin* e Malokit të rritur në jetën tradicionale shqiptare, me besë, nder e burrni, në kodet morale, që s'bën të preken a të thyhen. Këtë traditë Maloki e lexon të përthyer në letërsinë e Fishtës, në veprën e tij të madhe, të mbrujtur me palc ethnik (Ernest Koliqi), moralitet të vendit e shenja të politikës nacionale, që, së bashku, e bëjnë atë letërsi *vepruese* (edukuese).

Së pari *Shqiptarë*, pastaj *kombëtarë*, sepse *Shqiptarizma* është identitet e *kombëtarizma* program ideologjik/politik, mëson Maloki.

Edhe në këtë pikë, Maloki na shtyn të hapim rishtas njëqind (pikë)pyetjet që lidhte ai, në shekullin e vet, tek *Ideja shqiptare*, për idenë e jetën shqiptare, për qenien e rrnesën, madje për rendin politik, të gjitha si përvijim identiteti, për të zbuluar edhe një herë se sa rëndë ka pyetur ai e sa pak përgjigje kemi dhënë ne.

IV. SHTETI APO KOMBI?

Ndërkaq, Shteti apo kombi? është dilema që një teoricien i përjet-

[2] Po aty, f. 183.

shëm i etnisë e zgjidh në dobi të *kombit*, kur ai përcaktohet si kategori etnike, e lidhur me esencat e jetës, e përftuar si lidhje gjaku, traditë e jetë e përbashkët, përballë *shtetit*, si strukturë politike.

Për ta parë problemin në dimensionin jetësor të Malokit, hapim artikullin *Pro doma* të vitit 1964, në të cilin kombi *skajohet* si ent historik, kulturor e moral,[3] një totalitet aristotelik, e totaliteti është më i vlefshëm se të gjitha pjesët e tij në vete. Ndërsa, shteti një parcialitet politik, që s'e mban *kombin* shqiptar, si ent *historik*, *kulturor* e *moral*, por *nacionin*, si kontratë politike.

Maloki bën *skajimet shtet* e *komb*, kur ka para shtetin shqiptar të Tiranës, që s'e përmban kombin si të tërë.

> *Fjala* komb *âsht njí kaptim ethnik.* Kombi *përmbledh në gjí të vet njí grumbull personash që janë lidhë shoq me shoq (*ideel!*) nëpër gjakun e fisit e njajtë dhe mâ fort nëpër njí botëshikim e botëkuptim (*Weltanschaung!*) të përbashkët.*[4]

Ndërsa,

> *Fjala* nacion *âsht njí kaptim politik, e mâ fort politiko-ekonomik.*[5]

Skajimet e tilla dhe shteti shqiptar, pa tërë shqiptarët brenda, e bëjnë ideologun e totalitetit të kërkojë shpëtimin e Shqipërisë nga kombi, nga etnia e jo nga strukturat (organizimet) politike. Maloki rri larg pragmatikës së identifikuar me politikën, për t'u bërë, disi paradoksalisht, apolitik, por një *politikan i etnisë*, politikë që, në terma të tij, do të *skajohej* si politikë e esencave.

Në këtë pikë, lidhja me *skajimet* e Malokit për kombin çon te profili i tij si dijetar, kërkues i *ekzistencës* së etnisë, i traditës dhe i jetës së gjallë, që së bashku marrin emrin *komb*:

> *Kaptimi* komb *âsht njí nga ata kaptime që nuk mund të thjeshtëzohen mâ, si kaptimi* jeta, njeriu, Zoti... *Kombi âsht kombi... njí ndje-*

[3] Po aty, f. 319.

[4] Po aty, f. 117.

[5] Po aty, f. 118.

sí që vlonë nder zemrat e njí grumbulli njerëzish që e përbajnë at komb... njí ndjesí që: ose âsht ose s'âsht... që s'mund të blehet, të shitet, as të merret me qirá... Dhe para së gjithash: kombi âsht njí totalitet ashtetnor *(jo antishtetnor!) dhe nuk mund të kufizohet me gardhet politike të njí shteti sado përparimtar apo oriental... Kombi rrnon, kombi gjallnon...*[6]

V. HEROI I KULTURËS

Në zjarrminë e kërkimit e të kurorëzimit të Poetit kombëtar të shqiptarëve, Maloki propozoi Poetin e tipit Dichter të gjermanëve apo Vates të latinëve, i cili bën bashkë *veprën* e *veprimin*, të kurorëzuara si *përfaqësim*. Një Dichter është një Hero i kulturës, autor e Prijës, përftues e përfaqësues i jetës etnike. Një Dichter kap temat e mëdha të vendit, kolektivitetit, etnisë a të kombit. Vepra e veprimtaria e tij janë lehtësisht të identifikueshme dhe thellësisht përfaqësuese. Një Dichter është autor i rëndësishëm, përcaktim që shkon përtej aksiologjisë te një epistemologji letrare e kulturore, e cila ka premisat e përfaqësimit të kolektives. Kjo nyjë lë jashtë përnjëherë autorët e temave personale, të dhimbjeve e të dramava dhe kurrë nuk takohet me triumfin a gëzimet e lehta të njeriut. Përfaqësimi, dikur e sot, imiton apo imagjinon të rëndësishmen, përfaqësuesen, që shkon përtej shenjave të individit dhe lidhet në rrjetin e kolektivitetit. Me shenja të tjera, *përfaqësuesja* lidhet me *identitetin* apo me *autentiken*, bëhet trezor i saj dhe e rrezaton vetë atë.

Maloki e lexon Naimin, poetin e madh, dhe i del thellësisht universal, i lidhur me bektashizmin e me rrënjët e tij të vjetra. Temat nacionale të Naimit janë të vona, ndërsa *autentikja*, e identifikuar si *kolorit shqiptar*, s'jep shenjë në rrjetin e temave a të frymës universale të veprës së tij. Derisa, Poradeci i duket tepër fluid, kur ligjëron me vaj për humbjet e veta, thellësisht personal, prandaj jopërfaqësues.

---

[6] Po aty, ff. 115-116.

I larguar nga Naimi e Poradeci, Maloki kërkon Poetin te Fishta shkrimtar e veprimtar. Në këto përcaktime lidhen vetitë e një Dichteri shqiptar, njeri i literaturës dhe i kulturës, i temave dhe i veprave etnike. Në diskursin e në rrjetin e argumenteve të Malokit, Fishta është Dichter, Vates, Poet, Hero, d.m.th. Prijës.

Dekada më vonë, në 20-vjetorin e vdekjes së Fishtës, Maloki rihapte temën e madhe të Poetit kombëtar, në trajtën *A asht heró Gjergj Fishta?* (1960) Vërtet, ky tekst në dorëshkrim e rimerr çështjen në tërë përmasën e saj, nga formati teorik, te shenjat e një Prijësi kulturor a shpirtëror të shqiptarëve. Prijësi i tillë është zbulues i shpirtit të kombit, i vullnetit dhe i energjive të tij, si burim për veprim. Maloki e provon Fishtën me këtë format, ndesh dilemat e mëdha, atëherë kur Fishta hesht, dhe e rigjen si Hero, kur rihap veprën e trashëgimisë së tij kombëtare.

E me gjith atë: Gjergj Fishta asht heró

Në kohën e jetës së tijë dishka ka mungue në te dhe vepra e tijë disì ka marrë mësysh politikisht. Porse hylli i tij i flakshëm s'asht zhdukë - e s'ka per t'u zhdukë - nga qielli i Kombit Shqiptar. Sepse, si difton psykologjija socjologjike - sidomos ajo e fellësisë (Tiefenpsychologie) e Jung-ut - botëkuptimet dhe idealet e një kombi jan të rranjosunë, të pashlyeshëm dhe të pandryshueshëm në Trunin dhe Shpirtin Kombëtar. Mysteri i qenjës së një KOMBI asht i lidhun esencjalisht me njato ndjenja, me njato ideale apor karakteristika të veçanta e të përmbëledhuna ontologjike, që jan ngulë e formue neper shekuj e kohe nga një fat i pakuptueshëm, por i perendishëm (...) Gjergj Fishta la lëshue dritë nepër njato fellësina, nepër njato mystere të kombit t'onë: aj na ka kasnecue mbi Marash Utsin e të birt e Tsalit, mi Oso Kuken, Ded Gjo Lulin e sa e sa heroa tjerë të Kombit t'onë (...) Lene mandej që e shumëta e njatyne të rijve - që e bane deken si me lé - *kan qenë të frymzuemë nga vepra e pavdekëshme e Gjergj Fishtës. Sepse rinija e vertetë e një KOMBI i don idealet dhe veprat hovdhanëse kombëtare. Prandaj edhe n'asht çudì që sot Lahuta e Malcisë dhe vepra tjera fishtjane kalojn mësheftas dorë më dorë dhe këndohen e shijohen ma fort se kurr në Shqipnì. Tirana pra duhet të ja vejë menden këtij problemi: Shqipnija patriotike - në daç komu-*

niste, në daç antikomuniste - mund të mbahet vetëm me një rinì thjesht shqiptare. E deri sa nen rregjimin komunist nuk del ndonjë poet tjetër heroik e romantik me kvalitetin e Gjergj Fishtës, në mos ma tepër, kangëtari i Lahutës ka per të qëndrue gjithmonë si hyll i pashlyeshëm në qiellin e andrimeve të rinisë s'onë. Këtu asht Fishta me të vertët herò *dhe vepra e tijë ka per të mbetë gjithmonë e gjallë mbrenda Kombit Shqiptar.*[7]

* * *

Naim Frashëri i diskursit të Malokit është Naimi që jep psikanaliza, e kryqëzuar me shenjime të kulturës orientale dhe e matur, pa u shpallur, me kulturën e me jetën shqiptare. Maloki niset nga vepra biografike e Mid'hat Frashërit *Naim Be Frashëri* (1901) dhe bën ngadalë portretin psikologjik të autorit tonë, të lidhur në dy nyja, *shpirti* e *karakteri*, që bashkë bëjnë Personin. Në këtë frymë, Maloki e mendon veprën letrare si produkt të personit, të jetës psikologjike të tij dhe kjo e çon te *psikografia* si perspektivë e metodë kërkimi.

Në *psikografinë* e Malokit, Naimi shfaqet i mbyllur në vete, jashtë jetës praktike, pa shpirt veprues dhe i mbytur në ëndërrime. Mësimet e para apo rezymimet e mbrama e mbajnë Naimin në shtigjet e ëndrrës së vet, në të cilën ka mirësi (që përherë fiton), ndërsa e liga humbet. Maloki thekson fort se jeta shtrihet ndërmjet të kundërtave dhe kush s'arrin ta kapë këtë, s'e kap filozofinë e jetës. Jeta shqiptare autentike e ka kapur këtë filozofi nga rrënjët, ndaj shqiptari është *veprues*. I përhumbur në ëndrrën e vet, Naimi huq jetën e gjallë shqiptare, ndërsa për veprimin nacional mëson në Stamboll, nga Abdyli, Samiu, Pashko Vasa, e nga ëndrra, në dritën e jetës së kombit, e nxjerr Lidhja e Prizrenit.

Mësimet e hershme e ëndrrën e përhershme të Naimit, Maloki i gjen në tërë veprën e tij, nga *Ëndërrimet* në persishte (*Tejhyjylat*, 1885), te poema *Istori e Skënderbeut* (1898), të lakuara si ahistori dhe si kolorit uniform, pa marrë parasysh temën, apo situimin, me personazhe pa shenjën e tyre historike e autentike, hapur e mbyllur si kundërshti e luftë ndërmjet të

[7] Po aty, ff. 105-106.

mirës e të ligës, që përherë i çon personazhet te portreti i engjëllit apo i djallit përballë tij; fiton përherë i pari. Shenjat ahistorike dhe koloriti universal, bashkë me vetitë e personazheve, *kategori* që poetika i njeh si *përfaqësuese*, e bëjnë veprën e Naimit universale, ndërsa zgjimi nga ëndrra personale kryqëzohet me temën e heroit kombëtar të shqiptarëve, Skënderbeut.

Në këto nyja, që e provojnë përnjëherë metodën e Malokit, ndërtohet skema e veprës përfaqësuese të shqiptarëve në histori e bashkëkohësi dhe provohet se këto shenja i mungojnë veprës së Naimi Frashërit. Ai është një *ëndërrimtar i madh*, ndërsa Maloki kërkon një *veprimtar të madh*, të përthyer në vepër qëllimore e të shenjës ideologjike/politike. Vepra e projektuar nën këto shenja është vepër e Prijësit shpirtëror, çfarë Maloki do ta gjejë (të provuar) te Fishta.

* * *

Tek *A asht Poet Lasgush Poradeci?* Maloki e rihap në nyjat themelore *çështjen* e Poetit kombëtar, duke u marrë përnjëherë me veprën e Poradecit e me studimin e Kutelit për poezinë e tij. Maloki e ndërton teorinë e Poetit duke ndjekur përcaktimet e kulturave të mëdha, me përqendrim të parë atë gjermane. Ai bën modelin, pastaj e mat Poradecin me të, duke e dikur se ai është autor i një modeli tjetër dhe duke treguar shenjat që çojnë, përmjet Koliqit, te *Poeti kombëtar*, Gjergj Fishta.

Vepra e Poetit kombëtar lidhet me temat e vendit, të etnisë, me moralitetin dhe bëhet *vepruese*, një vepër edukuese. Vepra që ka këto shenja, shkon përtej rrafshit të estetikës, te rrafshi i rëndësisë, pra te klasa e veprave përfaqësuese. Kur e përthyen në argumente konkrete, Maloki do mendësi e moralitet *kombëtar* në vepër, *kolorit shqiptar*, që përcaktohet si frymë, madje formë letrare e shenjës autentike. Këto kërkohen te poezia e Poradecit, te vepra e rrathëve personalë e universalë, përherë në metodën *via negation*, që ndërton skemën e veprës përfaqësuese dhe e provon se vepra (këtu, vepra e Poradecit) që studiohet s'hyn tek ajo skemë, meqë hapet drejt *personës* e universales.

Në formatin e tillë të *Poetit*, Poradeci është i humbur. Maloki e diskuton në formatin e *poetit*, për të kaluar ngadalë te një lexim letrar, i cili vërtet sugjerohet nga vepra e Poradecit. Edhe në këtë pikë Maloki rrëshqet

shpejt te skema e tij, e vënë nga pikëpamjet e tij dhe e forcuar nga metoda, për të kërkuar, pa i gjetur, shenjat e Heroit te poetika e veprës (në kuptimin e një *poiesis*-i).

VI. DICHTER-i I HUMBUR

(Flamurtari e tregtari)

Në vjershën në dorëshkrim, të titulluar *Ernesto!*, Maloki e provon temën e vet të jetës kulturore si një obsesion personal. *Ernesto!* lidh në figura e retorikë të hapur idenë e Dichter-it dhe shenjat e humbjes së tij. Vërtet, teksti është i rastit, i lidhur me veprën dhe veprimet e Ernest Koliqit, të cilin Maloki dikur e kishte nyjë në kapërcimin te Fishta (Dichter), ndërsa tani e *nem* për shenjat e humbura të Dichter-it.

Teksti i Malokit lidh kontrastet e koncentruara në figura apo të hapura në nominalitet veprimesh. Kontrastet japin dy faqe, të parën në shenjat e një Dichter-i (Ernesti i parë) dhe të dytën në shenjat e një tregtari (*Ernesto* i fundit, trajtë që shenjon tëhuajësimin). Po u lidhem për figurën e njohur të Koliqit, Tregtar flamujsh: flamurin *flamurtarit* e leckën *tregtarit*. Në pikën në të cilën *flamurtari* tretet në *tregtar*, diskursi i Malokit bëhet i zi, i mbytur në mërzi e zhgënjim.

Vjersha e Malokit e thotë mërzinë e tij për Dichter-in e humbur, ashtu si thuhet mërzia për idenë e humbur jetësore. Në këtë pikë, shpërthen mallkimi që mbyll tekstin, por që (shpër)hap trishtimin.

Një ide e mbyllur me zhgënjim. Kjo është ndarja e madhe me *flamurtarin* që u bë *tregtar*. Ndaj, Maloki gjëmon e *nem* rëndë: Të vraftë Zoti.[8]

Ernesto!
Ti dikur ishe poet e vjershetàr
E ma fort ti ishe Dichter...
Dhe rinija shqiptare t'adhuronte

[8] Po aty, f. 247.

E lumnonte me ty,

Sepse ti ishe luftarak
Dhe ishe flamurtàr ner sfera idealesh...
Porse Orët e liga të verbuene
E t'i moren mend para kohe,
E shtojzavallet t'a kputne fijen e jetes hyjnore...

Ti sot m'je harlis mbas nishanesh,
Je ekselence e zâmadh nder karjera...
Porse zâni yt u bâ tyt
E ftyra e jote u zbé...

E aty ku ishe kumonare
Po shamatosen kukuvajkat e sorrat,
E aty ku m'ishe faltore
U bane figure simahore,
E aty ku ishe flamurtâr -
U bane tregtàr

Të vraftë Zoti.[9]

[9] Po aty, f. 247.

Kujtim M. SHALA, Prishtina

DISCOURSES OF KRIST MALOKI

Summary

Krist Maloki, the Albanian scholar of the German cultural school, who was educated in philosophy and proved himself in the literary critique, the *theoretician* of the nation and *cleanser* of Occidentalism, focuses in his discourses on the big topics of Albanian contemporariness. Tied to these knots and open in his discourses, the erudite Maloki depicts a landscape of the Albanian modern culture, which has criticism in its roots and ideology on the top. His strong insistence on methods and the basic topics, coupled with the attention on discourse, make Maloki an excellent scholar, a literary critic, and a theoretician of the Albanian identity.

Maloki's discourse has its roots in the philosophy and culturology, which together make him conceptual in the way he depicts and portrays. This makes him the brandname of a substantial discourse and further a methodological scholar. From start to the end, the substantiality becomes a research system, which in Maloki's methods is proven throughout . When these are connected, Maloki's discourses and views becomes programmatic and perhaps lecturer on the cultural and life of the Albanians.

Besim BOKSHI, Prishtinë

FORMAT E FUTURIT TË SHQIPES NË PËRQASJE ME ATO TË GJUHËVE BALLKANIKE[1]

KDU 811.18-26

1. Për një futur të lashtë sintetik të protoshqipes

Futuri sintetik me ***-syŏ,*** që nuk ishte i gjuhës së lashtë ie, por që e kishin krijuar disa gjuhë, si gjuhët indoiraniane e baltike e që e ka edhe greqishtja e vjetër në formën *-sō*,[2] dëshmohet se ishte edhe i protoshqipes në formën e pjesores pësore të futurit me *-shëm* < ***-syŏ** + ***-mŏ*: [i thyeshëm, i dukshëm, i pishëm etj]. Prapashtesën ***-mŏ** ~ ***-mā**, siç jemi shprehur në veprën *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes,* (Prishtinë, 1980) e zbulojnë si formant të participit mediopasiv të njëkohësisë emrat si *bimë* = që bin, *mjelm* = që milet, *pështymë* = që pështyhet, *frymë, shkelm* etj., që dalin të nominalizuar në të dy gjinitë. Eric Hamp-i në vitin 1973 e kishte barazuar prapashtesën *-m* të shqipes me atë të baltosllavishtes e të luvianishtes, ku ajo e kishte vlerën e shënuesit të participit pasiv të prezentit ashtu si dhe në gjuhën shqipe, duke u shprehur se kjo e rrit listën e lidhjeve baltosllave dhe shqipe. Edhe në greqishten e vjetër mbi futurin me *-sō* është shtuar prapashtesa *-meno-* e mediopasivit të njëkohësisë për të krijuar participin medial të futurit (lusómenos), të futurit ekzakt (lelusómenos) dhe të futurit të dobët (ludhesómenos). Trajtimi i prapashtesës *-shëm* si formant i dikurshëm i participit pasiv të futurit mbështetet dhe

---

[1] Kumtesë në Konferencën Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit, Prishtinë, 2011. Redaksia vendosi ta rimarrë këtë studim me rastin shuarjes së albanologut të çmuar si një nga më të vonat prej tij.

[2] Greqishtja kishte dy forma të futurit, njërin me *-mai* – nga një lidhore e vjetër, tjetrin me ***-sō*** nga dezideravi i vjetër, Pierre Montei, Eléments de phonétique et de morphologie du latin, Paris, 1986, f. 329.

në kuptimin që e zbulojnë mbiemrat deverbativë të tipit i thyeshëm = që mund të thyhet, a më parë: që do të thyhet, i pishëm = që mund të pihet a që do të pihet, i përdorshëm = që mund të përdoret a që do të përdoret etj.

Në vitet '50 Tamás i rimori hulumtimet lidhur me gjuhën dhe letërsinë shqipe. Në bazë të marrëveshjes kulturore të nënshkruar midis Hungarisë dhe Shqipërisë më 1951, në verë të vitit 1952 ndërmori një udhëtim studimi në Shqipëri bashkë me me kolegun e tij István Schütz. Qëllimi kryesor i udhëtimit qe rishikimi i dorëshkrimit të fjalorit shqip-hungarisht, të parit dhe deri tash të vetmit fjalor të këtij lloji. Fjalori ishte një punë pionieri, sepse ishte një nga fjalorët e parë dygjuhësh të gjuhës shqipe. Gjatë qëndrimit në Shqipëri Tamás e István Schütz kanë takuar gjuhëtarët më të rëndësishëm shqiptarë: Eqrem Çabej e Alexandër Xhuvani. Pas kthimit nga Shqipëria Tamás botoi dy dokumente lidhur me udhëtimin e tij: një relacion të shkurtë, dhe një studim të gjerë mbi formimin e gjuhës letrare shqipe. Më 1952, me redaktimin e Tamás-it u botua antologjia e parë e poezisë shqipe ném hungarisht. Më 30 nëntor 1954 në festimin e organizuar nga Lidhja e Shkrimtarëve Hungarezë për të shënuar çlirimin e Shqipërisë, Tamás bëri një paraqitje të gjerë për historinë e letërsisë shqipe, që ka mbetur dorëshkrim deri sot. Për motivet e përmendur mendoj se mund të poohoj që Lajos Tamás qe vërtet nismëtari i studimeve gjuhësore e letrare shqiptare në Hungari. Traditën e hulumtimeve albanologjike në Hungari e ka vazhduar më vonë nxënësi i tij István Schütz.

Bardh RUGOVA, Prishtinë

PËRFAQËSIMI FOLËS: RASTI I MBIEMRAVE TË SHQIPES

KDU 811.18’36-26

Ky studim mëton të tregojë se si zgjedhjet gjuhësore ndikohen nga njësi që dalin përtej fjalisë. Studimi trajton klasifikimin e mbiemrave të shqipes, duke i vënë në rrafshin e përfaqësimit folës dhe synon t’i nxjerrë përgjigjet e këtyre pyetjeve:

Si mund të klasifikohen mbiemrat e shqipes në rrafshin tekstor?

Si mund të shërbejë klasifikimi tekstor i mbiemrave për ta përcaktuar përfaqësimin tekstor?

Dy pyetjet mund të duken pothuajse e njëjta gjë. Punimi niset nga hipoteza se mbiemrat e shqipes mund të klasifikohen për nga mundësia e tyre për të shprehur këndvështrim tekstor, pra edhe përfaqësim, por, njëherësh, kjo aftësi e tyre shërben edhe si shënjues që do t’i klasifikojë më tutje tekstet sipas përfaqësimit folës. Prandaj, në këtë rast kemi të bëjmë me dy kahje të të njëjtit vektor.

Studimi do të realizohet duke analizuar në mënyrë kuantitative mbiemrat në dy kategori të ndryshme tekstesh: një tekst letrar me përfaqësim të pritshëm subjektiv dhe një joletrar, rrëfime me lajm të gazetave, me përfaqësim të pritshëm objektiv. Korpusi letrar i zgjedhur për këtë punim përbën hyrjen dhe një pjesë të kapitullit të parë të Kështjellës së Ismail Kadaresë (botimi i vitit 1978, Naim Frashëri, Tiranë) me gjithsej 19 paragrafë dhe 1718 fjalë. Si grup kontrolli është korpusi joletrar, i gazetave, i paraqitur te Rugova (2008, 2009). Krahasimi i mbiemrave në të dy korpuset do të tregonte nëse mbiemrat mund të shërbejnë për përcaktimin e përfaqësimit tekstor.

Këndi i vështrimit

Koncepti i këndvështrimit është një ndër kategoritë e gramatikës së tekstit dhe trajtohet në gjuhësi që nga vitet pesëdhjetë e gjashtëdhjetë (Benveniste 1959, Werlich 1966, sipas Dykro, Todorov 1984).

Këndi nga i cili kundrohet bota dhe mbi të cilin realizohen zgjedhjet gjuhësore brenda tesktit do të quhet këndvështrim i tekstit.

Studimi i tij ka dy boshte: atë të zgjedhjes gjuhësore (stili) dhe të vërejtjeve të qëndrimeve, të prirjeve dhe të ideologjive të dërguesit të tekstit (gjuhësia kritike).

Varësisht nga këto dy boshte, çështja e këndvështrimit të tekstit mund të trajtohet në këndvështrimin e strukturës, të funksionit dhe të përmbajtjes – secili nga ta këndvështrim më vete i një teksti që i nënshtrohet analizës. Për nga ajo se çka mund të përbëjë këndvështrim, do të mund të dalloheshin katër kategori (Fowler 1986, Simpson 1994:10): koha, hapësira, individi (psikologjia) dhe shoqëria (ideologjia). Dy të parat janë të lidhura me pamjen si njësi statike (përshkrim) dhe dinamike (pra, në rrjedhë kohore, rrëfim).

Këndvështrimi i individit si këndvështrim psikologjik ka të bëjë me mënyrat se si teksti është hartuar përmes vetëdijes së rrëfimtarit (Simpson 1994:10). Kjo niset nga ideja se dërguesi është një person me mendime të vetat dhe me shqisa e dije të kufizuara. Mbështetur në këto kufizime ai e bën edhe interpretimin e botës. Këndvështrimi në rrafshin e ideologjisë ka të bëjë me qëndrimin dhe bindjet e individit brenda shoqërisë.

Për këtë studim me rëndësi është këndvështrimi i individit.

Një prej mënyrave se si shprehet ky këndvështrim është përfaqësimi tekstor, të cilin do ta përkufizojmë si zgjedhje gjuhësore të përcaktuar varësisht nga qëndrimet e rrëfyesit kundruall faktorëve kontekstualë.

Werlich (1983:139) përfaqësimin sipas këndvështrimit të individit e ndan në bazë të dy boshteve: sipas përfshirjes së rrëfyesit në ligjërim dhe sipas përfshirjes së ligjërimeve të të tjerëve. Sipas boshtit të parë bëhet ndarja e teksteve objektive dhe subjektive, sipas boshtit të dytë ligjëratë e drejtë – ligjëratë e zhdrejtë.

Në trekëndëshin rrëfyes – i adresuar – objekt i diskutimit, orientimi mund të realizohet sipas cilitdo nga këto njësi. Kur orientohet nga dërguesi, teksti bëhet subjektiv.

Subjektiviteti shprehet, para së gjithash, në kontekste diskursi përmes formave gramatikore të tjera: foljeve, ndajfoljeve, kohës, modalëve, anaforës (Smith 2003:155) mbiemrave dhe mund të zgjerohet tutje fjalisë.

Në përfaqësimin subjektiv, dërguesi i lidh dukuritë me përvojat e tij personale të kohës, të hapësirës, të cilësive e kështu me radhë (Werlich 1983:139). Në përfaqësimin objektiv, orientimi bëhet sipas objektit të diskutimit. Me këtë rast duhet të kemi parasysh se ka dallim mes objektivitetit si përmbajtje dhe përfaqësimit objektiv. Përfaqësimi objektiv përfshin zgjedhje gjuhësore, në të cilat qëndrimi personal i dërguesit nuk manifestohet në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Tekstet subjektive janë karakteristike për përshkrimet impresioniste, rrëfimet me rrëfimtar personazh, në komente dhe instruksione. Tekstet me përfaqësim objektiv paraqiten në përshkrimet teknike, raporte (rrëfime me lajm), argumentime shkencore. Tekstet, po ashtu, mund të kenë përfaqësime të ndërlidhura objektive dhe subjektive.

Ndonëse tekstet subjektive dhe objektive, në radhë të parë, dallohen për nga prania ose jo e vetës së parë brenda tekstit, përfaqësimi tekstor manifestohet edhe me koncepte të tjera, përfshirë llojet e mbimerave.

Në përgjithësi, nocioni i këndvështrimit tekstor dhe i përfaqësimit të tekstit është trajtuar në studimet e shqipes qysh nga vitet shtatëdhjetë përmes studimeve të Ismajlit (1977 [1980], 1985). Fusha përgjithësisht më e trajtuar në kuadër të këtyre studimeve është ajo e trajtimit të foljeve (Ismajli 1980, 1985, Kelmendi 1993, Rugova 2006, Tahiri 2009).

Në këtë punim do të hulumtohet roli i përfaqësimit të tekstit në klasifikimin e mbiemrave të shqipes.

Klasifikimi i mbiemrave

Gramatikat e shqipes mbiemrat i klasifikojnë në tri rrafshe the-

melore: formal – të nyjshëm dhe të panyjshëm, për të cilën ndarje edhe nuk kemi shumë për të diskutuar; kuptimor-funksional: cilësorë – marrëdhëniorë dhe sipas taksonomisë semantike: me ç'rast ndarja është në pesë grupe: ngjyrë; formë, madhësi, shtrirje hapësinore; shije; veti fizike a gjendje shpirtërore dhe cilësi karakteri a cilësi fizike.

Në klasifikimin e përgjithshëm semantik të mbiemrave, Dixon (1977 [1982]) këto pesë kategori i zgjeron në tetë dhe, sipas tij, gjashtë nga to janë objektive dhe 2 subjektive. Megjithatë, është e vështirë që vetëm për nga klasa semantike të përcaktohet përfaqësimi subjektiv dhe ai objektiv. Sa për ilustrim, nocioni i madhësisë mund të jetë objektiv vetëm në një masë të ofruar krahasimi.

Konceptet e gramatikës së shqipes të Akademisë janë të ngjashme me të autorëve të tjerë që kanë bërë klasifikimin e mbiemrave, kryesisht duke e përfunduar analizën e tyre vetëm brenda kufijve të fjalisë.

Selman Riza (1952:386, 415) për ndajemnat, siç i quan ai, thotë se veç cilësisë mund të shprehin edhe lëndën përbërëse, prandaj i ndan në cilësorë dhe landorë-përkatësorë. Leonard Newmark (Newmark et al, 1982) i trajton në kuadër të funksionit si sintagma mbiemërore që modifikojnë një emër a një përemër qoftë si modifikator cilësor, qoftë përmes foljes si modifikues predikativ.

Camaj (1984:54) I cek vështirësitë e klasifikimit të mbiemrave, duke nxjerrë tri kritiere bazë: 1. vetë kuptimin e fjalës prej nga ka derivuar ar – i artë; 2. funksioni i formantit (p.sh., sufiksi të që shpreh atribut) dhe 3. kategorisë gramatikore nga e cila ka dalë, përemër, folje etj.

Polisi (2009:103) ndarjen e bën në cilësorë dhe përcaktorë-përkatësorë, ngjashëm me Rizën.

Bokshi (2012:30) i trajton modalitetin dhe aspektin te mbiemrat: *i thyeshëm* (epistemik) vs i *thyer (deontik),* me ç'rast i thyeshëm, pos mosshënjimit të përfunduar të veprimit, e jep edhe modaliettin epistemik të mundësisë, ndërsa i thyer paraqet veprim të përfunduar.

Një studim më i plotë i klasifikimit të mbiemrave, mund të gjendet te Dhrimo (2008).

Mirëpo, siç mund të vërehet në punimet e mëhershme (Rugova 2008, 2009) i tërë klasifikimi i mbiemrave nuk është aq i prerë sa duket në shikim të parë, nëse kundrohet në kuadër të tekstit si njësi.

Ibrahim Rugova te Strategjia e kuptimit (1980), ndonëse me tjetër terminiologji, e trajton këndvështrimin e tekstit, duke e analizuar një trend të poezisë së Kosovës të fundit të vitit tetëdhjetë që shfrytëzon përfaqësim objektiv teksti në poezi, duke përdorur mbiemra objektivë: trëndafili i drunjtë vs trëndafili i zi, me ç'rast i drunjtë përbën përfaqësim objektiv, kundruall i zi që përbën përfaqësim subjektiv.

Kur u bë përpjekja për të ndarë në mënyrë empirike mbiemrat në cilësorë a marrëdhëniorë ose sipas taksonimisë nuk qe e mundur të përcaktohej fare përfaqësimi i tekstit, sepse numri i mbiemrave në tekstin objektiv dhe në atë subjektiv nuk ka ndryshuar shumë.

Në korpusin joletrar të gazetës Zëri (Rugova 2009:206), mbiemrat përbëjnë 3,67 për qind të fjalësit të përgjithshëm, ndërsa në korpusin letrar, në sekuencën e romanit Kështjella të Kadaresë, mbiemrat përbëjnë 4,77 për qind të fjalësit të përgjithshëm (82 mbiemra në gjithsej 1718 fjalë). Ky dallim nuk është aq i madh, sa të mund të nxjerrim përfundimin se paraqitja ose jo e mbiemrave në një tekst përbën më vete njësi për matjen e përfqësimit tekstor.

Prandaj është kërkuar ndihmë në një klasifikim më të thellë – tekstor.

Në korpusin letrar janë gjetur mbiemra të tillë si i/e gjatë (7 raste), i/e madhe (6 raste), i/e frikshëm/e, i/e rëndë dhe i/e qetë (nga 3 raste) e kështu me radhë që nuk gjenden në korpusin e gazetave.

Le ta diskutojmë mbiemrin i madh. Po e nisim me një krahasim: 1) djali i madh si madhësi ose moshë e përgjithshme dhe 2) djali i madh si renditje moshe brenda familjes. Në këta shembuj, dallimi mes shembujve 1 dhe 2 është në ekzistimin e një konvente matëse.

Në terma të Halliday dhe Hasan (1976), rasti i parë tregon epitet, ndërsa rasti i dytë klasë. Rasti i dytë, si i tillë është objektiv, ndërsa rasti i parë subjektiv, sepse shpreh qëndrim folës, këndvështrim të dërguesit në

kuadër të komunikimit, ndërsa kokës së sintagmës ia jep shtresimin e nuancës.

Ky shembull bën që mbiemrat në bazë të këndvështrimit folës dhe përfaqësimit t'i klasifikojmë semantikisht në dy grupe të mëdha: mbiemra neutralë dhe mbiemra që shprehin qëndrim.

Përcaktimi i njërës kundruall tjetrës shprehet mbi ekzistimin ose jo të një konvente, këndi kuptimor a mërrëveshjeje, mbi të cilën kryhet përcaktimi.

Te shembulli 2), përcaktori mbështetet në bazë të kuptimit të drejtpërdrejtë konvencional: i madh, kundruall, i mesëm, i tretë. Djali që ka lindur më përpara se djali tjetër është djalë i madh. Kjo hierarki konvencionale e përcakton kuptimin e i madh dhe e bën mbiemrin të jetë neutral dhe të mos jetë i lidhur me qëndrimin e folësit.

Te shembulli 1), një bazë e tillë mungon, duke lënë që shkalla kuptimore të caktohet nga vetë dërguesi dhe konteksti. Pra, nuk ekziston një konventë e përgjithshme se çfarë quhet e madhe.

Harald Weinrich (2005) i përcakton kriteret themelore të semantikës tekstore, duke thënë se brenda fjalisë secili kuptim është abstrakt, por ai kuptim bëhen konkret brenda tekstit si të tërë. Së këndejmi, koncepti i madh pa një bazë të drejtpërdrejtë krahasimi nuk ka konventë, mbi të cilën do të mbështetej. Prandaj, përdorimi i saj është zgjedhje gjuhësore që e shpreh qëndrimin individual të folësit. Nuk ekziston një moshë e prerë, apo masë centimetërshe mbi të cilën automatikisht e quajmë dikend të madh. Çdo përdorim i tillë i mbiemrave përbën epitet të mbështetur në kritere individuale. Mirëpo, i kuq, i hekurt, i artë në kuptimet e tyre të drejtpërdrejta mbështeten në konventa të caktuara gjuhësore dhe si të tilla shërbejnë si klasë dhe janë neutrale.

Duke e bërë klasifikimin në mbiemra neutralë dhe mbiemra që shprehin qëndrim, të dhënat nga krahasimi i dy korpuseve janë në shpërputhje mes vete.

Mbiemrat te sekuenca e Kështjellës:

Mbiemrat që shprehin qëndrim te sekuenca e Kështjellës[1]:
e bukur; e çuditshme; e çrregullt; e dendur x 2; e frikshme x 3; e gjatë x 7; intime; e këndshme, e largët, e lartë, e lodhshme, e lodhur, e madhe x 6, e mbushur, e ndryshme x 2, e ngushtë, e nevrikosur, ogurzezë, e pafund x2, e pakapshme, e panatyrshme, e panumërt, e papushtueshme, e pashmangshme, e përhershme, e përgjumur, e prishur, e qetë x 3, e re, e rëndë x 3, e rregulluar, e rrethuar, e saktë, e shëndetshme, e shurdhër (te heshtje e shurdhër), teknike, e veçantë x 2, e vogël, e vjetër, më të zgjedhur, e zymtë.

[1] Mbiemrat janë paraqitur qëllimisht në gjininë femërore.

Mbiemrat neutralë te sekuenca e Kështjellës:
e bardhë x 2,
e dëmtuar,
e fundit,
e hekurt,
e kuqe x 2,
e mbjellë,
e mbuluar,
e mbyllur,
e ngarkuar,
më të ngushtë,
ndëshkimore (te sintagma ekspedita ndëshkimore),
e plotë x 2,
më të reja,
e saktë,
e vdekur,
e verdhë,
e zezë,
e zgjedhur.

Një pjesë e këtyre mbiemrave duan interpretim kotekstual dhe/ ose kontekstual. Sa për ilustrim, mbiemri e ngushtë' është mbiemër që shpreh qëndrim, përderisa nuk ka një konventë dimensionale për të ngushtën, por në shkallën krahasore ajo automatikisht bëhet neutrale, meqë mbështetet në konventën e krahasimit, me ç'rast është e përcaktueshme dhe e matshme se cila është më e ngushtë nga dy njësitë. Në anën tjetër, te sintagma ekspedita ndërshkimore, mbiemri ndëshkimore nuk shpreh qëndrim, sepse paraqet një klasë të caktuar kundruall ekspeditave të tjera. Kjo tregon se një pjesë e mbiemrave konkretizohen neutralë ose jo varësisht nga raporti me emrin.

Në sekuencën e hulumtuar raporti i mbiemrave që shprehin qëndrim kundruall atyre që nuk shprehin qëndrim është 61 me 21 në favor të mbiemrave që shprehin qëndrim (shprehur në përqindje 74,39% – 25,61%). Në korpusin joletrar, të gazetës Zëri me pritshmëri të tekstit objektiv, ky raport është thuajse i anasjelltë: 43 mbiemra janë neutralë dhe 12 janë të tillë që shprehin qëndrim (në përqindje 78,18% neutralë – 21,82% që shprehin qëndrim). Një pjesë e këtyre 12 mbiemrave që shprehin qëndrim përfshijnë njësi të pjesës përmendëse në ligjëratën e drejtë, duke mos qenë si të tilla pjesë të kumtimit të autorit.

Përfundime

Të trajtuar jashtë kufijve të fjalisë, mbiemrat e shqipes mund të klasifikohen mbështetur në këndvështrimin tekstor (konkretisht sipas përfaqësimit tekstor), varësisht nga qëndrimi që ka autori/folësi kundrejt botës së kumtuar. Kur autori/folësi vë distancë kundruall botës së rrëfyer, shfrytëzon mbiemra neutralë, ndërsa kur shpreh qëndrim mbi botën e kumtuar shfrytëzon mbiemra që shprehin qëndrim.

Përdorimi i mbiemrave më vete si sasi nuk arriti të bënte dallim substancial ndërmjet një teksti me përfaqësim objektiv dhe një teksti me përfaqësim subjektiv. Megjithatë, klasifikimi i tyre në rrafshin tekstor tregoi se mbiemrat që shprehin qëndrim janë shënjues të teksteve subjektive, ndërsa mbiemrat neutralë janë më karakteristikë për tekstet objektive.

Bardh RUGOVA, Prishtina

TEXT PRESENTATION: THE CLASSIFICATION OF ADJECTIVES IN ALBANIAN

Traditional grammar has limited classification of adjectives within the sentence and can not be used for measuring text presentation. Text grammar, however, introduces the category of point of view. With reference to the constitution of a text, point of view refers to that set of constituents which indicates and delimits aspects of the mental and physical positions from which the encoder speaks in a communication process and to which he relates all his references to phenomena (Werlich 1983:133). Presentation is that aspect of point of view which indicates in the encoder's linguistic choices what attitude he takes to major contextual factors (Werlich 1983:139). The most general form of text presentation is with reference to himself as the encoder – creating two main cetagories: subjective vs objective presentation.

Lets take an example: *djali i vogël*.

Adjective *i vogël* differs when it comes to text representation and taxonomy. In terms of Halliday and Hasan (1976), i *vogël* as the child born after another one, shows epithet, whereas i vogël as hight or age per se shows clasifier. As such, first case is objective, while second case is subjective. This example, according to the point of view and presentation, makes us classify adjectives in two large groups: neutral adjectives and adjectives that express encoders attitude.

Positioning of the one versus another is conveyed upon the existence or inexistence of a convention, a semantic angle or agreement upon which this positioning is made.

In the case of djali *i vogël*, the determiner is based upon direct conventional meaning: *i vogël* (little) versus *i madh, i mesëm, i tretë* (big, medium, third). A son, born after the first son, is *djali i vogël*.

This conventional hierarchy determines the meaning of *i vogël* and makes the adjective to be neutral.

In the case of *djalë i vogël*, as age or height, there is no such base, leaving the semantic level to be determined by the encoder and context. Therefore, there is no general convention as to what is called *i vogël* (little).

In a comparative case, we may determine a boy that is rather smaller than the other, but we do not have a universal convention for the little boy. Here, apparently, concepts and social, ethnic, psychological as well as other perceptions play a role too.

Therefore, while there is no convention according to which a clear-cut criterion would be set in order to define these concepts, classifications of such as form; size; spatial distribution; taste; physical or emotional state and physical and mental characteristics like: little, tall, short, pretty, easy, successful, are subject to attitudes of individual or social criteria and make these adjectives be subjective or expressed in our terms – adjectives that express attitude.

However, superlative adjectives, i.e. comparative ones of size and spatial distribution based on the criteria of comparision, create neutral adjectives.

Bibliografi**:**

Bokshi 2012: Bokshi, Besim. Format e futurit të shqipes në raport me ato të gjuhëve ballkanike. – In: Ismajli, Rexhep (ed.) *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit*. Prishtinë: AShAK, 2012

Ismajli 1980: Ismajli, Rexhep. *Shumësia e tekstit.* Prishtinë: Rilindja

Ismajli 1985: Ismajli, Rexhep. *Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit (1706).* Prishtinë: Rilindja.

Camaj 1984: Camaj, Martin. *Albanian Grammar*. Wiesbaden: Otto Harrassowitz

Dixon 1982: Dixon, Robert M. V. *Where have all the adjectives gone*. Mouton: Berlin; New York

Dykro, Todorov 1984: Dykro, Osvald; Cvetanov, Todor. *Fjalor enciklopedik i shkencave të ligjërimit*, Prishtinë: Rilindja

Dhrimo 2008: Dhrimo, Ali. *Për shqipen dhe shqiptarët I*. Tiranë: Infbotues

Fowler 1986: Fowler, Roger, *Linguistic Criticism*, Oxford: Oxford University Press.

Halliday, Hassan, 1976: Halliday Michael A. K., Hassan Ruqaiya. *Cohesion in English*. London: Longman

Kelmendi 1993: Këlemdni, Tafil. *Funksionet e kohës foljore të pakryer të dëftores në shqipen e sotme letrare*, Prishtinë: Universiteti i Prishtinës

Newmark et al 1982: Newmark, Leonard; Prifti, Peter; Hubbard Philip. *Standard Albanian: A reference Grammar for Students*. Stanford: Stanford University Press

Polisi 2009: Polisi, Mehdi. *Gramatika e gjuhës turke – fonetika dhe morfologjia*. Shkup: Logos A

Riza 1952: Riza, Selman. *Gramatikë e sërbo-kroatishtes*. Prishtinë: Mustafa Bakija

Rugova 2008: Rugova, Bardh. Dizajni i audiencës. – In: Ismajli, Rexhep (ed.) *Studime filologjike shqiptare*. Prishtinë: AShAK

Rugova 2009: Rugova, Bardh. *Gjuha e gazetave*. Prishtinë: KOHA

Rugova 1980: Rugova, Ibrahim. *Strategjia e kuptimit.* Prishtinë: Rilindja

Simpson 1994: Simpson, Paul, *Language, Ideology and Point of View*. London, New York: Longman

Smith 2003: Smith, C. *Modes of Discourse. The Local Structure of Texts*. Cambridge University Press: New York

Tahiri 2009: Tahiri, Lindita. *Rrëfimi impersonal i Kadaresë*. Shkup: Vatra

Werlich 1983: Werlich, Egon. *A Text Grammar of English*. Heidelberg: Quelle und Meyer

Weinrich 2005: Weinrich, Harald, *Linguistics of Lying & Other Essays*. Washington: University of Washington Press

Rexhep ISMAJLI, Prishtina

DYNAMIQUE DES STRUCTURES DE L'ALBANAIS STANDARD

KDU 811.18'26
811.18'271

Abstract

Depuis les décisions sur l'adoption de l'actuel albanais standard (Prishtina 1968, Tirana 1972), la situation de l'espace de communication pour l'albanais standard a bien changé, quoique des divisions persistent: la division principale entre l'espace de la République d'Albanie et celui de l'ex-Yougoslavie, caractérisé par des frontières à perméabilité contrôlées des deux côtés, vient d'être remplacé par une nouvelle division entre la République d'Albanie, République de Kosova, République de Macédoine, les Albanais de Serbie, ceux de Monténégro, caractérisés par des frontières perméables et une diaspora stratifiée avec des possibilités d'élargissement de l'intégration. Dans ces conditions, les impacts des nouvelles technologies de communication sur la normalisation de l'espace de communication en albanais standard paraissent être énormes. Les procéssus de globalisation ont eu des conséquences positives dans ce sens aussi, la totalité favorisant l'intégration.

L'élargissement de l'espace de communication, la dynamique des structures de la langue standard par rapport à celles des ex-variantes littéraires guègue et tosque, aussi bien que des variétés dia-topiques et dia-stratiques, vient de prendre un nouvel aspect et une nouvelle allure.

L'impact des différences au niveau des systèmes vocaliques avec des nasales et de différenciation de quantité (en guègue), parait se refléter au niveau dia-topique de la réalisation du standard. Au niveau grammatical vont être discuté les refléctions sur le système verbal de l'impact de l'infinitif du guègue, des types de formation du futur à des conséquences de différentiation fonctionnelle entre le volitif et le nécéssitatif, les questions de genre, du nombre, etc. Au niveau du lexique la nouvelle situation accentue des directions disparates: l'accroit des possibilités d'intégration venant de toutes parts de variation dia-topiques et dia-stratiques, mais aussi de différentiations provenant des influences étrangères italienne, d'une part, allemand (y inclus l'intermédiation serbo-croate du XXe siècle), de l'autre.

Les développements concernant le processus de standardisation et de l'implémentation des résultats de cette standardisation de la langue albanaise durant le dernier siècle représentent au moins deux dimensions de dynamisme à des rythmes différents, mais mutuellement corrélés:

1. **Une dimension spatio-territoriale**: premièrement il y a la division de l'espace albanophone après 1913 entre l'État d'Albanie et le reste réparti entre la Yougoslavie (Serbie et Monténégro) et la Grèce; avant la IIème Guerre Mondiale l'albanais ne jouissait de droit publique qu'en Albanie; durant la IIème Guerre mondiale réunification d'une grande partie avec l'Albanie sous l'Italie et ouverture des écoles primaires et secondaires; après cette Guerre l'albanais gagne un espace limité avec le statut de langue minoritaire à Kosova, en Macédoine, au Monténégro et en Serbie du Sud dans le cadre de la Yougoslavie socialiste, généralement au niveau des écoles primaires et partiellement secondaires jusqu'en 1966 et d'un niveau plus élargi avec le statut de langue co-officielle à Kosova dans l'enseignement jusqu'au niveau universitaire, dans l'administration régionale, dans la vie publique après; dans la période 1974-1989 l'albanais jouissait aussi d'un statut de langue utilisée dans la documentation parlementaire fédérale, tandis qu'en Macédoine, Serbie du Sud (Vallée de Presheva) et Monténégro d'un statut inférieur. L'abolition de l'Autonomie de Kosova en 1989 apportait la suppression du statut de la langue albanaise à Kosova et dans toute la Yougoslavie. Durant les années '90 l'organisation du réseau d'écoles à tous les niveaux en langue albanaise à Kosova représentait l'un des aspects les plus importants de la Résistance. Le statut publique de la langue albanaise dans la République indépendante de Macédoine s'est sérieusement dégradée jusqu'en 2001, quand les droits linguistiques ont servi de prétexte pour une vrai guerre interethnique. Après la Guerre de 1999 et la libération, à Kosova, sous protectorat Onusien, le statut de langue officielle sera réservé à l'anglais, l'albanais et le serbe, le premier gardant le statut de langue source en cas de conflits.

La Constitution de la République de Kosova indépendant garanti à l'albanais et au serbe un statut de langue officielle au niveau de la République, tandis que le statut de langue minoritaire à droits d'officialité aux langues bosniaque, turque et rom, là où les Turcs et les Roms attendent l'é-

chelle d'une minorité de 5%. Le statut de l'anglais est réglé selon les lois internationales.

En Macédoine actuellement, selon la loi Badinter l'albanais jouit d'un statut de langue co-officielle dans les municipalités dans lesquelles ils arrivent à l'échelle de 20% de la population. Une contradiction surgit ici du fait que, officiellement, dans la totalité de la population de la République de Macédoine les Albanais participent par plus de 25%, tandis que la langue albanaise ne jouit du statut d'officialité que dans les municipalités à plus de 20% de population albanaise.

L'albanais jouit des droits de pleine officialité en Albanie, d'officialité partagé avec le serbe à Kosova, d'officialité restreinte à coté du macédonien jouissant pleine officialité en Macédoine, de langue minoritaire au Monténégro et en Serbie du Sud, de langue de groupe ethnique selon la Charte Européenne des langues minoritaires en Italie du Sud, de langue sans statut en Grèce et en Turquie, ainsi que dans le reste de la diaspora. Trois religions traditionnelles, plusieurs sectes et des nouveaux venus rajoutent davantage à ce dynamisme politico-spatial.

2. **Une dimension d'évolution le long de son histoire interne**: analphabétisme énorme et manque de toute possibilité de manifestation publique en Yougoslavie jusqu'en 1940; un réseau limité d'écoles primaires et secondaires durant la IIème Guerre Mondiale et après jusqu'en 1966; très peu de livres, de périodiques sporadiques et un quotidien (*Rilindja*) depuis 1957, des émissions radio. Durant les années '950 il y a eu d'importantes initiatives, comme celle de la fondation de l'Institut d'Albanologie à Prishtina en 1953, vite fermé deux ans après; une activité importante pour la standardisation de la langue, toujours séparément de l'Albanie (1952, 1957, 1964, 1968), et jointe (1972); l'élargissement du système scolaire, universitaire; des éditions de livres, de journaux, de radio et tv, des productions cinématographiques, des échanges culturels et scientifiques avec les voisins, y inclus l'Albanie entre 1966-1989 (cf. Ismajli 1998, Ismajli 2005), etc.

Depuis les décisions sur l'adoption de la langue littéraire unifiée (Prishtina 1968, Tirana 1972), la situation de l'espace de communication

publique en albanais a bien changé, quoique certaines des divisions persistent: en premier lieu celle entre l'espace de la République d'Albanie et celui de l'ex-Yougoslavie, caractérisé par des frontières à perméabilité contrôlée des deux côtés et des systèmes politiques dirigistes, vient d'être remplacée par une nouvelle division entre la République d'Albanie, la République de Kosova, la République de Macédoine, la Vallée de Presheva en Serbie, le Monténégro. Les voies du commerce entre ces espaces s'intensifient parallèlement avec la croissance de la production. Grâce à la maitrise des langues européennes (anglais, allemand, italien, français), ensuite voisines (grec, turc, serbe, macédonien), et d'une assez large scolarisation, la très jeune population est mobile. Le réseau d'établissements scolaires est assez large, l'inclusion des jeunes dans la vie universitaire est toujours grandissante, mais le taux de chômage est le plus élevé en Europe. Il y a un réseau d'à peu près 40 journaux en circulation à l'intérieur de l'unité politico-territoriale, d'un tirage assez restreint, sauf via internet. La production des livres est libéralisée; les traductions sont énormes, surtout en Albanie, qui domine de loin le marché albanophone des livres. Un rôle énorme dans l'affranchissement des frontières et dans le nivèlement des manières de parler est joué par le réseau bien développé des médias électroniques. Dans les conditions de ce dynamisme sociétal toutes les variations de l'albanais standard, substandard, dialectal et slang gagnent leurs chances d'être présentes dans des espaces publiques. Ainsi, l'élargissement de l'espace de communication, la dynamique des structures de la langue standard par rapports à celles des ex-variantes littéraires guègue et tosque, aussi bien que des variétés diatopiques et diastratiques, vient de prendre un nouvel aspect et une nouvelle allure.

Écrit depuis le XVe siècle, l'albanais jouit d'une tradition de langue littéraire à des variantes basées sur les différents dialectes: guègue, tosque et arbëreshë. Chacune d'elles hérite des valeurs de toute une littérature. Depuis son adoption l'albanais standard représente la variation la plus répandue. Pourtant, la littérature en guègue à vieille tradition depuis le XVIe s. ne survivant entre 1972-1990 que dans la diaspora, ressuscite après, pour gagner de l'espace surtout aux alentours de l'ancien centre d' irradiation de Shkodra. Au-delà la variante scutarine du guègue, il y a la

tradition généralisé du guègue littéraire développée par la suite de la *Komisija letrare de Shkodra*, dont la base était le dialecte des alentours d' Elbasan et d'Abanie Centrale. C'était la langue officielle de l'État albanais depuis 1923 jusqu'a 1945 et la seule langue littéraire et commune pour les Albanais de Yougoslavie jusqu'à 1968. Cette langue littéraire a eu un grand impact sur l'albanais cultivé de Kosova, devenant aussi la langue non-dialectale de la famille, de l'école et de la vie sociale. Elle est toujours vivante à plusieurs niveaux de communication publique. La dernière orthographe du guègue en Albanie vient de 1956, tandis qu'à Kosova de 1964 (Ismajli: 2006).

Les processus de standardisation de l'albanais dans des conditions d'un polycentrisme imposé politique et culturel ont été marqués par des contradictions. Des tendances identifiables de l'évolution de la langue ont joué un rôle très important. Les solutions acceptées ont du être accordées avec les aspirations nationales. A Kosova la population devait apprendre la langue standard basée sur le tosque parlé sans contacts directes avec celuici. Ceci aurait une conséquence positive, de l'autre côté: une grande partie de la population étant confrontée à ces difficultés, la conscience que la langue standard est un moyen culturel pour l'apprentissage duquel l'on doit investir plus d'énergie devient plus largement acceptée. La conviction que la langue standardisée a toujours besoin d'être soigné s'élargit. Et avec ceci la base pour l'élargissement des aires de l'utilisation de la langue standardisée. Ainsi qu'en Kosova nous aurions une situation complexe de communication. Dans la famille et dans la vie quotidienne de la société généralement rurale de Kosova les formes dialectales continuent à être utilisées, tandis que dans les couches intellectuelles et partiellement dans les villes on rencontre le besoin d'une forme linguistique pas tellement éloigné de la quotidienne, mais qui ne doit pas être dialectale. Par conséquence *language shift* entre les trois variétés devient commun, les interférences entre l'albanais standard et le guègue standard sont larges. Un dynamisme d'espaces de communication d'au moins trois souches vient se cristalliser: albanais standard/ guègue (sub)standard/ guègue dialectal, répondant à des situations extrêmes – formelle, des fois désignée comme 'asphaltée', d'un côté, et 'rurale' ethnographique, ou encore à plein de na-

sales', de l'autre. Entre les deux extrêmes il restait un espace qu'on peut désigner comme neutre:

albanais unifié	guègue littéraire	guègue dialectal.
+ High	- Low	+ Low
+ 'asphalté' - infinitif - quantité des voyelles + ue, réalisé plutôt comme [ū], dans des contextes restreints des participes courts dans le cadre de dérivation nominale et adjectivale	+ neutre, + infinitif, + quantité des voyelles + *ue*, réalisé plutôt comme [ū] dans tous les contextes	- neutre, + 'à plein de nasales' + infinitif, +quantité des voyelles + ue, réalisé plutôt comme [ū] dans tous les contextes
+ formel	+ formel et non-formel	+ non-formel
+ non-familier	+ familier et non-familier	+ familier
+ normé	+ normé	- normé
+ de distance	+ de proximité et de distance	+ de proximité
+ suprarégional non-local	+ régional non-local	+ local

En Albanie les rythmes des développements ont été différents: à la suite du mouvement commun de la Renaissance et la tentative de créer un État au siège à Prizren en 1878, les insurrections à Kosova de 1910-1912 ont abouti à la formation de l'État d'Albanie, hors de qui restent Kosova et les espaces albanophones de Yougoslavie. À la suite du Congrès commun de l'Alphabet de Monastir (1908), la *Komisija e Shkodrës* (1916-1918) réalise un travail très important de standardisation sur les bases des parlers guègues de l'Albanie centrale. En 1923 le projet de la *Komisija e Shkodrës* sera adopté comme langue officielle de l'État albanais. Jusqu'en 1940 il y a eu d'autres tentatives de réglementation linguistique, mais sans succès. Le réseau des journaux et des périodiques prend une allure très large, le système scolaire primaire et secondaire s'élargit et une littérature importante se développe. Des centres d'irradiation sur la base d'une langue de culture fondé sur une des variantes respectives guègue ou tosque de la langue littéraire comme Shkodra, Korça avec son lycée français, Elbasan, Gjirokastra, Vlora et Tirana s'affirment largement. Après la IIème Guerre Mondiale le Régime communiste dominé par des chefs ressortissants du sud du pays impose la variante tosque de l'albanais littéraire. Des activités importantes de narrativisation ont eu lieu durant les années '50 séparément en Albanie et à Kosova. Jusqu'en 1966 le guègue littéraire était permis.

Pourtant, la littérature et les éditions largement contrôlés par le Parti étaient dominées par le tosque. La fameuse Consultation linguistique de Prishtina de 1968, avec sa Résolution d'adopter comme unique orthographe pour l'albanais le Projet d'orthographe basé uniquement sur le tosque publié à Tirana en 1967 venait de clore définitivement la voie séparée de planification linguistique et de standardisation. Le Congrès d'orthographe de Tirana 1972 avec la participation des représentants de Kosova et de la Yougoslavie vient de terminer les activités basiques de standardisation.

Durant les derniers 20 ans il y eu des manifestations de l'utilisation de la variante guègue dans différentes publications littéraires, discursives, journalistiques. Tout ceci étant mit en relation avec l'utilisation très large du guègue parlé semi standardisé, des manques de maîtrise du standard basé sur le tosque, ou encore avec une propre volonté. À Kosova ceci peut être remarqué dans les livres et dans les journaux, tandis qu'en Albanie dans les différentes publications, notamment à Shkodra. Surtout après la libération de Kosova et la déclaration de l'indépendance en 2008, le discours d'insistance sur la possibilité et le besoin d'adoption d'une variante basée sur le guègue pour le nouvel État ne manquait pas. En même temps il y a eu une sorte de reformulation des réactions venant de Shkodra: au lieu des contestations des années '90, on parle maintenant sur le besoin de promouvoir le guègue littéraire comme phénomène de culture et d'histoire littéraire afin de résoudre les problèmes de communication avec le riche héritage littéraire. Pourtant, la Conférence de Durrës 2010 venait d'accentuer l'insistance sur le standard unique, tout en désignant les points précis sur lesquels devaient être entrepris des travaux d'amélioration. Entre temps, en 2012 *Le Conseil inter académique* de la langue standard, fondé en 2004, vient de reprendre ses activités toujours dans la perspective désignée dès les débuts: discussion et étude sérieuse des indications de problèmes dans le fonctionnement de la langue standard dans tous les espaces. Les problèmes de la culture de langue et du dépassement des différences au niveau lexical causées par les divisions de l'espace de communication d'un siècle maintenant paraissent être apportés au centre de la discussion.

2. Les domaines de l'utilisation de l'albanais actuellement

	Guègue		Tosque	Arbë-resh	Albanais standard
	litt.	dialect.			
Documents	(X)	-	(X)	-	X
Discours au Parlement	(X)	-	(X)	-	X
Administration locale	X	X	X	X	X
Conférences	(X)	-	(X)	-	X
RTV news	-	-	-	-	X
Théâtre, cinéma	X	(X)	(X)	-	X
Journaux	X	-	(X)	X	X
Poésie	X	(X)	(X)	X	X
Textes discursifs	X	-	(X)	-	X
Discours familiers	X	X	X	X	(X)
Littérature orale	-	X	X	X	-
Humour	X	X	X		X
Musique	X	X	X	X	X
Cérémonie religieuse					
catholique	X	X	X	-	X
orthodoxe	X	X		X	X
islamique	X	X	X	-	X

Le dynamisme de l'albanais standard pour une bonne part provient de l'histoire du processus. La Résolution du Congrès d'orthographe déjà avait énoncé la possibilité de changements induits par la pratique: *La structure actuelle de la langue littéraire est ouverte et le restera*…. Ceci va de pair avec la conception selon laquelle l'albanais standard unifié représentait *une nouvelle synthèse de la langue albanaise*. L'affirmation du principe de compromis dans la sélection des différents éléments de la norme a déjà donné des fruits au niveau lexical et aussi partiellement au niveau de la structure, ce qui vient de prendre encore plus de poids dans une situation des politiques toujours plus libérales linguistiques. La dynamique des espaces de communication aussi bien que celle des structures de la langue nous disent des choses en faveur de tout ceci.

Selon Androkli Kostallari la base de la langue littéraire *unifiée* (standard) est représentée par les éléments communs *qu'on trouve dans les deux dialectes*, mais il y a aussi des éléments représentants *des traits différenciatifs des dialectes de l'albanais*. Comme éléments communs dans la structure phonologique y sont mentionnés les 29 phonèmes du système

consonantique et les 7 voyelles, qui *dans la lumière des théories actuelles sur les phonèmes et les allophones peuvent être pris comme phonèmes communs de la langue albanaise existants dans des différents parlers des deux dialectes* (Kostallari: 1972).

Le système consonantique de l'albanais standard est structuré selon quatre séries:

occlusives	sourdes	p	t	ts	tš	c	k
	sonores	b	b	dz	dž	ɟ	g
fricatives	sourdes	f	θ	s	š	-	h
	sonores	v	δ	z	ž	j	-
nasales		m	n			ɲ	
latérales			l L				
vibrantes			r				
			R				

Il est vrai que tous les 29 phonèmes consonantiques se trouvent quelque part dans l'albanais dialectal et que, sur ce point, la sélection a été inclusive de manière optimale. Certains de ces éléments font défaut dans certains parlers ou plus larges aires et, par conséquent, ceci représente un des points du dynamisme dans la réalisation du système de la langue standard. Les points de ce dynamisme sont: la neutralisation de l'opposition voisé/ non-voisé des consonnes en position finale, la neutralisation de l'opposition de deux vibrantes, la neutralisation de l'opposition *ll/ dh* et surtout les différences dans la réalisation des palatales *q, gj, nj* jusqu'à leurs défaut dans une large aire de Kosova.

Par conséquent le système, quant à la réalisation parlée, est en mouvement sur les points suivants: dans la majorité des parlers guègues du nord-est la différence entre les palatales et les prépalatales *q, gj/ ç, xh* **[c, ɟ/** ʧ, ʤ] n'existe pas; dans certains parlers guègues les groupes consonantiques *nd, mb, ng* fonctionnent comme un phonème unique /*n*, *m*, *ŋ*/; la codification de ce trait aurait induit des changements sur tout le système, avec des difficultés additionnelles pour la morphologie et la formation des mots.

Mais les difficultés viennent plutôt d'un autre coté, de celui des voyelles. La sélection d'un système de 7 voyelles impose, au contraire,

une restriction. Le principe a été déjà annoncé par le code alphabétique de 1908 qui ne prévoyait pas des moyens d'expression de nasalité et de la quantité distinctive des voyelles. Dans la pratique de l'écrit du guègue ceci venait d'être recouvert par des signes diacritiques, ce qui compliquait davantage l'écrit. En fait, la quantité des voyelles serait partiellement reprise par la poly-fonctionnalité de *ë*, dont la prononciation en position finale pose aussi bien des problèmes pour la langue parlée. La chute de [*ë*] en position finale se reflète de l'autre côté sur l'orthographe: dans des discussions du Conseil il y a eu des propositions de simplifier l'orthographe dans tous ces cas, par exemple des masculins comme *djathë, djalë, lumë*, etc., ou bien à l'intérieur du mot comme *mjekësi*. Les problèmes de *ë* se posent dans tout l'espace albanophone, quoi que de différentes manières selon les bases dialectales.

Le système des voyelles de l'albanais standard et du tosque est d'ordinaire représenté comme suit:

i y u
e ë o
a

Dans certains parlers du sud de l'Albanie, surtout dans les parlers albanais de la Grèce, tout comme danc certains parlers du nord (Dibër, Bujanovc) l'opposition de labialité chez les voyelles antérieures *i/ y* ne se réalise pas.

En principe les parlers guègues font distinction entre le nasales et les orales, aussi bien qu'entre les longues et les brèves:

orales			nasales		
i:	y:	u:	ĩ:	ỹ:	ũ:
ĭ	ў	ŭ	ĩ	ỹ	ũ
e:	(ë)[2]	o:	ẽ:		-
ĕ		ŏ	ẽ		-
ă	*a*:		ã	*ã*:	

Les longues se réalisent comme plus fermées, plus postérieures et plus intenses que les brèves. Les nasales montrent aussi des différences de timbre. Le problème de la quantité des voyelles est encore plus intéressant.

[2] En réalité, le guègue n'a de voyelle [ë] qu'en position hors d'accent. Elle est souvent interprété comme variante libre du phonème /ĕ/.

Les oppositions des longues et des brèves en guègue se réalisent par la durée des voyelles, mais aussi associée d'intensité et de labialisation dans le cas de l'***a***. Cela veut dire qu'en l'occurrence la quantité pourrait être indiquée par la seule intensité, ou bien la labialisation. Pour quelqu'un qui parle le standard, mais dont la base organique est le guègue, les différences entre *[thɑ̆]/ [u thɑ̄], [lɑ̆]/ [u lɑ̄]*, tout comme entre *[pɨ̆k] / [pɨ́k], [prɛ̆k], [prɛ̄k]* (*pik, pik, pikë; prek, prek* et *prekë*) persistent et ceci rajoute au dynamisme régional. Le problème de quantité se complique davantage par la nasalité en cours de disparition en guègue aussi bien, surtout dans les villes.

Les développements régionaux ont eu lieu dans la pratique de la réalisation du standard par la génération des jeunes de Prishtina des derniers 20 ans. Les gens de ma génération avaient l'habitude de labialiser les *ɑ̄* longues, la voyelle se réalisant souvent comme postérieure, tendant vers une médiane. La génération des jeunes, au contraire, tout en perdant la durée, tend vers une prédiphtonguaison: [i pᵘɑr], [mᵘɑm] (i parë, mamë). Tout ceci arrive librement dans certaines TV. Pour le moment on ne peut pas savoir ce que va donner ce mouvement à l'intérieur de la quantité de voyelles, surtout dans la situation de l'insistance des speakers TV à Tirana pour l'ouverture et l'abréviation maximale des voyelles sur une combinaison des modèles italien et grec. Ceci rajoute à la perception des différences régionales. Ces problèmes se posent aussi bien pour les sujets parlants guègue à l'intérieure de l'Albanie elle-même, surtout vers la région de Shkodra, où l'insistance de parler guègue a une dimension consciente aussi.

Ses pressions de nature dialectale se reflètent aussi bien au niveau des structures morphologiques. On assiste ces derniers temps à une insistance de la part des TV de Tirana sur certains changements par rapport au standard, se basant toujours sur le fond dialectal de l'Albanie centrale, mais des fois sous la pression des influences étrangères aussi. Pour le nombre 3 toutes les Grammaires de l'albanais standard distinguent des formes de masculin *tre* et du féminin *tri*, défini *të tre/ të trija*: *tre djem, tri vajza*; *të tre, të trija*. La génération actuelle des speakers de Tirana parle systématiquement: *tre djem, tre vajza, të tre/ të treja*, ce qui n'existait pas

avant. Ceci va de pair avec la confusion de genre pour les masculins pluriels déterminés par un pronom: *burrë/ burra*, sur le modèle de *mal/ male*: au lieu de *ata burra, ato male*, on insiste à *ato burra, ato male*.

On a pu remarquer de pareilles pressions provenant des bases dialectales aussi au niveau de l'utilisation du pronom indéfini *kush* 'qui', avec des formes *kujt, kë*, au lieu des pronoms *cili, cila* 'lequelle, laquelle'.

Il est bien connu que les fonctions syntaxiques exprimées par l'infinitif en guègue, se rendent en tosque par le subjonctif, comme dans les autres langues balkaniques. Pourtant le guègue utilise aussi les formes du subjonctif et a dans ce contexte développé des possibilités fines syntaxiques et stylistiques d'expression. Étant donné que cet infinitif dans la littérature écrite en guègue avec sa syntaxe complexe très souvent allait vers une haute abstraction, vu qu'il correspond à un infinitif dans les autres langues, il a été élevé au niveau du symbole d'élaboration et de plénitude expressive de la variante standard du guègue. La bataille pour retenir la variante guègue comme langue standard a été menée essentiellement au nom de la défense de l'infinitif.

Le guègue possède un infinitif du type *me punue* 'travailler', *me thanë* 'dire', privatif *pa punue* 'sans travailler', *pa thanë* 'sans dire', tosque *pa punuar, pa thënë* mais aussi *do punue* 'doit être travaillé', *do thanë* 'doit être dit'/ tosque *do punuar, do thënë*

Le type de l'infinitif avec *me* n'existe pas en tosque. Une forme **me punuar*, **me thënë* en tosque, et, par conséquent, en albanais standard, n'est pas acceptable. Il y est remplacé par le subjonctif spécifiant le nombre et la personne. Des auteurs comme Naim Frashëri, pourtant, utilisaient des formes come *domethënë, duk me thënë*, etc.

Les fonctions syntaxiques de l'infinitif en tosque et en albanais standard sont reprises par le subjonctif existant en guègue aussi. De toute façon, faute de l'infinitif, en albanais standard et en tosque il y a une fréquence sensiblement accrue du subjonctif, tandis que le guègue à travers la fréquente utilisation de l'infinitif a développé une gamme de possibilités fines d'expressions syntaxiques et stylistiques. Étant donné que dans la littérature en guègue la syntaxe complexe de cet infinitif a mené vers une

expression plus abstraite, la maîtrise de l'infinitif est devenue une sorte de symbole de l'élaboration et de la plénitude du guègue littéraire, et de l'affectation pour le guègue. Dans la pratique parlé par des locuteurs du standard/ tosque on atteste très fréquemment un infinitif du type *me dalë, me ngrënë*, etc. La pression des formes guègues dans ce cas est évidente, mais il y a aussi l'aspect d'économie de l'expression par rapport à l'alternative à subjonctif explicitant le nombre et la personne.

Sur ce point se nouent d'autres aspects de dynamisme. Le futur de l'albanais standard est du type balkanique: avec *do: do të punoj, do të them*. Le guègue a plutôt un futur formé avec l'auxiliaire *kam: kam me punue, kam me thanë*. Mais il y a en guègue aussi un futur avec *do*. C'est pourquoi on y distingue un **futurum necessitatis** *kam me punue, kam me thânë*. Des nuances pas seulement stylistique s'y nouent dans des cas comme: *kam me shkue, por s'do të shkoj* (Je dois aller, mais je n'irai pas). Sous la pression de ce type de futur on atteste en albanais standard des formes comme: *kam të shkoj, por s'do të shkoj*, c'est à dire des combinaisons de *kam* avec le subjonctif afin d'énoncer le nécessitatif. Une construction pareille existe déjà en arbëresh, même figée: *kat bënj*.

Quant à la morphologie du futur on a marqué une tendance évidente dans la langue parlée vers la simplification: *do bëj* au lieu de *do të bëj*. Des problèmes surgissent dans la réalisation phonétique: *do bëj (do të bëj) do e bëj (do ta bëj), do i bëj (do t'i bëj).* La pression de la langue parlée y est évidente.

L'albanais standard, les formes régionales du standard, les variétés dialectales locales, les variétés dialectales régionales plus larges, marquent une ligne de continuum, et de gradation. Les relations entre elles sont dynamiques tandis que la situation démographique avec des mouvements importants vers Tirana et Prishtina peut apporter d'autres niveaux de la langue parlée. Le standard empirique de l'albanais ne manquera pas d'avoir une influence autant sur le standard prescriptif.

Dans des discussions de ces questions souvent l'insistance a été faite sur les aménagements politico-territoriaux, ce qui peut avoir un impact. Sur cette base ont été émise des idées et des hypothèses sur une possible

variantisation linguistique. Mais les choses paraissent être plus complexes. Les effets des développements de la période d'absence totale de contacts 1948-1968, ensuite la visée d'approche 1968-1990, dans des relations de contacts en dehors des deux États à travers la diaspora, la communication libre par internet et la circulation libre enfin, ont apporté et nourri une situation dynamique reflétant de toutes côtés: les différences ont été enregistré, les idées de retour aux variantes ont été prises en considération, il y a eu des éditions et des journaux en guègue, tous les tabous ont été enlevés, mais le commun et la vision pour le commun ont survécu et dominé parce qu'il assure l'optimum de communication au niveau de la langue standard sur l'espace entier.

Rexhep ISMAJLI, Prishtina

DINAMIKA E STRUKTURAVE TË SHQIPES STANDARDE

Rezyme

Pas vendimeve për shqipen standarde (Prishtinë 1968, Tiranë 1972), gjendja në hapësirën komunikative ka ndryshuar mjaft, edhe pse vazhdojnë të mbijetojnë dallime: dallimet kryesore midis hapësirës së Republikës së Shqipërisë dhe asaj të ish-Jugosllavisë, të karakterizuar me kufij me përshkueshmëri të kontrolluar nga të dy anët, u zëvendësuan me një ndarje të re midis Republikës së Kosovës, Republikës së Shqipërisë, Republikës së Maqedonisë, shqiptarëve të Luginës së Preshevës dhe të Malit të Zi, të karakterizuara nga kufij të përshkueshëm dhe një diaspore të shtresëzuar me mundësi zgjerimi të integrimit. Në këto rrethana, ndikimi i teknologjive të reja të komunikimit në normalizimin e hapësirës në gjuhën shqipe standarde duket të jetë enorm. Proceset e globalizimit kanë lënë pasoja pozitive në këtë kuptim po ashtu, meqë në tërësi e favorizojnë integrimin.

Zgjerimi i hapësirë së komunikimit, dinamika e strukturave të shqipes standarde në raport me ish-variantet letrare gege e toske, ashtu si varietetet diatopike e diastratike kanë marrë pamje dhe vështrime të reja.

Ndikimet në dallimet në sistemet e zanoreve me zanore hundore e gjatësi zanoresh (në gegnishten) si duket reflektohen në rrafshin diatopik të realizimit të strandardit. Në rrafshin gramatikor diskutohen reflektimet e paskajores gege në sistemin foljor, tipet e formimit të futurit me pasojat në dallimin funksional midis volitivit e necesitativit, çështje të gjinisë, të numrit, etj. Në rrafshin e leksikut situata e re thekson drejtime disparate: rritja e mundësive intergruese që vijnë nga të gjitha anët e varieteteve diastratike e diatopike, por edhe dallimet që dalin nga ndikimet e huaja italiane, nga një anë, gjermane (përfshirë ndërmjetësimin serbokroat të sh. XX), nga tjetra. Të gjitha këto e bëjnë edhe më të gjallë dinamizmin e shqipes.

Bibliographie et réferences

AGALLIU, Fatmir - ANGONI, Engjëll - DEMIRAJ, Shaban - DHRIMO, Ali - HYSA, Enver - LAFE, Emil - LIKAJ, Ethem: **Gramatika e gjuhës shqipe, Vëllimi I, Morfologjia**, redaktor i vëllimit: Shaban Demiraj, Tiranë, 1995, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i letërsisë

Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 1972.

BECI 1995, B.: Gjuha letrare shqipe dhe baza e saj dialektore, Seminari XVII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Tiranë.

BECI 2000, B.: Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri, Pejë, 231 ff.

BUCHHOLZ, Oda & FIEDLER, Wilfried: Albanische Grammatik, VEB Verlag Enzyklopädie, Leipzig, 1987

BULETIN i Institutit të Shkencave, SShSh. (1952) Janar-mars, Tiranë.

BULETIN për shkencat shoqërore 1954, Tiranë IV.

BYRON 1976, J.: Selection among Alternates in Language Standardization: the Case of Albanian, The Hague.

BYRON 1979, J.: Language Planning in Albania and in Albanian-Speaking Yugoslavia, Word vol. 30, nr. 1-2, April-August.

ÇABEJ 1973, E.: Mbi disa çështje të traditës së shkrimit dhe të drejtshkrimit të shqipes, Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe, 1972, Tiranë.

CAMAJ 1984, M.: Albanian Grammar, Wiesbaden.

ÇELIKU 2000, M.: Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe, Tiranë.

Deklaratë e gjuhëtarëve të Shkodrës, Albanica 3-4, 1992.

DEMIRAJ 1970, Sh.: Historia e gjuhës së shkruar shqipe, Prishtinë.

DEMIRAJ 2002, Sh.: Gjuha letrare shqipe e njësuar dhe çështja e paskajores, Konferenca shkencore Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot, Tiranë, 1992, Akademia e Shkencave e Shqipërisë 2002, 56-59.

DODI 1996, A.: Gjuha letrare shqipe përballë rreziqeve që e kërcënojnë, Studime albanologjike II, Universiteti i Tiranës, Fak. Histori -Filologji, Tiranë, 77-92.

DOWNES 1984, W.: Language and Society, Fuffolk, Fontana Paperbacks, pp. 32-38.

FISHMAN 1974, J. (ed.): Advances in Language Planning, The Hague.

GARVIN, P. & Mathiot, M., The Urbanization of the Guarani Language, a Problem in Language and Culture, in Fishman 1968, pp. 365-374.

PEKMEZI, Gjergj, Grammatik der albanesischen Sprache (Laut- und Formenlehre),

Wien, 1908.

Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë. Materiale të Konferencës shkencore të mbajtur më 1984, 1988, Tiranë.

GUT, Chr. – BRUNET-GUT, A. – PËRNASKA, R.: **Parlons albanais**, L'Harmattan, Paris-Montréal, 1999

HAUGEN 1972, E.: Dialect, Language, Nation, in Pride-Holmes (1972): Sociolinguistics, pp. 97-112.

HAVRANEK 1955, B.: The Functional Differentiation of the Standard Language, in A Prague School Reader on Esthetics, Litterary Structure and Style, Washington 1955, 1-18.

ISLAMI 1980, H.: Popullsia e Kosovës, Studim demografik, Prishtinë.

ISLAMI 1997, H.: Dimensioni demografik i çështjes së Kosovës, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore të Kosovës, Prishtinë.

ISMAJLI 1991, R.: Gjuhë dhe etni, Rilindja, Prishtinë.

ISMAJLI 1998, R.: Në gjuhë dhe për gjuhë, Pejë.

ISMAJLI 2005, R., Drejtshkrimet e shqipes, Studim dhe dokumente përgatitur nga R. Ismajli, AShAK, Prishtinë, pp. 723.

ISMAJLI 2005, R.: Gjuhë standarde dhe histori identitetesh, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, pp. 503.

KASTRATI 1988, J.: Probleme të normës gramatikore në gramatikat e pasçlirimit, Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë, Tiranë.

KASTRATI 1996, J.: Përpjekjet për një gjuhë të përbashkët letrare kombëtare shqipe në shekujt 19-20, Studime, 3, Prishtinë, 187-215.

KOLGJINI 1974, T., Shqiptarët në Jugosllaví dhe gjuha e unjisuar, Shêjzat–Gli Pleiadi, 1-10, Romë, 56-67.

Konferenca I e studimeve albanologjike (1965), Tiranë.

Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe 20-2 5 nëntor 1972, I 1973, Tiranë.

Konkluzat e Konsultës gjuhësore të 22-23 prillit 1968 (1968), mbajtur në Prishtinë, Përparimi 3-4, Prishtinë.

KOSTALLARI 1971, A.: Mbi tiparet kryesore të shqipes së sotme letrare, Shkencat shoqërore në shkollë, 2, Tiranë.

KOSTALLARI 1972, A.: Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë, Probleme të gjuhës letrare shqipe dhe të drejtshkrimit të saj, v. I, Tiranë.

KOSTALLARI 1973, A.: Gjuha letrare e sotme shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj, Tiranë.

LLOSHI 1997, Xh.: Mbështetje për gjuhën letrare, Tiranë, 157.

LLOSHI 2001-2, Xh.: Gjuha shqipe letrare përmes kontestimit, Studime 8-9, Prishtinë, 101-120.

OSMANI 1999, T.: Udha e shkronjave shqipe, Shkodër.

PIPA 1989, Arshi: The Politics of Language in Socialist Albania, East European Monographs, Boulder, Distributed by Columbia University Presss, New York, 283 ff.

RAKA 1997, F.: Historia e shqipes letrare, Universtieti i Tetovës, Tetovë.

RIZA 1944, S.: Tri monografina albanologjike, Mesagjeritë shqiptare, Tiranë.

RIZA 1951, S.: Problemi gjuhësuer dhe zgjidhja e tij, Jeta e ré, Prishtinë, 5, 273-276.

RROTA 1968, J.: Për historinë e alfabetit shqip, Rilindja, Prishtinë.

SAMARA 2000, M.: Historia e gjuhës letrare shqipe, Tiranë.

SHUTERIQI 1952, Dh. S.: Mbi gjuhën letrare kombëtare shqipe, Buletin i Shkencave Shoqërore, IV, Tiranë, 3-55.

Srbija i Albanci I, II, III 1989, Pregled politike Srbije prema Albancima od 1878. Do 1914. Godine, I, II, III, Časopis za kritiko znanosti, Ljubljana, april , 12-26.

TRUDGILL, P. 1983: Sociolinguistics: An Introduction, Penguin.

VESELAJ 2000, N.: Paskajorja çështje e shqipes standarde, Dardania sacra, Shtufi, Prishtinë, ff. 168.

WILLIAMS 1992, G.: Sociolinguistics. A sociological Critique, Routledge, London and New York.

Skënder GASHI, Vjenë

NJË KOLONI-OAZË E HERSHME SERBE NË RRAFSH TË KOSOVËS

KDU 81’373.22

(Rreth toponimit *Slovinje* shq. *Sllovi*)

Abstrakt

Katundi i sotëm *Slovinje* i komunës së Lypianit do të jetë njëra ndër ngulitjet e para katundare ose kolonia e parë serbe e krijuar nga kisha serbe, pas pushtimit nga ata të ipeshkëvisë së Lypianit dhe sjelljes së një mase katundarësh/ bujqrobërish serbë. Kjo ka mundur të ndodhë ndoshta që në valën e parë të pushtimeve të Nemanjës kah fundi i shek. XII, atëherë kur nocioni *slovinь* nuk përdorej më për shenjimin e etnisë sllave, por të asaj serbe të principatës në ekspansion të Rashës. Masa sllave e vendosur në afërsi të Ulciana-s ilire përkatësisht të Ulpianës romake - *Lipenion*-it bizantin do të ketë pasur nevojë të shquhej nga pjesa tjetër e popullatës vendëse - qytetare e perandorisë së Bizantit. Dhe, këtë e bëri duke e quajtur vendbanimin që po bëhej i tyre me emrin etnik të tyre - *Slovinje* vend i serbëve, emër që as atëherë nuk ishte më në përdorim e as që është ruajtur deri sot për si emër etnik i serbëve.

Sa herë që flitet për emrat e vendbanimeve të sajuara nga emri etnik i një popullate, rëndom shtrohet pyetja nëse në aso rastesh kemi të bëjmë me emra të një popullate të ngulitur aty rishtas, të huajë për shumicën e ambientit përreth, apo (edhe) me emërtime të një kategorie sociale të të njëjtit popull. Sa për ilustrim të mundësisë së parë le t'i marrim psh. emrat e vendbanimeve *Arbanasi* - vendbanim jo larg derdhjes së lumit Lim në Hercegovinë; *Arbanaška* - një pjesë e katundit Krnjević në vendbanimin Šuma të Hercegovinës dhe *Arbanasi* - një katund afër Sinjit në Dalmacinë Perëndimore që dihet se janë vendbanime të krijuara nga shqiptarë të krishterë të ritit roman[1] të shpërngulur atje në shek. XV,[2] sikundër ndodhi

[1] Duket se këtë e dëshmon rrethana që Emni *Arbanasi* këndohet ndër poezi të vjetra

edhe më vonë me emrin *Arbanasi* të vendbanimit në periferi të Zarës (Kroaci), për të cilin dihet se u themelua në shek. XVIII nga shqiptarë të ikur atje nga katundet Larje, Brisk e Shestan të Krajës dhe me katunde me të njëjtin emër që, si rezultat i migrimit, u krijuan në Bullgari, pa i përmendur këtu ngulitjet arbëreshe në Kalabri, të cilat e përmbajnë mbiemrin *albanese* apo *degli Albanesi*, apo ato në Turqi me atributin *arnaut*. Duke u nisur nga koha e themeilimit të këtyre enklavave shqiptare në Dalmaci, në Hercegovinë e në Bullgari, del të jetë e qartë se në këto raste atributi *arbanas* e ka kuptimin e emrit etnik, nacional të shqiptarëve. Emërtimet e mësipërme janë si ato të tipit *Vlahinje*, çfare ka edhe në Kosovë, të cilat janë forma të zgjeruara me prapashtesën sllave (serbe) *-inje* që e kanë kuptimin vend i vllehëve si edhe toponimet e tipit *Srbica*, *Srbovac*, *Srbobran* etj., të formuara me prapashtesa të tjera, poshtu sllave.

I kategorisë së parë është edhe emri i katundit të sotëm *Slovinje* shq. *Sllovi* i komunës së Lypianit.[*] Dëshmia më e vjetër e përmendjes së këtij vendbanimi rrjedh nga viti 1331, kur mbreti serb St. Dušan ia falte pirgut në Hilandar kishën e Shën Mërisë në Lypian *Dhe katundin nën kishë*[**] *Slovinje me njerëzit, me livadhet dhe me kosheret e bletëve*.[3] Në të gjitha dokumentet ekzistuese që nga v. 1336 e më vonë, emri i këtij katundi dëshmohet vetëm në trajtën *Slovinje.*

Emri i këtij katundi rrjedh nga emri etnik i sllavëve. Dëshmia më e

---

dalmatine si dhe ndër kangë popullore te Bogishiqi e Vuka, por sod ndihet vetëm në Jugë, veçan në Raguzë e Mal të Zi, ku *Arbanas* don me thanë nji Shqiptar katholik-shkruajnë Dr. Ludwig v. Thallóczy, Djaspora shqiptare në: Vëzhgime iliro-shqiptare, përpuiluem prej Dr. Ludwig von Thalloczy, Shkodër, 2004, f. 68.

[2] sh. për këtë V. Škarić, Porijeklo pravoslavnoga naroda u Bosni i Hercegovini, Glasnik Zemaljskog Muzeja u Bosni i Hercegovini 30. (1918), f. 229.

[*] Kështu e shqiptojnë banorët e katundeve përreth, emrin e qytetthit të Lipjanit.

[**] Ka gjasë që kujtimi për kishën që përmendet në këtë dokument është ruajtur tek mikrotoponimet e sotme *Manastiri* e *Gryka e Manastirit* në këtë katund. Këto mikrotoponime i ka shënuar në terren Dr. Jusuf Osmani sh. Vendbanimet e Kosovës, 5, Lypjani, Prishtinë, 2003, f. 163.

[3] sh. Stojan Novaković, Zakonski spomenici srpskih država srednjega veka, Beograd, 1912, f. 486.

vjetër e përmendjes së lëtij emri etnik rrjedh nga shek. VI në veprën e historianit bizantin Prokopius të Cezaresë, i cili njofton edhe ekspeditat pushtuese e shkatërruese të skllavenëve nëpër Dardani e nëpër Iliri.[8] Për t'u mbrojtur nga sulmet e tyre, perandori Justinian ndërmori ndërtimin e fortifikatave të reja dhe rindërtimin e atyre të vjetrave. Prokopi shënonte se [...] Kështjella Adinain afër Palmotis-it në Mezi u aftësua, sepse në rrethina të saj Σκλαβηνοὶ βάρβαροι skllavenët barbarë e kishin për qejf t'i plaçkisnin udhëtarët.[9]

Emri etnik sllav i kësaj popullate është *Slověne*, emër që, sipas Al. Rosetti[10] në latinishte qenka reflektuar si *Sclavus* dhe prej andej paska kaluar në dakorumanishten si *schiau* (shkiau), arum. *şcl'au* (lexo *shklau*), shq. *shqa* në kuptimin bullgar, grek shkizmatik, grek dhe në greqishten nga shek. IX në trajtën *Sklavenos* në kuptimin sllav. A. Brückner, nga ana tjetër, kujton se lat. *Sclavus* dhe greq *Sklavenoi* që nga shek. X e kishte kuptimin e pol. *niewolnik*, skllav, gjerm. *Sklave*, frëngj. *esclave*, vllahisht, përkatësisht romanisht *schiavo* dhe që më vonë ky term qenka zgjeruar me prapashtesën *-ia-*,[11] prandaj në tarajtën serbe popullore *slovinъ* ky distinktiv, i zgjeruar me prapashtesën *-inje*, tregon kolektivitet. Është shfaqur edhe mendimi sipas të cilit emri *sllav* e kishte në krye të herës kuptimin skllav, shërbëtor. Këtë interpretim e kishte përkrahur edhe Max Vasmer-i.[12] Për mbështetje të këtij paravendimi, ky i sillte edhe dëshmitë *sklavъ* m. shërbëtor (i sulltanit) nga dy burime serbe të vjetra të vitit 1480. Vasmer kujton që emri *sllav* po rrjedhka nga greq. e mesme, bizantine, Σκλάβος skllav, i dalur nga emri Σθλαβηνός, Σκλαβηνός: sllav. *Slověninъ* i sllavëve (për këtë shih edhe më poshtë). Vetë trajta sllave *slovinъ* rrjedh [...] nga lat.

---

[8] Grup autorësh: Ilirët dhe Iliria te autorët antikë, Tiranë, 2002, f. 431.

[9] pas Constantin Jos. Jireček, Geschichte der Bulgaren, Prag, F. Tempsky, 1876, f. 84-85, i cili e citon: Procopios-in, De aedificis. IV, 11 ed. Bonn f. 304; De aedif. IV, 7, f. 293.

[10] sh. Istoria Limbii Române, de la origini pînă în secolul al XVII-lea, Editura Pentru Literatură, Bucureşti 1968, f. 286, 378.

[11] sh. Słownik etymołogiczny jezyka polskiegom,Warszawa, 1974, f. 501.

[12] khs. Die griechischen Lehnwörter im Serbo-kroatischen, Abhandlungen der Preußischen Akademie der Wissenschaften, Jahrg. 1944, Phil.-hist. Klasse, 3, Berlin, 1944, f. 134.

Sclavi dhe shënonte, sipas M. Pešikan[13] sllavët në përgjithësi, por më shpesh ata në territoret skajore të viseve të banuara me sllavë khs. *slovinjci* në veri të Polonisë dhe emrat: *sllovak, slloven, sllavon* të popujve. Nga kjo trajtë rrjedhin edhe emërtimet e mëvonshme *Slovinjanin* që në Istri e kishte kuptimin serb, ashtu si edhe në Dubrovnik *Slovinac* dhe *Slovinski = sllav* (1526) si edhe atributi *slovinski*: (më 1484) dhe më 1493: *zemlje htrvatske i slovinske od Save i Drave* tokat kroate e sllovine nga Sava e Drava. Nga fusha e oikonimisë, këtu duhet përmendur emrin e vendbanimit. Domethënien e kryehershme të nocionit kolektiv sllav të termit *slovin* e konstaton Petar Skok[14] i cili pohonte se Mund të merret që *Slovinje = Slovenje* [...] don të thotë vend i sllavëve, përkt. i serbëve.

Po nga emri *slovinь*, veçse në trajtën kroate të tij, është krijuar edhe emri i regjionit *Slavonija* e së ashtuquajturës Panonia kroate. Trajta *Slavonia* është formuar, sipas mendimit të përgjithshëm, nën ndikimin e trajtës latine *Sclavonia*. Prej këndej rrjedhin *Slovinje, Slovinja* vendi, toka e sllavëve që si trajta popullore sllave dëshmohen edhe gjatë mesjetës. Kështu psh. në dokumentacionin raguzas të mesjetës, emri i këtij regjioni (Slavonia) del në trajtat *Slovigna, Slovigne* (lexo Sllovinja, Sllovinje), *Slovinia, Schlovinie* (lexo Skllovinie) dhe shenjonte edhe shtetin serb të Rashës, i cili herë-herë quhej edhe *Servia*/*Serbia, Raška* dhe *Sclavonia*.

Dëshminë më të vjetër të një hapsire të quajtur *Serbia* e kemi nga gjysma e parë e shek. XII, përkatësisht në Kronikën e priftit të Duklës, i cili njoftonte se njëri ndër të ashtuquajtur mbretër popullorë [...]Serbinë, e cila quhet edhe Zagorje, e ndau në dy krahina: njërën nga lumi i madh i Drinës në drejtim të perëndimit deri tek bjeshka Pine (Borove), të cilën e quajti edhe Bosne, dhe tjetrën nga ky lum Drina në drejtim të lindjes e deri te Lapia (*Laba*) dhe [Liqeni lab (eat?)] i Shkodrës, të cilën e quajti Rasha.[15] Më e qartë del kjo ndarje, sidomos për shkak të interpretimit ndryshe-ndryshe (varësisht nga botuesit e Kronikës së priftit të Dioklesë/

---

[13] sh. Zetsko-humsko-raška imena na početku turskoga doba (I deo) në Onomatološki prilozi, III, SANU, Beograd 1982, f. 35.

[14] sh. Etimologijski rječnik hrvatskoga ili srpskoga jezika III, JAZU, Zagreb, 1973, f. 281.

[15] sh. V. Mošin, Ljetopis Popa Dukljanina, Zagreb, 1950, f. 55.

Duklës) të vendit *Lapia*: herë si Liqeni i Shkodrës e herë si lumi *Llap* i Kosovës, tek Përshkrimi anonim i Europës Lindore në vitin 1308, tek i cili lexojmë: [...] Mbretëria e Rashës i ka dy pjesë. E para - kryesorja quhet Rasha, e cila e ka marrë emrin sipas një lumi i cili e lag këtë dhe që edhe ai vetë quhet gjithashtu Rasha. [...] Ajo provincë laget nga një lum i madh bregetar, e cili quhet Drinus (Drini); gjithashtu ka edhe një liqe (SG. Liqeni i Shkodrës) [...] Pjesa e dytë e mbretërisë quhet Serbia, e quajtur kështu për shkak të përbërjes së popullsisë, duke qenë se atje të gjithë (banorët) janë shërbëtorë, skllevër.[16] [...] kjo përfshin tri provinca: Bosna, Macia (Mačva) dhe Marcia (Kraina). Ndërsa ajo pjesë e mbretërisë shtrihet rreth Hungarisë, prandaj midis saj dhe Hungarisë nuk ka ndonjë kufi. [...] Në këtë mbretëri gjithmonë ka pasur një mbret, por tani ka dy mbretër. Njëri sundon në Rashë, dhe ky është më i moçëm dhe quhet Uroš, [...] Tjetri quhet Stefan, ai sundon në Serbi, e cila është te Hungaria. [...],[17] shënim ky që tregon se hapsira e sotme e Kosovës nuk quhej në atë kohë Serbi, sepse nuk kishte një formacion shtetëror që, në atë kohë, do ta mbante emrin etnik të serbëve. Bërthama shtetërore e serbëve e mbante jo emrin etnik të tyre, porse atë të një lumi apo të një kështjelle - asnjëri nga të cilët nuk është sllavisht/serbisht.

Le të kthehemi për pak edhe një herë tek vendosja e serbëve në Ballkan, përkatësisht në Rashkë - një vend që më vonë do të bëhet bërthamë e shtetit serb në ekspansion. Dihet krejt qartë që tokat në të cilat u vendosën serbët sllavë nuk ishin të pabanuara. Nga burimet e periudhës para-

---

[16] Vlerën kuptimore shërbëtor, skllav i sulltanit kjo fjalë e paska ruajtur edhe në dëshmitë shkrimore serbe në të cilat kjo fjalë qenka dëshmuar dy herë në burime të vitit 1480. Kjo qenka, sipas Max Vasmer, Die griechischen Lehnwörter im Serbo-kroatischen, …, f. 134, një trajtë e huazuar nga greq. e mesme Σκλάβος skllav e mbështetur tek emri grek Σθλαβηνός, Σκλαβηνός që është sajuar nga emri *slověninъ* i sllavëve.

[17] khs. botimin maqedonisht në Spomenici za srednovekovnata i ponovata istorija na Makedonija, vëll. II, Shkup 1977, f. 447-479 të Anonymio Descriptio Europae Orientalis: imperium Constantinopolitanem, Albania, Serbia, Bulgaria, Ruthenia, Ungaria, Polonia, Bohemia, anno MCCCVIII exarata, edidit, praefacione et adnotatibus intruxit D-r Olgierd Górka, Cracovie. Sumptibus Academiae literarum 1916. Ka edhe një botim rumun të burimit: G. Papa-Lisseanu, Izvoarelle istorici Romanilor II, 1934.

bizantine mësohet se në Gadishullin e Ballkanit - përveç grekëve - jetonin popujt autoktonë të kësaj zone si dardanët e ilirë të tjerë, trakasit, dakasit, mizët, besët, triballët etj. Duke mos dashur të përballet pothuaj asnjëherë me substratin, dija serbe e historisë dhe e filologjisë e ka mohuar madje edhe ekzistimin në këto zona si të elementit shqiptar ashtu edhe të atij vllah. Këtë qëndrim jokorrekt e të ngjyrosur politikisht, dija serbe ka synuar ta arsyetojë duke u përpjekur të tregojë se kinse termi *vllah* që shënonte elementin autokton etnik të romanizuar të Dardanisë, të gjithë Ilirikut e të Trakisë parasllave nuk e paska kuptimin e përkatësisë etnike, porse vetëm atë të blegtorit.

Këtij mendimi, të cilin ka historianë serbë që e mbajnë edhe sot, i kundërvehej qysh në shek. XIX Fr. Miklosich. Ky thoshte: [...] Se ky mendim nuk është i drejtë e tregon rrethana që emri vllah jo gjithandej, porse vetëm aty e ka kuptimin e blegtorit, ku rumunët merren me blegtori [...].Përkatësia etnike rumune e vllehëve dëshmohet edhe mbi bazën e emrave personalë - përkatësia rumune e të cilëve nuk mund të vehet në dyshim- si *Bukor, Bun, Fečor, Singur, Surdul, Šerban, Ursul, Dančul, Dragul, Dražul, Negul, Radul, Rajul, Stanul, Vladul* - emra këta që si *Bukor* p. sh. pjesërisht rrjedhin nga brumi leksikor i rumanishtes e pjesërisht njihen për emra vllehë për shkak të prapashtesës rumune (S.G. romane ballkanike *-ul*) që u është shtuar emrave [...].[18] Kësaj të vërtete duhet shtuar edhe rrethanën që pikërisht në hapsirën e bërthamës së shtetit të Nemanjidasve janë malet e mëdha *Vlašić, Durmitor, Visitor, Korona, Negrišor, Rumska, Bukor* etj. Që të gjitha me prejardhje romane-ballkanike, përkatësisht vllahe.

Dhe, pikërisht përbrenda një treve të këtillë u formua në shek. XII një principatë e serbëve i cila madje as nuk u quajt me emrin etnik të atij populli, porse me emrin josllav të lumit apo të qytetit *Ras-*. Nuk është krejt e qartë nëse ky emër ka të bëjë me kështjellën ΄Αρςα që dëshmohet në listën e Prokopit të bërë për kështjellat e rindërtuara nga perandori Justinian në provincën e Dardanisë apo me ermin parasllav *Arsia* të lumit që

[18] sh. Über die Wanderungen der Rumunen in den Dalmatinischen Alpen und den Karpaten, Wien 1879, f. 6-7.

rrjedh aty pranë. Sllavët ardhës e morën këtë emër në krye të herës në trajtën *Ras*. Trajta e mëvonshme *Raška* rrjedh nga një **Ras-ьska* me bartjen e *š* nga etnikoni *Rašanin* nga **Ras-*(*janinь*).[19] Vendi *Ras* ishte deri në fillim të shek. XI kështjellë bizantine në kufi me serbët.[20] Këto të dhëna flasin qartë se bërthama e shtetit serb u organizua në një trevë e cila duhet të ketë qenë e banuar dendur nga popullsi josllave, autoktone. Për zonën e Rashës, si hapsirë e banuar nga një popullatë romane shkruante edhe sllavisti holandez N. Van Wijk. Sipas këtij, do të dilte se rumunët ose së pakut një pjesë e popullit rumun ishte popullatë autoktone në hapësirën e Ballkanit Jugor, (gjë që) dëshmohet përmes rrethanës se serbët dhe bullgarët ishin në mesjetën e hershme të ndarë nga një popullatë autoktone josllave. Kjo popullatë josllave, sidomos në Dardani ishte, sipas autorit tonë, popullatë romane: Të gjitha të dhënat përputhen bashkarisht nëse paravendojmë të dy grupet sllave ballkanike ishin të ndara nga një zonë romane e Ras-it përafërsisht në vitin 1200 apo pikërisht në këtë periudhë.[21] Sllavisti i merituar rumun Emil Petrovici kujton, nga ana tjetër, se ajo popullatë që i ndante këto dy degë të sllavëve, përkatësisht bullgarët e serbët, ishte pikërisht popullatë shqiptare.[22]

Edhe tek vetë serbët ka një dysi përsa i përket trajtës së emrit: karshi më të shpeshtës *Raška*, përdoret rrallë edhe ajo *Raša*. Duket se ky dualizëm është punë trashigimi sepse po kjo lëkundje dëshmohet edhe ndër burime historike. Nga burimet nuk mund të mësohet nëse ky emër ishte i gjinisë mashkullore apo femërore, sepse ky del psh. më 1504 si *Raška* ndërsa ndonjëherë *Ras.* Po ky dualaizëm del edhe në shkrimet bizantine: një herë si emër femëror *τή ΄Ράση* (*té Ráse*) dhe një herë si mashkullor *Ράσον*. Mbisundon mendimi se e kryehershme është trajta *Ras* ose *Rasa*. Fundja, është fenomen i njohur ky që ardhësit jo rrallë e marrin për emër etnik emrin e vendit ku nguliten. Le t'i kujtojmë në këtë mes psh. sllavët e

---

[19] sipas Anton Mayer, Die Sprache der alten Illyrier, I, Wien, 1957, f. 61.

[20] pas Gaspër Gjini, Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj, bot. Drita, Ferizaj, 1992, f. 73.

[21] sh. Les langues slaves (de l`unité à pluralité), Hage, 1956, f. 103.

[22] sh. Istoria poporului român aglindită în toponimie, Studi de dialektologie şi toponimie, Bucureşti, 1970, f. 242.

quajtur maqedonë emri i të cilëve është në të vërtetë emri i popullit parasllav të makedonëve dhe i shtetit të tyre; bullgarët e sotëm nuk e kanë për emër nacional të tyrin ndonjë emër sllav, porse emrin e protobullgarëve tataro-mongolë ashtu sikundër emri mesjetar i serbëve Rassiani i heq rrënjët pra nga emri *Arsia* i lumit apo i qytetit ballkanik - si atdhe i dytë i tyre - ku u vendosën në krye të herës.

Se një shtet serb i Rashës u krijua në një zonë të mbizotëruar nga një substrat ilir e roman ballkanik, përkatësisht shqiptaro-vllah e tregon gjithsesi edhe rrethana se as emrat e dy lumenjve më të mëdhenj të regjionit: *Lim* dhe *Ibër* nuk janë as emra sllavë e as refklese sllave emrash parasllavë. Emri *Lim* i lumit është sqaruar qysh nga Miklosich-i plak e nga Norbert Jokl me fjalën shqipe *lymë, lumë* balta që sjellin lumenjt e prrojet dhe askush deri tani nuk e ka vënë në dyshim këtë etimologji. Këtë shpjegim e pranon edhe dijetari serb i madh i gjuhësisë Ivan Popović.[23] Sa i përket emrit të dytë, është shfaqur mendimi jokompetent se ky mund të sqarohet me mbiemrin shqiptar *i bardhë*,[24] një mendim që mua më duket i guximshëm, sidoms në dritën e rrethanës se ka shumë mundësi që emri i këtij lumi të jetë me prejardhje paraindoeuropiane.

Në dritën e kësaj që u tha më sipër duhet kuptuar rrethana e konstatuar nga M. Šufflay sipas së cilës dijetarët sllavistë Rešetar e Jagić kishin vërejtur se: ... ekzistojshin prej të 12 tit qindvjet deri brendë në të 16tin, prej Drave deri në Zetë, breze të hapta, në të cillat nuk ishte në përdorim as emni kroat, as emni serb, por termi etnik i përgjithshëm slovenski, Slloven (slovenska) [....] Në veri ishte mbarë Slavonja e vjetër ndërmjet Dravës e Gvozdës; në jug ishte ana tjetër prej Splitit deri përtej Raguzës. Statutet qytetse të Kotorrit të të 14tit qindvjet i dallojnë qartë Kroatët në veri prej Sllavëvet (Sclavi), të cilët, të përziem me Rumunë (Vualachi) e me Shqiptarë, banojshin n'afërsin e varoshevet. Në nji konkordat tregtar ndërmjet Raguzës e Ankonës (1292), me emnin Slavoni kuptohej ana ndërmjet lumit të Narentës dhe Drinit e Bunës[*] (*et dicta Sclavonia intelligatur a lo-*

[23] khs. Elemente të gjuhës shqipe në gjuhët tjera, Përparimi 1-2, Prishtinë, 1957, f. 20.

[24] sh. Grup autorësh, Novi Pazar i okolina, NIP Književne Novine, Beograd, f. 90.

[*] Kështu është në origjinal. Duhet të jetë Drinës dhe emri i Bunës nuk e ka vendin aty fare.

co qui dicilur Orenta usque in flumen Lessi). Kjo ishte teprica e kuptimit madhështuer gjeografik të njihershëm Σκλαβινικαι, Sclavinica, e cila prej të 7tit deri në të 10tin qindvjet, përfshinte të gjitha viset ndërmjet Zarës, Selanikut e Rodopit.[25]

Nga historiografia moderne kroate mësohet se nocioni *Slovinje* është variant kroat i nocionit roman *Sclavonia*. Slovinja përfshinte në mesjetë hapsirën e Sllavonisë së sotme, Zagrebin me rrethinë, Kordunin dhe regjionin Banija. Nëpër burime që kanë të bëjnë me këtë hapsirë emri kombëtar i kroatëve as nuk është respektuar e as nuk është shënuar. Nga fundi i shek. IX kjo krahinë ra nën sundimin e Hungarisë. Në kohën e sundimit të Tomislav-it (910-928) [krahina e Sllavonisë] kishte njëfarë lidhshëmire politike me Kroacinë e Bregdetit. Nga ajo kohë janë të njohura lidhjet e forta tregtare e ato të komunikacionit, ndërsa më vonë, në shek. XIII, kur Zagrebi u bë qendër e rëndësishme e Sllavonisë, u krijuan kushtet për afrimin edhe në rrafshin kulturor e kishtar. Që nga shek. XII [për këtë hapsirë] përdoren nocionet (*S*(*c*)*lavonia* e *S*(*c*)*lavi*, dhe asnjëherë *Croatia* e *Croati*. Kontët e kryebashkiakët quhen *dux* ose *banus Sclavoniae*, përkrah *dux* ose *banus Croatiae et Dalmatiae*. [...]. Çështjen e emrit popullor të kroatëve dhe sidomos mosekzistimin e këtij emri në Sllavoni e studioi sllavisti zviceran R Zettl. Ky konsideron se përdorimi i emrit gjithsllav për atë hapsirë të Panonisë mund të shpjegohet me pozitën e veçantë të Sllavonisë në shtetin mesjetar të Hungarisë. Hungarezët, të cilët në mesjetë kishin nënshtruar politikisht pjesë të Sllovakisë, Sllovenisë e Kroacisë, i identifikonin popujt në ato vende kryesisht për sllavë, tamam ashtu siç veproi shpesh edhe Venediku me kroatët në (Dalmati, Dalmatini, Schiavoni). [...].[26]

Përdorimi tre shekuj më vonë nga të huajët i emrit *Sklavonia* edhe për pjesë të territorit të sotëm të Kosovës, përkatësisht për territorin në kuadër të të cilit përfshiheshin qytetet-miniera të Trepçes e të Novoberdës, mund të kuptohet vetëm si rezultat i pushtimeve serbe, përkatësisht si rezultat i pranisë së raguzasve sllavishtfolës. Kjo shihet nga një dokument i vitit 1382 kur është shënuar se njëfarë *Dom Georgius Gega; Nikola de*

[25] sipas Milan Shufflay, Serbët dhe Shqiptarët, Prishtinë, 1968, f. 208, 209.

[26] sipas http://www.stormfront.org/forum/showthread.php?t=318753.

presbitero Tanussio banor i Novoberdës së dioçezës së Kotorrit nga ipeshkvi i Tivarit ishte emëruar për vikar (mëkëmbës) të tij [...] *super omnes ecclesias illarum patriam Novimontis et Sclavonie...,* përkatësisht Mbi të gjitha kishat e atjeshme të vendit (SG: = qytetit) të Novoberdës e të Sklavonisë.[27] Varianti *Sklavinia* për formacionin shtetëror të Rashës është përdorur edhe në një dokument raguzas që ka të bëjë (vetëm) me Trepçën (Lamenta de foris 1446, f. 249) nga i cili mësohet se njëfarë Giuichus Braissich (lexo Gjukus Brajshiq), ankohej se atë e kishte vjedhur shërbëtori i tij që ishte arratisur *in Sclauonia in Sassi* (lexo: në Sklavonia, tek Sas-ët).[28] Një dëshmi të kësaj natyre e kemi edhe për qytetin e Pejës për ku në vitin 1327 përmendet një ulqinak, qytetar i Raguzës, për të cilin thuhet se ishte *habitantis ad presens in Pech in partibus Sclauonie* përkatësisht ... *de Pechio ... de Sclauonia* [...] prej tani banor në Pejë në pjesën Sklavonia, për të cilin qytetar thuhej se aty (në Pejë) merrej me tregti[29] dhe në testamentin e një raguzasi rreth të cilit dëshmitarët deklaronin në vitin 1327 se kishin qenë *in partibus Sclauonie i loco vocato in lingua Sclaua Pech.*[30] Në dokumente raguzase, psh. në një të tillë të vitiit 1326, qyteti i sotëm i Pejës cilësohet të ketë qenë në *Sclauonia*.

Me emrin *Mbretëria e Serbisë* përfshirë hapsirën e Kosovës së sotme, krijesën shtetërore të Serbisë e njihte edhe Selia e Shenjt. Kjo shihet në një shkresë të selisë së Shenjt që ka të bëjë me kishat e famullitë katolike të atëherëshme në: Brskovo, Rudnik, Trepçe, Graçanicë, që në vitin 1303 përmenden si kisha katolike [...] *de Briscovia* (e shkruar Bristonia), *de Rudinico, de Rogosna et de Trepczo et de Grazaniza ecclesie parochiales in Regno Servie* [...]. Kjo traditë u ndërpre nga fillimi i shek. 13.[31]

---

[27] M. Dinić, Za istoriju rudarstva u srednjovekovnoj Srbiji i Bosni, II, Beograd 1962, f..94.

[28] Vendi Sase ishte në rrethina të Trepçes. Ka një mendim sipas të cilit me këtë vend ka të bëjë katundi Zhazhë i rrethinave të Mitrovi cës.

[29] M. Dinić, khs. Nastanak dva naša sednovekovna grada, Prilozi za književnost, jezik, istoriju i folklor, nr. 31, bleu 1-2, Beograd, 1965, f. 198. Te Jahja Drançolli, Raguzanët në Kosovë, 1986, f. 103. është shënuar se ky dokument qenka i vitit 1376.

[30] khs. M. Dinić, Nastanak dva naša sednovekovna grada, ..., f. 197.

[31] sipas Mihailo J. Dinić, O nazivima srednjovekovne srpske države [Sklavonija, Srbija, Raška], Prilozi za književnost, jezik, istoriju i folklor, 1-2 (1966), f. 28.

Në rastin e oikonimit Sllovinje, që është objekt i kësaj trajtese, duhet shtruar pra pyetjen cili ishte momenti që ndikoi në emërtimin *Slovinje* të një vendbanimi të banuar nga sllavët në Kosovë?. Një gjë është në këtë mes e sigurt: këtu kemi të bëjmë me vendosjen e një bashkësie kolonizuese sllave në një mjedis të cilin vetëm diç më shumë se 200 vite para përmendjes së këtij katundi në dokumentacion, Konti i Madh Stepan Nemanja i principatës së Rashës e quante *grčka zemlja* tokë greke, (nënkupto tokë e Bizantit) dhe që më 1198 nga ajo tokë i kishte pushtuar Llapin e Lypianin e deri edhe Pultin në Shqipërinë e Veriut.[32] Ky rast tregon se ka pak arsye të dyshohet se sllavët (ndryshe nga perandoria romake dhe ajo osmane/turke) do ta kenë ndryshuar adetin që zgjerimin territorial të tyre ta realizojnë duke e marrë popullatën pas vetes dhe duke i kolonizuar menjëherë viset e pushtuara.

Po u nisëm nga vlerësimi i M. Pešikan-it[33] se emrat mesjetarë të vendeve, të formuara nga emra popujsh nuk janë emra të dhënë për arsye manifestive (S.G: siç ka ndodhur psh. me emrat Obilić, Miloševo, Lazarevo, Orlović, Devet Jugovića, Srbica, Srbobran (dy herë), Tankosić, Nova Šumadija, Dušanovo, General Janković, Uroševac etj. të vënë pas pushtimit serb më 1912 të Kosovës) porse që ata (emra) ruajnë në vete informacion të dyfishtë historik: së pari që këta tregojnë se në kohën e lindjes së toponimeve nga emra etnikë, përreth vendeve të tilla kishte popull a popuj të tjerë të cilët nuk quheshin si ky i ardhuri prandaj, për ta dalluar nga vetja, edhe e quajnë me emër të vetë popullit ardhës, do të rezultonte se në rastin e *Slovinje*-s kemi të bëjmë me një emër të cilin vendësit ua dhanë ardhësve për t'i dalluar nga vetja. Dhe, ky dallim sigurisht ka të bëjë si me gjuhën, ashtu edhe me konfesionin dhe me shtetësinë a ardhësve, nëse kihet parasysh rrethana që kjo hapsirë ishte pjesë e perandorisë bizantine. Sigurisht që sikur Kosova e sotme e shekujve XIII-XIV të kishte qenë e

---

[32] sh. Památky dřevního pisemnctiví jihoslovanův, Díl předehozí - Život Konstantina - Ž. Methoda - Ž. Symeona 1, 2 - Okaźy občanskeho pisemnctiví, serbal i vydal Pavel Josef Šafarik, v Praze, 1868-1873, f. 3.: *a odь grčske zemlje Labь s Liplanjem,* [...] *a odь arbanas pilot.*

[33] sh. Zetsko-humsko-raška imena na početku turskoga doba (prvi deo), Onomatološki prilozi, III, SANU, Beograd, 1982, f. 40.

banuar vetëm apo kryesisht nga serbët, nuk do të kishte nevojë që një vendbanim i banuar po nga serbët, përkatësisht nga sllovinët, të quhet me emrin e moçëm etnik të tyre. Po u vështrua historikisht, rezulton - sipas mendimit tim - se emri *slovinъ* për kolektivitetin sllav dëshmohet në ato vise në të cilat sllavët nuk ishin popullatë shumicë siç do të ishte rasti me emrin *slovinjci* në veri të Polonisë ku ky emër do të ketë qenë i domosdoshëm për dallimin e sllavëve nga germanët si edhe emrat *sloven* e *slavon* në Sllloveni [ku edhe sot, në rrethina të largëta të qytetit të Mariborit, ka një katund të quajtur *Slovenja vas* mbase katundi i sllovenëve] e në Panoni, që gjithashtu do të kenë shërbyer si distinktiv për sllavët e ngulitur në ambiente në të cilat edhe në kohën e ardhjes së tyre shumicën e popullsisë e përbënin keltët e japodët, përkatësisht ilirët dhe keltët e panonët, përkatësisht skordiskët e ilirët. Duket se, sipas A. Brückner[34] i njëjti proces do të ketë ndodhur tek sllovakët, sa kohë që kësaj popullate ia paskan dhënë emrin çekët, të cilët nuk e kanë në përdorim distinktivin etnik *sllav*.

Çështje të lidhura me emrin Slovinje të katundit tonë, që duhen sqaruar, mbeten nëse:

I. katundit të sotëm Sllovi, ku u ngulitën *sllovinët*, përkatësisht serbët, këtë emër ia dhanë fqinjët: 1. arqipeshkëvia bizantine e Lipenion-it ?; 2. raguzasit e Janjevës ? apo 3. shqiptarët? dhe

II. a mund të jetë edhe ky një emër vendbanimi i emërtuar nga kisha serbe si simobolikë e ngulitjes në vendin e pushtuar dhe që me qëllim të ngjalljes së ndjenjës së një lashtësie të thellë të pranisë së ardhësve, e riaktivizuan emrin e vjetër popullor (në atë kohë pas gjithë gjasësh vetëm emër librar) *slovin* sllav?.

Mundësia e parë, përkatësisht ajo që vendbanimin e krijuar serb ta ketë pagëzuar kisha bizantine - sadoqë më duket shumë mbushamendës definicioni i A. Brückner-it se emrin tënd ta caktojnë në rend të parë fqinjët dhe se kjo ndodh rëndom në bazë të vendit të ardhjes apo të një pararendësi të të ardhurve dhe konstaimi i tij në vijim se Sllavët i ndërronin emrat e tyre si dorëzat dhe vetëm aty-këtu jemi në gjendje, mbi bazën e të

[34] sh. Słownik etimołogiczny jezyka polsikego, Warszawa, 1974, f. 501.

dhënave të rastësishme të kronikave të të huajëve e të atyre vendëse, t'i njohim emrat e vjetër[35] - të tyre prandaj është më e vështirë për t'u besuar sepse, po të ndodhte kështu, do të duhej të paravendohej një trajtë bizantine *Sklavinika*, *Sklavoi*, *Sklavini*, përkatësisht *Sklavinia* e cila do të duhej të kalonte në *Slovinje* e për këtë do të duhej të kalonte kohë e gjatë. Përveç kësaj, ndonjë emër vendbanimi apo krahinëze të tpit *Sklavoi*, *Sklavini*, *Sklavinia* nuk është dëshmuar ndonjëherë jo vetëm në hapsirën gjeografike që sot e banojnë serbët, por as në Kosovën e sotme. Shkapërderdhja e sllavëve, përkatësisht pushtimi me hope nga ata i viseve të reja të banimit është arsyeja përse trevat e banuara nga ata i quanin në shumës *Sklavinie*.[36] Nocioni *Sklavinia*/*Sklavinie* - greq. Σκλαβηνία, lat. Sclavinia shenjonte që nga shek. VI bashkësitë e fiseve të sllavëve në hapsirat asokohe romake jo vetëm të Ballkanit, porse edhe të Panonisë, Karantania-s e të Transilvanisë. Emri i këtyre bashkësive ishte sajuar mbi bazën e emrave etnikë të përdorur në atë kohë: greq. Σκλαβηνοί/*Sklabēnoí* lat. *Sclavi*. Sipas M. Šufflay-it, nocioni Σκλαβινικι, *Sclavinica* paska përfshirë nga shek. VII deri në atë X të gjitha viset midis Zarës, Selanikut dhe Maleve Rodope ndërsa në shek. XIV hapsira e *Sclavi*-ve, përkatësisht e serbëve të përzier me vllehë e me shqiptarë që banonin përreth qyteteve, shtrihej midis lumit të Narentës dhe Drinit e Buenës.[37]

Këto bashkësi fisesh të sllavëve ishin të organizuara si lidhje fisesh luftarake, pa kufinj të përcaktuar territorialë dhe ngërthenmin më vete edhe pjesëtarë popujsh josllavë.

Pa pretendime se po zbuloj diç të madhe, kujtoj se ka arsye të paravendohet se *Sklavinie* quhej çdo pjesë e pushtuar, përkatësisht e kolonizuar rishtas nga sllavët - në rastin tonë nga serbët - shteti përkatësisht principata e të cilëve e Rashës ishte në ekspansion. Së këndejmi do të mund të para-

---

[35] khs. Der Name der Slawen, Zeitschrift für Ortsnamenforschung, 2, 1926/7, f. 149.

[36] pas Mihailo J. Dinić: O nazivima srpske srednjovekovne države, f. 26. Për *sklavinie* si territore të pushtuara me hope, jo si shtet, ka shkruar dhe S. Antoljak: Unsere Sklavinien në Actes du XII Congrés International d'études byzantines, v. 2 Beograd, 1964, f. 9 -13, cit. pas Schramm, Anfänge des albanischen Christentums, f.138, fusn. 37.

[37] khs. Dr. Milan Shufflay, Serbët dhe Shqiptarët, Prishtinë1968, f. 209.

vendohej që trajta *Slovinje* e katundit afër Lypianit të jetë një trajtë sllave e një *sklavinie* të re të sllavëve (në rastin tonë të serbëve) dhe të ketë shënuar në krye të herës një mikroregjion të pushtuar e të populluar nga sklavinët, emri i të cilit (regjion) do të jetë rrudhur apo përmbledhur në emrin e katundit *Slovinje*. Po të ishte kështu, do të mund të paravendohej se me një kësi emërtimi kisha serbe do të ketë pretenduar ta mbulojë, ta serbizojë emrin e regjionit dhe të arqipeshkëvisë së pushtuar bizantine të Lipenion-it nga ajo. Vetëm sikur një emër *Sklavinia* për këtë katund apo eventualisht për një famulli të ishte dëshmuar ndër shkrime bizantine do të duhej marrë parasysh mundësinë që emërtuesi i kryehershëm i këtij vendi të ketë qenë kisha bizantine e Lypianit, gjë që, mbase, nuk ka ndodhur.

Është për t'u vërejtur në këtë mes se fiset sllave të ndodhura territorialisht më afër perandorisë bizantine paraqiten që heret me emra të tyre të veçantë. Mësohet se bizantinët paskan ditur edhe për fiset sllave të sagudatëve, rinhinëve, draguvitëve, smoljanëve, bërzitëve etj.

Dëshmia më e vjetër porse, në të cilën veçohen emrat e dy fiseve të veçanta sllave ballkanike nga shumë sosh që do të kenë ekzistuar, rrjedhin nga mesi i shek. X. Në veprën *De administrando imperio,* autor i së cilës është perandori bizantin Konstantin VII Porphyrogennetos, sllavët përmenden një herë si *Sklavoi* me shënimin e gabueshëm se ata quhen edhe avarë dhe pastaj i përmend veçmas *tou thematos Peleponnesou Sklavoi* skllavët e themës së Peloponezit. Në vazhdim ai i përmend fiset e sllavëve Milingen e Ezerit dhe pastaj edhe ata *Hrovatoi* kroatët dhe *Serbloi* serbët për të vazhduar pastaj me *Zahumloi* Zahumljanët, *Terbuniotai*, *Kanalitai*, *Diokletian-ët* dhe së fundi *Arentan-ët* ose *Paganët* bashkë me *bulgaroi* bullgarët dhe *Raousaioi* raguzanët romanë.[38]

Për sa i takon prejardhjes së emrave të dy etnive të mëvonshme: serbe e kroate, dijetarë sllavistë e kanë përqafuar sqarimin e emrit *serb* si emër të dalë nga indishtja e lashtë, përkatësisht nga indoiranishtja. (për këtë sillet rëndom krahasimi me emrin *Serboi* të një popullate të Kaukazit Verior), ndërsa për emrin *hravati* në vend të sqarimit tradicional për si

[38] sh. Zetsko-humsko-raška mena na početku turskoga doba (prvi deo) ..., f. 38.

emër iranian, propozohet së voni edhe sqarimi si një emër nga gjuhët tyrkmene - më saktëshisht si emër me origjinë avare.[39] Sido që të jetë, s'ka dyshim se emrat me prejardhje josllave *serbë* e *kroatë* shenjonin më vonë dy popullata të ndryshme sllave.[40]

Mbi bazën e ç'u tha më lart do të rezultonte që vendosja e kolonëve në katundin e sotëm të Sllovisë nuk do të ketë ndodhur para fundit të shek. XIII dhe fillimit të atij XIV. S'ka dyshim që vendbanimi të jetë kolonizuar dhe emërtuar *Slovinje* pas pushtimit përfundimisht nga serbët të ipeshkëvisë bizantine të Lypianit.

Përkitazi me mundësinë e dytë duhet pasur parasysh rrethanën që famulli katolike më vete Janjeva e sotme do të ketë qenë kohë përpara përmendjes së saj në letrën e papës Benedikti i XI në vitin 1303, kur quhet gabimisht *Grazaniza*.[41] Në të mirë të mundësisë së prejardhjes raguzase të variantit *Slovinje* do të fliste edhe rrethana se *slovin*-ët e ardhur këtu në shek. XIV nga shteti serb i Rashës, nuk do ta kishin sjellur me vete më variantin *slovinь* të emrit etnik të tyre, porse atë *srbin* ose eventualisht *rasanin*, sepse asokohe as principata e Rashës e as rasianët, përkatësisht ser-

---

[39] Një mendim paksa më të ndryshëm për këtë çështje e shprehte M. Šufflay, Serbët dhe Shqiptarët, Prishtinë, 1968, f. 211: Emnin Hrvat charvata e bjen linguistika e sotme prej emnit para-indo-europjan të malevet të Karpatevet, i cilli u ba prej fjalës së vjetër europjane ase prej alarishtes *kar* dhe prej germës *p*, që asht forma e shumorit. Ashtu edhe emni i errët *Serb*, duket se mund të shkoqitet ma bukur prej ndonjenës prej gjuhëve të shumta të malevet të Kaukazit, qi janë nji muze i vërtetë për tepricat e popujvet të shumtë para-indoeuropjanë, që dikur paten jetuem mbi fushat e gjana të Skythjes. Mbas kësaj gjuhe pra, që e ban shumorin me mbrapashtesën *–b*, emni Serb do të kishte kuptimin njerz.

[40] sipas Mihailo J. Dinić: O nazivima srpske srednjovekovne države, ..., f. 26.

[41] khs. [...] Venerabili fratri Marino Archiepiscopo Antibarensi salutem etc. Regimini universalis ecclesie, disponente domino, presidentes ad ea libentius intendimus, que animarum salutem, ecclesiarum commode, nec non augmentum respiciant fidei orthodoxe. Ex tenore siquidem tue petitionis acccepimus, quod licet et Bristonia, de Rudinico, de Rogosna, et de Trepzo et de Grazaniza ecclesioe parochiales in regno Servie constitute sunt in locis, ubi fides catholica colitur et ritus Romane ecclesie observatu; [...] cit. sipas Nikola Čolak-Ive Mažuran, *Janjevo*, Sedam stoljeća opstojnosti Hrvata na Kosovu, Zagreb, 2000, f. 19.

bët, nuk e quanin më veten *slovinь*. Kjo shihet mbase mjaft mirë mbi bazën e rrethanës se qysh më 1313-1318 në krisobulën e Banjskës dëshmohet katundi i vogël i quajtur *Srbanja* në rrethina të Rasit/Rashës, përkatësisht të Deževo-s[42] dhe më 1348 dëshmohet edhe emri i katundit *Srbica* i rrethinave të Prizrenit.[43] I kësaj natyre është edhe emri *Srbšor/Selište Srbšor* i një truallishtje në regjionin e Strumicës, e cila (truallishtë) më 1332 i falej manastirit të Hilandarit.[44]

Nëse pra këta *sllovinë* të katundit të sotëm *Slovinje* të Lypianit do të jenë vendosur aty pikërisht më 1321, një faktor që do të ketë mundur të ndikonte qoftë në emërtimin vetë apo më së pakut në ruajtjen më tej të tij, do të ishte elementi raguzas i vendosur shumë më heret jo larg katundit të sotëm Slovinje, përkatësisht në Janjevë sesa *sllovinët* e Sllovinjes së sotme.

Në të mirë të emërtimit të vendbanimit *Slovinje* nga raguzasit do të flisnin jo vetëm shumë faktorë historikë të njohur, porse edhe faktori gjuhësor. Në këtë kontekst bën të përkujtohet se *Slovin* është pikërisht trajtë ikavishte dmth. dalmatine e kroatishtes për *Slovên*. Emri i fundit i shënonte banorët e Sllavonisë - të vendeve të sllovinëve (Slovenske zemlje) nga lumi Sutla drejt lindjes. Sllovinët, po u gjykua në bazë të dëshmisë Da imenovane dobrote na nas Slovine i Hrvate obrujene ... nam dvoju korist ... dhe Duhovnike s ńima ine i Latine i Slavine ose: Naš Dubrovnik dičaše se nad slovinske sve države[45] do të rezultonte sikur nën këtë emër nuk përfshihen të gjithë kroatët, porse vetëm një pjesë e këtij populli, përkatësisht njerëzit e përfshirë në hapsirën e Republikës së Raguzës, përkatësisht të Dalmacisë: khs. edhe kuptimin e *Slovinac*: Dalmatino, Illiricus, Dalmata që ky nocion e ka nëpër shekuj në kroatishten dhe në gjuhët e popujve me të cilët Dalmacia kishte raporte diplomatike, tregtare etj. Përveç

---

[42] sh. Lj. Kovačević, Svetostefanska hrisovulja ..., f. 4.

[43] Hrisovulja Cara Stefana Dušana koiomь osniva rnonastirь Sv. Arhangela Mihaila i Gavrilja u Prizrenu godine 1348? Glasnik Društva Srbske Slovesnosti 15 (1862) bot. J. Šafarik, f. 274: *selo Srbice a megja mou ot grada*....

[44] S. Novaković, Zakonski spomenici srpskih država srednjega veka, Beograd, 1912, f. 404.

[45] Rječnik hrvatskoga ili srpskoga jezika, JAZU, bleu 63 i v. 15, Zagreb 1955, f. 588; 590.

kësaj, nocioni *slovin* ndeshet ndër dalmatë e ndër kroatë edhe në funksion të emrit peronal: khs. emrin mashkullor *Slovinja* në Zarë dhe në funksion të emrit familiar *Slovinja* që e mbante një familje aristokrate e ishullit Rab dhe një tjetër e ishullit Pag të brigjeve sot kroate të Adriatikut.[46]

Përveç kësaj, Republika e Venedikut dhe qytete - shtete mesjetare të tjera, e njihnin (edhe) Republikën e Raguzës me emrin *Sclavinia*. Bile këtë emër e përdornin edhe vetë raguzasit në korrespondencën e tyre me Venedikun e me vende të tjera romane. Mjafton të përkujtohet në këtë mes se psh. në një dokument të hartuar në Venedik më 14 shkurt 1402 me të cilin Venediku urdhëronte ndjekjen e anijeve pirate, thuhet se galerat venedikase duhet të shkojnë nëpër viset e Skllavonisë deri në Durrës [origj. *ad zornatam debeant ire per partes sclauonie usque durachium*][47] nga i cili (dokument) kuptohet se lundrimi duhej të bëhej nëpër brigjet dalmate, përkatësisht se *Sclauonia* ishte për Venedikun Dalmacia.

Edhe dëshmia e janarit të vitit 1403 tregon se me emrin *Sklavonia* emërohej Dalmacia, përkatësisht Republika e Raguzës dhe rrethina e saj. Kjo shihet nga porosia që një i dërguar i kësaj Republike duhej t'ia përcillte vojvodës së Bosnes. I dërguari i Dubrovnikut duhej t'ia transmetonte atij porosinë se ata që shesin krip nëpër krahinën tuaj, në bregdet, dhe këtë gjë ata nuk duhet, as nuk mund ta bëjnë, siç e di madhëria juaj, sipas urdhëresave të Skllavonisë e të Bosnjës që ndalojnë shitjen ....[48] Në burime venedikase thuhet edhe se për disa kisha që po u gjendkan pranë lumit të Shkodrës (= Bunës) kanë pasur benefice që në kohët e lashta nga të gjithë të ndjerët mbretër të Skllavonisë, si edhe nga të tjerë princër të ndjerë të atyre viseve në kohët e kaluara ...[49] [origj. *quod sunt alique ecclesie penes flumen scutari ... ab omnibus condam regibus sclauonie ...*] që poashtu lë të kuptohet se Skllavoni quhej Dubrovniku dhe rrethina e tij. Në një shkresë të hartuar në Venedik më 13 tetor 1404 thuhet se Shkodra, Drishti

[46] Poaty, f. 592, 593.

[47] sh. Dokumente për Historinë e Shqipërisë të shek. 15 (1400-1405), përgatitur nga Injac Zamputi e Luan Malltezi, Tiranë, 1987, dok. 183, f. 272.

[48] Poaty, dok., 298, f. 364.

[49] Poaty, dok. 444, f. 506.

e Lezha mund të rrezikohen nga despotati i Skllavonisë. E njëjta gjë përsëdytet edhe në një shkresë të 10 Janarit, pa vit, të shkruar në Venedik. Ndonjëherë, Venedikasit i dallonin Dalmacinë e Skllavoninë: Kështu, në një shkresë të 31 marsit 1405 thuhet: Por, nëse këto dy galera, që do të shkonin nëpër Dalmaci dhe Skllavoni „...[50] [origj.: *verum si iste due galee que juerint per dalmatiam et sclauoniam inuenient* ...] e ndonjëherë e ngatërronin(?) me Zetën khs. mitropolitani grek (= ortodoks) ... i cili kishte jurisdiksion mbi të gjitha kishat e manastiret greke të Zetës etj., i zgjedhur patrik i Skllavonisë [origj.: *quod metropolitanus grecus ... habens Jurisdictionem super omnes ecclesias et Monasteria grecorum Gente etc. creatus patriarcham sclauonie*] e ndonjëherë edhe me Rashjen, përkatësisht me Rashën. Kështu ka ndodhur në një shkresë të hartuar po në Venedik më 14 tetor 1402, përmes së cilës Gjergj Strazimirit i refuzohej kërkesa që atij t'i lejohej t'i pushtonte tokat e Dukagjinëve, të Jonimëve e të Zakarive, porse i aprovohej kërkesa tjetër e tij që nëse të madhërishmit burra, zotërit Stefani dhe Vulku[*], kontë të Skllavonisë, kunetër të tij, [origj: *Magnifici viri domini sclauonie cognati sui* ...] të cilët kanë ikur nga lufta e Bajazitit dhe janë strehuar në Konstantinopol [...] për të ardhur në anët e Ulqinit....[51]

Nga shkrimet vendikase kuptohet se nocioni gjeografik *Sklavonia* në shembujt e sjellur më lart nuk ka të bëjë me Sllavoninë e sotme, porse me Dalmacinë si tërësi dhe me Republikën e Raguzës në veçanti. Duke u nisur nga kuptimi sllav, përkatësisht kroat që kjo fjalë e kishte në kroatishten do të rezultonte se jo vetëm Venediku, porse edhe vetë raguzasit romanë *sclavini* i quanin kroatët dhe raguzasit e kroatizuar. Kjo do të ishte mbështetja bazë për të besuar se raguzasit e kolonisë së Janjevës *Slovin*-ë do t'i kenë quajtur banorët ortodoksë, serbë të katundit Slovinje.

Sa për mundësinë e tretë duhet pranuar se në procesin e emërtimit të këtij vendi nuk mori pjesë elementi etnik shqiptar i Kosovës mesjetare, përkatësisht gjuha shqipe me veçoritë fonetike të saj. Veprimi i shqipes, toponimit në fjalë duhej t'ia ruantej tek shqiptarët psh. në trajtën **Sklaviní*,

---

[50] Poaty, dok. 469, f. 530; Dok. 509, f. 569.

[*] Është fjala për Stefan Lazarević-in e për Vuk Branković-in.

[51] sh. Dokumente për Historinë e Shqipërisë të shek. 15 (1400-1405), ..., f. 338.

**Shklaviní* ose edhe **Shkijení*, **Shqení* ose **Shqijení*. Kjo në rend të parë pse dihet që emri etnik *slovênin*ъ është reflektuar tek shqiptarët, si në Shqpëri, në Kosovë, Maqedoni ashtu edhe në diasporë, në krye të herës si *shkl'av* në kuptimin primar bullgar dhe si *Shk'ení*-a. (nga një trajtë më e vjetër *Shkl'avení-a*) në kuptmin Bullgari,-a; si *shk'a*-u përkatësisht *schiaa*-u *sckaa*-u, *scka*-u gek; shkizmatik *schkje skávu* shkizmatik; *shkiet, shkieet, shkija* serb dhe *Shkenija* Serbia; Iliria (në kuptimn Kroacia; Sllavonia); *shkinja* vllahja; serbja. Mungesa e dëshmimit të ndonjë trajte shqipe të toponimit *Slovinje* nuk mund të kuptohet si mosprani e shqipfolësve në këtë pjesë të hapsirës etnolinguistike të shqiptarëve, sepse popullata shqipfolëse e kësaj rrethine dhe gjithandej në hapsirën gjuhësore të shqipes edhe sot e gjithë ditën i quan serbët e sllavët e tjerë me emrin përmbledhës m. *shka,-u* shm. *shkije*; fem. *shkin,ë-a* dhe kjo trajtë nuk është e re sakohë që dihet se ... popullata autoktone greke, romake e shqiptare dhe fqinjët shihnin te këta (S. G. sllavët) një tërësi gjuhësore e etnike dhe i quajtën me të njëjtin emër gr. *Sklavoi*, (S. G: lat.) *Sclavi, Sclavini*, rum. *schei* shq. *shqa, shqe* sqaron Bogo Grafenauer.[52]

Një sqarim kompetent si për prejardhjen ashtu edhe për kohën e depërtimit të këtij emri në shqipen e jepte N. Jokl qysh në vitin 1927.[53] Ky sqaronte se emri *škīn* me kuptimin e përgjithshëm *sllave* në gegërishten veriperëndimore dhe ajo *škīnkɛ* e gegërishtes jugore ka hyrë në shqipen nga rom. *sclavína sclavinica* /*Sclavinica*.. Duke u nisur nga fazat e popullimit të gadishullit të Ballkanit me sllavë dhe të historikut të emrit *Sclavinica*, që në shek. VII - X, shenjonte pjesën tokësore midis Zarës, Selanikut e Rodopeve, Jokl arrin në përfundimin që këta emra do të kenë hyrë në shqipen në harkun kohor midis shekujve VII e X.

Në një punim tjetër të tijin[54] Jokl thoshte që kjo trajtë do të jetë marrë nga shqiptarët jo para vitit 700. Trajta latine *sclavus* e emrit popullor të sllavëve është reflektuar në shqipen si *shkla, shkja, shka*. (khs. psh.

---

[52] Pitanje srednjovekovne etničke strukture prostora jugoslovenskih naroda i njenog razvoja, Jugoslovenski Istorijski Časopis, 1-2/ 1966, f. 15-16.

[53] Altmakedonisch-Griechisch-Albanisch, Indogermanische Forschungen, 44, 1927, f. 37/38.

[54] khs. Zur Ortsnamen Albaniens, Zeitschrift für Ortsnamenforschung X, 2, 1934, f. 196.

atributet për banorë ende sllavë apo të shqiptarizuar Thomasio *Schiauo* një pronar bashtine në Villa clamada Capenico; Lecha *Sclauo* i Villa clamada Bolsa; Palli *Schiauo* nga Villa clamada Grisa; Zorzi *Sclavo* nga katundi Spatari; dy banorë të quajtur Andrea *Sclauo* nga katundi Barbarossi, përkatësisht Barbullush; Juan *Sclauo* banor i Villa clamada Somesi; Jon *Scaluo* i katundit San Serzi: (Shën Sirgji) dhe një Stani *Sclauo* i katundit Trompsi grandi dhe emrin e katundit *Shklav* që përemendet në Kadastrin venecian të Shkodrës të v. 1416[55] dhe në defterin osman/turk të regjistrimit më 1485 që asokohe i përkiste Krajës. Kemi të bëjmë me katundin *Shkja* në brigje të Liqenit të Shkodrës me nji kishë të vogël, në të cilën shihen ende shênja të padallueshme të freskut.[56] Me emrin e këtij katundi kanë të bëjnë edhe dy banorë vendës në shërbim të Republikës së Venedikut. I pari është komestabël[*] në kështjellën e Drishtit *Anton Sklavi* i cili përmendet jo vetëm më 18 mars 1400, por edhe shumë herë më vonë në funksione të ndryshme në shërbim të Republikës së Venedikut si edhe banori *Andrea sclauo*, një proniar i rrethinave të Shkodrës i cili, sipas një shkrese të 9 korrikut 1403, nga Republika e Venedikut kishte marrë për dhuratë, si edhe disa proniarë të tjerë, një sasi stofi.[57]

Dëshmi për një reflektim shqiptar të kësaj natyre kemi edhe tek emri *Shqiniqë* - siç quhej ndonjëherë Maqedonia nga shqiptarët.[58] Kjo trajtë, sipas P. Skok- ut, e ka për mbështetje nominativin e latinitetit ballkanik, i cili në shqipen ka dhënë *shqā*, shm. *shqē*, prej nga rrjedh *Shqiniqë* Ma-

---

[55] khs. Skadarski zemljišnik od godine 1416, Priobćio u sjednici fiologičko-historičkoga razreda jugoslavenske akademije znanosti i umjetnosti dne 10. studenoga 1881, Pravi član Sime Ljubić, në Starine, JAZU, Knj. XIV, Zagreb, 1882, f. 34, 37, 39, 42, 44, 45, 48, 52.

[56] sipas Dr. Konstantin Jireček, Shkodra e krahina e saj në mesjetë, në Vëzhgime iliro-shqiptare, Shkodër 2004 përk. Illyrisch-albanische Forschungen, Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy I. Band München und Leipzig 1916, f. 110.

[*] Sqarim sipas Dokumente për Historinë e Shqipërisë të shek. 15 (1400-1405), ..., , f. 653: Ushtarak i lartë në ushtrinë mercenare që i shërben Republikës së Venedikut në zotërimet e saj. Ofiqi i tij ishte *komestabileria*..

[57] Dokumente për Historinë e Shqipërisë të shek. 15 I (1400-1405), f. 84 e dok. 353, f. 432.

[58] pas P. Skok, Etimologijski rječnik hrvatskoga ili srpskoga jezika III, Zagreb, 1973, 282.

qedonia, rum. *Schei* shm. bullgarët. Fr. Miklosich[59] sqaronte para më shumë se një shekulli se tek shqiptarët e Greqisë me këtë emër shenjoheshin greku e greqishtja: *škl'a-au*, plur. *škl'e-ete γραικοί ώς πρὸς τήν γλώσσαν, είς αντίθεσιν πρός τὸ arbereš*; *šklerišt ἤ šklirišt ἐπίρημα: a di šklerišt*? savez-vous le grec? Reinh. 2. 31. - konstatim që e përtërinte edhe E. Çabej,[60] sipas të cilit (për shqipfolësit e Greqisë) *shkla ... shqa-* sllav, nga lat. *sclavus* ose nga *σκλάβος*; don të thotë grek, te shqiptarët në Ukrainë e ka kuptimin bullgar, ndërsa tek ata të Sremit banor i Sllavonisë, sllavon, kroat. Ndryshe, kalimi në shqipen i një *s* nistore e në pozicione të tjera në togjet konsonantike *sc* e *st* të peruidhës paralatine e latine, reflektohet gjithmonë në *shk*, përkatësisht në *sht* khs. *Scodra-Shkodra*, *Scupi- Shkupi*; lat. *striga* shq. *shtrigë, stratum* shq. shtrat etj.

Duket se atributi *shkla, shka* do të ketë hyrë në shqien nga latinishtja që nga koha kur sllavët u dukën në tokat e pararendësve të shqiptarëve. Atributi *shkla* e kishte mbase për protoshqiparët e krishterizuar së pakut që pesë shekuj para ardhjes dhe nëntë shekuj para krishterizimit të sllavëve paganë kuptimin *sllav* dhe *jo i krishter, jo katolik.* Ka edhe një tezë, për mendimin tim e lansuar nga autorë jo edhe me aqë kompetencë për historinë e lashtë të Kosovës, sipas së cilës Me të dhëna arkeologjike e historiografike vërtetohet se viset e Kosovës aktuale nuk e kanë përjetuar vendosjen sllave të periudhës së Dyndjeve dhe se paraardhësit e serbëve historikë janë kristianizuar jashtë territorit të Kosovës aktuale.[61] Një këso dykuptimsie (khs. më lart) e gjejmë,[62] edhe te Frang Bardhi i cili emrin

---

[59] sh. Die slavischen Elemente im Albanischen, Wien, 1870, f. 33.

[60] sh. Studime për fonetikën historike të gjuhës shqipe, përgatitur nga Mahir Domi e Seit Mansaku, Tiranë, 1988, f.408.

[61] khs. www.pashtriku.org.

[62] sipas Fr. Miklosich, Die slavischen Elemente im Albanischen, ..., f. 33: *slovênin*ъ *slovenus asl.* šk'a-u g. (aus škl'av) Bulgar; šk'ení-a. (aus škl'avení-a). Bulgarien. Hahn schiaa-u sckaâ-u, scka-u greco, eretico, scismatico. Rossi. schkje ein Rátz. Klem. Wrnd. 85. skávu scismatlco; sckiet plur. Guagliata 45. sckiet, sckieet plur. Conf. 39. 53. 55. škija Serbe; škenija Serbien. Mscr. schienia Illyris, Schiavonia. Blanchus sckiet, d. i., škje-t gli scismatici. Guagliata 45. škińa vlahinja (srpkinja). Vuk 12. 1. Das unmittelbar aus σκλάώος entstandene šk'a bezeichnet nach Verschiedenheit der Gegend

sckiet, përkatësisht *škje-t*, e shpjegonte si it. gli scismatici.

Kuptimin që ka fjala *shka /shqa* në të folme të ndryshme dhe nëpër fjalorë të gjuhës shqipe si edhe prejardhjen e saj e gjurmoi dhe Bardhyl Demiraj.[63] Ky tregon se nocioni *sllav* në ndonjë proverb e ka edhe kuptimin shërbëtor, skllav; se në terminologjinë kishtare popullore të krishterimit nocioni *shqa* është i lidhur ngusht me nocionin *sllav, sllavishtfolës*, përkatësisht pjesëtar i kishës ortodokse sllave, siç dëshmohet psh. tek P. Bogdani si edhe *shqa* /*shka* shm, *shkietë* e ka kuptimin sllavishtfolës, përkatësisht ata që flasin shkinisht sllavisht, tosk, shklerisht bullgarisht.[64]

Autori ynë sqaron më tej se nocioni shqa/shka e ka edhe kuptimin skizmatik, madje edhe heretik, përkatësisht besimtar fals, duke ngërthyer në vetvete kryesisht atë të krishter shqipfolës që i ishte bashkuar kishës ortodokse sllave, sikurse quhej grek dhe *urum* (turk. < (u)rum grek i krishteri shqipfolës që i përkiste kishës ortodokse greke, përkatësisht turk gjegjësi mysliman.[65] Tek arvanitasit (arbëreshët) e Greqisë, fjala *shkla,-u – sh. shkle*-të e paska kuptimin grek njëgjuhësh = që flet vetëm greqisht; joarvanit.

Përsa i bie etimologjisë së varianteve shqipe *shkla/shka* etj. B. De-

---

verschiedene slavische Völker: es muss daher auffallen, dass die Albanesen Griechenlands mit demselben Worte die Griechen bezeichnen: škl'a-au, plur. škl'e-ete γραικοὶ ώς πρὸς τὴν γλῶσσαν, εἰς ἀντίθεσιν πρὸς τὸ arbereš; šklerišt ἢ šklirišt ἐπίρημα:a di šklerišt? savez-vous le grec? Reinh. 2. 31. Aus dem it. *schiavone* stammt *schlavun*-i. Raps. 17.

[63] Së pari në punimin gjermanisht Der Slawe, shqau, im Albanischen. Eine ethnolinguistische Fallstudie zu Herkunft und Aussagekraft einer Fremdbezeichnung, Südost Forschungen 65/66 (2006-207), f. 406-421 e më vonë në versionin shqip të tij Kur Etnikët tregojnë: Shqa-u ndër Shqiptarë, Studime, 16-17 (2009-2010), Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2010, f. 231, 248.

[64] Për ilustrim të kësaj B. Demiraj sjell citatin veçe ju lutshë të më shtampohej libri, ashtu qi kur të kthenje prej dheut sinë të keshë nji qiri ndezunë në dorë, për të ndritunë atë të vobek dhē t'Arbënit e të Sherbisë, i silli, e madhe pjesë flet arbënisht, tue kjanunë dalunë dheut së Arbënit e mbiellë Shënjtënë Fē ndë dhē të Despotit: prashtu shkietë për antonomasi Fesë Katolike i thonë arbanaska vera nga vepra e P. Bogdanit.

[65] Kur Etnikët tregojnë : Shqa -u ndër Shqiptarë, …, f. 233-234.

miraj kujton se kjo mund të rrjedhohet formalisht ose nga greqishtja bizantine σκλάβος shm, σκλάβοι,ose prej latinishtes mesjetare *sclavus,* sh, *sclavi*, apo, siç sqaron në vazhdim, nga një bazë e përbashkët paradialektore e shqipes (S. G. para shek. VI[*]): shq. */*sklavinā*/, e cila nuk mund të shpjegohet ndryshe, veçse si një huazim i drejtpërdejtë shqiptar prej lat. mesjetare *Sclavina*. Ka mundësi që nga kjo trajtë të rrjedh varianti *Shkjeni* për *Slavonia*: *Illyris*, *Schiavonia, Schienia*; *Shkenija* që tek Frang Bardhi, (1635) përdorej për ta shenjuar nocionin gjeografik *Serbia.*

Lidhur me kohën e përfitimit të këtij huazimi në shqipe, B. Demiraj sqaron se: Përcaktimi i kronologjisë (absolute) të huazimit me mjete gjuhësore përkon kështu katërçipërisht me faktet historike, shi me kohën, kur tributë e sllavëve të Jugut (lat. *Sclavi*, *Sclaveni* – gr. biz. *Σκλαυήνοί*, *Σκλαυηνοί*; *Σκλάβοί*) depërtuan në Ballkan, dhe nëpërmjet shtrirjes dhe dominimit të tyre thuajse kudo e gjithkund në gadishull ndryshuan thellësisht marrëdhëniet kulturore ekzistuese ndëretnike.

Meritë e B. Demirajt do të mbetet, në këtë kontekst, konstatimi i tij se Përdorimi i dikurshëm i *shqa* edhe me kuptimin pagan, jo i krishterë, i cili nxori jashtë përdorimit në terminologjinë popullore kristiane shenjuesin e mëhershëm tosk. (*i*) *pëgërë*, geg. i *pëgāmë*. *i papastër, i fëlliqur* (< † *pagan,* jo i krishterë < lat. kisht. *pāgānus*) erdhi dhe u përdor me kohë, sipas përkatësisë konfesionale ose fetare, me kuptimin skizmatik, ortodoks, pjesëtar i kishës ortodokse bullgare, përkatësisht serbe madje edhe me konotacion negativ si heretik. Ky përbërës i ri kuptimor, që është përdorur gjerësisht sidomos në letërsinë fetare të arealit kulturor katolik të Veriut, duket të jetë një zhvillim i brendshëm i shqipes, pasi nuk ka një gjegjës përkatës në terminologjinë kishtare të vendeve të krishtera (ballka-

[*] Ky sqaron në vazhdim se në rast se zhvendosim tash kahen e hetimit diakronik në aspektin e kuptimeve që gëzon kjo njësi leksikore në kohën tonë, do të vërejmë se ndikimi i latinshtes së mesme, (<greqishtes bizantine) mund dhe duhet të ketë vepruar në një periudhë bukur të gjatë, meqë përgjatë aksit kohor atë arrijmë ta izolojmë në të paktën tre përbërës kuptimorë, e pikërisht: a) sllav: si emër përmbledhës për një pjesëtar çfarëdo të tribuve sllave-jugore që u dyndën dhe u përhapën në Ballkan në shek. VI-VII; në bashkëlidhje me këtë b) pagan në kuptimin jo-kristian; e më vonë i kombinuar edhe me kuptimin c) skllav si një person pa të drejta dhe pa plang (shek.IX-XI).

nike). Konstatimi i B. Demirajt se Në rrjedhë të kohës, organizimi i popullsisë shqipfolëse në katër grupime fetare. d.m.th. në *shqa* ortodoks-sllav pranë latin katolik-romak, turk mysliman dhe grek ortodoks-grek erdhi duke u bërë një faktor destabilizues në matriksin e kukturës etnike shqiptare, madje në një masë të tillë, sa që në gjysmën e dytë të shek. XIX, shi gjatë procesit të zgjimit të vetëdijes kombëtare, komponenti fetar u mënjanua krejtsisht e në mënyrë të vetëdijshme nga programi kulturor-ideologjik i lëvizjes së Rilindjes kombëtare. e lejon shtrimin e pyetjes për-se për hapsirën e Kosovës nuk u ruajtën emrat *Rasha, Rashka, Servia* etj. e aqë më pak *Sklavonia* ose variantet e saj shqip *Shkjeni*/ *Shkini*, por vetëm emri etnik *shka,* sepse pasardhësit e dardanëve nuk e ndien veten kurrë për shtetas të një kreature prej shteti, të një formacioni shtetëror/ social të instaluar nga pushtesit serbë të Kosovës në fillim të shek. XII.

Konstatimit të P. Skok (khs. më lart) se edhe tek grekët e tek romanët ballkanikë *o* e sllavishtes reflektohet në *a* [...] bën t'i shtohet se i njëjti fenomen vërehet edhe në shqipen moderne tek varianti *sllav* për atë të serbishtes *sloven* sllav. Se trajtat *shkā, shqā* paskan pas gjalluar edhe në variantin gegë të Prishtinës e dëshmon rrethana se - gjithnjë sipas P. Skok - Në të folmen e fshehtë (argot) *bošački* përkatësisht *boškački* të vorbëtarëve (SG. serbë?) në Prishtinë nga e shq. *shqā* është krijuar *čkavac* njeri, burrë; serb, prej nga sërish në të folmen gegavishte (në origjinal: gegavački) nga shm. shqip *shqē* ka dalur *kevac* baba, atë, ndërsa në të folmen e fshehtë të muratorëve në Bracigovo (Rodope) *škjau* don të thotë njeri, burrë; bullgar. Nga fusha e onomastikës, një dëshmi të emërtimit të sllavëve, përkatësisht të serbëve e të bullgarëve si *shklā* e gjejmë edhe në gjysmën e parë të shek. XV kur një banor i katundit Bogde të krahinës së Rekës së Epërme (Maqedoni) e mbante mbiemrin *Ishklav*.[66] Sa kohë që dihet se turqit ia shtojnë zanoren *i* emrave të vendeve e të njerëzve që fillojnë me një bashkëtingëllore apo me togun bashkëtingëllor *sk* (khs. *Ipek* nga **Pek/ Peć* - Peja*; Istepan* për Stepan etj.) del se trajta e mirfillt shqipe e mbiemrit të banorit Nikolla do të ketë qenë në shek. XV patjetër **Shklav* përkatësisht

[66] sh. Galaba Palikruševa & Aleksandar Stojanovski, Etničeskite priliki vo severozapadna Makedonija vo XV vek, Jugoslovenski istorijski časopis 1-2, Beograd, 1970, f. 35.

Shkla,-u serbi. Duhet vërejtur kalimthi se dëshmimi i këtij togu konsonantik në trajtën *kl* e më vonë *q* (khs. më lart *shqē* e *Shqiniqë*) edhe në këtë pjesë të truallit gjuhësor të shqipes tregon se kalimi i mëvonshëm i togut *kl* në *q* është i gjithë hapsirës gjuhësore të shqipes përkatësisht që në këtë rast ky fenomen është zhvilluar në vend prandaj folësit e shqipes nuk janë në këtë zonë të Maqedonisë së sotme ardhës në shek. XVII - sikundër u përpoqën t'i paraqisnin shkencat etnografike e linguistike serbe e bullgare/ maqedone. Se këtu nuk kemi të bëjmë me një dëshmi të izoluar apo të rastësishme të ruajtjes së togjeve të vjetra konsonantike *kl* e *lk* po e sjell edhe dëshminë e vitit 1454 kur midis 24 pleqnarëve që e pleqnuan çështjen e mexhëve të katundeve Pagarushë, Jançishtë e Hoçë midis Rahovecit e Suharekës përmendet edhe njëri i quajtur *David Buzulьk*.[67] Personi David, që jetonte në katundin Korish midis Prizrenit e Suharekës, mbante një emër familiar të përbërë që i përmban fjalët shqipe *buz*/*ë,-a* dhe *ulk,-u*. Me rëndësi për t'u përmendur me këtë mes është rrethana se në mbiemrin familiar *Buzulk* përmbahet trajta e vjetër *ulk* e fjalës së sotme shqipe *ujk*, trajtë që në funksion apelativi në të njëjtën formë dëshmohet edhe në emrin ilir të vendit *Ulcinium* (sot Ulqin).[68] Në dritën e rrethanës se në gjysmën e parë të shek. 16 (në vitin 1555) mbiemri i autorit (Gjon Buzuku) të librit më të vjetër shqip që dimë deri tani dëshmohet në trajtën Buzuku, mund të pohohet se, në dritën e dëshmive Nikola *Išklav* të krahinës së Rekës dhe *Shklavi* - katund në brigje të Liqenit të Shkodrës, është së pakut më i vjetër se shek. XV.

Arsyet e mungesës së ndonjë dublete shqiptare të emrit të vendbanimit Slovinje duhen kërkuar në rend të parë tek rrethana se nuk është dëshmuar ndonjëherë ndonjë variant *Sclavinia* i këtij vendbanimi. Vetëm sikur të ekzistonte një trajtë e tillë, atëherë ajo do të mund të kalonte plotësisht në harmoni me ligjet fonetike të shqipes në një trajtë psh. **Sklaviní*, **Shklaviní* ose edhe **Shkijení*, **Shqení* apo **Shqijení*. Përveç kësaj, mun-

---

[67] khs. *ot Koriše David Buzulьk*, te A. V. Solovjev, Odabrani spomenici srpskog prava, Bograd, 1928, f. 215.

[68] Sqarimin e emrit antik *Ulcinium* me fjalën shqipe *ulk* (sot *ujk,-u*) e kanë përvetësuar shumë dijetarë indoeuropeistë. Khs. psh. Paul Kretschmer, Einleitung in die Geschichte der griechischen Sprache, Göttingen, 1972, f. 265 e të tjerë.

gesa e një varianti shqip të emrit të këtij vendbanimi sqarohet edhe nga fakti se këtu kemi të bëjmë me një vendbanim kolonësh nën mbikqyrjen e kishës serbe dhe së dyti se as vendbanimet e shqiptarëve nuk kishin emra shqip, sepse procesi i sllavizmit onomastik të hapësirave etnogjeografike të tyre ishte kryer shumë kohë para shek. XIV.

Pikërisht mungesa e variantit shqip të emrit edhe do të dëshmonte se kolonia serbe Slovinje u emërtua jo nga arqipeshkëvia bizantine e Lipenionit, nën jurisdiksionin e së cilës do të kenë qenë shqiptarët - besimtarë ortodoksë të perandorisë bizantine - porse nga kisha serbe pas pushtimit më 1282 të Lypianit (për këtë sh. më poshtë) ose nga raguzasit fqinjë që jetonin në Janjevë. Mungesa e dubletës shqiptare nuk do të fliste në të mirë të tezës aprioristike e të politizuar të dijes serbe se në Kosovë dhe sidomos në Rrafsh të Kosovës nuk na paska pasur shqiptarë para shekullit XV, sepse prania e shqiptarëve, përkatësisht e shqipfolësve pikërisht në këtë zonë dëshmohet edhe nga vetë burimet kishtare serbe të shekujve XIII-XIV.[69]

Se emërtimi *Slovinje* nuk mund të jetë më i vjetër se shek. XIV do ta tregonte rrethana se Lypiani as deri në vitin 1282 nuk ishte pushtuar definitivisht nga principata e Rashës. Ky fakt del i qartë në një shënim të arqipeshkvit serb Danilo, i cili më 1282, kur po e përshkruante fillimin e sundmit të atij mbreti (SG: të Milutin -it) shkruante (përkthimi im i lirë): se: *po ta shikoje ato ditë tokën serbe do ta shihje atë të ngushtuar shumë, të varfër e të zvogëluar; shteti ishte i mbretërisë greke që shtrihej deri në vendin e quajtur glagolisht, Liplan*.[70] Me këto fjalë - vashdon St. Novaković – Që Lypiani me të vërtetë ishte një kohë jashtë pushtetit serb, kujtoj se e dëshmon krisobula e Milutin-it manastirit të Graçanicës lëshuar për arqipeshkëvinë e Lypianit,[71] përmes së cilës ky e ngriste rishtazi ipeshkvinë e rrënuar e të djegur dhe ia kthente kësaj pronat sipas krisobulës së të

[69] khs. për këtë librin tim Kërkime Onomastike II, Prishtinë, 2014.

[70] khs. origjinalin: *bě bon vь tы dьni viděti zemlju srьbьskoju vь těsnotě vєlicě obьjetou i umaljenou; drьžava bo carsьstva grьčьkago bě priležešti do města glagoljenago Lipljan* te Stojan Novaković, Novo Brdo i Vranjsko Pomoralvje u istoriji srpskoj 14 i 15 veka, Beograd 1880, f. 28.

[71] khs. Fr. Miklosich, Monumenta serbica ... 562 etj.

gjyshit e të t'et (dmth. sipas krisobulave të Nemanjës e të Mbretit të Parë të Kurorëzuar[*]) që, fundja, e dëshmon edhe rrethana që manstirit i jepnin prona të Lypianit (Kosovës), të Moravës (Gjilanit) e të Topolnicës (Krivarekës) *pushteti grek dhe sundimtari* (SG: serb). Ato luftëra dhe pushtime alternative midis bizantinëve e serbëve bënë që Graçanica të shkatërrohej[**] e të lehej pasdore.[72] Me këtë ka lidhje edhe konstatimi i këtij autori se pikërisht për këtë arsye as një xehtari në Novoberdë e në Janjevë, që do të ishte e drejtuar nga serbët, nuk mund të jetë më e herëshme se e shekullit të XIV, përkatësisht më e vjetër se viti 1326 kur Milutini i pushtoi të dy Pollogët, Ovqepolen e Zletovon në Maqedoni dhe Novoberdën sepse - thotë Novaković - në Janjevë dëshmohet qysh më 1303 kisha katolike dhe pse në fund të shek. XIII, përkatësisht në periudhën midis viteve 1282-1336 në hapsirën midis lumenjve të Sitnicës e të Moravës xehtaria kishte marrë hov të madh zhvillimi[73] dhe, kjo xehëtari as ishte nxitur e as drejtohej nga serbët.

Këtyre të dhënave bën t'u shtohen edhe disa të tjera që nuk i përmend Novaković -i e këto janë se Lypiani sulmohej e pushtohej apo shkretërohej nga zhupanë të principatës së Rashës. Në shkrime të karakterit gjenealogjik, biografik mësohet se edhe Stepan Nemanja ka rrënuar qytete të grekëve. Pikërisht gjatë kohës së sundimit të tij 12 bujarë të mëdhenj e paskan nisur përndjekjen e bullgarëve e të grekëve dhe i rrënuan qytetet e tyre.[74]

Në dritën e zhvillimeve historike të trajtuara më lart që karakteri-

---

[*] I bir i Stepan Nemanjës. Edhe ky quhej Stepan. Falë martesës së tij me bijën e një venedikasi të shtresës së lartë, kurorën mbretërore ia dha vetë papa aktual. Më gjerësisht shih te Opis jugoslavenskih novaca od Prof. Sime Ljubića, Zagreb, 1875.

[**] Ky rrënim e shkretërim do të jetë vetëm njëri ndër disa sish që kjo qendër ipeshkëvnore i pësoi nga sulmet e herëpasherëshme të kontëve serbë të Rashës. Kështu e kishte pësuar Lypiani një herë edhe nga një sulm i kontit të madh serb Vukan më 1091 kur ky e kishte djegur Lypianin dhe kishte shkatërruar vise të tjera. Khs. për këtë edhe Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës, 5, Lypjani, Prishtinë 2004, f. 149.

[72] sh. Stojan Novaković, Novo Brdo ..., f. 29.

[73] Poaty, f. 29.

[74] khs. Ljub. Stojanović, Stari srpski rodoslovi i ljetopisi, Beograd 1883, f. 18.

zohen me luftime e shkatërrime të ndërmarra në emër të pavarësimit të kishës serbe sikur dëshmohet se nuk ka asnjë arsye të paravendohet që qendra ipeshkvnore bizantine e Lypianit të ketë sjellur pikërisht kolonë serbë e aqë më pak që ata t'i quante me variantin sllav të emrit të tyre etnik, sa kohë që bizantinët e kishin në përdorim variantin e tyre *Sklavinika, Sklavoi, Sklavini*.

Në të mirë të mundësisë së katërt, përkatësisht të emërtimit të këtij vendi nga kisha serbe do të fliste rrethana që mbase *Slovinje* do të jetë njëra ndër ngulitjet e para katundare ose kolonia e parë serbe e krijuar nga kisha serbe e Lypianit. Kjo koloni serbe do të jetë pagëzuar mbase nga kisha serbe, pas pushtimit të arqipeshkëvisë së Lypianit nga serbët. Këtë masë katundarësh serbë, kisha serbe do ta ketë sjellur si masë bujqrobërish. Vështruar në rrafshin gjuhësor, kjo ka mundur të ndodhë ndoshta që në valën e parë të pushtimeve të Nemanjës, atëherë kur nocioni *slovinъ* nuk përdorej më për shenjimin e etnisë sllave, por të asaj serbe të principatës së Rashës në ekspansion. Masa sllave e vendosur në afërsi të Ulciana-s ilire përkatësisht të Ulpianës romake - *Lipenion*-it bizantin do të ketë pasur nevojë të shquhet nga pjesa tjetër e popullatës - qytetare e perandorisë së Bizantit. Dhe, këtë e bënë duke e quajtur njërin nga vendbanimet e ngritura katundare me emrin etnik të tyre - *Slovinje* vend i serbëve, emër që as nuk ishte më në përdorim e as që është ruajtur si emër etnik i serbëve. Ka arsye të supozohet se nun i emrit Slovinje mund të ketë qenë kisha serbe e cila me qëllim të krijimit të ndjenjës së lashtësisë së vendbanimit do ta ketë zgjedhur qëllimisht një emër nga lashtësia sllave, nga leksiku i serbishtes kishtare ashtu sikundër e provoi që ta serbizonte emrin **Manastir* të vendbanimit midis katundeve Butovc e Makovc të Prishtinës, duke ia vënë këtij më 1455 emrin Bitolj, Bitol[75] nga sllav. *obitelь* përkatësisht *obitolь* pronë tokësore apo vendbanim që i takon bashkësisë së manastirit; manastir.

Përveç nga trajta e vjetër *slovinъ*, në Kosovë është dëshmuar në mesjetën e vonë edhe ndonjë emër vendbanimi që është formuar nga varianti *srb-in* i emrit etnik të serbëve. Dëshmia më e vjetër e një emri të

[75] khs. Oblast Brankovića, Opširni katastarski popis iz 1455. godine, Sarajevo 1972, f. 313.

vendit në Kosovë, të formuar nga emri popullor i serbëve, është e vitit 1348.[76] Këtu kemi të bëjmë, sipas M. Bukumirić, me katundin e sotëm Serbica e Poshtme në rrethina të Prizrenit, sepse në këtë katund paska edhe sot kishë e varre dhe se po këtu është edhe lumi Jagllednica që po me këtë emër përmendet në atë krisobulë.[77]

Pushtetet serbe e zbatuan këtë traditë edhe më vonë me rastin e zgjerimeve territoriale, përkatësisht të ripushtimeve të Kosovës dhe në Vojvodinë. Këtu i kanë rrënjët emrat e dy vendbanimeve si *Srbobran* e *Srbica* (shqip Skënderaj) në Kosovë. Emri i parë është riemërtim administrativ serb i vendbanimit që në krisobulën e Banjskës të viteve 1313-1318, e njohur edhe si Krisobula e kishës së Shën Stefanit, quhej *katun blgars'ki*[78] katuni i bullgarëve dhe që nga popullata shqiptare - si rezultat i kontinuitetit në të banuar të këtyre anëve - quhet edhe sot e gjithë ditën *Bugariq*, ndërsa i dyti i periudhës së pas vitit 1912, përkatësisht i periudhës së kolonizimit të Kosovës me kolonë nga Mali i Zi, Lika e nga Serbia. Edhe në komunën e Istogut paska një katund të quajtur *Srbobran*. Katundi paska 33 familje serbishtfolëse. Nga këto, 31 janë të ardhura midis dy Luftërave Botërore; 26 nga ato nga Mali i Zi dhe vetëm 2 sosh qenkan të vjetra. Vendësit shqiptarë dhe banorët serbë e mbajnë mend emrin e përparshëm *Sovllak* të këtij vendbanimi.[79] Të gjitha këto emërtime e kanë për bazë emrin etnik të serbëve që u është vënë vendbanimeve të krijuara si rezultat i pushtimit e i kolonizimit prandaj, së këndejmi, edhe janë emra librarë të ngjyrosur politikisht.

Rrethana që në Kosovë ka emra vendbanimesh me emrat etnikë të serbëve *Sllovinje* në rrethina të Lypianit dhe *Srbica* në Drenicë e në re-

---

[76] Hrisovula... 1348, f.274, 302: khs. *i pridasmo mu ot crkovne zemle ot arbanasь špinadiju. a megja špinadii kako ide poutь is korišeo u srьbice do megje srьbič'ke; selo srьbice.*

[77] sipas M. Bukumirić: Iz onomastike južne Metohije, Onomatološki prilozi V, SANU, Beograd 1984, f. 414.

[78] sh. Lj. Kovačević, Svetostefanska hrisovulja, Spomenik SKA, IV, Beograd, 1890, f. 8.

[79] sipas Svetozar Stijović, Onomastika središnjeg dela Metohijskog (Pećkog) Podgora, Onomatološki prilozi II, Beograd, SANU, 1981, f. 329.

gjionin e Prizrenit dhe *Srbobran* në komunat e Leposavić-it e të Istogut, tregon se kjo popullatë është e ardhur në këtë pjesë të hapsirës gjuhësore të shqipes. Faktori emërtues, emërdhënësi, i këtyre vendbanimeve është mbase vetë popullata serbe e ardhur. Serbët i quajtën vetë vendbanimet e veta me emrin etnik të tyre për t'u dalluar nga të tjerët, sepse edhe ishin të tjerë në krahasim me popullatën vendëse shqiptare. Emrat kosovarë të kësaj kategorie u takojnë dy harqeve kohore: emrat Slovinje e Srbica (regjioni i Prizrenit) janë të gjysmës së parë të shek. 14, ndërsa ato Srbica (Drenicë), Srbobran të Leposavić-it dhe të Istogut janë emra libreskë me prapavijë politike të pushtetit serb të vënë pas pushtimt më 1912 të Kosovës. Vendbanimet e quajtura me emrin etnik të serbëve janë në të vërtetë oaza gjuhësore e religjioze serbe që mund të jenë menduar si mjet për serbizimin e terrenit. Këtë do ta dëshmonte më së miri zëvendësimi me emrin *Srbobran* në çerekun e parë të shek. XX të emrit të vendbanimit të blegtorëve vllehë që më 1313 në vetë shkrimet kishtare serbe dëshmohet si *katunь blgar'ski*. Po këtë e tregon edhe emërtimi i oazës serbe *Srbobran* në komunën e Istogut dhe *Srbica* në krahinën e Drenicës - të ngritura pra në ambiente me popullsi shumicë absolute shqiptare.

Skënder GASHI, Wien

EINE FRÜHE SERBISCHE KOLONIE – OASE IN KOSOVA-EBENE

(Über den Urspung des Namens Slovinje)

Zussammenfassung

Der erstmals in den serbischen kirchlichen Quellen als *Slovinje* im Jahre 1331belegten Dorf der heutigen Gemeinde Lipjan (serb. Lipljan) ist der einzige aus den spätmittelalterlichen Volks-bzv. ethnischen Namen *slovinь* (mit der Endung -inje erweiterten) der Serben entstandener Ortsname im heutigen Kosova. Im Lichte der Tatsache dass, im XIV Jhdt. der Volksname *slovinь* für Serbe nicht üblich war, kann man leicht annehmen dass es hier um eine Bezeichnung einer neugegründeten *Sklavinie*, als Folge der Expansion des im XII Jhdt. gegründeten Serben- Fürstentums Raša- Raška der Serben handelt. Das umsomehr weil die Variante *slovinь* für Serbe wird in keiner, aus den XIII- XV jhdt. stammenden serbischen kirchlichen-staatlichen Urkunden im Gbrauch war. Daher kann man annehmen dass dieser Name unmittelbar nach der Eroberung durch St. Nemanja im Jhre 1198 des größten Teils Kosovas, bzw nach der Eroberung des byzantinischen Bistums Lipenion (1282) entstannden sein könnte. Um den Gefühl zu erwecken, bei diesen serbischen Neuankömmlingen handele es sich um eine schon seit der Eindringen der *Slovine*n im VI- VII Jhdt: auf dem Balkan, taufte die serbische Kirche diese Kolonie mit einen Namen *slovinь* der in dieser Zeit nicht mehr im Gebrauch war. Diese Annahme könnte glaubwürdig sein wenn die neuentstandene Serben-Kolonie Slovinje nicht von den katholischen slawischsprechenden Rgusaner-Kolonie von Janjevo, die schon in ihren Mutterland (Ragusa, Dalmatien) die orthodoxen Serben wie auch den eigenen Land Sclavinia bezeichneten.

Es bleibt zu erklären warum die Albaner (die auch bei der ersten Erwähnung des Dorfes im Jahre 1331 dort anwesend waren) nur die serbische Variante des Dorfnamens und nicht die erwartende albanische Form *Shklavini*, *Shkleni*, *Shkeni- Shkini Shkijeni*, weiterbewahrt haben. Dies umsomehr weil es allgemein bekannt ist dass der Slawenname lat. *Sclavi*, *Sclaveni* – gr. byz. *Σκλαυήνοί*, *Σκλαυηνοί*; *Σκλάβοί* bzw. *Sklavinika*, *Sklavoi*, *Sklavini* schon seit der Einwanderung der Slawen auf dem Balkan im albanischen als *Sklaviní, *Shklavení oder auch **Shkijení*, **Shqení* ,**Shqijení Shkenija* (aus *Shkl'avení-a*) *Shk'ení*-a in der Bedeutung Bulgarien, Serbien, Kroatien, Slavonien als Bezeichnung für jeweilligen Land und als *shk'a*-u *schiaa*-u *sckaa*-u, *scka*-u *schkje skávu* der Grieche; der Serbe; der Orthodoxe; Schismatiker Pl. *shkiet*, *shkieet*, *shkija* die Serben und *shkina*,-t als Bezeichnung für die Slawen und Orthodoxen in allgemeinem eingedrungen ist.

Teuta ABRASHI, Prishtinë

LIDHJA KRYEFJALË-KALLËZUES: PËRSHTATJE, DREJTIM APO TË DYJA?

KDU 811.18'36

Abstrakt

Ky punim trajton disa çështje të kategorisë së vetës. Ato do të trajtohen duke vështruar më saktë lidhjen kryefjalë-kallëzues për të cilën thuhet se bëhet me anë të përshtatjes së vetës dhe numrit. Së pari do të paraqiten disa të dhëna elementare rreth vetës dhe numrit dhe do të analizohet se si reflektohen ato gramatikisht te kryefjala dhe te kallëzuesi. Punimi do të sjellë gjithashtu disa të dhëna themelore rreth përshtatjes (kongruencës) dhe drejtimit (reksionit). Duke analizuar paradigmën e mbaresave foljore do të konstatohet ngjashmëria sintaksore ndërmjet vetës dhe rasës, e cila 'vendoset' te sintagma emërore nëpërmjet drejtimit. Punimi tenton të dëshmojë se lidhja kryefjalë kallëzues bëhet me përshtatje dhe me drejtim. Konkretisht, kur kryefjala është përemër kallëzuesin e merr vetën me përshtatje, kurse kur kryefjala është emër kallëzuesin e merr vetëm nëpërmjet drejtimit.

1. Hyrje

Për lidhjen kryefjalë-kallëzues në *Gramatikën e Akademisë*[1] shënohet:

> "*Lidhja gramatikore e kallëzuesit me kryefjalën shfaqet si përshtatje... Kallëzuesi foljor përshtatet në vetë dhe në numër...*".

Në këtë frymë konstatojnë edhe Buchholz/ Fiedler:

> *"Wenn ein Subjekt Aktant des regierenden Verbs ist, kongruiert das finite Verb..., das als Prädikat fungiert, stets mit dem Subjekt in den Merkmalen der gramatischen Person und des Numerus...*[2][3].

[1] Tiranë (1996:198), vëllimi II.

[2] Buchholz/ Fiedler (1987: 429).

[3] Nëse një kryefjalë është aktant i foljes drejtuese, atëherë folja që funksionon si kallëzues,

Lista e librave të gramatikës së gjuhës shqipe, që pohojnë ngjashëm me dy librat e mësipërm, është e gjatë dhe këtu nuk po i përmendi. Natyrisht, një konstatim i tillë është i pritshëm, sepse kështu thuhet edhe (gati[4]) në të gjitha gramatikat e gjuhëve të tjera, por edhe në ato të gjuhësisë së përgjithshme, por duke përjashtuar monografitë studimore.

Në këtë punim do të vështrojmë lidhjen sintagmatike kryefjalë-kallëzues në gjuhën shqipe me një dioptri më të mprehtë. Motivimi për të ndërmarrë një vështrim të tillë erdhi nga arsyeja se kohët e fundit, e sidomos me versionet e reja të modeleve gramatikore,[5] gjithnjë e më shumë po theksohen tiparet dhe kategoritë gramatikore. Trajtimi i tyre jo rrallë sjell huti. Ato herë dalin të interpretueshme në domenin nominal e të painterpretueshme në domenin verbal dhe e kundërta, të painterpretueshme në të parin e të interpretueshme në të dytin. Në këtë punim do të analizojmë tiparin e vetës dhe të numrit dhe mënyrën se si këto tipare reflektohen te folja. Siç do të shihet, një gjë e tillë bëhet jo vetëm nëpërmjet përshtatjes (kongruencës), por edhe nëpërmjet drejtimit (reksionit). Besoj se nëpërmjet analizës më të mprehtë të kësaj lidhjeje sintagmatike do të ndihmohet (sadopak) për të kuptuar problematikën e tipareve gramatikore dhe për paraqitjen më të saktë të strukturës së fjalisë, por edhe të sintagmës emërore. Sidomos për këtë të fundit, sepse rishtas vërehet një tentativë nga disa gjuhëtarë për të riformuluar (konceptualisht) strukturën e zgjeruar të sintagmës emërore[6], me ç'rast veta zë një vend qendror[7].

2. Disa të dhëna themelore

Në gjuhën shqipe vetat shprehen kryesisht me mbaresat foljore apo

përshtatet gjithnjë me kryefjalën në vetë dhe numër gramatikor, përkth. T. A.

[4] Përjashtim këtu bëjnë, Eisenberg (1986): 272 dhe Zifonun et. al (1997) :1683).

[5] P. sh. Programi minimalist i modelit të parimeve dhe parametrave.

[6] Sintagma e zgjeruar emërore (angl. Extended Nominal Phrase) përfshin edhe fjalët shërbyese (funksionale), prandaj për ta dalluar nga sintagma jo e zgjëruar, pa fjalë shërbyese (Nominal Phrase a NP) , në literaturë ajo njihet si Determiner Phrase a DP. P.sh. Në gjuhën shqipe: emri pa nyj] *libër* është NP, kurse emri me nyj] *libr-**i*** është DP.

[7] Shiko: Bernstein (2008), Longobardi (2008).

mbaresat vetore të foljeve të cilat shënojnë vetat në funksion të kryefjalës[8]. Shqipja e ka ruajtur një tipar të indoeuropianishtes[9], por meqë kemi të bëjmë me një kohë tepër të lashtë, kjo nuk na ndihmon të diktojmë lidhjen formale të këtyre mbaresave[10] me elementet e shqipes. Por, ngjashëm me Paul,[11] mund të supozojmë se pas mbaresave të tjera (të aspektit, të kohës apo të mënyrës) të kallëzuesit u shfaq përemri vetor: **shkue unë* (*gehen ich*), **shko ti* (*gehen du*) **shko ai* (*gehen er*), por njëkohësisht edhe formulat e tipit **shko babë (gehen Vater)*, **babë shko* (*Vater gehen*) apo **unë shko (ich gehen)* ishin të mundshme. Për të treguar se formulat FOLJE + VETOR ishin të mundshme, Paul merr shembullin e hungarishtes, gjuhë jo-indoeuropiane, e cila, për dallim nga vetat e tjera, në vetën e 3 privohet nga sufiksi. Te ky sufiks, sipas Paul, është ende e pranishme mënyra origjinale e lidhjes sipas formulës **shko baba* apo **baba shko*. Zhvillimi i mëtutjeshëm vazhdoi duke rimarrë kryefjalën, fillimisht vetëm për nevoja të emfazës, pra kur duhej gjithsesi të theksohej bartësi i veprimit, e pastaj filluan të përdoren rregullisht, kështu që formulat *Vater gehen* (**babë shko*) u zgjeruan dhe u zëvendësuan me *Vater gehen er* (**babë shko ai*). Një dukurie të tillë sidomos i shkon në favor reduktimi fonetik i vetorëve duke rezultuar në enklizë të vetorit. Paul e dëshmon këtë me ndihmën e shembujve nga dialektet e Bavarisë: *mir hammer* (= *wir haben wir*, shqip: *ne kemi ne*) ose *hammer mir*, *ess lebts* (*ihr lebt ihr*,shqip: *ju jeton ju*), me ç'rast vërejmë se te këto dialekte i tërë procesi është përsëritur, por për dallim nga gjuha indo-europiane, tek e cila enkliza u bë pas mbaresave të kohës, te dialektet bavariane enkliza bëhet në format e plota të foljes, duke e dyfishuar kështu tiparin e vetës (dhe numrit) te folja, por ky dyfishim, siç do të shohim më vonë, nuk është tërësisht pa funksion. Sidoqoftë, analiza e Paul-it na jep një ide se si ka rrjedhur procesi i enklizës së vetorit, i cili në parim duhej të kishte një rrjedhë të ngjashme edhe në gjuhën shqipe.

[8] Bokshi (2004): 16.

[9] Domi (2013): 90.

[10] Bokshi (2004): 17.

[11] Paul (1920), shih § 217.

2.1 Numri dhe veta

Kategoria morfologjike e numrit është gramatikalizim i kategorisë funksionale-semantike të numërimit[12]; përmes saj mund të kuptohet se a ka marrë pjesë në ngjarje një individ apo më shumë individë. Nëse themi:

(1) Nita paketon librat.

përmes 'vetorit të enklitizuar' tipari i numrit bartet tek folja, dhe ky numër na tregon se sa (pra, një ose më shumë) individë të quajtur *Nita* kanë marrë pjesë në ngjarjen e paketimit, e jo sa herë është kryer ngjarja e paketimit[13]. Pra, numri i shfaqur te folja në fakt është një numër emëror që 'dislokohet' te folja. Gjithashtu, në shembullin vijues:

(2) Yjet ndriçojnë.

kryefjala (*Yjet*) dhe kallëzuesi (*ndriçojnë*), shënojnë tiparin e numrit, por për secilin prej tyre ky tipar ka kuptim të ndryshëm. *Yjet* janë në shumës për arsye thjesht semantike dhe në rast se jepet nevoja për të kaluar në njëjës, kryefjala do të pasqyrojë edhe në këtë rast përzgjedhjen semantike. Mirëpo, shumësi i foljes *ndriçojnë* nuk është i motivuar për arsye semantike, sepse s'është e thënë se ekziston më shumë se vetëm një ngjarje e *ndriçimit*. Mund të konkludojmë: prania e numrit tek emri bëhet me motivim semantik, kurse prania e tij te folja bëhet me motivim sintaksor.

*(3) a) Sekretarja ime dhe bashkëpunëtorja jote **është** gati për t'u nisur.*
*b) Sekretarja ime dhe bashkëpunëtorja jote **janë** gati për tu nisur.*

Në shembullin (3) situata është pak më ndryshe. Në (3a) i njëjti person kryen dy profesione në të njëjtën kohë për dy individë të ndryshëm: folësin dhe dëgjuesin, prandaj numri (semantik) i kryefjalës është njëjës dhe rrjedhimisht folja këpujore ka formën e njëjësit. Ndërkaq, në (3b) për folësin dhe dëgjuesin janë të angazhuar dy veta, kështu që kryefjala është *de facto* në shumës, ani pse emrat: sekretarja dhe bashkëpunëtorja semantikisht janë (veç e veç apo ndaras) në njëjës. Për shkak të kontekstit, pra

[12] Buchholz/Fiedler (1987:244)

[13] Shiko më gjërësisht Corbett (2006:1)

thjesht për motive pragmatike, kryefjala është në shumës, pavarësisht se emrat në (3a) janë në njëjës, folja merr numrin e kryefjalës, prandaj këpuja ndërron formën nga *është* në *janë*. Thënë ndryshe, numri te kryefjala janë të pranishëm për motive pragmatiko-semantike, kurse prania te kallëzuesi është për motive sintaksore.

Kategoria gramatikore e vetës tradicionalisht[14] pasqyron bazën kognitive të tiparit të vetës që lidhet me strukturën themelore të aktit të të folurit, gjegjësisht tipari i vetës ngërthen gjithashtu çastin e relacionit ndërmjet aktit të të folurit dhe pjesëmarrësve të këtij akti: folësit, dëgjuesit dhe personit jo të pranishëm. Mirëpo, në rastin e tiparit të vetës, kundërvënia nuk është aq e thjeshtë si te tipari i numrit: [Njëjës] kundruall [Shumës], kjo kujtoj është arsyeja se përse në literaturë haset jo vetëm një propozim, por disa sosh, për të bërë dallimin e vetave. Këtu po paraqesim dy prej tyre.

I pari është në frymën e konceptit tradicional, që njihet si propozimi i të Benveniste-s[15]. Sipas këtij modeli, ndërmjet vetës 1./2. dhe vetës 3. ekziston një relacion asimetrik, nëse supozohet se dy vetat e para janë të shënuara me tiparet [+Participant][+/- Folës] apo [+Participant][+/-Dëgjues], kurse veta 3. ka tiparet [-Participant], [-Folës] dhe [-Dëgjues]. Në këtë mënyrë, nga njëra anë sigurohet përjashtimi i vetës 3. nga diskursi, kurse nga ana tjetër kundërvënia e dyfishtë ndërmjet vetave. E para: veta 1. dhe veta 2. dallohen nëpërmjet tiparit [+/-Folës] dhe e dyta: veta1. dhe veta 2. (secila ndaras) janë në kundërvënie me vetën 3. Rrjedhimisht, vendin më të spikatur në hierarkinë e vetave[16] e zë veta 1. (folësi), pas saj vjen veta 2. (dëgjuesi), dhe në fund vjen veta 3., e cila, për dallim nga dy të parat, është e përjashtuar nga diskursi.

[14] Benveniste (1971)

[15] Bokshi (2004) mbështetet gjithashtu në konceptin e Benveniste, shiko f. 9

[16] Lidhur me hiearkinë e vetave shih Plank (1985)

(4)



(5) Hierarkia e vetave sipas modelit tradicional: veta 1. > veta 2. > veta 3.

Hierarkia e vetave është parametër i rëndësishëm, sepse ajo reflekton bazën kognitive dhe, nëse vetat janë të konceptuara si u tha më lart, atëherë në bazë të parimit të ikonicitetit[17] do të duhej që paradigma e vetave të ndiqte këtë renditje: veta 1. e pamarkuar, veta e dytë e markuar dhe veta 3. më e markuara, gjegjësisht veta 3. duhej të kishte mbaresat vetore më të dallueshme në krahasim me dy të parat. Këtë e dëshmon dhe fakti se nëse një individ apo një send nuk është i pranishëm, kodifikimi i tij gjuhësor bëhet më parë me 'mund' se sa kodifikimi i një sendi të pranishëm, i cili mund të identifikohet thjesht me elemente deiktike. Krahaso: *motra jote e vogël* me *kjo* (*që po flet*/*këtu*) apo *tavolina e drurit* me *këtë/ atë* etj.

Një tjetër propozim është i Lyons-it[18]. Atë po e paraqesim grafikisht në (6):

[17] Marr nga semiotika,parimi i ikonicitetit bënë vlerësimin ndërmjet formës (shenjës apo ikonës) me sendin apo kuptimin e tij.

[18] Lyons (2001:261)

(6)



Në këtë propozim vërejmë gjithashtu se ekziston një relacion asimetrik i vetës 1. kundruall vetës 2. dhe vetës 3. Një gjë e tillë arrihet duke përfshirë tiparin [+/-UNË] apo [+/- EGO] (siç e shënon Lyons), ndërkaq opozicioni ndërmjet vetës 2. dhe vetës 3. arrihet duke përfshirë tiparin [+/- TI] përkatësisht [+/- TU]. Edhe me këtë propozim renditja hierarkike mbetet si te propozimi (5), por dallimet ndërmjet vetave janë ndryshe: përderisa te propozimi i parë dallimi ndërmjet vetës 1. dhe vetës 2. nuk është i spikatur, sepse të dyja janë pjesë e diskursit, Lyons kujton se pjesëmarrja në diskurs nuk e privilegjon dëgjuesin, prandaj ai konsideron se do bërë dallimi esencial ndërmjet vetvetes dhe të tjerëve. Rrjedhimisht, sipas këtij propozimi veta 1. duhej të ishte e pamarkuar, kurse veta 2. dhe veta 3. të markuara dhe të dallueshme ndërmjet tyre. Në gjuhën shqipe, përveç Bokshit, i cili mbështetet qartë në propozimin e Benveniste-it, të tjerët nuk janë konkretë rreth kësaj çështjeje. P. sh. Demiraj[19]: *Në gjuhën shqipe, ashtu si në gjuhët e tjera indo-evropiane, veta e parë dhe e dytë, si në njëjës edhe në shumës, përdoren për njerëz e në disa raste edhe kafshë e sende të personifikuara... Për sa i takon vetës së tretë, ajo përdoret si për njerëz ashtu edhe për kafshë, sende etj.* Por, meqë edhe Demiraj e veçon vetën 3. kujtoj se tërthorazi orientohet kah modeli tradicional.

[19] Demiraj (1986: 678)

3. Analiza e paradigmës

Paradigma e foljes në gjuhën shqipe përfshin 251 forma analitike e sintetike, prej tyre 49 janë forma sintetike[20]. Buchholz/ Fiedler[21] duke marrë për bazë formën e mbaresave në dëftoren e tashme dhe të raporteve të temës bazë, e grupojnë paradigmën foljore në gjashtë zgjedhime.

(7)

Zgjedhimi I		Sg.	Pl.	Zgjedhimi II		Sg.	Pl.
1	mëso	-j	-jmë	1	hap	-	-im
2		-n	-ni	2		-	-ni
3		-n	-jnë	3		-	-in
Zgjedhimi III		Sg.	Pl.	Zgjedhimi IV		Sg.	Pl.
1	dua	-	-më	1	ec	-i	-im
2		-	-ni	2		-ën	-ni
3		-	-në	3		- ën	-in

Zgjedhimi V		Sg.	Pl.	Zgjedhimi VI		Sg.	Pl.
1	thua	-m	-mi	1	vete	-	-mi
2		-	-ni	2		-	-ni
3		-të	-në	3		-	-në

Në tabelat në (7) janë paraqitur gjashtë zgjedhimet, por në formë të thjeshtuar[22], sepse kaq mjaftoë për analizën e shtruar këtu. Po të analizojmë mbaresat e numrit, duke krahasuar secilën tabelë horizontalisht, pra për secilën vetë njëjës (Sg.) kundruall vetës përkatëse në shumës (Pl.) nuk vërehet se ka forma homonime, prandaj mund të themi se numri te mbaresat foljore është qartë i dallueshëm ndërmjet njëjësit dhe shumësit. Ndryshe qëndron puna me vetën. Në shumës vetat janë të dallueshme në të gjitha zgjedhimet, mirëpo ato nuk mund të thuhet se pasqyrojnë bazën kognitive të vetës, së paku jo ashtu si është konceptuar nga Benveniste apo Lyons. Në njëjës asortimenti i mbaresave është i varfër: ato mungojnë fare në zgjedhimin II, III dhe VI. Kurse, te zgjedhimi I dhe IV mbaresat e vetës 2. dhe 3. janë homonime, ndërkaq vetëm zgjedhimi i pestë dallon vetën 1. dhe 2. Ndonëse e veçojnë vetën 1. nga 2. dhe 3. te zgjedhimi I dhe IV, as

[20] Memushaj (2012): 154.

[21] Memushaj (2012): 71-72.

[22] Nuk janë marr parasysh edhe nën-grupet e zgjedhimeve.

mbaresat e këtyre dy zgjedhimeve nuk pasqyrojnë modelin e Lyons-it (apo të Benveniste-it), sepse veta 2. dhe 3. janë homonime.

Pra, mund të konstatojmë: në gjuhën shqipe mbaresat e numrit janë të dallueshme, kurse mbaresat e vetës janë të dallueshme vetëm në shumës, kurse në njëjës ato janë të sinkretizuara dhe shpesh mungojnë fare.

(8) Paradigma foljore: NUMRI > VETA

Në (8) është paraqitur skematikisht konstatimi se mbaresat foljore për numrin në gjuhën shqipe kanë ruajtur funksionin e tyre fillestar, kurse për vetën mbaresat nuk sigurojnë një funksion të tillë të plotë. Gjithashtu, ato nuk pasqyrojnë bazën kognitive të vetës.

Të shohim tani se si qëndron puna me mbaresat e numrit dhe vetës në gjuhë të tjera, si p. sh. në gjuhën gjermane. Ngjashëm si gjuha shqipe, gjuha gjermane ka 3 vetë dhe numrin njëjës dhe shumës:

(9)

a)

Zgjedhimi		Sg.	Pl.
1	rief	-	-en
2		-st	-t
3		-	-en

b)

Zgjedhimi		Sg.	Pl.
1	leg	-e	-en
2		-st	-t
3		-t	-en

Vërejmë se edhe në gjuhën gjermane mbaresat e numrit janë të dallueshme, kurse mbaresat e vetës janë edhe më të eroduara. Ato nuk mund të dallohen qartë as në shumës e as në njëjës. Ato janë homonime për vetën 1. dhe 3. shumës në (9a) dhe (9b) si dhe për vetën 3. njëjës dhe vetën 2. shumës në (9b). As në gjuhën gjermane mbaresat nuk pasqyrojnë bazën kognitive të vetës. Gjithashtu, edhe për gjuhën gjermane mund të thuhet:

(10) Paradigma foljore: NUMRI > VETA

Siç duket numri është më i qëndrueshëm në krahasim me disa tipare

të tjera. Sipas Buchholz/ Fiedler[23] dhe Eisenberg[24] kështu ndodh edhe në paradigmën emërore: numri e dominon rasën. Prandaj, nëse do të kishim bërë një analizë të paradigmës emërore, ngjashëm siç u veprua me paradigmën e foljes, do të konstatonim:

(11) Paradigma emërore: NUMRI > RASA

Bazuar në Buchholz/ Fiedler dhe Eisenberg, kjo renditje vlen si për shqipen ashtu edhe për gjermanishten.

Renditja në (10) e (11), përveç që tregon funksionalitetin e mbaresave, lë të kuptohet edhe diçka që është e rëndësishme për të lidhur formën dhe kuptimin. Meqë mbaresat e foljes janë të përbashkëta për numrin dhe vetën[25], atëherë themi se paradigma mundet më mirë të kategorizohet nëpërmjet numrit se sa vetës. Thënë ndryshe, numri dominon ndaj vetës. Ngjashëm është edhe tek emri: numri dominon ndaj rasës. Por, mbaresat foljore dhe emërore kodifikojnë edhe tiparet e tjera. Kështu p. sh. mbaresat foljore kodifikojnë edhe aspektin, mënyrën dhe kohën etj. Në fakt, mbaresat janë morfema portmateau të cilat në vete ngërthejnë jo vetëm një morfemë. Avantazhi i tyre është se ato nuk lejojnë që fjala të zgjatet pa nevojë, mirëpo, në anën tjetër, ato jo rrallë pamundësojnë veçimin e morfemave të tipareve përkatëse. Pavarësisht nga këto vështirësi, Bybee,[26] duke analizuar paradigmat e 50 gjuhëve, konstaton se hierarkia e aftësisë kategorizuese të tipareve është si në (12):

(12) Paradigma universale foljore: GENUS VERBI > (ASPEKTI) > MËNYRA > KOHA > NUMRI > VETA[27]

---

[23] Buchholz (po aty) f. 268: Die Kategorien Numerus und Genus entscheiden wesentlich über d1e Zuordnung der Substantive .

[23] Eisenberg (2004:153)

[24] Bybee (1985: 34)

[25] Sipas Bybee (1985:42), vetëm morfemat fqinje mund të bashkohen.

[26] Eisenberg (2004: 205)

[27] Renditja e morfemave sipas Bybee pasqyron renditjen e fjalëve në një fazë më të hershme të gjuhës, shiko Bybee (1985:38)

Një analizë e tillë është bërë edhe për gjuhën gjermane[28]. Duke marrë parasysh të pesë kategorizimet e mundshme të paradigmës foljore, hierarkia në gjuhën gjermane është si vijon:

(13) Paradigma foljore gjermane: GENUS VERBI > MËNYRA > KOHA > NUMRI > VETA[29]

Në gjuhën shqipe një analizë e ngjashme mungon, mirëpo meqë në këtë punim jemi kufizuar në tiparin e numrit dhe vetës, po mjaftohemi me hierarkinë e dhënë në (8), në të cilën numri dominon vetën. Sipas Bybee[30], dominimi përveç pikëpamjes funksionale, ka edhe një domethënie tjetër. Nëse renditja e morfemave është nga rrënja e foljes në skajin e majtë e deri te fundi i mbaresës në skajin e djathtë, kjo do të thotë se jo të gjitha morfemat janë njëlloj të nënshtruara ndaj ndikimeve nga jashtë. Gjithashtu, morfemat e kategorive që kanë rëndësi më të madhe për foljen janë të pozicionuara më afër rrënjës së saj në krahasim me ato që janë më pak të rëndësishme. Ngjashëm është edhe tek emri. Si në shqip ashtu edhe në gjermanisht ai është gjithnjë ndërmjet rrënjës dhe rasës. Arsyeja e kësaj renditjeje, sipas Bybee[31], është se numri është më i rëndësishëm për emrin se sa rasa. Numri ka efekt të drejtpërdrejtë në entitet apo entitete të cilave emri u referohet. Nga ana tjetër, rasa nuk ka ndonjë efekt në referencën e emrit, ajo vetëm përcakton relacionin e atij entiteti me entitetet e tjera (në atë ngjarje). Të rikujtojmë, më herët konstatuam se numri nuk ndikon në kuptimin e foljes, ngase ai nuk tregon sa herë përsëritet një ngjarje. Në fakt, ai tregon se sa pjesëmarrës janë në ngjarje. Sigurisht se për ngjarjen (foljen) është më e rëndësishme se kur (KOHA), se ç'pikëpamje ka folësi rreth ngjarjes (MËNYRA), përfundon apo vazhdon të ndodhë (ASPEKTI) dhe ç'rol kanë pjesëmarrësit në atë ngjarje (GENUS VERBI/ VALENCA)[32].

Nga ajo që u shtrua deri më tani, në lidhje me hierarkinë e kategori-

---

[28] Po aty, f. 33-34

[28] Gjuha gjermane nuk ka aspekt

[29] Lidhur me këtë konstatim Bybee citon Greenberg

[30] Bybee (1985):34.

[31] Lidhur me këtë konstatim Bybee citon Greenberg

[32] Shiko Eisenberg (2004: 205), Nübling (2002: 92) dhe Hopper/ Traugott (2008: 152)

zimeve sipas tipareve të foljes për punimin tonë, i rëndësishëm është konstatimi se morfema e vetës është e pozicionuar në skajin e djathtë dhe se kontakti me jashtë është i drejtpërdrejtë. Kjo duhet të jetë edhe arsyeja e pranisë së sinkretizmave dhe paaftësia për të identifikuar nëpërmjet mbaresave të foljes të gjitha rastet e vetës. Mirëpo, në këtë pikëpamje shqipja në krahasim me gjermanishten qëndron shumë më mirë. Madje, ajo hyn në grupin e të ashtuquajturave gjuhë pro-drop, te të cilat kryefjala mund edhe të mungojë, meqë ajo është e nënkuptueshme nëpërmjet pranisë së vetës te folja. Kështu ndodh me gjuhët të cilat kanë eptim të pasur (p. sh. Latinishtja, spanjishtja, rusishtja etj.). Në anglishte ka ngelur vetëm mbaresa *-s* në vetën e tretë njëjës (*he, she, it likes*), kurse suedishtja i ka humbur të gjithat[33]. Për këtë arsye te këto gjuhë prania e kryefjalës është e domosdoshme. Gjermanishtja nuk është gjuhë pro-drop[34], sepse mbaresat nuk mjaftojnë. Siç duket tek gjermanishtja, megjithë praninë e disa mbaresave, gradualisht është humbur vetëdija e kuptimit të tyre[35], prandaj mbaresat paraqiten së bashku me kryefjalën edhe kur janë të dallueshme[36]. Por, në këto raste ato nuk mbeten fare pa funksion: ato ndihmojnë për të identifikuar kryefjalën kur duhet dalluar nga kundrina, por vetëm në rastet nëse kryefjala nuk është e shënuar nëpërmjet rasës, topikës, valencës së foljes apo intonacionit[37].

4. Lidhja kryefjalë-kallëzues: përshtatje apo reksion?

Për t'u përgjigjur në këtë pyetje padyshim se dallimi ndërmjet përshtatjes dhe drejtimit është i rëndësishëm, prandaj këtu po citoj Lyons-in (1968) në origjinal (përkthimi në fusnotë)

> *…the difference between concord and government lies in the fact that under concord two or more words or phrases are ' inflected ' for the same category (e.g. number or person), whereas under government the principal and the dependent member of a syntactic construction do not both exhibit the same*

---

[33] Nübling (po aty), f. 90

[34] Gjermanishtja e vjetër (Althochdeutsch, rreth vitit 800) ka qenë gjuhë pro-drop. Shih Nübling (po aty), f. 90

[35] Eisenberg (2004: 188)

[36] P. sh. ich geh**e**/du geh**st**/er geh**t**

[37] Eisenberg (1987: 113)

category: instead the dependent member is determined with respect to the relevant category (e.g. case) by the principal member[38]. (Lyons 1968: 241)

Dallimi ndërmjet lidhjeve nënrenditëse të përshtatjes dhe drejtimit të cilin e bën Lyons është në frymën tradicionaliste, ngjashëm e dallon edhe Gramatika e Akademisë[39]. Të marrim së pari rastin kur kryefjala është një përemër vetor (p.sh. *unë shkoj/ ti shkon/ ai shkon* etj.). Te paradigma e vetorëve, këto janë tiparet gramatikore të cilat veprojnë: veta, numri, gjinia dhe rasa. Nëse nuk e marrim parasysh dallimin në gjini për vetën e tretë njëjës (ai/ ajo) dhe vetën e tretë shumës (ata/ ato), sepse gjinia nuk shfaqet te folja, themi se në gjuhën shqipe paradigma e mundshme e vetorëve ka 30 forma, po kaq ka edhe paradigma e mbaresave të foljes e cila ndeshet me këtë kryefjalë. Te paradigma e emrit janë këto tipare gramatikore të cilat bëjnë përcaktimin e saj: gjinia, numri, rasa, trajta e shquar/ e pashquar. Nëse nuk e marrim parasysh gjininë, për arsyet që u cekën më lart, atëherë do të kemi gjithsejtë 20 forma të mundshme, të cila paraqiten edhe tek folja që ndeshet me këtë kryefjalë. Mirëpo përderisa numri te paradigma e mbaresave foljore ndërron në mënyrë të sinkronizuar sikurse forma e paradigmës emërore, te veta nuk ndodh një gjë e tillë: ajo vazhdimisht është në vetën e tretë (njëjës apo shumës). Arsyeja është se emri nuk eptohet në vetë sepse ai përfaqëson individin, sendin apo entitetin i cili as nuk është folësi e as dëgjuesi. Prandaj, kuptimisht emri e ka vetën e tretë, mirëpo nuk e shfaq. Është e qartë se 'imponimi' i vetës së tretë te folja bëhet për shkaqe semantike, mirëpo në pikëpamje (formale) sintaksore emri është ekuivalent me foljen apo parafjalën, sepse të dy këto kategori leksikore imponojnë rasën tek emri ani pse ato nuk e shfaqin formalisht atë. Në bazë të dallimit ndërmjet përshtatjes dhe drejtimit mbështetur te Lyons, del se kur kryefjala është emër, ndërmjet kësaj kryefjale dhe foljes që përket ajo, veta e foljes shfaqet për shkak të drejtimit. Shikuar nga pikëpamja e imponimit të tyre, mbase nuk është e rastit që veta e rasa në hierarkinë foljore përkatësisht emërore mbajnë pozicione të skajshme, të

[38] … dallimi ndërmjet përshtatjes dhe drejtimit mbështetet në faktin se te përshtatja dy ose më shumë fjalë apo sintagma flektohen për të njëjtën kategori (p. sh. Për vetën apo numrin), kurse te drejtimi gjymtyra kryesore dhe elementi i varur i konstruktit sintaksor nuk e shfaqin të njëjtën kategori, ani pse kategoria relevante (p. sh. rasa) te elementi i varur përcaktohet nga gjymtyra kryesore. (Përkthimi nga T. A.).

[39] Vëllimi II, f. 67

nënshtruara ndaj ndërrimeve ciklike. Këto ndërrime mund të jenë edhe shkaku kryesor pse parimi i ikonicitetit mungon te paradigma e vetës.

Teuta ABRASHI, Prishtina

CONNECTION SUBJECT-PREDICATE: AGREMENT, RECTION OR BOTH?

Summary

This article is about the grammatical category Person. Taking under scrutiny the syntagmatic relation between subject and predicate of the clause, it will be shown that this relationship is not performed as is traditionally claimed through agreement; instead in this syntactic operation government is active as well. Concretely, when the subject is a pronoun only agreement will be active, but when the subject is a noun, than only through agreement and government the syntagmatic relation should be completed. Based on the morphological analyses of verbal endings it will be also shown the similarity between case and grammatical person.

Literatura**:**

Benveniste, Emil (1971): Problems in general Linguistics, University of Miami Press.

Bernstein, Judy (2008): Reformulating the Determiner Phrase Analysis, *Language and Linguistics Compass* 2/6 (2008): 1246–1270.

Bokshi, Besim (2004): *Për vetorët e shqipes*, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës Prishtinë.

Buchholz/Fiedler (1987): *Albanische Grammatik*, Verlag Ezyklopädie, Leipzig.

Bybee, Joan (1985): *Morphology-A Study of the Relation between Meaning and Form*, Benjamins, Amsterdam.

Corbett, Greville (2006): *Agreement*, Cambridge University Press, Cambridge.

Demiraj, Shaban (1986): *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Universiteti i Tiranës, Tiranë.

Domi, Mahir (2013): *Vepra I-Studime sintaksore*, Tiranë.

Eisenberg, Peter (1987): *Grundriss der deutschen Grammatik*-Metzler, Stuttgart.

Eisenberg, Peter (2004): Das Wort-Grundiss der deutschen Grammatik, Band 1, Metzler, Stuttgart.

Grup autorësh (1996): *Gramatika e gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë-Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, Vëllimi I dhe II.

Hopper/Traugott (2008): *Grammaticalization*, Cambridge University Press, Cambridge.

Longobardi, Giuseppe (2008): Reference to individuals, person, and the variety of mapping parameters. *Essays on nominal determination*, ed. by Alex Klinge and Henrik Müller, 189–211. Amsterdam, The Netherlands: John Benjamins.

Lyons, John (1968): *Introduction to Theorietical Linguistics*, Cambridge University Press, Cambridge.

Lyons, John (2001): Hyrje në Gjuhësinë e Teorike, Dituria, Tiranë.

Memushaj, Rami (2012): Morfologji e eptimit të shqipes standard, INFBOTUES, Tiranë

Nübling, Damaris (2002): *Wörter beugen. Grundzüge der Flexionsmorphologie*, Në: Jürgen Dittmann, Claudia Schmidt: *Über Wörter*. Freiburg: Rombach Verlag, 2002, S. 87- 104.

Paul, Hermann (1920): *Prinzipien der Sprachgeschichte*, Max Niemayer Verlag, Tübingen, Projekt Gutenberg.

Plank, Frans (1985): Die Ordnung der Personen, Folia Linguistica, Vol. 19 (1-2), p. 111-176.

Zifonun, Gisela (1997): *Grammatik der deutschen Sprache*, Walter den Gruyter, Berlin.

Linditë SEJDIU-RUGOVA, Prishtinë

STRUKTURAT DETERMINATIVE TË SHQIPES – ANALIZË PRAGMATIKE E NYJES SË SHQUAR DHE ÇËSHTJE TË TERMINOLOGJISË SINTAKSORE NË SHQIPEN

KDU 811.18’367

Abstrakt

Fjalori krahasues i termave të gjuhësisë (Belluscio-Rrokaj, 2011), në çerdhen e fjalës përcaktor, krahas termit shqip, jep edhe termat krahaues italisht, frëngjisht dhe anglisht. Në anglisht thuhet: *determiner*, gjë që nuk korrespondon me termin *përcaktor* të përdorur në këtë Fjalor. E nxitur nga një këndvështrim i tillë, dua ta shtjelloj më tutje çështjen e elementeve determinative brenda sintagmës emërore, në mënyrë që të jepet një pasqyrë më e plotë rreth çështjes nëse mund të konsiderojmë se shqipja ka sintagmë determinative ose jo.

Ky studim mëton të jetë një shtjellim i koncepteve teorike të autorëve të ndryshëm lidhur me ekzistimin ose jo të sintagmave determinative, kryesisht duke u mbështetur në shembujt e nxjerrë nga anglishtja dhe nga shqipja.

Hyrje në konceptin e strukturës determinative brenda SE-së[1]

Në gjuhësinë shqiptare ende vazhdojnë të përdoren në të njëjtin kontekst (kuptim) termat: *caktuesor* (determiner) dhe *përcaktor* (modifier) ose të analizohen *caktuesori dhe përcaktori gabimisht si plotës (complement).*[2] Këto tri funksione bëjnë pjesë në të ashtuquajturit elementë të

[1] SE = sintagmë emërore (Noun phrase in Albanian)

[2] Në Grmatikën e Akademisë (1995), përcaktori konsiderohet gjymtyrë e dytë e fjalisë, në të njëjtin nivel me kryefjalën dhe kallëzuesin. Terminologjia e përdorur: caktuesor ose determiner, përcaktor ose modifier dhe plotës ose complement është terminologji e

varësisë në strukturën e sintagmës (dhe jo vetëm) meqë varen drejtpërsëdrejti nga koka apo bërthama e sintagmës. Por, nuk kemi të bëjmë me të njëjtin element funksional.

Edhe në Fjalorin më të ri krahasues të termave të gjuhësisë (Belluscio-Rrokaj, 2011), në çerdhen e fjalës përcaktor, krahas termit shqip janë dhënë edhe termat krahasues italisht, frëngjisht dhe anglisht. Në anglishte thuhet *determiner*, gjë që nuk korrespondon me termin *përcaktor*. Në një analizë të drejtpërdrejtë të shkallës së parë *determiner* (caktuesori) del të jetë një lloj i përcaktorit të sintagmës emërore, por me degëzim të mëtejmë strukturor në të ashtuquajturën sintagmë determinative ose në një element të thjeshtë determinativ. (Determiner dhe sintagmë determinative janë dy koncepte të ndryshme, gjithashtu)[3]. Ndryshe nga përcaktori i drejtpërdrejtë i kokës emërore, që mund të jetë edhe mbiemër (mbiemër që shpreh klasë: vetura *e kuqe*), sintagmë parafjalore (vetura *në fund të rrugës*) apo edhe ndonjë fjali e varur (vetura, *e cila ishte parkuar para shtëpisë*), caktuesori (determineri) e përcakton shquarësinë (nyja: *vajza**t***) dhe përkatësinë (gjinorja: vetura *e Agimit*, pronorët: vetura *e tij*) e kokës së SE[4], duke e specifikuar atë, duke e individualizuar atë, por nuk e shtjellon atë kokë më tej (nuk jep detaje përshkruese të mëtejme, siç bëjnë përcaktorët). Një shembull konkret i shpjegimit të funksionit të caktuesorit do të ishte përdorimi i numërorit *dy* në SE *dy vajza*, ku numërori *dy* do ta kishte funksionin e një caktuesori (determineri) të kokës *vajza* në të pashquarën shumës të emërores. Numërorët themelorë dhe rreshtorë në gramatikat e gjuhës angleze bëjnë pjesë në grupin e caktuesorëve fundorë ose të postdeterminerëve (Quirk, Greenbaum, Leech, Svartvik, etj.) derisa nyjet, gjinorja dhe dëftorët konsiderohen determinerë qendrorë (central determiners). Determinerët qendrorë e përjashtojnë njëri-tjetrin brenda një sintagmeje emërore, por në shqipen situata del pak më ndryshe. Dëftori *ky ose ai*

---

propozuar nga autorja, në mënyrë që t'i dallojmë këto tri koncepte bazike, por të ndryshme funksionalisht, brenda analizës sintaksore të sintagmës në një gjuhë.

[3] Termi determiner (caktuesor) është njësi funksionale e gramatikës, ndërkaq sintagmë determinative është njësi strukturore. Ky dallim i gjason raportit gramatikor kryefjalë / SE (sinagmë emërore).

zakonisht kombinohet me emrin në të pashquarën (*këto / ato vajza*), por jo rrallë del edhe në trajtë të shquar (ASHRSH, 1995: 231): *e këtij mikut, këto vajzat,* etj. Pra,emri në të shquarën nuk e përjashton dëftorin në të njëjtën sintagmë (***këto vajzat*** *këtu*). Për më tepër, në një sintagmë emërore të tipit: *pothuajse të gjitha vajzat (erdhën),* mund të kemi një situatë të përcaktimit (modifikimit) brenda sintagmës determinative *pothuajse të gjitha (pothuajse* e përcakton kokën determinative *të gjitha,* dhe të dyja bashkërisht e determinojnë kokën *vajzat* (*pothuajse të gjitha vajzat,* por *jo të gjitha vajzat*), bashkë me nyjen e prapavendosur vajza-t.

Pra, caktuesori (determineri), si funksion i brendshëm i sintagmës emërore, lidhet ngushtë me sintagmën emërore dhe e përcakton llojin e referencës që ajo sintagmë shpreh ose posedon. Në anglishten shpreh: shquarësinë (*these*), joshquarësinë (*a, an),* përgjithësimin (*all*) apo veçimin (*several, some*) (Pullum, 2002: 23-26). Në shqipen, disa koka të sintagmave emërore janë vetvetiu të shquara ose të vetëcaktuara, p.sh. kokat e shprehura me emra të përveçëm apo me përemra vetorë (*Agimi, Teuta, ata, ne*, etj.), dhe nuk kanë nevojë për caktuesorë. Por, në shumicën e rasteve, kur koka e sintagmës është një emër i përgjithshëm, caktuesori (qoftë ai nyjë e shquar apo nyjë e pashquar), si element funksional i sintagmës emërore, përdoret natyrshëm, por nuk është obligativ përdorimi i tij (varet nga koka dhe nga elementet e tjera përreth): p.sh. nuk mund ta mohojmë përdorimin e obligueshëm të numërorit *një* në fjalinë: P*ashë* ***një*** *veturë si im****ja****!*.

Përcaktorët (modifiers), ndërkaq, paraqesin një funksion me një gamë më të gjerë të përdorimit: çdo sintagmë, qoftë ajo emërore, foljore apo mbiemërore a parafjalore, përmban para dhe paspërcaktorë.[5] Parapërcaktorët i paraprijnë kokës dhe paspërcaktorët vijnë pas saj. Semantikisht, përcaktorët japin një informacion shtesë dhe përshkrues për kokën, shpeshherë duke e kufizuar referencën e caktuesorit të kokës (Quirk at al. 1985: 60-67). P.sh. në sintagmën *vajzat e panjohura që vinin nga punishtja,* mbiemri *e panjohura* del në funksion të paspërcaktorit të kokës tashmë

[5] Konceptet parapërcaktor dhe paspërcaktor i ka përdorur autorja e këtij punimi për herë të parë në vitin 2004 në punimin e saj të magjistraturës Fjalitë lidhore në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe - analizë kontrastive (dispensë e UP-së, korrik 2004).

të determinuar (të shquar) *vajzat*, paralelisht me fjalinë lidhore *që vinin nga punishtja*: e para si përcaktor i kokës (e cila mund të përdoret me mbiemrin e panjohura vetëm nëse është e shquar) dhe e dyta si plotës i saj.

P.sh. në sintagmën emërore *dy fanella të bardha*, numërori *dy* është caktuesor meqë i shquan *dy fanella* nga shumë të tjera ndërkaq mbiemri *të bardha* e kufizon më tej referencën e kokës *fanella* duke i veçuar të bardhat, jo fanellat me ngjyra të tjera. Disa gramatikanë tradicionalë të gjuhëve të huaja e barazonin përdorimin e përcaktorëve në sintagmë me përdorimin e rrethanorëve të foljes në fjali, gjë që është e diskutueshme.

Sa u përket plotësve (compliments), ata mund të dalin në strukturë të sintagmës (fjalitë e varura që e përcaktojnë një emër apo një mbiemër), por edhe brenda strukturës së fjalisë së thjeshtë (plotësit e foljes apo siç njihen në teorinë gjenerativiste edhe si argumente të foljes). Brenda strukturës së sintagmës plotësit e përmbyllin specifikimin e kuptimit. Pra, plotësit paraqiten aty ku kuptimi i kokës, bashkë me shquarësinë e saj, apo edhe i ndonjë elementi tjetër brenda sintagmës del 'i pamjaftueshëm për t'u kuptuar dhe kërkon një informacion shtesë që duhet të jepet në kuadër të atij konteksti të caktuar (Quirk at al., 2002: 60-67). Pra, koka e sintagmës e kontrollon (drejton) plotësin e saj ndonëse plotësit nuk janë domosdoshmërisht të lidhur me kokën e sintagmës (ashtu siç janë caktuesorët dhe përcaktorët). P.sh. brenda sintagmës emërore *gjuhë më e vështirë se anglishtja* në shembullin: *Gjermanishtja është gjuhë më e vështirë se anglishtja*, sintagma krahasore *se anglishtja* e plotëson më shumë kuptimin apo më mirë të themi është plotës i pjesëzës *më* dhe i përcaktorit *e vështirë*, por jo i kokës *gjuhë*. Një konstatim të tillë e mbështesim duke iu referuar papranueshmërisë së kësaj fjalie në mungesë të këtyre fjalëve funksionale: **Gjermanishtja është e vështirë se anglishtja.* (fjali e papranueshme gramatikisht).

Do të përpiqemi që nëpërmjet shembullit në vijim ta ilustrojmë në formë përmbledhëse dallimin ndërmjet caktuesorëve, përcaktorëve dhe plotësve të sintagmës emërore në shqipen:

(1) ...dhe pikërisht e kryera e thjeshtë është ***njajo shenjë vepruese përmes së cilës rrëfyesi e shpie shpërthimin e realitetit në një folje të ngushtë dhe***

***të pastër**,...(Barthes, 2008: 91, përkthyer nga R.Ismajli)*

Koka *shenjë* brenda sintagmës emërore ***njajo shenjë vepruese përmes së cilës rrëfyesi e shpie shpërthimin e realitetit në një folje të ngushtë dhe të pastër*** përmban caktuesorin *njajo*, përcaktorin *vepruese* dhe plotësin *përmes së cilës rrëfyesi e shpie shpërthimin e realitetit në një folje të ngushtë dhe të pastër*.[6]

Sintagma emërore kundruall sintagmës determinative (caktuesore) (SE vs SD)

Në gjuhësinë e sotme vazhdon debati rreth ekzistimit ose jo të sintagmave determinative në gjuhë të ndryshme, kryesisht duke u nisur nga struktura analitike e anglishtes. Elementet që sipas gjenerativistëve të sotëm[7] konsiderohen determinative, siç janë: nyja, dëftorët dhe gjinorja, në shqipen janë shtjelluar mjaft mirë nëpërmjet të studimeve të Besim Bokshit, Selman Rizës, Shaban Demirajt, etj. Megjithatë, studimi ynë do t'i kundrojë këto elemente nga rrafshi i gramatikës së sintagmës (ndarja në përbërës të drejtpërdrejtë) dhe i semantikës së diskursit (rolet e këtyre përbërësve brenda njësive gjuhësore më të mëdha).

Në teorinë leksiko-funksionale të Bresnanit (2001), vërehet dallimi ndërmjet nivelit strukturor dhe funskional të përfaqësimit gramatikor, pra ndërmjet koncepteve determinativ dhe determiner dhe njëkohësisht kundërshtohet kategorizimi i Bloomfield-it (1933), sipas të cilit koncepti determiner është një segment pozicional, apo i Quirk-ut at al. (1972) që e konsideron konceptin determiner (caktuesorin) si pjesë të ligjëratës. Kjo teori mund të kontrastohet edhe me pikëpamjet gjenerativiste të Lyons-it (1999), i cili e bën dallimin midis determiner (caktuesor) si klasë fjalësh

[6] Sipas gramatikanëve tradicionalë, të gjitha këto elemente janë përcaktorë të sintagmës emërore, por jo edhe sipas koncepteve më të reja sintaksore të vitit 2000 e këndej, të zbatuara në shqipen. Sintaksa gjenerative e bashkëautoreve Koleci / Turano, Sintaksa e gjuhës shqipe e Th. Dhimës dhe shumë studime të D. Kallullit, A. Kananajt, T. Abrashit, etj. e vështrojnë kryekëput nga aspekti gjenerativist.

[7] Teoricientët minimalistë

(pjesë e ligjëratës) dhe si element përfaqësues i shquarësisë (si kategori kryesisht semantike). Huddleston at al. (2002: 23) e përdor termin Determinative Phrase (Sintagmë determinative) duke iu referuar trajtave strukturore të anglishtes si: *almost every child, almost all students, not many people, too few volunteers,* etj., brenda sintagmës emërore, të cilat i konsideron kategori sintagmatike. Ai më tutje thekson se pozitën funksionale të caktuesorit (determinerit) në gjuhën angleze e zë kryesisht një determinativ ose një sintagmë determinative (Huddlestone, 2002: 330).Sipas tij, në një SE komplekse, caktuesorët marrin pozitën e një elementi të jashtëm në varësi nga koka, ndërkaq përcaktorët dhe plotësit e SE-së marrin pozitën e një elementi të brendshëm në varësi nga koka. Huddlestone (2002: 330) shpjegon më tutje se ka raste kur një determinativ herë merr funksionin e një determineri (caktuesori): *I found two mistakes*. e herë të një përcaktori (modifier) në rastet kur përdoret pas një caktuesori (*the): the two mistakes I made...* Por në shembujt e tipit: *not many girls, not many* analizohet si sintagmë determinative me funksion të një determineri (caktuesori) të kokës *girls*.

Rrjedhimisht, mund të themi se termi caktuesor (determiner) do të duhej të konsiderohej si term funksional, ngjashëm me përcaktorët dhe plotësit (modifiers & complements) që paraqitet brenda sintagmës emërore (SE). Një dallim i tillë determiner/determinativ vërehet më së miri nëse e analizojmë një sintagmë emërore të anglishtes, e cila në vete e ngërthen një sintagmë determinative në funksion të një determineri (caktuesori):

SE (NP) = {almost all students} = {SD (DP) (almost all) + koka (NH) (students)}

SD (DP) = {almost all} = {Adv (almost) + koka (DP) (all)}

Pra, Sintagma determinative (SD ose Determinative Phrase-DP) që përfaqësohet me funksion të një determineri (caktuesori) brenda sintagmës emërore *almost all students* do të zbërthehet më tutje në një përcaktor (modifier) *almost* (Adv), që klasifikohet si ndajfolje strukturalisht, dhe në kokën e sintagmës determinative (Determinative Head: DH) *all,* që në të vërtetë është një determinativ (D).

Rrjedhimisht, elementi determinativ *all* është kategori leksikore, dhe

si e tillë mund të zgjerohet në kategorinë sintagmatike të quajtur **Sintagmë determinative**: *almost all*. Ashtu siç do të mund të zgjerohej sintagma emërore *woman* në *pretty woman*.

Nëse duam ta theksojmë edhe më shumë këtë dallim në rrafsh të strukturës dhe të funksionit sintaksor, do t'i analizojmë shembujt e sintagmave emërore:

a) *a house* dhe
b) my daughter's house.

Në shembullin a) elementi determinativ *a* (nyja e pashquar) funksionalisht përfaqësohet si caktuesor (NP determiner), ndërkaq në shembullin b) *my daughter's* është një sintagmë emërore gjenitivale që del në funksion të një përcaktori të kokës *house* dhe e cila në vete ngërthen kokën emërore në gjinore (*daugther's*) dhe elementin determinativ *my* në funksion të një caktuesori të kokës *daughter's*.

a) NP (SE) b) NP (SE)

Det (caktuesor) + H (kokë); M (percaktor) + H (kokë)

D (element determinativ) + N (emër); NP(gjinore+emër)+N(emër)

Det (caktuesor) + H (kokë); D (element determinativ) + N (emër)

Por, si është puna me caktuesorët e shqipes? A ka shqipja struktura të tilla që do të mund të merrnin funksionin e një caktuesori brenda sintagmës emërore?

Në gjuhën shqipe caktuesorët do të mund të analizoheshin ngjashëm me anglishten strukturalisht por problemi i shquarësisë dhe joshquarësisë del më kompleks për shkak të prapavendosjes së nyjës në vetë trupin e emrit të shquar: *<u>një</u> djalë* kundruall *djal<u>i</u>*.

Nëse strukturat e tipit: *të gjithë/a, çdo, krejt, secili/secila, disa/ ca, një, ky, kjo, ai/ ajo, ata/ ato, këta/ këto, ime, yt, tona, juaj*, etj. do t'i konsideronim struktura determinative në shqipen, duke u mbështetur gjithnjë në kategorizimin që u bëhet këtyre njësive gramatikore edhe në gjuhët e tjera, atëherë i bie që pozita e caktuesorit (determiner) në gjuhën shqipe të ndryshojë për shkak të topikës relativisht të lirë të saj dhe duke qenë pjesë e

trupit të fjalës, struktura determinative bëhet komponentë përcaktuese e vetë kokës (e detyron kokën leksikore të analizohet si kokë determinative). Kështu, sintagmat emërore:

a) *bija ime dhe*
b) *ime bijë*

në strukturë sipërfaqësore do të mund të analizoheshin që të dyja si sintagma emërore me kokën *bijë*, por sa i përket zbërthimit të drejtpërdrejtë të elementeve sintaksore brenda tyre, procesi i analizës do të ishte i ndryshëm. Koka e së parës (a) konkretizohet nga pronori *ime, ndërkaq determinativi –a* në trup të fjalës e shquan, e veçon emrin *bijë*. Pra, në terma të gjenerativistëve, mund të flasim për një SD. *Në shembullin (b)* ka një element determinativ (D): *ime* me funksionin e caktuesorit të vetëm brenda sintagmës emërore *ime bijë*.

Nëse i krahasojmë sintagmat emërore a) *bija ime* dhe c) *ime bijë*, del se në të dy shembujt, elementi determinativ *ime* del drejtpërsëdrejti në funksion të një caktuesori (determiner), ndonëse te njëra para kokës e te tjetra pas kokës, ndërkaq në shembulin nën a) caktuesori shprehet me caktuesor edhe në trup të fjalës. Pra, në shembullin nën a) nuk mund të themi se kemi të bëjmë me një strukturë të thjeshtë sintagmatike (kokë e sintagmës emërore), por kemi të bëjmë me një sintagmë emërore të përbërë nga emri *vajzë* dhe elementi determinativ i shquarësisë - *a*.

Koleci, Turano (2011: 64) e shpjegojnë një proces të tillë nëpërmjet të teorisë së Abney-t (1987)[8], sipas së cilës, në rastet kur skema e sintagmës emërore nuk mund t'i përgjigjet të gjitha rasteve që mund t'i realizojnë elementet determinative, atëherë koka emërore të zërë vendin e një komplimenti të sintagmës determinative, e cila në të vërtetë është jo më pak se një sintagmë emërore në projeksionin e saj maksimal. Kjo e tëra nga një këndvështrim gjenerativist i bashkëautoreve të Sintaksës së parë gjenerative të shqipes (Koleci/ Turano, 2011).

[8] Teoria e Abney-it përdoret si term në studimet gjuhësore gjenerativiste (shih: Leffel & Bouchard, 1991: Views on Phrase Structure (Studies in Natural Language and Lingusitic Theory), KAPG, The Netherlands;

Një shpjegim i tillë, që sipas Turanos mbështetet në të dhënat e nxjerra nga anglishtja, pa marrë parasysh teknikalitetin që e ka, do të mund të merrej parasysh edhe gjatë analizës së kokës *bija*, ku elementi determinativ i shquarësisë *–a* do të mund të përcaktohej si kokë e sintagmës determinative *bija*. Por, si do të mund të shpjegohej më pas fakti që sintagmat duhet të përkojnë me kokat e tyre dhe nëse sintagma *ime bijë* ka për kokë një sintagmë determinative, atëherë a ka sens ta quajmë emërore më?!

Turano (2011:67) e shtjellon më tutje këtë devijim nga rregulli tradicional sipas së cilit koka e SE-së duhet të jetë patjetër emër, duke u mbështetur, sipas saj, në Longobardin (1992) dhe duke e arsyetuar ngritjen e emrit në pozitë të determinantit (elementit determinativ)[9] për shkak të tiparit të përbashkët që e bashkëndajnë këto dy kategori: referencialitetit. Turano (2011: 67) propozon që edhe në rastet kur emri del i pashoqëruar me nyjë (*lexoj gazeta, ha domate*, etj.), prapëseprapë projektohet një sintagmë determinative me element determinativ zero (0). Koleci / Turano më tutje e ndajnë sintagmën determinative nga sintagma kuantifikatore më pas, duke e emërtuar këtë të fundit si SQ.

Abrashi (2012: 239), në studimin e saj për nyjën e prapavendosur në gjuhët ballkanike, me theks të veçantë në shqipen, në përmbledhjen e punimeve të prezantuara në një konferencë të AShAK-ut, dukurinë e përcaktimit të statusit të nyjës së shqipes e shtjellon si afiks, jo si klitik, duke u mbështetur në kriteret e përgjithshme të Zwicky-it dhe të Pullum-it. Abrashi diskuton për karakterin dual të nyjës (sipas Alexiadou-t, 2007:51) në gjuhën shqipe, duke e konsideruar nyjën e shqipes me funksion pragmatik (individualizimi) dhe me funksion semantik (e shquar/ jo e shquar). Sipas Abrashit (2012: 264), mbështetur tek Alexiadou (2007: 51), nyjën e shquar të shqipes duhet ta kundrojmë në domenin e funksionit pragmatik: si referencialitet apo deiktik dhe në domenin e funksionit semantik: e shquar / jo e shquar.

---

[9] Longobardi pohon se në gjuhët në, të cilat emri i përveçëm nuk pajiset me nyjë, si p.sh. në italishten standarde, emri i përveçëm zhvendoset në pozicionin e kokës se DP, gjegjësisht të nyjës, për ta marrë nëpërmjet nyjes së shquar në atë pozicion, tiparin e referencialitetit.

Një shpjegim i tillë nga aspekti i analizës së diskursit funksional apo i pragmatikës do të ndihmonte në përcaktimin e saktë të strukturave tjera me funksion të një caktuesori (determineri) në shqipen, e që janë joeptimore (jashtë trupit të emrit), siç janë nyja e pashquar si sintagmë determinative në vete apo edhe çështja e përemrave pronorë dhe e gjinores në fuksion të një caktuesori (determineri).

Ta shtjellojmë më tutje problemin e nyjës në trup të fjalës nga aspekti pragmatik (e ashtuquajtura nyja D sipas Alexiadou-t): Nëse e përdorim sintagmën emërore *vajza ime* në një kontekst të caktuar: *Ajo bukuroshja atje është vajza ime*., atëherë paragjykimi apo presupozimi që folësi ka për këtë akt të të folurit është se vajza e tij ekziston, se ai ka *një vajzë*, por mund të ketë edhe më shumë se një vajzë. Implikimi që përftohet nga kjo fjali është se marrësi nuk e njeh vajzën e tij, qoftë ajo e vetmja apo një nga vajzat, por pasoja themelore e një segmenti të tillë, mbështetur në tiparin referencial dhe deiktik të së shquarës, është se që të dy (folësi dhe marrësi) e ndajnë të njëtin kontekst shoqëror dhe lokativ me objektin për të cilin po flasin (*vajzën*). Ata (bashkëbiseduesit) po e shohin vajzën me sy, vajza e folësit është prezente, pa marrë parasysh largësinë fizike nga bashkëbiseduesit. Në raste të tilla përdorimi i deiktikëve (i nyjës së shquar dhe i dëftorit) del i natyrshëm. Një implikim tjetër që kjo fjali mund të ketë te marrësi është se folësi ka dashur t'ia bëjë me dije marrësit që vajzën e ka të bukur, dhe një interpretim i tillë pragmatik e lejon edhe mundësinë e analizës së sintagmës *vajza ime* si një nga vajzat e tij, jo e vetmja që ka ai. Pra, në të gjitha rastet e interpretimit kemi të bëjmë me vajzën, me rrënjën e një emri, apo me një kategori leksikore që shpreh një qenie të gjallë apo një organizëm biologjik (Huddleston, 2002: 32). Rrjedhimisht, a do të mund ta shpjegojë termi sintagmë determinative tërë këtë kombinim funksionesh dhe domenesh që ngërthen nyja e shquar e shqipes në mënyrë që sintagma emërore *vajza ime* të konsiderohet sintagmë determinative dhe njëkohësisht njësi e mëvetësishme gjuhësore – një degëzim i veçantë brenda strukturës së sintagmës, qoftë ajo emërore apo determinative (kokë ose caktuesor)?! Unë mendoj se po, me kusht që paraprakisht ta shpjegojmë këtë kompleksitet funksionesh, nëpërmejt analizës së diskursit: mundësinë që ka nyja e shqipes, qoftë e caktuar apo e pacaktuar, që të përdoret si

shprehje vetëm pragmatike (*vajz**a***), vetëm morfo-sintaksore (**e** vajzës) apo si strukturë metaforike (*mbush mendj**en)***. Riza, gjatë shtjellimit të gjerë që ia bën klasifikimit semantik të nyjes së caktuar dhe të pacaktuar të shqipes, konstruktet e tipit (*mbush mendjen, është nevoja),(Riza, 2002: 208),* i arsyeton si struktura në funksion herë stilistikor e herë idiomatik.

Në vend të përfundimit

Në gjuhët me tendencë analitike siç është anglishtja, e cila dita-ditës po i humb tiparet e saj të pakta flektive dhe po shndërrohet dalngadalë në një gjuhë plotësisht analitike, dukuria e gramatikalizimit të nyjës duket më e lehtë për t'u shtjelluar me terma gjenerativistë të gjenerimit të strukturave, por në gjuhët më flektive edhe se vetë shqipja, dukuritë e tilla të ngjashme nuk do të mjaftoheshin me shpjegime që i përshtaten modeleve dhe kornizave të gjuhëve tjera. Prandaj, nyja e shqipes do të analizohet si sintagmë determinative më vete edhe brenda trupit të fjalës që leksikalisht është emër ose mbiemër, që ka lidhje me diskursin dhe nuk është e detyruar të shprehë vetëm një eptim të thjeshtë apo kundërvënie e shquar / e pashquar. Huddleston me të drejtë thekson se një element nominal bashkë me një strukturë determinative përbëjnë prapëseprapë një sintagmë nominale (emërore) (Huddleston/ Pullum, 2002: 22), duke marrë parasysh faktin që koncepti nominal është pakëz më i gjerë së termi emër (noun). Një pohim i tillë na çon drejt një përfundimi tjetër: sintagma determinative bashkë me sintagmën emërore dhe mbiemërore do të mund të shtjelloheshin dhe krahasosheshin brenda konceptit të një sintagmeje nominale. Sidomos në gjuhët si shqipja, ku fleksioni paraqet kategori semantike dhe gramatikore me përfaqësim multistrukturor.

Linditë Sejdiu-Rugova, Prishtina

DETERMINATIVE STRUCTURES IN ALBANIAN – PRAGMATIC-ORIENTED ANALYSIS OF THE DEFINITE ARTICLE IN ALBANIAN AND SYNTACTIC TERMINOLOGY

Albanian Grammars (ASHRSH, Çeliku, Domi, Jashari/ Çitaku, etc.)tend to misuse the noun phrase syntactic concepts: determiner, modifier and complement, by not making the clear distinction between them. The Comparative Dictionary of Linguistic Terminology (Belluscio/Rrokaj, 2011) under the lexical entry përcaktor (modifier), gives the English translation determiners, by considering determiners përcaktorë, too.

The three Noun-Phrase functional dependencies: determiners, modifiers and complements are considered to be phrasal categories, or subtypes of the dependent according to their more specific relation to head (Huddleston, 2002: 24). At the first level of subdivision, The Cambridge Grammar of the English Language distinguishes between complements, modifiers and determiners. One needs distinguishing here the difference between Object as a complement (on a clause level) and Head Complement on the Phrase level. The modifier is common and general to all phrases (it modifies the head), whereas the determiner function is found only in the structure of the NP, The following example in Albanian illustrates the three above-mentioned functions:

(1)...dhe pikërisht e kryera e thjeshtë është ***njajo shenjë vepruese përmes së cilës rrëfyesi e shpie shpërthimin e realitetit në një folje të ngushtë dhe të pastër****,...(Barthes, 2008: 91, përkthyer nga R.Ismajli)*

The NP: ***njajo shenjë vepruese përmes së cilës rrëfyesi e shpie shpërthimin e realitetit në një folje të ngushtë dhe të pastër*** , consists of the*:* determiner: *njajo*, modifier: *vepruese* and complement: *përmes së cilës rrëfyesi e shpie shpërthimin e realitetit në një folje të ngushtë dhe të pastër*.

The functional concept determiner and structural concept determinative (*the*), or the lexical category class: Determinative Phrase (DP: *almost every*), need distinguish for the same reason we distinguish subject from NP (Huddleston, 2002: 25). Huddleston suggests that *this* functions as determiner in a NP *this height*, and as a modifier of an AdjP in *She is (about this tall).* Or, let us compare another example of determinatives used in two different functions within a NP: *a* in the NP *a house* as a determiner and *my* in the NP: *my daughter's*, within another NP *my daughter's house*, functioning as a modifier of the NP (*my daughter's*), being a modifier itself to the head *house.*

The situation in Albanian seems to be more complex due to the morpho-syntactic grammaticality of definitness/indefinitness, in singular and plural and in different case paradigms, within the noun, adjectival and pronominal declination. In Albanian, the definite article is attached to the lexical category, as a post-positioned ending. Abrashi (2012:239) treats it as an affix (not clitic) in terms of Zwicky and Pullum's criteria (1983), whereas the indefinite one is used analytically and precedes the lexical category: (e.g. in Nom. case: Ind. vajzë, def. vajza, ind. vajza (pl.), def. vajzat (pl.)).

Based on generative approach, Turano and Koleci (2011: 66) treat definitness (when affixed to the word) in such a way that they move the noun from the base position (N zero) into the (D zero position), where the determinative element has been generated in order to get attached to it: a noun head, driven to the upper right position of the DP, due to the affixed definitness, makes the affix D'*(–a*) the head of the DP.

DPs analysis in Albanian, mainly by Albanian generativists (Kallulli, Abrashi, Kananaj, etc.) suport the fact of DP existence and usage in Albanian syntax (regardless the fact that most of the students' university textbooks ignore them as being such. Most of the textbooks and individual studies speak of semantic definitness or determinacy but not of Determinative Phrase category!).

In terms of pragmatic perspective, the definitness could be considered in terms of deictic reference and individualisation, not merely being conditioned by its position. Moreover, structural elements, other than affixed ones, such as indefinite article, genitive and pronouns, could be treated from the functional discourse perspective, too.

Generativism does not seem to give a supportive and satisfactory account of DPs in Albanian, without a combined pragmatic analysis. Albanian could not fit the rules and explanations of patterns introduced from other analytical languages, such as English. The definite article should be analysed as a DP, discourse driven, expressing and implying more than what is said, not merely positioned as an inflected singular branching within the NP or DP tree diagram analysis, An integrated syntactic and pragmatic approach should be considered, particularly when speaking of Albanian inflection, which represents a semantic and grammatical multistructural category. An example of pragmatic analysis of the NP *vajza ime* in Albanian illustrates it in the best way possible.

Bibliografia

ASHRSH, Instituti i gjuhësisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I (Morfologjia)*, Tiranë, 1995

ASHRSH, Instituti i gjuhësisë, *Gramatika e gjuhës shqipe II (Sintaksa)*, Tiranë, 1997

Abrashi, T. 2012. *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit.* Prishtinë: AShAK

Alexiadou, A., L. Haegemman and M. Stavrou (2007). *Noun Phrase in Generative Perspective*. Berlin & New York: De Gruyter.

Alerton D. J., Carney E., Holdcroft D. (eds), (1979). *Function and Context in linguistic analysis*, London: Cambridge University Press.

Bloomfield, L. 1933. *Language*. New York: Holt & Co.

Bresnan, J. 2001. *Lexical-Functional Syntax.* Oxford: Blackwell.

Carnie, A. 2006. *Syntax (A Generative Introduction).* Oxford: Blackwell Publishing

Lyons, C. 1999. *Definiteness*. Cambridge: Cambridge University Press.

Bach, E. (1974). *Syntactic Theory*, New York: Holt, Rinehart and Winston,

Beci, B., (2001). *Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë*, Prishtinë: Enti i teksteve.

Belluscio, G. & Rrokaj, Sh. (2011). Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë. Tiranë.

Dhima, Th., *Gjuha shqipe – Sintaksa*, SHBLU, Tiranë, 2005.

Buchholz, O. & Fiedler, W. (1987). *Albanische Grammatik*. Leipzig.

Demiraj, Sh. (1971). *Gramatika e gjuhës shqipe – fonetika dhe morfologjia*, Prishtinë.

Dykro, O.& Todorov, C. (1984). *Fjalor enciklopedik i shkencave të ligjërimit*, Prishtinë.

Ismajli, R., (1980). *Shumësia e tekstit*. Prishtinë: Rilindja.

MacLaughlin D. (1997). The Structure of Determinative Phrase (retrieved from ftp://louis-xiv.bu.edu/pub/asl/disserts/MacL97.pdf

Payne, J.R. & R.Huddleston (2002). *Nouns and noun phrases. The Cambridge Grammar of the English Language.* Cambridge: Cambridge University Press.

Huddleston R. , G.K. Pullum at al. (2002). *The Cambridge Grammar of the English Language.* Cambridge: Cambridge University Press.

Quirk, R., S.Greenbaum, G.Leech & J.Svartvik (1972). *A Grammar of Contemporary English.* London: Longman.

Quirk, R., S.Greenbaum at al. (1985). *A Comprehensive Grammar of the English Language*. London & New York: Longman.

Koleci, F. & G. Turano. (2011). *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*. Tiranë. SHBLU.

Prfti, S.(1971). *Sintaksa e gjuhës shqipe,* Prishtinë: Enti i teksteve dhe i mjeteve i KSAK

Riza, S. (2002). Vepra 3, Prishtinë: AShAK

Zwicki, A & G. Pullum (1983). *Clitization vs. Inflection: English n't. Language* 59, 502-513. (retrieved from http://web.stanford.edu/~zwicky/ZPCliticsInfl.pdf)

Mehmet HALIMI, Prishtinë

KONTRIBUTI I AKADEMIK IDRIZ AJETIT NË FUSHËN E STUDIMEVE DIALEKTOLOGJIKE

KDU 811.18'282.3

Abstrakt

Shtegun e studimeve dialektologjike ndër ne, në Kosovë, nga dialektologë shqiptarë e hapi studiuesi akademik Idriz Ajeti, duke i studiuar dhe duke i parë të folmen shqipe në dy rrafshe: në rrafshin *diakronik* dhe në rrafshin *sinkronik.* Ai në studimet e veta zbatoi tri metoda shkencore: *metodën e studimit diakronik,* ku lënda gjuhësore u muar nga dokumentet e shkruara; *Metodën e studimit sinkronik* ku lënda gjuhësore u eksplorua nga terreni (shih studimin: Rreth disa veçorive të të folmeve të shqiptarëve të Preshevës dhe Bujanocit) dhe *metodën krahasimtare evolutive* (shih: *Zhvillimi historik i së folmes gege të arbëneshve të Zarës*), i cili paraqet studimin më të plotë të prof. Idriz Ajetit duke përfaqësuar kontributin e tij më të madh në fushën e studimeve dialektologjike, ku autori shqyrton e qorton në mënyrë kritike e objektive konstatimet e gabuara të studiuesëve të huaj të kësaj të folmeje (Gustav Weigand, Carlo Tagliavini etj.). Autori me sukes arrin të japë një sintezë të kësaj të folmeje në fizionominë e saj diakronike e sinkronike nëpërmjet metodës krahasimtare.

Pa gjuhë të pasur e të pastër, s'ka as ide e mendime të larta, I. Ajeti

Studimet dialektologjike në Kosovë, në veçanti, dhe në trojet shqiptare në përgjithësi, janë relativisht të vona. Ato mezi kapin një shekull, duke u nisur në fillim të shekullit XX. Studimet e para dialektologjike të dialekteve e të folmeve shqipe fillojnë nga albanologë e studiues të huaj, siç janë: Georg von Hahn (l854) dhe L. Kujundžić, S. Mladenov, P. Skok, C. Tagliavini, M. Lambertz, N. Jokl e G. Elezović dhe A. Urošević. Megjithë të metat e mangësitë e tyre, ato hapin shtegun e studimeve dialektologjike në Kosovë, në veçanti e në mbarë trojet shqiptare, në përgjithësi.

Ndërkaq, studimet dialektologjike të studiuesve shqiptarë zënë fill

që nga vitet e pesëdhjeta të shekullit të kaluar, pra të shekullit XX, të cilat na dalin në frymë polemikash me studiuesit e huaj dhe në formë skicash dialektologjike, të cilat paraqesin bazë të mirë për studimet monografike që do të pasojnë, fillimisht në gjysmën e dytë, e intensivisht, në çerekun e tretë të shekullit XX[1] edhe me studime monografike.

Shtegun e studimeve dialektologjike ndër ne në Kosovë nga dialektologë shqiptarë e hapi akademik Idriz Ajeti, duke i studiuar dhe duke i parë të folmet shqipe në dy rrafshe:në rrafshin diakronik dhe në rrafshin sinkronik. Ai në studimet e veta dialektologjike në e parë, zbatoi metodën diakronike, të cilën e ndoqën edhe studiues të tjerë të të folmeve shqipe.[2] Prandaj, mund të themi se hullia e parë e studimeve gjuhësore, në përgjithësi dhe e studimeve dialektologjike, në veçanti, filloi me prijatarin Idriz Ajetin, nga i cili u rrahën e u trajtuan, u shestuan e u ndriçuan shumë çështje gjuhësore. Duke zgjeruar e thelluar kështu gjithnjë fushën e studimeve shkencore albanologjike në përgjithësi, akademik Idriz Ajeti shënoi rezultate të dalluara në fushën e studimeve dialektologjike, në veçanti.

Merret vesh se puna dhe merita më e madhe në fushën e studimeve dialektologjike i takon Profesor Idriz Ajetit studimet e të cilit shquhen për metodologji e kriter të rreptë shkencor dhe u bënë shembull i punës shkencore edhe për studiues të rinj të kësaj disipline shkencore.

Lëndën studimore në fushën e studimeve dialektologjike, akademik Idriz Ajeti e mori (e nxori), dhe e eksploroi nga dy gurra burimore:

l. Duke u mbështetur në lëndën gjuhësore të nxjerr nga dokumentet e shkruara nga autorë të ndryshëm dhe

2. Duke vjelë lëndë dialektologjike nga të folme dialektore ekzistuese në terren.

Prof. Idriz Ajeti shquhet për një metodologji të veçantë shkencore e origjinale, duke u dalluar nga studiues të tjerë. Ai në studimet e veta dialektologjike zbatoi tri metoda shkencore*: Metodën e studimit diakronik,*

---

[1] Halimi, Mehmet: Perspektiva e kërkimeve dhe studimeve dialektologjike në Kosovë, në bot. 50 vjet studimealbanologjike, Prishtinë 2004, f. l07-ll0.

[2] Halimi, M.: Vepër e spikatur dialektologjike, Vështrime gjuhësore, Prishtinë I993, f. l40.

Metodën e studimit sinkronik dhe metodën krahasimtare, ku ndërlidhi metodën sinkronike me atë diakronike, arriti me sukses të zgjidh shumë çështje e dukuri gjuhësore të një të folmeje gjatë zhvillimit të saj historik dhe ndryshimeve që ka pësuar ajo deri në ditët e sotme, duke hetuar kështu edhe prirjet zhvillimore të saj në perspektivë.

Për llojet e natyrën e këtyre studimeve dialektologjike do të bëjmë fjalë veç e veç në studimin tonë.

l. Studimet dialektologjike, ku lënda gjuhësore u mor nga dokumentet e shkruara dhe ku u zbatua metoda shkencore e diakronisë.

Këtu bënë pjesë studimi monografik me titull: Pamje historike E ligjërimit shqip të Gjakovës në fillim të shekullit XIX.

Prof. Idriz Ajeti, duke marrë në shqyrtim hulumtimin e dokumenteve të vjetra gjuhësore të shkruara me alfabet arab, turk apo ndonjë tjetër, ndriçoi veçori e tipare të të folmeve të trevave të ndryshme të Kosovës të para nga aspekti i tyre diakronik. I kësaj natyre është edhe studimi monografik në fjalë, duke pasë për objekt studimi veprën me përmbajtje fetare *Vehbije* të Tahir Efendi Boshnjakut, më l835, ndërsa botuar në Stamboll me alfabet arab.

Sado që lënda shkrimore nga një intelektual fetar, nuk mund të jetë autentike me të folmen e atëhershme të gjakovarishtes, sepse autori i veprës në fjalë, ishte shkolluar në gjuhë të huaja, ndaj edhe ndikimet nga këto gjuhë janë të dukshme. Për këtë është i vetëdijshëm edhe autori kur thotë: …mbi ligjërimet shqiptare të kësaj treve: njëherë, sepse na mungojnë pothuajse kryekëput të dhëna dialektore të shkoqura, që do të na jepnin krah e dorë për të bërë një vëzhgim të mirë rreth të folmeve në truallin e Kosovës. Edhe më parë, kushdo që kishte marrë të hetonte ndonjë prej ligjërimeve të këtyre viseve, për mungesë materiali të saktë gjuhësor, pak gjë ka nxjerr në dritë[3].

Mirëpo, megjithatë duke analizuar e studiuar në mënyrë të shte-

[3] Ajeti, I.: Pamje historike e ligjërimit shqip të Gjakovës në fillim të shekullit XIX, Vepra, Prishtinë 1998, f. 9-61.

rrueshme këtë vepër si *Dokumentin më të vjetër të shqipes së Kosovës të shkruar me alfabetin arabo-turk,* Idriz Ajeti merr në shqyrtim sistemin vokalik të së folmes së Gjakovës, vokalin neutral *ë,* hundorëzimin e vokaleve në tekstin e *Vehbijes,* labialin ea = o, diftongjet e grupet e zanoreve, sistemin konsonantik, duke përfshirë këtu edhe togjet bashkëtingëllore, foljet dhe përdorimin e kohëve, merr në shqyrtim edhe turcizmat, dhe në përqasje shpesh edhe me trajtat e sotme, sjell edhe tekste nga kjo vepër dhe vërtetë arrin të na japë një pamje historike të ligjërimit të së folmes së Gjakovës nga aspekti i saj diakronik.

I kësaj natyre është edhe *Gjuha e Divanit të Sheh Maliqit.* Ky studim për herë të parë pa dritën në revistën *Gjurmime albanologjike*[4]. *U botua edhe në përmbledhje të tjera gjuhësore. Tani bënë pjesë në vëllimin Vepra 2,* botim i AShAK-ut[5]. Në këtë studim monografik autori vë në spikamë një varg tiparesh fonetike e morfologjike të së folmes shqipe të Rahovecit në mbarim të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX.

Studimi në fjalë dallohet për rëndësinë e tij të dyfishtë, sepse pos të folmes së Rahovecit, në veçanti, lëshon rreze edhe mbi të folmen e Podrimes e të Kosovës, në përgjithësi[6].

Ndërkaq, në punimin *Djali plëngprishës në të folët shqip të Istrisë,* Akademik Idriz Ajeti rreket të pasqyrojë të folmen e Istrisë, duke u mbështetur në dokumentin e shkruar *Djali plëngprishës,* që e ndeshim në *Dhjatën e re,* të linguistit italian Biondelli, i cili meqë nuk e kishte kuptuar gjuhën e këtij tregimi në dorëshkrim, e la të dergjet në Arkivin e Bibliotekës Ambrosiane të Milanos, të cilën pastaj linguisti italian Matteo Bartoli e mori dhe e botoi në revistën *Studi albanesi I,1*932, f. 7. Pas një kohe të shkurtër transkribimin e tekstit provoi ta gatit linguisti shqiptar Mjeda[7], me të cilin në shumë pika ne nuk pajtohemi- thotë Idriz Ajeti[8]. Përkundër zgjidhjeve të suksesshme të historisë së disa prej zhvillimeve gjuhësore të

---

[4] Ajeti, I.: *Gjurmime albanologjike,* nr. 6, 1966.

[5] Ajeti, I.: *Gjuha e Divanit* të Sheh Maliqit l998, f. 65-I29.

[6] Halimi, M.: Vështrime gjuhsore, Prishtinë l993, f. l42.

[7] Mjeda, LEKA IV, l932, f. 359-362.

[8] Ajeti, I.: *Djali plëngprishës në të folët shqip të Istrisë,* Vepra 2, AShAK, l998, f. l3l-l40.

këtyre të folmeve të periudhave të ndryshme historike në fjalë, mendoj se mbesin edhe shumë çështje të pasaktësuara, si: *shkalla e intensitetit të nazalizmit, gjatësisë së zanoreve niveli i kulturës gjuhësore të periudhave të caktuara historike, përdorimi i fondit autokton leksikor në raport me përdorimin e leksikut të huazuar,* sepse është çështje mjaft e ndërlikuar të saktësohet se dokumentet e shkruara paraqesin gjendjen e të folmeve të atëhershme dialektore, apo paraqesin kulturën gjuhësore të autorëve të dokumenteve në fjalë. Megjithë aftësinë studimore të profesor Idriz Ajetit për të ndriçuar në mënyrë të gjithanshme këto dokumente gjuhësore, vetë materiali dhe lënda e kufizuar gjuhësore, nga njëra anë, dhe pamundësia e verifikimit të trajtave fonetike e morfologjike në variantin autentik të tyre të folur për studimet tona dialektologjike do të përfaqësojnë një kureshtje të përhershme enigmatike të ndriçimit të tyre të gjithanshëm në këtë drejtim, nga ana tjetër.

Megjithëkëtë, këto studime të dokumenteve në fjalë, do të zgjojnë interesim të veçantë ndër studiuesit e dialektologjisë shqiptare dhe filologjisë albanologjike e ballkanologjike në përgjithësi, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, dëshmon edhe njëherë se profesor Idriz Ajeti është njohës i thellë i dialekteve shqipe e dokumenteve të shkruara të saj. Duke zbatuar një kriter të rreptë shkencor në studimet e veta, ai zgjeroi e thelloi studimet e gjuhësisë sonë në përgjithësi, dhe studimet dialektologjike në veçanti[9].

Këtu bënë pjesë edhe studimi për gjuhën e stilin e një varg shkrimtarësh të vjetër shqiptarë, si: *Dy fjalë për gjuhën e Bogdanit,* ku në bazë të dhënave të një gjuhe shqipe nëpërmjet të së cilave vihet përpara një shkallë mbidialektore e të folmeve gege të Veriut të Kosovës[10], pastaj për gjuhën e Kristoforidhit[11], *Nihmesa e Naim Frashërit në punë të formimit të gjuhës letrare shqipe*[12], e të tjerë.

Në studimet dialektologjike të profesor Idriz Ajetit, spikatë tendenca për gjurmimin e dokumenteve të shkruara, që hedhin dritë mbi veçoritë

[9] Halimi, M.: Vështrime gjuhësore, Prishtinë l993, f. l45.

[10] Ajeti, I.: Vepra 2, f. l65-l70.

[11] Ajeti, I., po aty, f. l7l-l76.

[12] Ajeti, I.: po aty, l77-l84.

dialektore të të folmeve të këtij territori në prerje kronologjike më të hershme, kryesisht në fundin e shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, gjë që i ka dhënë mundësi autorit të rindërtojë me mjaft sukses historinë e disa prej zhvillimeve gjuhësore të këtyre të folmeve në periudhën nga fillimi i shekullit XIX e deri më sot. Sepse këtë qëndrim Idriz Ajeti e kishte formuluar qysh në vitin 1957, duke pohuar: asht e ditur se në përpjekjet tona ma e ndritshme çashtje gjuhësore te na, nuk mund të lëshohet kurrfarë drite mbi këto, po s' u studiuan historikisht[13].

2. **Studimet dialektologjike**, ku lënda dialektore u eksplorua nga terreni dhe ku autori zbatoi metodën shkencore *sinkronike,* ku bëjnëpjesë studimet, siç janë: *Tipat e L-ës në dialektet shqiptare të Brisk-Shestanit të Krajës*[14] , ku bën fjalë për tipat e L-së në këtë të folme dhe në shqipen në përgjithësi. Meqenëse mendimet e albanologëve botërorë me kohë ishin ndarë në dy lagje, duke u rropatur të zgjidhnin çështjen se a ka shqipja tre tipa të L-ës, tani kjo çështje kërkonte një shpjegim e gjykim dhe një zgjidhje të përhershme. Lidhur me këtë çështje Idriz Ajeti shfaq shtjellueshëm, qartë dhe në mënyrë bindëse pikëpamjet e veta për çështjen në tërësi[15]: *këtu për ta ftillëzuar punën njëherë e mirë dhe për të mos lënë më asnjë dilemë, në kundërshtim me B. Miletić-in, ai hetoi problemin dhe në fill trajtimin e tij historik, ashtu si e kishin vështruar atë klasikët e albanistikës Dozon-i, Meyer-i, Pedersen-i e deri te Pekmezi që të pohojë prerazi se shqipja nuk ka tre, po ka dy tipa të L-ës, pra nuk ka L evropiane të ndërmjetme*[16]..

Në punimin *Rreth disa tipareve gjuhësore të ligjërimeve shqiptare të Kosovës*[17], ku siç thotë autori i studimit në fjalë: *Hetimet e dialekteve shqiptare, që këto vitete fundit kanë zënë të intensifikohen, në punën e tyre të përtardhme do të sillen e të shikojnë vjetërsinë a moshën e dukurive që na shfaqen në dialektet e gjuhës sonë, të cilën e degëzojnë në gegënishten*

---

[13] Ajeti, I.: revista *Përparimi* nr. l, l957, f. 57.

[14] Ajeti, I.: Vepra 2, f. l4l- l49.

[15] Halimi, M.: Vështrime gjuhësore, Prishtinë l993, f. l43.

[16] Gjurmime albanologjike, SSHF, nr. l4, l984, f. 95.

[17] Ajeti, I.: Vepra 2, f.97 – l04.

e në toskërishten[18]. Pra me anë të këtij punimi *autori synon të vijëzojë zhvillimin historik të disa të folmeve dialektore, që mbesin karakteristikë specifike e të folmeve gjuhësore të Kosovës*[19].

Këtu trajtohet reduktimi i grupeve konsonantike, kalimi dhe rrafshimi i *q, gj* në *ć, đ, mbaresa –ke e vetës së tretë* njëjës e së pakryerës në mënyrë dëftore dhe ndryshime të tjera.

Studimi dialektologjik*Rreth disa veçorive të të folmeve të shqiptarëve të rrethit të Preshevës dhe të Bujanovcit*[20]*, ku* autori vë në spikamë disa tipare e veçori fonetike dhe morfologjike të kësaj të folmeje, duke dhënë në këtë mënyrë deri diku pasqyrën e përgjithshme të të folmeve shqipe të popullsisë shqiptare, që si vazhdimësi e pashkëputshme tokësore gjeografike jeton në Kosovën Lindore, e cila ende dergjet e vuan nën robërinë shekullore të juridiksionit të Serbisë.

Me rastin e vizitës sime në Preshevë, në rrethin e saj dhe në disa fshatra të Bujanovcit, për arsye të kohës së shkurtër, munda të shënoja vetëm disanga karakteristikat më kryesore të të folmeve shqiptare të këtyre viseve[21], shprehet me modesti autori i studimit në fjalë dhe duke umbështetur në dialektet e shqipes, ai sheh si rrethanë lehtësuese edhe përkatësinë fisnore që i mundëson studiuesit të identifikojë se cilit tip dialektor i takon popullsia, të folmen e së cilës ai është duke e hetuar në vështrim. Mirëpo, ai kryekëput mbështetet në lëndën konkrete të eksploruar në terren, ndaj pohon: *Në punën tonë do të mbështetemi kryesisht në materialin gjuhësor që do të na orientojë nga rruga që do të na sigurojë rezultate që flasin në dobi të përcaktimit të tipit dialektor në studim*[22]. Përkundër modestisë për punën studimore kinse të rastit e të kërkesave të kufizuara studimore të autorit, kemi të bëjmë me një studim të shterueshëm dialektologjik i mbështetur në lëndë të pasur e konkrete dialektore, nga njëra anë, por edhe të mbërthyer e të mbathur me të dhëna të bollshme

[18] Ajeti, I.: po aty, f. 97.

[19] Halimi, M.: Vështrime gjuhësore, f. l42.

[20] Ajeti, I.: Vepra 2 , f. l05 – l29.

[21] Ajeti, I.: Vepra 2, f. l05.

[22] Ajeti, I.: Vepra 2, f. l05.

shkencore, nga ana tjetër. Autori pasi jep një pasqyrë se kush është marrë me studimin e të folmeve shqipe të këtij krahu, qoftë në mënyrë të thelluar, qoftë në mënyrë sipërfaqësore, kalimthi e të rastit, siç izë ngoje studiuesit: Stefan Mladenov-in, Carlo Tagliavini-n, Atanasije Urošević-in, Jovan Trifunovski-n, Tatomir Vukanović-in, etj, me pohimet e të cilëve autori nuk pajtohet tërësisht. Ndaj punimin e vet në mbështetje të lëndës së vjelë në terren e shtron në bazë të shterueshme shkencore. Për të hedhur dritë për fizionominë e koloritin dialektor të kësaj të folmeje, autori studimin e vet e hap me veçoritë fonetike, duke marrë në shqyrtim në tërësi sistemin vokalik, duke përfshirë këtu edheçështjen e theksit se ku bie theksi te fjalët e theksuara, nazalitetin e vokaleve, palatalizimine y-së në *i*, diftongjet dhe grupet vokalike, asimilimin e togjeve konsonantike *mb, nd në m e n,* **duke veneruar me veshin e mprehtë edhe trajtat e paasimiluara, si *këndena* (këndej), *mundet,* e unë poshtoj** se në ekspeditat e mia dialektologjiuke në Preshevë kam dëgjuar edhe trajtën me *mb, mbarre (për marre).*Autori merr në shqyrtim edhe *konsonantizmin, ku* bënë fjalë për çiftet e tyre afrikate prepalatale:*q, gj* dhe *ç, xh,* ku ruhet dallimi i okluziveve palatale prej jopalataleve, merr në shqyrtim edhe Veçoritë morfologjike, duke filluar me emrin, lakimin, gjininë e numrin e tij me përqasje e krahasime, jo vetëm të të folmeve tjera shqipe në gjendjen e tyre të sotme, por duke bërë krahasime edhe me trajtat e përdorura nga shkrimtarët e vjetër të dialektit gegë, punimin e vet autori e pasuron edhe me trajtimin e hollësishëm të foljeve, duke marrë në shqyrtim të gjitha kategoritë e saja, e krahason atë me të folmet e sotme shqipe të trevave të tjera shqiptare, e rrallë e tek edhe me gjuhët e popujve fqinj. Në këtë mënyrë shihet njohja e gjithanshme e dialekteve shqipe e autorit, nga njëra anë, por edhe e folmja në shqyrtim jepet në një tërësi të plotë në mesin e këtyre të folmeve dialektore. Do të thotë se autori nuk e kundron këtë të folme si oazë apo si të folme ishullore të veçuar e të izoluar nga të folme të tjera, por vë në spikamë edhe dallimet e ngjashmëritë si dhe ndikimet e të folmeve fqinje.

Ndërkaq, kryevepra dhe studimi i parë monografik në fushën e studimeve dialektologjike është studimi: **Zhvillimi historik i së folmes gege të Arbëneshëve të Zarës**, paraqet studimin më të plotë të Prof. Idriz Ajetit, duke përfaqësuar kontributin e tij më të madh në fushën e studi-

meve dialektologjike. Këtij studimi monografik i paraprin një parathënie e shkurtër e autorit, ku autori vë në pah qëllimin dhe punën e tij kërkimore në terren[23], pason *hyrja* , ku bëhet një vështrim për dialektet shqiptare në përgjithësi. Kurse në kaptinën e dytë të kësaj monografie spikatë një vështrim kritiko-historik i përpjekjeve të deriatëhershme për studimin e së folmes së Arbëneshit, ndërsa në kaptinën e tretë bëhet fjalë për prejardhjen e arbëneshëve të Zarës dhe lidhjet e tyre me truallin e lashtë autokton, në Brisk-Shestan. Autori e sheh të udhës që në kaptinën e katërt të ndriçojë *Pozitën e të folmeve të Krajës në gjirin e dialekteve të shqipes.* Pas një ndriçimi të gjithanshëm të çështjeve në fjalë, autori thellohet në studimin e veçorive dialektore të kësaj të folmeje diasporike, duke marrë në shqyrtim, tingujt, trajtat, emrat dhe kategoritë gramatikore të tyre, foljet e pjesët tjera të ligjëratës. Në kaptinën e fundit sjell një numër të konsideruar njësish tekstore nga e folmja e drejtpërdrejtë e subjekteve shqipfolëse të Zarës, duke mbyllur monografinë e tij me rezymenë në gjuhën gjermane.

Monografia, *Zhvillimi historik i së folmes gege të arbëneshëve të Zarës,* u publikua për herë të parë në gjuhën serbokroate si tezë disertacioni. Tani për herë të parë në vëllimin Studime gjuhësore në fushë të shqipes II, l985, punonjësve të shkencës e lexuesve të shumtë po u ofrohet i publikuar në gjuhën shqipe, i përkthyer nga autori i këtij punimi[24], e pastaj

---

[23] Ajeti, I.: Vepra l, Prishtinë l997, f. 6: Gjatë kohës së kërkimeve të së folmes së arbëneshëve të Zarës, në dy ekspeditat e mia, nga ana e arbëneshëve jam mirëpritur përzemërsisht, duke më ofruar ndihmë të pakursyeshme në këtë drejtim e duke pasur kujdes të veçantë ndaj meje. ata bënin gara ndërmjetveti se cili prej tyre do të ofronte më shumë lëndë gjuhësore... Ndiej kënaqësi të veçantë që me këtë rast mund t'i falënderoj posaçërisht veteranët e arsimit Josip Vlladoviq –Relën dhe kolegun e tij Budimir Peroviqin, të quajtur Miroa i Kikicës, të cilët me mirëpritje të veçantë njerëzore dhe me përpjekje të pakursyeshme më ndihmuan të gjej informatorë autentikë e të përshtatshëm].

[24] Halimi, M.: Duke e përkthyer punimin në fjalë, kisha drojë se mos po më shpëtojnë gabime, ndaj për të heq përgjegjësinë time profesionale, Profesorit të nderuar i thashë: - Profesor po mos t' ishe gjallë, përgjegjësia do të ishte imja, por meqë ju jeni, përgjegjësia është Juaja, ndaj kam dëshirë që përkthimin tim ta shihni edhe Ju vetë që të dalin sa më pak gabime që është e mundshme. Dhe meqë që të dy jemi shqiptarë, emri im nuk ka nevojë të figurojë fare, sepse unë jam nxënësi juaj. Por, ai më tha: - Jo,

edhe si botim i veçantë i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës[25], duke bërë pjesë në kuadër të kompletit prej pesë vëllimeve. Prandaj me këtë rast e shohim të udhës të shfaqim disa vlerësime tonat lidhur me të: *Kjo monografi konsiderohet jo vetëm si monografi e parë, por mund të veçohet edhe si njëra ndër monografitë më të spikatura në fushën e studimeve të dialektologjisë shqiptare, ku përveç pasqyrimit në vija të holla të punës së deriatëhershme në dialektologji, spikatë në mënyrë tërësore, kritike e shkencore, duke filluar nga aspekti i zhvillimit të saj vihet në shoshitje të përimtuar e në tërësinë e saj të plotë, e folmja e arbëneshëve të Zarës, duke shkoqitur gjerësisht e thellësisht në dritën e zhvillimit historik edhe të mbarë të folmeve gege, në përgjithësi*[26].

Si i këtillë, ky studim monografik shquhet, jo vetëm për tërësinë e tij të plotë, por edhe për një kriter shkencor, sepse autori këtu trajton një të folme me përdorimin e zëkosave të gjerë nga të gjitha tërthoret e viseve shqiptare dhe nga të gjitha aspektet e saj, duke e studiuar atë në formë komplekse, autori përdor shpesh edhe metodën krahasimtare, duke e ndërlidhur këtë të folme ishullore me të folmen amësore-Krajë-Shestan, nga njëra anë dhe metë folmen bijë – të arbëneshëve të Zarës, do të thotë me të folmen e truallit të lashtëe autokton (rrënjës) dhe me të folmen e truallit të ri – në Arbënesh të Zarës, autori me sukses arrin të na japë një sintezë të kësaj të folmeje në fizionominë e saj diakronike e sinkronike nëpërmjet metodës krahasimtare.

Autori, në këtë studim monografik në fushë të dialektologjisë shqiptare, revidon dhe shqyrton njëkohësisht në mënyrë kritike e objektive konstatimet e gabuara të studiuesve të mëparshëm të kësaj të folmeje, kryesisht të studiuesve të huaj, siç ishin linguistët e njohur: Gustav Weigand-i, Carlo Tagliavini e të tjerë[27].

---

jo, emri juaj gjithsesi duhet të qëndrojë si përkthyes, sepse ju keni bërë punë të madhe, por me këtë rast edhe më ngarkoi me përgjegjësinë e përkthimit.

[25] Ndërsa si botim në vete, më l997 e botoi AShAK në vëllimin Vepra l, si pjesë përbërëse e kompletit prej pesë vëllimeve.

[26] Halimi, M.: Vështrime gjuhësore, f . l4l.

[27] Halimi, M.: Vepër e spikatur dialektologjike, në Gjurmime albanologjike SSHF, nr. l6-

Kjo monografi tepër interesante dhe me vlerë të lartë shkencore e Idriz Ajetit merret me dialektologjinë historike, me një fushë hulumtimi që zakonisht është paraqitur tepër pak edhe në shumë gjuhë të tjera të hulumtuara më rrënjësisht se ç' është rasti me shqipen. Dhe mu për këtë ajo duhet të përshëndetet- shkruan Cimochowski[28]. Kështu një pamje e gjerë e të folmeve shqipe dhe e hulumtimit të tyre, që mund të pretendonte për të qenë sintezë, është edhe studimi i Lamberz-it (Të folmet e gjuhës shqipe).

Prandaj, gjuhësia shqipe në përgjithësi dhe dialektologjia shqiptare, në veçanti akademik Idriz Ajetit i detyrojnë mirënjohje e respekt të veçantë, jo vetëm për studimin e plotë monografik në fishën e studimeve dialektologjike *Zhvillimi historik i së folmes gege të arbëneshëve të Zarës*, por, edhe për të dhënat mbi të folmen e Krajës dhe vendosjen e pozitës së saj në kuadër të të folmeve fqinje të gegërishtes veriore, sepse për këto të folme për herë të parë hedh dritë akademik Idriz Ajeti.

l986, Prishtinë l987, f. 292-295.

[28] Cimochowski, Wacław: Studim me vlerë (Pasthënie), në Vepra l, f. l65.

Mehmet HALIMI

ACADEMICIAN IDRIZ AJETI'S CONTRIBUTION IN THE FIELD OF DIALECTOLOGY STUDIES

Summary

Academician Idriz Ajeti laid the groundwork of the dialectology studies in Kosova, by examining the Albanian speech in two domains - *the diachronic domain and synchronic domain*. Ajeti employed three methodical schemes: the method of diachronic study, the method of synchronic study, and the comparative methodical scheme. On the domain of the dialectological studies, Academician Ajeti explored two basic sources: 1) by relying on the linguistic corpus of the written materials of different Albanian authors; 2) by assembling dialectological substance from the existing dialectological discourse in the field. While applying a comparative methodology, the author managed to successfully shape out a synthesis of the speeches and their diachronic and synchronic physiognomy.

IN MEMORIAM

AKADEMIK BESIM BOKSHI
(1930-2014)

Më 17 gusht 2014 pushoi së rrahuri zemra e të urtit, dijetarit dhe poetit, studiuesit frymëgjatë, vrojtuesit dhe këshilltarit të durimshëm, albanologut dhe patriotit, profesorit, akademikut të shquar dhe Kryetarit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, njeriut që gjithë jetën e tij kërkonte shpjegime për misteret e historisë së pashkruar të thesarit tonë më të madh - të gjuhës, poetit që me dritën e mendjes përjetësonte e luçidonte qeniesimin tonë të përkohshëm, të vështirë e të mundimshëm, vinte çdo ditë nga një gur në themelin e krenarisë sonë, të njeriut me empati të theksuar sociale dhe Kryetarit të Partisë Socialdemokrate të Kosovës. Shuarja e tij është një humbje e madhe dhe e pakompensueshme për familjen, për miqtë, për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, për studimet e shqipes, për shkencën shqiptare, për tërë Kosovën dhe shqiptarinë.

Besim Bokshi lindi në Gjakovë më 1930, shkollimin fillor dhe të mesëm i mbaroi në Gjakovë e Prishtinë, ndërsa studimet për albanologji në Beograd, ku u diplomua më 1958. Doktoratën në shkencat filologjike me specializim në fushë të historisë së gjuhës shqipe, me temën Rruga e formimit të fleksionit të sotëm të shqipes, e mbrojti në Prishtinë më 1978.

Besim Bokshi mbahet në mend ndër breza si profesor i dinjitetshëm i shkollës së mesme dhe si drejtor i Gjimnazit Hajdar Dushi në Gjakovë, profesor dhe Drejtor i Shkollës së Lartë Pedagogjike në Gjakovë, profesor i shquar, frymëzues për kolegët dhe brezat me qëndrimet e paepura prej shkencëtari dhe Shef i Degës së Gjuhës Shqipe në Fakultetin e Filozofisë/ Filologjisë të Universitetit të Prishtinës, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës që nga viti 1991, nënkryetar i AShAK-ut nga 2002 deri më 2008 dhe Kryetar i këtij institucioni në mandatin 2008-2011. Mbahet në mend si pjesëmarrës aktiv, bashkëhartues i Konkluzave të Konsultës Gjuhësore të Prishtinës, që ndikoi në mënyrë vendimtare në zhvillimet e mëtejme në fushën e planifikimeve gjuhësore në mba-

rë hapësirën shqiptare, pjesëmarrës i Kongresit të Drejtshkrimit, drejtues i Komisionit për Gjuhë i AShAK-ut, anëtar i Këshillit Ndërakademik për Shqipen Standarde. Ishte anëtar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës. Akademik Besim Bokshi ishte i pranishëm në mënyrë të vazhdueshme, të qetë, por me veprim të themeltë, në jetën tonë plot të papritura, dhe ngado që sillej linte gjurmë të pashlyeshme kulturore, shkencore, arsimore dhe emancipuese shoqërore, ishte deputet i Kosovës në Kuvendin Federativ, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës në vitet e turbullta ’90, Kryetar i Partisë Socialdemokrate të Kosovës dhe pjesëmarrës aktiv i shumë veprimtarive në vitet ’90 e më vonë. Për të gjitha këto, për ndihmesat e pashoqe që kishte dhënë për zhvillimin e shkencës, të kulturës e të dijeve, për zhvillimet e përgjithshme shoqërore, për Gjakovën e për Kosovën, Kuvendi i Gjakovës i akordoi Besim Bokshit nderimin më të madh Nderi i Gjakovës.

Prania e tij në gjithë këtë gamë përpjekjesh të botës shqiptare në një histori tashmë të spikatur për rropatjet e turbulencat, do të mbetet e shënuar me ndihmesat thelbësore, me rezultatet që çojnë peshë, me orientimet ndriçimtare, me synimet për çlirimin nga vargojt e të gjitha llojeve. I dijshëm dhe i urtë, shembull korrektese ndaj tjetrit, vrojtues i thellë e me veprime të matura por të vendosura, deri në fund të përgjegjshme, Besim Bokshi ishte bërë një nishan orientues për ata që e rrethonin, për ata që ndjenin rrezet e dritës së mendjes së tij, për ata që mësuan prej tij, për ata që shijuan bukurinë dhe thellësinë e fjalës së tij, për ata që vlerësuan moralin dhe mësimin shembullor prej veprës dhe veprimtarisë së tij, për të gjithë ata që nga Gjakova e në tërë Kosovën, në hapësirat e dijeve e të jetës kërkonin horizonte të lirisë, të dinjitetit, të krijimit e të lumturisë njerëzore.

Në letrat shqipe emri i Besim Bokshit shfaqet në vitet ’50 me poezitë me ngjeshje semantike e emocionale, refleksive e shoqërore, shpesh me vulën e protestës, me metaforikën e thellë e me simbolikën kombëtare. Në poezinë e Bokshit edhe tematizimet sociale marrin vulën e refleksionit, shprehen me një figuracion të kursyer. Në kohë të vështira para vitit 1966 frymëzimet e tij mund të ishin në shenjën e pikës së ujit që ëndërron të shpojë masën e gurtë, ndërsa më vonë me pritjen e lirisë, e cila, kur të vijë, siç thoshte vetë, edhe pse do të më gjejë të plakur,

e s’do të mundem me qeshë si flladi i pranverës,
Me vdekë, porse, nga gëzimi
– do të mundem.

Shkëlqimin madhor të mendjes krijuese akademik Besim Bokshi e shënoi në studimet për gjuhën shqipe, ku vlen ndër autoritetet më të mëdha. Me hu-

lumtimet frymëgjata e të thelluara në fushën e linguistikës, në fushën e strukturës gramatikore të shqipes, me vrojtimet e rëndësishme për strukturat gramatikore të gjuhëve të Ballkanit, me akribinë shembullore shkencore, akademik Besim Bokshi ka sjellë kontribute me vlerë të jashtëzakonshme. Ndihmesat e tij për studimet e zhvillimeve gramatikore të shqipes zënë vend të veçantë për origjinalitetin e mënyrës së hulumtimit, për rezultatet e shumta, për thellimin krejt të veçantë, për vështrimin sistemor e struktural në këto studime, për orientimin e përgjithshëm të tyre drejt horizonteve të reja, për krijimin e një koncepti koherent dhe konsistent për rrugët e zhvillimeve morfologjike, në ndërlidhje me zhvillimet e tërësishme strukturore të shqipes. Duke i integruar studimet për strukturën gramatikore të shqipes në rrjedhat studimore të kohës, duke i shpënë ato ndjeshëm përpara dhe modernizuar në metodë, akademik Besim Bokshi e ka rritur kredibilitetin e studimeve albanistike shqiptare në komunitetin e studiuesve të gjuhës dhe ka krijuar një model për të ndjekur nga të rinjtë, ka vendosur një standard të lartë në këto studime.

Po lejohem të shquaj disa prej veprave të tij madhore, vepra për të cilat do të mbahet në mend gjatë. Në gjuhësinë shqiptare ai u shfaq më 1971 me studimin befasishëm të thellë për tipat e temave nominale në gjuhën shqipe. Më 1978 Bokshi përfundoi monografinë *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*, me cilësitë dalluese prej linguistit: me orientim diakronik, por me vështrim të thelluar në funksionimin sinkronik të sistemit gjuhësor. Në studimet e gramatikës historike të shqipes me atë vepër futeshin nëpër derë të madhe metodat gjuhësore mbisunduese të shekullit 20, ato që gjuhën e shihnin si sistem, metodat strukturale, çka nuk mund të mos shënonte risi në albanistikën shqiptare. Kjo monografi e Besim Bokshit mbetet një nga veprat me rëndësi themelore për studimet në fushën e gramatikës historike të shqipes në tërësi. Në të Besim Bokshi shquhet dhe me origjinalitetin shpjegues: sistemi flektiv i shqipes, siç ishte supozuar dhe nga të tjerë më herët, për pasojë të veprimit të theksit të ngulitur, ishte reduktuar dhe kishte bjerrë shumë elemente nga trashëgimia dezinenciale. Më vonë, nëpër proceset komplekse morfosintaksore ajo kishte krijuar një sistem të ri, ku elementet e ndryshme flektive kishin marrë dhe funksione të tjera. Të gjitha këto ai i kishte hulumtuar në detaje në sistemin emëror të shqipes. Vështrimet e elementeve të fleksionit në paradigmën e tyre në vështrimin e Besim Bokshit nuk ishin aspak të mjaftueshme për shpjegime të kënaqshme në zhvillimet e sistemit gramatikor të shqipes. Hulumtimi nuk duhet të mjaftohet me kërkimin, qoftë dhe gjetjen, e etimologjive të veçanta, shpesh inkompatibile, po duhej të shtrihej në vështrimin e aspekteve të ngërthimit sintagmatik të elementeve të ndryshme në bazë të

funksionit që do të luanin brenda thënies. Derisa në analizat paradigmatike duheshin sprovuar modelet e njohura shumë gjatë të shpjegimit historik e etimologjik, ngërthimit logjiciste e semantike, në analizat sintagmatike të gjitha këto duheshin parë në përthyerje të ndërtimeve me funksione të ndryshme dhe këtu i hynin në punë modelet e analizave sintaksore strukturale-funksionale, sidomos të V. Broendal e L. Hjelmslev (për parafjalët dhe rasët, për kategoritë gramatikore), po edhe të funksionalizmit të pragasve e të A. Martinet-së. Por as kjo nuk i mjaftonte dhe ai e shtriu analizën e tij sintagmatike përmes ideve të distribucionit drejt sprovave të para të analizës gjenerative të J. Dubois etj. Në raport me idetë sunduese në gramatikën historike të shqipes e tërë kjo tentativë shpjeguese është krejtësisht origjinale. Thellësia e të menduarit dhe shpjegimet funksionale-strukturale e bëjnë atë njëherësh frymëzuese dhe atraktive, por edhe të vështirë. Studimet e historisë gjuhës do t'i rikthehen vazhdimisht këtij modeli të menduari.

Në këtë vazhdë studimesh Besim Bokshi na ka lënë monografinë e shquar *Prapavendosja e nyjeve në gjuhët ballkanike*, një vepër me vlerë për albanologjinë dhe për ballkanologjinë, vepër në të cilën hipoteza për ngjizjen e procesit të prapavendosjes së nyjës në gjuhët e Ballkanit ka nisur pikërisht në shqipen vjen e bëhet një teori e rëndësishme, refutimi i së cilës tashmë nuk është gjë e lehtë.

Besim Bokshi nuk ndaloi vetëm në studimet e sistemit nominal të shqipes. Ai na ka dhënë edhe një monografi të rëndësishme që na shpie drejt shpjegimeve të sistemit foljor po me këto rrugë e procedime: monografinë *Pjesorja e shqipes*.

Depërtime të ngjashme të Bokshit ndeshim dhe në monografinë me shumë interes *Për vetorët e shqipes*, ndërsa kërshëri të madhe zgjon libri i tij i fundit *Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes*, që, për idetë dhe për periodizimet e propozuara deri tash mbi bazë të të dhënave vetëm gjuhësore, paraqet një vepër sintetizuese. Me këtë libër Bokshi ka bërë dhe një hap tjetër me rëndësi, duke vënë kështu një rend që mund të nxisë ide të reja më tej për morfologjinë historike të shqipes.

Akademik Besim Bokshi nuk reshti së studiuari deri në frymën e fundit të jetës së tij. Pak para vdekjes dorëzoi veprën e tij më të re *Varia*, ku përfshihen diskutime për çështje të veçanta shkencore, por edhe për personalitete të dijes e të jetës shoqërore. Për fat të keq, ai nuk arriti ta shihte dritën e këtij botimi. Pak ditë më herët ai fliste për një projekt të tij të ri studimi, për të cilin po punonte edhe në atë gjendje të rënduar me probleme shëndetësore.

Horizontin e studimeve të tij gjuhësore akademik Besim Bokshi e kishte lidhur me nevojën për shpjegimet e zhvillimeve që kanë ndodhur në një gjuhë me

lashtësi të madhe, por me dokumentim të vonë. Të kuptuarit e funksionimit të sotëm të kësaj gjuhe i jepte atij dritën e çelësit shpjegues për rrugët e atij zhvillimi. Besim Bokshin studiues e shquante fryma kritike shkencore, vështrimi objektiv dhe këmbëngulja e pashoqe për t'i ndriçuar deri në fund çështjet.

Në poezi, si në aforizma, në gjuhësi apo në jetë, Besim Bokshit i përshtatet thënia: për thelbësoren folë në mënyrë thelbësore. Me thellësinë, me refleksivitetin prej të urti, me vendosmërinë dhe guximin prej hulumtuesi të përkushtuar, me lirinë dhe dritën e mendjes, me afërsinë njerëzore, me butësinë dhe dashamirësinë e tij, me përmbajtjen dhe respektin ndaj tjetrit që rrezatonte qetësi e siguri tek rrethi, akademik Bokshi ka bërë që mjedisi ku ka vepruar të ndjehet krenar që e ka pasur. Me studimet që shënojnë majat e albanistikës, me krijimet e veçanta letrare poetike, me veprimtarinë intelektuale publike, me jetën e tij frymëgjatë arsimuese për brezat e shekullit që shoi robërinë, me punën e tij të themeltë shoqërore e politike, me angazhimet në Lëvizjen për pavarësi të Kosovës, akademik Besim Bokshi shquhet në horizontet e dijeve, të kulturës dhe të botës shqiptare.

Rexhep ISMAJLI

SHËNIME BIOGRAFIKE PËR AKADEMIK BESIM BOKSHIN

Besim Bokshi lindi në Gjakovë më 12. XI. 1930. Gjashtë klasë të mësimit fillor i kreu në Tiranë, ndërsa dy të tjerat - në Gjakovë. Maturoi në Gjimnazin e Prishtinës. Studimet e larta i ndoqi në Katedrën e Albanologjisë në Beograd dhe, me ndërprerje, i përfundoi më 1959. Studimet pasuniversitare në Drejtimin e gjuhësisë i vijoi në Beograd. Në Universitetin e Prishtinës iu lejua tema e tezës së doktoratës në bazë të punimit të botuar Zhvillimi i strukturës së temave emërore të shqipes (Gjurmime albanologjike, 1, 1971). Tezën e doktoratës Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes e mbrojti në Fakultetin Filozofik të Prishtinës më 1977.

Besim Bokshi ka qenë profesor i lëndës e gjuhë dhe letërsi shqipe në Gjimnazin e Gjakovës. Në vitet 1961-63 ka qenë drejtor i kësaj shkolle. Në vitet 1967-73 ka qenë profesor në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Gjakovës për lëndët *Morfologji të gjuhës së sotme shqipe* dhe *Hyrje në gjuhësi* dhe në vitet 1967-1971 ka qenë drejtor i kësaj shkolle. Brenda kësaj kohe për tetë muaj ka punuar në Institutin Albanologjik të Prishtinës. Nga viti 1974 është zgjedhur ligjërues i *Morfologjisë historike* në Degën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës dhe, pas doktorimit, është zgjedhur profesor inordinar e pastaj edhe profesor ordinar deri kur u përjashtua nga Fakulteti më 1991 bashkë me mësimdhënës të tjerë shqiptarë nga dekanati i dhunshëm. Në vitet 1992-2001 ka ligjëruar lëndën *Hyrje në studimin krahasues të gjuhëve indoevropiane* në Shkallën e tretë të studimeve - Drejtimi i gjuhësisë në Fakultetin Filologjik të Prishtinës. Ka qenë anëtar i komisionit për konkluzione të Konsultës Gjuhësore të Prishtinës më 1968 dhe delegat në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe në Tiranë më 1972. Ka marrë pjesë në Kongresin e Studimeve të Evropës Juglindore në Ankara më 1978 me kumtesën për prapavendosjen e nyjës në gjuhët ballkanike. Në Universitetin e Jenës ka mbajtur ligjëratën për origjinën e mbaresave rasore të shqipes. Para ligjëruesve të Katedrës së Gjuhës e të Letërsisë Shqipe të Fakultetit Filologjik të Tiranës dhe bashkëpunëtorëve shkencorë të Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë ka mbajtur ligjëratën për zhvillimin e sistemit emëror të shqipes (1979).

Nga viti 2004 është anëtar i Këshillit Ndërakademik për Shqipen Standarde.

Besim Bokshi ka qenë deputet në Dhomën për Arsim në Kuvendin Federativ të Jugosllavisë në vitet 1967-69. Në zgjedhjet e organizuara nga subjektet politike të Kosovës më 1992 është zgjedhur deputet i Kuvendit të Kosovës. Në vitet 1993-96 ka qenë Kryetar i Partisë Socialdemokrate të Kosovës.

Për veprën Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes ka marrë Shpërblimin e Dhjetorit të Kuvendit të Kosovës më 1980.

Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës. Anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës është zgjedhur më 1991, ndërsa nga viti 1996 është anëtar i rregullt i kësaj akademie. Më 2002 u zgjodh nënkryetar, ndërsa në vitet 2008-2011 ishte Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Besim Bokshi ndërroi jetë më 17 gusht 2014 në Gjakovë.

BIBLIOGRAFIA E BOTIMEVE TË AKADEMIK BESIM BOKSHIT

Libra t e botuar:

Në pritje (Përmbledhje poezish), Jeta e ré, Prishtinë, 1966. Ribotim nga Rilindja, Prishtinë, 1978. Përkthyer në serbisht nga E. Mekuli, **U očekivanju**, Bagdala, Krushevc, 1969. Në vitet 1981- 87 ka publikuar rreth 20 poezi të reja në shtypin e kulturës dhe të letrave, **Rilindja**, **Fjala** dhe **Jeta e ré**).

Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes, AShAK, Prishtinë, 1980; botimi i dytë AShAK, Prishtinë, 2006.

Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike, Rilindja, Prishtinë, 1984; Botimi i dytë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2009.

Hije të këputura (Aforizma), Dukagjini, Pejë, 1996.

Pjesorja e shqipes (Vështrim diakronik), AShAK, Prishtinë, 1998.

Për vetorët e shqipes, AShAK, Prishtinë, 2003.

Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes, AShAK, Prishtinë, 2010.

Varia, AShAK, Prishtinë, 2014.

Studime dhe artikuj:

Ndryshimi i strukturës së temave emërore të shqipes, **Gjurmime albanologjike**, SSHF, 1, 1971-72, Prishtinë.

Postposition of Article in the Balkans Languages, **Actes du Congrès International des Études Balkaniques et Sud-est Européennes**, Ankara, 1978 (rezyme e kumtesës së lexuar).

Sur l'origine des pronoms possesifs en albanais, **Recherches albanologiques**, 3, 1984.

Recostitution des différentes phases relatives à la postposition de l'article défini dans les langues balkaniques, **Rechershes albanologiques**, 3, 1985.

Politika gjuhësore në disa vise të Jugosllavisë, **Gjuha shqipe**, 1, 1987, Prishtinë.
Agense shqetësuese anticivilizuese e makiaveliste, **Rilindja**, 16.VI. 1990. Ribotuar te Mehmet Emërllahu: **Nyja shqiptare**, Prishtinë, 2001.

Në 80-vjetorin e lindjes së akademik Idriz Ajetit, **Studime**, AShAK, 4, 1997, Prishtinë, 1998.

Për format e diatezave, **Studime**, ASHAK, 4, 1997, Prishtinë, 1998.

Profesor Selman Riza, **Demokracia**, XI, 1999.

Hyri në zgjua të metaforave dhe u bë amëz e tyre, **Jeta e ré**, 1, 2001.

Në 80-vjetorin e lindjes së akademik Shaban Demirajt, **Studime**, ASHAK, 5,6,7, 2001.

Për tri mbaresa vetore, **Dardania sacra**, 3, 2001, Prishtinë.

Për trajtat e përemrave vetorë, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 19, 2002.

Në 70-vjetorin e lindjes së Fehmi Aganit, **Studime**, ASHAK, 8-9, 2001 – 2002.

AKADEMIK SHABAN DEMIRAJ
(1920-2014)

Ndarja nga jeta, pas një sëmundje të rëndë e të gjatë, e akademikut të shquar profesor Shaban Demiraj (1.1.1920 – 30. 8. 2014), është një lajm i hidhur jo vetëm për familjen dhe të afërmit e tij që humbën njeriun e tyre të dashur, por edhe për të gjithë kolegët e tij që humbën një profesor, një bashkëpunëtor të rrallë, një dashamirës dhe mbështetës në veprimtarinë e tyre shkencore, një shembull të madh të përkushtimit ndaj vlerave gjuhësore e historiko-kulturore të kombit shqiptar. Ndarja e tij nga jeta është një humbje për të gjithë botën shkencore e kulturore shqiptare në përgjithësi për shkencat albanologjike në veçanti, të cilave ai u përkushtoi jetën e vet intelektuale dhe veprimtarinë e tij shkencore për më se tre çerekë shekulli. Ai është një nga themeluesit e përparuesit e arsimit të lartë shqiptar dhe të shkencave filologjike shqiptare, personalitet i shquar i arsimit, i gjuhës dhe i kulturës shqiptare, me njohje të gjerë në botën shqiptare dhe në rrethet shkencore albanologjike në botën e jashtme, autor i një vargu studimesh e veprash përgjithësuese në të gjitha fushat e studimit historik e bashkëkohor të gjuhës shqipe, me të cilat kanë mësuar e mësojnë breza të tërë studentësh, studiuesish e profesorësh nga fusha e shkencave filologjike e më gjerë. Kjo trashëgimi e pasur shkencore që ai ka lënë dhe kujtimet e mbresat e paharruara te të gjithë ata që e kanë njohur nga afër, kanë bashkëpunuar me të dhe kanë mësuar prej shembullit dhe veprës së tij, janë një ngushëllim i madh për familjen e të afërmit e tij, për kolegët, për breza të tërë studentësh e studiuesish, për të gjithë ne që po i japim sot lamtumirën e fundit me dhimbje dhe me mirenjohje të thellë për ato që ai ka bërë për gjuhën shqipe e kulturën shqiptare. Vepra, shembulli dhe kujtimi i tij do të jenë gjithmonë pranë nesh e brenda nesh.

Seit MANSAKU

NË KUJTIM TË AKADEMIK SHABAN DEMIRAJT[1]

Më 30. 08. 2014 u nda nga ne njëri prej të merituarve të mëdhenj të shkencës e të kulturës të kombit shqiptar, akademik Shaban Demiraj. Shuarja e tij është humbje e pamatshme për familjen, për miqtë, për shkencën e kulturën, për tërë kombin shqiptar. Shuarja e njerëzve të përmasave të tilla është e rëndë. Por ai mbetet i përjetshëm në veprat që e kanë shpënë dukshëm përpara shkencën dhe që na kanë bërë të gjithëve të ndjehemi krenarë që e kishim.

Ndihmesat shkencore të Shaban Demirajt për studimin e gjuhës sonë të sotme, të shkruar dhe të fazave të saj para shkrimit deri në kohët e mugëta të lashtësisë ballkanike e indoeuropiane, studimet e thelluara krahasuese për shqipen në raport me gjuhët e Ballkanit, për vetë këto gjuhë dhe për gjuhët indoeuropiane, për gjurmët e shqipes në ato rrafshe të largëta, i bëjnë atij vend nderi dhe shkencës sonë i japin prestigj. Veprat e tij i kapërcejnë kufijtë e albanologjisë, shtrihen dhe në fusha të ballkanistikës, të romanistikës, të sllavistikës, etj. Në fushën e historisë së gjuhës ato shënojnë kulmet e shkencës albanistike. Veprat e tij sintetizuese për fonologjinë dhe për gramatikën historike të shqipes, ato për historinë mijëvjeçare të gjuhës sonë, për prejardhjen e për vendin e shqipes ndër gjuhët indoeuropiane e në zhvillimet ballkanike, kanë vendosur një rrafsh të ri në këto studime, prej nga më nuk është e mundur të shkohet më tej pa iu referuar Shaban Demirajt.

Këmbëngulja e pashembullt në punë, fryma e sistematicitetit që shquante mendjen dhe personalitetin e tij, kanë lënë vulë të fuqishme në ndërmarrje të mëdha në këto fusha në mbi 6 dekadat e fundit. Ndër to të përmendim ndihmesat e tij brilante në Kongresin e Drejtshkrimit, në Universitetin e Tiranës, në kreun e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në Këshillin Ndërakademik për Gjuhën Shqipe, në hartimin e Gramatikës së sotme dhe historike e të veprave të tjera sintetizuese autoriale të tij apo kolektive, në formimin e brezave të panumërt të mësuesve e të studiuesve, në jetën shkencore të vendit dhe në veprimtaritë ndërkombëtare shkencore, përtej vështirësive që sillte koha. Të gjitha këto natyrshëm

[1] Fjalë me rastin e vdekjes së akademik Shaban Demirajt.

e bënë atë Mjeshtër të madh të punës, Mësues të popullit, laureat të Çmimit të Republikës. Shkëlqimin e ligjëratave dhe të mendjes së tij kemi pasur rast ta ndjejmë dhe ne studentë e kolegë më të rinj të Universitetit të Prishtinës në kohën e këmbimit intensiv midis dy universiteteve tona në vitet ’70. Drita e mendjes së tij ndjehet kudo, gjurmët e thella të saj shihen gjithandej.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës është e nderuar ta kishte anëtar të saj të jashtëm nga viti 1996, i ka mirëpritur rezultatet e tij dhe krenohet që kishte anëtar Shaban Demirajn. Si Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë ai i ka dhënë mbështetje të fuqishme bashkëpunimit midis dy akademive tona. Projektet, synimet, veprimet e përbashkëta kanë qenë gjithnjë në horizontin e tij. Këmbëngulja në punë, durimi, mirësia, gatishmëria për t’i ndihmuar tjetrit, etika e lartë në shkencë dhe në raportet me të tjerët, atdhetarizmi i urtë, mbahen mend gjithandej në mjediset ku u soll ai.

Shuarja e tij për familjen dhe miqtë është e pakompensueshme. Komuniteti shkencor albanistik po humbet një nishan orientues, por vepra e tij kulmore në shkencë, në kulturë, në arsim e në dije, na mbetet përgjithmonë bazë prej së cilës do të synojnë ngjitjen më tej studimet shkencore, do të frymëzohen brezat. Të gjithë ne bashkë duhet të gjejmë ngushëllim në veprën e madhe që na ka lënë prapa.

Ndihmesat e Shaban Demirajt në fushën e standardizimit të gjuhës shqipe, në gramatologjinë shqipe, aty ku ai ishte autoritet i pakontestueshëm, janë thelbësore jo vetëm për përshkrimin shkencor, po edhe për vendosjen e normës morfologjike për shqipen standarde.

Akademik Shaban Demirajn e shquante vendosmëria dhe serioziteti i skajshëm në punë, frytet e së cilës i kalojnë të gjitha caqet lokale, shtresore e të tjera, për të arritur në piedestalin e njërës nga figurat më të rëndësishme të albanistikës, e me këtë edhe të shkencës në përgjithësi.

Albanolog i jashtëzakonshëm, studiues dhe ndriçues i të fshehtave të shqipes së lashtë, por të shkruar vonë, ballkanolog i dorës së parë, akademik Shaban Demiraj jo vetëm me studimet e tij madhore për shqipen, po edhe me punën dhe rezultatet konkrete dhe krejtësisht të veçanta në përqasjen e gjuhëve ballkanike është ndër figurat e rendit të parë dhe gjithandej të referuara në studimet ballkanistike dhe në shkencën e gjuhësisë së krahasuar indoeuropiane.

E gjithë kjo punë e gjerë, e shumanshme dhe shterruese i ka zgjeruar interesimet e Shaban Demiraj fare natyrshëm dhe gati domosdoshmërisht në dy drejtime: në drejtim të hetimit të fazave të hershme të parashqipes, pra të fazave indo-

evropiane, fare të mugëta dhe krejtësisht vështirë të rindërtueshme për shkak të regjistrimit të vonë të shqipes, në një anë, dhe për shkak të mungesës së afrive më të mëdha të saj me ndonjë grup tjetër të gjuhëve të dëshmuara dhe të njohura indoevropiane; në drejtim të hulumtimit të raporteve të shqipes me gjuhët e tjera ballkanike, qoftë për të shpjeguar proceset komplekse nëpër të cilat kanë kaluar këto gjuhë, qoftë për të sqaruar fenomene të veçanta brenda shqipes.

Në studimet ballkanistike, ku ai ndjek rrugën tashmë të shtruar nga klasikët e saj, Sh. Demiraj ka arritur të krijojë dhe një pasqyrë më të plotë për ballkanistikën nga aspekti i albanistikës. Është vendi dhe rasti këtu të themi se është për të ardhur keq që rezultatet e studiuesve tanë posaçërisht të thelluar në çështje ballkanistike duke filluar nga Çabej, Ajeti, Domi, etj. e deri te sot më të thelluarit Demiraj e Bokshi, nuk i kemi bërë sa duhet të njohura në botë dhe nuk kemi arritur t'i pasqyrojmë në përmasat e cilësisë së tyre në veprat në gjuhë të tjera.

Shaban Demiraj vazhdon të jetë shumë aktiv dhe prodhimtar në albanologji. Vitin që shkoi ai botoi librin vëllimor *Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmive të gjuhës shqipe*, vepër sintezë në të cilën, duke u marrë me çështje kaq themelore të së kaluarës dhe të qenies sonë, ai ka dhënë një pasqyrë të gjerë të studimeve të deritashme në këtë fushë, me shumë detaje dhe shënime bibliografike, për të nxjerrë në pah vazhdimisht ndihmesat e rëndësishme vetiake, po edhe të tjerëve. Në thelb Demiraj me këtë vepër nëpër tërë ecurinë e paraqitjes së saj ka mbrojtur idenë e formuluar mjaft herët në albanologji dhe të shpënë përpara sidomos nga brezi pararendës i albanologëve dhe nga Çabej posaçërisht për vendin e formimit të shqipes në Ballkanin perëndimor dhe afërsisht në hapësirat ku flitet sot dhe pak më gjerë, prandaj edhe për prejardhjen e shqipes nga ilirishtja e jugut. Në këtë drejtim ai ka azhurnuar argumentimet dhe ka ngulur këmbë në diskutimet e gjithanshme, por sidomos në disa pika si emrat e vendeve si Durrës, etj., apo në raportet e parashqipes me gjuhët e asaj kohe.

Rexhep ISMAJLI

Shaban DEMIRAJ

DISA TË DHËNA NGA JETA IME[1]

Kam lindur në Vlorë, sipas dëshmisë së nënës sime, në mars të vitit 1921, por sipas regjistrimit zyrtar më 1 janar 1920, në Mëhallën e Re, (sot Lagjja Partizani). Babai im quhej Sulejman Demiraj, por në popull thirrej Mulla Sulo, sepse shërbente si imam në ish-xhaminë e Tabakëve, e cila u shkatërrua gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Familja jonë ka qenë e lidhur me atë luftë. Prandaj dy vëllezërit e mi të mëdhenj, Aliu dhe Shyqyriu u internuan dhe u vranë nga nazistët gjermanë. Pas Çlirimit ata janë shpallur dëshmorë.

Babai më çoi në shkollën plotore të vetme të Vlorës pa mbushur gjashtë vjeç. Shkolla ndodhej në lagjen Muradije, afër sheshit të Flamurit, pra mjaft larg shtëpisë sonë në Lagjen e Re. Në shkollë shkoja bashkë me dy nipërit e mi, Mustafanë dhe Mynyrin, që ishin ndonjë vit më të mëdhenj se unë. Por më kujtohet se në shkollë veja me qejf, sepse babai më kishte abonuar te një furrxhi afër xhamisë së Tabakëve për të marrë një simite çerek-lekëshe, të cilën e haja thatë me dëshirë aq të madhe.

Mësuesi i klasës së parë mbante llagapin Stringa dhe ka shumë të ngjarë që të ketë qenë nga fisi Stringa prej Elbasani. Në klasën e parë, në të dytën dhe në të tretën, me sa më kujtohet, nuk shkoja aq mirë me mësime, kurse në klasën e katërt nuk kalova dot, sepse vija edhe i imët me shëndet dhe bëja shumë mungesa dhe mësimet më dukeshin të vështira. Vitin tjetër u hap në Vlorë shkolla plotore nr. 2, pak më afër shtëpisë sonë. Aty vazhdova përsëri klasën e katërt me një mësues të shkëlqyer nga Tërbaçi i Vlorës, që quhej Musa Muho. Ai kishte mbaruar Shkollën Normale të Elbasanit dhe ruaj për të përshtypjet më të mira.

---

[1] Ky shkrim me karakter biografik, i hartuar nga vetë autori, është botuar për herë të parë në vëllimin e akteve të konferencës Akademik Shaban Demiraj dhe kontributi i tij në arsimin dhe shkencën shqiptare (bot. Bardhosh Gaçe et al.) Triptik, Vlorë 2011 159vv. Falënderojmë botuesin dhe profesor Bardhyl Demirajn për vullnetin që patën të na jepnin tekstin në këtë formë. (Red.)

Pas Çlirimit të Shqipërisë e takova një herë rastësisht në tren dhe iu prezantova. Me atë rast i kujtova një episod, që ai nuk e mbante mend fare. Një ditë prej ditësh, gjatë orës së mësimit më ngarkoi të veja në shtëpi të tij, që ndodhej afër shtëpisë sonë, me një porosi për të shoqen e tij, që ishte gjithashtu nga lagjja jonë. Me qëllim që kjo të më besonte, hoqi nga gishti unazën e florinjtë të martesës e ma besoi mua. Ky episod mirëbesimi më bëri një përshtypje të jashtëzakonshme. Me Musa Muhon kam mbajtur pastaj letërkëmbim, deri sa vdiq.

Gjatë punës në klasën e katërt me Musa Muhon më duket se edhe unë sikur u poqa mendërisht dhe fillova të kem sukses të madh në mesime duke dalë ndër të parët e klasës. E qysh atëherë e ruajta vazhdimisht këtë përparim në mësime. Në klasën e pestë të shkollës plotore nr. 2 pata fatin të kem një mësues tjetër shumë të mirë me emrin Tahir Hoxha, nga Tragjasi i Vlorës. Ai ishte edhe drejtor i shkollës. Tahir Hoxha kishte studiuar në Shën Mitër Koronë të Kalabrisë dhe ishte shumë mbresëlënës me shpjegimet e tij. Ishte edhe atdhetar i mirë. Më duket se kishte marrë pjesë në Luftën e Vlorës kundër pushtuesve italianë më 1920. U aktivizua edhe në Lëvizjen Antifashiste në fillim të Luftës Nacionalçlirimtare, por më pas u bashkua me lëvizjen kundërshtare, Ballin Kombëtar dhe pas luftës u dënua si kolaboracionist nga gjykata popullore, ku prokuror ishte i biri, Lufter Hoxha, një pjesëmarrës aktiv i Luftës Nacionalçlirimtare. Një djalë tjetër i Tahirit është dëshmor. Kjo është një nga të papriturat e asaj lufte. Unë nuk di se sa fajtor ishte Tahiri, por mbaj mend që ishte njeri me kulturë dhe i ndershëm.

Në klasën e pestë të shkollës plotore mbaj mend të kem pasur shok klase Naum Hondron, nga Vlora. Ai vazhdoi mësimet në Shkollën Tregtare të Vlorës, mori pjesë në Luftën Nacionalçlirimtare dhe pas luftës shërbeu si oficer për çështje kontabiliteti këtu në Tiranë. Me atë konkurroja për vendin e parë në klasë. Ishte një njeri i urtë dhe i dashur dhe me të e ruajta miqësinë, derisa vdiq.

Si mbarova Shkollën plotore pesëvjeçare të Vlorës me përfundime shumë të mira, në shtator të vitit 1932 babai më dërgoi të vazhdoja mësimet në po atë shkollë, ku një vit më parë u diplomua vëllai im i tretë, Vexhiu, d.m.th. në Medresenë e Përgjithshme të Tiranës. Me sa duket, gjendja e tij ekonomike i linte të hapur dy rrugë: Ose të më jepte një zanat, duke më futur si shegert te ndonjë usta, si p.sh. berber, rrobaqepës, këpucar, ose të më dërgonte me bursë në Medresenë e Tiranës, sepse të më mbante në ndonjë shkollë tjetër të mesme, si p.sh. në Shkollën Tregtare të Vlorës, ndoshta nuk kishte mundësi.

Gjithsesi, unë ia di për nder që nuk më la pa shkollë, aq më shumë që në dy klasat e fundit të shkollës plotore kisha dhënë shenja se mund të përparoja mirë në

mësime. Medreseja atëherë kishte shtatë klasa dhe konsiderohej edhe nga shteti si shkollë e mesme, sepse krahas mësimeve fetare atje zhvilloheshin edhe lëndë laike, si gjuhë dhe letërsi shqipe, matematikë, histori, gjeografi etj. Si gjuhë të huaja mësoheshin arabisht dhe anglisht e në dy klasat e fundit edhe pak persisht.

Nga kujtimet që kam prej asaj shkolle, mund të përmend miqësinë e ngushtë, që zura me Xhemil Selamin nga Vranishti i Vlorës. Ai shërbeu disa vjet si mësues dhe pas Çlirimit shërbeu si diplomat në Egjypt dhe Turqi, por vdiq i ri.

Unë e ruaj miqësinë me pasardhësit e tij. Në atë shkollë kisha shoqëri edhe me Qemal Gorishovën, i cili u vra nga fashistët italianë më 1943, sepse ishte i angazhuar në Lëvizjen Nacional-Çlirimtare. Për të nderuar kujtimin e tij emri i tij iu vu një shkolle shtatëvjeçare, por më vonë emri i tij u hoq, sepse ndërtesa e shkollës iu kthye pronarit privat. Mendoj se Seksioni i Arsimit i qytetit të Vlorës duhej t'ia kishte vënë një shkolle tjetër të ngjashme emrin e atij dëshmori, që sakrifikoi jetën për liri në lulen e rinisë.

Pas mbarimit të shkollës ndihesha mjaft i dobët nga tifoja në zorrë, që hoqa në vitin 1939. Pas disa muajsh hoqa edhe një të ftohtë me ujë (pleuritis) në brinjën e majtë, që ma rëndoi edhe më shumë gjendjen shëndetësore. Në të tilla rrethana, duke qenë një barrë për babanë plak, që përveç meje duhej të mbante edhe nënën time si edhe motrën Fetije, m´u desh të gjeja ndonjë punë. Dhe kam shërbyer në punëra të lehta. Dhe puna e vetme, që m'u ofrua më 1940 nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, ishte të veja në Berat si konfencier i fesë islame e kjo përputhej edhe me përgatitjen time shkollore. Kjo ishte një punë e thjeshtë, që kryhej një herë në javë, duke qenë i veshur civil, pra përshtatej edhe me gjendjen time shëndetësore.

Në Berat qëndrova pak kohë (disa muaj) dhe pastaj më transferuan me të njëjtën punë për pak kohë në rrethin e Tiranës. Ndërkaq, unë e shfrytëzova rastin për të plotësuar e thelluar më tej njohuritë e mia e sidomos për të mësuar më mirë italishten, me synimin që të jepja disa provime për të marrë diplomën e gjimnazit. Për këtë qëllim, dikush (nuk e mbaj mend se kush) më bëri të ditur se në Romë ishte një qendër arsimore me emrin Scuole riunite, e cila shpërndante me çmime të përballueshme materiale për lëndët e ndryshme të shkollave të mesme, duke përfshirë edhe latinishten e greqishten e vjetër. Kështu, duke pasur kohë të lirë dhe duke qenë pak më mirë edhe me shëndet, iu futa një pune intensive përgatitore për të gjitha lëndët e liceut klasik. Kjo punë e madhe, që bëra atëherë, më ndihmoi shumë për formimin tim të përgjithshëm, për të cilin kam punuar vazhdimisht duke e konsideruar veten nxënës të përjetshëm. Një interesim të vazhdueshëm

kam treguar sidomos për thellimin e mëtejshëm të njohurive të mia për gjuhët klasike dhe për gjuhët e huaja në përgjithësi. Këtë punë munda ta vazhdoja edhe më me sukses, pas mundësisë, që m'u krijua për të punuar në arsim.

Në vitet '40 të shekullit XX kam jetuar kryesisht në Tiranë, herë me punë e herë pa punë. Në Tiranë më mbajti bujarisht vëllai im i tretë, Vexhiu, i cili atëherë ishte për vete ngushtë ekonomikisht. Për këtë qëndrim dashamirës të atij dhe të së shoqes së tij fisnike, Paqizes, i kujtoj gjithnjë me mirënjohje. Pas njëfarë kohe gjeta një punë të përkohshme pranë një shoqërie tregtare me emrin SASTEB me një rrogë sa për të mbetur gjallë. Pata mundësi të punësohesha si përkthyes në Ministrinë e Kulturës së atëhershme, por nuk pranova.

Në këtë ndërkohë u mora me përkthimin e një libri të vogël anglisht me titull Jeta dhe lundrimet e Kristofor Kolombit, që u botua kundrejt njëfarë shpërblimi nga shtëpia botuese e tiranasit Ismail Malosmani. Përktheva edhe një libër tjetër të vogël me titull Tales from Shakespeare, që përmbante disa nga tragjeditë dhe komeditë më të mira të Shakespeare-it (të përmbledhura në prozë) dhe ia dorëzova për botim librarit Vesim Kokalari. Por libri nuk arriti të botohej, pasi në këtë ndërkohë në Tiranë kishin hyrë trupat partizane dhe Vesim Kokalari u ekzekutua bashkë me disa të tjerë. Para disa vjetësh doreshkrimi im, i shtypur me makinën e shkrimit të Vexhiut, u gjet nga bijtë e të ndjerit Kokalari, që ma dorëzuan mua. Nuk është pa interes të botohet, natyrisht duke i bërë disa përmirësime të karakterit drejtshkrimor.

Gjatë muajve të fundit të pushtimit nazist gjerman familja ime në Vlorë u bë objekt përndjekjeje për shkak të mbështetjes së Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe si rrjedhim dy vëllezërit e mi të mëdhenj, Aliu dhe Shyqyriu, sikurse e përmenda edhe më sipër, u internuan dhe u zhdukën. Si rrjedhim, qëndrimi im në Tiranë u bë i rrezikshëm me ardhjen e disa forcave balliste këtu nga Vlora. Prandaj vendosa të largohesha nga Tirana dhe e rregullova të veja në Peshkopi, ku forcat partizane atje më pritën mirë dhe më caktuan të punoja si sekretar pranë komandës ushtarake të atij qyteti.

Pra, çlirimi i Shqipërisë më gjeti në qytetin e Peshkopisë. Por nga fundi i dhjetorit të vitit 1944 më njoftuan se më kishte vdekur babai në Vlorë. Më vonë mora vesh se, për të më lajmëruar mua, ishte interesuar me telefon miku i babait tim, Dr. Sezai Agalliu, i cili i kishte shërbyer babait tim si mjek deri në vdekje. Prandaj m´u desh të largohesha nga Peshkopia për në Vlorë, duke udhëtuar më së forti në këmbë me shokë të rastit. Në Vlorë, pas vdekjes së babait dhe pas zhdukjes së dy vëllezërve të mëdhenj, i gjeta njerëzit në kulmin e mjerimit nga

ana shpirtërore dhe ekonomike. Prandaj nuk qëndrova gjatë atje dhe u ktheva me mjete të rastit në Tiranë. Këtu gjeta mirëkuptim dhe më futën po në atë punë në ish-Ministrinë e Kulturës, që pak kohë më parë nuk e kisha pranuar. Ministria e Kulturës atëherë ndodhej në një ndërtesë ministrore pranë Ushtarit të Panjohur te Sheshi Skënderbej. Atëherë atje ishte ministër Sejfulla Malëshova dhe sekretar i përgjithshëm Shefqet Musaraj. Në fillim më ngarkuan me punë të rëndomta, por pas pak kohe, me që dija disa gjuhë të huaja, më caktuan të punoja si përkthyes nga anglishtja dhe frëngjishtja në Agjensinë Telegrafike Shqiptare. Kjo agjenci atëherë funksiononte në nja dy dhoma në katin e sipërm të ministrisë. Por më pas u zgjerua dhe u transferua në një ndërtesë në anën e djathtë të Bulevardit Zogu I e më pas në një vilë dykatëshe në të majtë të ndërtesës, ku ndodhet sot Universiteti i Tiranës.

Agjensia Telegrafike Shqiptare, ku unë punova tre vjet e gjysmë, atëherë drejtohej nga Thanas Nanoja dhe unë gjeta atje tre përkthyes shumë të aftë, punëtorë e shumë të sjellshëm: Petro Konomin, Beqir Çelën nga Lushnja dhe Koço Seminin nga krahina e Korçës. Mjerisht, që të tre këta njerëz aq të mirë përfunduan keq, të akuzuar si armiq. Petro Konomin me origjinë nga shqiptarët e Egjyptit e kishte dërguar i ati në Shqipëri para vitit 1939 për të kryer shërbimin ushtarak, por, për shkak të Luftës II Botërore ai nuk mundi të kthehej më në Egjypt dhe prandaj jetonte tek xhaxhai i tij (kasap) këtu në Tiranë. Lushnjari Beqir Çela u transferua shpejt në një punë tjetër para vitit 1948, d.m.th. kur unë isha ende në Agjensinë Telegrafike Shqiptare dhe më pas u dënua me vdekje si armik. Edhe Petrua u largua nga Agjensia Telegrafike pas vitit 1948 dhe u pushkatua bashkë me disa të tjerë, të akuzuar se kishin hedhur një bombë në ish-ambasadën sovjetike. Edhe Koço Semini, që ishte larguar vetë nga Agjensia Telegrafike, më pas u arrestua dhe u dënua me burgim të përjetshëm. Me sa munda t´i njoh unë, ata ishin njerëz të mirë dhe korrektë.

Në nëntor të vitit 1946, u hap në Tiranë e para shkollë e lartë shqiptare, Instituti Pedagogjik dyvjeçar me drejtor Dhimitër Shuteriqin. Atje pranoheshin edhe studentë me korrespondencë dhe një ndër këta të fundit isha edhe unë. Në atë kohë shumë shokë të mi ishin dërguar për studime në ish-Bashkimin Sovjetik dhe në vende të tjera ish-socialiste. Por unë as që bëra ndonjë përpjekje të isha midis atyre të privilegjuarve, sepse më duhej të mbaja edhe nënën edhe motrën, së cilës, i ishte vrarë i fejuari, Qemal Gorishova.

Gjithsesi unë u regjistrova në Institutin Pedagogjik si pa qejf në degën e gjuhës e të letërsisë shqipe. Me që ligjëratat e pedagogëve atje atëherë zhvilloheshin pasdrekeve, unë pata mundësinë të asistoja në një pjesë të mirë të tyre, sepse

e rregullova që në Agjensinë Telegrafike të punoja më fort paradrekeve. Në ligjëratën e parë dëgjova zërin mbresëlënës të Profesor Kostaq Cipos, i cili më la një përshtypje shumë të mirë. Ligjëratat e Cipos dhe të profesorëve të tjerë, si Aleksandër Xhuvani, Dhimitër Shuteriqi, Eqrem Çabej, Mahir Domi etj, më bënë që ta ndiqja me dëshirë atë degë, ku kisha shok, ndër të tjerë, edhe Qemal Haxhihasanin nga Elbasani, i cili punonte edhe si sekretar i atij Instituti. Ai më vonë punoi në Institutin e Folklorit duke u bërë një ndër folkloristët më të mirë të vendit tonë. Ai ishte një njeri shumë i sjellshëm dhe i dashur, por mjerisht vdiq në një moshë relativisht të re dhe kujtimi i tij është nderuar nga qyteti i Elbasanit, duke i vënë emrin e tij një shkolle të atij qyteti.

Pra, duke punuar njëkohësisht si përkthyes në Agjensinë Telegrafike Shqiptare dhe si student pa shkëputje nga puna, më 1948 e mbarova Institutin Pedagogjik me nota shumë të mira. Në shtator të atij viti Ministria e Arsimit më emëroi mësues të letërsisë në gjimnazin e vetëm të Tiranës. Por drejtori i Agjencisë Telegrafike nuk pranoi me asnjë mënyrë që unë të largohesha prej asaj agjencie, ku kishte shumë punë dhe pak përkthyes. Prandaj unë vazhdova punën atje. Mirëpo pas një jave i njëjti drejtor më thirri në zyrën e tij e më lexoi një urdhër të prerë të kryeministrisë, sipas të cilit unë duhej të shkoja urgjentisht në gjimnazin e Gjirokastrës, sepse atje kishte vdekur papritmas mësuesi i letërsisë shqipe. Atëherë unë banoja në një dhomë, që më kishte lëshuar vëllai im bujar, Vexhiu, bashkë me nënën plakë dhe uloke, të cilën nuk mund ta merrja me vete. Në këtë ndërkohë edhe motra Fetije ishte martuar me Ahmet Kondon.

Por urdhri i qeverisë ishte i pakundërshtueshëm. Prandaj, u detyrova të shkoja në Gjirokastër në shtator a tetor të vitit 1948, duke e lënë këtu nënën vetëm nën kujdesin e vëllait. Por ajo parapëlqeu të shkonte tek e bija, e cila mund t´i shërbente më mirë në gjendjen e saj si plakë uloke. Pranë gjimnazit të Gjirokastrës atë vit u hap edhe klasa e parë e shkollës pedagogjike. Prandaj mua m´u desh të jepja letërsi shqipe dhe të huaj jo vetëm në katër klasat e gjimnazit, por edhe në klasën e parë pedagogjike. Kuptohet vetiu se ç'punë e madhe duhej bërë për të përballuar gjithë atë ngarkesë mësimore, sidomos po të kihet parasysh që unë nuk kisha fare përvojë pedagogjike.

Gjithsesi, mund të pohoj se me një punë të jashtëzakonshme arrita ta mbyll me sukses vitin e parë shkollor, falë edhe përgatitjes sime sidomos në fushën e letërsisë botërore, që zinte një vend të madh në programet mësimore të gjimnazeve të asaj periudhe. Edhe nga ana ekonomike më ndihmoi fakti që fjetjen dhe ushqimin e kisha falas, sepse më caktuan të shërbeja edhe si kujdestar konvikti, punë kjo që kufizohej me praninë time në orët e studimit të nxënësve konviktorë

pasdarkeve gjatë përgatitjeve të tyre për mësimet e së nesërmes. Kurse për të fjetur mua dhe tre kolegë të tjerë na caktuan falas një dhomë konvikti më vete. Nga kolegët e atij viti shkollor ruaj kujtime të mira sidomos për mësuesin veteran dhe patriot Thoma Papapano dhe për mësuesin e matematikës,Thoma Harilla nga Korça. Ruaj kujtime të mira gjithashtu edhe për nxënësit e sjellshëm dhe punëtorë të asaj shkolle, ndër të cilët mund të përmend sidomos Dritëro Agollin, Panajot Bogan e Vedat Islamin të klasës së parë pedagogjike, Rushit Bezhanin, Thoma Kriston (të klasës së katërt gjimnaz).

Më duket se jam ndër të parët, në mos i pari, që kam zbuluar talentin e Dritëro Agollit si shkrimtar i ardhshëm. Dritëroi, nga Devolli i Korçës, kishte një pamje fshatarake, që s´ta mbushte syrin. Por qysh në hartimin e parë, që organizova me klasën e tij, ai më bëri një përshtypje shumë të mirë dhe qysh atëherë lidha me të një miqësi, që e ruaj edhe sot e gjithë ditën.

Në Gjirokastër qëndrova vetëm një vit shkollor, sepse vitin tjetër, duke qenë se nëna nuk kishte mundësi të lëvizte nga Tirana, më transferuan në Politeknikumin 7 Nëntori të Tiranës, ku ishte drejtor një arsimtar i vjetër, i ditur dhe i sjellshëm me emrin Gjergj Canco. Aty më ngarkuan të jepja letërsi shqipe dhe të huaj në klasat e para dhe të treta të shkollës, kurse në klasat e dyta dhe të katërta këto lëndë i jepte Leonard Kraja, i diplomuar në Itali. Me Nardin, i shoqi i këngëtares së mirënjohur Maria Kraja, u bëmë miq, por nga fundi i jetës ai u sklerozua.

Pas një viti më transferuan në ish-Institutin e Shkencave, me sa duket me sugjerimin e prof. Kostaq Cipos, i cili kishte pasur përshtypje të mira për mua gjatë provimeve në Institutin Pedagogjik. Ish-Instituti i Shkencave e kishte selinë në ish-shtëpinë e nënës e të motrave të ish-mbretit Zog, afër Bibliotekës Kombëtare (të vjetrës). Profesor Cipua, një njeri largshikues dhe dashamirës, për gjashtë muaj më ngarkoi të shfletoja literaturën albanologjike të Bibliotekës Kombëtare, punë që më shërbeu shumë për pasurimin e njohurive të mia albanologjike.

Por në këtë punë nuk më lanë gjatë, sepse nga nevoja për arsimtarë më transferuan në Shkollën Pedagogjike të Tiranës. Në atë kohë arsimi kishte nevojë shumë për kuadro dhe nuk mund të kundërshtoje. Por nga ana tjetër, kthimi në arsim më ndihmoi për të mënjanuar rekrutimin si ushtar, rrezik që nuk m´u nda, deri sa mbusha moshën 29-30 vjeç. Madje, edhe kur isha në Gjirokastër më 1949, zyra ushtarake kërkoi të më rekrutonte, por edhe atë vit ndalohej rekrutimi i arsimtarëve, që ishin të paktë.

Pra, shkova në Shkollën Pedagogjike, ku më ngarkuan të jepja letërsi

shqipe dhe të huaj në klasat e treta dhe në disa klasa të dyta, kurse në disa klasa të para dhe në disa klasa të dyta jepte mësim Petër Elezi, një mësues veteran dhe njeri shumë i mirë nga Elbasani, ndërsa në disa klasa të para jepte mësim Vasil Vinjau, një mësues veteran dhe shumë i njerëzishëm. Në klasat e katërta më parë jepte mësim Ziaudin Kodra, i diplomuar në Itali dhe njohës i mirë i letërsisë arbëreshe dhe pas largimit të tij për në Institutin Pedagogjik e zëvendësoi Dhurata Xoxe, e shoqja e shkrimtarit Jakov Xoxe, e diplomuar në Bullgari. Ziaudin Kodra ishte edhe drejtor i shkollës pedagogjike, ndërsa Vasil Vinjau shërbente si nëndrejtor. Pas largimit të Ziaudin Kodrës drejtor i shkollës u bë Sinan Tafaj, i diplomuar në Bashkimin Sovjetik për psikologji-pedagogji. Me të gjithë këta kolegë kam pasur marrëdhënie miqësore, deri sa vdiqën.

Në janar të vitit 1954 më morën si asistent pranë katedrës së gjuhës shqipe të Institutit Pedagogjik, me sa duket me sugjerimin e prof. Zijaudin Kodrës, megjithëse unë atëherë kisha vetëm diplomën e Institutit Pedagogjik dyvjeçar. Në këtë rast ndoshta mund të ketë ndikuar edhe fakti që në vitin 1953 unë kisha botuar në tre numra të revistës Buletin i Institutit të Shkencave një studim të gjatë për gjuhën e Jul Varibobës, një punim ky që në përgjithësi u prit mirë dhe edhe sot mund ta nënshkruaj. Instituti Pedagogjik atëherë ndodhej në ish-ndërtesën e Gjimnazit të Tiranës (afër stacionit të trenit), që më vonë u zgjerua Por më 1957, kur u themelua Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë u transferua në një ndërtesë të re në rrugën e Elbasanit, ku është edhe sot.

Puna e re shënoi një fazë të re në jetën time. M´u dha mundësia që të jepja provimet plotësuese për të marrë diplomën e Institutit Pedagogjik 4-vjeçar dhe të marr përsipër studime shkencore të tjera, që erdhën duke u shtuar nga viti në vit. Këto nuk është rasti t´i përmend këtu, sepse janë pasqyruar pothuaj gjerësisht në Bibliogafinë e punimeve të mia. Por nuk mund të lë pa përmendur qëndrimin dashamirës të kolegëve të mi, sidomos të profesorëve Zijaudin Kodra dhe Mahir Domi. Me këtë të fundit, që vdiq para disa vjetësh, kam pasur një bashkëpunim miqësor të pandërprerë. Ky ishte një tip shumë i qetë dhe i vetëpërmbajtur dhe kishte një kulturë të gjerë albanologjike dhe njihte disa gjuhë të huaja, sidomos frëngjishten dhe gjuhët klasike, latinishten dhe greqishten e vjetër. Ishte edhe shumë punëtor, por mjerisht nuk ka lënë prapa një trashëgimi të tillë shkencore, që pritej nga një ish-nxënës i shkëlqyer i Liceut francez të Korçës, i diplomuar në Francë. E kjo ndoshta do shpjeguar me faktin se ai ishte qejfpaprishur dhe merrte përsipër çdo detyrë drejtuese administrative, që i ngarkohej dhe ishte i gatshëm të ndihmonte çdo njeri, që i kërkonte ndihmë.

Transferimi im në ish-Institutin e Lartë Pedagogjik u shoqërua edhe me një

ndryshim në gjendjen time familjare. Pas shumë ngurrimesh më në fund vendosa të fejohesha me një ish-nxënësen time të shkollës pedagogjike, Fatimen, e bija e Isuf Saraçit, me ndërmjetësinë e një kushëririt të saj, Osman Saraçit, me të cilin kisha bashkëpunuar në shkollën politeknike 7 Nëntori. U martuam në maj të vitit 1954 dhe jetonim në një dhomë, që na kishte vënë në dispozicion motra ime dhe i shoqi i saj, Ahmeti, në shtëpinë e tyre me qira afër Pazarit të Ri. Në atë dhomë banonim bashkë me nënën, kur u ktheva nga Gjirokastra, sepse dhomën, që na kishte vënë në dispozicion vëllai im, Vexhiu, e kishte zënë një ushtarak pas largimit të nënës sime që andej, kur unë u transferova në Gjimnazin e Gjirokastrës.

Pas martesës sime nëna u detyrua të flinte në një dhomë tjetër të Ahmetit. Dhoma, ku flinim ne, ishte e veçuar pranë portës së shtëpisë dhe atje minjtë hynin e dilnin si në shtëpi të tyre. Për më tepër, nevojtorja ishte larg dhe pa kanalizim. E në të tilla kushte banimi mua më është dashur të punoj për t´u përgatitur për ligjëratat në Institut e për të përgatitur edhe ndonjë shkrim me makinën e vjetër të vëllait tim aq dashamirës, Vexhiut. Më kujtohet se në atë kohë kisha nisur, ndër të tjera, edhe të përktheja romanin Martin Iden të shkrimtarit amerikan Jack London, që u botua më 1956. E po në atë dhomë të vjetër kam shkruar edhe një numër artikujsh dhe veprash, derisa gjithnjë falë përkrahjes së Vexhiut më 1961 më dhanë një shtëpi me dy dhoma e një kuzhinë në rrugën e Kavajës, afër sheshit 21 dhjetori, ku u vendosa me gjithë familjen, që atëherë përbëhej prej pesë vetësh, unë, gruaja, nëna, Eglantina (dl. 1955) dhe Bardhyli (dl. 1958). Eglantina flinte në dhomën e pritjes dhe atje banoi, derisa u martua me Agim Brucin më 1982, kurse Bardhin e vumë të flinte në kuzhinë bashkë me nënën time plakë, e cila vdiq në vitin 1964.

Gjithsesi, në shtëpinë e re e ndjenim veten shumë më mirë se në atë dhomën e vetme afër Pazarit të Ri. Por në vitin 1988 bëmë një gabim të pafalshëm. Atëherë, me që Bardhyli ishte martuar dhe priste një fëmijë, ish-dekani i fakultetit, Ali Xhiku, një njeri shumë fisnik, më kishte dhënë një apartament me një dhomë e një kuzhinë në ndërtesën, ku banojmë sot (në rrugën Margarita Tutulani), të ndërtuar nga fakulteti. Unë i sugjerova djalit që të shkonte e të banonte ai atje me gjithë nusen, por ai nguli këmbë që të mos ndahej nga ne. Dhe kështu vendosëm që ta këmbenim shtëpinë tek 21 Dhjetori me një apartament (një dhomë e një kuzhinë) pranë apartamentit të dhuruar nga fakulteti. Në këtë mënyrë jo vetëm që humbëm një dhomë, por edhe u larguam nga një shtëpi shumë e mirë. E një gjë e tillë ndodhi më 1988, d.m.th. pak kohë, para ngjarjeve të vitit 1990.

Por le t´i kthehemi veprimtarisë sime pedagogjike e kërkimore. Kur u transferua Fakulteti ynë në Rrugën e Elbasanit, bashkë me të punonte edhe Instituti i

Historisë dhe i Gjuhësisë dhe dekani Stefanaq Pollo ishte njëkohësisht edhe drejtor i Institutit. Por disa vjet më vonë Instituti u shkëput nga fakulteti dhe u vendos në një ndërtesë tjetër në një rrugicë të rrugës së Kavajës. Atëherë m´u ngarkua mua drejtimi i katedrës së gjuhës shqipe, që më parë drejtohej nga prof. Mahir Domi, i cili ishte njëherazi edhe shef i sektorit të gjuhës shqipe të Institutit, Unë e drejtova katedrën, derisa dola në pension në vitin 1990. Pedagogët efektivë të katedrës ishin të paktë dhe pikërisht: Anastas Dodi, Stefan Prifti, Fatmir Agalliu, Thoma Rushi e më pas edhe Et-hem Likaj dhe Rami Memushaj. Kishim edhe disa ndihmës-pedagogë për mësimin e gjuhës shqipe studentëve të huaj dhe pikërisht: Lumni Radovicka, Zana Daci, Ana Golemi, Donika Londo, Abedin Faja etj. Por vazhduan të jepnin mësim si pedagogë të jashtëm Prof. Mahir Domi, Androkli Kostallari dhe Jorgji Gjinari. Në përgjithësi bashkëpunimi midis katedrës sonë dhe sektorit të gramatikës të Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë ka qenë mjaft i mirë. Madje, organizoheshin pranë Institutit në bashkëpunim me katedrën tonë edhe diskutime shkencore për probleme të caktuara të gjuhës shqipe dhe të historisë së saj.

Unë në fillim zhvilloja lëndën e Morfologjisë së Gjuhës së Sotme Shqipe. Pastaj mora përsipër edhe Gramatikën Historike të shqipes, sepse prof. Mahiri u përqendrua në lëndën e sintaksës dhe në problemet e sektorit të tij në Institut. Por, para se të merrja përsipër zhvillimin e lëndës së Gramatikës Historike, m´u desh t´i futesha studimit të gjuhëve ballkanike. Më parë u mora me rumanishten e pastaj me maqedonishten e bullgarishten, greqishten e re e serbishten, por njëkohësisht vazhdova të merresha edhe me rusishten, sepse literatura gjuhësore dhe metodat për mësimin e gjuhëve ballkanike etj, në atë kohë, mund të gjendeshin kryesisht në gjuhën ruse. Për mësimin e rumanishtes më ndihmoi edhe qëndrimi im (bashkë me Jorgji Gjinarin etj.) në Rumani (pak më shumë se një muaj). Nga gjuhët ballkanike arrita të mësoja më mirë rumanishten, të cilën më parë arrita me ca vështirësi edhe ta flisja. Edhe maqedonishten arrita ta mësoja relativisht mirë, të paktën për të lexuar vepra gjuhësore të shkruara në atë gjuhë.

Më pak përparim pata në mësimin e bullgarishtes dhe të greqishtes së re, sepse nuk u kushtova edhe aq shumë kohë. Por literaturës së nevojshme për greqishten e vjetër dhe latinishten i kam kushtuar vëmendjen e duhur vazhdimisht. Gjatë qëndrimit në katedër u interesova edhe për spanjishten dhe portugalishten, por këtë të fundit nuk arrita ta mësoj, ashtu siç nuk arrita të mësoj edhe sanskritishten, për të cilën gjeta një metodë jo edhe aq të mirë. Studimin e këtyre gjuhëve të huaja e kam ndier vazhdimisht të nevojshëm për të thelluar njohuritë e mia në fushën e Gramatikës dhe të Fonetikës Historike të Gjuhës Shqipe. Njohja

pak a shumë mirë e gjuhëve ballkanike më ndihmoi edhe për të marrë përsipër zhvillimin e një kursi special për gjuhësinë ballkanike në vitet tetëdhjetë të shekullit XX, derisa dola në pension. Madje, vjetët e fundit u përqendrova vetëm në Gramatikën Historike dhe në Gjuhësinë Ballkanike, kurse Morfologjinë e Shqipes së Sotme e mori përsipër Et-hem Likaj, të cilin unë e mora në katedër edhe për arsye se njihte gjermanishten, sepse kishte studiuar ca kohë në Gjermani në një degë tjetër, para se të ndiqte degën e gjuhës e të letërsisë shqipe pranë fakultetit tonë pas prishjes së marrëdhënieve të Shqipërisë me ish-Republikën Demokratike Gjermane, të drejtuar nga komunistët.

Unë kisha shumë dëshirë që të përgatitja sa më mirë një pasardhës, që të vazhdonte e të thellonte më tej studimin e historisë së gjuhës shqipe. Por ai u dha më shumë nga ç'duhej pas punëve administrative, duke arritur të bëhej edhe rektor i Universitetit të Tiranës. Megjithatë, ai ka botuar disa punime sidomos nga fusha e gramatikës historike, duke ndjekur kryesisht metodën e profesorit kosovar Besim Bokshi, i cili mbron tezën se gjuha shqipe (a më saktë nëna e saj) në një fazë të caktuar të evolucionit të saj e humbi sistemin e lakimit emëror, por rikrijoi prapë më vonë sistemin e lakimit, që ka sot. Në një recension të gjatë të botuar në Studime filologjike unë e kundërshtova një tezë të tillë, duke vënë në dukje, ndër të tjera, se asnjë nga gjuhët indoeuropiane, që e kanë mënjanuar sistemin e lakimit emëror të trashëguar, nuk kanë ndier (dhe nuk kishin përse të ndienin) nevojë për të rikrijuar një sistem të ri lakimi. E këtë qëndrim e kam përsëritur edhe në veprën time Gramatikë Historike e Gjuhës Shqipe (1986), e cila në një formë më të përmbledhur u botua edhe gjermanisht nga Akademia e Shkencave e Austrisë më 1993.

Hartimin gjermanisht të këtij botimi e kam bërë vetë me ca vështirësi, sipas kërkesës së palës austriake gjatë një vizite në Vjenë me ftesë të Institutit të Sllavistikës për të mbajtur nja dy ligjërata gjermanisht atje në vitin 1989. Me atë rast, u njoha me akademikun austriak me origjinë çeke, Frantishek Maresh, i cili ma bëri një propozim të tillë gjatë një dreke. Unë e prita i habitur një propozim të tillë dhe premtova se do t´u dërgoja një kapitull të kësaj vepre, për të mësuar edhe mendimin e tyre nëse gjermanishtja ime ishte në rregull. Prof. Mareshi nuk vonoi të më përgjigjej se gjithçka ishte në rregull dhe unë të vazhdoja punën.

Pasi e përfundova këtë vepër gjermanisht dhe ia dërgova Prof. Mareshit, gjatë vitit 1989 mora përgjigjen se vepra po shqyrtohej në Komisionin Ballkanik të Akademisë së Austrisë për të siguruar fondet e botimit të saj. Dhe në prill të vitit 1990 mora një letër të nënshkruar nga akademiku austriak me origjinë kroate Katiçiq, i cili edhe në emër të akademikut austriak Solta më shkruante, ndër të

tjera, se botimi i një vepre të tillë do të jetë i dobishëm për shkencën dhe nder për Akademinë. Një vlerësim i tillë, merret me mend, ka shënuar një nga çastet më të lumtura të jetës sime. Dhe edhe sot, kur i rikujtoj ato çaste, ndiej një kënaqësi të madhe. Kjo vepër u botua në Vienë më 1993.

Por në fund të dhjetorit të vitit 1990 më thirri ish-dekani i atëherëshëm i Fakultetit. Arkile Bërxolli, i cili më njoftoi se sipas rregullave të Ministrisë së Arsimit unë duhej të dilja në pension, pasi kisha mbushur moshën 70 vjeç dhe më pyeti se ç´mendoja për këtë. Unë iu përgjigja se rregullat janë një për të gjithë dhe se s´kisha asnjë vërejtje. Natyrisht, që nuk më erdhi mirë, sepse një njoftim i tillë ma prishi sadopak humorin e mirë, që më kishte shkaktuar lajmi i gëzueshëm nga Austria. Për më tepër, në atë kohë unë po përgatitja për shtyp edhe librin Gjuhësi ballkanike.

Gjithsesi, në janar të vitit 1991 nuk isha më efektiv i fakultetit dhe dola në pension me 7.000 lekë të reja në muaj, Por ai pension atëherë ishte shumë më i mirë se pensionet e sotme. Prandaj mund ta vazhdoja jetën normalisht me pensionin tim dhe me atë të gruas sime. Punën pedagogjike e vazhdova edhe një semestër, për të përfunduar kursin e Gjuhësisë Ballkanike, që zhvilloja. Pastaj i ndërpreva krejt marrëdhëniet me katedrën e gjuhës shqipe, e cila nuk tregoi më asnjë interesim për të më aktivizuar. Përkundrazi, me përjashtim të Rami Memushajt, me të cilin jemi edhe komshi, pedagogët e tjerë të asaj katedre, ish-studentë të mi, pothuajse nuk u kujtuan fare as për ndonjë përshëndetje me telefon. Përkundrazi, bashkëpunimin me sektorin e Gramatikës të Institutit të Gjuhësise e të Letërsisë, të drejtuar më parë nga Mahir Domi dhe më pas nga Seit Mansaku e vazhdova pa ndërprerje, falë qëndrimit miqësor të punuesve të atij sektori, sidomos të prof. Seit Mansakut, që u bë edhe kryeredaktor i revistës Studime filologjike, ku unë kam bashkëpunuar vazhdimisht me artikuj shkencorë.

Në këtë ndërkohë, pasi përfundova librin mbi gjuhësinë ballkanike aty nga viti 1992, u interesova që ta botoja atë nëpërmjet fakultetit, ku kisha punuar për më shumë se 35 vjet, por nuk gjeta asnjë mbështetje. Atëherë u detyrova ta botoja në Shkup falë përkujdesjes së mikut tim të atjeshëm, prof. Remzi Nesimit. Libri u botua në vitin 1993 me interesimin e katedrës së Gjuhës e të Letërsisë shqipe pranë universitetit të Shkupit nëpërmjet shtëpisë botuese Logos A. Përurimi i këtij libri u bë dy herë në Shkup në vitin 1994, herën e parë nga katedra e gjuhës shqipe dhe herën e dytë nga katedra e gjermanistikës (për versionin maqedonisht të përkthyer nga prof. Haki Ymeri). Në të dy herët shkova bashkë me gruan dhe na pritën shumë mirë.

Në maj (?) të vitit 1993 më thirri kryeministri i atëhershëm, prof. Aleksandër Meksi, i cili më propozoi që të merrja përsipër detyrën e kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, anëtar i së cilës isha pranuar në vitin 1989. Ky propozim më befasoi dhe pas ngurrimit tim dhe premtimeve të rastit nga ana e ish-kryeministrit më në fund pranova. Pas vdekjes së kryetarit të mëparshëm, prof. Aleks Budës, ky post kishte mbetur vakant dhe drejtohej nga zëvendësi, prof. Hekuran Mara. Por kryesia e mëparshme u shfuqizua nga qeveria e Partisë Demokratike, që erdhi në pushtet dhe atje ishin emëruar dy zëvendëskryetarë, prof. Ylli Vejsiu dhe prof. Petrit Skënde, me sekretar të përgjithshëm shkencor prof. Emin Rizën. Ata ishin profesora universiteti, por jo anëtarë akademie. Ishin njerëz me kulturë dhe të arsyeshëm. Ylli Vejsiu ishte edhe deputet i Partisë Demokratike. Edhe Emin Riza u bë deputet i asaj partie për pak vjet. Në kryesinë e re vetëm unë isha pa parti, sepse anëtarësimin në çfarëdo parti as që e kam dashur kurrë ...

Megjithëse e kuptova lojën, unë dhe kolegët e mi morëm pjesë në ceremoninë e rastit, ku u prezantua kryesia e re e Akademisë me kryetar prof. Ylli Popën, nënkryetarë prof. Luan Omarin dhe prof. Kristo Frashërin dhe sekretar shkencor prof. Fahrudin Hoxhën. Kjo funksionoi si kryesi e përkohshme, derisa pas ndonjë viti e gjysmë u bënë zgjedhjet e reja të kryesisë së Akademisë. Por në këtë ndërkohë ishin bërë edhe zgjedhjet për anëtarë të rinj të Akademisë, në të cilat prof. Kristo Frashëri nuk fitoi votat e nevojshme dhe atëherë ai dha dorëheqjen si nënkryetar dhe qysh atëherë kryesia e Akademisë zgjodhi në vend të tij prof. Fahrudin Hoxhën, dhe në vend të këtij si sekretar shkencor u caktua prof. Eduard Sulstarova. Unë atëherë dola përsëri në pension, që ishte qesharak, megjithëse pak më vonë, pa ndonjë kërkesë nga ana ime, më përfshinë ndër personat me pension të posaçëm, që pak ndyshim kishte nga pensioni i zakonshëm.

Por për hir të së vërtetës më duhet të pohoj se qeveria e re mbajti një qëndrim më të favorshëm ndaj Akademisë, duke u caktuar të gjithë anëtarëve të Akademisë pa përjashtim një rrogë të posaçme, që erdhi duke u përmirësuar. Edhe fondi për botimet shkencore erdhi duke u përmirësuar. Mjafton të përmend këtu se gjatë kohës që isha kryetar i Akademisë unë nuk munda të botoja asnjë vepër me fondet e kësaj. Veprat e mia të asaj periudhe u botuan jashtë shtetit (Gramatika Historike gjermanisht dhe gjuhësia ballkanike – shih më sipër). Në Tiranë m'u botua vetëm Fonologjia Historike e Gjuhës Shqipe me ndihmën bujare të fondacionit SOROS më 1996. Kurse pas dorëheqjes sime u botuan me fondet e Akademisë veprat Prejardhja e shqiptarëve në dritën e dëshmive të gjuhës shqipe (1999), Gramatikë Historike e Gjuhës Shqipe – një version i përmbledhur

(2002), Gjuhësi ballkanike (ribotim - 2004), The origin of the Albanians, linguistically investigated (2006) etj.

Gjatë kësaj periudhe kam vazhduar bashkëpunimin tim në revistat e Akademisë Studime filologjike dhe Studia Albanica. Edhe qëndrimi i drejtuesve të rinj të Akademisë ndaj meje ka qenë korrekt. Natyrisht, ka pasur edhe raste që qëndrimi im ka qenë i ndryshëm nga ai i atyre. Mjafton të përmend këtu që unë kam qenë kundër ndryshimit të nenit të statutit të Akademisë, sipas të cilit kryetari nuk duhej të zgjidhej dy herë, sepse puna administrative e pengon atë në punën e tij kërkimore. Por ai nen fatkeqësisht u ndryshua dhe si rrjedhim stafi drejtues i ri i Akademisë qëndroi më shumë se dhjetë vjet. E kjo ndoshta ka qenë një nga arsyet që qeveria e re e kryesuar nga Sali Berisha qysh nga viti 2005 vendosi ta reformojë Akademinë, duke ia hequr institutet kërkimore, që ishin në varësi të saj nën pretekstin se duhej ndryshuar modeli i tipit të Akademisë sovjetike.

Pavarësisht nga qëndrimi i ri zyrtar (jo i drejtë) kundrejt Akademisë dhe instituteve të saj kërkimore, qëndrimi i të njëjtëve njerëz në drejtimin e Akademisë ishte i dëmshëm jo vetëm për punën e saj, por edhe për vetë ata. Dhe në të vërtetë drejtuesit e Akademisë u kthyen në administratorë të thjeshtë pa ndonjë veprimtari shkencore të denjë për anëtarët e Akademisë. Sigurisht, në këtë rast ka ndikuar edhe fakti që ata janë specialistë fushash, ku është vështirë të nxjerrësh vepra shkencore të nivelit akademik. P.sh. kryetari prof. Ylli Popa është një mjek kardiolog shumë i mirë, por ç´vepër shkencore mund të bënte ai në këtë fushë dhe në moshën e tij të thyer? E kjo vërejtje vlen edhe për një pjesë të mirë anëtarësh të Akademisë, që kanë punuar në universitet si profesorë matematike, gjeologjie, fizike etj., d.m.th. në fusha, ku është vështirë të japësh ndonjë ndihmesë të re në moshë të thyer dhe pa bazën e nevojshme laboratorike.

Një e metë tjetër në punën e Akademisë sonë ka qenë mungesa e kërkimit të llogarisë ndaj vetes dhe ndaj instituteve vartëse për një prodhimtari sa më të frytshme shkencore në të gjitha fushat, që ajo dhe institutet e saj mbulonin. Me një kërkesë llogarie të vazhdueshme mund të ishin bërë më shumë punime nga sa janë kryer. E kjo vërejtje vlen edhe për institutet albanologjike, ku prodhimtaria shkencore ka qenë relativisht më e pasur, por jo aq e frytshme.

Por edhe qëndrimi i ri zyrtar ndaj Akademisë dhe instituteve kërkimore ishte i nxituar dhe i pamenduar si duhet. Dhe këtë mendim unë ua kam shprehur hapur autoriteteve të kryeministrisë si edhe presidentit të Republikës, Bamir Topit, në takimet e një grupi akademikësh me ta. Sipas këtij qëndrimi të ri, Akademia jonë e Shkencave nuk duhet të ketë institute kërkimore, për t´u kthyer

kështu gjoja në një akademi të tipit perëndimor, d.m.th. për t´u desovjetizuar. Në të vërtetë, edhe në vendet kapitaliste perëndimore ka pasur dhe ka akademi me institute kërkimore, si p.sh. në Austri etj. Prandaj, ky ishte një pretekst për të përligjur një qëndrim, që po çon drejt shkatërrimit të traditës tashmë të krijuar për zhvillimin e kërkimeve shkencore në vendin tonë.

Për këtë qëllim më thirrën mua në Kryeministri dhe më propozuan që ta drejtoja unë kryesinë e përkohshme të Akademisë, por unë nuk pranova, duke paraqitur si arsye gjendjen time shëndetësore dhe moshën e thyer si edhe dëshirën që t´u përkushtohesha hulumtimeve shkencore. Pastaj caktuan një ekip të ri të kryesuar nga prof. Teki Biçoku. Sipas shtypit, qeveria ka vendosur që vetëm tre anëtarë nga akademikët aktualë mbi moshën 75 vjeç do të mbeten akademikë me të drejta të plota, kurse të tjerët u nxorën në pension e një ndër këta isha edhe unë që e prita këtë njoftim me botimin e veprës sime të re kushtuar kryesisht Epirit dhe me dhënien për një ribotim të përmirësuar dhe me shënime të veprës së Gavril Darës, Kënga e sprasme e Balës, që e mori përsipër shtëpia botuese private Dituria.

Për zgjedhjen e këtyre tre akademikëve të përjetshëm u tha se do të vendoste Asambleja e re e Akademisë, që do të përbëhej nga ata të paktë anëtarë aktualë me moshë nën 75 vjeç dhe nga anëtarët e rinj të zgjedhur a më saktë të emëruar nga një komision i përbërë prej nëntë vetësh, ndër të cilët edhe katër të huaj pa ndonjë emër të spikatur. Të shohim se ç´do të bëhet. Ndër anëtarët e rinj të zgjedhur bie në sy më fort që ata në pjesën më të madhe janë të mbështetur nga partia demokratike në pushtet, megjithëse ka midis tyre edhe ndonjë që e meriton-te. Sot (18.XII.2008) mësova se Asambleja e re e Akademisë ishte mbledhur dhe kishte vendosur që unë dhe Teki Biçoku të ishim anëtarë të përhershëm të Akademisë. Për anëtarin e tretë, që nuk fitoi votat e nevojshme, do të vendosej më vonë. Unë qysh nga prilli i vitit 2008 financiarisht jam në pension, që nuk më ka dalë i keq në krahasim me pensionet e zakonshme, pasi përfitoj, ndër të tjera, edhe një pension special të mëparshëm. Për më tepër, me vendim qeverie, ne akademikët pensionistë marrim edhe një shpërblim mujor të veçantë prej 450 lekësh të reja, shumë kjo vetëm pak më e vogël nga ajo e pensionit, kështu që pensioni im mujor është gati sa rroga mujore, që merrja, para se të dilja në pension.

Ndërkaq, unë, pa marrë parasysh se ç´do të bëhet me ne pleqtë, do të përpiqem të vazhdoj punën time shkencore, që nuk ka të sosur. Deri tashti, me kërkesën e kryesisë së mëparshme të Akademisë, kam përgatitur për ribotim librin kushtuar jetës dhe veprës së Eqrem Çabejt, që doli nga shtypi me rastin e 100-vjetorit të lindjes së atij gjuhëtari të shquar.

Me rastin e 100-vjetorit të Kongresit të Manastirit doli nga shtypi më 2008 edhe ribotimi i monografisë për atë kongres, që kemi përgatitur e botuar edhe nja tri herë më parë bashkë me Kristaq Priftin. Po përgatit edhe një ribotim të plotësuar të librit tim Gjuha shqipe dhe historia e saj, që u botua nga Universiteti i Tiranës më 1988 dhe u ribotua një vit më vonë edhe në Prishtinë e në vitin 1997, u botua edhe italisht nga Universiteti i Kozencës me titullin La lingua albanese – origine, storia, strutture, përkthyer italisht nga unë vetë. Ky është një libër, që është pritur mirë dhe kërkohet. Nuk di nëse do të jem në gjendje të filloj hartimin e një monografie pak a shumë të gjerë për Mesapët e Italisë dhe gjuhën e tyre, të krahasuar me shqipen. Kjo ka qenë një dëshirë e vjetër imja dhe për këtë qëllim kam grumbulluar edhe një material faktik relativisht të pasur. Por në këtë ndërkohë jam marrë me punime të tjera dhe e kam lënë pas dore këtë temë, për të cilën kam botuar vetëm dy artikuj, një shqip në revistën Studime filologjike në vitin 2000 dhe një tjetër italisht në një përmbledhje studimesh të botuar në Itali më 2002 për nder të studiuesit arbëresh Antonino Guzzetta. Të dhënat e këtyre dy artikujve i kam paraqitur edhe në kreun e fundit të librit tim të vitit 2008: Epiri, pellazgët, etruskët dhe shqiptarët.

Ndërkaq, vërej me keqardhje se interesimi për hulumtime shkencore të mirëfillta në përgjithësi dhe në fushën e albanologjisë në veçanti sa vjen e bie jo vetëm për arsye të degradimit të nivelit të përgatitjes nëpër universitet tona, por edhe për mosinteresimin e qeverive për të financuar hulumtimet shkencore, që kërkojnë patjetër një mbështetje financiare shtetërore sidomos tashti që interesimi për kërkime shkencore ka rënë.

Në këtë ndërkohë qeveria vendosi që të bëheshin zgjedhjet e drejtuesve të rinj të Akademisë. Dita e zgjedhjeve u caktua për më 08. 02. 2009. Per kryetar të Akademisë u paraqitën tre kandidatë, nga të cilët fitoi matematikani Gudar Beqiraj, ish-nënkryetar i përkohshëm i Akademisë dhe nënkryetar u zgjodh Muzafer Korkuti, ish-drejtor i Institutit të Arkeologjisë, kurse sekretar shkencor i Akademisë u zgjodh prof. Salvadore Bushati.

Më 3 prill 2009, rreth orës 06 të mëngjesit, kur po bëhesha gati për t`u rruar në dhomën e pritjes, u pengova pa dashur afër bibliotekës dhe pësova një aksident të rëndë në anën e brendshme të pjesës se sipërme të kofshës së këmbës së majtë. Në këtë këmbë kisha pësuar edhe dy herë të tjera aksidente nga makinat në rrugë më 1994 thyerje kocke dhe më 2004 shëmbje. Herën e parë iu nënshtrova një operacioni 3-4 orësh në spitalin ushtarak nga një ekip mjekësh (prof. Karagjozi, prof. Panajot Boga dhe prof. Evi Gjika). Por në të dy rastet, pas një kohe jo edhe aq të gjatë e mora veten mirë, veçse herën e dytë m´u desh të mbaja një shkop,

kur ecja në rrugë.

Pas aksidentit të fundit në shtëpi më shtruan përsëri në spitalin ushtarak të Tiranës, ku më operoi prof.. Evi Gjika. Operacioni i rëndë u krye me sukses dhe pas pak ditësh më kthyen në shtëpi, ku për rreth 5 muaj pothuaj nuk lëvizja dot nga shtrati as për nevojat e domosdoshme, për të cilat më ka shërbyer sidomos gruaja, Fatimja e në fillim edhe çupa, Eglantina e madje edhe dhëndëri, Agimi. Gjatë asaj periudhe edhe lëvizja më e vogël më shkaktonte dhembje në kofshën e operuar, por këto dhembje erdhën duke u lehtësuar sidomos pas muajit të pestë, kur fillova edhe të lëvizja nëpër shtëpi dhe të shkoja vetë në banjë me ndihmën e një këmbaleci. Por dhembjet, kur eci, ndonëse të pakësuara vazhdojnë dhe më pengojnë për të lëvizur pak më lirshëm e kjo gjendje pothuajse më ka bllokuar për të vazhduar punën e ndërprerë shkencore.

235. Rreth qiellzorëzimit të bashkëtingëlloreve grykore në gjuhën shqipe [Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare në përkujtim të albanologes ruse A. V. Desnickaja, në Sant Petersburg, maj 1997]. Studime filologjike, nr. 1-2, 2001, f. 5-13. (Përmbledhje anglisht).

236. Arbën/Arbër. Historia e Popullit Shqiptar I. Tiranë, Toena 2002, f. 346-348.

237. Ç'na kujton e ç'na mëson 28 Nëntori i vitit 1912. [Fjala e mbajtur në mbledhjen solemne të zhvilluar në Vlorë me rastin e 90-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë. në nëntor 2002 – 2 faqe dorëshkrim]

238. Fjala e mbylljes në Konferencën shkencore me temë: Vlora në rrjedhën e kohës. Në Buletin Shkencor nr. 2, .f. 371-372. Universiteti Teknologjik. Ismail Qemali Vlorë.

239. Gavril Dara. Jeta dhe vepra. [Studim i përgatitur për parathënien e re të librit Kënga e Sprapme e Balës] (17 faqe dorëshkrim).

240. Gjuha letrare shqipe e njësuar dhe çështja e paskajores. Konferenca shkencore Gjuha

letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot. Tiranë 20-21 nëntor 1992. Tiranë 2002, f. 56-59.

241. Il rapporto tra conservazione e innovazione nella lingua albanese. Variazioni linguistiche in albanese. A cura di Addolorata Landi. Pubblicazioni dell' Universita degli studi di Salerno, f. 25-42. Napoli. Edizioni Scientifiche Italiane, 2002.
242. Ku dhe kur është formëzuar etnosi arbëresh (shqiptar). [Kumtesë e mbajtur në Konferencën shkencore me temë: Vlora në rrjedhë të kohërave]. 'Buletini shkencor nr. 2. prill 2002, f. 3-10. [Universiteti Teknologjik Ismail Qemali, Vlorë]
243. Mesapët dhe gjuha e tyre. Përgatitur brenda vitit 2002 dhe dërguar për botim në revistën e Universitetit Teknologjik Ismail Qemali, Vlorë (6 faqe dorëshkrim).
244. Ndihmesa e Joklit në përcaktimin e kronologjisë së disa dukurive të vjetra të gjuhës shqipe. [Kumtesë e mbajtur në Simpoziumin ndërkombëtar kushtuar N. Joklit në Shkodër, qershor 2002] (4 faqe dorëshkrim).
245. Romanizimi në Europën Juglindore. Kohëzgjatja, përmasat dhe pasojat. [Bisedë e zhvilluar në Akademinë e Shkencave më 2002] (12 faqe dorëshkrim).
246. Sull'origine dei Messapi. = Mbi origjinën e mesapëve. Studi in onore di Antonino Guzzeta. Cattedra di Lingua e Letteratura Albanese. Universitá di Palermo, Helix media Editore, Palermo 2002. f. 131-135.
247. Shoqëria nuk mund të përparojë pa zhvillimin e gjithanshëm të arsimit, kulturës dhe shkencës. Ligji dhe jeta, nr. l. 2002, f. 37-40.
248. Rreth disa çështjeve thelbësore të shqipes standarde [Kumtesë e mbajtur në Konferencën Kombëtare të Gjuhës Shqipe. Nëntor 2002]. Studime filologjike, nr. 3-4, 2002, f. 37-42.
249. Rreth disa ndihmesave të rëndësishme të Milan Shuflajit në fushën e albanologjisë. [Kumtesë e mbajtur në Konferencën ndërkombëtare për Shuflajin në Tiranë në vitin 2002].
250. V. Cimochovski rreth dy risive në sistemin emëror të shqipes. Studime filologjike, nr. 1-2, 2002, f. 103-109. (Përmbledhje anglisht).
251. Rreth disa ndihmesave të Milan Shuflajt në fushën e albanologjisë. Studime filologjike, 1-2, 2003, f. 81-87.
252. Rreth autorësisë së poemës Kënga e sprasme e Balës. Studime filologjike, 3-4, 2003. f. 63-74.
253. Rreth huazimeve turke në gjuhën shqipe. Studime filologjike, 3-4, 2004, f. 19-28.
254. Kongresi i alfabetit të gjuhës shqipe dhe vendi i tij në kulturën shqiptare, (në bashkëpunim me Kristaq Priftin). Studime filologjike, 3-4, 2008. f. 5-16.
255. Rreth emrave të fshatrave të Dropullit e të Vurgut dhe të banorëve të tyre gjatë shekujve. Studime filologjike, 1-2, 2008, f. 73-90.

KRITIKA

RECENSIONE

Eqrem ÇABEJ: **Studime etimologjike në fushë të shqipes**, **Bleu V (K-M),** SHB Çabej, Tiranë 2014, 478 f.; ISBN 978-99956-35-20-6

Consummatum est ~ u kompletua! Me këtë reagim të parë përcolli shkruesi i këtyre radhëve kumtin fatlum, që shtëpia botuese Çabej hodhi këto ditë në treg bleun e pestë të opusit postum Studime etimologjike në fushë të shqipes me autor gjuhëtarin dhe eruditin shqiptar Eqrem Çabej (1908-1980). Kompletohet kështu pas një rrugëtimi për thuajse katër dekada trashëgimia shkencore 7-vëllimëshe e Eqrem Çabejt në atë fushë të shkencave gjuhësore albanologjike, me të cilën identifikohet tashmë vetë emri i tij.

Konsiderata të përgjithshme

Ky vëllim prej 478 faqesh, i rudaktuar dhe përgatitur për shtyp prej prof. Seit Mansakut, dr. Anila Omarit, si edhe Brikena Çabejt, bijës së të ndjerit Eqrem Çabej, shtjellon historinë dhe etimologjinë e asaj pjese të fondit leksikor të gjuhës shqipe që nis me shkronjat K - L - LL - M. Teksti origjinal i autorit (f. 5-392) ndiqet prej fjalësit shqip dhe atij të gjuhëve të tjera, që janë marrë në vështrim gjatë analizave gjuhësore (f. 393-478) dhe përmbyllet me një faqe të fundit të panumëruar me një pasqyrë të treguesit të gjuhëve me numrat e faqeve përkatëse, që lehtësojnë kërkimin në këtë rubrikë. Ndryshe nga vëllimet e mëparshme, mungon në këtë vëllim për fat të keq një përmbledhje e zgjeruar frengjisht e përfundimeve të arritura prej autorit gjatë shqyrtimit të lemave në tekstin origjinal[1].

Siç mësojmë edhe nga vëzhgimi i thukët redaksional që i prin punimit (f. 3), lemat që përfshihen në këtë vëllim: me disa përjashtime, autori nuk arriti t'i shtjellonte e zgjeronte ato ashtu si ato të shkronjave A-F [deri te fjala *flutur*: bl. II-IV - B.D.], të cilat edhe janë redaktuar nga vetë autori. Pjesës tjetër të etimologjive shqipe, sikurse edhe ato që përfshin ky vëllim, autori, për fat të keq, nuk arriti t'u jepte dorën e fundit. Një numër i vogël syresh është botuar në fakt edhe më parë në formë studimesh të numëruara me shifra romake dhe me titullin e përbashkët *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe* në revistat albanologjike Buletin i Universitetit të Tiranës. Seria Shkencat Shoqërore (1960-1963) dhe Studime filologjike (1964-1968), duke u ribotuar më pas edhe në vëllimet I dhe II të kolanës 8-vëllimshe Studime gjuhësore (Prishtinë 1976-) me autor Eqrem Çabejn. Gjithsesi

[1] Me redaktimin fillestar të këtij vëllimi, sikurse edhe me hartimin e përmbledhjeve shqip është marrë intensivisht përgjatë viteve 1987-1988 edhe shkruesi i këtyre radhëve.

nuk mund të lemë pa përmendur këtu që pjesa më e madhe e lemave me shkronjat nistore K - L - LL - M botohet për herë të parë në këtë vëllim të ri.

Po të ndalemi paraprakisht disi më gjatë në vëzhgimin redaksional lidhur me dallimin ndërmjet lemave të (pa)plotësuara dhe/ose të (pa)redaktuara për botim nga vetë autori, e bëjmë këtë me qartësuar lexuesin se ky dallim nuk ka të bëjë aspak me koherencën e veprës, jo aq edhe me shkallën e përditësimit të saj me materialin (e ri) leksikor të shqipes apo me literaturën shkencore të botuar deri në gjallje të autorit. Ai ka të bëjë më fort me gjerësinë e trajtimit të historisë së fjalëve si edhe me syzimet mbi etimonet e një numri fjalësh të lashta, të cilave autori sigurisht që ka dashur t'u rikthehej më vonë.

Një studim statistikor i materialit gjuhësor shqip të mbledhur dhe hetuar në këtë vëllim na lejon të fitojmë paraprakisht një përshtypje të parë mbi përmasat e pazakonshme të studimeve etimologjike të Çabejt, që dallojnë në gjithë historinë e zhbillimit të albanologjisë si shkencë komplekse rajonale. Duke u ndalur paraprakisht vetëm te ky vëllim, vërejmë se bëhet fjalë për një korpus lemash prej gjithë-gjithë 1776 njësish (= K 910 + L 304 + LL 35 + M 527), ndërkohë që korpusi i fjalëve shqipe në varietetin e tyre dialektor e shkrimor, të shpërndarë në kohë dhe hapësirë rezulton të jetë në këtë vëllim thuajse 4 herë më i madh: me 6657 njësi. Trajtimi i një leme të veçantë varjon nga referimi i thjeshtë në një rresht të vetëm (: gjithsej 282 lema) – d.m.th. për të mësuar mbi shqyrtimin e saj etimologjik në bashkëlidhje me një tjetër lemë, që i takon në shumësinë e rasteve së njëjtës çerdhe leksikore – e deri te disa faqe, p.sh. lema *mal* (f. 274-276), *mbath* (f. 298-300) etj.

Një studim kritik i të gjitha zgjidhjeve që shtrohen për diskutim në vëllim, e për më tepër nxjerrja në pah e arritjeve dhe vlerave njohëse të tij është vështirë të bëhet brenda një artikulli të shkurtër recensional. Prandaj do të mjaftohemi në vazhdim me disa konsiderata të përgjithshme lidhur me organizimin e korpusit lematik në vëllim, me metodologjinë e hartimit të lemave të veçanta, me synimet e autorit në vepër si edhe me një statistikë të rezultateve etimologjike të arritura në të.

Organizimi i fjalorit

Siç e cekëm shkurt edhe më lart vepra ka si objekt studimi thesarin leksikor mbarëdialektor, dialektor e krahinor të gjuhës shqipe, të mbledhur, të përpunuar e pjesërisht të përfunduar e redaktuar prej vetë autorit në gjallje të tij. Njësitë leksikore grupohen në çerdhe leksikore të veçanta. Analizës gjuhësore diakronike, përkatësisht hetimit etimologjik përkatës, i nënshtrohen përgjithësisht ato njësi që qëndrojnë në bazë të secilës çerdhe. Më shpesh trajtohen si lema të veçanta fjalë të parme e huazime, dmth. ato njësi që sipas rregullave të fjalëformimit produktiv ose joproduktiv të gjuhës shqipe nuk janë më të zbërthyeshme në njësi më të vogla, p.sh. *kafshë, kalb, kam, lajthi, llom, (i) madh, motër, mulli* etj. Raste të tjera, që dëshmojnë shmangie të forta dialektore, zakonisht vetëm regjistrohen sipas radhës alfabetike së bashku me kumtimin e lemës përkatëse, ku lexuesi mund të marrë indormacion më të hollësishëm, p.sh. *larth* pranë *lerth*; *las* pranë *llazinë*; (dial.)

kthenj, këthej e me metatezë *thkej* për *kthej* (me gjithë çerdhen e saj leksikore, si *kthim, kthinë, kthesë, kthenjë* etj.), e bashkëlidhur kjo brenda gjuhës me *këcej* e variantet e saj dialektore, si: *kathej, gathej, gdhej* etj.

Si lema të veçanta shqyrtohen edhe një numër (pseudo)fjalësh, të regjistruara në ndonjë fjalor, doracak dialektor apo të nxjerra nga ndonjë vepër letrare, egzistenca e dikurshme e të cilave ose përdorimi i tyre në formën e dhënë është më se i dyshimtë, por që shpesh janë bërë objekt i studimeve të mëparshme etimologjike, p.sh. *lone* për sh. këlyshë (f. 242), të cilën G. Meyer-i e gjen në shkrimet e Thimi Mitkos, por që për Çabejn kemi të bëjmë aty thjesht dhe vetëm me gabime shkrimi ose regjistrimi. Një kujdesi të veçantë i nënshtrohen me këtë rast edhe disa fjalë të pazakonshme, në kuptimin që dalin vetëm te një autor, sidomos kur ky është i njohur për ndërtime të reja fjalësh, siç është p.sh. rasti i (arb. It.) *l'ëfarinj* me kuptimin përhap vetëm në veprën e De Radës e që për Çabejn nuk mund të shpjegohet ndryshe përpos një sajimi të vetë autorit. Krahas fondit leksikor, autori bën objekt të studimit historik edhe një numër makro- e mikrotoponimesh në hapësirën jetike dhe atë të diasporës shqiptare, etnonime të ndryshme, emra personash, shenjtorësh e familjesh etj., si p.sh. *Mborje, More,* (em. fam.) *Muzaki, lab,* (*Shën*) *Mëhill* etj., sigurisht pa i vënë vetes aspak si detyrë specifike mbledhjen dhe hetimin e tyre ballor.

Organizimi i lemave të veçanta

Çdo lemë i nënshtrohet shqyrtimit diakronik-etimologjik sipas një metodologjie të përcaktuar mirë. Autori prezanton fillimisht lexuesin me mendimin albanologjik të deri-atëhershëm, tezat e ndryshme që janë hedhur për diskutim me përkrahësit dhe kundërshtarët e tyre. Në rastet kur etimoni i fjalës është më se i qartë, autori e tumir menjëherë atë, pa munguar të saktësojë edhe autorësinë e atij etimoni, dhe shpesh duke shtuar edhe literaturën shkencore më të rëndësishme, që është shkruar rreth tij. Gjithsesi nuk janë të pakta edhe rastet kur kjo rubrikë mungon, pasi fjala është vjelë dhe shqyrtohet për herë të parë nga vetë autori, p. sh. (dial.) *mavzer* m. lloj pushkeprej gjerm. *Mauser* si emri i konstruktorit të saj; (dial.) *kikë* f. jele e kalit < serb.-kr. *kìka*, bullg. *kika* gërshet etj.

Në një rubrikë të veçantë trajtohen përhapja dhe variantet dialektore të njësisë në shqyrtim, çerdhja e saj leksikore, kuptimet dhe shmangiet kuptimore nga njëri dialekt në tjetrin, nga një e folme në tjetrën, të pajisura të gjitha këto me literaturën përkatëse ose me shënimin e emrit të indormantëve. Jo më pak interes ka për autorin edhe përdorimi i njërës apo tjetrës njësi në letërsinë e vjetër shqipe të shekujve XVI-XVIII. Shestimi i arealit gjuhësor për çdo njësi dhe saktësimi i qerthullit të kuptimeve e lejon autorin të syzojë me siguri fazat e shkallëshkallshme të evolucionit historik të fjalës, duke përcaktuar si kuptimin themelor, ashtu edhe formën primitive të fjalës bazë, që i takojnë asaj periudhe kohore, kur shqipja nuk ishte ndarë ende përfundimisht në dy dialekte (shek. IV-VII e.j.). Njësitë ose çerdhet leksikore me përhapje dialektore të rrudhur i nënshtrohen analizave diakronike të veçanta, ku autori saktëson, nëse kemi të bëjmë këtu me fjalë a çerdhe fjalësh

të përftuara brenda njërit dialekt, me huazime apo me relike gjuhësore të një faze më të hershme, kur fjala ishte pronë e mbarë shqipfolësve. E tillë është p.sh. (tosk.) *mëllë,-ri* pranë (geg.) *mullâ,-ni* bullungë në trup të njeriut a shtazës, të cilën Çabej, ndryshe nga përsiatjet e mëparshme etimologjike, e bashkon në një çerdhe leksikore me *mullë* bark, stomak, si një ndërtim i hershëm augmentativ më *-an* brenda shqipes, bash në një periudhë që i paraprin zhvillimit të dukurisë së rotacizmit në dialektin toskë (shek. VI-VIII).

Interpretimi i brendshëm i zhvillimit kuptimor dhe formal të fjalës e lejon autorin të përzgjedhë me më shumë siguri njërën apo tjetrën tezë të shtruar për diskutim ose të ndjekë një rrugë të vetën në kërkim të marrëdhënieve të tjera etimologjike. Për shembëllzim le të përmendim këtu emrin e drurit (të afërt me vidhin) *mëllezë* Ostrya carpinifolia pranë dy varianteve të tjera dialektore *mëllënjë, mullenjë,* të cilin Çabej, ndryshe nga disa pararendës të tij, nuk e ndan brenda shqipes me emrin e zogut të *mëllenjë*-s, duke i afruar të dyja me bazën e përbashkët kuptimore (ngjyrë) e zezë, e errët e si të tillë e ndeshim edhe në terminologjinë baritore si *mëllenjë, mullenjë* për të shënuar një dhi a dele me gëzof të zi.

Rezultate të studimit etimologjik

Pa dashur të ndalemi në më shumë hollësi domethënëse që mundëson leximi sqimatar i veprës, mund të përmbledhim në mënyrë po aq domethënëse rezultatet etimologjike të arritura për lemat e marra në shqyrtim në këtë vëllim, të cilat po i rreshtojmë të klasifikuara si më poshtë:

fjalë vendi:	K 217	L 122	LL 7	M 156	= 502
latinizma:	K 76	L 26		M 57	= 159
romanizma/dalmatizma:	K 6	L 1			= 7
italianizma (venecianizma):	K 90	L 18		M 28	= 136
fjalë rumune/arumune:	K 6	L 1		M 3	= 10
neologjizma/frengjisht:	K 7			M 3	= 10
ballkanizma/mesdhetare:	K 3	L 2	LL 1		= 6
greqizma te vjetra:	K 8	L 1		M 8	= 17
greqizma te reja/bizantine	K 98	L 28	LL 4	M 50	= 180
sllavizma:	K 90	L 29	LL 11	M 50	= 180
turqizma:	K 108	L 18	LL 5	M 80	= 211
fjalë cigane:	K 1	K 2			= 3
neologjizma/gjermanisht				M 2	= 2
neologjizma/anglisht	K 1				= 1
pa shpjegim:	K 43	L 20		M 7	= 70
Referime	K 156	L 38	LL 7	M 81	= 282
Shuma	K 910	L 304	LL 35	M 527	= 1776

Pasqyra e mësipërme na jep një imazh të plotë dhe të saktë të raportit *trashëgim ~ huazim* në leksikun historik dhe në atë dialektor-bashkëkohor të shqipes. Mund të shtojmë gjithashtu që për shumë njësi që i takojnë fondit të trashëguar indoevropian të shqipes autori tenton edhe rindërtimin e formave bazë të fjalës, edhe pse nuk e ka bërë këtë objekt qendror të hulumtimit të tij. Synimi kryesor i autorit, që ndiqet me konseguencë gjatë gjithë veprës, është bash shtjellimi i historisë së çdo njësie leksikore në dhe gjatë periudhës së formëzimit historik të shqipes dhe të etnosit shqiptar, qëmtimi i shtresave të leksikut të shqipes, duke veçuar fondin e trashëguar indoeuropian nga ai i huazuar, krehja e leksikut të huazuar dhe shtresimi i tij në kohë dhe hapësirë, saktësimi i marrëdhënieve gjuhësore të shqipes në rrethin e gjuhëve fqinjë si edhe përcaktimi i vendit dhe i rolit të etnosit shqiptar në historinë e Gadishullit Ballkanik.

Duke përfunduar, pohojmë se vepra shumëvëllimëshe e Eqrem Çabejt me titull tejet modest *Studime etimologjike në fushë të shqipes* është sintezë e debatit albanologjik shqiptar dhe të huaj deri në fund të viteve 70-të të shekullit të kaluar. Ajo ngërthen në vetvete një fjalor të mirëfilltë historik dhe etimologjik të gjuhës shqipe, i cili tejkalon në çdo pikë fjalorët e doracakët e derisotëm etimologjikë të kësaj gjuhe (Meyer 1881; Tagliavini 1935; Huld 1984; Demiraj 1997; Orel 1998). Vëllimi i porsadalë në qarkullim dëshmon rishtas që aktiviteti shkencor i Eqrem Çabejt sendërton bashkëlidhjen sa optimale, aq edhe unikale të formimit shkencor-intelektual me intuitën në hetimin etimologjik e sidomos me përkushtimin për të njohur, mbledhur, krehur, studiuar dhe sistematizuar në mënyrë ballore e në thellësi të gjithë thesarin leksikor të gjuhës shqipe. Janë pikërisht këto dhunti të aktivitetit shkencor-intelektual së bashku angazhimin e tij social e atdhetar, që përcollën kolosin e shkencave albanologjike qysh në gjallje të vet drejt kupolës së mëndimit shkencor-intelektual shqiptar të të gjitha kohërave, ndërsa fjalori i tij etimologjik – *konsummatum est*! – ruan e do të ruajë si gjithherë vlerën e një objekti studimi të amëshuar, që vështirë se do t'i mungojë dikur studiuesit albanolog serioz në tavolinën e tij të punës.

Bardhyl DEMIRAJ

Shaban DEMIRAJ**: Gjuha shqipe dhe historia e saj,** botime Onufri, Tiranë, 2013.

Studimet mbi historinë e gjuhës shqipe përfaqësojnë një traditë solide që ka pasur me vite me radhë si objekt studimi çështjet e gjenezës së gjuhës dhe të popullit shqiptar, autoktoninë dhe vijimësinë e ekzistencës në të njëjtat troje të njërit prej popujve më të lashtë në arealin ballkanik dhe atë evropian.

Këto studime kanë kërkuar përherë një veshje apo një kontekstualizim të domosdoshëm historik dhe social, sa herë që nëpërmjet tyre dhe disiplina të tëra të kësaj fushe të gjerë të studimeve humane janë përfshirë, ndihmuar dhe mbështetur nga gjetjet apo diskutimet përkatëse.

Vepra *Gjuha shqipe dhe historia e saj* e Shaban Demirajt shënoi një arritje për ecurinë e gjurmimeve në fushë të trajtimit të mjaft problemeve që nuk përfshinë vetëm aspektin gjuhësor apo dhe të sqarimit të thjeshtë të historisë së një dukurie, të disa dukurive apo të regjistrave të caktuar gjuhësorë të shqipes.[1]

Vështrimi i gjuhës sonë si një gjuhë me origjinë i.e. mbi bazë tiparesh që e afrojnë studimin e saj me të tjera gjuhë që kanë pasur dokumentim më të hershëm shkrimor, mbetet ndër trajtesat më origjinale të punimit të Shaban Demirajt. Të tilla trajtesa jo vetëm e vënë shqipen në një plan vështrimi të përafërt me gjuhë të tjera të kësaj familjeje, por dhe plotësojnë qasje të niveleve themelore, ndër të cilat spikatin aferitë gjenetike sa i përket tipologjisë së shfaqjeve të disa dukurive të nënsistemeve të caktuara gjuhësore si dhe regjistri leksikor që përfshin pikërisht ato elemente që merren parasysh në çdo manual mbi gjuhësinë indoevropiane, historinë e gjuhëve të Evropës dhe vetë gjuhët indoeuropiane.[2]

Karakteri konservator në drejtim të disa tipareve drejton vëmendjen ndaj natyrës së evolucionit të shqipes, të dallueshëm nga gjuhë të tjera të së njëjtës familje tek të cilat të njëjtat tipare nuk mund të gjurmohen a të konstatohen në të njëjtën shkallë shfaqjeje apo ruajtjeje.Ky evolucion merret parasysh në disa krerë të punimit, në veçanti dhe kur bëhet fjalë për modifikimin e kategorive të caktuara gramatikore, ndër të cilat eptimi emëror dhe

[1] Demiraj Sh., *Gjuha shqipe dhe historia e saj,* Shtëpia botuese e librit universitar, Tiranë, 1988.

[2] Shih në veçanti Kreun *Shqipja gjuhë indoeuropiane*, në *Gjuha shqipe dhe historia e saj, botim i dytë i ripunuar*, Tiranë, 2013, f.56-66. Trajtimi i tipareve konstitutive si sistemi tri gjinish (mashkullore, femërore, asnjanëse); sistemi rasor i modifikuar në krahasim me sistemin e supozuar të indoeuropianishtes; supletivizmi i foljeve i pranishëm në të njëjtat folje dhe në gjuhë të tjera të vjetra i.e.(greqishtja e vjetër, latinishtja), tipare të tjera më specifike të pranishme në eptimin emëror dhe atë foljor mbeten rastet më tipike të qasjes së shqipes me këto gjuhë të familjes gjuhësore i.e.; shih Demiraj Sh., *Albanese; Il sistema nominale;* në Ramat P., Ramat A.G., *Le lingue indoeuropee,* Il Mulino, Bologna, 1994, f.517.

ai foljor i shqipes.[3]

Evidentimi i fenomeneve që vënë në dukje qasje herë të pjesshme, herë më të veçuara sa në shqipen sa në gjuhë të tjera të familjes gjuhësore i.e., i jep veprës një perspektivë të domosdoshme drejt studimeve në fushë të gjuhësisë i.e. dhe përbën njëkohësisht një prej kontributeve më të vyera të autorit në këtë punim shkencor.[4]

Këtij vështrimi i bashkangjiten trajtesa mbi shqipen si gjuhë ballkanike si dhe vënia në dukje e disa tipareve të veçanta të saj, përftimi i të cilave mendohet të jetë kryer gjatë evolucionit historik të shqipes pikërisht në sistemin fonetik dhe strukturën gramatikore.[5]

Gjuha shqipe përbën një faktor që duhet marrë parasysh në çdo studim që ka për objekt fazat më të hershme të historisë së gjuhëve ballkanike, gjuhëve të arealit adriatik e në veçanti atij jugor, areal në të cilin dhe janë shkëmbyer që në antikitet kultura e elemente qytetërimi mes popujve të këtyre viseve.

Ndaj në çdo trajtesë a studim të kësaj natyre, artikuluar në kapituj që synojnë të trajtojnë si problematikën themelore të sqarimit të origjinës së kësaj gjuhe ashtu dhe traditën e studimeve që në mënyrë të pashmangshme paraqet dhe mospërkim pikëpamjesh e përfundimesh, kontekstualizimi i çdo dukurie të rëndësishme gjuhësore në një kornizë të natyrës historike dhe sociokulturore mbetet një prirje e studimeve tona në lidhje me këto argumente,konkretizuar më së miri dhe në punimin e profesor Shaban Demirajt.[6]

Të tilla fakte i dëshmojnë më së miri dhe kapitujt në të cilët janë marrë me radhë në bazë të një kriteri kronologjik sipas depërtimit dhe prejardhjes së mundshme huazimet apo elementet me origjinë greke, latine si dhe ato sllave e turke. Në veçanti trajtimi i greqizmave me shtresëzimet përkatëse sipas vetë historisë së gjuhës përkatëse dhe i huazimeve latine me të gjitha proceset fonetike që i karakterizojnë ato, mbetet një ndër argumentet më

---

[3] Për një trajtim sintetik të çështjeve të ruajtjes dhe modifikimit të mundshëm të disa kategorive gramatikore në sistemin foljor të shqipes shih Demiraj Sh., *Albanese; Il sistema verbale*, në Ramat P., Ramat A.G., *Le lingue indoeuropee*, Il Mulino, Bologna, 1994, f. 522.

[4] Për bashkëpërkimet e vjetra leksikore të pjesshme të shqipes me gjuhë të tjera simotra shih Demiraj Sh., *Gjuha shqipe dhe historia e saj, botim i dytë i ripunuar*,Tiranë, 2013, *Kreu II: Vendi i shqipes në rrethin e gjuhëve indoeuropiane,* f.88-89; sa i përket ruajtjes së dukurisë së aoristit sigmatik dhe bashkëpërkimeve në këtë pikëpamje me gjuhë të vjetra i.e.(indishte e vjetër, greqishte e vjetër dhe latinishte), shih sërish Demiraj Sh., *botim i cituar, po aty, Kreu II/22,* f.87.

[5] Demiraj Sh., *Gjuha shqipe dhe historia e saj, botim i dytë i ripunuar*,Tiranë, 2013, *Kreu III: Shqipja gjuhë ballkanike,* f.91-105; *Kreu IV: Disa tipare të veçanta të shqipes,* f.106-121.

[6] Shih në veçanti Demiraj Sh., *Gjuha shqipe dhe historia e saj, botim i dytë i ripunuar*,Tiranë, 2013, *Kreu VIII: Prejardhja e gjuhës shqipe,* f. 200: *Për çështjen e prejardhjes së gjuhës shqipe deri sot janë parashtruar hipoteza të ndryshme, nga të cilat mund të përmenden hipoteza të ndryshme, nga të cilat mund të përmenden hipotezat pellazgjike, ilire, trakase, dako-mize etj., me një mbizotërim të hipotezës për burimin ilir të kësaj gjuhe. Argumentet që janë sjellë në të mirë të kësaj apo të asaj hipoteze, kanë qenë të karakterit gjuhësor, historik, gjeografik etj., duke mbizotëruar herë argumentet e karakterit gjuhësor, herë ato të karakterit historik-gjeografik.*

të rëndësishme nëse bëhet fjalë për raportet konkrete mes popullsive dhe fiseve antike në arealin epirot dhe më tej, duke qenë se del në pah dhe një faktor historik mjaft i rëndësishëm që qëndron në themel të natyrës së gjithsecilës prej këtyre popullsive, influencuese të padiskutueshme në historinë dhe psikikën e popujve me të cilët ranë në kontakt në rrugë ushtarake apo kolonizuese.[7]

Vetë çështja e sqarimit të vendbanimit të hershëm të popullit tonë përfshihet drejtpërdrejt nga studimi i këtyre elementeve, lashtësia e të cilave dëshmon dhe për një fakt tjetër po aq të rëndësishëm: praninë e tyre në gjuhën tonë e jo në gjuhë të tjera siç është rasti i disa gjuhëve romane.[8]

Ndër huazimet latine pikërisht një pjesë e tyre që i përkasin terminologjisë kishtare janë bërë objekt studimi dhe më tej nga studiuesi Demiraj për faktin se nëpërmjet tyre dëshmohen procese fonologjike që bëjnë të gjykosh për lashtësi të depërtimit të tyre në gjuhën shqipe apo nënën e saj.[9]

Këto kontribute e trajtesa të sipërpërmendura duhen parë në një vështrim që merr në konsideratë dhe studime të tjera të Shaban Demirajt, duke qenë se në ecuri të natyrshme janë finalizuar prej tij studime mbi morfologjinë historike të shqipes, fonologjinë historike të saj por dhe janë parë kontaktet e mundshme me gjuhë të tjera në dritën e një perspektive që shpie studiuesit në kërkim të sqarimit të rrethanave të shkëmbimeve mes popujve të hershëm, shkëmbime që paraqesin interes dhe për vetë kulturat fqinje që përfshihen në këto raste.

Elementet leksikore të konsideruara si paraindoevropiane e të bartura nga një popull në tjetrin (të pranishme në greqishte, latinishte dhe në shqipe) dëshmojnë se çdo popullsi ka asimiluar nga kulturat e mëparshme por dhe vetë vijimësinë e bartjes së tyre në areale të mëtejme, siç është rasti i mjaft elementeve që qëndrojnë në bazë të kulturës dhe qytetërimit antik italik me gjasa të sjella apo të ndërmjetësuara nga fiset greke, por që përfshijnë mbarë popullsitë e këtij areali, jo vetëm ato që njihen si i.e.[10]

---

[7] Shih në veçanti Demiraj Sh., *Gjuha shqipe dhe historia e saj, botim i dytë i ripunuar, Kreu VI(Shtresimi kohësor i fjalorit të gjuhës shqipe)*,f.153-165.

[8] Shih në veçanti Demiraj Sh., *Gjuha shqipe dhe historia e saj, botim i dytë i ripunuar,Kreu IX: Vendi dhe koha e formimit të gjuhës shqipe*, f.255-260.

[9] Për trajtimin e proceseve morfonologjike shih Demiraj Sh., *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996, *Kreu IX: Dukuritë morfonologjike*, f.144-148; Demiraj Sh., *Gjuha shqipe dhe historia e saj, botim i cituar, Kreu VI(Shtresimi kohësor i fjalorit të gjuhës shqipe),* f.162-163: *Gjithashtu nga analizat që i janë bërë elementit latin që gjuha shqipe e ka trashëguar nga nëna e saj, ka dalë në shesh se ai përfshin fjalë të sferave të ndryshme të jetës lëndore dhe shpirtërore. Ndër këto të dytat bie në sy edhe një fakt me rëndësi: terminologjia fetare (e krishterë) e shqipes, sidomos ajo më e moçmja, është në përgjithësi prej burimi latin. Lidhur me këta terma fetarë të shqipes, do pasur parasysh se mungojnë fare asish prej burimi sllav, që në rumanishte zënë një vend të rëndësishëm. Për më tepër, termat kishtarë të shqipes prej burimi latin paraqiten me ndryshime të tilla fonetike që dëshmojnë për një vjetërsi relativisht të madhe.*

[10] Këto elemente që nuk u përkasin vetëm kulturave nga vijnë dëshmojnë qartë kontributin e disiplinave gjuhësore

Çështjet e lidhura drejtpërdrejt me gjenezën, vijimësinë dhe lidhjet birnore dhe të afërisë më të ngushtë gjenetike të shqipes janë parë vazhdimisht në studimet e albanologëve shqiptarë dhe të huaj me gjithë vështirësinë që në rastin e gjuhës sonë paraqet fakti i mungesës së të dhënave konkrete që gjuhë të tjera i kanë pasur si falë një dokumenttimi shkrimor më të hershëm, si dhe falë vetë referimit ndaj identitetit dhe historisë së tyre në burime historike dhe gjeografike të shkruara në gjuhë të vjetra të kohës. Rimarrja e këtyre argumenteve në një shtjellim të gjerë dhe evidentues në punimin e Sh. Demirajt vë në dukje gjithashtu kontributin e shkencës së arkeologjisë dhe gjurmimet përkatëse të kryera në vendin tonë dhe në hapësirat kufitare me të.[11]

Trajtimi i historisë së lindjes së shkrimit shqip dhe i veprave themelore të kësaj historie mbetet ndër krerët më të rëndësishëm të këtij punimi. Çështja e gjetjes së burimeve më të plota shkrimore para librit të Gjon Buzukut është dhe sot e kësaj dite një objektiv i pazgjidhur nga studiuesit. Gjuha e konsoliduar deri në njëfarë shkalle në tekstet e veprave të letërsisë së vjetër shqipe, përfshirë librin e Buzukut nuk mund të mos konsiderohet si një provë e ekzistencës së një tradite shkrimore të mëparshme, dhe pse disa tipare gjuhësore në këto vepra jo gjithmonë përbëjnë shembuj vijimësie në pikëpamje përdorimit të termave dhe emërtesave të posaçme, ashtu dhe veçorive dialektore të gjuhës së gjithsecilit.[12]

Dokumentet e njohura dhe sot me emërtimin *dokumente parabuzukiane* nuk përbëjnë prova të mjaftueshme për të gjykuar mbi një vijimësi të qartë prej tyre në veprat e mëvona me të cilat përfaqësohet letërsia e vjetër shqipe.

Gjithsesi, fakte të caktuara si qëndrueshmëria fonetike dhe morfologjike me një raport të përcaktuar mes shkronjës dhe tingullit të Buzuku, alfabeti mjaft i stabilizuar që pësoi dhe modifikime evolutive graduale në autorët pasardhës si Budi, Bardhi, Bogdani etj., janë dëshmi që flasin në të mirë të tezës që shqipja është lëvruar dhe para këtij autori.[13]

Duke sjellë shembuj nga tekstet tipike introduktive apo përmbyllëse të këtyre veprave si dhe modele të formimit të fjalëve që dëshmojnë aftësinë e lëvrimit të shqipes nga ana e tyre, autori i veprës realizon një percursus të rëndësishëm të historisë së shkrimit shqip nga fillesat e tij deri në autorë të tjerë që i përkasin një tradite të mëvonë shkrimore.Një rëndësi e veçantë i kushtohet lidhjes me traditën shkrimore të lëvruar këtej

---

ndaj atyre kufitare me to dhe u japin një vështrim më të gjerë nga pikëpamja e përfshirjes dhe vetë trajtesave në fjalë të studiuesit tonë.Shih në veçanti Demiraj Sh., *Gjuha shqipe dhe historia e saj, botim i dytë i ripunuar*,Tiranë, 2013, *Kreu VIII: Prejardhja e gjuhës shqipe*, f. 201.

[11] Për traditën e studimeve në lidhje me këtë argument shih Demiraj Sh., *Gjuha shqipe dhe historia e saj, botim i dytë i ripunuar*, Tiranë, 2013, *Kreu VIII: Prejardhja e gjuhës shqipe*, f.200-220; shih gjithashtu Demiraj Sh., *Epiri, pellazgët, etruskët dhe shqiptarët*, Tiranë, 2008, f.34 v.

[12] Shih Demiraj Sh., *Albanese; Note preliminari*, në Ramat P., Ramat A.G., *Le lingue indoeuropee*; Il Mulino, Bologna, f.507-508.

[13] Shih Demiraj Sh., *Gjuha shqipe dhe historia e saj, botim i dytë i ripunuar*, Botime Onufri, Tiranë, 2013, *Kreu XIII: Lëvrimi i gjuhës shqipe*, f.324-331.

Adriatikut përfaqësuar nga autorë të rëndësishëm të letërsisë arbëreshe.[14]

Sa i përket trajtimit të kategorive themelore dhe specifike gjuhësore në studimet e Shaban Demirajt, dhe në këtë punim me natyrë sintetizuese e që nuk mund të shihet i ndarë nga të tjera kontribute po aq të rëndësishme në fushë të studimeve mbi historinë e gjuhës shqipe, spikat një arsenal i mjaftë i evidentimit të burimeve nga shqipja e vjetër e më saktë nga veprat dhe autorët përfaqësues të letërsisë së vjetër shqipe, vjelë përherë si burim parësor në trajtesat mbi dukuri të caktuara që shfaqen në gjuhën e shkruar shqipe.

Gjuha shqipe dhe historia e saj mbetet një punim shkencor që për vetë natyrën dhe objektin e studimit ka shoqëruar breza të tërë studiuesish, duke shërbyer për ta si një *vademecum* i rëndësishëm formimi profesional. Ribotimi aktual i veprës rikonfirmon rëndësinë e saj në fushë të formimit të tyre dhe përbën një homazh domethënës për vetë autorin e saj, profesor Shaban Demirajn.

Evalda PACI

[14] Sa i përket afërisë mes traditës drejtshkrimore të autorëve të letërsisë së vjetër shqipe dhe atyre të traditës arbëreshe shih Demiraj Sh., *Gjuha shqipe dhe historia e saj, botim i dytë i ripunuar,* Tiranë, 2013, *Kreu XIII: Lëvrimi i gjuhës shqipe,* f.330: *Prania e një norme të tillë drejtshkrimore në veprat e shkrimtarëve të vjetër shqiptarë përkëtej dhe përtej Adriatikut nuk mund të jetë një rastësi, as diçka e përftuar nën ndikimin e përbashkët të drejtshkrimit të ndonjë gjuhe tjetër. Siç dihet, gjuhët letrare më të përhapura të kohëve të vjetra dhe mesjetare, greqishtja dhe latinishtja, i shënonin krejt ndryshe zanoret e gjata. Për më tepër, norma drejtshkrimore në shqyrtim nuk ndeshet as në traditën shkrimore romane, sllave etj. Prandaj prania e një norme të tillë drejtshkrimore te shkrimtarët shqiptarë pas Buzukut dhe te shkrimtarët arbëreshë pas Matrëngës dëshmojnë qartë se në këtë rast kemi të bëjmë me një traditë drejtshkrimore të ngulitur mirë qysh para shekullit të Buzukut e të Matrëngës. Dhe kuptohet vetiu që ngulitja e një tradite drejtshkrimore në kushtet historike të Shqipërisë së asaj periudhe nuk ishte punë që mund të kryhej brenda një kohe të shkurtër.*

Gjovalin SHKURTAJ, **Dialektet e shqipe, Tiparet e përbashkëta dhe dallimet dialektore, sipas hartave të ADGJSH-së. Të folmet shqipe të diasporës** (*shkurtore për sistemin Bachelor*), Tiranë, 2012, ff. 288.

Dialektologjia është një nga fushat e gjuhësisë shqiptare që ka shënuar arritjet më të mëdha deri në vitet nëntëdhjetë. Një material i pasur dialektor, mirë i sistemuar, ruhet në kartotekën e dialektologjisë të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, po kështu një numër i konsiderueshëm regjistrimesh me magnetofon, përfshirë edhe tërësinë e materialeve të regjistruara për Atlasin Dialektologjik të Gjuhës Shqipe (ADGjSh), ruhen në arkivin e Institutit të Folklorit, mbi 60 skica dhe monografi janë botuar për shumicën e të folmeve të shqipes. Janë shkruar gjithashtu dhjetëra studime me karakter përgjithësues për dukuri të veçanta dialektore dhe për grupe të folmesh. Janë botuar libra për dialektet dhe historinë e formimit të shqipes, për të folmet e gegërishtes veriperëndimore dhe qendrore, janë botuar shtatë variante të tekstit të dialektologjisë shqiptare dhe një tekst për sistemin Bachelor si edhe libri *Gjuha shqipe dhe dialektet e saj* nga A. V. Desnickaja dhe, mbi të gjitha, është botuar Atlasi Dialektologjik i Gjuhës Shqipe. Në themel të gjithë kësaj pune është pa dyshim kontributi i shumë studiuesve nga Shqipëria, Kosova, diaspora etj., që, pa u lodhur për vite të tëra, në kushte jo gjithmonë të favorshme, kanë gjurmuar e regjistruar të folmet e shqipes, kanë skeduar materialet e mbledhura, kanë hartuar skica monografi dialektore për të folmet e shqipes, kanë hartuar studime përgjithësuese.

Ashtu si edhe fushat e tjera të kulturës e të dijes, midis viteve 1944-1990 edhe dialektologjia nuk i ka shpëtuar mungesës së lirisë akademike dhe diktatit që impononte sistemi monist i kohës. Me këtë mund të shpjegohet, besoj, që për pesëdhjetë vite me radhë studentët shqiptare kanë qenë të detyruar të përdorin variantet e të njëjtit tekst, të hartuar nga i njëjti autor. Nuk është rastësi që, duke filluar nga viti 1963 janë botuar e vazhdojnë të botohen, përveç pesë variante të njëjtit tekst të dialektologjisë (1963, 1969, 1975, 1988, 1989) nga i njëjti autor (J. Gjinari) dhe të dy varianteve të tjera (më 1997 dhe 2000, ribotuar 2003, 2013) nga i njëjti autor, po kësaj radhe në bashkautorësi me Gj. Shkurtajn. Më 2012 Gj. Shkurtaj botoi një tekst të ri të dialektologjisë shqiptare, të emërtuar prej tij *Dialektet e shqipes, Tiparet e përbashkëta dhe dallimet dialektore, sipas hartave të ADGjSh-së, Të folmet shqipe të diasporës (shkurtore për sistemin Bachelor*), 288 faqe.

Në të vërtetë një tekst i ri i dialektologjisë shqiptare do të ishte i përligjur në kushtet e daljes në dritë të materialeve të reja të panjohura, të një mënyre të re të konceptimit të objektit ose të metodës së parashtrimit të të dhënave, ose edhe për shkak të evidentimit të një problematike të re të patrajtuar deri tani. Por e vërteta është se ky libër nga njëri prej dy

bashkautorëve të dy varianteve të tekstit të dialektologjisë të botuar më 1997, 2000 (ribotuar 2003, 2013), nuk është rezultat i evolucionit të kërkimeve ose i një mënyre tjetër të menduari a të trajtuari të problematikës së gjuhës dialektore shqipe.

Libri ka dy pjesë themelore: I. *Tiparet e përbashkëta dhe dallimet dialektore, sipas hartave të ADGjSh-së* dhe II. *Të folmet shqipe të diasporës.*

Pas fjalës paraprijëse dhe hyrjes (9 faqe) ka këto nënndarje: I. 1. *Gjuha dhe dialektet, lidhja dhe marrëdhëniet e tyre* (21 f.); 2. *Tiparet e përbashkëta dhe dallimet ndërmjet dy dialekteve të shqipes* (6 f.); 3. *Dallimet fonetike ndërmjet dy dialekteve të shqipes* (19 f.); 4. *Dallimet morfologjike* (40 f.); 5. *Dallimet leksikore midis dialekteve të shqipes* (151 f.); 6. *Studimi i dialekteve të shqipes* (13 f.); 7. *Pjesë mbështetëse përnjohëse dhe ndihmuese për seminare praktike* (10 f.), 8. *Të folmet shqipe të diasporës* (57 f.), 9. *Pjesë mbështetëse (Shkurtore rreth ndarjes dialektore të shqipes* (5 f.); 10. *Tekste dialektore* (15 f.), *11. Modele për analizë dialektologjike* (6 f.) e *Detyra të shkurtra me shkrim* në seminare (3 f.).

Në krahasim me dy botimet para tij, *Dialektologjia* 1997, dhe *Dialektologjia*, 2000 (ribotuar më 2003 dhe 2013) nga J. Gjinari dhe Gj. Shkurtaj në bashkautorësi, të vetmet shtesa në këtë botim të ri janë: *Modelet për analiza dialektologjike* (6 f.*)* dhe *Detyrat të shkurtra me shkrim* (3 f.), që lidhen me aspektin pedagogjik të tekstit, po jo me karakterin shkencor të tij. Besoj se është e vështirë që me këto shtesa 9 faqesh të aspektit pedagogjik të justifikohet botimi i një libri të ri pas botimit prej tij dhe J. Gjinarit të dy teksteve të mësipërme, i pari prej 455 faqesh dhe i dyti prej 487 faqesh.

Por le ta vështrojmë këtë variant të tekstit të dialektologjisë shqiptare më për së afërmi. Në fjalën paraprijëse Gj. Shkurtaj, edhe pse nuk flet shprehimisht për objektin e këtij studimi, le të kuptohet se synimi i librit është të paraqesë ***njësinë (unitetin)*** *dhe* ***larminë*** *dialektore të shqipes në hapësirat dhe trevat e ndryshme shqiptare*...(f. 7). Që në një punim kushtuar *dialekteve të shqipes*, të synohet të paraqitet edhe *njësia (uniteti) i shqipes* edhe *larmia dialektore* është një non-sens.

Libri quhet *Dialektet e shqipes*, kurse synim është të paraqitet fillimisht ***njësia (uniteti) i shqipes***, çka vështirë se mund të kuptohet se si mund të realizohet në një tekst për dialektet e shqipes. Dhe me të vërtetë, të ashtuquajturës *njësi (unitet) të shqipes* në tekst drejtpërsëdrejti i kushtohen vetëm dy faqe.

Po kështu, në fjalën paraprijëse të librit lihet të kuptohet se synimi i librit, ndër të tjera, është të paraqesë *njësinë (unitetin) dhe larminë dialektore të shqipes... **në Evropë** e **në botë***... (f. 7). Kur shikon për së afërmi librin konstaton se nuk flitet (me gjendjen e sotme të studimeve, as nuk mund të mendohet se mund të flitet) për shqipen në vendet e ndryshme të Evropës dhe të botës, kam parasysh sidomos diasporën e re shqiptare që, pas viteve nëntëdhjetë, është bërë botërore.

Në fjalën paraprijëse të punimit pretendohet se tiparet dialektore të shqipes në fu-

shën e fonetikës dhe të gramatikës parashtrohen duke nxjerrë në pah ***përbashkësitë dhe dallimet*** sipas tri vijave ose drejtimeve: *fjalë që kanë kudo të njëjtën formë fonetike dhe të njëjtin kuptim, fjalë që dalin kudo në trevat shqiptare me të njëjtin kuptim, por me forma fonetike të ndryshme, fjalë ose leksema të ndryshme për të emërtuar objekte ose veprime të njëjta*[1].

Po në kapitujt kushtuar dallimeve fonetike e morfologjike ndërmjet dy dialekteve të shqipes ai flet *për dallime në vendin e theksit, për rotacizmin, për ndërrimin historik të ã hundore në ë, për kalimin e o-së në va, për zanoret e gjata, për ë-në e patheksuar, për togjet e zanoreve, grupet e bashkëtingëlloreve* etj*; për trajtën e shquar, për gjininë numrin rasat e emrave, për mbiemrin, përemrat, trajtat e foljeve* etj., pra për shtrirjen e tipareve dalluese të të folmeve të shqipes dhe jo për ***përbashkësitë dhe dallimet*** sipas tri vijave ose drejtimeve, siç pohonte më sipër.

E vërteta është se pretendimi i autorit për një qëndrim të ri teorik që ta ketë detyruar të rimarrë hartimin e një teksti të ripër dukuritë dialektore të shqipes, nuk përligjet nga analiza që u bëhet dukurive dialektore të shqipes në këtë libër.

Në titullin e librit lihet të kuptohet se do të trajtohen *Tiparet e përbashkëta dhe dallimet dialektore,* ***sipas hartave të ADGjSh****-së*. Kjo në fjalën paraprijëse pohohet shprehimisht: *parashtrimi i tipareve të dialekteve të shqipes... është bërë duke u mbështetur sa më gjerë edhe në hartat e ADGjSh-së* (f. 7).

Siç shihet, autori përpiqet ta përligjë botimin e këtij libri pas pesë varianteve të botuara nga J. Gjinari dhe 2 varianteve nga ai dhe J. Gjinari, me argumentin se mbështetet në të dhënat e ADGjSh-së. Mirëpo J. Gjinari ka pohuar që në vitin 1988 se në hartimin e variantit të katërt të tekstit të dialektologjisë shqiptare ai është mbështetur *në Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe* (J. Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë, 1988, f. 7). Edhe në botimin e pestë të tekstit të bërë më 1989 thuhet shprehimisht se të dhënat janë nxjerrë edhe nga *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe* (J. Gjinari, *Dialektet e gjuhës shqipe,* Tiranë, 1989, f. 92).

Pra, prania e këtij varianti të ri të tekstit të dialektologjisë shqiptare pas kaq shumë varianteve të hartuar herë vetëm nga J. Gjinari dhe herë nga J. Gjinari e Gj. Shkurtaj, nuk përligjet me argumentin se, në parashtrimin e tipareve dialektore të shqipes, është mbështetur në ADGjSh-në.

Në fjalën paraprijëse dhe në hyrje të këtij libri të tërheqin vëmendjen disa formulime pa vend, të paqarta a të pakuptimta dhe të gabuara shkencërisht. Për ilustrim ndonjë prej tyre.

---

[1] Gj. Shkurtaj, *Dialektet e shqipes, tiparet e përbashkëta dhe dallimet dialektore sipas hartave të ADGJSH-së, të folmet shqipe të diasporës*, Tiranë, 2012, f. 7.

Për mua, shkruan autori, *gjuha dhe dialektet nuk janë dy ushtri që* ***ndeshen*** *dhe njëra do ta asgjësojë tjetrën, por* ***ujëra*** *të cilat nisen nga treva të ndryshme dhe shkojnë në të njëjtin det të përbashkët:* ***ligjërimit shqip*** (f. 8) ose *...në gjuhë (në çdo gjuhë) vepron* ***parimi i ujit në enët komunikuese*** *dhe i ujërave në përgjithësi. Ajo që vjen prej përrenjve e lumenjve niset dhe gjakon të shkojë drejt detit, ku, ndonëse në nisje i turbullt e i ndryshëm, duke shkuar shtratit më të thellë të lumenjve dhe sidomos kur mbërrin në det, vjen e njëjtësohet, bëhet thjeshtë ujë deti* ose *Ishte ujë i ëmbël do të bëhet i kripur, ishte i turbullt nga prurjet prej përrenjve e përroskave a shenave, porse do të kthjellohet e njëjtësohet më masën e stërmadhe të ujit të detit. Por, edhe në nisje, qysh nga boenat e përroskat e vogla të krijuara prej shiut, ai ujë është* (f. 13-14).

Sipas këtyre pohimeve të autorit del se dialektet dhe gjuha janë dy gjëra të ndryshme, dialektet *ujëra të cilat nisen nga treva të ndryshme* kurse gjuha *deti ku shkojnë a derdhen ato* ose dialektet *përrenj, lumenj* kurse *gjuha deti ku ata derdhen*, pra gjithsesi dy gjëra të ndryshme (BB). Në kundërshtim me këtë në faqen 15 të tekstit ka shkruar: *Dialektet dhe gjuha janë e njëjta gjë....* Më qartë se kaq nuk ka.

Po kështu në këtë pjesë hyrëse të punimit gjen edhe formulime të tilla pa kuptim *Kam qenë e mbetëm* ***ithtar*** *i thënies urtake të J. Rrotës se* ***gjuha shkon tue u bamë ato ndryshime të veta****, si edhe i konceptit të shëndoshë të atij studiuesi se njeriu, sipas rasteve e rrethanave,* ***mundet me e dredhë gjuhën*** *në përshtatje me mjedise ose synime të caktuara* (f. 8) ose se *J. Rrota me* ***largpamësi e kthjelltësi të mahnitshme****, formuloi parimin e tij se njeriu* ***mundet me e dredhë gjuhën*** *prej dialektit në gjuhën e përbashkët dhe anasjelltas* (f. 13).

Në fjalën paraprijëse po edhe në hyrje të këtij libri vihet re një mungesë stabiliteti lidhur me terminologjinë e përdorur. Vetëm brenda faqeve të para të tekstit (7-9, 13-14 dhe 17) janë përdorur rreth 11 emërtime të ndryshme për të shënuar shqipen standarde: *gjuhë standarde*, *shqipe e njësuar e përbashkët* (f. 7), *shqipe standarde* (f. 8), *shqipe e shkruar e njësuar (që po quhet standarde*) (f. 8), *shqipe standarde e njëjtë dhe e përbashkët* (f. 8), *shqipe e përbashkme* (f. 8), *shqipe e përbashkët standarde* (f. 9), *gjuhë e shkollës* (f. 13), *gjuhë e përbashkët* (f. 13), *varieteti standard* (f. 14), *shqipe e shkruar zyrtare* (17).

Autori në fjalën paraprijëse dhe në hyrje përdor emërtime me ngjyrime folklorike që nuk kanë të bëjnë me terminologjinë shkencore si *gjuha e nënës, gjuha e zemrës*, ose gjuha nuk mund të jetë *bllok monolit, atje ku i thonë bukës buk dhe ujit ujë* si edhe *me e dredh gjuhën,* etj.

Në kapitullin e parë të tekstit me karakter teorik *Gjuha dhe dialektet, lidhja dhe marrëdhëniet e tyre (9 f.),* gjëja e parë që të bie në sy është përpjekja e autori për të sqaruar lexuesin lidhur me përkufizimin e dialektit. Përfundimi në të cilin arrin është se *për-*

kufizimin më të saktë për dialektin ndër ne e ka dhënë J. Gjinari (f. 19)[2], sikur përkufizimi i dialektit të jetë problem yni dhe jo i dialektologjisë a gjuhësisë së përgjithshme. Dhe pas këtij përfundimi origjinal, do të thosha, në kundërshtim me sa më sipër, duke folur për termin *dialekt* shkruan se *kuptimi i termit dialekt në vetëvete nuk është përcaktuar ende me gjithë rreptësinë e duhur* (f. 20). Dhe në vijim jep një tjetër përkufizim për dialektin pa shënuar se kujt i përket *gjuha është njësia gjuhësore më e lartë, e pranuar përgjithësisht si e tillë nga një bashkësi (një popull), ndërsa* ***dialekti është një variacion vendor i saj i pranuar nga një grup i vogël*** (f. 22).

Brenda tri faqeve tre a më shumë qëndrime të ndryshme për përkufizimin e dialektit.

Po kështu, duke dashur të paraqesë *larminë e gjuhës* në procesin e realizimeve të saj konkrete, shkruan se *mund të na ndihmojë një paraqitje* ***që mbështetet në idenë e qilimit,*** *i cili është realisht i larmë dhe që përmban shumë ngjyra: të kuqen, të bardhën, të zezën, të gjelbërtën, të murrmen, të hirtën, të kuqërremtën etj. si dhe ojna që nuk kanë mbarim; por, po ta shohim nga larg, do të na duket sikur të ishte vetëm me një ngjyrë* (f. 29). Besoj se çdo koment është i tepërt.

Po ajo që tërheq më shumë vëmendjen është se në këtë pjesë të parë *teorike* të punimit, autori përpiqet të vërë shenjën e barazimit ndërmjet konceptit të André Martinet-së që e konsideron dialektin si një rreth i ndarë në disa pjesë me anë rrezesh që nisen nga qendra, ku secila pjesë përfaqëson, sipas tij, një dialekt që ai e shënon d1, d2, d3 etj. (f. 21-23) me skemën e zbatuar tek ne që ai e quan *ndarje e bigëzueshme e në progresion rritës–zbritës* (kupto ndarjen në *dialekte, nëndialekte, grupe të folmesh, të folme*).

Skema e zbatuar tek ne që paraqet strukturën dialektore të shqipes si një ndarje suksesive në hapësirë nga njësi më të mëdha në njësi më të vogla, pra fillimisht në dy dialekte dhe të secilit dialekt në dy nëndialekte dhe të secilit nëndialekt në dy grupe të folmesh, për mendimin tonë, nuk ka asgjë të përbashkët me skemën e paraqitur nga A. Martineja.

Bëhet, pra, një përpjekje, do të thosha e sforcuar dhe pa bazë, për t'i dhënë ndarjes dialektore të shqipes në mënyrë suksesive në hapësirë nga njësi më të mëdha në më të vogla, të zbatuar tek ne, pra edhe në tekstin e tij, një mbështetje teorike si të thuash ndërkombëtare, çka nuk është as e saktë.

Që në fillim të kapitullit *Tiparet e përbashkëta dhe dallimet ndërmjet dy dialekteve të shqipes* gjejmë një formulim të tillë: *Koncepti ynë ka qenë dhe mbetet ky:* ***shqipja është gjuhë e të gjithë shqiptarëve*** *dhe, në të gjitha hapësirat shqiptare të trojeve kompakte ball-*

[2] Përkufizimi i J. Gjinarit, të cilit i referohet autori, është ky: "Dialekti është një variant i një gjuhe, i cili shërben si mjet komunikimi për një kolektiv pak a shumë të vogël njerëzish, përfaqësuesit e të cilit kanë marrëdhënie të drejtpërdrejta në një territor të caktuar" (J. Gjinari, Dialektologjia shqiptare, Tiranë, 1988, f. 13).

kanike, këndej dhe përtej kufijve shtetërorë të RSh-së, atje ku i thonë bukës bukë dhe ujit ujë, ***banorët e etnikumit shqiptar, e quajnë veten shqiptarë*** *dhe gjuhën e tyre* ***shqipe*** (f. 17). Ka të tjerë që mendojnë ndryshe?!

Përse duhet a shërben një formulim i tillë në hyrje të këtij kapitulli. Të krijohet përshtypja se autori është nën presion dhe i frikësuar se mos do të paragjykohet kur kërkon të evidentojë dallimet dialektore të shqipes. E kjo nuk justifikohet kur është fjala për një punim dialektor që pretendon të jetë shkencor.

Po kështu e njëjta përshtypje të krijohet kur, në vijim të atyre që u vunë në dukje më sipër, nxiton të konfirmojë, ndonëse nuk është as vendi, as rasti, se degëzimi dialektor i shqipes *është relativisht i ri,* çka është e diskutueshme shkencërisht. Po kështu citimi i dy paragrafëve njëri pas tjetrit, të dy nga një faqe, nga E. Çabej lidhur me historinë e tipareve dalluese të dialekteve të shqipes kur ato nuk janë objekt i këtij punimi është pa vend.

Në dy variantet e tekstit të dialektologjisë të botuar në bashkautorësi me J. Gjinarin përkatësisht më 1997 dhe 2000 (ribotuar më 2003 dhe 2013), në kapitullin kushtuar klasifikimit të dallimeve fonetike thuhet se do të zbatohet kriteri strukturor dhe funksional. *Duke u nisur nga kriteri strukturor dhe funksional,* shkruhet atje, *dallimet e të folmeve në sistemin fonetik klasifikohen në tri grupe të mëdha. Dallimet e grupit të parë quhen* ***dallime fonologjike.*** *Këto ndahen në tri nëngrupe: 1.* ***dallime të inventarit të fonemave,*** *2.* ***dallime të sistemit të fonemave****; 3.* ***dallime të funksionit të fonemave***[3].

Në dallim prej këtyre dy varianteve të tekstit të dialektologjisë, në këtë variant të ri të botuar nga Gj. Shkurtaj, hyhet direkt në parashtrimin e tipareve dalluese fonetike pa u dhënë ndonjë shpjegim a kriter teorik për parashtrimin e tyre. Një qëndrim i tillë nga ana e autorit të këtij libri të ri është e vështirë të kuptohet.

Formulimi i bërë në faqen 47 të librit se *Për të pasur një pamje sa më të plotë dhe të atillë që të na lejojë të shohim dallimin dialektor, por pa bjerrë mundësinë e të hetuarit edhe të njësisë (unitetit) të shqipes, mënyra më e përshtatshme është ajo që* ***dukuritë e së njëjtës farë fonetike t'i grupojmë në mënyrë që të fitojmë izoglosa të qarta dhe të vlefshme***[4], është i paqartë. Për ne është e pakuptueshme se si mund të shihen dallimet dialektore *pa bjerrë mundësinë e të hetuarit edhe të njësisë (unitetit) të shqipes.*

Në të vërtetë në paraqitjen konkrete të dukurive dialektore në tekstin e Gj. Shkurtajt vihet re një braktisje totale e metodës strukturore e funksionale të analizës të shpallur si themelore në dy botimet para tij të hartuara në bashkautorësi me J. Gjinarin (më 1997 dhe 2000, 2003, 2013). Edhe për këtë nuk jepet ndonjë shpjegim a argumentim nga ana e autorit.

---

[3] J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, *Dialektologjia,* Tiranë 1997, f. 110-112.

[4] Gj. Shkurtaj, *Dialektet e shqipes, tiparet e përbashkëta dhe dallimet dialektore sipas hartave të ADGJSH-së, të folmet shqipe të diasporës,* Tiranë, 2012, f. 47.

Lidhur me dukuritë dialektore të trajtuara pohohet se parashtrimi i tipareve të dialekteve të shqipes është bërë *duke u mbështetur sa më gjerë edhe në hartat e ADGjSh-së* (f. 7). Ne kemi verifikuar disa nga dukuritë e trajtuara nga autori për të parë saktësinë e këtij pohimi. Dhe konkretisht kemi marrë në shqyrtim vetëm *dallimet në vendin e theksit*. Në faqen 46 të librit lidhur me dallimet në vendin e theksit ndër të tjera lexojmë: *Një numër jo i vogël fjalësh, të cilat kanë hyrë në shqipen si huazime nga turqishtja, ndërsa kanë të njëjtin kuptim, në toskërishten e ruajnë theksin në rrokjen e fundit (janë theks fundore ose oksitone)..., kurse në gegërishten ato pësojnë asimilim e përngjashmim më të dukshëm me tipin paratheksor (paroksiton) të shqipes.* Si shembuj jep fjalët: *agá-agái* (tosk.) > *a:g-ága* (geg.), *daí-daíu* (tosk.) > *da:j-dája* (geg.), *babá-babái* (tosk.) > *ba:b-bába* (geg.); *xhaxh-xhaxhái* (tosk.) > *a:xh-áxha* (geg.), *teneqé-teneqéja* (tosk.) > *tenéqe-tenéqja* (geg.), *penxheré-penxheréja* (tosk.) > *penxhére-penxhérja* (geg.), *kafé-kaféja* (tosk.) > *káfe-káfja* (geg.); *gajlé-gajléja* (tosk.) > *gájle-gájlja* (geg.); *bahçé- bahçéja* (tosk.) > *bá(h)çe-bá(h)çja* (geg.), *dajré-ja* (tosk.) > *dájre-dájrja* (geg.); *xhadé-ja* (tosk.) > *xháde-xhádja* (geg.); *qoshé-ja* (tosk.) > *qóshe-qóshja* (geg.); *bakllavá-ja* (tosk.) > *bakllá:v-baklláva* (geg.); *pashá-pasháí* (tosk.) > *pa:sh -pásha* (geg.), *shishé-shishéja* (tosk.) > *shíshe-shíshja* (geg.), *shamatá- shamatája* (tosk.) > *shamát-shamáta* (geg.), *kaúrr- kaúrri* (tosk.) > *káurr- káurri* (geg.) etj. Dhe për të vërtetuar saktësinë e këtyre të dhënave na referon tek hartat e Atlasit Dialektologjik të Gjuhës Shqipe, Vëllimi I, harta nr. 65. a/1, f. 198, nr. 65. a/2.f. 199; nr. 65. a/3, f. 200; nr. 65, b/1, f. 201; nr. 65. b/2, f. 202.

Nga pesë hartat që sillen për të dëshmuar fenomenin, vetëm tri të parat (harta nr. 65. a/1, f. 198, nr. 65. a/2.f. 199; nr. 65. a/3, f. 200) trajtojnë këtë dukuri, dy të tjerat trajtojnë dukuri të tjera. Nga tri hartat që trajtojnë këtë dukuri vetëm harta 65. a/1. e ADGjSh-së dëshmon se fjalët *baba, para* dalin me theks parafundor në mbarë të folmet e Shqipërisë së Veriut: *bába, páre,* kurse në të folmet e Shqipërisë së Jugut me theks fundor: *babá, pará.*

Dy hartat e tjera (65. a/2. dhe 65. a/3.) vërtetojnë që fjalët *dajë, tenxhere, qoshe* në shumicën e të folmeve të shqipes përfshirë edhe ato të Shqipërisë së Jugut janë me theks parafundor.

Pra, hartat e ADGJSH-ë konfirmojnë pohimin e autorit vetëm për fjalët *baba, para* për fjalët *dajë, tenxhere, qoshe* e hedhin poshtë atë, kurse për fjalët e tjerat nuk ka të dhëna.

Në këto kushte mund të thuhet se nuk është e vërtetë që autori në paraqitjen e shtrirjes territoriale të kësaj dukurie është mbështetur, siç pohon, *sa më gjerë edhe në hartat e ADGjSh-së.*

Lidhur me dallimet në vendin e theksit pohohet: *Theksin në rrokjen e fundit në toskërishten e ruajnë edhe emrat vetjakë (antroponimet) me origjinë orientale, si Fatimé-ja, Feridé-ja, Hatixhé-ja, Hanifé-ja, Hatifé-ja, Kadifé-ja* etj., ndërsa në gegërishten ata janë bërë paratheksorë: *Fatíme-Fatímja, Feríde-Ferídja, Hatíxhe-Hatíxhja, Hanífe-Hanífja, Hatífe-Hatífia, Kadífe-Kadífja.* Po ashtu edhe disa nga emërvendet (toponimet) e asaj

gurre, si: *Qabé- Qabéja (tosk)-Qábe-Qábja* (geg.); *Kadaré-Kadaréja (tosk)- Kadáre-Kadárja* (geg.), p.sh. *Maja e Kadáres* (toponim në Kastrat-Malësi e Madhe), *Tepé-Tepéja (tosk.)-Tépe-Tépja* (geg.), p.sh. *Kodrat e Tépes* (Shkodër).

ADGjSh-ja nuk jep të dhëna që vërtetojnë pohimin e mësipërme të autorit.

Në vazhdim të trajtimit të dukurive dialektore që lidhen me vendin e theksit (f. 46-47) pohohet: *Dallime në vendin e theksit (fundor a oksiton në toskërishten dhe parafundor a paroksiton në gegërishten) kanë edhe disa fjalë të tjera, jo me prejardhje turke, si: njeri-u* (tosk.) > *nier,-i /nir,-i* (geg. Veriperëndimore), *nje'ri- nje'riu* (geg. verilindore); *ai/ ay* (tosk. veriore e krahut lindor: Devoll, Kolonjë etj.); *aj* (geg. veriperëndimore, madje diku edhe në formën *av* (Grudë, Traboin, Triesh etj.), *verí-u (tosk)-véri-vériu* (geg. veryore), *qirí-qiríu/ qiríri (tosk)-qir-qíri* (geg.); *kallí-kallíri* (tosk.) - *ka:ll-i (geg.), gjetíu (tosk.)- gjétit / njétit* (geg.) etj. Dhe për të vërtetuar saktësinë e këtyre të dhënave na referon tek hartat e ADGjSh-së, Vëllimi I, harta nr: 91/2, f. 273 dhe harta nr. 65. b/1, 65. b/2 f. 201.

Harta 91/2. jep të dhëna për shtrirjen e varianteve *ai/ay* në të folmet e shqipes, po jo për vendin e theksit në këtë fjalë në të folmet e shqipes. Harta 65.b/1 e ADGjSh-së dëshmon se fjalët: *veri, qiri, njeri* janë paroksitone në të folmet veriore të Shqipërisë së Veriut, po edhe në disa nga të folmet qendrore të Shqipërisë së Veriut që janë fqinje me to. Në dallim prej tyre në të folmet qendrore e jugore të Shqipërisë së Veriut si edhe në të folmet e Shqipërisë së Jugut fjalët *veri, qiri, njeri* shqiptohen në rrokjen e fundit, janë pra oksitone: *ve´ri, qi´ri, nje´ri.* Pra nuk është e vërtetë ajo që pohohet prej autorit që në fjalë të tipit *veri, qiri, njeri* theksi është fundor a oksiton në toskërishten dhe parafundor a paroksiton në gegërishten. E vërteta është se sipas këtij tipari kundërvihen të folmet veriore të Shqipërisë së Veriut me të folmet e tjera të shqipes.

E vërteta është se gjatë parashtrimit të shtrirjes së dukurive dialektore fonetike autori u referohet hartave të ADGjSh-së, por pa i përdorur ato për të argumentuar shtrirjen e dukurive dialektore fonetike. Hartat e ADGjSh-së, më së shumti, jepen si ilustrim i pohimeve të autorit lidhur me shtrirjen e dukurive dialektore fonetike. Në këto rrethana do të duhej të jepeshin burimet e tjera që përligjin shtrirjen territoriale të dukurive fonetike që trajtohen. Mirëpo, jo vetëm nuk thuhet, po as nuk lihet të kuptohet se në cilat punime konkretisht është mbështetur autori për përcaktimin e shtrirjes së dukurive dialektore fonetike të shqipes. Dhe ajo që të çudit është se në 18 faqe kushtuar, për shembull, përcaktimit të shtrirjes së dukurive dialektore fonetike, nuk ka asnjë citim nga punimet dialektologjike për shtrirjen e dukurive fonetike dialektore dhe ka dhjetë referenca nga E. Çabej për historinë e këtyre dukurive (diçka e tepërt në një paraqitje sinkronike të dukurive dialektore) dhe tri referenca nga J. Rrota për shtrirjen e disa dukurive. Ky qëndrim vështirë se mund të kuptohet a të justifikohet, po të kemi parasysh se shkrimet e botuara nga dialektologët shqiptarë për këtë problematikë deri në vitet 2012 janë të shumta dhe të aktualizuara e të verifikuara. Ngjan si një lloj snobizmi referimi a citimi me vend e pa vend tek E. Çabej e J. Rrota, sidomos për shtrirjen e dukurive dialektore të shqipes po të kemi

parasysh se rezultatet shkencore të arritura në përshkrimin e dukurive dialektore të shqipes nga studiuesit shqiptarë, këtej e andej kufirit, në periudhën e pasluftës janë të shumta.

Në dy variantet e tekstit të botuar më 1997 dhe 2000 (ribotuar më 2003 dhe 2013) në bashkautorësi me J. Gjitarin lidhur me dukuritë dialektore morfologjike shkruhet se *Duke u nisur nga kriteri strukturor dhe funksioni i formave dhe mjeteve gramatikore, dallimet morfologjike të folmeve të gjuhës shqipe mund të klasifikohen ndër të tjera në: 1) dallime të* ***inventarit të strukturave,*** *të cilat ndahen në vetvete në dallime që* ***prekin një kategori të plotë*** *dhe në dallime që prekin* ***një formë të veçantë të një paradigme*** *dhe 2) dallime në* ***variantet e strukturave,*** *të cilat ndahen në* ***variante të një forme gramatikore,*** *që e prek plotësisht formën dhe në* ***variante të një morfeme,*** *që prekin vetëm një morfemë të formës gramatikore: Dallimet e grupit të dytë, ato që nuk e prekin mirëfilli strukturën gramatikore, ndahen në: 1)* ***dallime të shpërndarjes së varianteve të strukturave ose të morfemave*** *dhe në dallime të* ***2)varianteve fonetike të formave gramatikore***[5]**.**

Në dallim nga sa më sipër në këtë variant të tekstit të dialektologjisë shqiptare të hartuar nga Gj. Shkurtaj nuk jepet ndonjë klasifikim strukturor dhe funksional i formave dhe mjeteve gramatikore, po pranohet ndër të tjera (f. 65) se *Dallime* ***jo të pakta,*** *gjithashtu pa vlerë kuptimdalluese, por* ***mirëfilli morfologjike****, ka ndërmjet gegërishtes e toskërishtes* (po në njësitë e tjera më të vogla nuk ka) *në* ***gati të gjitha kategoritë gramatikore****...* (deri tani ka insistuar se dialektet e gjuhës shqipe janë shumë të afërta me njëri tjetrin). Dhe pas kësaj hyrjeje të shkurtër kalohet direkt në parashtrimin e shtrirjes së dukurive dialektore morfologjike në të folmet e shqipes, po edhe këtu pa na dhënë shpjegime lidhur me burimet ku është mbështetur për përcaktimin e shtrirjes së dukurive morfologjike.

E themi përsëri këtë sepse përcaktimet e dhëna për shtrirjen e dukurive dialektore të shqipes në fushë e morfologjisë nuk përligjen me hartat e ADGjSh-së.

Nga një krahasim i shpejtë i të dhënave për shtrirjen e dukurive dialektore morfologjike në këtë tekst me ato të parashtruara në dy variantet e botuara përkatësisht më 1997 dhe 2000 (ribotuar më 2003, 2013) vihet re se përshkrimet për trajtën e shquar të emrave mashkullorë, njëjës që mbarojnë me *ua* (f. 65) dhe të atyre që mbarojnë me *k, g, h* (f. 66) etj., për rasën vendore (f. 76), për mbiemrin (f. 78), për përemrat dëftorë dhe përemrat e pacaktuar (f. 80) janë marrë nga botimet e vitit 1997, 2000, 2003, 2013 të tekstit të dialektologjisë. Po kështu pohimet për shumësin e emrave (f. 70), për rasën gjinore-dhanore (f. 77), për përemrat vetorë (f. 79-80) janë marrë pjesërisht nga ato dy botime. Tek hartat e ADGjSh-së është mbështetur vetëm për shumësin e emrave (f. 71-75).

Lidhur me mënyrën e parashtrimit të dukurive dialektore qofshin këto fonetike qofshin morfologjike në tekstin e Gj. Shkurtajt vihet re një kthim tek metoda e zbatuar në variantet e tekstit të dialektologjisë të J. Gjinari të viteve 1963 dhe 1975.

---

[5] J. Gjinari-Gj. Shkurtaj, *Dialektologjia*, Tiranë, 1997, f. 143; *Dialektologjia*, Tiranë, 2013, f. 210.

Një gjë tjetër që vihet re gjatë parashtrimit të dukurive dialektore të shqipes është se përzihen pa kriter vështrimi sinkronik i dukurive të trajtuara me vështrimin diakronik. Për këtë mjafton të shihen pohimet e bëra për zanoret e gjata (f. 49-51), për togjet e zanoreve (f. 53-55), për grupet e bashkëtingëlloreve (f. 57-59) etj.

Përzierje planesh (diakronik e sinkronik) vihen re në emërtimet e dukurive. Nga njëra anë flitet për *zanore të gjata*, për *ë* të patheksuar, për *togje të zanoreve*, për grupe *mb, nd, ng, ngj* dhe nga ana tjetër për ***ndërrime fonetike historike*** *që përcaktojnë vija ndarëse të dialekteve të shqipes, për* ***ndërrim historik*** *të ã-së hundore në ë* etj.

Po kështu vihet re një përzierje pa kriter e problemeve që lidhen me përcaktimin e shtrirjes territoriale të veçorive dalluese të shqipes dialektore me ato të drejtshkrimit të shqipes standarde. Për këtë mjafton p.sh. të lexohet se çfarë thuhet për ruajtjen (përkatësisht rënien) e *ë*-së së patheksuar në dialektet e shqipes (f. 57).

Po kështu termat a formulimet e përdorur zakonisht nuk janë të karakterit strukturor a funksional, mirëpo gjen herë pas here edhe terma a formulime të karakterit strukturor a funksional. Kështu për shembull në faqen 63 flet për *dallime* josistemore në një kohë që deri në atë moment nuk ka folur për dallime sistemore ose, duke folur për dallimet morfologjike ndërmjet gegërishtes e toskërishtes, përdor formulimin *dallime pa* ***vlerë kuptimdalluese*** (f. 65), ose *disa dallime nuk janë* ***të karakterit strukturor*** (f. 68) etj.

Dallimeve leksikore midis dialekteve të shqipes u janë kushtuar 102 faqe. Sipas tij përhapja e fjalëve krahinore dhe dialektore që i dallon e diferencon dialektet e të folmet e shqipes është shumë e ndërlikuar dhe nuk mund të paraqitet me ndarje a kufij të prerë. Dhe në vend tipareve dalluese dialektore të shqipes në fushën e leksikut ai na jep, siç thotë vetë, *disa prej fjalëve dhe varianteve fonetike ose fjalëformuese të tyre, të nxjerra nga hartat leksikore të Atlasit, të cilat tregojnë* ***larminë dhe pasurinë e madhe*** *të të folmeve të gjuhës sonë, po edhe domosdoshmërinë që, mbi tërësinë e tyre,* ***të çelej edhe hullia a kahu normativizues,*** *që ngre në normë jo secilën prej tyre, por pikërisht atë që paraqitet më e përbashkët e më e mundshme për t'u përgjithësuar* (f. 107).

Pra vazhdon me përcaktimin e shtrirjes së dukurive dialektore leksikore, po pa na bërë të qartë atë që kërkohet në studimet dialektologjike, rolin dalluese të tyre në strukturën dialektore të shqipes.

Një kapitull relativisht i gjerë u kushtohet *Të folmeve shqipe të diasporës* (57 f.).

Në kopertinën dhe frontespicin e librit trajtimi i të folmeve të diasporës shqiptare konceptohet si një pjesë më vete e dytë e librit. Pra, sipas kopertinës dhe frontespicit, në pjesën e parë të librit trajtohen *Tiparet e përbashkëta dhe dallimet dialektore* (nuk thotë të kujt?!) *sipas hartave të ADGjSh-së*, kurse në pjesën e dytë *Të folmet shqipe të diasporës*, çka nënkupton që veçoritë dialektore të të folmeve të diasporës nuk do të përfshiheshin në pjesën e parë. Mirëpo në pjesën e parë, kur trajton shtrirjen e dukurive dialektore të shqipes jepen të dhëna edhe për të folmeve të diasporës (shih faqe 49, 51, 55, 56, 58, 59, 69, 71, 74,

77, 82, 83, 84, 85, 86, 87, 93, 96, 101). Si rrjedhim të folmet e diasporës nga njëra anë përfshihen në analizë e tipareve të folmeve të mbarë shqipes dhe nga ana tjetër trajtohen jashtë tyre si njësi dialektore më vete. Pra edhe në këtë pikë shfaqet një paqartësi në qëndrimin e autorit.

Pritej që, në një tekst që pretendon një paraqitje të re dhe më të argumentuar të shtrirjes së dukurive dialektore të shqipes, të arrihej edhe në konkluzione ose të reja ose të ndryshme ose më të argumentuara lidhur me strukturën dialektore të shqipes dhe veçoritë e tyre dalluese. Për fat të keq konstatojmë se ndarjes dialektore të shqipes u kushtohen vetëm 5 faqe (158-171). Dhe këto 5 faqe, edhe pse nuk thuhet shprehimisht, janë fjalë për fjalë ato që janë thënë nga J. Gjinari në dy variantet e fundit të tekstit të dialektologjisë të botuara së bashku me të në vitin 1997 dhe 2000 (ribotuar më 2003 dhe 2013), po me disa shkurtime, edhe këto aspak të justifikuara.

Struktura dialektore e shqipes, që do të duhej të ishte pjesa e dytë dhe më e rëndësishme e këtij libri dhe rezultat logjik i analizës së dukurive dialektore të parashtruara prej tij, jo vetëm që nuk vjen si rezultat logjik i të dhënave të parashtruara prej tij për shtrirjen dialektore të dukurive, po është marrë pa asnjë shpjegim nga J. Gjinari ashtu si paraqitet ajo në dy variantet e fundit të tekstit të dialektologjisë.

Ajo që të befason është se në konkluzionet lidhur me ndarjen dialektore të shqipes dhe veçoritë dalluese të tyre nuk ka asnjë fjalë lidhur me veçoritë dalluese leksikore të njësive dialektore të shqipes edhe pse paraqitjes së dukurive dialektore leksikore, siç kemi shkruar më sipër, ai u ka kushtuar 102 faqe.

Pra, nga njëra anë analiza disi të ndryshme nga tekstet e fundit lidhur me shtrirjen e dukurive dialektore të shqipes dhe nga ana tjetër konkluzione plotësisht të njëjta me këto tekste lidhur me strukturën dialektore të shqipes dhe veçoritë dalluese të tyre.

Edhe diçka tjetër lidhur me kapitullin kushtuar strukturës dialektore të shqipes. Në qoftë se gjatë analizës së dukurive dialektore nuk është përdorur kriteri strukturor a funksional, po as edhe një terminologji e tillë, në kapitullin kushtuar strukturës dialektore të shqipes (autori e quan *pjesë mbështetëse ose shkurtore rreth ndarjes dialektore të shqipes*) ose më mirë në pjesën kushtuar ndarjes dialektore, ndër të tjera, shkruhet: Disa tipare dalluese të dy dialekteve lidhen me ***strukturën fonetike e gramatikore*** të të folmeve, kurse disa të tjera, një numër i madh, nuk e prekin ***strukturën*** dhe ***funksionin e fonemave***, por lidhen me ***variante*** *thjesht ndajshtesash në* ***sistemin gramatikor*** ose *me* ***dendurinë e përdorimit të fonemave e të varianteve të strukturave*** *e të ndajshtesave gramatikore*. Ose Dy dialektet dallohen nga këto veçori në ***sistemin fonetik****:* për gegërishten është karakteristike ***seria*** *e zanoreve hundore,* pra aty ekziston ***kundërvënia*** *e zanoreve hundore me zanore gjegjëse gojore,* kurse në toskërishte ka vetëm *zanore gojore,* ose toskërishtja ka *ë* në ***serinë*** *e zanoreve të theksuara,* kurse gegërishtja nuk e ka këtë *fonemë* etj. (f. 240), ose ... të folmet e gegërishtes kanë ***serinë e fonemave zanore*** *gojore të gjata, që formojnë* kundërvënie *me të shkurtrat, kurse toskërishtja nuk e ka një* ***kundërvënie*** *të këtillë në* ***sistemin***

e fonemave *zanore* etj., me përjashtim të labërishtes e në një farë mase edhe të çamërishtes, në toskërishte *ekziston vetëm* ***seria e fonemave zanore*** *gojore të shkurtra (de:t, be:, tu:f, tufë, shpi shtëpi, fry:m frymë, fja:l fjalë, mo:ll mollë etj. në gegërishte*) (f. 241), ose Midis toskërishtes dhe gegërishtes ka një numër dallimesh që lidhen **me** ***variantet e strukturave*** *të formave gramatikore* (f. 241).

Gjithsesi ky botim i ri, duke e gjykuar nga objekti, metoda dhe përmbajtja e tij, mund të vlerësohet si një hap prapa në studimet tona dialektologjike.

E vërteta është se në të gjitha variantet e tekstit të dialektologjisë shqiptare të botuara përkatësisht më 1963, 1969, 1975, 1988, 1989, 1997, 2000 (ribotuar më 2003, 2013), përfshirë dhe këtë të fundit të botuar më 2012 nga Gj. Shkurtaj, ka një paqartësi në pozicionin teorik të autorëve, ndryshime pozicionesh teorike dhe qëndrimesh praktike nga njëri botim në tjetrin. Dhe pas më shumë se pesëdhjetë vite eksperimentimi të varianteve të të njëjtit tekstit nga i njëjti ose të njëjtit autorë, vazhdojmë të kemi në qarkullim dy tekstet e tyre që në metodën e studimit dhe të parashtrimit të dukurive dialektore të shqipes kanë të njëjtat probleme lidhur me trajtimin e dukurive dialektore të shqipes dhe strukturën e saj dialektore.

Në thelbin e vet ky libër i ri i Gjovalin Shkurtajt për dialektet e gjuhës shqipe është parashtrim jo me shumë kriter të dhënash pa inventar në fushën e dialektologjisë shqiptare.

Bahri BECI

Kujtim SHALA: **Portret semiologu në rini**, ShB Buzuku, Prishtinë, 2013, f. 175, ISBN 978-9951-08-161-0.

Libri Portret semiologu në rini i Kujtim M. Shalës (ShB Buzuku, Prishtinë, 2013, f. 175) është një lexim i parë dhe i plotë i veprës së akademik Rexhep Ismajlit që nga libri i tij debutues, përmbledhja e punimeve Shenjë e ide, për të vazhduar tutje nëpër një varg veprash që përfshijnë studime strukturale dhe funksionale të gjuhës brenda katër dekadash. Vepra është e shtrirë në dhjetë kapituj dhe një shtojcë, e cila përfshin dy intervista të Ismajlit për standardin e shqipes.

Veta autori shkruan se ky libër është shenjë për djetarin që mbetet i ri, ndërsa figura e semiologut në rini shënjon semiologun e ri edhe sot… figura e parë, 'Portret semiologu në rini' zgjerohet, kur shënjohen kërkimet sociolinguistike, në radhë të parë në fushën e planifikimit të shqipes. Vërtet, zgjerimi i tillë i figurës do të duhej të lexohej si shënjim metode për t'i hapur diskurset e Ismajlit.

Profesor Rexhep Ismajli ka mbaruar studimet e rregullta në Prishtinë më 1971, ndërsa është doktoruar më 1982. Ka specializuar në Sorbonë nën drejtimin e profesorit të shquar Andre Martinet dhe në Bohum. Për më se dyzet vjet punon në Universitetin e Prishtinës. Që nga viti 1993 është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, kryetar i së cilës ka qenë në dy mandate. Që nga viti 2002 është edhe anëtar i Akademisë Evropiane të Shkencave me seli në Vjenë dhe Salzburg, ndërsa është anëtar edhe i Interacademic Human Rights Network në Nju Jork. Është njëri ndër themeluesit e Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, duke qenë në periudha të ndryshme sekretar i përgjithshëm dhe drejtor i tij.

Rexhep Ismajli, si asnjë albanolog tjetër, e ka shtrirë rrezen e studimit të tij në një flurudhë të gjerë që përfshin strukturën e gjuhës, në të gjitha nivelet e saj, që nga fonema, deri te njësitë e tekstit, dhe që kap më tutje diakroninë dhe studimet funksionale e sociolinguistike. E gjithë kjo shtrirje në gjerësinë dhe thellësinë e saj është paraqitur në librin Portret semiologu në rini.

Kujtim M. Shala e nis diskutimin e tij për Ismajlin, duke e trajtuar vëllimin e Shenjë dhe ide, në të cilin Ismajli i nis shkrimet e tij të mbështetura në studimet e tij strukturale, të cilat do t'i zbatojë edhe në kërkimet e tij diakronike të mëvonshme.

Autori i trajton edhe hulumtimet e Ismajlit për tekstet e vjetra, përfshirë botimin kritik të gramatikës së përfshirë te Dorëshkrimi i Grotaferratës: Gramatika e parë e gjuhës shqipe, ndërsa vëren se te studimi i tij Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit (1706), ai kalon

te funksioni i gjuhës, në përftesa të zgjedhura të semiologjisë.

Më tutje, Kujtim M. Shala e diskuton edhe librin Gjuhë dhe etni të Ismajlit, duke konstatuar se gjuha, etnia dhe bashkëkohësia janë fushat që lidhen në kërkimet e mëtejme të Ismajlit, në hapjen dhe kalimin e tij nga analizat dhe historia e gjuhës te manifestimet e gjuhës si shenjë etnie dhe kombi në kontekste konkrete. Ndërkaq, në kapitullin Gjuha: status dhe korpus shtrohen për t'u trajtuar dy librat e Rexhep Ismajlit Në gjuhë dhe për gjuhë dhe Standarde dhe identitete, në të cilat ai merret me çështje të sociolinguistikës përgjithësisht dhe të standardit në radhë të parë, si dhe Drejtshkrimet e shqipes, ku Ismajli pos drejtshkrimeve ofron edhe një studim autorial të vetin që provon punën sistematike të këtij autori në fushën e planifikimit të gjuhës shqipe e të socialinguistikës në përgjithësi.

Shala konstaton se Në gjuhë dhe për gjuhë është përshkrimi më sistematik i procesit të standardizimit të shqipes në fushën e standardologjisë shqipe, po edhe libri më sistematik i Ismajlit në këtë fushë.

Lidhur me këtë fushë studimi të Ismajlit janë edhe dy intervistat në shtojcën e ofruar nga Shala.

Në kapitullin Pasionet e dijetarit diskutohet për librin e Ismajlit Pasionet dhe pësimet e Selman Rizës. Kujtim M. Shala thotë: Ismajli e pati Rizën autori të zgjedhur, një autor që e zbuloi në vijimësi për vete e për të tjerët.

Kujtim M. Shala është një ndër studiuesit më prodhimtarë dhe me ndikim në fushën e studimeve letrare shqiptare. Nga vitit 1999, ka mbetur njëzet libra me studime, në mesin e të cilëve është edhe Portret semiologu në rini.

Autori Kujtim M. Shala, përmes këtij libri, krijon bazë të mirë dhe të qëndrueshme të studimeve të ardhshme për njërin ndër autoritetet kryesore të albanologjisë përgjithësisht. Ai, duke e përshkruar rrugën krijuese të një autori me ndikim në letrat shqipe, ka arritur të përshkruajë njëherësh një pjesë të historisë së studimeve të albanistikës në dekadat e fundit.

Bardh RUGOVA

Besim BOKSHI: **VARIA,** Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2014.

Akademik Besim Bokshi dorëzoi për botim në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës në çastet e fundit të jetës së tij dorëshkrimin me titull **Varia**. Për fat të keq, libri nuk arriti të delte sa ishte gjallë ai.

Dorëshkrimi përmbledh në vete disa pjesë trajtesash të ndryshme, disa të natyrës ngushtësisht shkencore-hulumtuese, disa diskutime për çështje të ndryshme, ndër to edhe për çështje të drejtshkrimit dhe të shqipes standarde dhe disa të tjera të një natyre shënimi për autorë të ndryshëm, apo edhe shënimi përkujtimor. Për këtë arsye dorëshkrimi mban titullin **Varia**.

Autori vetë i ka klasifikuar ndihmesat e përfshira në këtë vëllim si vijon:

1. Çështje albanistike janë përmbledhur kumtesat e mbajtura në konferenca e tryeza shkencore:

a) Emrat e ditëve të javës - dëshmi e një gjendjeje të lashtë të fleksionit emëror të shqipes,

b) Vështrim krahasues i sistemit rasor të Mesharit me tipat e tjerë të sistemit rasor të shqipes,

c) Sistemimi i parafjalëve të shqipe (e pakumtuar),

ç) Rreth problemit të paskajores në gjuhën shqipe,

d) E folmja e arbneshëve të Zarës në veprën e Idriz Ajetit,

dh) Trajtimi i relikteve gjuhësore nga Selman Riza,

e) Për theksin e shqipes dhe për lëvizjen e hershme të tij,

ë) Politika gjuhësore në disa vise të Jugosllavisë.

2. *Çështje ballkanistike*:

a) Emrat e ditëve të javës - dëshmi e një gjendjeje të lashtë të fleksionit emëror të shqipes,

b) Vështrim krahasues i sistemit rasor të Mesharit me tipat e tjerë të sistemit rasor të shqipes,

c) Sistemimi i parafjalëve të shqipe (e pakumtuar),

ç) Rreth problemit të paskajores në gjuhën shqipe, e zanoreve në gjuhët ballkanike.

3. *Për disa personalitete akademike:*

Cimochowski, Shaban Demiraj në 80-vjetorin e lindjes, *Selman Riza* në 100-vjetorin e lindjes, *Idriz Ajeti, Eqrem Çabej, Rexhep Ismajli, Fehmi Agani* në 70-vjetorin e lindjes, *Mark Krasniqi* në 90-vjetorin e lindjes, *Jashar Rexhepagiqin* në 80-vjetorin e lindjes, *Pajazit Nushi, Ali Podrimja, Din Mehmeti, Brdhyl Çaushi, Qamil Gexha*.

4. *Fjalë përshëndetëse e falënderuese,* ku hyjnë fjalët që ka mbajtur nëpër konferenca e tryeza shkencore në emër të Akademisë si nënkryetar dhe kryetar i saj. Kjo pjesë mbyllet me intervistën e Bokshit për gazetën Rilindja të vitit 1990.

5. Në fund janë përfshirë diskutimet dhe mendimet e Bokshit për disa ndryshime që ai mendon se duhet të bëhen në drejtshkrim të shqipes standarde për të theksuar më tej parimin fonetik, d.m.th. përafrimin e formës së shkruar me shqiptimin dhe në disa pika morfologjike që bëjnë presion që të hyjnë në shqipen standarde në funksion të begatimit e të lehtësimit të shprehjes, d.m.th. në për lehtësimin e përdorimit më të përgjithësuar të saj.

Në përgjithësi trajtesat albanologjike dhe ballkanologjike kanë të bëjnë me strukturat morfologjike të shqipes, si *Emrat e ditëve të javës, Sistemi rasor i Mesharit me tipat e tjerë të sistemit rasor të shqipes, Sistemimi i parafjalëve të shqipe, Paskajorja në gjuhën shqipe, Theksi në shqipen,* pastaj, pastaj diskutime për statusin e shqipes në Kosovë e Jugosllavi, etj. Disa prej këtyre ndihmesave janë botuar më parë nëpër organe të ndryshme, ndërsa disa botohen këtu për herë të parë. Në përgjithësi këto shqyrtime i shquan metoda e sprovuar më herët e Besim Bokshit, me vështrimet e tij në dy akset e strukturimit të gjuhës – paradigmatike e sintagmatike, duke hetuar me ngulm karakterin sistemor. Vështrimet tij në këto fusha, si gjithandej në studimet e mëhershme, përshkohen nga fryma e gjuhësisë strukturale.

Ndihmesat e tjera janë të natyrës së diskutimeve, në një pjesë thjesht shkencore për çështje të ndryshme albanistike, por ka edhe diskutime të tjera. Pjesa Për personalitetet përfshin fjalë të Besim Bokshit me raste të ndryshme qoftë për personalitete të shquara të albanistikës të fazave më të hershme, qoftë dhe për bashkëkohës të tij. Një pjesë e këtyre shënimeve ka të bëjë me personalitete të jetës sonë kulturore e shoqërore, përtej albanistikës.

Në përgjithësi libri përmban tekste të natyrës shkencore, përveç pjesëve për personalitetet dhe fjalëve përshëndetëse, që janë më tepër reflekse pas leximeve të mëhershme, ose shënime të rastit.

Libri shquhet, si gjithnjë te Bokshi, për stilin e tij konciz dhe për korrektesën ndaj çështjeve dhe të tjerëve.

Rexhep ISMAJLI

Skënder BLAKAJ e Ismail ISMAILI: **Letërkëmbime të Rilindjes Kombëtare Shqiptare**, të botuar nga Arbi Ltd. Prishtinë e Vatra New York, në një gjerësi prej 703 faqe.

Botimet epistolare, me përmbledhje letrash reale a fiktive, me adresë e korrespondent, me elemente të theksuara personale, shpesh me karakter intim, në raste të tjera të natyrës më zyrtare, por gjithnjë me qëndrim të shprehur autorial, gjithnjë në dialog nga larg me marrësin, janë të njohura qysh nga lashtësia greko-romake.

Botimet epistolare shqip kanë qenë të lidhura me zhvillimet e përgjithshme kulturore e të historisë së shkrimit, nuk mund të jenë më të vjetra se fillimet e shkrimit shqip. Por shqiptarët kanë marrë pjesë në këtë lloj komunikimi më herët e në gjuhë të tjera.

Autorët e botimit që po paraqesim kanë ardhur me një propozim letrash të njohura e të panjohura, të botuara e të pabotuara, me emërtimin Letërkëmbime të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, çka e përcakton përmbajtjen. Autorët kanë vënë si kufi vitin 1913, krijimin e Shtetit të Shqipërisë. Duke zbritur në kohë ata kanë ndjekur kriter tjetër: kanë përfshirë letra edhe të periudhave të mëhershme, përfshirë letra të dërguara nga hapësirat shqiptare qysh në sh. I para Krishtit. Të nisur nga shtytjet atdhetare, nga nevojat për theksimin e fillit të lashtë të dëshmisë ekzistenciale në këto hapësira përmes letrave, ata e kanë shpërthyer shumëfish kufirin kohor të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, që nuk mund të shkojë para sh. 19. E kanë shpërthyer dhe kufirin e gjuhës shqipe: kanë përfshirë letra në gjuhë të ndryshme dhe letra nga kohë shumë të hershme. Mbase kjo pjesë mund të hiqej dhe libri do të mbetej po kështu i vlefshëm dhe më homogjen e në pajtim me titullin.

Për periudhën e Rilindjes kanë sjellë një letërkëmbim me përqëndrim të hetueshëm: letra nga fillimi i sh. 19, duke nisur me Lord Byronin e deri te N.Veqilharxhi, për të vijuar me një korpus 76 letrash të F. Konicës, 16 letrash të N. Naços, 35 letrash të V. Dodanit, 9 letrash të D. Himës, 11 letrash të Princit A. Gjika, një korpusi 29 letrash për shkollat shqipe, 63 letrash të tjera të kohës së Rilindjes dhe 32 letrash të ditëve të shpalljes së Pavarësisë. Më vete ky korpus është impozant qoftë si autorësi, qoftë si larmi temash. Sigurisht që botimi do të merrte peshë edhe më të madhe sikur të kishim përpara përgjigjet eventuale përkatëse për këto letra nga ata të cilëve u janë drejtuar. Gjendja e hulumtimeve në të cilën jemi, për fat të keq, nuk e ka bërë të mundur këtë punë, pos në pak raste. Ata kanë zgjedhur që vepra të mbarojë me shënimin e Y. Jakës për një libër të panjohur për Skënderbeun të vitit 1913 dhe me shënimet e S. Blakajt *Në mbyllje*.

Letrat e shumta të Konicës paraqesin interes të veçantë. Kjo bie në sy po të lxoni shumë syresh, ndër to edhe letrën që i dërgonte Princ Wiedit në dhjetor 1913, në të cilën ai

përpiqej të shprehte gjithë mirësinë dhe mirëseardhjen për Princin, duke vënë në pah një varg sugjerimesh për ndërmarrjet që do të rezultonin në harmoni me pritshmëritë shtetformuese dhe emancipuese për vendin në raport me dispozitat dhe pambarësitë e tij, të cilën pata mundësi ta krahasoja me Letrën e hapur të tij për K. Brugmann *Gjermania dhe Shqipëria*, në vitin 1915, e cila letër shquhet me një ton ekzemplar polemizues dhe refuzues të synimeve të aktit të dërgimit të një mëkëmbësi si *princ i aftë për të menduar dhe për të vepruar*, por tani të karakterizuar dëshpërueshëm plot ironi, si: *Mesi i sojit të gjeniut me gjashtëkëmbësh, i sjellshëm, i qeshur (edhe pa motiv), fëmijë i mirë sa s'ka më, por që për budallallëkun nuk kishte çift nga Nijmeni e në Rin dhe nga Lybeku e në Pasau. Një fatkeqësi e thjeshtë! Një vendi pre të intrigave dhe të përçarjeve, i cili priste një kokë të kthjellët dhe një dorë të fortë për ta shpëtuar dhe për ta drejtuar, princi Wilhelm zu Wied erdhi t'ia shtonte inkoherencën dhe t'ia rriste çrregullimin.* Shkëlqen i tërë dinamizmi i shpirtit konician, që herë të tjera, nëpër letrat që na kanë sjellë Blakaj-Ismaili mund të dalë dhe me nuanca dëshpëruese. Letrat e shfaqin atë sipas dinamikës kohore, sipas ngjarjeve, gjithnjë në gjallërinë e pashoqe.

Merita e autorëve tanë është se kanë sjellë shumë letra më parë të panjohura të Konicës, me një përkthim të shkëlqyer të romanistit Ymer Jaka, por jo pak të qëlluara edhe ato të I. Ismailit, më tej letrat pak të njohura të N. Naços, letra të njohura e të panjohura të V. Dodanit, të D. Himës, të A. Gjikës e gjithato letra për shkollat e për periudhën e Rilindjes. Si i tillë ky libër mund të shërbejë si nxitje për botime të tjera sistematike të letërkëmbimit sipas periudhave dhe çështjeve, e aq më shumë për njohjen e kohës, të ngjarjeve e të mënyrave të komunikimit, të kulturës së shkrimit e të personalitetit të autorëve.

Në pjesën *Letra të moçme* autorët kanë përfshirë 25 letra, prej të cilave 19 nuk lidhen as kohësisht me kuadrin e përgjithshëm të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Hyjnë aty letrat me peshë dokumentare të e P. Budit, F. Bardhit e P. Bogdanit, nga kuadri i letrave të priftërinjve të rëndësishëm, ku mund të gjendeshin dhe letra të Gj. N. Kazazit, por janë përfshirë letra të mëhershme nga Butrinti qysh para Krishtit, letra të Ciceronit nga lashtësia, letra anonime e vitit 1308, letra të krerëve të Arbërisë për Papën, letra e G. Adamit, letra të Skënderbeut dhe letra për Skënderbeun, etj. Një korpus më vete në ketë periudhë paraqet letërkëmbimi i priftërinjve shqiptarë dhe prej viseve shqiptare me Vatikanin, që këtu është paraqitur vetëm pjesërisht. E tërë kjo pjesë nis me shënimin e D. Farlatit të vitit 1751për mitin: *Ilirët janë bijtë e pellazgut Herkul.*

Ky libër i punuar me kujdes dhe dashuri, i ilustruar me faksimile letrash dorëshkrim, i prirë nga parathënia shpjeguese e S. Blakajt: *Letërkëmbimi si jetëshkrim* dhe tjetra e frymëzuar e Efthim Dodonës: *Dy fjalë për librin*, paraqet një vepër me vlerë në fushën e botimeve epistolare shqiptare. Ai do të shërbejë si nxitje për punë të tjera të ngjashme në këtë fushë dhe, çka është më me rëndësi, për thellimin e hulumtimeve. Ai tashmë është ndihmesë e çmueshme për njohjen e rrethanave, të jetës e të përpjekjeve të pashoqe të verpimtarëve të Rilindjes të para nga autorët si të pashkëputura nga rrjedha e moçme veprimtare për mëvetësinë e vendit.

Rexhep ISMAJLI

Engjëll ANGONI, Tiranë

BIBLIOGRAFI PËR VEPRËN E SELMAN RIZËS (1909 – 1988)

Krijimtaria shkencore e prof. Selman Rizës, si dhe shkrimet e mjaft autorëve kushtuar jetës dhe veprës së tij, gjendet e shpërndarë në organe të ndryshme, të botuara në Shqipëri, në Kosovë e gjetkë. Prandaj e gjykuam të nevojshme t'i përfshijmë në një bibliografi të veçantë, me qëllimin e mirë që studiuesit dhe lexuesit të kenë mundësi të njohin dhe të vlerësojnë jetën dhe veprën e këtij gjuhëtari e atdhetari të shquar, por edhe të shfrytëzohet sa e si duhet veprimtaria e tij e pasur shkencore, gjithmonë e gjallë e frymëzuese.

Bibliografia është ndarë në dy pjesë: në të parën është përfshirë krijimtaria shkencore e Selman Rizës, e ndërsa në të dytën janë përmbledhur shkrimet e autorëve të ndryshëm, kushtuar jetës dhe veprës së tij. Ndërkaq, shkrimet dhe veprat e atyre autorëve shqiptarë e të huaj që nuk u kushtohen në tërësi jetës dhe veprimtarisë shkencore të Selman Rizës, edhe pse mund të kenë, ndër të tjera, të dhëna e vlerësime me interes për të, nuk janë përfshirë në këtë bibliografi.

E gjithë lënda bibliografike është renditur kronologjikisht, sipas kohës së botimit, deri në vitin 2013 (përfshirë), por, kur kjo nuk ka qenë e mundur, brenda një viti, është bërë renditja alfabetike sipas emrit të autorit. Ribotimet, me ose pa ndryshime, janë shënuar të botimi i parë. Titujt e veprave janë dhënë me dy theksime, ndërsa artikujt, kumtesat, diskutimet, recensionet etj. me një nënvizim.[1]

Me gjithë përpjekjet e bëra, nuk mëtojmë që kjo bibliografi të jetë shteruese dhe e përkryer, prandaj mirëpresim çdo vërejtje e sugjerim për plotësimin dhe përmirësimin e saj të mëtejshëm.

Shpresojmë që kjo bibliografi t'u shërbejë studiuesve dhe lexuesve jo vetëm për t'u njohur me jetën dhe veprën e pasur të këtij gjuhëtari e atdhetari në zë, por dhe si mjet i volitshëm që do të ndihmojë për të çuar më përpara punën kërkimore-shkencore në lëmin e shqipes, e cila ka mjaft probleme të mëdha e të vështira, me karakter teorik e praktik, që presin të zgjidhen.

Ndërkaq e shikojmë të arsyeshme të vëmë në dukje se në Arkivin e Institutit

[1] Redaksia vendosi që të gjitha nënvizimet t'i jepte me kursiv, ndërsa nga titujt e botimeve, revistave t'i hiqte thonjëzat.

të Gjuhësisë dhe të Letërsisë pranë Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, si dhe sidomos në Arkivin vetjak të Selman Rizës pranë familjes, ruhet një pasuri e tërë me materiale gjuhësore e dokumente nga më të ndryshmet, të daktilografuara ose në dorëshkrim, një pjesë e mirë e të cilave nuk janë botuar ndonjëherë, ndaj paraqitin interes për studiuesit tanë e të huaj. Që të gjitha këto ruhen me kujdes dhe në gjendje të mirë, të vendosura në 22 dosje në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë dhe në 21 dosje të tjera në Arkivin vetjak të Selman Rizës pranë familjes. Në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë përfshihen kryesisht dorëshkrimet e pothuaj të gjitha punimeve të botuara të këtij gjuhëtari, madje, disa, edhe në disa variante, hartuar gjatë veprimtarisë së tij shkencore pranë atij instituti, ndërsa në Arkivin vetjak pranë familjes përfshihen, ndër të tjera, jo vetëm materiale e dokumente nga puna e tij 11-vjeçare në Institut, por edhe gjithë veprimtaria krijuese 20-vjeçare, pasi e larguan nga puna në prill të vitit 1967.

I. *VEPRIMTARIA E PROF. DR. SELMAN RIZËS*

(*vepra, monografi, artikuj, kumtesa, diskutime, recensione*)

1930

1. *Serbët dhe kosovarët* (Përgjigje Pater Leon Ashikut Shqipëria e re, Konstancë, 1 tetor 1930, nr. 439 f. 1 (Shkrimi është botuar me pseudonimin Një djalë kosovar, shih dhe Palokë Daka. *Fjalor i pseudonimeve (1713-1944)*, Tiranë, 1988, f. 173): Koha jonë, Tiranë, 7.7.2003 f. 16: 55, Tiranë, nr. 229 (1717). F. 19. Koha ditore, Prishtinë, nr. 229, 20.11.2004, f. 26: Shqip, Tiranë, 16.12.2008, nr. 347 (997. f. 19.

1936

2. *Shqiponja dhe shqipja*, Përpjekja shqiptare, Tiranë, 1 tetor 1936, nr. 1, f. 28-29; *Tri monografna albanologjike*. Biblioteka shqiptare. Mesagjeritë shqiptare, Tiranë, 1944, f. 219-228.

1938

3. *Dilettantismi dhe zanati*. Përpjekja shqiptare, Tiranë, janar 1938, nr. 13, f, 82-84: *Selman Riza – gjuhëtar dhe atdhetar i shquar*. Shtëpia Botuese Toena, Tiranë, 1999, f, 101-104: Tema, Tiranë, 11-12.XX.2001, nr. 427, f. 14: *Vepra 4*. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2004, f. 7-10, Shqip, Tiranë, 6.4.2009, nr. 92 (1103), f. 29.

1944

4. *Një shqipnim i padenj i kryeveprës së Sufflay-it*, Kritika, Tiranë, 3 maj 1944, f. 87-97.
5. *Pozita e toskërishtes letrare*, Revista letrare, Tiranë, 15.8.1944, nr. 13, f. 1.
6. *Tri monografina albanologjike*, Biblioteka shqiptare, Mesagjeritë shqiptare, Tiranë, 1944, 228 f. (Përmbajtja: *Parathanje e përbashkët*, f, 3-8: *Abeceja*, f, 9-35: *Drejtëshkrimi*, f. 36-102: *Çështja gjuhësore*, f. 103-209: *Mbasthanje e për-*

bashktë, f, 211-216: Shtojcë: *Shqiponja dhe shqipja*, f, 219-228); *Vepra I*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 1966, f 3-222: Vepra të zgjedhura, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2009, f. 17-224.

1951

7. *Problemi gjuhësuer dhe zgjidhja e tij*, Jeta e ré, Prishtinë, 1951, nr. 5, f, 273-276: *Vepra V*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2009, f. 109-111.

1952

8. *Gramatikë e serbokroatishtes*, 1. Fonetikë, 2. Morfologji, Shtëpia Botuese Krahinore Mustafa Bakija, Prishtinë, 1952, 278, f.: *Vepra 2*. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 1997, f. 317-596.
9. *Fillimet e gjuhësisë shqiptare*, Shtëpia Botuese Krahinore Mustafa Bakija, Prishtinë, 1952, 126 f.. *Vepra 1* , Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 1966, f. 223-351.

1953

10. *Diftorët e shqipes dhe historiati i tyne*, Shtëpia Botuese Krahinore Mustafa Bakija, Prishtinë, 1953, 59, f.: *Studime albanistike 1*, Rilindja, Prishtinë, 1979, f. 417-475: *Vepra 3*. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2002, f. 429-487.
11. *Hyrje në fjalorthin terminologjik*, Rilindja, Prishtinë, 1953.
12. *Një shqyrtim kritik mbi Fjalorin e Bariqit*, Jeta e ré, Prishtinë, 1953, nr, 6, f. 426-441: *Vepra 4*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2004, f. 193-208.

1954

13. *Albanologjia dhe albanistika*, Rilindja, Prishtinë, 21.3.1954, f. 7.
14. *Në marzh të Shqyrtimit kritik mbi Fjalorin e Bariqit*, Jeta e ré, Prishtinë, 1954, nr. 2, f. 125-136: *Vepra 4*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2004, f. 209-224.
15. *Rishbotimi i fjalorit të Konstantin Kristoforidhit*, Rilindja, Prishtinë, 1.8.1954, f. 5.

1955

16. *Kritika reciproke në shërbim të lavrimit gjuhësuer*, Përparimi, Prishtinë, 1955, nr. 5, f. 300-304.
17. *Kritikë gjuhësore e njëj referati letrar*, Përparimi, Prishtinë, 1955, nr. 6, f. 369-373.
18. *Linguistika, filologjia dhe gramatika deskriptive*, Përparimi, Prishtinë, 1955, nr. 1-2, f. 47-54: *Vepra 4*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2004, f. 11-18.

1958

19. *Mbi vlerën fonetike të grafive buzukjane ѵ (sllave dhe v (latine).* Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria shkencat shoqërore, Tiranë, 1958, nr. 1. f.

81-84.

20. *Nyjat e shqipes* (Punim përshkrues normativ), Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria shkencat shoqërore, Tiranë, 1958, nr. 2, f. 3-72, *Studime albanistike 1*, Rilindja, Prishtinë, 1979, f, 147-218: *Vepra 3*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë 2002, f. 161-230; *Vepra V*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2009, f. 269-369
21. *Pronorët e shqipes* (Punim historik e kritik, kërkues e dokumentues), Autoreferat i disertacionit për marrjen e gradës shkencore "kandidat i shkencave filologjike, botim i shaptilografuar i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Fakultetit Histori-Filologji, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1958, f. 34: Studime albanistike 1, Rilindja, Prishtinë, 1979, f. 395-415: *Vepra 3*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2002, f. 407-427.

1959

Laureati Prof. Dr. Qëndrim Gashi në fjalën e tij pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, falënderoi Akademinë për *Shpërblimin mbështetës.* Ai tha se ndjehet jashtëzakonisht i nderuar dhe i privilegjuar që merr këtë shpërblim, nga Institucioni më i lartë i Shkencës dhe i Artit në vend dhe u zotua se do ta mbajë me nder gjatë gjithë jetës dhe veprimtarisë së tij.

MBAHET LIGJËRATA INAUGURUESE E ANËTARIT KORRESPONDENT SALIH GASHI

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, më 13 shkurt 2014 organizoi ligjëratën inauguruese të anëtarit korrespondent, prof. dr. Salih Gashit, me temë: ‘’Proceset membranore dhe zbatimi i tyre’’. Fjalën e hapjes më këtë rast e mbajti sekretari i Seksionit të Shkencave të Natyrës akademik Fejzullah Krasniqi.

AKADEMIK HIVZI ISLAMI DHE ANËTARE KORRESPONDENTE EDI SHUKRIU INAUGUROHEN ANËTARË TË AKADEMISË EVROPIANE TË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE

Më 8 mars 2014, në Asamblenë e përgjithshme të Akademisë Evropiane të Shkencave dhe të Arteve (ASAE), me seli në Salcburg të Austrisë, u bë inaugurimi solemn i dy anëtarëve të kësaj Akademie, prof. dr. Hivzi Islamit, demograf, anëtar i rregullt i AShAK dhe kryetar aktual i saj, dhe prof. dr. Edi Shukriut, arkeologe, anëtare korrespondente. Akademikët Islami dhe Shukriu në nëntor të vitit 2013 ishin zgjedhur anëtarë të Akademisë Evropiane të Shkencave dhe të Arteve.

NËNSHKRUHET MARRËVESHJA E BASHKËPUNIMIT ME AKADEMINË E SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË MAQEDONISË

Në Prishtinë, më 11 mars 2014 - Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Maqedonisë, nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit në fushat e shkencave dhe arteve. Marrëveshja u nënshkrua në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës nga Kryetari i AShAK-ut, Akademik Hivzi Islami dhe Kryetari i Akademisë së Maqedonisë Akademik Vlado Kambovski.

Para ceremonisë së nënshkrimit u zhvillua takimi në mes të udhëheqjes së Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe delegacionit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë. Kryetari i MANU-së, Akademik Vlado Kambovski, shoqërohej nga Nënkryetari, Akademik Lupço Kocarev, Sekretari, Akademik Gjorgji Stardellov, dhe Akademikët Alajdin Abazi e Luan Starova, dhe nga Ambasadori i Maqedonisë në Kosovë, H.E. Stojan Karajanov.

Format e bashkëpunimit ndërakademik mes të tjerash do të jenë përmes modaliteteve: takime bilaterale shkencore, simpoziume, konferenca dhe seminare pune, si dhe aktivitete në fushën e arteve që mbulohen nga Palët; shkëmbim të shkencëtarëve; shkëm-

bim të informacioneve dhe publikimeve; mbajtje të ligjëratave; dhe aktivitete të tjera nëse është e nevojshme, sipas marrëveshjes ndërmjet të dy palëve.

ANËTAR KORRESPONDENT ARSIM BAJRAMI MERR PJESË NË KONFERENCËN SHKENCORE NDËRKOMBËTARE NË UNIVERSITETIN SHTETËROR TË TETOVËS

Më 11-13 mars anëtari korrespondent Arsim Bajrami ka përfaqësuar AShAK-un në Konferencën shkencore ndërkombëtare me titull: ''Demokracia dhe sfidat e transicionit demokratik'', të mbajtur në Universitetin Shtetëror të Tetovës. Profesor Bajrami në konferencë ka paraqitur kumtesën me titull: ''Sfidat e transicionit në Kosovë''.

MBAHET NË PRISHTINË MBLEDHJA E KËSHILLIT NDËRAKADEMIK PËR GJUHËN SHQIPE

Në mjediset e Qendrës leksikografike-enciklopedike të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, më 14 mars 2014, u mbajt mbledhja e radhës e Këshillit Ndër-akademik për Gjuhën Shqipe. Mbledhja u mbajt nën drejtimin e akad. Rexhep Ismajlit dhe akad. Jani Thomait (bashkëkryetarë), me pjesëmarrjen e akad. Besim Bokshit, akad. Ethem Likajt, akad. Kolec Topallit, akad. Gjovalin Shkurtajt, prof. dr. Shezai Rrokajt, prof. dr. Mehmet Çelikut, prof. dr. Seit Mansakut, prof. dr. Enver Hysës, prof. dr. Tomor Osmanit, prof. dr. Imri Badallajt, prof. dr. Shefkije Islamajt, ligjërues Isa Bajçincës, prof. dr. Bardh Rugovës, prof. dr. Rrahman Paçarrizit dhe prof. dr. Abdullah Zymberit.

Diskutimet u zhvilluan në tri seanca sipas materialeve të parapërgatitura nga grupet e punës për çështje të drejtshkrimit dhe të morfologjisë nga Tirana, si dhe nga anëtari i Këshillit e i kryesisë së tij akad. Kolec Topalli, të diskutuara me shënime të veçanta edhe nga grupet përkatëse nga Prishtina.

MBAHET LIGJËRATA INAUGURUESE E ANËTARIT KORRESPONDENT ARSIM MORINA

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, më 28 mars 2014organizoi ligje-ratën inauguruese të anëtarit korrespondent, prof. dr. Arsim Morinës, me temë: "Shkenca e Neurokirurgjisë sot". Fjalën e hapjes me këtë rast e mbajti sekretari i Seksionit akademik Fejzullah Krasniqi.

ANËTAR KORRESPONDENT LUAN MULLIQI NË RUMANI

Më 2-6 prill, anëtari korrespondent Luan Muliqi me ftesën e galerisë Triada

Timisuara ka marrë pjesë në ekspozitën personale, në të cilën ka paraqitur 20 punime të derdhura në bronz. Ekspozita ka zgjuar interesim si te kritika ashtu edhe te mjetet e informimit dhe të publikut prezent. Profesor Mulliqi po ashtu ka marrë pjesë edhe në tryezën:''Mundësitë e bashkëpunimit kulturor rajonal''.

AKADEMIK EQREM BASHA NË TUBIMIN E ALLEA-s.

I deleguar nga AShAK, akademik Eqrem Basha ka marrë pjesë në tubimin e ALLEA-s (All European Academies), në Bruksel, më 8-10 prill 2014. Ai është takuar me përfaqësues të Akademisë Mbretërore Flamane, me të cilët Akademia jonë ka marrëveshje bashkëpunimi. Profesor Basha po ashtu ka marrë pjesë edhe në ceremoninë në të cilën ndahej Çmimi i lartë i ALLEA-s, ku prezentë përveç përfaqësuesve të shumë Akademive Europiane, ishte edhe Kryetari i Komisionit Europian, Jose Emanuel Baroso.

LIGJËRATA INAUGURUESE EDI SHUKRIU

Në mjediset e Akademisë, më 17 prill 2014 u mbajt Ligjërata inauguruese e anëtares korresp. Edi Shukriu:"Tej imazhit arkeologjik – Kosmologjia dardane". Fjalën e hapjes më këtë rast e mbajti sekretari i Seksionit të Shkencave Shoqërore akademik Mark Krasniqi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit tha se ligjërata inauguruese po mbahet me rastin e zgjedhjes së Prof. Shukriut anëtare korrespondente e AShAK.

AKADEMIK REXHEP ISMAJLI NË ASAMBLENË E XV TË PËRGJITHSHME TË ALLEA-s

Më 23-26 prill 2014 akademik Rexhep Ismajli ka qëndruar në Oslo. Në mjediset e Akademisë Norvegjeze të Shkencave dhe të Arteve në Oslo ai ka marrë pjesë në Asamblenë e XV e përgjithshme e ALLEA-s. Në kuadër të punimeve të Asamblesë akademik Ismajli ka marrë pjesë në Simpoziumin me temë: ''Enabling Early Carrier Researchers –Need for Training of a New Generation''.

AShAK MERR PJESË NË FESTIVALIN E LIBRIT DHE ARTIT

Më 23-27 prill, në Tiranë AShAK mori pjesë me botimet e veta në *Festivalin e Parë të Librit dhe Artit, Tirana 2014*. Manifestimi u mbajt në Muzeun Historik Kombëtar dhe u organizua nga Shoqëria e Librit Shqip.

AKADEMIK ZEQIRJA BALLATA MERR PJESË
SIMPOZIUMIN NDËRKOMBËTAR MBI ARTET NË SOFJE

Me ftesë të Akademisë së Shkencave të Bullgarisë, në kuadër të Protokollit të

bashkëpunimit AShAK-BAS, akademik Zeqirja Ballata ka marrë pjesë në Simpoziumin 5-ditor ndërkombëtar mbi artet, të organizuar nga Instituti i Studimeve të Arteve të Akademisë së Shkencave të Bullgarisë. Akademik Ballata është paraqitur me kumtesën: ‘’Mbi disa veçori të kompozitorëve shqiptarë të Kosovës, të shek. XX’’.

AKADEMIK REXHEP ISMAJLI MERR PJESË NË PLENUMIN SOLEMN TË AKADEMISË AUSTRIAKE TË SHKENCAVE

Më 15 -19 maj akademik Rexhep Ismajli ka qëndruar në Vjenë ku ka marë pjesë në Plenumin Solemn të Akademisë Austriake të Shkencave. Ai atje ka marrë pjesë edhe në organizimet tjera në kuadër të plenumit, si dhe ka realizuar takime të rëndësishme.

TRAJNIMI PËR FJALORIN ENCIKLOPEDIK

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, përkatësisht Redaksia Qendrore e FEK-ut ka organizuar Takim pune për Fjalorin Enciklopedik të Kosovës në Durrës nga 9-12 qershor 2014. Në takim kanë marrë pjesë:Redaksia Qendrore e Fjalorit dhe redaktorët e fushave përkatëse të FEK-ut, me përjashtim të ndonjë zëvendësimi të tyre nga një anëtar i redaksisë përkatëse. Takimi është realizuar sipas programit të paraparë.**ÇMIMI STIMULUES I FONDIT**

Më 16 qershor 2014 u organizua ceremonia solemne e ndarjes së *Çmimit stimulues* për veprën më të mirë nga lëmi i shkencave të Natyrës për tre vjetët e fundit (2011-2013). Laureati i këtij çmimi u zgjodh Prof. Dr. Lulzim Zeneli. Fjalën e hapjes me këtë rast e mbajti akademik Fejzullah Krasniqi, ndërsa për veprimtarinë shkencore të Prof. Zenelit foli akademik Nexhat Daci, i cili e vlerësoi lartë punën e tij. Në fund Prof. Zeneli falënderoi AShAK, për çmimin e dhënë.

TRYEZË SHKENCORE

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Seksioni i Shkencave Shoqërore, organizoi Tryezën shkencore "Arkeologjia në trojet shqiptare: Sfidat dhe mundësitë". Tryeza u mbajt të enjten, më 19 qershor 2014, me fillim në orën 9:30, në mjediset e Akademisë. Fjalën e hapjes e mbajti sekretari i Seksionit akademik Mark Krasniqi.

AKADEMIK PAJAZIT NUSHI MERR PJESË NË KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE KUSHTUAR AKADEMIKUT JASHAR REXHEPAGIQI

Me ftesë të Akademisë Pedagogjike të Tiranës, akademik Pajazit Nushi ka marrë pjesë në Konferencën ndërkombëtare me titull: ‘’Akademik Jashar Rexhepagiqi dhe

mendimi social-pedagogjik i tij''. Akademik Nushi është paraqitur me kumtesën e tij: ''Psikologjia dhe pedagogjia në mendimin social-pedagogjik të akademik Jashar Rexhepagiq''.

ANËTAR KORRESONDENT SALIH GASHI QËNDRON NË KOPENHAGEN

Më 21-26 qershor anëtar korrespondent Salih Gashi ka qëndruar në Kopenhagen, ku ka marrë pjesë në tubimin:''Euroscience Open Forum (ESOF). Ai ka realizuar edhe takime të rëndësishme në kuadër të zhvillimit të shkencës dhe orientimet për të ardhmen.

AShAK MERR PJESË NË SHKOLLËN VERORE DHE KONFERENCËN LET'S FACE CHAOS THROUGH NONLINEAR DYNAMICS

Më 22 qershor deri më 6 korrik 2014, në Maribor u mbajt shkolla verore dhe konferenca: ''Lets's Face Chaos Through Nonlinear Dynamics''. Në emër të AShAK, në këtë ngjarje mori pjesë Prof. Dr. Qëndrim Gashi.

KONCERT VEPRASH VOKALO-PIANISTIKE

Seksioni i Arteve i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, më 3 korrik 2014, në mjediset e Akademisë organizoi Koncert veprash vokalo-pianistike, me vepra të përzgjedhura kompozitorësh të njohur: Wolfgang Amadeus Mozart, Franz Lehar, Kozma Lara, Esat Rizvanolli, Fahri Beqiri, Zeqirja Ballata, Rauf Dhomi. Artistët: Besa Llugiqi, soprano,Armando Likaj, bariton Lejla Haxhiu Pula, piano, Etrita Ibrahimi, piano, Çun Lajqi, aktor,realizuan me shumë sukses programin e paraparë.

TUBIM SHKENCOR-GJUHA E SIMETRIVE

Më 11 korrik 2014, në sallën e Akademisë, Seksioni i Shkencave të Natyrës, përkatësisht Këshilli organizativ: Dr. Qamil Haxhibeqiri (AShAK), Dr. Masoud Kamgarpour (Universiteti i Kuinslandit) dhe Dr. Qëndrim Gashi (Universiteti i Prishtinës), organizoi Tubimin shkencor me titull: "Gjuha e simetrive-një këndvështrim nga teoria e përfaqësimit dhe gjeometria" Referues në këtë tubim ishin:Dr. Ethan Cotterill, Universiteti Federal Fluminese, Brazil,Dr. Harald Grobner, Universiteti i Vjenës, Austri,Dr. Masoud Kamgarpour, Universiteti i Kuinslendit, Australi, Robert Kremser, Universiteti i Mynihut, Gjermani, Dr. Marie-Amelie Lawn, Universiteti i Teksasit, Austin, SHBA, Dr. Justin Noel, Universiteti i Regensburgut. Gjermani, Dr. Travis Schedler, Universiteti i Teksasit, Austin, SHBA.

MBAHET NË TIRANË MBLEDHJA E KËSHILLIT NDËRAKADEMIK PËR GJUHË SHQIPE (KNGJSH)

Më 20 qershor 2014, në Tiranë, në mjediset e Bibliotekës së Akademisë së Shkencave, u mbajt mbledhja e radhës e Këshillit Ndërakademik për Gjuhën Shqipe, nën drejtimin e akademikëve Jani Thomai e Rexhep Ismajli (bashkëkryetarë) dhe me pjesëmarrjen e anëtarëve të Këshillit: akademikët Kolec Topalli e Gjovalin Shkurtaj dhe profesorët Mehmet Çeliku, Seit Mansaku, Shezai Rrokaj, Shefkije Islamaj, Enver Hysa, Isa Bajçinca, Imri Badallaj, Abdullah Zymberi, Bardh Rugova e Rrahman Paçarizi.

Në rendin e ditës për diskutim pati dy çështje:

1. Çështje të sintaksës në shqipen standarde.

2. Shqipja standarde dhe shkolla.

Për të dy çështjet u paraqitën parashtresat e hartuara nga grupet përkatëse të punës, në Tiranë e në Prishtinë, në të cilat shtroheshin vëzhgimet për gjendjen dhe propozimet për përmirësime të mëtejshme në përdorimin e zbatimin e shqipes standarde.

Këshilli arriti këto përfundime e propozime:

1. Meqë cikli nëntëvjeçar nuk po arrin dot t'ua mësojë mirë nxënësve të gjitha nënsistemet e shqipes standarde, si në të shkruar ashtu edhe në të folur, propozohet që gjuha shqipe në planin mësimor të shkollës së mesme të jetë lëndë e veçantë, e ndarë nga letërsia, dhe të jepet provim pjekurie në përfundim të shkollimit parauniversitar.

2. U miratua propozimi që në të gjitha shkollat e mesme të të gjitha profileve lënda e gjuhës të mësohet gjatë tri viteve, me një program të ri dhe me tekste të reja.

3. U mbështet propozimi që në vitet e para të ciklit nëntëvjeçar (cikli fillor) në mësimin e gjuhës shqipe t'i jepet përparësi anës praktike, zotërimit të standardit, bashkë me leximin; në vitet në vazhdim të ciklit nëntëvjeçar (klasa VI-IX) dhe në ciklin e shkollës së mesme gjuha të mësohet në aspektin teorik, por, krahas kësaj, t'u jepet rëndësi e veçantë leximit të letërsisë artistike dhe punëve me shkrim, hartimeve e diktimeve.

4. U arrit përfundimi që planet e programet në fakultetet e mësuesisë, përfshirë ato të gjuhëve të huaja e fakultetet që përgatisin edukatorë për institucionet parashkollore, si dhe në fakultetet e gazetarisë, ka nevojë të rishikohen, duke u dhënë shtrirje më të gjerë lëndëve kryesore të gjuhës së sotme, si leksikologjia, morfologjia, sintaksa. Mendohet që përvetësimi i drejtshkrimit duhet të përfundojë në shkollimin parauniversitar. U propozua

që lënda Kulturë gjuhe të përfshihet në programet e universiteteve, në radhë të parë në fakultetet e mësuesisë, të gazetarisë, të gjuhëve të huaja, të arteve, të drejtësisë, të mjekësisë etj., me synimin e zotërimit sa më të mirë të normës leksikore, gramatikore, stilistike e terminologjike në funksion të komunikimit sa më të plotë.

5. U pa e arsyeshme të kërkohet për t'u zbatuar nga institucionet përkatëse:

- rritja e orëve mësimore për lëndën e gjuhës në ciklet nëntëvjeçare;

- reduktimi i normës mësimore për mësuesit e gjuhës;

- mësimi i gjuhës shqipe në ciklet parauniversitare, nëpërmjet teksteve e mësuesve, sipas koncepteve teorike e terminologjike bashkëkohore;

- trajnimi i mësuesve të gjuhës në kurse periodike katërvjeçare;

- hartimi i teksteve për fëmijët e emigrantëve sipas një politike në ndihmë të emigracionit;

6. Përgatitja e gjuhës shqipe në universitete duhet të jetë përparësi e arsimit universitar, ndërsa mësimdhënës i lëndës së gjuhës dhe të letërsisë shqipe në nivelet e ulëta e të mesme nuk mund të jetë askush që nuk ka, së paku, 180 kredite (ECTS) të lëndëve profesionale sipas planprogrameve të shkollave përkatëse. Ndonëse nismat për përmirësimin e cilësisë në arsim kanë propozuar shtimin e komponentit didaktik, kujtojmë se kompetenca gjuhësore është parakushti themelor për mësimdhënie cilësore.

7. Albanologjia, me shqipen në veçanti, duhet të jetë përparësi e investimeve shkencore të qeverive përkatëse. Përqindje të konsiderueshme të investimeve për shkencë e kërkime shkencore duhet të jepen për projekte që lidhen me albanologjinë. Duhet të ngrihet departament i veçantë për gjuhën shqipe (përdorimet, terminologjitë, përshtatjet me standardet evropiane, ku po synojmë të integrohemi) në kuadër të ekzekutivit (mbase brenda Ministrive të Arsimit a të Kulturës).

8. Në shkolla t'i kushtohet vëmendje diversitetit kulturor e begatisë dialektore të shqipes, në mënyrë që të mos krijohet hapësirë për stigmatizim të cilitdo varieteti të shqipes.

MBLEDHJA PËRKUJTIMORE PËR AKADEMIK BESIM BOKSHIN

Më 16 gusht 2014 vdiq akademik Besim Bokshi. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës mbajti mbledhjen komemorative më 17 gusht.

Mbledhjen e hapi kryetari i Akademisë akademik Hivzi Islami i cili ndër të tjera tha:

‘’E nderuara familje Bokshi, Të nderuar kolegë dhe miq, Zonja dhe zotërinj,

Jemi mbledhur sot këtu, në mjediset e Akademisë, për t’i bërë nderimet e fundit anëtarit të rregullt të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe ish-kryetarit të saj, dijetarit dhe personalitetit që pati një rrugë të bujshme jetësore, intelektuale, shkencore-hulumtuese dhe publike, akademik Besim Bokshit.

Ju ftoj që me një minutë heshtje ta nderojmë bashkëshortin, prindin, gjyshin, mikun dhe kolegun tonë të dashur profesor Besim Bokshin. Akademik Bokshi bën pjesë në lagjen e personaliteteve më të shquara në fushën e shkencës, të arsimit dhe të kulturës shqiptare në Kosovë dhe jashtë saj këto 6 dhjetëvjetëshat e fundit, ku la gjurmë të pashlyeshme në jetën letrare-kulturore, kombëtare dhe intelektuale, në dijet albanologjike dhe veçanërisht në gjuhësinë shqiptare, duke u gjendur në majat e saj. Punën e tij e filloi në Gjakovën arsimdashëse dhe patriotike, ku në vitet e 50-ta e të 60-ta të shek. të kaluar ushtroi funksione të ndryshme në arsim dhe kulturë, për të arritur deri te bashkëpunëtori shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës, të cilit në fillimet e tij i dha mbështetje të fuqishme profesionale, pastaj u zgjodh profesor i Universitetit të Prishtinës dhe anëtar i rregullt i Akademisë dhe nënkryetar dhe kryetar i saj. U shqua dhe në afirmimin e vlerave kombëtare e kulturore-civilizuese të shqiptarëve dhe në organizimin e institucioneve shkencore, pedagogjike e kulturore të Kosovës. E deshi shumë Gjakovën, por edhe ajo e deshi dhe e respektoi shumë, duke ia akorduar çmimin qytetar i nderit të qytetit. Deri në minutën e fundit të jetës nuk pushoi të kontribuojë në fushën e shkencës së gjuhësisë dhe albanistikës në përgjithësi, duke zgjeruar opusin e tij shkencor me botime të reja. Për këtë dëshmon edhe dorëshkrimi që la të finalizuar, i cili këto ditë shkon në shtyp, gjithnjë në fushën e gjuhësisë shqiptare, por nuk pati jetë që ta priste daljen në dritë të tij. Vepra e tij shkencore në sferën e gjuhësisë do të mbetet pa dyshim burim reference për brezat e sotme dhe të nesërme. Pa akademik Bokshin nuk ka dyshim që gjuhësia dhe kultura shqiptare do të ishin më të varfra. Trashëgimia e ndritshme që la pas e bëjnë të pavdekshëm shkencëtarin dhe krijuesin, profesor Besim Bokshin.

Me këtë rast Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes së akademikut Besim Bokshi, si dhe të gjithë miqve dhe shokëve të tij të shumtë anë e mbanë Kosovës dhe trojeve shqiptare’’.

Për jetën dhe vdekjen e akademik Bokshit fjalë rasti mbajti akademik Rexhep Ismajli, nga e cila veçuam:

‘’I nderuar Z. Kryetar i Akademisë, Zonja Muhamedije, Astrit, Shkëndije, Ilir, familja Bokshi,m iq e kolegë të pikëlluar.

Dje pushoi së rrahuri zemra e dijetarit dhe poetit, e të urtit, studiuesit, vrojtuesit e këshilltarit të durimshëm, albanologut që gjithë jetën e tij kërkoi dhe gjeti shpjegime për mistere të fshehura në historinë e pashkruar të thesarit tonë më të madh të gjuhës, poetit që me dritën e mendjes përjetësonte e luçidonte qeniesimin tonë të përkohshëm, të vështirë e të mundimshëm, vinte çdoditë nga një gur në themelin e krenarisë sonë.

Me studimet që shënojnë majat e albanistikës, me krijimet e veçanta letrare poetike, me veprimtarinë intelektuale publike, me jetën e tij frymëgjatë arsimuese për brezat e shekullit që shoi robërinë, me punën e tij të themeltë shoqërore e politike, me angazhimet në Lëvizjen për pavarësi të vendit, Akademik Besim Bokshi shquhet në horizontet e dijeve, të kulturës dhe të botës shqiptare. I lindur në Gjakovë më 1930, i diplomuar në albanologji më 1958, i doktoruar në shkencat filologjike me specializim në fushë të historisë së gjuhës shqipe në Prishtinë më 1978, profesor dhe drejtor i gjimnazit në Gjakovë, profesor dhe Drejtor i SHLP në Gjakovë, profesor dhe Shef i Degës së Gjuhës Shqipe në FF/ F të UP-së, anëtar i AShAK-ut nga 1989, nënkryetar i AShAK 2002- 2008 dhe kryetar nga viti 2008-2011, pjesëmarrës aktiv dhe bashkëhartues i Konkluzave të Konsultës Gjuhësore të Prishtinës, pjesëmarrës i Kongresit të Drejtshkrimit, drejtues i Komisionit për Gjuhë i AShAK, anëtar i Këshillit Ndërakademik për Shqipen Standarde, akademik Besim Bokshi ishte i pranishëm në mënyrë të vazhdueshme, të qetë, por me veprim të themeltë, në jetën tonë plot të papritura, dhe ngado që sillej linte gjurmë të pashlyeshme kulturore, shkencore, arsimore e emancipuese shoqërore në botën shqiptare qysh nga vitet ’50 të sh. XX. Prania e tij në gjithë këtë gamë përpjekjesh të botës shqiptare në një histori tashmë të pikatur për rropatjet e turbulencat, do të mbetet e shënuar me ndihmesat thelbësore, me rezultatet që çojnë peshë, me orientimet ndriçimtare, me synimet për çlirimin nga vargojt e të gjitha llojeve. I dijshëm dhe i urtë, shembull korrektese ndaj tjetrit, vrojtues i thellë e me veprime të matura por të vendosura, deri në fund të përgjegjshme, Besim Bokshi ishte bërë një lloj shenje orientuese për ata që e rrethonin, për ata që ndjenin rrezet e dritës së mendjes së tij, për ata që mësuan prej tij, për ata që shijuan bukurinë dhe thellësinë e fjalës së tij, për ata që vlerësuan moralin dhe mësimin shembullor moral prej veprës dhe veprimtarisë së tij, për të gjithë ata që nga Gjakova e në tërë Kosovën, në hapësirat e dijeve e të jetës kërkonin horizonte të lirisë, të dinjitetit, të krijimit e të lumturisë njerëzore.

Në veprimtarinë e tij shoqërore Besim Bokshi ishte gjithnjë i lidhur me fushën e arsimit, ku shkëlqeu me aurën e tij prej të dijshmit, të thellit, të urtit kërkues të së drejtës e të barazisë, dhe pikërisht në bazë të një autoriteti të tillë vazhdimisht ishte kërkuar nga ai të angazhohej në funksione të ndryshme shoqërore, të jepte ndihmesën e tij për zgjerimin e horizonteve të lirisë nga deputeti i Kosovës në fund të viteve ’60 e deri te Kryetari i Partisë Socialdemokrate të Kosovës në vitet e rënda ’90.

Në letrat shqipe emri i Besim Bokshit shfaqet në vitet ’50 me poezitë me ngjeshje të madhe semantike e emocionale në tamën e poezisë refleksive e shoqërore, me vulën e protestës, me metaforikën e thellë e me simbolikën kombëtare, poezi që zhytet në thellësitë dhe degëzimet e simboleve, të kuptimeve. Në poezinë e Bokshit edhe tematizimet sociale marrin vulën e refleksionit, shprehen me një figuracion të kursyer, por të thellë. Jo rrallë në të gjejmë reflekse të thelluara me shprehje finoke të qëndrimeve, të distancave ndaj padrejtësisë, ndaj pabarazisë, ndaj shkeljeve të dinjiteti njerëzor, ndaj cënimit të lirisë, në pritje të së cilës edhe kur të plakem, siç thoshte ai në poezinë e bukur Në pritje, ‘e s’do të mundem me qeshë si flladi i pranverës’, “Me vdekë, porse, nga gëzimi do të mundem”.

Shkëlqimin madhor të mendjes krijuese akademik Besim Bokshi e shënoi në studimet për gjuhën shqipe, ku vlen ndër autoritetet më të mëdha. Me hulumtimet frymëgjata e të thelluara në fushën e linguistikës, në fushën e strukturës gramatikore të shqipes, me vrojtimet e rëndësishme për strukturat gramatikore të gjuhëve të Ballkanit, me akribinë shembullore shkencore, akademik Besim Bokshi ka sjellë kontribute me vlerë të jashtëzakonshme. Ndihmesat e tij për studimet e zhvillimeve gramatikore të shqipes zënë vend të veçantë për origjinalitetin e mënyrës së hulumtimit, për rezultatet e shumta, për thellimin krejt të veçantë, për vështrimin sistemor e struktural në këto studime, për orientimin e përgjithshëm të tyre drejt horizonteve të reja, për krijimin e një koncepti koherent dhe konsistent për rrugët e zhvillimeve morfologjike, në ndërlidhje me zhvillimet e tërësishme strukturore të shqipes. Duke i integruar studimet për strukturën gramatikore të shqipes në rrjedhat studimore të kohës, duke i shpënë ato ndjeshëm përpara dhe modernizuar në metodë, akademik Besim Bokshi e ka rritur kredibilitetin e studimeve albanistike shqiptare në komunitetin e studiuesve të gjuhës dhe ka krijuar një model për të ndjekur nga të rinjtë.

Po lejohem të shquaj me këtë rast për disa prej veprave të tij madhore. Në gjuhësinë shqiptare ai u shfaq më 1971 me studimin befasishëm të thellë për tipat e temave nominale në gjuhën shqipe.

Më 1978 Bokshi përfundoi monografinë Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes,vepër në të cilën dalin në shesh cilësitë kryesore të linguistit Bokshi: orientimi rezolut diakronik, por prandaj me vështrim të thelluar në funksionimin sinkronik

të sistemit gjuhësor. Në studimet e gramatikës historike të shqipes me atë vepër futeshin nëpër derë të madhe metodat gjuhësore mbisunduese të shekullit 20, ato që gjuhën e shihnin si sistem. Kjo monografi e Besim Bokshit mbetet një nga veprat me rëndësi themelore për studimet në fushën e gramatikës historike të shqipes në tërësi. Prapavendosja e nyjeve në gjuhët ballkanike është një libër tjetër me vlerë i Besim Bokshit për albanologjinë dhe për ballkanologjinë, vepër në të cilën hipoteza për ngjizjen e procesit të prapavendosjes së nyjës në gjuhët e Ballkanit ka nisur pikërisht në shqipen vjen e bëhet një teori e rëndësishme, refuzimi i së cilës tashmë nuk është gjë e lehtë.

Ai na ka dhënë një monografi të rëndësishme që na shpie drejt shpjegimeve edhe të sistemit foljor po me këto rrugë e procedime: monografinë Pjesorja e shqipes. Depërtime të ngjashme të Bokshit ndeshim dhe në monografinë me shumë interes Për vetorët e shqipes, ndërsa kërshëri të madhe zgjon libri i tij i fundit Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes, që paraqet një vepër sintetizuese për idetë dhe për periodizimet e propozuara deri tash mbi bazë të të dhënave vetëm gjuhësore. Me këtë libër Bokshi ka bërë dhe një hap tjetër me rëndësi, duke vënë kështu një rend që mund të nxisë ide të reja më tej. Akademik Besim Bokshi nuk reshti së studiuari deri në frymën e fundit të jetës së tij. Para pak javësh shkoi në shtyp vepra e tij më e re Varia, ku përfshihen diskutime për çështje të veçanta shkencore, por edhe për personalitete të dijes e të jetës shoqërore. Për fat të keq, ai nuk arriti ta shihte dritën e këtij botimi. Pak ditë më herët ai më fliste për një projekt të tij të ri studimi, për të cilin po punonte edhe në atë gjendje të rënduar me probleme shëndetësore. Horizontin e studimeve të tij gjuhësore akademik Besim Bokshi e kishte lidhur me nevojën për shpjegimet e zhvillimeve që kanë ndodhur në një gjuhë me lashtësi të madhe, por me dokumentim të vonë. Të kuptuarit e funksionimit të sotëm të kësaj gjuhe i jepte atij dritën e çelësit shpjegues për rrugët e atij zhvillimi. Dhe atë funksionim ai e kishte hetuar me tërë frymën dhe thellësinë e mendjes, gjë që shpesh, në mbisundimin e nevojës për shpjegimet diakronike, mbetej implicite, e nënkuptuar, e kërkueshme nga lexuesi, frymëzuese për atë që hyn në dialog me të. Dhe kjo u siguron veprës dhe ideve të tij jetëgjatësinë.

Në poezi, si në aforizma, në gjuhësi apo në jetë, Besim Bokshit i përshtatet thënia: për thelbësoren folë në mënyrë thelbësore. Me thellësinë, me refleksivitetin prej të urti, me vendosmërinë dhe guximin prej hulumtuesi të përkushtuar, me lirinë dhe dritën e mendjes, me afërsinë njerëzore, me butësinë dhe dashamirësinë e tij, me përmbajtjen e respektin ndaj tjetrit që rrezaton qetësi e siguri tek rrethi, akademik Bokshi ka bërë që mjedisi ku ka vepruar të ndjehet krenar që e ka pasur në shkollë, në Universitet, në Akademi, në institucione apo jashtë tyre, në rrethin e gjerë dhe në horizontet e jetës. Për familjen dhe rrethin e të afërmeve shuarja e të dashurit është e rëndë, ndërsa për kulturën, dijen dhe botën shqiptare e pakompensueshme. Ngushëllimin duhet ta gjejmë në veprën që na ka lënë, në dritën e mendjes që do të vijojë të na ndriçojë''.

Pas mbledhjes komemorative u bënë homazhe të shumta pranë trupit të të ndjerit dhe më pas kortezhi funeral u nis për në varrezat e Gjakovës.

Pranë varrit të akademik Bokshit në praninë e shumë strukturave udhëheqëse, qytetarëve të Gjakovës dhe më gjerë folën: akdemik Pajazit Nushi, në emër të AShAK, përfaqësues nga ASHSH dhe Kryetari i Asamblesë komunale të Gjakovës.

KONFERENCË SHKENCORE

Lufta e Parë Botërore dhe Çështja Shqiptare 1914-1918.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Seksioni i Shkencave Shoqërore, organizoi Konferencën shkencore "Lufta e Parë Botërore dhe çështja shqiptare 1914-1918". Konferenca u mbajt të premten, më 19 shtator 2013, me fillim në orën 10:00, në mjediset e Akademisë. Konferencën e shpalli të hapur me një fjalë rasti akademik Pajazit Nushi. Anëtarë të Këshillit Organizues ishin Jusuf Bajraktari, Beqir Meta, Fehmi Rexhepi, Marenglen Verli, Frashër Demaj, Lush Culaj.

Me kumtesat e tyre në konferencë u paraqitën:

1. Beqir META, Ndikimi i Luftës së Parë Botërore në procesin e konsolidimit të kombit shqiptar.

2. Jusuf BAJRAKTARI, Kosova dhe viset tjera shqiptare gjatë Luftës së Parë Botërore.

3. Marenglen VERLI, Shqipëria në optikën e diplomacisë vjeneze në prag të Luftës së Parë Botërore.

4. Anton PANÇEV, Statistikat bullgare mbi popullsinë e Kosovës në Luftën e Parë Botërore.

5. Skender ASANI, Viset lindore shqiptare nën okupimin serb 1912-1915.

6. Fehmi REXHEPI, Zona okupuese bullgare gjatë Luftës së Parë Botërore në Kosovë.

7. Frashër DEMAJ, Diplomacia e Fuqive të Mëdha gjatë Luftës së Parë Botërore.

8. Isa BICAJ, Mali i Zi dhe shqiptarët gjatë Luftës së Parë Botërore.

9. Islam LAUKA, Lufta e Parë Botërore dhe konflikti aktual Rusi-Ukrainë.

10. Teki KURTI, Shtypi shqiptar për Luftën e Parë Botërore.

11. Ramë MANAJ, Lënda arkivore për Luftën e Parë Botërore në Arkivin e Kosovës.

12. Lush CULAJ, Protestat e shqiptarëve dërguar Konferencës së Versajës.

Fjalën përmbyllëse e mbaji anëtar korrespondent Jusuf Bajraktari.

TRYEZË SHKENCORE

‘’UJITJA NË KOSOVË- Menaxhimi i ujërave për bujqësi të qëndrueshme’’.

Seksioni i Shkencave të Natyrës i AShAK-ut organizoi më 16 tetor 2014 tryezën shkencore ‘’Ujitja në Kosovë- Menaxhim i ujërave për bujqësi të qëndrueshme’’. Anëtarë të Këshillit Organizues ishin Ruzhdi Pllana, anëtar korrespondent i AShAK-ut, Feriz Krasniqi, akademik, dhe prof. dr. Bashkim Kabashi. Fjala hyrëse u mbajt nga akademik Fejzullah Krasniqi ndërsa fjala përshëndetëse nga Ruzhdi Pllana, anëtar korrespondent i

AShAK-ut. Tryeza u zhvillua në dy sesione gjatë të cilave u paraqitën kumtesat e pjesëmarrësve si dhe u zhvilluan diskutime pas secilit sesion. Kumtesat u lexuan nga këta pjesëmarrës: Bashkim Kabashi, Ruzhdi Pllana, Mazllum Baraliu, Besnik Gjongecaj, Latif Susuri,Sylejman Daka, Shukri Fetahu, Sali Aliu, Justina Boriqi, Besim Sahiti, Lavdim Lepaja, Demë Abazi dhe Sami Kryeziu. Disa nga kumtesat ishin kumtesa të përbashkëta. Në fund pjesëmarrësit u pajtuan që të dalin me konkluzione të përbashkëta rreth tryezës shkencore.

TRYEZË SHKENCORE ‘’Në 200-vjetorin e lindjes së Jeronim De Radës”.

Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i AShAK-ut më 21 nëntor 2014 organizoi, tryezën shkencore ‘Në 200-vjetorin e lindjes së Jeronim De Radës’. Fjala hyrëse u mbajt nga akademik Mehmet Kraja ndërsa tryezua u moderua nga akademik Ali Aliu. Tryeza u mbajt sipas programit të paraparë prej dy seancash gjatë të cilave u lexuan kumtesat e të ftuarve. Në tryezë morën pjesë të gjithë të ftuarit. Në kuadër të seancës së parë u paraqitën me kumtesa pjesëmarrësit si në vijim: Ali Aliu, Françesko Altimari, Floresha Dado, Sabri Hamiti, Pajazit Nushi, Dhurata Shehri, Luan Starova dhe Alfred Uçi. Pushimi i shkurtër për kafe u shfrytëzua për promovimin e veprës së Françesko Altimarit ‘’Arbërishtja në kontekstin gjuhësor ballkanik dhe italian’’ e cila u mirëprit nga pjesëmarrit si një kontribut i çmuar në këtë lëmi. Pjesëmarrësit që u paraqitën me kumtesa në seancën e dytë ishin: Mateo Mandala, Ymer Çiraku, Zejnullah Rrahmani, Ardian Marashi, Fatmir Sulejmani, Mark Marku, Kujtim Shala dhe Mehmet Kraja. Kjo tryezë u vlerësua të jetë edhe një hap më tutje në trajtimin e veprës së Jeronim De Radës nga aspekte të ndryshme socio-linguistike, estetike etj.

AKADEMIKËT IDRIZ AJETI, MARK KRASNIQI dhe ALI ALIU "Nderi i Kombit"

Presidenti i Republikës së Shqipërisë z. Bujar Nishani dekoroi me çmimin "Nderi i Kombit" akademikët Idriz Ajetin, Mark Krasniqin dhe Ali Aliun.

REAGIM I AShAK

Deklaratë e AShAK përkitazi me ngjarjet e fundit në UP

Udhëheqja e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës po i ndjek me vëmendje zhvillimet në Universitetin e Prishtinës dhe rreth tij. Tensionimet e fundit kanë marrë përmasa shqetësuese.

E tërë kjo situatë tendosjeje në UP ndërlidhet me praktikat e gjata të ndërhyrjeve të ndryshme, të drejtpërdrejta a të tërthorta, nga jashtë në punën e këtij institucioni të pavarur. Pasojat e një gjendjeje të atillë, bashkë me ritmet e paharmonizuara të zhvillimeve e sollën UP-në në një gjendje të vështirë, me rreziqe për proceset e ligjshmërisë në funksionimin e tij.

Zgjedhja e Rektorit të ri – profesor dr. Ramadan Zejnullahut dhe veprimet e tij në drejtim të respektimit të ligjshmërisë dhe të stabilizimit të gjendjes të përcjellë me

çrregullime për vite të tëra janë një shpresë për zhvillime të reja në drejtim pozitiv në këtë institucion të rëndësishëm arsimor-shkencor të Kosovës dhe të rajonit. Duke e njohur dhe punën e tij të mëhershme si profesor i UP-së, si shkencëtar dhe si Dekan shumë i suksesshëm i Fakultetit të Shkencave, duke i vlerësuar nismat që ka ndërmarrë dhe maturinë e vendosmërinë që e karakterizojnë punën e tij, shprehim publikisht mbështetjen për angazhimet e tilla brenda UP-së dhe kërkojmë nga institucionet që të gjejnë rrugë për zhbllokimin e nismave të tij gjithsesi pozitive.

Jemi të ndjeshëm dhe për kërkesat dhe nevojat e shtresave të ndryshme të popullsisë, sidomos të pasardhësve të pjesëmarrësve të UÇK-së në luftën e viteve 1998-99, por besojmë se shoqëria dhe institucionet munden dhe duhet të gjejnë rrugë për mbështetjen e tyre duke krijuar rrethana për respektimin e ligjshmërisë dhe të pavarësisë institucionale të Universitetit të Prishtinës, ashtu si të të gjitha institucioneve të tilla në vend. Ligjshmëria dhe puna e përgjegjshme institucionale në UP janë thelbësore dhe vetëm respektimi i plotë i tyre mund të krijojë rrethana edhe për mbrojtjen e interesave të shtresave të ndryshme dhe të tërë Kosovës.

Në historinë e këtij vendi UP ka luajtur rol shumë të rëndësishëm. Prekja e themeleve të tij, që është të qenit institucion i pavarur i arsimit dhe shkencës, vatër e dijes dhe e emancipimit të përgjithshëm të Kosovës dhe të rajonit, mund të lërë pasoja që nuk merren me mend në zhvillimet e mëtejme. Prandaj bëjmë apel tek institucionet e shtetit që të ndërmarrin çdo gjë për të krijuar rrethana sa më të përshtatshme infrasturkturore, po edhe në fushën e burimeve njerëzore e profesionale-shkencore, në mënyrë që UP-ja të jetë në gjendje t'i zgjidhë vetë dhe në mënyrë të pavarur kërkesat e rritura gjithë duke e ngritur cilësinë. Ndërhyrjet nga jashtë, tensionimet si këto të fundit dhe kërcënimet ndaj Rektorit që po bën përpjekje serioze për stabilizimin e gjendjes vetëm sa e thellojnë krizën në këtë institucion vital edhe për funksionimet e tjera në vend. Kërkojmë nga të gjithë të jemi të matur dhe të përgjegjshëm në vlerësime, ndërhyrje e nxitje dhe të shquajmë atë që është thelbësore për interesat e UP-së dhe të vendit.

EKSPOZITË & MBRËMJE MUZIKORE-POETIKE

Seksioni i Arteve i AShAK-ut organizoi më 5 dhjetor 2014, një ''Ekspozitë & Mbrëmje Muzikore-Poetike'' në kuadër të shënimit të 80-vjetorit të lindjes së muzikologut Engjëll Berisha dhe piktorit Xhevdet Xhafa. Mbrëmja muzikore-poetike u hap nga akademik Zeqirja Ballata. Akademik Rexhep Ferri mbajti fjalën e rastit për piktorin Xhevdet Xhafa ndërsa akademik Zeqirja Ballata mbajti fjalën e rastit për muzikologun Engjëll Berisha. Aktori i njohur Çun Lajqi recitoi vargje poetike ndërsa pjesa muzikore përfshiu interpretimet e sopranos Sanije Matoshi, përcjellë në piano nga Lirika Pula Kasapolli. Mbrëmja muzikore-poetike u mbyll nga akademik Zeqirja Ballata.

AKADEMIK NEXHAT DACI – anëtar i Akademisë Evropiane të Shkencave dhe të Arteve të Europës (ASAE)

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Europës (ASAE), me seli në Salcburg të Austrisë, ka konfirmuar këto ditë zgjedhjen në radhët e saj të akademik Nexhat Dacit. Në adresë të Akademisë dhe të prof. Dacit, ekspert i njohur në fushën e shkencave kimike, anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ka ardhur letra zyrtare me të cilën njoftohen se është zgjedhur anëtar i rregullt i kësaj Akademie në mbledhjen e Komitetit të Nominimit, të mbajtur në nëntor të këtij viti. Inaugurimi solemn i Akademik Nexhat Dacit do të bëhet në Asamblenë e përgjithshme, që do të mbahet më 8 mars 2015, në Salcburg. Me këtë dëshmohen edhe një herë meritat që u bëhen shkencëtarëve nga Kosova në suaza ndërkombëtare.

AShAK NDEROHET ME MIRËNJOHJE NGA BIBLIOTEKA NDËRKOMUNALE E PRIZRENIT

Më 22 dhjetor 2014, në Prizren në një ceremoni solemne AShAK nderohet me *Mirënjohje për bashkëpunim në pasurimin e fondit librar*. Nga AShAK në ceremoni morën pjesë anëtarja korrespondente Edi Shukriu dhe znj. Lendita Juniku Pula, sekretare e AShAK. Mirënjohjen në emër të AShAK e mori znj. Pula, e cila me këtë rast përshëndeti të pranishmit me një fjalë rasti.

MBAHET MBLEDHJA E KUVENDIT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJEN E KRYESISË SË AKADEMISË

Më 24 dhjetor, në sallën e Akademisë u mbajt mbledhja e Kuvendit zgjedhor të Akademisë, për zgjedhjen e Kryesisë së re të saj. Kuvendi zgjodhi Kryesinë e re me këtë përbërje:

Akademik Hivzi islami, kryetar, akademik Pajazit Nushi, nënkryetar, akademik Isuf Krasniqi, sekretar i përgjithshëm, akademik Eqrem Basha, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, anëtar korrespondent Jusuf Bajraktari, sekretar i seksionit të Shkencave Shoqërore, akademik Fejzullah Krasniqi, sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës dhe anëtar korrespondent Luan Mulliqi, sekretar i Seksionit të Arteve.

PËRMBAJTJA

NË 200-VJETORIN E LINDJES SË JERONIM DE RADËS 5

Ali ALIU, VIZIONI TESTAMENTAR I JERONIM DE RADËS TE PARIME TË ESTETIKËS 9

Francesco ALTIMARI, MBI STRUKTURËN E DYFISHTË TË POEMËS *KËNGËT E MILLOSAUT*: NJË PËRPJEKJE PËR NJË PËRQASJE TË RE NË INTERPRETIMIN E POEMËS SË JERONIM DE RADËS 15

Floresha DADO, DE RADA I PAPËRFUNDUAR 25

Sabri HAMITI, JERONIM DE RADA: MILOSAO, 1836 31

Pajazit NUSHI, NDJENJAT ESTETIKE NË VEPRËN E JERONIM DE RADËS *PARIME TË ESTETIKËS* DHE NË VEPRËN E UILIAM XHEJMSIT *PARIME TË PSIKOLOGJISË* 47

Dhurata SHEHRI, KËNGËT E MILOSAUT, KRIJIMI I SUBJEKTIT LIRIK 69

Luan STAROVA, JERONIM DE RADA - FAIK KONICA: DIKOTOMIA E IDENTITETIT SHQIPTAR 77

Alfred UÇI, JERONIM DE RADA PËRBALLË RILINDJES KOMBETARE 85

Matteo MANDALÀ, JERONIM DE RADA DHE ARBËRESHËT E SICILISË 91

Ymer ÇIRAKU, QASJE RIVLERËSIMI RRETH OPUSIT KRITIK MBI VEPRËN DERADIANE 113

Zejnullah RRAHMANI, JERONIM DE RADA: ESTETIKA SI TEORIE ARTIT ROMANTIK 119

Ardian MARASHI, VENDI I MILOSAOS NË ROMANTIZMIN EVROPIAN 127

Fatmir SULEJMANI, JERONIM DE RADA - THYES KONVENCASH ROMANTIKE 137

Mark MARKU, NARRATIVA E DE RADËS: NGA NARRATIVA PERSONALE TEK METANARRATIVA 145

Kujtim M. SHALA, MËSIMET E DE RADËS E KURORA E POETIT 151

Mehmet KRAJA, PAS NJË RILEXIMI TË RAPSODIVE… TË DE RADËS 157

STUDIME, ARTIKUJ/ PAPERS 161

Shaban SINANI, ALFABETET SI KUFI: KUR DHE SI U SHTHURËN QARQET 163

Ali ALIU, VIZION SHUMËSHTRESOR KOMUNIKIMI 193

Kujtim M. SHALA, DISKURSET E KRIST MALOKIT 201

Besim BOKSHI, FORMAT E FUTURIT TË SHQIPES NË PËRQASJE ME ATO TË GJUHËVE BALLKANIKE 213

Bardhyl DEMIRAJ, ALBANIEN UND DIE ALBANER AM ÖSTERREICHISCH-UNGARISCHEN KAISERHOF – EIN ERSTER FALL DER VERFLECHTUNG VON WISSENSCHAFT UND POLITIK 223

Victor A. FRIEDMAN, WYSIWYG: PRIRJET E NDRYSHIMET MORFOSINTAKSORE DHE SINTAKSORE NË GJUHËN SHQIPE 239

Levente NAGY, UN STUDIOSO UNGHERESE DI ALBANOLOGIA: LAJOS TAMÁS 249

Bardh RUGOVA, PËRFAQËSIMI FOLËS: RASTI I MBIEMRAVE TË SHQIPES 263

Rexhep ISMAJLI, DYNAMIQUE DES STRUCTURES DE L'ALBANAIS STANDARD 275

Skënder GASHI, NJË KOLONI-OAZË E HERSHME SERBE NË RRAFSH TË KOSOVËS 293

Teuta ABRASHI, LIDHJA KRYEFJALË-KALLËZUES: PËRSHTATJE, DREJTIM APO TË DYJA? 325

Linditë SEJDIU-RUGOVA, STRUKTURAT DETERMINATIVE TË SHQIPES – ANALIZË PRAGMATIKE E NYJES SË SHQUAR DHE ÇËSHTJE TË TERMINOLOGJISË SINTAKSORE NË SHQIPEN 341

Mehmet HALIMI, KONTRIBUTI I AKADEMIK IDRIZ AJETIT NË FUSHËN E STUDIMEVE DIALEKTOLOGJIKE 355

IN MEMORIAM 367
AKADEMIK BESIM BOKSHI (R. Ismajli) 369
SHËNIME BIOGRAFIKE PËR AKADEMIK BESIM BOKSHIN..... 374
BIBLIOGRAFI E BOTIMEVE TË AKADEMIK B. BOKSHIT..... 376
AKADEMIK SHABAN DEMIRAJ (S. Mansaku)..... 379
NË KUJTIM TË AKADEMIK SH. DEMIRAJT (R. Ismajli)..... 380
Shaban DEMIRAJ, DISA TË DHËNA NGA JETA IME..... 383
BIBLIOGRAFI E BOTIMEVE TË AKADEMIK SH. DEMIRAJT..... 400

KRITIKA/ RECENSIONE 419
Eqrem ÇABEJ: Studime etimologjike në fushë të shqipes (B. Demiraj) 421
Shaban DEMIRAJ: Gjuha shqipe dhe historia e saj (E. Paci)..... 427
Gjovalin SHKURTAJ, Dialektet e shqipe, Tiparet e përbashkëta dhe dallimet dialektore, sipas hartave të ADGJSH-së. Të folmet shqipe të diasporës (shkurtore për sistemin Bachelor) (B. Beci) 433
Kujtim SHALA: Portret semiologu në rini (B. Rugova)..... 445
Besim BOKSHI: VARIA (R. Ismajli)..... 447
Skënder BLAKAJ e Ismail ISMAILI: Letërkëmbime të Rilindjes Kombëtare Shqiptare (R. Ismajli) 449
Engjëll ANGONI, BIBLIOGRAFI PËR VEPRËN E SELMAN RIZËS (1909–1988) 451
Lendita JUNIKU-PULA, KRONIKA/2014 471

STUDIME

21

2014

Botues
AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:
Mr. Shefqet Riza

Rezymetë anglisht i përktheu:
Hilmi Zogjani e Xhemshit Brajshori

Redaktor teknik:
ASHAK

Realizimi kompjuterik:
ASHAK

Madhësia:
30.75 tabakë shtypi

Tirazhi:
200 copë

Formati:
16x24 cm

U shtyp në shtypshkronjën:
Focus Print
Shkup